

ENVER HOXHA

VEPRA

19

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANE KQ TE PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

19

QERSHOR 1960 – DHJETOR 1960

**SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1975**

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 19-të

Në serinë e Veprave të shokut Enver Hoxha dokumentet e këtij vëllimi zënë një vend të posaçëm. Këto dokumente, shumica e të cilave botohen për herë të parë, i përkasin periudhës qershor-dhjetor 1960. Kjo është një kohë tepër e ndërlikuar, kur në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe në marrëdhëniet midis disa partive kishin lindur mosmarrëveshje të thella ideologjike dhe politike. Në këtë periudhë, Partisë sonë iu desh të merrte vendime me përgjegjësi të veçantë dhe të ngrihej hapur para tërë lëvizjes komuniste ndërkombëtare, për të mbrojtur marksizëm-leninizmin nga rryma e re dhe e rrezikshme revizioniste, që po kristalizohej në gjirin e saj, revizionizmi hrushovian.

Vendin kryesor në këtë vëllim e zënë dokumente, në të cilat është përpunuar vija strategjike dhe taktike e PPSH kundër përhapjes së revizionizmit modern dhe sidomos kundër veprimtarisë përçarëse antimarksiste të udhëheqjes sovjetike me Hrushovin në krye. Deri atëherë PPSH ia kishte bërë të njohur udhëheqjes sovjetike kundërshtimet dhe rezervat e veta për një varg tezash dhe veprimesh të padrejta të saj. Por faktet dëshmonin se grupi i Hrushovit vazhdonte të ecte me këmbëngulje në një rrugë të shtrembër e plot rreziqe

për lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, gjë që e tregoi me qartësi të veçantë prapaskena e organizuar prej tij në Mbledhjen e Bukureshtit. Në këto rrethana bëhej e domosdoshme që vija dhe qëndrimet antimarksiste të udhëheqjes sovjetike t'i nënshtroheshin një kritike të hapur e të guximshme përpara të gjitha partive komuniste e punëtore.

Në këtë vëllim jepet një tablo e qartë e luftës konsekuente që ka zhvilluar Partia e Punës e Shqipërisë në Mbledhjen e Bukureshtit e në Mbledhjen e Moskës. Në Bukuresht PPSH nuk pranoi të gjykohen të ashtuquajturat gabime të Partisë Komuniste të Kinës dhe as të dënohej ajo në bazë të materialit plot akuza shpifëse që kishte fabrikuar udhëheqja sovjetike, pa i dhënë PK të Kinës kohë dhe mundësi që ta lexonte këtë material dhe të paraqiste pikëpamjen e saj. Në Mbledhjen e Moskës Partia jonë me guxim revolucionar tha fjalën e saj dhe, përballë komunizmit ndërkombëtar, kritikoi hapur vijën e shtrembër të udhëheqjes sovjetike për një varg çështjesh të mëdha parimore. PPSH nuk bëri asnjëherë lëshime në parime dhe nuk pranoi të ndiqte kursin revizionist të grupit të Hrushovit. Dëshmi e gjallë janë një radhë dokumentesh që botohen në këtë vëllim, si raporte, fjalime, diskutime e biseda. Botohen gjithashtu edhe një numër radiogramesh e letrash, që janë dërguar nga Tirana në Bukuresht e në Moskë, në Pekin e në Nju-Jork dhe që çonin atje direktivën e PPSH, vijën revolucionare të saj. Firma «Shpati» që mbajnë disa nga këto radiograme të kujton vitet e stuhishme të Luftës Nacionalçlirimtare.

Lufta ideologjike midis PPSH dhe udhëheqjes sovjetike u bë më e ashpër pas Mbledhjes së Bukureshtit,

kur grupi i Hrushovit u hodh në sulm të rreptë kundër PPSH, për ta gjuhëzuar e për ta detyruar atë të ndiqte vijën revizioniste. Dy metoda kryesore përdori në fillim grupi i Hrushovit: kërcënimet dhe demagogjinë. Por nuk qëndroi pa vepruar edhe me anë të ambasadës sovjetike në Tiranë, e cila zhvillonte një punë armiqësore e diversioniste kundër PPSH dhe udhëheqjes së saj. Udhëheqja sovjetike hrushoviane u përpoq «për të marrë kalanë nga brenda». Për këtë qëllim ajo përpunoi dhe vuri në shërbim të saj Liri Belishovën e Koço Tashkon. Pikëpanjjet dhe qëndrimet e këtyre dy armiqve ishin në opozicion të hapur me vijën e drejtë që ndiqte Partia jonë ndaj udhëheqjes sovjetike me Hrushovin në krye. Prandaj përpjekjet e tyre për të revizionuar vijën e Partisë sonë dështuan. Materialet e këtij vëllimi nxjerrin në pah jo vetëm veprimtarinë e armiqve të jashtëm, por edhe atë të armiqve të brendshëm, luftën klasore që ka zhvilluar PPSH kundër tyre për të mbrojtur unitetin e saj të çeliktë, vijën e saj të kristaltë, pastërtinë e marksizëm-leninizmit.

Veprat që përmban ky vëllim pasqyrojnë luftën e Partisë së Punës për kalitjen ideologjike dhe për forcimin organizativ të saj. Vëllimi përmban raporte, fjalime e diskutime të shokut Enver Hoxha mbajtur në katër plenumet e Komitetit Qendror, që u zhvilluan në gjysmën e dytë të vitit 1960, si dhe letra drejtuar organizatave-bazë të Partisë. Ka edhe një numër diskutimesh në Byronë Politike e në Sekretariatit e Komitetit Qendror. Në këto materiale trajtohen probleme që kanë të bëjnë me rritjen e rolit udhëheqës të Partisë, me forcimin gjithnjë e më shumë të diktaturës së proletariatit, me

çelikosjen e mëtejshme të unitetit të popullit rreth Partisë, me edukimin revolucionar, vigjilencën politiko-ideologjike, gatishmërinë luftarake për të mbrojtur atdheun etj. Koha kërkonte gjallërimin e mëtejshëm të punës së Partisë, revolucionarizimin e pareshtur të saj.

Në shkrimet e këtij vëllimi duket qartë fryma e lartë e patriotizmit të popullit tonë për të mbyllur me sukses planin e dytë pesëvjeçar, për të përballuar presionet ekonomike të grupit të Hrushovit, që kishin filluar të dukeshin dhe që në të ardhshmen do të ishin më të mëdha. Nën udhëheqjen e Partisë, në sektorët ekonomikë, kulturorë e shoqërorë u arritën suksese të rëndësishme.

Komiteti Qendror dhe shoku Enver Hoxha bënë thirrje për një mobilizim të ri e të fuqishëm nga të gjithë punonjësit me komunistët në krye. Kështu, në këtë vëllim botohen një radhë materialesh që kanë të bëjnë me direktivat për pesëvjeçarin e tretë, me naftën, me riorganizimin e shkollës, me qarkullimin e monedhës, me lëvizjen për shpikje e për racionalizime, me mirëmbajtjen e banesave etj. Të gjitha këto përbëjnë një përvojë të madhe të punës së Partisë për t'i parë problemet kurdoherë me syrin politik.

Mësimet që rrjedhin prej dokumenteve të këtij vëllimi janë të mëdha. Ato na armatosin më tej në luftë për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e interesave të larta të atdheut e të popullit tonë, kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm. Veprat e vëllimit të 19-të përbëjnë një fond të pasur në teorinë dhe në praktikën revolucionare të Partisë sonë, në thesarin e madh të marksizëm-leninizmit.

RADIOGRAM

SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT¹

21 qershor 1960

Ora 11.^{30'}

VETËM SHOKUT HYSNI

Nga radiogramet e tua shohim se gjendja po rrokulliset në rrugë të gabuar, prandaj paraqitet shumë delikate.

Bëj shumë kujdes. Lëru të kuptojnë se ti do të marrësh pjesë vetëm në mbledhjen që kemi vendosur së toku, ku do të jenë vetëm partitë e kampit të socializmit, *për të caktuar datën dhe vendin e mbledhjes së ardhshme* më të gjerë të partive komuniste e punëtore. Na mbaj në korent. Na lajmëro ekzaktërisht kur do të bëhet mbledhja.

Përqafime

E n v e r

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Në atë kohë kryetar i delegacionit të PPSH në Kongresin III të Partisë Punëtore të Rumanisë dhe në Mbledhjen e partive komuniste e punëtore në Bukuresht.

TË NDJEKIM SI KURDOHERË NJË VIJË TË DREJTË

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

22 qershor 1960

Çështja për të cilën do të bisedojmë sot ka të bëjë me Mbledhjen e Bukureshtit. Siç kemi vendosur, ne dërguam në Rumani një delegacion partie, të kryesuar nga shoku Hysni Kapo për të marrë pjesë në punimet e Kongresit III të Partisë Punëtore të Rumanisë. Ne e kishim parashikuar që atje do të shkonin me këtë rast në krye të delegacioneve të partive sekretarët e parë ose një pjesë e tyre, por për shumë arsye që ne i dimë, gjykuam që unë të mos shkoja. Delegacioni ynë u autorizua gjithashtu që, përveç pjesëmarrjes në punimet e Kongresit të Partisë Punëtore të Rumanisë, të merrte pjesë edhe në Mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të kampit socialist, për të caktuar, sipas marrëveshjes së arritur, vendin dhe datën e një mbledhjeje të të gjitha partive, ku do të diskutohet, midis të tjerash, edhe për mosmarrëveshjet që

ekzistojnë në mes Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës.

S'ka dyshim se këto mosmarrëveshje duhen zgjidhur sa më parë e në rrugën marksiste-leniniste, në radhë të parë në mes Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës dhe, në rast se nuk do të zgjidhen dot midis tyre, atëherë të jepen tezat për një diskutim në mes partive, ku të thonë fjalën e vet përfaqësuesit e partive komuniste dhe punëtorë dhe mosmarrëveshjet të zgjidhen në rrugën e drejtë.

Mirëpo udhëheqësit sovjetikë në Bukuresht po bëjnë përpjekje që të flitet që tash për këto mosmarrëveshje. Në radiogramin që na dërgon shoku Hysni thotë se, meqë Mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtorë u shty, ata propozojnë të zhvillohet një takim me përfaqësuesit e të gjitha partive, që ndodhen atje, ku të shtrohen mosmarrëveshjet që ka Bashkimi Sovjetik me Kinën, natyrisht në atë drejtim siç mendon Bashkimi Sovjetik. Sipas Hrushovit, në këtë takim mund të merren edhe vendime dhe të gjitha partitë të shfaqin pikëpamjet e tyre, të solidarizohen me Bashkimin Sovjetik dhe me Deklaratën e Mbledhjes së Moskës të vitit 1957 që, siç thotë Hrushovi, «shokët kinezë nuk po i përmbahen!». Të gjitha këto po bëhen duke biseduar dhe duke përpunuar delegacionet njëri pas tjetrit, me qëllim që pastaj t'i thuhet delegacionit të Partisë Komuniste të Kinës nëse do të mbetet në kampin socialist apo jo. Thonë se kjo mbledhje nuk është për të izoluar Kinën, po bëhet që «të informohemi, të mbajmë qëndrim të përbashkët».

Unë mendoj se vendimi që kemi marrë¹ ne është i drejtë. Ne nuk duhet të dëgjojmë vetëm ç'thonë sovjetikët, por ç'thonë edhe kinzët, pastaj të diskutojmë dhe të themi fjalën tonë. Prandaj shtrohet çështja: Çfarë qëndrimi do të mbajë delegacioni ynë në këtë mbledhje të kurdisur nga sovjetikët, me Hrushovin në krye?

Atje po na bëhen mjaft provokacione, të cilave Hysniu u ka qëndruar fort, por ai ka nevojë të ndihmohet e të udhëzohet më tej, sepse ndodhet para një varg vështirësish, presionesh e provokacionesh nga më të ndryshmet.

Ne, si kurdoherë, duhet të ndjekim një vijë të drejtë, sepse kemi përgjegjësi të madhe para popullit tonë. Ne jemi parti marksiste-leniniste dhe na përket që në çdo ngjarje të mbajmë qëndrim marksist-leninist. Jeta ka treguar se asnjëherë s'jemi lëkundur, prandaj as tani s'ka top që të na tundë nga vija e drejtë që ndjek Partia jonë. Në mendimet e në qëndrimet tona ndaj revizionistëve jugosllavë, jeta ka treguar se nuk kemi gabuar, ato kanë qenë të drejta. Në qoftë se Hrushovi me shokë kanë mbajtur një qëndrim tjetër, duke mos luftuar kundër revizionistëve jugosllavë, kjo është puna e tyre, ata kështu e gyykojnë, po edhe ne kemi të drejtë t'ua themi mendimin tonë. Ne e kemi mbështetur Deklaratën e Mbledhjes së Moskës të vitit 1957 jo vetëm për çështjen jugosllave, por edhe për çështje

¹ Është fjala lidhur me pjesëmarrjen në Mbledhjen e partive të kampit socialist në Bukuresht për të caktoar vendin dhe datën e një mbledhjeje të ardhshme më të gjerë të partive komuniste e punëtores.

të tjera, siç janë: uniteti i kampit socialist, bashkekzistenca paqësore etj. Por, nga ana tjetër, për mjaft çështje që janë përfshirë në të, ne kemi pasur rezervat tona që ua kemi thënë sovjetikëve ose kemi mbajtur qëndrim në shtypin e në propagandën e Partisë. Ne jemi për bashkekzistencën paqësore, por ashtu siç e konceptonte Lenini, jo për ta shtrirë atë në fushën e ideologjisë, pse kjo është tepër e rrezikshme. Përsa i përket çarmatimit, është provuar nga jeta se imperializmi nuk çarmatoset, përkundrazi ai armatoset gjithnjë e më tepër. Atëherë si të çarmatosemi ne? Përkundrazi, ne duhet të jemi vigjilentë. Dhe kështu jemi dhe kemi bërë mirë. Në bazë të vijës që ka ndjekur Partia jonë, populli e gjithë komunistët janë gati të ngrihen në këmbë kundër çdo rreziku agresioni. Ka disa gjëra që ne mund t'ua themi sovjetikëve se nuk janë në rregull, mund t'u themi, për shembull, që nuk jemi dakord me ju, që nuk i demaskoni gjer në fund revizionistët jugosllavë. Po kështu, po të kemi gjë edhe për të tjerët, do t'ua themi hapur dhe me frymë shoqërore, në rrugë marksiste. Prandaj për këto gjëra ne duhet të përgatitemi dhe të shkojmë në Mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtoresh për të thënë fjalën tonë. Në këto gjëra duhet mbajtur qëndrim i qartë e i palëkundur marksist-leninist nga të gjithë dhe të mos lejohet të bëhen provokacione nga njëri ose tjetri.

Tani, po të dëshironi, mund të lexojmë radiogramin që ka dërguar shoku Hysni.

Pasi lexohet radiogrami që ka dërguar shoku Hysni Kapo, e merr fjalën përsëri shoku Enver Hoxha.

Me të arritur shoku Gogo [Nushi] në Moskë, e thirri

Brezhnjevi. Pasi e pyeti si jeni e si shkoni, i tha tezat e tyre për kinezët. Po kështu edhe kur vajti shoku Mehmet [Shehu] në Moskë i shkoi Kosigini dhe i foli një orë e gjysmë për këto çështje. Shoku Mehmet iu përgjigj duke i thënë se «kur qenkan kështu këto gjëra, pse janë lënë të trashen, gjersa ka qenë e mundur që ato të zgjidhen në rrugën marksiste-leniniste më parë midis dy partive dhe më pas, po të shihej e nevojshme, të shtroheshin me partitë e tjera». Mehmeti i tha atij se «Partia jonë do të mbajë qëndrim të drejtë, parimor, marksist-leninist dhe nuk do të bjerë në pozita sentimentale dhe oportuniste».

Në letrën që dërgon shoku Hysni tregon se Teodor Zhivkovi i ka bërë një provokacion. Ai i ka thënë: «Çfarë bën Shqipëria? Vetëm Shqipëria nuk është dakord!» Shoku Hysni i është përgjigjur: «Çfarë doni të thoni ju me këtë?» Pastaj Zhivkovi i ka thënë: «Bëra shaka». Hysniu i vuri në dukje se duhet të kesh diçka në kokë që të thuash se «vetëm Shqipëria nuk është dakord». Ai prapë iu përgjigj se «bëra shaka».

Bullgarët kanë botuar në një broshurë të ilustruar një hartë të Ballkanit në të cilën Shqipëria paraqitet si pjesë e Jugosllavisë. Për këtë çështje i thashë Beharit¹ të thërresë ambasadorin bullgar, t'i thotë çfarë është kjo që bëni dhe të kërkojë që kjo broshurë të hiqet nga qarkullimi menjëherë.

Lidhur me çështjet që diskutuam këtu mendoj të orientojmë shokun Hysni. Unë kam përgatitur letrën, të cilën po e lexoj me ngadalë pasi ka rëndësi.

¹ Shoku Behar Shtylla, në atë kohë ministër i Punëve të Jashtme i RPSH.

Pas leximit dhe aprovimit të letrës¹, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Dua të theksoj se forca jonë qëndron në unitetin e mendimit e të veprimit të udhëheqjes sonë dhe të gjithë Partisë që ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Uniteti ynë bazohet në mësimet e marksizëm-leninizmit, prandaj ta kalitim atë gjithnjë e më shumë. Ne vazhdimisht kemi ecur dhe ecim në këtë rrugë, duke luftuar për zbatimin me përpikëri deri në fund të vendimeve që marrim bashkërisht këtu, në Byronë Politike e kur lind nevoja prapë këshillohemi me njëri-tjetrin. Por në ato raste, kur ndonjëri nga ne ndodhet në vështirësi dhe i vetëm e nuk ka mundësi me cilin të këshillohet, ai duhet të veprojë, siç bënim në kohën e luftës, kur, duke qenë pa shokë, duhej të vendosje vetë nëse do të hidheshin ose jo të gjitha forcat në sulm ose për të mbrojtur e për të zbatuar vijën e Partisë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Shih letrën drejtuar shokut Hysni Kapo në Bukuresht, botuar në këtë vëllim, f. 8.

LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT

22 qershor 1960

I dashur shoku Hysni,

Telegramet tuaja dhe letrën i morëm dhe i studjuam në Byronë Politike. Mendojmë unanimitisht se gjendja paraqitet shumë e rëndë dhe zhvillohet në mënyrë jo të rregullt partie. Zhvillimin e ngjarjeve, ndezjen dhe përhapjen e konfliktit në mes të Bashkimit Sovjetik dhe Kinës, në këtë mënyrë siç po bëhen, Byroja jonë Politike i quan shumë të gabuara, shumë të dëmshme dhe shumë të rrezikshme, prandaj nuk mund të pajtohet në asnjë mënyrë me metodat dhe me format që përdoren për të zgjidhur këtë konflikt që i kushton shtrenjtë kampit tonë të socializmit dhe komunizmit ndërkombëtar. Byroja jonë Politike qëndron e patundur si kurdoherë në vijën marksiste-leniniste që mosmarrëveshjet në mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës nuk duhej në asnjë mënyrë të liheshin të trasheshin, nuk duhet lejuar që të thellohet konflikti, por duhet të zgjidhet me rrugë dhe me metoda marksiste-leniniste.

Byroja Politike mendon se mosmarrëveshjet që ekzistojnë në mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës u janë

bërë të njohura partive komuniste dhe punëtoze jo sipas rregullave leniniste, por në mënyrë të rastit, nëpërmjet polemikash të hapura dhe të tërthorta në shtyp dhe në mënyrë gojore. Kjo nuk është metoda e drejtë e zgjidhjes së një konflikti të tillë në rast se dëshirohej, siç e lyp marksizëm-leninizmi, që edhe partitë e tjera të ndërhyjnë dhe të ndihmonin me eksperiencën dhe me peshën e tyre. Kjo ndihmë nuk u kërkua deri tash në fund, por megjithatë, sipas telegrameve që na dërgove, edhe tash nga ana sovjetike synohet të evitohet kjo mënyrë e drejtë zgjidhjeje. Dalim, pra, me konkluzion se s'janë bërë të gjitha përpjekjet që të sqaroheshin këto çështje në mes dy partive më të mëdha të kampit socialist në mënyrë të rregullt dhe objektive, në rrugën marksiste-leniniste. Edhe zgjidhja e çështjes nga një mbledhje ku të marrin pjesë edhe partitë komuniste e punëtoze të kampit tonë, na duket se nuk po merret aq seriozisht, derisa të dyja partitë që kanë mosmarrëveshjet nuk u kanë paraqitur *zyrtarisht* partive të tjera motra tezat dhe pikëpamjet e tyre për këto mosmarrëveshje.

Byroja Politike konsideron se Partia jonë ka përgjegjësi po aq të madhe, sa dhe të gjitha partitë e tjera si për forcimin e unitetit të kampit socialist në rrugën marksiste-leniniste, ashtu edhe për ruajtjen e pastërtisë së Partisë dhe të marksizëm-leninizmit. Për Partinë tonë Bashkimi Sovjetik është i shtrenjtë, por edhe Kina është e shtrenjtë për ne. Prandaj nuk na lejohet të bëjmë gabime, nuk na lejohet të futim Partinë në qorr-sokak dhe në konfuzione ideologjike dhe politike. Këtë s'e kemi bërë dhe nuk do ta bëjmë kurrë. Kur është

fjala për të mbrojtur parimet, ne nuk marrim parasysh se mund t'i mbetet qejfi njërit ose tjetrit. Qëndrimet e drejta marksiste-leniniste e kanë udhëhequr dhe do ta udhëheqin vazhdimisht Partinë tonë dhe ajo do të karakterizohet kurdoherë nga guximi parimor marksist-leninist.

Tash çfarë qëndrimi duhet mbajtur përpara ngjarjeve që po zhvillohen atje? Për vijën e Partisë sonë ti je i qartë dhe s'është nevoja të zgjatemi. Por gjersa kanë shpërthyer pasionet në forma jo të rregullta partie, duhet të jesh shumë i kujdesshëm. Përgjigjja duhet të jetë e matur dhe e peshuar mirë. Mendo kurdoherë interesin e Partisë dhe të marksizëm-leninizmit. Por kjo s'do të thotë që të mos i japësh përgjigjen e duhur dhe zjarr për zjarr kujtdo qoftë. Pse, për shembull, a nuk është qesharake dhe e papranueshme që të vijë një farë Mogjoroshi¹ të na bindë ne, shqiptarët, për drejtësinë e vijës së Bashkimit Sovjetik dhe për «fajet» e Kinës?! Mogjoroshi të vejë në tregje të tjera të shesë pallavrat e tij dhe jo te ne. S'kemi nevojë ne të vijë të na «sqarojë» Mogjoroshi për ato parime e të vërteta për të cilat Partia jonë ka luftuar dhe është gati të luftojë kurdoherë. Ose, për shembull, lëri mirë të kuptojë Andropovit se ne s'jemi dakord që sovjetikët të zënë shokët tanë, anëtarë të delegacionit në Kongresin e Partisë Punëtore të Rumanisë, dhe t'u thonë me habi: «Si, udhëheqja juaj nuk ju ka vënë në korent për këto gjëra?!». I kujto Andropovit se Mikoiani ka dashur t'ia

¹ A. Mogjorosh, në atë kohë anëtar i Byrosë Politike të KQ të PP të Rumanisë.

thoshte këto çështje¹ vetëm shokut Enver dhe ishte ky, (Enveri), që me inisiativën e vet mori edhe shokun Mehmet. Mikoiani iu lut shokut Enver që të gjitha ato që i tha të mbaheshin shumë sekret, dhe kur i thuhet kështu udhëheqjes sonë, ajo e mban fjalën, pse nuk e ka zakon t'i bëjë këto muhabete rrugësh. Por ne shohim, i thuaj Andropovit, te shokët sovjetikë që biseduan me shokët e delegacionit tonë, dy tendenca të rrezikshme: E para, të nënvleftësojnë rrezikun e revizionizmit, gjë me të cilën ne s'mund të jemi kurrë dakord, dhe e dyta, tendenca për të bërë fajtoare, në sytë e shokëve tanë, udhëheqjen e Partisë sonë, që gjoja s'po i vë në kërent. I thuaj Andropovit që t'i ndërpresin menjëherë këto taktika antimarksiste, dhe se ata duhet të dinë se uniteti i udhëheqjes sonë është çelik, ashtu siç është çelik dhe uniteti i udhëheqjes sonë me gjithë Partinë e Punës dhe kush përpiqet, në një formë ose në një tjetër, të bëjë të tilla orvatje, të jetë i sigurtë se do të presë grushte nga ne. I thuaj gjithashtu Andropovit se nuk është as e rregullt as e nevojshme, që shokët sovjetikë të vënë në kërent shokët tanë, pse udhëheqja jonë, që di të mbrojë marksizëm-leninizmin,

¹ Në fillim të shkurtit të vitit 1960 shoku Enver Hoxha që ndodhej në Moskë në krye të delegacionit të PPSH për të marrë pjesë në mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtoare të vendeve socialiste të Evropës për çështjet e zhvillimit të bujqësisë u takua me A. Mikojanin me kërkesën e këtij të fundit. Mikoiani për rreth 5 orë foli në këtë takim për mosmarrëveshjet ideologjike e politike që ekzistonin midis PK të BS dhe PK të Kinës.

di gjithashtu të vërë në korent anëtarët e saj, kur duhet dhe për çfarë duhet.

Këto thuaja Andropovit me gjakftohtësi, por ti e kupton mirë pse i duhen thënë. Ata po veprojnë në mënyrë jo të rregullt dhe jo në rrugë partie dhe këtyre veprimeve është rasti t'u presim rrugën. I thuaj, gjithashtu, Andropovit se «më ka ardhur shumë keq që solle me vete Mogjoroshin, jo si zot shtëpie, por që të më mbushte mendjen mua për drejtësinë e vijës së Bashkimit Sovjetik dhe për rrugën e shtrembër të Kinës. Vetëm mirësjellja, pse isha në shtëpinë e tij, më ndaloi, i thuaj, të tregohesha «harbut» i drejtë».

Ose, kur të paraqitet rasti, si ai kur të tha Andropovi që «Partia Komuniste e Kinës, duke menduar se ju jeni të vendosur kundër jugosllavëve, do t'ju bënte me vete, por gaboi. . .» etj., u thuaj se «kanë vdekur ato kohëra, që Partia jonë e Punës dhe udhëheqja e saj të gabohet nga ndokush dhe të bëhet partizane e vijave të shtrembra. Partia jonë është e kalitur në luftëra dhe s'shkel në dërrasë të kalbur. Ajo ka qëndruar dhe do të qëndrojë kurdoherë në rrugën e parimeve marksiste-leniniste».

Edhe disa çështje të kesh parasysh, se mund të të ndihmojnë, para se të vijmë në thelbin e problemit. Situatat po zhvillohen shtrembër, siç na shkruan dhe në letrën tënde, atje po kurdisen prapaskena e provokacione. Prandaj u qëndro fort dhe tregoj se në udhëheqjen tonë ka unitet, ka vendosmëri dhe guxim.

Në bazë të vendimeve të Byrosë Politike ti do të vepros si më poshtë:

I. — Thirr Andropovin dhe i thuaj në emër të udhëheqjes së Partisë (kurdoherë në emër të Partisë,

në emër të udhëheqjes): «Ja komunikova udhëheqjes sime çfarë më thatë. Udhëheqja jonë ka qenë në dijeni në mënyrë të përgjithshme për këto mosmarrëveshje dhe i ka konsideruar shumë të rënda, shumë të dëmshme për çështjen tonë të përbashkët dhe shfaq përsëri mendimin se këto duhet të zgjidhen, dhe duhet të zgjidhen në rrugë të drejtë, sipas rregullave organizative marksiste-leniniste. Udhëheqja jonë ka shfaqur mendimin që këto mosmarrëveshje ideologjike dhe politike në mes të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës të zgjidhen në mënyrë marksiste-leniniste nëpërmjet bashkëbisedimesh në mes dy partive. Në qoftë se nuk do të zgjidheshin kështu, atëherë duhej të thirreshin përfaqësuesit e partive komuniste e punëtoresh të kampit të socializmit, të diskutonin dhe të shfaqnin pikëpamjet e tyre. Qëndrimet që do të mbaheshin në këtë mbledhje mund të shtroheshin në një mbledhje më të gjerë të partive komuniste e punëtoresh si ajo e Moskës e vitit 1957.

Tash kjo mbledhje është vendosur të bëhet. Udhëheqja e Partisë sonë këtë vendim e ka quajtur të drejtë, ka qenë dakord, po përgatitet të shfaqë mendimin e vet mbi çështjet, dhe pret caktimin e datës». Thuaju se «unë, [Hysniu], jam i autorizuar të diskutoj për caktimin e datës. Udhëheqja jonë ka caktuar dhe ka komunikuar gjithashtu që delegacioni ynë në mbledhjen e ardhshme do të kryesohet nga shoku Enver Hoxha.

Mbledhjen që propozohet të bëhet tash në Bukuresht me të gjithë përfaqësuesit e partive komuniste e punëtoresh motra, që kanë ardhur në Kongresin e Partisë Punëtoresh të Rumanisë, për mosmarrëveshjet në mes

PK të BS dhe PK të Kinës udhëheqja jonë e konsideron të parakohshme dhe shumë të dëmshme. Partia jonë e konsideron gjithashtu shumë të dëmshme një fushatë të maskuar ose të hapur në shtyp, për këto çështje kaq delikate. Kush ka të drejtë ose gabim le ta gjykojë mbledhja e ardhshme. Partia jonë do të vërë të gjitha forcat e veta dhe atë eksperiencë modeste që ka, për të zgjidhur në rrugën parimore marksiste-leniniste këto mosmarrëveshje të rënda. Partia jonë merr të gjitha përgjegjësitë, ajo do të luftojë me nder dhe me guxim si kurdoherë për të mbrojtur vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste, për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, për të mbrojtur kampin e socializmit dhe unitetin e tij. Për Partinë tonë Bashkimi Sovjetik dhe Partia Bolshevike kanë qenë, janë dhe do të jenë shumë të shtrenjta. Por është e pamohueshme dhe e padiskutueshme që, si për ju, ashtu edhe për ne dhe për gjithë kampin tonë, Kina e madhe është gjithashtu shumë e shtrenjtë. Prandaj, udhëheqja jonë mendon dhe rithekson se gabimet, atje ku janë, të shikohen realisht në mbledhje dhe të bëhen të gjitha përpjekjet, të bëhet çmos në rrugë dhe me metoda marksiste-leniniste që të ndreqen për të mirën e socializmit e të komunizmit. Ky ka qenë mendimi zyrtar i udhëheqjes sonë kur mua më nisën për Bukuresht dhe ky mbetet edhe tash pasi i vura në dijeni për çka më komunikuat ju».

Gjithashtu thuaji Andropovit: «Unë [Hysniu] jam i autorizuar vetëm të përfaqësoj Partinë e Punës të Shqipërisë në Kongresin e Partisë Punëtore të Rumanisë dhe të bisedoj me përfaqësuesit e partive të tjera të kampit të socializmit për caktimin e datës së mble-

dhjes së afërme. Në rast se mbledhja që propozoni ju dhe Partia Punëtore e Rumanisë do të bëhet tani menjëherë në Bukuresht, sikundër e theksova edhe më parë, udhëheqja jonë e konsideron të parakohshme, megjithatë unë jam i autorizuar të marr pjesë.

Jam i autorizuar zyrtarisht t'juaj komunikoj këto që t'ia transmetoni udhëheqjes suaj. Partia jonë çdo gjë që ka e thotë hapur dhe pa druajtje, në rrugë leniniste».

II. — Në mbledhjen që mund të bëhet qëndro gjakftohtë. Fjalë të matura. Për mosmarrëveshjet që ekzistojnë në mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës nuk duhet të prononcohesh. Deklarata duhet të jetë e shkurtër dhe koncize.

Në esencë ti do të deklarojsh në emër të Partisë sonë:

1. — Partia jonë e Punës i ka aprovuar e i ka zbatuar vendimet e Mbledhjes së Moskës [1957].

2. — Thekso politikën e drejtë, konsekuente dhe parimore të Partisë sonë, besnikërinë e pafund ndaj marksizëm-leninizmit, dashurinë e madhe të Partisë dhe të popullit tonë për partitë dhe për popujt e vendeve të kampit të socializmit, për të gjitha partitë e tjera komuniste dhe punëtore motra të botës. për unitetin e kampit tonë që s'duhet rrezikuar në asnjë mënyrë, por duhet forcuar dhe kalitur në rrugën marksiste-leniniste.

3. — Shpreh hidhërimin e Partisë sonë për këto mosmarrëveshje që kanë lindur në mes PK të Bashkimit Sovjetik dhe PK të Kinës, dhe shpreh bindjen që këto duhet të zgjidhen në rrugën marksiste-leniniste në

mbledhjen e ardhshme të partive komuniste dhe punëtorë që do të mbahet më vonë.

4. — Shpreh vendosmërinë e Partisë sonë se ajo do të luftojë krah për krah me vendet socialiste, duke qenë kurdoherë vigjilente dhe duke demaskuar deri në fund dhe pa mëshirë imperializmin dhe agjentët e tyre, revizionistët.

Këto të bëjnë thelbin e ndërhyrjes tënde.

Besojmë se çdo gjë do të shkojë mirë. Ne jemi në rrugë të drejtë, prandaj ti ndiq situatat me gjakftohtësinë e me guximin revolucionar që të karakterizojnë.

Na mbaj në korent për çdo gjë.

Një lajm gazmor: Dje ra shi i mirë kudo.

Të gjithë shokët të bëjnë të fala shumë dhe

unë të përqafoj.

Enver

P.S.

Çdo tentative a sugjerimi nga ana e sovjetikëve për ardhjen time në Bukuresht duhet t'i përgjigjesh se ai nuk vjen.

Botohet për herë të parë me ndonjë shkurtim sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**NGA LETRA DËRGUAR LIRI BELISHOVËS MBI
QËNDRIMIN QË DUHET TË MBANTE NË PEKIN¹
NDAJ MOSMARRËVESHJEVE TË KRIJUARA
MIDIS BASHKIMIT SOVJETIK DHE KINËS**

23 qershor 1960

Byroja Politike, që kur na dërgove letrën dhe informacionin, mendon se ti ke bërë një gabim të rëndë duke informuar ambasadën sovjetike në Pekin, për sa të thanë shokët kinezë, sepse, së *pari*, ti akoma s'kishe informuar udhëheqjen e Partisë tënde dhe as kishe aprovimin e saj; së *dyti*, ato nuk ishin çështje të Partisë sonë dhe nuk të përkiste ty t'i informoje sovjetikët, dhe së *treti*, ti e dije mendimin tonë, që këto mosmarrëveshje duhej dhe duhet të zgjidhen në rrugë dhe në forma marksiste-leniniste dhe jo vesh më vesh e duke i thënë njërit e tjetrit. Jashtë kësaj rruge për çështje të tilla Partia jonë nuk duhet të marrë pjesë.

Prandaj të shkruaj këtë letër të shkurtër për të

¹ Kjo letër i është dërguar Liri Belishovës me korrier të posaçëm.

pasur kujdes që të mos prononcohesh për mosmarrëveshjet që ekzistojnë në mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës, për arsye se Byroja jonë Politike ka gjykuar se kështu si po zhvillohet ky konflikt nuk është i rregullt dhe në rrugë të drejtë. Është vendosur nga të gjitha partitë tona të kampit që këto çështje të bisedohen në një mbledhje të afërme, për të cilën data do të caktohet më vonë. Kjo është rruga e drejtë, prandaj në këtë mbledhje ne do të shfaqim mendim.

Kujtdo që të të pyesë, i thuaj se «këto mosmarrëveshje janë të dëmshme dhe të rrezikshme për çështjen tonë, këto janë lënë dhe janë trashur, duhet të zgjidheshin në mes të dy partive në rrugën marksiste-leniniste dhe tash që është vendosur të bëhet në të ardhshmen e afërt Mbledhja e partive komuniste dhe punëtoare, duhet të zgjidhen atje një herë e mirë. Partia jonë do të mbajë si kurdoherë qëndrim parimor, marksist-leninist».

Më parë në Moskë dhe tani në Bukuresht, sovjetikët i kanë informuar të gjithë delegatët që kanë vajtur në kongresin rumun për mosmarrëveshjet që kanë ata me kinezët. Në këto informacione përmendesh edhe ti në radhën e atyre që ke njoftuar sovjetikët për çfarë të thanë kinezët. Për informatat, që ke dhënë ti, sigurisht, sovjetikëve u ka ardhur mirë, prandaj ata të mburrin me të madhe, duke e quajtur gjestin tënd «heroik», «parimor» dhe të tjera shprehje të tilla. Ata po të bëjnë dhe do të të bëjnë shumë lëvdata. Natyrisht, ty nuk duhet të të rritet mendja nga këto lëvdata, se bëhen me qëllime të caktuara.

Prandaj të shkruaj këtë letër që të kesh kujdes dhe, për sa të shkruaj, janë *absolutisht* vetëm për ty!

Enver

Botohet për herë të parë. Nxferrë nga kopja e origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADI OGRAM

SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT

23 qershor 1960

Ora 20.⁴⁵

Shoku Hysni,

Siç po zhvillohet situata ka mundësi që të propozohet të mos zhvillohet Mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore që është caktuar për më vonë. Në një rast të tillë ti shfaq mendimin e udhëheqjes sonë se ajo mbledhje është e domosdoshme dhe nuk mund të zëvendësohet me këtë që do të zhvillohet tani në Bukuresht.

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM

SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT

24 qershor 1960

I dashur Hysni,

Në mbledhjen e mëngjesit që do të bëhet thuaj: «Udhëheqja jonë, nga letrat e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, di se delegacionet tona, jo të nivelit të lartë, këtu në Bukuresht, do të caktojnë vetëm datën dhe vendin e Mbledhjes së ardhshme të partive komuniste e punëtore. Në ato letra thuhet se mund të shkëmbehen mendime mbi situatën politike të jashtme të krijuar nga dështimi i konferencës së Parisit. Kurse këtu shoh që po shtrohen gjëra jashtëzakonisht serioze në lidhje me Partinë Komuniste të Kinës. Nga delegacioni sovjetik na u dha një material voluminoz vetëm 10 orë para mbledhjes dhe as na jepet fare kohë të marrim frymë. Ne kjo gjë na çudit».

Kur të marrësh fjalën në mbledhje duhet të deklarosh: «Mbi këto çështje nuk jam i autorizuar të proncohem, sepse udhëheqja jonë di se këto çështje do të diskutohen në Mbledhjen e ardhshme të përfaqë-

suesve të partive, ashtu sikurse kemi rënë dakord të gjithë». Në rast se «ndonjë i madh» bën ndonjë aluzion provokues për mosproncimin tonë në këtë mbledhje, atëherë ti nxirr deklaratën zyrtare që të dërguam për t'ia komunikuar udhëheqjes sovjetike me anën e Andropovit dhe lexoje pas fjalës që do të mbash. Nëse «aluzioni» bëhet pasi ti të kesh folur, atëherë kërko fjalën për të dytën herë dhe lexo deklaratën e Komitetit tonë Qendror që i transmetove Andropovit.

E kuptojmë situatën tënde të vështirë, por mos u shqetëso fare se jemi në rrugë të drejtë. Shëndet e durim.

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM

SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT

24 qershor 1960

HYSNIUT

Në qoftë se paraqitin komunikatë ose rezolucion si konkluzion të mbledhjes, ku të bëhet qoftë dhe aluzioni më i vogël kundër Kinës dhe jashtë përmbajtjes së Deklaratës së Moskës [1957], ti nuk duhet ta firmosësh. Ti, pa humbur kohë, pyet dhe kërko zyrtarisht a do të ketë komunikatë dhe, nëse ka, kjo të të dorëzohet. Na njofto për përmbajtjen e saj dhe prit pikëpamjen tonë për pranimin ose jo të kësaj komunikate.

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

ASNJË PRESIONI TË MOS I NËNSHTROHEMI

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

24 qershor 1960

Kemi marrë nga shoku Hysni një sërë radiogramesh në lidhje me Mbledhjen e Bukureshtit. Këto radiograme kanë vazhduar gjer mbrëmë vonë në orën 3 pas mesit të natës. Mendova se s'ishte nevoja të mblidhej Byroja Politike prapë pas mesit të natës, por, në bazë të direktivave të saj, unë i transmetova përgjigjet përkatëse shokut Hysni.

Pasi lexoi radiogramet e dërguara nga shoku Hysni dhe përgjigjet e dhëna, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Është e qartë se Hysniu ndodhet në një gjendje shumë të vështirë në Bukuresht. Marrëveshja është e tillë që delegacionet e partive komuniste e punëtore që marrin pjesë në Kongresin e Partisë Punëtore të Rumanisë, të takoheshin së bashku në Bukuresht për të vendosur vetëm datën dhe vendin e një mbledhjeje të partive komuniste e punëtore të botës. Por shoku Hysni

ndodhet në fakt përpara një mbledhjeje ndërkombëtare të papritur, të kurdisur nga grupi i Hrushovit.

Unë mendoj që, në rast se kjo mbledhje do të lëshojë ndonjë komunikatë, e cila nuk bie në kundërshtim me Deklaratën e Mbledhjes të partive komuniste e punëtoresh që u zhvillua në Moskë në vitin 1957, Hysniu ta pranojë. Mirëpo mund të ndodhë që komunikata të ketë edhe nuanca të tjera, sepse ajo del nga një mbledhje jo e rregullt, ku përfaqësuesit e partive komuniste e punëtoresh kanë marrë një raport prej 65 faqesh nga ana e udhëheqjes sovjetike, ku dënohet Partia Komuniste e Kinës. Ne nuk mund të pranojmë një komunikatë, e cila do të bëjë, qoftë edhe aluzionin më të vogël kundër Kinës. Kjo është e rëndësishme, sepse situatat janë të tilla që në Mbledhjen e tanishme të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtoresh të Bukureshtit shtrohen gështje jashtëzakonisht serioze. Raporti i delegacionit sovjetik kundër Partisë Komuniste të Kinës do të ketë reperkusione të mëdha në botë, ashtu sikurse pati raporti sekret i Hrushovit në Kongresin XX të PK të BS mbi të ashtuquajturin kult të Stalinit.

Edhe në qoftë se ne pranojmë një komunikatë pa aluzione, prapëseprapë këtë ne duhet ta konsiderojmë se nuk është e rregullt, sepse kjo është rezultat i një mbledhjeje të befasishme, në kundërshtim me normat organizative marksiste-leniniste. Prandaj qëndrimi i Partisë sonë që i kundërvihet kësaj mbledhjeje, është i drejtë.

Këto janë disa mendime paraprake, por lidhur me komunikatën Hysniu u njoftua të mos prononcohet

derisa të marrë udhëzime të reja. Në qoftë se atij i jepet komunikatë me aluzione kundër Kinës të thotë në mënyrë kategorike: «Këtë komunikatë nuk e firmos pa ia njoftuar edhe udhëheqjes së Partisë që unë përfaqësoj». Ndërsa, në qoftë se nuk ka asnjë aluzion, atëherë Hysniu të ngrihet në mbledhje dhe të thotë se «jam i autorizuar nga Partia e Punës e Shqipërisë që të deklaroj se jam dakord me këtë komunikatë, por shtoj se kjo komunikatë është rezultat i punimeve të një mbledhjeje jo të rregullt. Prandaj nuk kemi ardhur të përgatitur për një mbledhje të tillë dhe nuk mund të prononcohem për çështjet që ngrihen kundër PK të Kinës».

Shokët kinezë kanë kërkuar që mbledhja të shtyhet, por përfaqësuesit e partive të tjera komuniste dhe punëtorë nuk janë dakord. Kjo s'është e drejtë dhe i vë shokët kinezë në gjendje të vështirë. Një vend socialist kërkon kohë që të përgatitet për mbledhjen, kurse kjo kohë nuk i jepet. Është e qartë se kjo bëhet me qëllim.

Hysniu të thotë që Partia jonë e Punës nuk është dakord me procedurën që propozohet të ndiqet në Mbledhjen e partive komuniste e punëtorë të Bukureshtit, se ajo është dakord të vendosim tani vetëm kur e ku do të bëhet mbledhja e ardhshme e partive komuniste e punëtorë për të cilën kemi rënë dakord në parim dhe vetëm pasi të kemi marrë materiale sqaruese edhe nga pala tjetër, nga Partia Komuniste e Kinës, atëherë ne do të përgatitemi dhe do të themi fjalën tonë në mbledhjen e ardhshme.

S shumë gjëra mund të ndodhin, por ne asnjë presioni të mos i nënshtrohemi, të zbatojmë kurdoherë vijën tonë të drejtë marksiste-leniniste.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT

25 qershor 1960

I dashur Hysni,

Morëm radiogramet e mbrëmjes dhe të shkruaj këtë copë letër tash në mëngjes¹, për të thënë vetëm se mirë ia ke dhënë përgjigjen «mikut»². As hiç mos u trubullo kur të të provokojë ndonjë, por përgjigju, bile dhe fort, veçse me gjakftohtësi. Poshtërsira po bëhen, por e drejta kurdoherë fiton. Në rast se vazhdojnë të bëjnë provokime, mos lërë gjë mbi kurrizin tonë, por ua lër në kurriz.

Të përqafoj
Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Dërguar me avionin që do të sillte në atdhe shokun Hysni.
² Nikita Hrushovi.

RADIOGRAM

SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT

25 qershor 1960

Ora 24⁰⁰

Shoku Hysni,

Ti duhet të flasësh nesër sipas udhëzimeve të Byrosë Politike që i ke marrë me letër. Në fund të fjalës tënde, ose gjej vendin a rastin e përshtatshëm, deklaro: «Unë, në emër të Partisë sonë, deklaroj se Partia e Punës nuk është kurrsesi dakord me frymën e me metodat që përdoren në këtë mbledhje për zgjidhjen e këtij problemi kaq të madh për lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Mendimi i Partisë sonë është se këto çështje duhen trajtuar me kujdes, me gjakftohtësi dhe në frymë shoqërore sipas normave leniniste». Në rast se pas kësaj deklarate të drejtohen pyetje ose vërejtje provokuese, ngrihu dhe thuaj: «Përveç atyre që thashë nuk kam tjetër për të thënë në këtë mbledhje». Në rast se ke folur kërko të flasësh përsëri dhe bëj këtë deklaratë. Në rast se nuk të japin fjalën, atëherë fjalimin që do të mbash dorëzoje në kryesinë e mble-

dhjes duke kërkuar që të regjistrohet në proces-verbal.

Të presim. Mirë ardhsh.

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**NGA LETRA DËRGUAR LIRI BELISHOVËS MBI
ZHIVILLIMIN E Mbledhjes së Bukureshtit
DIJE MBI QËNDRIMIN QË DUHEJ TË MBANTE
AJO NË MOSKË¹**

28 qershor 1960

Mbledhja e Bukureshtit u organizua dhe u zhvillua jo në rrugën dhe në frymën marksiste-leniniste. Normat leniniste në praktikën e punës e në marrëdhëniet midis partive u shkelën. Këto pikëpamje të Byrosë sonë u shtruan haptazi në mbledhje.

Tezat tona: «Këto ishin mosmarrëveshje në mes dy partive dhe duhej të zgjidheshin në mes tyre. Derisa kjo s'u bë, jemi dakord të zhvillohet Mbledhja e partive komuniste e punëtoare në Moskë, në nëntor të këtij viti».

Teza e sovjetikëve (me të cilët brenda dy ditëve në Bukuresht u bashkuan edhe partitë e tjera të vendeve të demokracisë popullore të Evropës): «Kina ka shkelur vendimet e Mbledhjes së Moskës dhe mosmarrëveshjet janë në mes të Kinës dhe të kampit tonë».

¹ Kjo letër, e dërguar me korrier të posaçëm, iu dorëzua Liri Belishovës atë ditë që arriti në Moskë delegacioni ku ajo bënte pjesë.

Puna vajti deri atje sa Hrushovi u tha kinezëve «*trockistë*» dhe «*po të doni, largohuni nga kampi*». Më gjatë nuk të shkruaj dot, por ti e kupton përnjëherë situatën. Sigurisht, për qëndrimet e matura dhe parimore të Komitetit tonë Qendror, Hrushovit s'i ka ardhur mirë, por ne, pavarësisht se s'i vjen mirë njërit ose tjetrit, mbrojmë parimet. Mendimin tonë për mosmarrëveshjet sovjeto-kineze ne do ta themi në Mbledhjen e ardhshme të nëntorit në Moskë.

Këto po t'i shkruaj që t'i kesh parasysh, sepse sovjetikët do të bisedojnë me ty, që «*të të sqarojnë*». Dëgjoji me kujdes, me gjakftohësi, po mos shfaq asnjë mendim, vetëm thuaju: «Unë s'jam në korent të zhvillimit të ngjarjeve, prandaj s'mund të jap asnjë mendim», thuaju se «*udhëheqja jonë ka vepruar shumë drejt në Bukuresht dhe unë solidarizohem plotësisht me qëndrimin e Komitetit Qendror të Partisë sonë*».

Kaq dhe mos u zgjat më tej. *Le të shohin ata unitetin e çeliktë të udhëheqjes sonë, drejtësinë e guximitin leninist të të gjithë vijës sonë dhe të çdo anëtari të udhëheqjes sonë.*

Kështu të veprosh për këtë çështje kaq të madhe dhe delikate. Një këshillë vetëm të jap: *Çdo fjalë mate mirë dhe sa më pak fjalë, aq më mirë!*

Enver

Botohet për herë të parë. Nxjerrë nga kopja e origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**NOTË VERBALE DHËNË AMBASADORIT SOVJETIK
NË TIRANË MBI QËNDRIMIN ANTIMARKSIST
TË AMBASADORIT SOVJETIK E TË ATASHEUT
USHTARAK NË BEOGRAD LIDHUR ME MITINGUN
NË SREMSKA MITROVICA**

9 korrik 1960

Sikurse dihet, Partia e Punës e Shqipërisë, në marrëdhëniet e saj me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe me të gjitha partitë e tjera komuniste dhe punëtore, është bazuar dhe bazohet në parimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, të internacionalizmit proletar. Duke u nisur nga këto parime, dëshirojmë t'ju shfaqim haptas dhe sinqerisht hidhërimin tonë të thellë për një ngjarje që ka ndodhur këto kohët e fundit.

Më 4 korrik 1960, në Sremska Mitrovica të Serbisë, agjenti i ndyrë i borgjezisë kapitaliste, një nga kryerevizionistët e klikës së Beogradit, armik për vdekje i popullit shqiptar dhe xhelati gjakatar i popullsisë shqiptare të Kosovës, Aleksandër Rankoviçi, duke folur në një miting «solemn», sulmoi haptazi politikën e vendeve socialiste dhe, në mënyrë të posaçme, sulmoi

ashpër Partinë e Punës të Shqipërisë, popullin shqiptar, Republikën tonë Popullore.

Agjenti i imperializmit, Aleksandër Rankoviçi, duke e cilësuar vendin tonë socialist si një «skëterrë ku mbretëron teli me gjemba» etj., arriti gjersa të thotë se regjimi neofashist italian qenka më demokratik nga regjimi ynë i demokracisë popullore!

Për ne komunistët shqiptarë, për popullin shqiptar, nuk ka asgjë për t'u çuditur dhe të papritur në këto deklarata të një armiku të popullit tonë dhe të kampit të socializmit, në shërbim të imperializmit, siç është Aleksandër Rankoviçi. Kur të sulmon armiku, kjo do të thotë se je në rrugën e drejtë. Dhe ne, për t'u dhënë përgjigjen e merituar armiqve të marksizëm-leninizmit, të atdheut tonë dhe të kampit të socializmit, shkopin e kemi pasur dhe do ta kemi kurdoherë të ngritur. Por thelbi i çështjes, për të cilën ne do të shfaqim shqetësimin tonë me anën e kësaj note, nuk qëndron këtu.

Sulmet e poshtra të Rankoviçit, të bëra me qëllime të paracaktuara, kundër socializmit në përgjithësi dhe Republikës Popullore të Shqipërisë veçanërisht, marrin një kuptim tjetër, kur në mitingun «solemn» të Sremska Mitrovicës, sikurse ka njoftuar edhe agjensia sovjetike TASS, asistuan ambasadori i Bashkimit Sovjetik në Beograd, I.K. Zamçevski, dhe atasheu ushtarak sovjetik në Beograd, kolonel V.K. Taraseviçi, dhe dëgjuan gjer në fund të gjitha shpifjet që u bënë në miting kundër nesh nga Aleksandër Rankoviçi.

Komiteti Qendror i Partisë sonë, me këtë rast, i shpreh Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të

Bashkimit Sovjetik habinë dhe hidhërimin e tij për qëndrimin e ambasadorit dhe të atasheut ushtarak sovjetik, qëndrim që ne e konsiderojmë se është në kundërshtim me parimet e internacionalizmit proletar mbi të cilat janë ndërtuar marrëdhëniet midis të dy partive dhe të dy shteteve tona, e konsiderojmë si një qëndrim jomiqësor ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe popullit shqiptar, miq të vërtetë dhe besnikë konsekuentë dhe pa zigzage të popujve sovjetikë dhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Natyrisht, çështja nëse ambasadori dhe atasheu ushtarak i Bashkimit Sovjetik duhet ose nuk duhet të asistojnë në këtë ose në atë miting, është një çështje që nuk na përket neve ta vendosim, është një çështje që i përket vetëm Bashkimit Sovjetik, dhe neve as që na ka shkuar dhe as që na shkon kurrë në mend që të ndërhyjmë në punët e brendshme të të tjerëve. Por ne nga ana jonë nuk kemi lejuar dhe nuk do të lejojmë kurrë, në asnjë rast, që ambasadori i Republikës Popullore të Shqipërisë të vazhdonte të asistonte në një miting të tillë si ai i Sremska Mitrovicës, ku armiqtë e komunizmit dhe agjentët e imperializmit do të sulmonin poshtërisht një parti tjetër motër ose një vend tjetër socialist. Dhe këtë do ta bënim dhe do ta bëjmë, sepse e konsiderojmë si detyrë internacionaliste, në pajtim të plotë me parimet në të cilat mbështeten marrëdhëniet midis partive marksiste-leniniste dhe vendeve socialiste.

Megjithëse e gjithë bota e mori vesh se çfarë u tha në Sremska Mitrovica dhe se kush asistoi në këtë miting revizionist, ne e quajmë si detyrë internacionaliste dhe

miqësore që qëndrimin e ambasadorit dhe të atasheut ushtarak sovjetik, qëndrim që në fakt nuk ishte aspak marksist, ta trajtojmë në mes partive tona, në bazë të normave leniniste, pa i dhënë publicitet. Kurse, përsa u përket sulmeve, shpifjeve, qëllimeve tendencioze të Rankoviçit, si kurdoherë, ashtu edhe kësaj here, ato nuk do të mbeten pa u paguar nga ana jonë me monedhën e merituar.

Ne nuk mund ta imagjinojmë që ambasadori Zamçevski dhe koloneli Taraseviç të mos dinë se ç'janë revizionistët titistë, se sa të rrezikshëm janë ata për lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe për unitetin e kampit të socializmit, se ç'kanë bërë ata dhe se ç'qëllime kanë kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Partisë sonë të Punës. Sot është e njohur nga të gjithë se revizionistët e Beogradit janë armiq të rrezikshëm të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, janë komplotistë të rrezikshëm kundër pavarësisë së popullit shqiptar dhe të vendeve të tjera socialiste. Revizionistët jugosllavë kanë shkuar aq larg në komplotet e tyre kundër Republikës Popullore të Shqipërisë sa që, më 1948, tentuan *manu militari* ta skllavëronin Shqipërinë. Historia e 19 vjetëve të jetës së Partisë sonë flet për të gjithë veprimtarinë kriminale të trockistëve të Beogradit kundër vendit tonë.

Ashtu sikurse popujt e Bashkimit Sovjetik me plot të drejtë u revoltuan kundër agresionit të poshtër amerikan kur aeroplani spiun U-2 amerikan, me urdhrin e presidentit Ajzenhauer, cenoi sovranitetin e Bashkimit Sovjetik, ashtu edhe populli shqiptar ka mbi 15 vjet që vazhdon të jetë i revoltuar për veprimtarinë armiqësore

të revizionistëve të Beogradit kundër pavarësisë së atdheut tonë. Ne, i gjithë populli shqiptar pa përjashtim, aprovuam dhe aprovojmë me gjithë zemër qëndrimin e qeverisë sovjetike ndaj imperializmit amerikan si përgjigje të agresionit të aeroplanit spiun U-2. Ne përkrasim me gjithë zemër çdo qëndrim të vendosur kundër armikut numër një të njerëzimit, imperializmit amerikan, por në të njëjtën kohë luftojmë edhe kundër shërbëtorëve besnikë të imperializmit amerikan, revizionistëve të Beogradit.

Ne jemi të bindur se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik do ta kuptojë drejt qëndrimin legjitim të Komitetit Qendror të Partisë sonë përpara qëndrimit jomarksist të ambasadorit sovjetik, Zamçevski, dhe të atashkut ushtarak, Taraseviç.

Si për çdo çështje tjetër, ashtu edhe për këtë, ne ju folëm haptazi dhe me sinqeritetin komunist, ashtu siç na mëson marksizëm-leninizmi. Dhe ju duhet të na kuptoni drejt.

Ju sigurojmë se, nga ana jonë, ne do të bëjmë të gjitha përpjekjet që miqësia midis popujve tanë të forcohet vazhdimisht, sepse ajo bazohet në gjakun që kanë derdhur ata kundër të njëjtit armik, në parimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

NË MBLEDHJEN E BUKURESHTIT NE S'PRANUAM TË SHKELEN NORMAT LENINISTE TË MARRËDHËNIEVE MIDIS PARTIVE

Nga fjala në Plenumin XVII të KQ të PPSH¹

11 korrik 1960

Dëshiroj të shtoj edhe unë diçka mbi raportin e mbajtur nga shoku Hysni [Kapo] që ishte caktuar si kryetar i delegacionit tonë në Kongresin III të Partisë Punëtore të Rumanisë dhe në Mbledhjen e përfaqësuesve të partive që u mbajt në Bukuresht. Çështjet që do të them kanë të bëjnë me ato që u shtruan në raport, vetëm theksoj se duhet të kuptohen mirë këto, pasi janë shumë të rëndësishme.

Çështja qëndron kështu: Në mes të Partisë Komu-

¹ Plenumi XVII i KQ të PPSH, që zhvilloi punimet më 11 dhe 12 korrik 1960, dëgjoi, diskutoi dhe aprovoi raportin «Mbi zhvillimin e punimeve në Mbledhjen e Bukureshtit midis përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore motra dhe qëndrimin e mbajtur nga delegacioni i Partisë sonë në këtë mbledhje», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Hysni Kapo.

niste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës ka mosmarrëveshje të mëdha, që kanë krijuar një situatë shumë të rëndë për kampin e socializmit dhe për gjithë komunizmin ndërkombëtar. Dhe pse është krijuar kjo situatë e vështirë dhe e rëndë, nga këto mosmarrëveshje midis dy partive, është e domosdoshme që të gjitha partitë komuniste dhe punëtorë, të kampit të socializmit dhe të të gjithë botës, të ndihmojnë me të tëra forcat që këto mosmarrëveshje ideologjike dhe politike t'i nënshtrohen një diskutimi parimor që të zgjidhen sa më parë, sa më mirë dhe sa më drejt, se këtë e lyp interesi i komunizmit ndërkombëtar, i kampit të socializmit dhe i së ardhshmes sonë.

Byroja Politike e KQ të PPSH mendon se këto mosmarrëveshje nuk janë për çështje të vogla, nuk janë çështje që mund të zgjidhen në këmbë. Probleme të tilla në asnjë mënyrë nuk mund të zgjidhen lehtë, sepse ato janë serioze dhe kanë të bëjnë me jetën e me të ardhshmen e njerëzimit. Këtë ne e themi me plot ndërgjegje dhe, pavarësisht se jemi përfaqësues të një populli të vogël prej një milion e gjysmë banorësh, ne i shikojmë çështjet si marksistë që mbrojnë interesat e popullit, të Partisë së tyre dhe të kampit të socializmit, jo vetëm aktualisht, por edhe në të ardhshmen. Si marksistë, ne kemi të drejtë të themi pikëpamjen tonë.

Pikëpamjet që do të shprehë çdo parti kanë një rëndësi të madhe. Prandaj, në këtë rast sidomos, ato duhet të rrihen mirë në udhëheqjet e çdo partie, të studjohen me shumë kujdes burimet e konfliktit dhe mosmarrëveshjet, pa *parti pris*, pa paragjykime, të dilet me një konkluzion të drejtë marksist-leninist dhe pastaj

në rrugë marksiste-leniniste ato të diskutohen në një mbledhje të rregullt, të shihet kush ka faj dhe pse, e të bëhen të gjitha përpjekjet që fajtori të vihet në rrugë të drejtë. Në fund të të gjitha përpjekjeve, të bëra me durim të madh, mund të merret qoftë edhe një masë kapitale, sipas nevojës dhe shkallës së fajit, ashtu sikurse është praktika marksiste-leniniste e partive tona. Një praktikë e tillë, na mëson marksizëm-leninizmi, nevojitet jo vetëm për këto probleme kaq të mëdha dhe me karakter ndërkombëtar, por, edhe kur merret masë për një anëtar të thjeshtë partie. Edhe në këtë rast duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për ta sjellë fajtorin (në qoftë se është me të vërtetë fajtor) në rrugë të drejtë. Kjo është praktika leniniste. Këtë praktikë e ka zbatuar dhe do ta zbatojë kurdoherë Partia jonë, në çështje të vogla e të mëdha. Prandaj, askush nuk ka të drejtë ta kritikojë Partinë tonë në këto çështje parimore, për të cilat ajo qëndron e vendosur si shkëmbi.

Mënyra se si u përpoqën t'i paraqitnin çështjet udhëheqësit sovjetikë në Mbledhjen e Bukureshtit lidhur me mosmarrëveshjet që kanë ata me Partinë Komuniste të Kinës, si çështje që janë në kundërshtim me gjithë komunizmin ndërkombëtar, dhe se si u shtruan këto çështje kaq të rëndësishme për kampin e socializmit dhe për tërë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, udhëheqjes së Partisë sonë i duket se nuk është aspak e matur dhe e denjë për udhëheqësit sovjetikë, ajo nuk është mënyrë e drejtë, marksiste-leniniste. Të shtrohet çështja menjëherë në këtë formë si u veprua atje dhe të kërkohet nga përfaqësuesit e partive, të cilët kishin shkuar në Bukuresht për tjetër qëllim, që brenda disa

orëve të mbanin qëndrim kundër Partisë Komuniste të Kinës, do të thotë të pranosh tezën shumë të shpejtuar të Nikita Hrushovit që «në qoftë se ti, Kinë, nuk je me ne, veçohu, dil nga kampi socialist, nuk je më shoku ynë!». Po ta kishte pranuar këtë delegati ynë do të kishte bërë një gabim të rëndë, të palejueshëm, që do të njolloste Partinë tonë. Tani unë nuk flas për partitë e tjera; këtu në Komitetin Qendror ne gjykojmë qëndrimin që ka mbajtur Byroja Politike. Ne mendojmë se asaj nuk i lejohej të mbante një qëndrim tjetër pa e gjykuar mirë e me kujdes çështjen, pa pasur të dhëna konkrete nga të dyja palët. Byroja Politike nuk mund të lejonte kurrë që brezat e sotëm e të ardhshëm të Partisë dhe të popullit tonë të thoshin «si Partia jonë në këtë moment historik ka gabuar kaq rëndë?!».

Të kuptohemi, shokë, unë nuk po flas për konfliktin në mes nesh dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Problemi qëndron në atë se si vepruan udhëheqësit sovjetikë në zgjidhjen e një çështjeje kaq të madhe, kaq serioze që ka të bëjë me jetën e kampit të socializmit. Ne i themi Komitetit Qendror të na gjykojë nëse kemi vepruar drejt apo jo.

Ne, shokë, jemi marksistë. Partia jonë nuk është më një parti një ose dyvjeçare, por një parti që mot mbush 20 vjet. Gjithë këtë kohë ajo nuk e ka kaluar në krevat me pupla, por në luftë të përgjakshme e të papajtueshme me fashizmin italian, nazizmin gjerman, ballistët, anglezët, amerikanët, revizionistët jugosllavë, me monarko-fashistët grekë dhe me lloj-lloj armiqsh të tjerë të jashtëm e të brendshëm. Kështu, marksizmin

ne e kemi mësuar edhe në libra, edhe në luftë, edhe në jetë. Prandaj, tani as të rinj, as të papjekur s'jemi. Partia jonë nuk është një parti kalamanësh sa të mos jetë në gjendje të kuptojë marksizmin edhe në teori, edhe zbatimin e tij në praktikë. Partia jonë është përpjekur të ecë kurdoherë drejt, prandaj në rrugën e saj nuk janë vërtetuar gabime parimore, sepse në çdo rrethanë ajo e ka zbatuar drejt marksizmin.

Pra, si marksistë, neve nuk na mbushet mendja që këto mosmarrëveshje kaq serioze në mes të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës të kenë lindur brenda një ose dy muajsh. Dialektika marksiste nuk e pranon këtë; ato kanë rrënjë të thella. Ka plot fakte si ka ndodhur ky proces dhe se si gabimet, duke u grumbulluar, erdhën e u trashën e u arrit deri atje sa të thuhet që «Kina do luftë», që «ajo nuk është për çarmatimin» ose «për bashkëzistencën paqësore». Kinezët thonë: «Ne kemi qenë dhe jemi për këtë rrugë». Dhe me të vërtetë, lexoni notën e fundit të Qeverisë së RP të Kinës drejtuar Qeverisë së BRSS. Ajo tregon se RP e Kinës është dakord me propozimet sovjetike për çarmatimin, për mbrojtjen e paqes. Një qëndrim i tillë për këto probleme është mbajtur jo vetëm në këtë dokument, por edhe në raste të tjera.

Atë që shkel marksizëm-leninizmin, ta kritikojmë në rrugën marksiste-leniniste dhe të marrim masat e përshtatshme për ta ndrequr. Ky është i vetmi qëndrim i drejtë dhe ky u intereson të tëra partive në të gjithë botën, veçanërisht Partisë dhe popullit tonë, që mbron me konsekuencë marksizëm-leninizmin. Gomulka me

shokë, që tani hiqen si miq të Bashkimit Sovjetik, i kanë vënë zjarrin m'qësisë me Bashkimin Sovjetik. Dihet se në Poloni u lejua kisha dhe reaksioni të ngrihen në këmbë kundër Ushtrisë Sovjetike. Atje dëbuan marshalë sovjetikë që komanduan Ushtrinë e Kuqe, e cila çliroi Poloninë dhe Evropën nga fashizmi dhe tani duan të na japin mend neve, shqiptarëve. Përfaqësuesi i Partisë Punëtore të Rumanisë, Mogjoroshi, ngrihet të bindë udhëheqjen e Partisë sonë për drejtësinë e vijës së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Këtë ia kemi thënë, me anën e përfaqësuesit të Partisë sonë, edhe Nikita Hrushovit. Shokët tanë që luftonin nëpër male mbanin «Historinë e Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik» në gji, kur legjionet rumune të atëhershme martirizonin popullin sovjetik. Përprjekjet e Mogjoroshit bashkë me përfaqësuesin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për të bindur përfaqësuesin e Partisë së Punës të Shqipërisë për «drejtësinë» e vijës së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ne nuk i pranojmë; këto ne nuk i hamë. Bashkimin Sovjetik ne e duam jo për hatrin e Mogjoroshit apo për hatrin e Andropovit. Bashkimin Sovjetik, Partinë Komuniste Bolshevike të Lenin-Stalinit ne i kemi dashur e do t'i duam. Por, kur shohim se bëhen gjëra të tilla, është gabim i rëndë të mos mbash qëndrim të drejtë, dhe një gabim pastaj të çon te tjetri. Marksizëm-leninizmi dhe dialektika na mësojnë se, po të gabosh një herë dhe nuk do ta kuptosh se ke gabuar, ai gabim zmadhohet ashtu siç zmadhohet një top me borë që rrokulliset poshtë. Por një gjë të tillë ne nuk do ta lejojmë kurrë.

Si mund të merrnim pjesë në këtë veprimtari jo të drejtë? Nga shokët kinezë deri kohët e fundit ne nuk dinim asgjë për këto çështje. Vetëm Mikojani na vuri në dijeni në shkurt të këtij viti. Aeroplani ynë sapo kishte zbritur në Moskë, kur menjëherë erdhi një nga funksionarët e Komitetit Qendror dhe na tha se të nesërmen në mëngjes më kërkonte Mikojani në takim për të biseduar për disa çështje të rëndësishme. «Dakord, i thashë unë, por do të marr edhe shokun Mehmet [Shehu] me vete». Ai m'u përgjigj se «vetëm për ju më ka thënë», por unë i thashë se duhej të vinte edhe ai.

Shkuam dhe na mbajti jo pak, por rreth 5 orë dhe kjo para mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtores, të muajit shkurt, që do të bëhej për problemet e bujqësisë.

Mikojani na tha: «Shokë shqiptarë, unë do t'ju vë në dijeni për shumë mosmarrëveshje që kemi me Partinë Komuniste të Kinës, e theksoj me Partinë Komuniste të Kinës. Ne kishim vendosur që këto t'ua thoshim vetëm sekretarëve të parë, prandaj i lutem shokut Mehmet Shehu të mos na e marrë për keq, jo se nuk kemi besim te ai, por kështu kishim vendosur». «Jo, i tha Mehmeti, unë dal, bile bëra shumë gabim që erdha». Po vetë Mikojani nuk e la të largohej. Dhe pastaj na tregoi të gjitha ato që dëgjuat nga raporti i shokut Hysni.

Ne i thamë Mikojanit se këto nuk janë gjëra të vogla, por çështje shumë të rëndësishme që ekzistojnë në mes dy partive, prandaj nuk e kuptojmë pse janë lënë të trashen; mendojmë se ato duhej të ishin zgji-

dhur menjëherë se janë shumë të rrezikshme për kampin tonë.

Ai na tha se d'ia raportonte ato që biseduam Presidiumit të Komitetit Qendror të PK të BS. I thamë edhe një herë, në emër të Partisë sonë, se kjo është një çështje shumë e madhe, prandaj duhet zgjidhur në mes partive tuaja. Më në fund, na sinjalizoi se «kjo është një çështje shumë sekrete, prandaj as Byrosë Politike mos ia thoni». Dhe ne nuk ia thamë as Byrosë Politike, me përjashtim të disa shokëve. Ju e kuptoni se këtë qëndrim e mbajtëm se çështja na u duk tepër delikate dhe shpresonim se nëpërmjet diskutimeve e debateve të brendshme mund të zgjidheshin mosmarrëveshjet e lindura.

Mirëpo në Mbledhjen e Bukureshtit, Nikita Hrushovi e gjen të çuditshëm qëndrimin e Partisë sonë, që nuk u radhit së bashku me të gjitha partitë e tjera për të dënuar Kinën në ato forma dhe për ato arsye që shtroi ai, pa i gjykuar thellë këto çështje. Mundet ai vetë të ketë reflektuar mbi këto çështje, por edhe ne kemi të drejtë të themi se nuk kemi reflektuar për të gjitha ato materiale voluminoze që iu dhanë Hysniut, të cilat ai nuk pati kohë as t'i lexonte, pa le të jepte mendimin. Këtu nuk kishe të bëje me një çështje të vogël. Për shumë gjëra të tjera, jo të kësaj natyre, ne i jemi përgjigjur menjëherë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, se jemi dakord, por për një çështje kaq të madhe sa t'i themi Kinës: «ik jashtë nga kampi!», na duket se nuk është e drejtë. Byroja Politike ka menduar se ne nuk duhej ta bënim kurrë një akt të tillë. Për këtë arsye na u tha se «na

vjen shumë keq që Partia e Punës e Shqipërisë nuk u radhit me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, se çështjet që u shtruan në Bukuresht janë çështje të të gjithë kampit socialist». Por edhe ne a mund të mos na vijë hidhur të mos kemi të drejtë, si marksistë-leninistë, të pyesim Nikita Hrushovin nëse ai të gjitha çështjet me karakter të rëndësishëm ndërkombëtar i ka zgjidhur kështu si deshi të zgjidhte çështjen e Kinës? Këtë edhe ne kemi të drejtë plotësisht ta themi.

Le të marrim çështjen e revizionistëve jugosllavë, për të cilën do të flas edhe më vonë. Kur do të shkonte Nikita Hrushovi për herë të parë në Jugosllavi për t'u pajtuar me revizionistët jugosllavë, 2-3 ditë më parë i dërgoi një letër Komitetit Qendror të Partisë sonë, me të cilën na njoftonte për këtë çështje. Byroja jonë Politike u mblodh dhe gjykoi me gjakftohtësi. Dihet se dënimi dhe demaskimi i revizionistëve jugosllavë në vitin 1948 ishte bërë nga një forum ndërkombëtar i partive motra, nga Byroja Informativë, sepse nuk ishte një konflikt i thjeshtë dhe vetëm në mes të dy partive, por një çështje që u përkiste të gjitha partive komuniste dhe punëtore në botë. Prandaj, që të ndiqej një kurs tjetër kundrejt revizionistëve jugosllavë, duhej të mbli-dhej përsëri po ai forum që kishte vendosur, dhe ai të zhvendoste ose të caktonte formën dhe metodën e shqyrtimit të kësaj çështjeje dhe deri ku do të bëhej kthesa në qëndrimin ndaj revizionistëve. Kështu mendojmë ne se duhej vepruar në bazë të normave leniniste.

Byroja Politike e Partisë sonë i dërgoi një letër Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik me të cilën njoftonte se nuk kishte kundërshtim

për këtë gjë, pasi nuk varej nga ne nëse duhej të shkonte apo jo Hrushovi në Beograd. Por Komiteti Qendror i Partisë sonë, theksuam ne, mendon se për këtë çështje duhet të merret një vendim tjetër, duhet të mbledhet përsëri Byroja Informativë dhe në mbledhjen e saj plenare të vendosë çfarë duhet bërë. Megjithatë ne nuk ishim anëtarë të Byrosë Informativë shfaqëm dëshirën që të ftoheshim në këtë mbledhje si vëzhgues dhe të thoshim edhe ne pikëpamjen tonë. Mirëpo një gjë e tillë nuk u bë, megjithatë kjo ishte një çështje që nuk u përkiste vetëm dy partive, por të gjitha partive komuniste e punëtore. Komiteti Qendror i Partisë sonë mbajti qëndrim për këtë hap duke njoftuar me anën e një letre tjetër Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, kopjet e të cilave janë në arkivat e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Komitetit Qendror të Partisë sonë.

U bë kundërrevolucioni në Hungari, një katastrofë e madhe. Atje iu dha një goditje socializmit nga imperia- lizmi i bashkuar me revizionistët jugosllavë, me Imre Nagin dhe me gjithë llumin antikomunist. Ç'qëndrim u mbajt para dhe pas këtyre ngjarjeve? Edhe kjo ishte një çështje që i përkiste gjithë komunizmit ndërkombëtar, veçanërisht kampit të socializmit. Dihej që pak më parë ishin bërë përpjekje për shpërthimin e një kundër- revolucioni të tillë edhe në Shqipëri, pra, rrezikohej ekzistenca e një pjesëtari të Traktatit të Varshavës, e Shqipërisë, që ishte kërcënuar vazhdimisht dhe kërcënohej gjatë gjithë atyre viteve me humbjen e lirisë dhe të pavarësisë së saj. Por Partia jonë diti t'i godasë

armiqtë e brendshëm dhe bëri që në vendin tonë të mos ndodhte gjë. Mirëpo për sa ndodhnin në Hungari, ne nuk ishim vënë në dijeni, Shqipëria «ishte harruar». Anëtarët e Presidiumit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik u nisën nga të katër anët me aeroplan nëpër vendet socialiste, për të shpjeguar çështjen e kundërrevolucionit hungarez, kurse në Shqipëri, që ishte një pikë shumë nevroalgjike e kampit socialist, e sulmuar vite me radhë nga revizionistët me Titon në krye dhe që kishin dijeni të plotë se ishte përgatitur një kundërrevolucion i tillë edhe kundër vendit tonë, nuk erdhi njeri dhe as na u tha gjë.

E keni dëgjuar ndonjëherë këtë? Asnjëherë. Ne këto nuk i bënim çështje, sepse mendonim që ishin gabime të njerëzve të veçantë e që një ditë do të korrigjoheshin. Ato nuk ia thamë as Komitetit Qendror të Partisë sonë, megjithëse Komiteti Qendror është udhëheqja e Partisë së Punës. Por në ato kohë të vështira, nuk donim që këtë hidhërim të Byrosë Politike t'ua komunikonim të gjithë shokëve të Komitetit Qendror, nuk donim për asnjë grimë që këto kritika, qoftë edhe në mënyrë të pandërgjegjshme, të kalonin në një ftohje me shokët sovjetikë. Këtë ne nuk e kemi lejuar. Po, mendonim se njerëzit e veçantë bëjnë gabime, si te ne, ashtu edhe te ata.

Ndodhën ngjarjet e Polonisë. Për këto ngjarje ne nuk u informuam, nuk u bë asnjë mbledhje dhe duhet pasur parasysh se ato nuk ishin vetëm çështje të brendshme të Polonisë, se ne jemi lidhur me Poloninë me një traktat që, po të vijë rasti, popullit tonë do t'i kërkohet të derdhë gjak për kufijtë në Oder-Najse. Atë-

herë, kur është kështu, nuk ka të drejtë populli shqiptar të pyesë se ç'janë gjithë ata priftërinj në ushtrinë polake? Me një ushtri të tillë do të luftojmë bashkë? Ne jemi të lidhur me një traktat, por megjithëkëtë as që u pyetëm për këto çështje. Mua Hrushovi dikur më kishte thënë haptazi se «nuk po e kuptojmë këtë Gomulkën çfarë flet, vetëm fashistët mund të flasin si Gomulka». A ishin, pra, këto çështje vetëm të dy partive? Ne vetëm sot i bëjmë çështje këto, sepse sot Nikita Hrushovit dhe udhëheqësve të tjerë sovjetikë u vjen keq që veprimet e tyre të gabuara në Bukuresht, ne gjoja nuk i paskemi kuptuar si duhet, kur themi se janë çështje në mes të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës. Ky qëndrim i tyre nuk është një qëndrim logjik.

Dy-tri ditë para Mbledhjes së Bukureshtit, Kosigini vete te Mehmeti që ndodhej në Moskë dhe ndër të tjera i thotë: «Ne, në asnjë mënyrë nuk mund të bëjmë asnjë kompromis, asnjë lëshim ndaj kinezëve» dhe e përsëriti këtë shprehje katër herë me radhë. Kjo do të thotë se çdo gjë ishte e paravendosur nga sovjetikët. Kur nuk pranohet asnjë mendim, atëherë përse më kërkon mua atje, për të mbushur numrin, për të ngritur dorën? Jo, në rast se më fton duhet të them edhe unë atë që mendoj. Ne jemi me Deklaratën e Moskës [1957] dhe luftojmë për zbatimin e saj në vendin tonë. Por, shokë, në zbatimin e çështjeve kemi edhe ne për të thënë fjalën tonë, kanë edhe sovjetikët për të thënë fjalën e tyre, për ne kanë për të thënë edhe shokët kinezë ose çekoslovakët, kemi edhe ne për të thënë për ta etj. Çështje të tilla mund të ketë në jetë. Sigurisht mund

të ngjasë që çdo parti në praktikë të bëjë lëshime ose gabime. Po përse jemi këtu? Të ndihmojmë njëri-tjetrin për t'u korrigjuar në rrugë të drejtë.

Por ne shohim se disa gjëra nuk përputhen në praktikë me zbatimin e vijës nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe nga mjaft parti të tjera. Këto kanë të bëjnë me çështjen e luftës kundër revizionizmit jugosllav, në bazë të Deklaratës së Moskës dhe përpara Deklaratës së Moskës.

Tani unë nuk dua t'ju përsërit e t'ju them ç'janë revizionistët jugosllavë dhe si duhet luftuar kundër tyre. Por, për rrugën si duhen luftuar, nuk mendojnë të gjithë si ne. Mirëpo, të kritikosh Partinë tonë për qëndrimin e saj heroik marksist-leninist kundër revizionistëve jugosllavë, që mundohen të përçajjnë partitë e vendet socialiste e që kërkojnë të likuidojnë Shqipërinë, këtë nuk mund ta pranojë kurrë Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë sonë. Komiteti Qendror, gjithë Partia e populli e kanë aprovuar qëndrimin e drejtë që kemi mbajtur dhe mbajmë ndaj revizionistëve jugosllavë. Qëndrimin tonë e respektojnë shumë parti e komunistë në botë.

Byroja jonë Politike edhe mosmarrëveshjet në lidhje me zbatimin në praktikë të vijës marksiste-leniniste ndërmjet të gjitha partive motra, pa përjashtim, kundër revizionistëve jugosllavë nuk i ka bërë çështje pazari, por ka ditur të manovrojë me urtësi, me gjakftohtësi dhe jo me gjaknxehhtësi, si thotë Hrushovi. Byroja Politike ka vepruar në mënyrë të tillë që të mos i lërë të kuptojë jo vetëm popullit, jo vetëm opinionit ndërkombëtar, por në shumë raste as Komitetit Qendror

që në zbatimin praktik të kësaj çështjeje ka ndryshime midis nesh.

Provat kanë qenë aq të mëdha, saqë nuk mund të dyshosh aspak se revizionistët jugosllavë nuk janë armiq të betuar të kampit socialist. Ata janë agjentura e imperializmit, këtë e ka thënë edhe vetë ministri i Punëve të Brendshme të Bashkimit Sovjetik në konferencën e ministrave të brendshëm të vendeve socialiste të Evropës, që u mbajt para dy javësh në Pragë, dhe të gjithë kanë qenë dakord me këtë konkluzion.

Nikita Hrushovi e ka kritikuar qëndrimin tonë ndaj revizionistëve jugosllavë. Kur ne vajtëm me delegacionin e Partisë dhe të Qeverisë në Moskë në vitin 1957 dhe folëm, përveç të tjerave, edhe për qëndrimin tonë ndaj revizionistëve jugosllavë, Hrushovi u revoltua aq shumë, sa u ngrit e tha: «Nuk bisedohet me ju, t'i presim bisedimet». Ne u indinjuam, por mbajtëm gjakftohësi se ishim në rrugë të drejtë dhe mbronim popullin dhe Partinë tonë, mbronim miqësinë tonë me Bashkimin Sovjetik. Ne nuk u përkulëm nga presioni që na u bë dhe e detyruam Hrushovin, me qëndrimin tonë, të ulej dhe të vazhdonim bisedimet. Unë me Mehmetin ishim shumë të shqetësuar kur shkuam në miting pas asaj që na ndodhi, por dora dhe zemra atje nuk na u drodhën. Të sillesh në një mënyrë të tillë me Partinë tonë, pse ajo mban qëndrim revolucionar kundër revizionistëve jugosllavë, kjo nuk është aspak e drejtë. Megjithatë ne nuk u lëkundëm asnjëherë, përkundrazi duam dhe gjykojmë se e kemi drejt dhe se koha do ta tregojë drejtësinë e vijës së Partisë sonë. Nuk vonoi dhe përsëri u duk se ç'ishin revizionistët jugosllavë me

komplotet që përgatitën në kongresin e tyre. Atëherë vetë Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik mbajti qëndrim, vetë Hrushovi i demaskoi ata, duke i cilësuar «banditë», «kali i Trojës» e të tjera.

Nuk mjaftoi me kaq. 15 ditë para se të ndodhte kundërrevolucioni në Hungari, unë dhe Mehmeti, në një takim që kemi pasur me Suslovin në Moskë, kur po bisedonim për çështje ndërkombëtare, i thamë mbi përshtypjet tona për Hungarinë, i vumë në dukje se ç'po ndodhte atje dhe se duheshin marrë masa e të ishim vigjilentë. Ai na pyeti se ç'mendim kishim për Imre Nagin. Kur ne iu përgjigjëm se ai është një njeri i poshtër, një antimarksist, Suslovi menjëherë na tha se e keni gabim, se Nagi nuk paskësh qenë njeri i keq. Ne i thamë se ky është mendimi ynë, kurse ai na tha se partia atje kishte bërë gabim që e kishte përjashtuar. Koha tregoi se ç'ishte Imre Nagi dhe sa i drejtë e i saktë ishte mendimi ynë për të.

Nikita Hrushovi kishte marrë një letër të gjatë nga tradhtari Panajot Plaku ku i shkruante për «patriotizmin» e tij të madh, për «dashurinë e zjarhtë» që ka për Bashkimin Sovjetik dhe për Partinë e Punës të Shqipërisë dhe i kërkonte që Hrushovi me autoritetin e tij të ndërhynte për të likuiduar udhëheqjen e Partisë sonë me Enver Hoxhën në krye, se ne qenkemi «antimarksistë», «stalinistë». Atje ai shkruante se kishte ikur në Jugosllavi, pasi gjoja na qenkej organizuar një komplot kundër tij për ta vvarë. Sa e mori Hrushovi letrën, na tha: «Po sikur të vijë ky Plaku në Shqipëri, ose ta marrim në Bashkimin Sovjetik?». Ne iu përgjigjëm se «po të vijë në Shqipëri, ne do ta varim 20 herë, kurse,

po të vijë në Bashkimin Sovjetik, do të bëni një veprim që do të jetë fatal për miqësinë tonë». Atëherë ai u tërhoq.

Po puna shkon edhe më tej. Hrushovi na ka thënë se ne nuk kemi bërë mirë që kemi vrarë Dali Ndreun dhe Liri Gegën, e cila ishte shtatzënë. «Një gjë të tillë as cari nuk e ka bërë» — tha ai. Ne iu përgjigjëm me gjakftohtësi se nuk bëjmë vrasje kot dhe shkojmë në plumb vetëm ata që tradhtojnë atdheun dhe popullin e pasi vërtetohet se kanë bërë vepra armiqësore dhe e kanë mbushur kupën. Këta njerëz Partia jonë i ka dënuar me vite të tëra, ata kanë qenë tradhtarë dhe agjentë të revizionistëve jugosllavë dhe, vetëm kur deshën të arratiseshin, organet tona i zunë dhe gjyqi i popullit, në bazë të fakteve, u dha dënimin e merituar. Përsa i përket asaj se Liri Gega ka qenë gjoja shtatzënë, kjo është shpifje.

Këto gjëra ne nuk i kemi hapur ndonjëherë, këto ju po i dëgjoni për herë të parë. Po të mos kritikoheshin, si i ka kritikuar Byroja jonë Politike këto gabime, do të ishte e palejueshme. Edhe ju nuk duhej të na i lejonit, sepse këto nuk e forcojnë miqësinë. Ç'kemi bërë ne me gjithë këto që kanë ndodhur dhe që na kanë bërë si në lëmin ndër-kombëtar, ashtu edhe në çështjet e brendshme? Keni parë ju ndonjë gjë në shtyp ose keni dyshuar për ndonjë veprim kundër Bashkimit Sovjetik ose udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik? Jo.

Këto qëndrime që janë mbajtur ndaj nesh, nuk ia kemi thënë askujt, por ne jemi marksistë dhe tani është koha t'i themi. Është hapur fjala se shqiptarët janë

gjaknxehtë. E përse jemi gjaknxehtë? Gjaknxehtësi është të mbrosh atdheun dhe popullin tënd nga revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë, nga neofashistët italianë që kanë 16 vjet e më tepër që po na sulmojnë e na provokojnë në kufi? Nëse ne quhemi gjaknxehtë pse mbrojmë interesat jetike të popullit tonë, këtë ne nuk e pranojmë. Haram qumshti i nënës, haram buka që na ushqen Partia dhe populli, në qoftë se ne nuk mbrojmë interesat e popullit tonë. Duke vepruar kështu, ne mbrojmë njëkohësisht edhe interesat e Bashkimit Sovjetik dhe të të gjithë kampit të socializmit.

Do të them edhe një shembull të vogël që na ndodhi parimbrëmë. Erdhi në takim ambasadori i Bashkimit Sovjetik, Ivanovi, dhe më solli një informacion të Hrushovit në lidhje me takimin me Sofokli Venizellosin. Në mes të tjerash, ky i ka folur Hrushovit edhe për Shqipërinë. Venizellosi i ka thënë se «me Shqipërinë do të merremi vesli, po të bisedojmë edhe për çështjen e Epirit të Veriut, çështja e të cilit duhet të zgjidhet në formën e autonomisë». Hrushovi ishte shprehur se «këto çështje ju duhet t'i zgjidhni në mënyrë paqësore, por unë këtë pikëpamje do t'ua them shokëve shqiptarë».

I thashë menjëherë ambasadorit sovjetik se Hrushovi nuk i është përgjigjur drejt, se nuk duhej t'i jepte atë përgjigje që i dha, por t'i kishte thënë Venizellosit se kufijtë e Shqipërisë janë të pakalucshëm. Ambasadori sovjetik më tha: «po ju e dini qëndrimin e Bashkimit Sovjetik». «Unë këtë e di, po konkretisht përgjigjja që i ka dhënë Venizellosit, nuk ka qenë e drejtë. Në këtë Venizellos nuk e njohim, i thashë ambasadorit Ivanov,

por babanë e tij¹ ne e njohim mirë. Në qoftë se Moska nuk e njeh, megjithëse duhet ta njohë, ne i themi se ai ka djegur gjithë Shqipërinë e Jugut dhe ka vrarë mijëra shqiptarë, ka dashur të djegë edhe Gjirokastrën, ka organizuar banda dhe është ai që ka hedhur prej kohësh idenë e autonomisë së «Epirit të Veriut». Pra ideja e Venizellosit të ri është e vjetër, është ideja e gjithë shovinizmit grek. Prandaj, kundër kësaj ideje, për të mbrojtur tërësinë e vendit të tij, populli shqiptar në të kaluarën ka derdhur gjak dhe, po të jetë nevoja, do të derdhë edhe në të ardhshmen. Ne jemi për paqen në Ballkan, jemi për marrëdhënie normale shtetërore, marrëdhënie tregtare, por kushte të tilla me Greqinë nuk pranojmë. Ne do t'i normalizojmë marrëdhëniet me Greqinë, kur ajo të thotë se nuk është në gjendje lufte me Shqipërinë, ndryshe nuk do të bëjmë asnjë marrëveshje. Me të duhet të bashkëpunojmë në baza pariteti. Mënyrës si është vepruar deri tani, i është dhënë përgjigje. Nesër ndonjë udhëheqës sovjetik mund të deklarojë se shoku Enver ka thënë që Bashkimi Sovjetik nuk e mbron Shqipërinë. Nuk është kështu, gjërat duhet të dalin qartë si thuhet.

Ne flasim në bazë të fakteve dhe nuk e kalojmë masën, se shikojmë në radhë të parë interesin e madh të përgjithshëm. Edhe në këtë rast pra është çështja e një interesi të madh. Byroja Politike me qëndrimin

¹ Është fjala për Elefter Venizellosin (1864-1936), udhëheqës reaksionar grek, përfaqësues i interesave të borgjezisë së madhe greke. Për disa vjet me radhë kryeministër i Greqisë. Më 1919 dërgoi ushtrinë greke për të marrë pjesë në intervencionin kundër Rusisë Sovjetike.

që shprehëm në Bukuresht ka vepruar shumë drejt e me gjakftohtësi, sepse nuk mund të lejohej që gjithë këto çështje të rëndësishme politike dhe ideologjike në mes të dy partive të mëdha të zgjidheshin kaq lehtë dhe pa përgjegjësi.

Më në fund, pyesim: Çfarë u bë në Bukuresht? Asgjë nuk u zgjidh, vetëm se u rreshtuan forcat për një luftë të ashpër, sikur kishim të bënim me SHBA-në dhe jo me motrën e madhe, Kinën. Ne u kemi qëndruar besnikë propozimeve të udhëheqjes sovjetike për të vajtur në mbledhjen e Moskës dhe për t'i zgjidhur këto çështje, por të kemi edhe materialin nga ana e shokëve kinezë. Ashtu sikurse e ka paraqitur Bashkimi Sovjetik çështjen në Bukuresht, të lihet edhe Kina të flasë dhe të paraqesë pikëpamjen e saj, pastaj të gjykojmë.

Derisa kemi vendosur të bëjmë Mbledhjen e Moskës me një program të caktuar është e nevojshme të kemi edhe ne kohë t'i studjojmë çështjet mirë. Sovjetikët e kanë pranuar një gjë të tillë, atëherë përse vepronë kështu? Kjo nuk është e drejtë. Kështu ka menduar Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë sonë.

Byroja Politike ka menduar që Partia jonë, në asnjë mënyrë të mos njolloset me veprime të tilla organizative jomarksisteleniniste. Po atëherë për ç'qëllime shkuan partitë e tjera? Çdo parti është përgjegjëse përpara Komitetit Qendror dhe popullit të vet si dhe përpara komunizmit ndërkombëtar. Ne le të na gjykojë Komiteti Qendror i Partisë sonë dhe jemi përgjegjës para tij, para Partisë, para popullit dhe komunizmit ndërkombëtar për qëndrimin tonë.

Po përse në Bukuresht shkuan sekretarët e parë të partive të vendeve socialiste dhe unë nuk shkova? Unë bëra shumë mirë që nuk shkova, se zbatova vendimin e Byrosë Politike, për të mos komprometuar Partinë tonë në çështje që nuk janë marksiste-leniniste. Unë do të paraqitja atje mendimet e Byrosë Politike. të cilat shumë mirë i transmetoi Hysniu. Mosvajtja ime u dogji udhëheqësve sovjetikë se atje shkuan të gjithë, vetëm Enveri nuk shkoi, se veprimet nuk binin erë të mirë. Partia mua do të më dërgojë në nëntor në Moskë për ta thënë fjalën e saj. Partia jonë do ta thotë pikëpamjen e vet kur kjo pikëpamje të aprovohet në Komitetin Qendror, se kjo nuk është një gjë e thjeshtë.

Në Bukuresht u caktua data dhe komisioni i përbërë nga përfaqësuesit e 26 partive që t'i studjojnë mirë këto çështje, t'i hedhin në letër, në mënyrë që materialet t'u dërgohen komiteteve qendrore të të gjitha partive respektive për t'i studjuar e për t'i diskutuar. Pas kësaj, t'i thuhet Komitetit Qendror: shokë, ja materiali i njërës palë, ja materiali i palës tjetër, ja edhe pikëpamja e Byrosë Politike, prandaj mendojmë se duhet të mbajmë këtë qëndrim. Kështu mendojmë ta diskutojmë këtë çështje në Komitetin Qendror dhe pastaj të shkojmë në mbledhje. Kjo është forma më e rregullt. Të mos pranosh t'i japësh një ose dy muaj afat një partie motër për të reflektuar, pra, të bësh një veprim të tillë që nuk të jep asnjë rezultat, nuk është e drejtë. Mendoj se Byroja Politike në këtë rast ka mbajtur qëndrim marksist-leninist, në mbrojtje të interesave të kampit socialist. Nga qëndrimi ynë nuk u ka ardhur mirë udhëheqësve sovjetikë, se nuk u

reshtuam edhe ne me ta siç bënë Gomulka, Kadari dhe Zhivkovi në këto çështje. Por e vërteta është se, për të mbrojtur Bashkimin Sovjetik, Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ka vepruar mirë vetëm Partia e Punës e Shqipërisë dhe ne duhet të jemi kurdoherë parimorë në këto çështje. Gabime dhe mosmarrëveshje ngjasin, por ato duhen zgjidhur në rrugë të drejtë, në bazë të parimeve dhe të normave leniniste.

Pas gjithë këtyre që ngjanë, të vjen keq dhe hidhur, kur sheh që ambasadori sovjetik dhe ai bullgar në Beograd qëndrojnë deri në fund dhe duartrokasin agjentin Rankoviç në Sremska Mitrovica të Serbisë, i cili foli aq ndyrë kundër kampit socialist dhe veçanërisht kundër Shqipërisë. Ai e cilësoi Shqipërinë socialiste si «skëterrë ku mbretëron teli me gjemba» dhe demokracinë tonë popullore më keq se regjimi i sotëm në Itali. Marrëdhëniet midis Jugosllavisë dhe Italisë ai i mori si shembull, si model, sepse me miliona jugosllavë e italianë çdo vit hyjnë e dalin lirisht në kufijtë e njëritjetrit. Neve na vjen keq për këtë qëndrim dhe ia thamë Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Bullgare ka marrë vendim të mos sulmohen revizionistët jugosllavë as në shtyp, as në fjalimet e udhëheqësve. Teodor Zhivkovi, kur i dha dorën shokut Hysni, që porsa kishte shkuar në Bukuresht, me paturpësinë më të madhe, i tha: «Çfarë bën Shqipëria? Vetëm Shqipëria nuk është dakord!». «Çfarë doni të thoni ju me këtë?», e pyeti Hysniu. «Jo, jo, bëra shaka!», iu përgjigj Zhivkovi. Po të mos jesh konsekuent në luftën kundër revizionistëve jugosllavë, të ndodhin ato që ndodhën në Bullgari. Në

ndërmarrjet bullgare të botimeve është shtypur 2 muaj më parë, me gabime të mëdha, një broshurë e ilustruar me një hartë të Ballkanit, ku Shqipëria paraqitet si pjesë e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë. Natyrisht, për një gjë të tillë Komiteti Qendror i Partisë sonë protestoi dhe, megjithëse udhëheqësit bullgarë shprehën keqardhjen për atë që ndodhi dhe premtuan se do të merrnin masa për grumbullimin e të gjitha broshurave, këto broshura kanë marrë dhenë në të katër anët e botës. Ata këtë e paraqitin vetëm si një gabim teknik. Por përse nuk u bë gabimi që një pjesë e Bullgarisë t'i jepej, fjala vjen, Turqisë?

Në Poloni 6 muaj më parë, njerëz të rekomanduar nga Ministria e Jashtme e RP të Polonisë, në festën e 29 Nëntorit, tentuan të vidhnin dokumentet shtetërore dhe t'i vinin zjarrin ambasadës shqiptare dhe, pasi u zunë me presh në duar, vjedhësit, për të humbur gjurmët, morën filmin «Skënderbeu». Por kriminelit u kap dhe ne protestuam për këtë gjë. Po ç'ndodhi? Prokurori kërkoi që fajtori të dënohej me 12 vjet burgim, kurse gjykata e dënoi me 2 muaj kondicional.

Një javë më parë, ish-shifranti i ambasadës polake në Tiranë dhe tani nëpunës i Ministrisë së Jashtme në Varshavë, shkoi në ambasadën tonë dhe nxori revolvërin për të vrrarë ambasadorin tonë, por njerëzit tanë atje e kapën dhe ia dorëzuan policisë.

Ç'janë këto gjëra? Ç'është ky terror i bardhë kundër vendit tonë? Ne i kemi dërguar një notë proteste qeverisë polake, kemi thirrur ambasadorin tonë në Tiranë dhe i kemi thënë qeverisë polake që në qoftë se nuk e siguron Qeverinë Shqiptare se veprime të tilla

nuk do të ndodhin më kundër personelit të ambasadës sonë në Varshavë, ne nuk do ta kthejmë ambasadorin atje. Për këtë ngjarje vumë në dijeni edhe të gjithë ambasadorët e vendeve socialiste, të cilët u indinjuan shumë nga kjo ngjarje.

Atëherë ç'janë këto gjëra? Përse ndodhin? Prandaj t'i gjykojmë dhe të na thuhet nëse kemi gabuar apo jo, nëse kemi vepruar me urtësi apo me gjaknxehësi. Ju e kuptoni se këto gjëra kanë rëndësi të madhe për të gjithë ne, e sa më parë duhen zgjidhur në rrugë të drejtë, në rrugë shoqërore. Tjetër rrugë nuk ka për zgjidhjen e këtyre çështjeve. Normat i ka caktuar Lenini, atëherë t'i zbatojmë. Përse dy norma, përse dy masa, përse dy pesha? Këtu duhet të ketë vetëm një normë, një masë, një peshë. Këtej ne duhet të dalim të qartë se kemi të drejtë, se ndërgegjja jonë është e pastër dhe asgjë nuk ka ndryshuar në qëndrimet tona të patundura.

Ne duhet të jemi të qartë për këto çështje, se kështu kurrë nuk gabojmë dhe nuk duhet të gabojmë, kurrë nuk duhet ta shtrembërojmë busullën dhe nuk duhet të lejohen shtrembërime nga ana e kujtdo qoftë.

Duhet pasur parasysh se ky është fillimi i një pune shumë të ndërlikuar, por me bindjen tonë dhe me mundësitë tona modeste ne do të bëjmë ç'është e mundur që këto çështje të rregullohen drejt, në rrugën marksiste-leniniste. Tani kërkohet uniteti i çeliktë i Komitetit Qendror të Partisë sonë, i Komitetit Qendror me masën e Partisë, i Partisë me popullin tonë.

Nga ky Plenum ne duhet të dalim të fortë si çeliku, si kemi qenë kurdoherë, dhe tani akoma më shumë,

sepse ne mbrojmë marksizëm-leninizmin. Të mbrojmë me vendosmëri atdheun dhe Partinë tonë, se kështu kemi mbrojtur popullin dhe të ardhshmen e tij. Kjo është e vetmja rrugë e drejtë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Plenumit
XVII të KQ të PPSH që
gjendet në AQP*

**NE DO TË FLASIM NË MOSKË SIÇ NA MËSON
MARKSIZËM-LENINIZMI, GJUHË TJETËR
PËR NE NUK KA**

Fjala e mbylljes në Plenumin XVII të KQ të PPSH

12 korrik 1960

Siç e thatë të gjithë, sikurse foli edhe shoku Mehmet që shprehu drejt, në mënyrë marksiste-leniniste, pikëpamjen e të gjithë Partisë sonë, çështjet që u shtruan në këtë Plenum, janë jetike dhe nuk kishim asnjë fije dyshimi se Komiteti Qendror i Partisë sonë, i cili ka dalë nga lufta, nga përpjekjet dhe nga mundimet e mëdha të popullit dhe të Partisë sonë, do të ishte patjetër në lartësinë e duhur në këtë moment kaq të vështirë që po kalon lëvizja komuniste ndërkombëtare.

Ne mund të nxjerrim një konkluzion të madh se akoma pa ia hequr petën lakrorit, anëtarët e Komitetit Qendror të Partisë sonë janë jashtëzakonisht vigjilentë dhe të armatosur me ideologjinë marksiste-leniniste, i kuptojnë këto probleme shumë më mirë nga shumë njerëz që po vënë çdo ditë tellallin, por që në fakt punojnë për të gënjyer njerëzit dhe popujt. Anëtarët e

Komitetit Qendror të Partisë sonë janë kalitur në luftën e Partisë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Në dukje ata janë të thjeshtë dhe kjo është një meritë e madhe e udhëheqjes sonë. Por shokët e Plenumit të Komitetit tonë Qendror janë në nivel të lartë përsa i përket kuptimit të drejtë të problemeve politike e ideologjike dhe kanë një nuhatje të jashtëzakonshme për të parë, për të gjykuar dhe për të thënë me një kurajë të jashtëzakonshme dhe shembullore pikëpamjen e tyre ndaj kujtdo që bën gabime të mëdha, të cilat i kushtojnë shumë socializmit e revolucionit proletar në botë.

Pse ka pasur një udhëheqje të tillë Partia jonë, prandaj ka fituar gjithë këto beteja dhe me këtë udhëheqje ajo do të kapërcejë të gjitha vështirësitë, sado të mëdha që të jenë. Gjithashtu, është plotësisht e drejtë shprehja juaj, shokë të Komitetit Qendror, se Partia jonë e vogël, por trime dhe heroike, me siguri do të kontribuojë për të mirën e lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Ne do të shkojmë të flasim në Moskë siç na mëson marksizëm-leninizmi dhe do të flasim vetëm kështu si na porosit Komiteti Qendror, gjuhë tjetër për ne nuk ka. Sigurisht disave, ato që do të themi ne, nuk do t'u vijnë pas oreksit, por ne mendojmë se fjalët tona të drejta, të bazuara në marksizëm-leninizmin dhe në faktet, nuk do të mbeten brenda katër mureve të dhomës ku do të zhvillohet mbledhja, ato do të dëgjohen me siguri nga të gjitha partitë dhe nga popujt e tjerë. E vërteta nuk mund të fshihet, ajo nuk mund të mbyllet në burg, nuk mund të ndrydhet me kërcënime ose me shantazhe. Partia jonë, që ka dalë nga gjiri i popullit, nuk u trem-

bet kurrë as kërcënimeve as shantazheve, por ka për të qëndruar kurdoherë e palëkundur.

Është e domosdoshme të mbahen qëndrime të tilla të vendosura se ato janë jetike për ne si komunistë, si marksistë, si patriotë. Përse udhëheqësit sovjetikë e kanë çuar punën si në një panair dhe me një mendjelehtësi të çuditshme po kërkojnë të diskutojnë një turlig formulash, të kapen pas disa fjalësh dhe shprehjesh, jo the kështu, jo the ashtu, të cilat jo vetëm nuk janë të lejueshme, por janë edhe njaft të dyshimta? Në Mbledhjen e Moskës ne do të diskutojmë sipas parimeve të marksizëm-leninizmit dhe të bazuar në eksperiencën tonë revolucionare, në faktet e përditshme.

A mund të lejohet që në një kohë kur imperializmi po armatoset deri në dhëmbë dhe po bën kaq provokacione, në një kohë kur gjendja revolucionare në Azi e gjetkë po ngrihet, kur në Japoni, për shembull, me miliona njerëz sulmojnë Kishin dhe qeverinë e tij, kur ata frymëzohen nga Partia heroike Komuniste e Kinës, nga idetë e Mao Ce Dunit, udhëheqësit sovjetikë dhe Hrushovi, duke u kapur pas formulave, të shkojnë drejt përçarjes së kampit të socializmit?! Tamam në këto momente udhëheqësit sovjetikë përçajnë kampin dhe diskreditojnë këtë forcë të madhe revolucionare që frymëzon gjithë Azinë.

Pikërisht tani, kur luhen fatet e njerëzimit, t'i thuash Kinës të dalë nga kampi është një krim i madh që i bëhet njerëzimit dhe komunizmit ndërkombëtar. Në një kohë kur Bundesveri gjerman po merr armë raketë dhe po kërcënon Evropën dhe botën, Nikita Hrushovi sulmon Partinë Komuniste të Kinës dhe e

akuzon si luftëdashëse, sepse ajo me të drejtë thotë që parullat e çarmatimit janë vetëm iluzione. Vetëm Nikita Hrushovi qenka për paqe!

Me siguri faktet dhe qëndrimi i partive marksiste-leniniste do ta demaskojnë këtë veprimtari jomarksiste dhe do ta detyrojnë Hrushovin të veprojë ndryshe. Ai u detyrua të thotë në mbledhjen e oficerëve të diplomuar që u bë në Kremlin: «Ne u tërhoqëm nga Gjeneva nga komisioni i të dhjetëve, sepse çarmatimi është bërë një iluzion, një perde që shërben për të gënjyer popujt».

Shikoni, pra, ç'metoda përdoren. Ç'thuhet sot nuk thuhet nesër, një fjalë pro një çështjeje, pesë kundër saj, domethënë një konfuzion i madh dhe, kur ti kërkon t'i vësh pikat mbi i-të, kërcen hop si pëhlivani dhe në një numër të «Pravdës» shkruajnë se kanë thënë edhe për këtë edhe për atë. Kanë thënë, po çfarë po dalin këtu? Ike nga komisioni i të dhjetëve. por kë pyete që ike? Sa kohë keni ju, shokë, që e dini këtë çështje? Rreth 10 ditë. Po jemi apo nuk jemi ne anëtarë të shteteve pjesëmarrëse të Traktatit të Varshavës? Vetëm sot mora një telegram, me të cilin njoftohemi nga qeveria sovjetike se ikën nga Gjeneva dhe çështja iu dha OKB-së. Po ç'janë këto? Dhe si këto. shokë, ka shumë.

Shokët këtu i numëruan të gjitha çështjet dhe kjo tregon pjekurinë e madhe të Komitetit Qendror të Partisë sonë dhe jo vetëm të Byrosë Politike. Çdonjëri nga ne mund të bënte gabime, por te ne kjo s'ka ndodhur, se jemi të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. shkëmbejmë mendime me njëri-tjetrin, i shoshitim mirë

ato dhe qëndrojmë kështu në rrugë të drejtë. Kjo është metoda marksiste-leniniste, metoda më e drejtë për të mos gabuar dhe ne nuk kemi gabuar, jo për meritë të një ose dy personave, por të unitetit tonë të mendimit, të bisedimeve të hapëta shoqërore dhe vëllazërore, se jemi luftëtarë të një çështjeje të madhe dhe të vetme, të triumfit të komunizmit, të mirëqenies së popullit tonë, të ndërtimit të socializmit në Shqipëri, për ta nxjerrë këtë popull të shumëvujtur në dritë.

Ky unitet e bën forcën tonë të pathyeshme, kjo na shton besimin në luftën tonë kundër vështirësive, në përballimin e furtunave, për të dalë fitimtarë, dhe me siguri ne do të dalim fitimtarë. Por përpara nuk kemi shesh me lule, edhe luftë do të kemi. Përse? Sepse udhëheqësit sovjetikë nuk veprojnë me një logjikë të shëndoshë marksiste-leniniste. Unë mund t'ju them, dhe kjo është pikëpamja e të gjithë Byrosë Politike, se në veprimtarinë e tyre ka gabime të rënda e të thella, ka shkelje të normave leniniste, ka subjektivizëm, ka antimarksizëm, ka një shovinizëm të tmerrshëm. Formula dhe norma mund të përmendin sa të duash, por po të hapim një herë sytë dhe të themi: dale të analizojmë pak veprimet e tyre, se po na thuhet «ose kështu si themi ne, ose nuk ka!». Ç'domethënë kjo? Atëherë mos na fol për leninizmin! Unë kam mendimet e mia dhe dua t'i them ato, mirë ose keq. Mirëpo ti po merr masa antileniniste që, po më gjete frikacak, të më gjunjëzosh. Por komunistët e vërtetë nuk janë ashtu, të tillë mund të ketë vetëm disa.

Kjo është një çështje shumë e madhe. Partia na ka mësuar dhe na ka edukuar që të mos i hamë kalbësitat

që na sërvinin revizionistët, të mos e hamë sapunin për djathë.

Ne jemi përgatitur me kohë për këtë luftë. Mundet edhe të na kritikoni që jemi treguar, si të thuash, ca konspirativë ndaj jush për këto çështje. Për këtë keni të drejtë. Ju nuk mund ta imagjinoni ç'forca të mëdha morëm ne këtu, nga Plenumi i Komitetit Qendror, ç'mësime të mëdha nxorëm nga ju për trimërinë që duhet të tregojmë në të ardhshmen, pse, ashtu si u radhitën forcat në Bukuresht, do të jetë shumë e vështirë që menjëherë të shpartallohen radhët e armiqve. Në Mbledhjen e Moskës do të bëhet një betejë e tmerrshme. Por si u shtruan çështjet këtu dhe si na armatosi Komiteti Qendror, në qoftë se syri nuk na është trembur dhjetë herë. tani nuk do të na trembet një mijë herë.

Prandaj kjo mbledhje e Plenumit, për ne anëtarët e Byrosë Politike, ka qenë një mësim i madh, megjithëse ju na hodhët shumë lule. Këto çështje ne nuk ia thamë më parë Komitetit Qendror për arsye se nuk donim që këto brenga t'ia komunikonim të gjithë udhëheqjes së Partisë. Ne ishim plotësisht të bindur se një ditë këto çështje do të dilnin përsipër dhe do të shtroheshin e do të zgjidheshin. Dhe kemi besim se këto çështje do të zgjidhen. Në Mbledhjen e nëntorit mendojmë se diçka do të arrihet. Po lehtë-lehtë nuk do të ecin punët, sepse pamë edhe shpejtësinë me të cilën Hrushovi e organizoi Mbledhjen e Bukureshtit, si dhe thëniet drejtuar shokut Hysni nga i deleguari zyrtar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Ai duke shkelur të gjitha ato që kishim vendosur i tha Hysniut që në këtë mbledhje të merre-

shin edhe vendime, domethënë që të përjashtojë Kina, por një gjë e tillë në Bukuresht nuk u bë, se Hrushovi e ndjeu frikën dhe u tërhoq. Pra ai kishte menduar të merreshin vendime. Megjithëse vendime nuk mundi të marrë, ai pregatiti terrenin për mbledhjen tjetër, në nëntor, që t'i thotë Kinës: «Shikoni se si ne të gjithë të tjerët jemi grusht, prandaj i vini gishtin kokës, ose nënshtrojuni shumicës, ose ndryshe ikni!». Mirëpo Kina nuk i ha këto gjëra. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës në fund të Mbledhjes së Bukureshtit u ndau të gjitha delegacioneve një letër mbi baza marksiste ku akuzonte drejtpërdrejt N.S.Hrushovin dhe dënonte metodat antimarksiste që u përdorën prej tij e të tjerëve dhe ku theksohej se këto gjëra do të shtrohen në mbledhjen e ardhshme.

N. Hrushovi akuzon Kinën se do luftë dhe shtrembëron hapur e me qëllim të keq thëniet e shokut Mao Ce Dun. Ne e dëgjuam vetë shokun Mao Ce Dun kur foli në Mbledhjen e partive komuniste e punëtore në Moskë më 1957. Shoku Mao Ce Dun foli me hollësi për forcën e madhe të kampit socialist duke filluar qysh nga Lufta e Dytë Botërore, nga lufta në Kore, në Indokinë etj. Pastaj, pasi foli për forcën e madhe të kampit tonë, theksoi se ka mundësi që imperialistët edhe të na godasin. Në rast se do të bëhet luftë, imperializmi mund të përdorë edhe bombën atomike e mund të vriten edhe qindra milion njerëz, megjithatë, tha, ne do të fitojmë. Edhe shprehjen e shokëve kinezë se «imperializmi është tigër prej letre», nuk e interpretojnë drejt. Udhëheqësit sovjetikë kapen pas ndonjë shprehjeje dhe e kurdisin ndryshe. Me këtë kinezët kanë dashur të argumentojnë

kalbëzimin e imperializmit. Vetë Mao Ce Duni vuri në dukje forcën e madhe të kampit tonë duke thënë se përpara forcës së madhe të kampit socialist imperializmi është një tigër prej letre.

Ne jemi për bashkëzistencën, por jo për një bashkëzistencë të tillë si ajo që predikon Hrushovi, i cili i thotë vëlla Nehruit, në një kohë kur ky shtyp me gjak revoltat e popullit të uritur indian.

Sa herë që kam shkuar në Kremlin, kam parë në tavolinën e Hrushovit bustin e Gandit. Ju e dini kush është Gandi. E pse u dashka që Sekretari i Parë i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të mbajë në tavolinën e tij bustin e Gandit?

Çarmatimi, për të cilin flet Nikita Hrushovi, nuk është gjë tjetër veçse iluzion, është paradë. Por për këto çështje që kanë të bëjnë me fatet e revolucionit, me fatet e njerëzimit, përgjigjemi edhe ne që jemi të vegjël dhe jo më udhëheqësit sovjetikë që kanë një përgjegjësi të jashtëzakonshme, prandaj qëndrime të lëkundshme s'duhën mbajtur. Në qoftë se Nikita Hrushovi ne shokë e çojnë në qorrrokak çështjen, kemi edhe ne fjalën tonë për të thënë dhe fjalën e saj Partia jonë e ka thënë dhe e thotë vetëm në rrugë të drejtë, marksiste-leniniste.

Liri Belishovën e kritikua më rëndë që shkoi e ia tha këshilltarit të ambasadës sovjetike në Pekin të gjitha ato që shokët kinezë ia kishin parashtruar. Po pse e kritikua? Sepse kjo ishte një çështje që nuk i përkiste Partisë sonë. Në mes Partisë sonë dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik nuk ka pasur asgjë të fshehtë. Por të shkosh e të informosh, ashtu siç veproi Liri

Belishova, është njëlloj sikur t'i hedhësh benzinë zjarrit. Kështu informacionin e Lirisë, Hrushovi dhe të gjithë udhëheqësit e tjerë të Bashkimit Sovjetik, e shfrytëzuan dhe qëndrimin e saj e quajtën «heroik». Shokët kinezë ia thanë asaj mosmarrëveshjet që kishin me Bashkimin Sovjetik dhe ata nuk bënë ndonjë gabim, se ajo ishte një çështje direkt e tyrja, kurse Liria gaboi që shkoi e ua tha ato sovjetikëve. Prandaj e kritikua.

Por Liria nuk ka gabuar vetëm në këtë çështje. Ajo nuk ka zbatuar direktivën e Byrosë Politike që i dërguam me korrier të posaçëm në Ulan-Bator. Partia na ka edukuar për gjithçka. Ne kemi kaluar në kaq prova dhe i nuhatim metodat antimarksiste, prandaj nga disa veprime të sovjetikëve nuhatëm se, me të zbritur në Moskë gjatë kthimit nga Kina, sigurisht udhëheqësit sovjetikë do ta kapnin Lirinë për këto çështje. Prandaj i drejtuam një letër të Byrosë Politike, koncize, konkrete, me të cilën ajo të kuptonte metodat që mund të përdroreshin ndaj saj në këtë rast në Moskë. Me këtë letër Liria udhëzohet me një mënyrë të qartë e të prerë se çfarë duhet të thoshte në takimin që mund të kishte me udhëheqës sovjetikë, me një fjalë, të mbronte qëndrimin e Partisë sonë në Bukuresht, të thoshte se, megjithëse nuk kishte qenë në Tiranë, solidarizohej plotësisht me vendimet e Byrosë Politike, sepse ato janë të drejta. «Ata po të bëjnë dhe do të të bëjnë shumë lëvdata, i shkruhet Lirisë në atë letër, ty nuk duhet të të rritet mendja. . . prandaj të kesh kujdes». Në fakt udhëheqësit sovjetikë vepruan ashtu siç e kishim parashikuar, ndërsa Liria nuk e zbatoi direktivën.

Çështjen e Lirisë mendoj ta rishikojë me kujdes Byroja Politike dhe ajo vetë të reflektojë për këto. Uniteti i udhëheqjes ka rëndësi të jashtëzakonshme, duhet ta ruajmë atë si sytë e ballit, se armiqtë tentojnë ta përçajnë, tentojnë të korrutojnë njerëzit e lëkundshëm. Pa unitet nuk ka jetë Partia dhe rrezikohet ndërtimi i socializmit në vendin tonë.

Metodat që kanë përdorur udhëheqësit sovjetikë, janë antimarksiste. Këtë e tha shoku Hysni në Bukuresht, në emër të Byrosë Politike, ku ai sugjeroi që të ndërpriten të tilla metoda menjëherë. Me të tilla metoda armiqtë synojnë të vënë njerëzit e Partisë sonë kundër udhëheqjes, por Partia jonë metodave të tilla do t'u japë grushte.

Nga njëra anë, Mikoiani na thotë mua dhe Mehmetit «ju lutemi, shokë shqiptarë, i mbani të fshehta këto gjëra», prandaj ne as Byrosë Politike nuk ia thamë, kurse, nga ana tjetër, Andropovi u thotë anëtarëve të delegacionit tonë në Kongresin III të PP të Rumanisë, në Bukuresht: «Nuk ju ka thënë gjë Byroja Politike për këto çështje?». Ne i thamë Hrushovit nëpërmjet shokut Hysni se e di Partia jonë çfarë dhe kur u duhet thënë anëtarëve të Partisë.

Tani e shohim që sovjetikët sigurisht kanë marrë udhëzime për ato që bëjnë. Ja, për shembull, edhe këtu, pa e njohur fare, shkojnë te një funksionar i aparatit të Komitetit Qendror dhe i thonë si je, kur do të takohemi bashkë, të bisedojmë për këto çështje, por ai u tha se këto bisedohen atje ku duhet dhe jo me mua.

Ç'janë këto gjëra? Këto nuk janë marksiste. Prandaj ne u dërguam komiteteve të Partisë letrën. Byroja Poli-

tike ka marrë vendim që në gazetat tona të mos shtypet asnjë fjalë nga materialet sovjetike, në të cilat direkt ose indirekt bëhet qoftë edhe aluzioni më i vogël për këtë konflikt, sepse ne nuk duam të futet Partia në konfuzion, pa u gjykuar çështja, dhe të shqetësohet në këto momente shumë të vështira ndërkombëtare dhe përsa i përket çështjes së kampit tonë, unitetit të tij.

Ju i keni të qarta këto çështje. Është shumë e rëndësishme për Partinë tonë që anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror, sekretarët e parë e kuadrot i kanë kuptuar drejt këto gjëra, edhe më parë se ato t'ua shtronte Komiteti Qendror dhe Byroja Politike. Kështu, në shembullin tuaj, është e armatosur e gjithë Partia, për këtë nuk ka asnjë dyshim. Është e qartë se ne duam që të zgjidhen këto mosmarrëveshje. Qëndrimet tona janë të qarta, prandaj ne do të vijmë përsëri në Komitetin Qendror dhe do të marrim ndihmën tuaj, me qëllim që të jemi plotësisht të armatosur. Por e theksoj se duhet të keni parasysh edhe disa gjëra.

Kjo çështje e madhe, që na preokupon tani dhe do të na preokupojë derisa të zgjidhet drejt, të mos bëhet pengesë për miqësinë që duhet të tregojmë ndaj popujve të Bashkimit Sovjetik. Në qoftë se njerëzit sovjetikë që punojnë në vendin tonë, i ngrenë këto çështje, t'u thuhet se këto mosmarrëveshje do të zgjidhen në Mbledhjen e Moskës në rrugë marksiste-leniniste.

Çështje tjetër është që vigjilenca, në çdo moment, të jetë në lartësinë e duhur. Të jemi të armatosur dhe të dimë të parashikojmë se si do ta shfrytëzojnë këtë situatë armiqë e shumë të që na rrethojnë. Ata do të

mundohen të vjellin vrer me njerëzit e tyre këtu, për ta zmadhuar dhe për ta nxitur këtë luftë kundër Partisë sonë dhe kundër ndërlimit të socializmit në Shqipëri. Prandaj vigjilenca të mprehet në kulm.

Një problem tjetër është puna që duhet të bëjmë për realizimin e planeve, siç e shtroi edhe shoku Mehmet. Çështjet ekonomike duhet t'i shohim seriozisht, të mendojmë shumë për to, se mund të krijohen situata të vështira. Për këtë duhet të jemi të përgatitur për çdo eventualitet. Po çfarë eventualiteti? Mund të ndodhë që armiqtë të na sulmojnë. Për këtë ne duhet të jemi vigjilentë ndaj armiqve ashtu si kurdoherë, prandaj armikun ta përballojmë me luftë të ashpër dhe pa kompromis, ta godasim pa mëshirë.

Sigurisht, armiqtë tanë do të kurdisin komplete. Ne i dimë planet e revizionistëve jugosllavë kundër vendit tonë. Për këto arsye ne kemi qenë dhe do të jemi vigjilentë, po tani vigjilenca duhet të ngrihet në një shkallë akoma më të madhe në radhët e Partisë në të gjitha drejtimet, deri në disiplinën e prodhimit, që asgjë të mos i shpëtojë punës së Partisë.

Problemet ekonomike të merren mirë në dorë nga Partia, të mos mendojmë se tani nuk na bëri koha etj. dhe t'i lëmë çështjet të ecin vetë. Ne kemi mundësi që të punojmë mirë, të marrim më shumë grurë, misër, pambuk dhe prodhime të tjera, pavarësisht nga kushtet atmosferike. Këto mundësi të mëdha duhet t'i shfrytëzojmë, të mobilizohemi totalisht në këtë drejtim, sepse imperialistët mund të na shkaktojnë të papritura.

Për këtë qëllim ushtria të jetë e armatosur, të jetë në këmbë e vigjilente dhe ky zjarr revolucionar, që

vlon në zemrën e komunistëve, të përshkojë të gjithë ushtrinë. Partia të jetë në këmbë, të mbajë mirë armët në dorë, të jetë e disiplinuar, e ngritur politikisht. Pra, me një gatishmëri dhe me një përgatitje të tillë, punët me siguri do të na ecin mirë.

Organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme të tregojnë vigjilencë të madhe revolucionare, të jenë ashtu si kanë qenë kurdoherë, në sulm kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm për mbrojtjen e kufijve nga orvatjet e panumërta që do të na bëjnë armiqtë. Partia atje të mobilizojë të gjitha forcat e saj, të qëndrojë fort dhe t'u japë armiqve grushte kokës, pa mëshirë. Vija jonë ka qenë e është e drejtë dhe vigjilenca asnjëherë nuk është shuar. Prandaj edhe në të ardhshmen të jemi kurdoherë vigjilentë dhe të mos biem në gjumë. Kjo ka rëndësi të jashtëzakonshme.

E vërteta është se komunistët shqiparë janë trima, ata nuk janë gjaknxehët, siç thotë Hrushovi, por gjakftohtë. Trimi i mirë është gjakftohtë. E them këtë se asnjë alarm në punën tonë nuk ka pasur. Ne kemi pasur edhe momente të tjera shumë të vështira, por kemi qëndruar të patundur dhe koka nuk na është trullësuar.

T'i mobilizojmë masat në rrugën e Partisë, për realizimin e planeve, për forcimin e vigjilencës revolucionare dhe të gjithë, pa u alarmuar, se të na alarmojë dëshiron edhe armiku, të kryejmë mirë detyrat që na ngarkon momenti. Metodrat e armikut janë të shumëllojshme për të futur panik, por Partia të japë shembullin, komunistët të qëndrojnë të patundur, hercikë dhe të mos trubullohen. Po të mbahet një qëndrim

i tillë edhe populli do të frymëzohet e do të kalitet me qëndresën e patundur të Partisë. Prandaj të gjitha këto cilësi që ka Partia jonë të vihen në dukje, t'i çojmë në bazë, të mobilizojmë njerëzit dhe të kalitim në ta të gjitha këto virtyte të Partisë.

Ky Plenum ka qenë një shkollë e madhe për ne të gjithë. Të armatosemi, pra, me mësimet e këtij Plenumi dhe t'i vihemi punës. Tani propozojmë që projektkomunikatën ta botojmë, me qëllim që populli ynë dhe miqtë të dinë mbi zhvillimin e mbledhjes sonë të Komitetit Qendror.

*Botohet për herë të parë me disa
shkurtime sipas tekstit të nxjerrë
nga procesverbali i mbledhjes së
Plenumit XVII të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**TELEGRAM NGUSHULLIMI KQ TË PK TË FRANCËS
ME RASTIN E VDEKJES SË SHOKUT
GASTON MONMUSO**

15 korrik 1960

**KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË KOMUNISTE TË FRANCËS**

P a r i s

Me hidhërim të thellë mësuam vdekjen e papritur të anëtarit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Francës, të militantit dhe të revolucionarit të shquar, që gjithë jetën ia kushtoi çështjes së lavdishme të klasës punëtore dhe të revolucionit proletar, shokut dhe mikut tonë të shtrenjtë, Gaston Monmuso.

Shoku Gaston Monmuso ishte një mik i madh i popullit shqiptar dhe ndiqte me entuziazëm e simpati të veçantë përparimet e popullit tonë në ndërtimin e socializmit.

Në emër të të gjithë komunistëve shqiptarë dhe të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë pranoni, të dashur shokë, ngushullimet tona të thella

dhe ndjenjat o solidaritetit tonë vëllazëror për këtë humbje të rëndë që goditi partinë tuaj dhe gjithë klasën punëtore të lavdishme franceze.

Në emër të Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Sekretari i Parë

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR KQ TË PK TË BS LIDHUR ME
INCIDENTIN E KRYER NË AMBASADËN
E RP TË SHQIPËRISË NË POLONI**

M o s k ë

21 korrik 1960

Morëm letrën tuaj të datës 13 korrik të vitit 1960, që bën fjalë për incidentin e padëshirueshëm që ka ndodhur në ambasadën tonë në Varshavë, si rezultat i orvatjes së një funksionari të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Polonisë për të vrarë ambasadorin tonë, shokun Muhsin Kroj.

...Neve na vjen shumë keq që ndodhi një incident i tillë dhe kuptohet se nuk jemi ne fajtorë për këtë incident dhe për konsekuencat që rrjedhin prej tij, por përgjegjësinë e kanë shokët polakë, të cilët nuk kanë marrë asnjë masë për të mos e lejuar një incident të tillë.

Për të qenë në korent të çështjes dëshirojmë t'ju themi se kanë ngjarë dy incidente të rënda në ambasadën tonë në Varshavë.

1) Gjatë pritjes së dhënë nga ambasadori ynë në Varshavë, më 29 Nëntor 1959, me rastin e 15-vjetorit

të Çlirimit të Shqipërisë nga okupacioni nazi-fashist, një element i rekomanduar për shërbim në këtë pritje nga autoritetet kompetente polake tentoi të grabiste dokumentet shtetërore dhe t'i vinte zjarrin ambasadës shqiptare, por funksionarët e ambasadës sonë ndërhyjnë menjëherë, e shuan zjarrin, kapën kriminelin dhe ua dorëzuan organeve kompetente polake. Këtë akt diversionist, duke marrë parasysh lidhjet miqësore që ekzistojnë në mes të dy vendeve tona, në frymë shoqërore dhe internacionaliste ia vumë në dukje verbalisht Ministrisë së Punëve të Jashtme të Polonisë, duke kërkuar që të merreshin masa për mospërsëritjen e gjesteve të tilla armiqësore ndaj vendit tonë. Pas kësaj ndërhyrjeje në frymë miqësore nga ana jonë, ambasadës sonë në Varshavë iu dhanë «sigurime» formale nga ana e organeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Polonisë «se do të merreshin të gjitha masat për të mos lejuar që të përsëriteshin në të ardhshmen të tilla veprime diversioniste». Megjithatë ne konstatuam se autori i krimit të përmendur, i cili kaloi në gjyq sa për formalitet, u dënua për aktin e tij të shëmtuar me 2 muaj kondicional dhe u la i lirë gjoja si «i çmendur» ose «i pirë».

Ambasada jonë në Varshavë, pas këtij incidenti të rëndë, i është drejtuar tri herë me notë zyrtare Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Polonisë për të vënë një roje të armatosur te porta e ambasadës sonë në Varshavë. Por Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Popullore të Polonisë nuk denjoi të merrte asnjë masë për të vënë roje pranë ambasadës sonë në Varshavë, duke ia lënë kujdesin e

ambasadës sonë një milici, i cili ruan në të njëjtën kohë edhe shumë ambasada të tjera të huaja. Të gjitha këto tregonin për ne se Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Popullore të Polonisë e trajtoi këtë çështje në mënyrë shumë të lehtë.

2) Më 29 qershor të këtij viti, një ish-funksionar i ambasadës polake në Tiranë dhe pikërisht shifrant i saj, dhe tani, sikurse deklaroi ai, funksionar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Polonisë, u paraqit dhe hyri në ambasadën shqiptare në Varshavë dhe, duke nxjerrë revolverin, tentoi të vriste ambasadorin tonë, shokun Muhsin Kroi. Funksionarët e ambasadës sonë e kapën kriminelin, e çarmatosën dhe ua dorëzuan organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Polonisë.

Nga këto dy incidente të rënda njëri pas tjetrit kuptohet se Qeveria e Republikës Popullore të Polonisë, sipas pikëpamjes sonë, jo vetëm që nuk e ka marrë seriozisht sigurimin e ambasadës sonë në Varshavë dhe të personelit të saj, po e ka trajtuar këtë çështje me një mungesë konsekuence të rëndë dhe me një përbuzje të palejueshme, që nuk pajtohet jo vetëm me frymën miqësore dhe internacionaliste që lidh të dy vendet tona, po as edhe me normat formale diplomatike. Mund të merret me mend se çfarë skandali ndërkombëtar do të bëhej sikur të vritej ambasadori i Republikës Popullore të Shqipërisë në mes të Varshavës nga një nëpunës i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Polonisë ose të digjej ambasada jonë nga «diversionistët»... Ne mendojmë se këto provokacione që ngjanë nuk janë gjëra të rastit dhe

janë bërë nga elementë armiq, të cilët përpiqen të prishin marrëdhëniet vëllazërore midis dy vendeve tona. Përgjegjësia e organeve qeveritare të Republikës Popullore të Polonisë, sipas pikëpamjes sonë, konsiston në atë që nuk kanë marrë deri sot asnjë masë serioze për të ndaluar akte të tilla provokimi kundër ambasadës sonë dhe personelit të saj.

Nota e Qeverisë sonë drejtuar qeverisë polake është plotësisht me vend dhe karakterizohet nga një durim i madh në vështirësi të zhvillimit të ngjarjeve.

Por, siç duket, shokëve polakë nuk u pëlqen kur u thuhet e vërteta në sy dhe u kërkohet gjëja më elementare, të marrin masa për ruajtjen e ambasadës sonë dhe të personelit të saj. Ishte e arsyeshme dhe e domosdoshme për çka ngjau që ne të largonim përkohësisht ambasadorin tonë nga Varshava, derisa qeveria polake të kërkonte ndjesë dhe të merrte masat e përshtatshme ndaj këtyre incidenteve, që po bëheshin një vijë e rrezikshme dhe plot konsekuenca të rënda.

Qeveria polake nuk iu përmbajt jo vetëm normave diplomatike, po as edhe frymës miqësore dhe internacionaliste, pas këtyre dy incidenteve shumë të rënda që jo për fajin tonë i ndodhën ambasadës dhe ambasadorit tonë në Varshavë. Përveç kësaj, notëpërgjigjja e qeverisë polake drejtuar Qeverisë sonë është hartuar me një ton përbuzës dhe në një mënyrë të tillë që lë qartë të kuptohet se qeveria polake jo vetëm nuk ka ndër mend të njohë gabimin e vet, por as edhe të marrë masa në të ardhshmen. Notës polake ne do t'i përgjigjemi.

Është shumë e arsyeshme ajo që thoni ju, se kjo

çështje, derisa nuk u rregullua në vijën diplomatike, të rregullohet në vijë partie, sido që për ne çdo veprim i Qeverisë përputhet me vijën dhe me vendimet e Komitetit Qendror të Partisë. Ne ju themi se edhe këtë vijë e tentuam. Kur ndodhi incidenti në fjalë, ndodhej në Shqipëri për pushime zëvendësministri i Punëve të Jashtme i Republikës Popullore të Polonisë, shoku Nashkovski Marian, i cili kërkoi të bisedonte për këtë çështje në rrugë partie, si anëtar i Komitetit Qendror. Ne e pranuan një gjë të tillë dhe ai bisedoi me anëtarin e Byrosë Politike dhe sekretarin e Komitetit Qendror të Partisë sonë, shokun Rita Marko. Megjithëse kjo çështje u shtrua nga ana jonë me ton dhe frymë partie, zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Polonisë, shoku Nashkovski, u suall jo si njeri partie, po si një diplomat. Toni i tij ishte toni i notës polake dhe nuk u arrit asnjë rezultat.

Përveç kësaj ne duhet të theksojmë se shokët polakë, në vazhdim të këtyre incidenteve të rënda, morën edhe një masë tjetër, që nuk i përshtatet frymës miqësore dhe internacionaliste që duhet të ekzistojë në mes të dy vendeve dhe partive tona. Zëvendësministri polak i Punëve të Jashtme, shoku Nashkovski, i cili kishte paraqitur shumë herë dëshirën të vinte dhe të pushonte në Shqipëri dhe që kjo dëshirë iu plotësua, la pushimet dhe u largua. Këtë akt ne nuk kemi si të mos e konsiderojmë si përbuzje të miqësisë vëllazërore që tregon Partia jonë ndaj shokëve polakë.

Ne mendojmë se incidentet e rënda dhe aktet jomiqësore në drejtim të vendit tonë tregojnë se shokët polakë jo vetëm janë larg njohjes së gabimeve të tyre,

por dëshirojnë gjithashtu të luajnë ndaj Shqipërisë socialiste motër kartën e një shteti të madh ndaj një shteti të vogël. Sigurisht ata gabojnë adresë dhe harrojnë se populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë as nuk kanë lindur dhe as nuk rrojnë me mëshirën e shokëve polakë.

Ne kurdoherë kemi dashur dhe dëshirojmë që me popullin, me partinë dhe me qeverinë polake të kemi marrëdhënie shumë të mira dhe shumë të ngushta, në frymën marksiste-leniniste, në frymën e barazisë dhe të internacionalizmit proletar dhe këtë rrugë do ta vazhdojmë me këmbëngulje deri në fund. Ne nuk kemi ndonjë kundërshtim që çështja të zgjidhet midis komiteteve qendrore të të dyja partive, sikurse rekomandoni ju me plot të drejtë, por mendojmë se i takon udhëheqjes polake, qoftë në rrugë partie, qoftë në rrugë shtetërore që të marrë inisiativën për të ndrequr këto gabime të rënda të saj dhe të japë garanci që në të ardhshmen të mos ndodhin të tilla incidente...

Me përshëndetje komuniste.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
«Dokumente kryesore të PPSII-»,
vëll. III, 1970, f. 340*

*Botohet me ndonjë shkurtim
sipas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**KOMITETI QENDROR ËSHTE UDHËHEQJA E
PARTISË QË GJYKON KURDOHERË DREJT,
URTË, QETË, POR KUR DUHET EDHE ASHPËR**

Nga biseda me Koço Tashkon

3 gusht 1960

SHOKU ENVER HOXHA: E mora letrën që më dërgove, me të cilën kërkoje takim me mua. Unë autorizova shokun Hysni Kapo të bisedonte me ty, po ti bëre naze, sepse të ishte mbushur mendja o të bisedoje me mua, o s'ka. Sigurisht edhe një njeri i thjeshtë mund të kërkojë të flasë me Sekretarin e Parë të Komitetit Qendror, por mund të ndodhë që Sekretari i Parë është shumë i zënë me ndonjë punë, ose nuk ndodhet fare në Tiranë. Në këto raste autorizohet një njeri tjetër, siç bëra unë.

Që kur mora letrën tënde në mbrëmje, ia dërgova menjëherë Hysniut me anë të një oficeri. Oficeri u porositi që të të njoftonte ty për të ardhur në takim në Komitetin Qendror. Ty nuk të paska pëlqyer një gjë e tillë dhe je shprehur keq për oficerët tanë. Kur të thërret në takim një sekretar i Komitetit Qendror, duhet

të shkosh pa një pa dy në orën që të cakton ai dhe jo kur të të shkrepet ty, ndryshe si mund ta quajë njeriu veten komunist, në rast se nuk tregohet korrekt dhe i disiplinuar kur thirret nga një shok që Partia e ka zgjedhur në udhëheqje?¹ Veç kësaj, ti e di që oficerët tanë janë shokët tanë, janë komunistë, nuk janë «poli-cë», siç thua ti. Nuk është e drejtë të flasësh kështu, sepse ti je anëtar partie. Ata i ka ngarkuar Partia me detyra të rëndësishme.

Sot të kemi thirrur² të bisedojmë për çështjet që ke shkruar në letër dhe për çka bisedove me Hysniun. Prandaj të flasësh hapur, qartë, në detaje, si anëtar partie. Në dispozicion kemi kohë dhe durim të të dëgjojmë deri në fund. Na fol me radhë për çështjet që ke. Në se qëndron kundërshtimi që ke ti me Komitetin Qendror dhe nga se erdhi? Na fol për bisedat që ke pasur me funksionarët e ambasadës sovjetike, ç'të kanë thënë ata, ç'u ke thënë ti.

Koço Tashko nisi të flasë pa përgjegjësi dhe me një mendjemadhësi të theksuar. Shoku Enver Hoxha herë pas here edhe duke ndërhyrë e duke pyetur u përpoq ta ndihmojë me durim.

SHOKU ENVER: Ti kërkove të kapesh degë më degë duke na treguar se çfarë u fol në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë sonë, sikur unë të mos isha në mbledhje. Pse s'na flet për çështjet e tjera që të kërkujmë? Nuk na the ato që i ke shfaqur Hysniut.

¹ Edhe në takimin me shokun Enver Hoxha, Koço Tashkoja u paraqit me tri orë vonesë, gjë për të cilën u kritikua rëndë.

² Në këtë takim ishte i pranishëm edhe shoku Rita Marko.

Unë them se ti duhet të gjykosh më mirë. Shumë gjëra që ngre janë pjellë e imagjinatës tënde.

Nuk je në rregull kur thua se kritikën, që ne i bëmë Hrushovit, s'ishin të drejta. Sipas mendimit tënd, në cilat gjëra ka gabuar Hrushovi? Apo ai s'ka gabuar fare? Siç the dhe vetë, mendimi yt është se «Hrushovi u godit pa të drejtë nga diskutantët në Plenum dhe ndaj tyre nuk u mbajt qëndrim!». Kjo është e çuditshme. Ti në vend që të dënosh qëndrimet e Hrushovit, kërkon të dënosh shokët e Plenumit që folën me të drejtë kundër tij.

Kur fole pak më parë, ti the: «Ndoshta Hrushovi, duke shëtitur kaq shumë në vendet kapitaliste, mund të sjellë ide të tjera. Dua të them se ka mundësi të influencojnë disa rrethana te ai. Po, në qoftë se gabon Hrushovi, edhe Stalini ka gabuar». Jo kështu, Koco Tashko, mos e përziej Hrushovin me Stalinin. Mos na fol në përgjithësi, por na thuaj konkretisht, a ka gabuar Hrushovi, apo jo?

KOÇO TASHKO: Unë them se ai nuk ka gabuar.

SHOKU ENVER: Po ti the se Hrushovi mund të gabojë, ashtu si Stalini?!

KOÇO TASHKO: Edhe sikur të gabojë unë kam besim se ai do të ndreqet.

SHOKU ENVER: Ti the se nuk ishe dakord që unë nuk shkova në Mbledhjen e Bukureshtit, se gjoja unë nuk iu përgjigja ftesës së sovjetikëve. Nuk është kështu siç thua ti. Unë nuk kisha ndonjë ftesë të tillë. Ti trillon gjëra të paqena.

Normat e partive marksiste-leniniste janë të njohura prej të gjithëve. Në qoftë se ti nuk i njeh këto norma,

atëherë, ja ku po ta them unë: nuk ka ndodhur dhe nuk ndodh që Komiteti Qendror i Partisë sonë t'i thotë Sekretarit të Parë, mos shko, kur ftohet në një mbledhje të partive komuniste e punëtore të kampit socialist apo të botës. Edhe në Plenumin e fundit u vendos që në mbledhjen e ardhshme që do të zhvillohet në nëntor në Moskë, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të vejë në krye të delegacionit të Partisë sonë. Në Bukuresht ne na ftoi vetëm Partia Punëtore e Rumanisë për të marrë pjesë në kongresin e saj dhe ne dërguam atje delegacionin tonë. Përsa i përket mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore që u zhvillua në Bukuresht, ajo, sipas marrëveshjes së arritur qysh më parë, kishte për qëllim vetëm të caktonte datën dhe vendin e mbledhjes së ardhshme të partive komuniste e punëtore të botës, ndaj Komiteti ynë Qendror nuk e pa të nevojshme të më dërgonte mua në Bukuresht, po autorizoi shokun Hysni Kapo të merrte pjesë në atë mbledhje. Tani se nga i nxjerr ti këto gjëra që i thua ndryshe nga ç'janë në realitet e nga nisesh, nuk e kuptojmë, prandaj na i shpjego vetë.

Ti je anëtar partie, si shpjegohet që arrin të gjykosësh se të gjitha çështjet që u thanë në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë, nuk u shtruan drejt dhe nuk qëndrojnë? Po cilat qëndrojnë atëherë? Këto që na thua ti?

KOÇO TASHKO: Duhet të keni më shumë besim te Hrushovi!

SHOKU ENVER: Kur në bazë të normave organizative marksiste-leniniste dhe të rrëgullave të internacionalizmit proletar një parti kritikon një parti tjetër

ose kur një udhëheqës kritikon një udhëheqës të një partie tjetër, sepse ka bërë gabime, ky është një qëndrim i drejtë.

Ti je i mendimit që Mbledhja e Moskës të mos bëhet në nëntor, por sa më parë. Por ky është një propozim që bëhet nga ti. Thelbi i çështjes është që ne do të veni në Mbledhjen e Moskës dhe atje do të themi pikëpamjen tonë. Ti ç'mund të na thuash?

KOÇO TASHKO: Nuk jam dakord të thuhet hollësisht.

SHOKU ENVER: Po përse je dakord, pa na thuaj.

KOÇO TASHKO: Fola, nuk kam përse të zgjatem, jam dhe njeri i sëmurë.

SHOKU ENVER: Jo, Koço Tashko, ti s'je aq i sëmurë sa hiqesh nga trupi, ti je i sëmurë nga koka. Por është e shëndoshë Partia. Dhe të sëmuret nga koka, po të duan, Partia i shëndosh. Ajo ka për detyrë t'i ndihmojë njerëzit që të thonë fjalën e tyre, të korrigjohen, të ecin në rrugë të drejtë, po, për të marrë këtë ndihmë, ata duhet të jenë me zemër të hapur përpara Partisë. Ti i di këto parime?

KOÇO TASHKO: I di, prandaj kërkova të flisja me ju, se në Plenum nuk mund të flisja si këtu, kush të lë atje të flasësh kështu? Atje do të më hidheshin në grykë.

SHOKU ENVER: Ç'janë këto që thua? Na e shpjego pak çështjen, kush nuk të lë të flasësh në Plenumin e Komitetit Qendror? Sipas mendimit tënd kur nuk folke dot në Plenum, kjo do të thotë se atje paska një situatë të sëmurë. Ti na the vetë se ke një besim të madh te Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të BS, atëherë

përse nuk e ke të njëjtin besim edhe te Partia jonë, anëtar i së cilës je dhe vetë?

KOÇO TASHKO: E thashë këtë se, po të më ndër-hynin kur të flisja, jam njeri nevrik dhe... pastaj, një ndërhyrje, një vërejtje të më bëhet mua, më hedh në hava.

SHOKU ENVER: Se ç'ndien ti, këtë unë nuk e di. Unë di vetëm normat leniniste të Partisë sonë. Komiteti Qendror është udhëheqja e Partisë që gjykon kurdoherë drejt, urtë, qetë, por, kur duhet, edhe ashpër. Atëherë, si flet kështu ti për Komitetin Qendror, për udhëheqjen e Partisë? Anëtarët e Komitetit Qendror nuk janë kalamane që, siç thua ti, nuk do të të gjykonin mirë, do të të hidheshin në grykë! Ç'do të thuash me atë se je nevrik?

KOÇO TASHKO: Që atje nuk flas dot, kjo është çështje fizike.

SHOKU ENVER: Po një qëndrim i tillë përpara Komitetit Qendror të Partisë sonë, a mund të quhet marksist? Ti mbrëmë i the Hysniut se, po të kishe folur në Plenum, do të shkaktoje përçarje, kurse mua këtu po më thua se, po të kishe folur, «do të të hidheshin në grykë». Cila nga këto qëndron? Në qoftë se ti e shpjegon këtë me «arsye shëndetësore», kjo nuk na e mbush mendjen. Shpjegimet që kërkon Komiteti Qendror ti ke për detyrë t'i japësh, se je anëtar i Partisë. Prandaj, na trego përse mendon se anëtarët e Plenumit nuk do të gjykonin drejt?

Komunisti flet haptazi në mbledhjet e Partisë. Kur ai e sheh se shpreh një mendim të drejtë, kjo është në interesin e partisë, prandaj e mbron mendimin e vet

deri në fund, sikur të gjithë të jenë kundër mendimit të tij, kështu na mëson Lenini. Mbi çdo gjë duhet parë interesi i Partisë dhe jo interesi personal. Komunisti mund edhe të vdesë, mund t'i bjerë edhe të fikët në mbledhje, po Partia duhet ta dijë pikëpamjen e tij tani ose pas 50 vjetëve, prandaj ai duhet ta thotë këtë pikëpamje, ashtu siç është. Në këtë mënyrë mendojnë anëtarët e Partisë dhe jo siç mendon ti, që ke frikë të flasësh në Plenum dhe na thua këtu «mos më ndalet zemra po të flas»! Kërkoj përsëri të na thuash, ç'është ai mendim që i shprehe Hysniut se fjala jote do të shkaktonte përçarje?

KOÇO TASHKO: Unë thashë që shokët e Komitetit Qendror të mos mendonin se unë po ju bëja kritikë juve.

SHOKU ENVER: Mendon ti kështu dhe jo shokët e Plenumit, të cilët e kuptojnë drejt kritikën. Pastaj, pse të mos më bësh edhe mua kritikë? Na thuaj ç'është Komiteti Qendror dhe ç'jam unë? Unë jam një anëtar partie, një ushtar i Partisë. Mbi mua është Byroja Politike, mbi Byronë Politike është Komiteti Qendror, mbi të cilin është Kongresi i Partisë. Atëherë, përse ti preferon të bisedosh vetëm për vetëm me mua dhe jo me Komitetin Qendror, që është forumi udhëheqës i Partisë, ndërsa unë jam një anëtar i Komitetit Qendror? Nesër ti përsëri në Komitetin Qendror do të vesh të japësh shpjegime për këto pikëpamje.

KOÇO TASHKO: Po ka edhe gjëra që njeriu duhet t'i bisedojë pak më mbyllur.

SHOKU ENVER: Me sa duket, ti nuk ke kuptim të drejtë për Komitetin Qendror. Ç'ka këtu për të

diskutuar në mënyrë të mbyllur? Përse t'i diskutosh këto gjëra më mbyllur, për ç'arsye? Si shpjegohet që ti kërkon të mos i thuash këto çështje në Komitetin Qendror? Pse të ka ngrënë merakun se duke folur në Plenumin e Komitetit Qendror do të shkaktoje përçarje në radhët e tij? S'na e sqarove këtë.

Ti këtu pohove se po të flisje në Plenum mund të mendohej se «Koçoja priti dhe i tha këto gjëra në një mbledhje, ku kishte kallaballëk!». Si flet, more, kështu për Komitetin Qendror? Je apo nuk je në vete? Ç'është Komiteti Qendror, një «kallaballëk», një grumbull njerëzish të rastit? Le t'i kishe thënë në Plenum këto çështje, se nuk do të krijohej asnjë përçarje, vetëm se do të të ulej autoriteti që të ka dhënë ty Partia. Mendohu, fol si duhet folur në Parti, mor derëzi! Ç'janë këto gjëra? Ti ke 20 ditë që i ke mbajtur pa na i thënë këto mendime.

Ti ke thënë se je dakord vetëm për çështjen që të vemi në Moskë dhe, «po të jetë se kemi mendime për Hrushovin t'ia themi atij». Po ti e di fare mirë, sepse ishe në Komitetin Qendror dhe dëgjove, që ne Hrushovit ia kemi thënë vazhdimisht mendimet tona. Prandaj për Hrushovin ato që mund t'i themi, nuk janë të reja, ia kemi thënë në sy, nuk i kemi mbajtur për vete. I dëgjove në Plenum apo jo?

Si tregojnë faktet, ti nuk je dakord me vendimet e Plenumit, me përjashtim të një gjëje, që në Moskë mund të vemi.

Këto nuk janë as çështje familjare, as çështje miqësore. Ti del me pikëpamje të kundërta me Komitetin Qendror. Përse atëherë i ngre sot e jo në kohë këto

çështje kaq preokupante, për të cilat Komiteti Qendror ka vendosur se ç'qëndrim duhet mbajtur? Për çështje të tilla partie, përse të presësh e të mendosh që «të takoj shokun Enver kur të vejë me pushime»? Për gjithë këto gjëra që ke e që janë në kundërshtim me Partinë, ti që të nesërmen duhet të vije te ne. Pse e le atëherë këtë çështje për 20 ditë? Këto nuk janë qëndrime partie. Si do t'ia shpjegosh këtë qëndrim organizatës-bazë?

KOÇO TASHKO: Nuk erdha se mendova që je i zënë me Torezin.

SHOKU ENVER: Po unë dy orë ndenja me Torezin. Ti duhet të kërkoje takim, e kishe për detyrë t'ia thoshe Partisë të gjitha dhe jo të mendoje se «shoku Enver tani është me Torezin», se «do vete ta takoj kur të shkojë në Korçë me pushime» etj. Po sikur unë të mos shkoja në Korçë, si do të bëje ti, akoma do t'i mbaje pa i thënë këto gjëra? Aq më tepër që ti nuk deshe t'ia thoshe këto gjëra asnjërit nga sekretarët e tjerë të Komitetit Qendror.

KOÇO TASHKO: Unë kisha shpresë, siç ua thashë edhe shokëve sovjetikë, se me Torezin ju do të bisedonit për këto çështje dhe ai do të ndërmjetësonte për t'u dhënë rrugëzgjdhje.

SHOKU ENVER: Kjo është pikëpamja jote. Dhe kjo, me sa duket, të ka shtyrë të mos marrësh menjëherë takim me mua. Përse ti ke shpresë te Torezi e te vetja jote dhe jo te Enveri, që e ke Sekretar të Parë? Po a është i drejtë mendimi yt se tani që erdhi Torezi do të ndreqen punët? Cilat punë do të ndreqen, na thuaj, ke menduar drejt apo jo?

Ti mendove se tani që erdhi Torezi, do të bëhen tentativa për të përmirësuar marrëdhëniet me Hrushovin. Ç'janë këto tentativa? Ç'ndërmjetësim do të kërkohet ne, sipas teje, nga Torezi? Shpjegoje!

KOÇO TASHKO: Kjo është fare e thjeshtë: Torezi është sekretar i përgjithshëm i një partie të lavdishme dhe mendova se shoku Enver do të flasë me të që Mbledhja e Moskës të bëhet më parë se muaji nëntor.

SHOKU ENVER: Ty të mbeti mendja që Mbledhja e nëntorit të bëhet më parë. Të thashë se kjo nuk varet nga ne. Ne kemi dashur dhe duam të bëhej kjo mbledhje dhe këtë e kemi deklaruar përpara përfaqësuesve të më se 50 partive. Në Bukuresht është vendosur që mbledhja të bëhet në Moskë, me rastin e festës së Revolucionit të madh Socialist të Tetorit. Përpara mbledhjes është vendosur gjithashtu të zhvillohen punimet e komisionit që përbëhet nga përfaqësuesit e 12 partive të vendeve socialiste dhe përfaqësuesit e 14 partive të tjera të vendeve kapitaliste. Këto çështje do të diskutohen më përpara në komision dhe pastaj materialet do t'i dërgohen çdo partie, pra edhe Partisë sonë. Kur të na vijne, ne këto materiale do t'i studjojmë me shumë vëmendje dhe do të veprojmë ashtu siç u vendos në Plenumin e Komitetit Qendror e siç je dhe ti në dijeni. Prandaj nuk ke pse t'i kërkosh Partisë sonë që mbledhja të zhvillohet sa më parë. Po të bëhet më parë mbledhja, ne jemi gati të vemi.

Ti do që mbledhja të bëhet shumë shpejt, po që të vish sipas rregullave të Partisë e t'ia thuash Sekretarit të Parë brengën që të mundon, këtë nuk e bën.

Atëherë cilat janë arsyet që ti mendon se «tani që erdhi Torezi çështjet do të vihen në rrugë të mirë dhe do të rregullohen»? Për cilat çështje e ke fjalën?

KOÇO TASHKO: Për çështjet që dihen, xhanëm! Janë të tëra ato që u thanë në Plenum dhe po i themi edhe këtu.

SHOKU ENVER: Domethënë ne t'ia thoshim të tëra Torezit dhe ai t'i parashtronte atje ku mendon ti! Po si u vendos në Komitetin Qendror? Në Plenum vendosëm që këto çështje do t'i shtrojmë në Mbledhjen e Moskës. Në qoftë se ne këto çështje do t'i zgjidhnim nëpërmjet Torezit, kjo do të thotë të vepronim jashtë vendimit të Komitetit Qendror. Si arrin të mendosh në këtë mënyrë?

KOÇO TASHKO: Mendoj se është e drejtë që Torezi të përdoret për ndonjë mosmarrëveshje që keni me Brezhnjevin, Kozllovin e të tjerë.

SHOKU ENVER: Ç'është ky Brezhnjev, pse na tremb ti me këta? Ne s'kemi punë me presidentin e Presidiumit të Sovjetit Suprem të Bashkimit Sovjetik. Mos na bëj këtu provokacion. Kozllovit unë ia kam thënë dhe do t'ia them në fytyrë ato që ka.

Tani na fol për takimet që ke pasur me sovjetikët. Na intereson të dimë çfarë biseduat. Na thuaj ato që kanë rëndësi.

KOÇO TASHKO: Më 29 korrik, Bepallovi më mori në telefon dhe më ftoi për të biseduar. E takova në klubin sovjetik, pamë filmin dhe pastaj dolëm dhe shkuam në hotel «Dajti». Bepallovi më tha se marrëdhëniet në mes nesh janë ftohur.

SHOKU ENVER: Nuk të thanë përse janë ftohur?

KOÇO TASHKO: As më tha, as e pyeta. Ne biseduam për shumë gjëra. I thashë se Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë sonë për zgjidhjen e çështjeve ka ngarkuar shokun Enver. I thashë se ndoshta mund të bëhet diçka nëpërmjet bisedimeve që do të zhvillohen me Torezin.

SHOKU ENVER: Po mendimi yt cili ishte?

KOÇO TASHKO: Mendimi im ishte që këto çështje të zgjidhen në mbledhjen e nëntorit ose në çdo mbledhje tjetër që mund të bëhet. Unë nuk e përjashtoj një mbledhje tjetër, përveç asaj të nëntorit.

SHOKU ENVER: Pra, ti nuk përjashton një mbledhje tjetër. Vazhdo.

KOÇO TASHKO: I thashë Bepallovit se me ardhjen e Toretit në vendin tonë, do të ketë diçka pozitive, sepse atë ditë kisha lexuar në gazetën «Zëri i popullit» fjalimin e Toretit mbajtur në Korçë dhe më kishte bërë përshtypje se ai fliste shumë mirë për Partinë tonë, për Komitetin Qendror dhe për shokun Enver.

SHOKU ENVER: Domethënë se ti erdhe në konkluzionin që ne kishim biseduar, kishim shtruar edhe këto çështje dhe ishim në një mendje me Toretin. Kështu, ti gjykon nga jashtë, formulon mendime me imagjinatën tënde që Torezi nuk ka ardhur te ne për pushime, po për të biseduar. Dhe këtë ia thua edhe Bepallovit. Paske menduar se shokët e Byrosë mund të kenë ardhur në marrëveshje me Toretin dhe, duke u nisur nga vlerësimi që i bëri Torezi Partisë sonë në fjalimin që mbajti në Korçë, ke gjykuar se edhe udhëheqja e Partisë sonë ka lëshuar. Pra, sipas mendimit tënd, del që u hodhën poshtë të gjitha ato që

vendosi Plenumi, dhe Enveri ka dalë me ato mendime që ka Koçoja. Po me Novikovin je takuar? -

KOÇO TASHKO: Jam takuar. Beshpallovi më tha që të veja për darkë në shtëpi të Novikovit, ku do të ishte dhe Ivanovi. Mbase hëngrëm darkë kaluam në bisedime një kohë të gjatë. Nga fundi, nuk mbaj mend si erdhi muhabeti dhe folëm për Torezin.

SHOKU ENVER: Përpiqu të kujtohesh, si erdhi ky muhabet.

KOÇO TASHKO: Ja, folëm për Torezin.

SHOKU ENVER: Të gjithë bisedimin për Torezin e bëre?

KOÇO TASHKO: Po, se Torezi do të ishte shpëtimtar.

SHOKU ENVER: Po Ivanovi çfarë të tha?

KOÇO TASHKO: Nuk e di, ai foli në përgjithësi.

SHOKU ENVER: Ivanovin ne e njohim shumë mirë, ai nuk është njeri që flet në përgjithësi.

KOÇO TASHKO: Ivanovi nuk ka biseduar kurrë me mua për çështjet që po flasim, as Zollotovi, as Beshpallovi, unë ata i kam shumë miq.

SHOKU ENVER: Mua më çudit fakti që ata s'paskan biseduar me ty, që i ke miq të ngushtë, kurse po u drejtohen kuadrove që nuk i njohin mirë, e u thonë «hajde të bisedojmë».

KOÇO TASHKO: Ata me mua nuk kanë biseduar jo vetëm tani, por as më 1957, kur isha në Bashkimin Sovjetik. Nga gjithë ato që bënë atëherë për mua, diçka kuptova. Më bënë gjithë ato nderime të mëdha, më thanë «po të duash, mund të rrish në vilën ku rri shoku Enver me delegacionin qeveritar», më ftuan edhe

në pritjen që u dha në Kremlin. Për mua, pra, ata kanë uvazhenie [respekt] dhe sillen mirë. Por kohët e fundit Ivanovi kur më jep dorën e heq menjëherë, për të mos më komprometuar para ndonjërit që nuk më do.

SHOKU ENVER: Po përse mund të të komprometojë? Kush nuk të do dhe a është e vërtetë kjo?

KOÇO TASHKO: Nuk e di, nuk kam si ta shpjegoj.

SHOKU ENVER: Po më vonë pse u afrua përsëri me ty Ivanovi?

KOÇO TASHKO: Kjo është një nga pyetjet që kam edhe unë në kokën time.

SHOKU ENVER: Ti the se «gjithë muhabeti me sovjetikët u bë rreth Torezit, se kjo ishte çështje mjaft e rëndësishme». Po kur ti e gjykon të rëndësishme çështjen e Torezit, përse bisedon me Novikovin dhe Ivanovin dhe nuk vjen te unë? Tërë bisedimet me ta ti i bëre përpara se të më dërgoje mua letrën.

KOÇO TASHKO: Te ata vajta rastësisht.

SHOKU ENVER: Do të qeshin shokët e Partisë me ty kur të diskutohet kjo çështje. Gjersa pranon tezën që shoku Enver mund të ketë biseduar me Torezin, atëherë përse ti i bisedon çështjet me sovjetikët?

KOÇO TASHKO: Unë këtu nuk shoh ndonjë gjë të keqe.

SHOKU ENVER: Këtu jemi në zyrat e Komitetit Qendror, prandaj fol si duhet. Unë nuk jam prokuror, po Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë, prandaj diskutoi çështjet siç diskutohen në Parti. Këto që na thua ti nuk shkojnë fare. Nga njëra anë, ti thua se mund të bisedoj vetëm me shokun Enver, sepse është Sekretar i Parë i Komitetit Qendror, nga ana tjetër

mendimin që ke për Partinë tonë nuk ia thua atij, po vete e ia thua Bespallovit, që e konsideron, siç e the edhe vetë, mik të ngushtë. Ç'janë këto gjëra që na thua? Bespallovi ka vendin e tij dhe Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë sonë ka vendin e vet.

Përse nuk respektove rregullat organizative të Partisë dhe të bisedoje me mua? Në qoftë se ke mosmarrëveshje me Komitetin Qendror dhe doje që këto t'ia thoshe Sekretarit të Parë, këtë ta kishe bërë në kohën e duhur, bile menjëherë pas Plenumit. Pastaj do të shkoje apo jo te sovjetikët, kjo është diçka tjetër. Për mua s'kishte pse të shkoje, kurse ti jo vetëm vajte dhe bisedove me ta, por shkove pa folur fare me ne dhe bërë tri takime me sovjetikët.

KOÇO TASHKO: jo, dy kam bërë.

SHOKU ENVER: Këto janë të shkruara në letrën tënde. Edhe sikur fare të mos i takoje, po vetëm ideja të të lindte për të shkruar për bisedime te ata, përpara se të vije te Partia jote, kjo është e palejueshme dhe në kundërshtim me rregullat organizative të Partisë.

Nuk jam dakord që letrën për mua ti e ke shkruar para se të bisedoje me sovjetikët, vetë përmbajtja e saj e hedh poshtë një pohim të tillë.

Sipas teje, del që Torezi ka ardhur apostafat nga Parisi që të bisedojë me ne mbi këto çështje dhe pastaj të vejë në Moskë. Kur Ivanovi të tha se veç Torezit, më 8 gusht, në Moskë do të venë edhe të tjerë, nuk u bërë pak kurioz ta pyesje se kush janë të tjerët? Pastaj kush të ngarkoi ty t'i thoshe Ivanovit që t'i vijë ftesë edhe shokut Enver për këtë takim? Kush të autorizoi ty të flasësh në emrin e Sekretarit të Parë të

Komitetit Qendror? Ti tani vjen e më thua se mendimi yt është që çështjet të mos mbeten për t'i biseduar në nëntor «se pastaj trashen». Ne këtë e dimë, por dimë edhe tjetrën që Partia jonë nuk i trash çështjet, çështjet i trashin veprimet që bën ti, prandaj mos e akuzo Partinë tonë.

Ne kemi 4-5 vjet që nuk kemi nxjerrë jashtë asnjë fjalë për veprimet e padrejta të disa udhëheqësve sovjetikë. Disa udhëheqës sovjetikë na godasin, po ne jemi treguar të duruar, kurse ti tani na thua që këto gjëra nuk duhet t'i lëmë të trashen. A nuk është kjo një akuzë? Unë ta thashë dhe e përsërit se nuk varet nga Partia jonë të vendosë për kohën e mbledhjes. Pse të ka hipur ty në kokë që të bëhet sa më parë kjo mbledhje? Ivanovit i thua duhet t'i vijë ftesë shokut Enver, pastaj më vjen këtu dhe më thua të vete të bisedoj vetë me Ivanovin. Reflekton ti ndonjë çikë në ç'rrugë je? Pse vepron kështu? Ç'të keqë të ka bërë ty Partia jonë? Ajo të ka rritur, të ka ndihmuar, të ndihmon dhe do të të ndihmojë, por kjo që ke bërë ti është shumë e rëndë.

Ti thua se e do Partinë, por përse atëherë nuk ia thua Partisë ato që të shqetësojnë kaq shumë?

KOÇO TASHKO: Unë ju thashë se jam tip flegmatik prandaj duhet të mbani parasysh edhe anën humane dhe tipin e njerëzve. Pastaj, pasi u takova me sovjetikët, ata më vunë të dyja këmbët në një këpucë.

SHOKU ENVER: Po si t'i vunë këmbët në një këpucë? Shpjegohu!

KOÇO TASHKO: Unë kisha ndër mend të takohe-sha me ju, po këtë takim e shtyja nga dita në ditë. Sa

bisedova me Bepallovin e kuptova se nuk kishte si shtyhej më kjo çështje.

SHOKU ENVER: Po na e shpjego pak pse vajte bisedove me të, meqenëse këlë bisedim ti e dënon.

KOÇO TASHKO: Jo, nuk e dënoj, por diçka duhet t'ju thosha edhe juve.

SHOKU ENVER: Atyre ua thua të gjitha, ndërsa Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë tënde, i thua vetëm «diçka». Po kush e ka fajin për këto që ke bërë? Në qoftë se ti e kupton fajin, atëherë bëj një fije autokritikë. Nuk të pyetën sovjetikët, me të cilët u takove, si shkoi Plenumi?

KOÇO TASHKO (Heziton të flasë), pastaj thotë: Mund të më kenë pyetur...

SHOKU ENVER: Fol hapur, the gjë për Plenumin? Nuk të pyeti Ivanovi si u diskutuan këto çështje në Plenum? Përsëri po të pyes, të ka pyetur Ivanovi si u diskutuan këto çështje në Plenum? Ta bëri një pyetje të tillë?

Ç'që ajo që i the Hysniut dhe që na hiqe sikur gjoja e di historinë e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, kur e vë udhëheqjen tonë në pozitë e men-shevikëve dhe trockistëve dhe thua se te ne ndodhka «si në kohën e Kronshtadit» në Bashkimin Sovjetik. Për Partinë tënde i mendon ti këto gjëra? Po pse ç'jemi ne, bjellogardistë? E njeh ti historinë e Partisë sonë? Dashurinë e madhe të popullit tonë për popujt e Bashkimit Sovjetik nuk e ke mbrujtur ti, por Partia jonë në luftë, me gjak dhe me djersë, kurse ti vjen tani e na bën akuza të tilla. Këto gjëra që thua ti i kanë rrënjët gjetskë, prandaj mendo dhe reflekto vetëm në rrugën e

Partisë, ndryshe nuk korrigjohesh. Ulu pak në tokë. Partia ty të ka respektuar më shumë se ç'ke merituar. Imagjinata jote është e sëmurë dhe kjo imagjinatë nuk është sëmurur tani, këtë sëmundje ti e ke pasur edhe më përpara.

Të them të drejtën, nga asnjë njeri në jetën time nuk kam dëgjuar një diskutim dhe shtruarje të tillë të çështjes pa kokë, pa bisht, pa lidhje, si kjo që dëgjova nga ti. Shumë shokë kanë ardhur dhe më kanë hapur zemrën kur kanë gabuar, por nga bisedimi kanë dalë të ngrohtë. Kurse tani ti më flet mua për «humanizëm» për tipin flegmatik! Unë jam treguar humanitar për njerëzit, për shokët. Tani ç'kërkon ti kur më thua «të shikoj edhe anën humane», mos do që unë të mos mbroj vijën e Partisë, interesat e saj? Të lutem, interesat e Partisë dhe të popullit unë i vë mbi çdo gjë dhe do t'i mbroj ato sa të jem gjallë. Nëse ka kush fakte për të më kritikuar mua dhe Komitetin Qendror, me ballë hapur ne do t'i presim kritikën e drejtë dhe kështu i kemi pritur kurdoherë.

Po nëse ndonjë na kritikon për qëndrimin që mbajmë ndaj revizionistëve jugosllavë, ne i themi «ndal!», kujtdo qoftë, edhe Hrushovit, se dërrit dajë ne nuk i themi. Ai vetë ka thënë për udhëheqjen jugosllave që është agjenturë e imperializmit. Atëherë përse të goditet Partia jonë për qëndrimet e drejta të saj kundër revizionistëve jugosllavë? Për ç'arsye? Si mund të mbyllim gojën për këto? Kur themi se Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik është partia më e mirë, kjo s'do të thotë që përpara gabimeve të ndonjërit nga udhëheqja e saj ne të heshtim.

Pas bisedimeve që zhvilluam në Moskë më 1957, ne, për respekt të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, nuk shkruam për një kohë në shtyp kundër revizionizmit jugosllav. Mirëpo s'kaloi shumë kohë dhe revizionistët jugosllavë zhvilluan Kongresin e tyre VII famëkeq në lidhje me të cilin u duk përsëri drejtësia e vijës së Partisë sonë. Duke qëndruar në pozita revolucionare, ne e mbrojmë edhe vetë Bashkimin Sovjetik dhe Partinë e tij Komuniste, kurse ata që shkelin, në një mënyrë ose në një tjetër, parimet e marksizëm-leninizmit, cilëtdo qofshin, ne do t'i kritikojmë në rrugën marksiste-leniniste. Nuk kemi ne të drejtë të kritikojmë ndonjë kur ai e mbush kupën? Kur bëhen gabime, ne nuk mund të rrimë pa folur, do të kritikojmë, në rrugën marksiste-leniniste, se kështu mbrohet liria dhe pavarësia e atdheut tonë dhe e vetë Bashkimit Sovjetik, se për këto u derdh shumë gjak. Kështu mbrohet marksizëm-leninizmi dhe internacionalizmi proletar dhe jo ashtu si mendon ti, Koço Tashko. Ti i bluan gjërat në imagjinatën tënde. Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik ka të drejtë të veprojë si të dojë, po për vërejtjet që i bëhen Partisë sonë kemi edhe ne të drejtë të themi fjalën tonë. Partia jonë lufton gjer në fund t'i mbrojtë interesat e popullit dhe të marksizëm-leninizmit nga armiqtë, por imagjinata jote e sëmurë thotë ndryshe. Kritika është kritikë, prandaj kur je përpara gabimesh, është oportunizëm të mos kritikosh. Mirëpo ti ke vuajtur ca nga kjo sëmundje. Unë e kam ndjekur me kujdes jetën e Partisë që nga fillimi. Ka raste që duhet folur pak, por ka edhe raste që duhen shtrënguar dhëmbët dhe, kur vjen

puna te parimet, ato duhen mbrojtur, nuk mund t'i shkelim.

I ke parë ti shkrimet tona kur kritikojmë revizionistët jugosllavë? Në to ne vazhdimisht kemi folur për eksperiencën e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Atëherë ç'vjen e më numëron artikujt që kanë botuar sovjetikët? Unë i di ato, po ka edhe ndryshime në qëndrimet, të cilat nuk janë vetëm ndryshime taktike. Vërejtjet tona ne ia kemi thënë edhe Hrushovit, nuk i themi fshehurazi, ia kemi thënë përpara syve dhe ai na i ka thënë gjithashtu në sy. Por këto nuk na kanë çuar në përçarje. Ti e di pikëpamjen e Partisë sonë që mosmarrëveshjet që kanë lindur, janë midis dy partive, midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, dhe ne kemi thënë në kohën e duhur që shqyrtimi i këtyre çështjeve në Bukuresht është i parakohshëm, i shpejtuar, se ato duhen zgjidhur me kujdes dhe duke zbatuar me rigorozitet rregullat organizative leniniste të marrëdhënieve midis partive. Atëherë çfarë të shtyn ty të mbash këtë qëndrim kundër Komitetit Qendror? Prandaj, si shok të them, reflekto për këto çështje. Ke mundësi që këto 2-3 ditë, sipas rregullave të Partisë, t'i shkruash Komitetit Qendror për të gjitha këto çështje.

KOÇO TASHKO: Nuk kam ç'them më tepër.

SHOKU ENVER: Domethënë, ti nuk do të veprosh si çdo anëtar partie, të cilit Partia i jep dorën të thellohet mbi gabimet. Atëherë mos thuash nesër që shoku Enver nuk më dha mundësi të reflektoj për t'i parë më thellë gabimet e mia.

KOÇO TASHKO: Nuk kam ç'të them. Ato që kisha i thashë këtu.

SHOKU ENVER: Me pak fjalë, këto janë qëndrimet e tua. Nuk do ta rishikosh pozitën tënde? Unë edhe një herë të këshilloj të reflektosh sot, nesër dhe deri pasnesër e të na i dorëzosh me shkrim mendimet e tua, pastaj do ta gjykojmë çështjen tënde në Komitetin Qendror, sepse është një çështje me rëndësi për të cilën duhet të diskutojë e të vendosë Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë.

KOÇO TASHKO: Për të shkruar, nuk do të shkruaj. Ç'kisha i thashë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbajtur në këtë takim
që përfundoi në AQP*

**LETËR DREJTUAR KQ TË PK TË BASHKIMIT
SOVJETIK LIDIHUR ME NDËRHJRJEN E HAPUR
NË PUNËT E BRENDSHIME TË PPSH DHE TË
SHTETIT SHQIPTAR NGA DISA FUNKSIONARË
TË AMBASADËS SË BS NË TIRANË**

M o s k ë

6 gusht 1960

Partia e Punës e Shqipërisë, në marrëdhëniet e saj me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, është udhëhequr dhe udhëhiqet nga parimet e mëdha të marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar...

Me keqardhjen më të madhe ju vëmë në dijeni se këto kohët e fundit, pas Mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtorë në Bukuresht, konstatojmë një ndryshim rrënjësor në qëndrimin e disa personave që janë funksionarë të ambasadës sovjetike në Tiranë, qëndrim i cili nuk mund të sjellë veçse dëm në marrëdhëniet miqësore midis dy vendeve dhe dy partive tona, sepse ka të bëjë me ndërhyrjen e hapur të këtyre

personave në punët e brendshme të Partisë dhe të shtetit tonë, në kundërshtim me qëndrimin marksist-leninist që është mbajtur kurdoherë nga njerëzit sovjetikë ndaj çështjeve tona të brendshme.

Ne konstatojmë me hidhërim të madh se shoku K.I. Novikov, këshilltar i ambasadës sovjetike në Tiranë, jashtë çdo rregulli partie dhe normash që përcaktojnë marrëdhëniet tona vëllazërore, është orvatur shumë herë për të mbledhur informata nga kuadrot dhe nga funksionarët e Partisë sonë si në Tiranë, në Elbasan, në Durrës dhe gjetkë, për çështje kaq të rëndësishme mbi Partinë tonë, siç janë ato që shqyrton Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë, të cilat kanë të bëjnë me vijën e përgjithshme politike të Partisë së Punës të Shqipërisë. Ai u ka folur kuadrove tanë të Partisë haptazi kundër vijës së përgjithshme të Partisë dhe u ka bërë atyre agjitacion për t'i vënë në pozita të gabuara kundër Komitetit Qendror të Partisë sonë.

Sekretari i parë i ambasadës sovjetike, F.P. Bespallov, bashkë me ambasadorin, shokun V.I. Ivanov, dhe këshilltarin e ambasadës, shokun K.I. Novikov, me anën e metodave të palejueshme në marrëdhëniet midis partive marksiste-leniniste, kanë mundur të influencojnë negativisht te Koço Tashko, kryetar i Komisionit të Revizionimit në Partinë tonë, duke e tërhequr atë në pozita të hapura kundër vijës së përgjithshme të Partisë sonë.

Një veprimtari e tillë është ndërhyrje flagrante dhe e palejueshme në punët e brendshme të Partisë

sonë marksiste-leniniste nga ana e këtyre funksionarëve të ambasadës sovjetike, është veprimtari e hapur kundër unitetit të Partisë sonë dhe kundër vijës së saj të përgjithshme.

Ne jemi shumë të prekur sidomos nga qëndrimi i ambasadorit sovjetik, shokut Ivanov, këto kohët e fundit, i cili shkoi aq larg në veprimtarinë e tij jomiqësore ndaj Partisë sonë, sa që pati guximin që t'u bëjë gjeneralëve dhe oficerëve tanë, publikisht, në aerodromin e Tiranës, pyetjen e çuditshme dhe të dyshimtë: «Kujt i qëndron besnike ushtria?». Gjeneralët tanë i dhanë atij përgjigjen e duhur aty për aty dhe kanë ardhur me lot ndër sy në Komitetin Qendror të Partisë, të revoltuar nga një pyetje e tillë tendencioze e shokut Ivanov dhe duke bërë pyetjen e logjikshme: «përse ai bën një pyetje të tillë, përse ai të vërë në dyshim besnikërinë e ushtrisë sonë ndaj Partisë, atdheut, popullit dhe kampit të socializmit?». Për të gjithë ne është krejtësisht i palejueshëm ky qëndrim i ambasadorit të Bashkimit Sovjetik, shokut Ivanov.

Këto fakte (dhe ka edhe shumë të tjera si këto) ne na kanë dëshpëruar pa masë. Deri sot ne kemi bërë veshin të shurdhër dhe kemi mbyllur një sy ndaj veprimeve të këtyre funksionarëve të ambasadës sovjetike, dhe këtë e kemi bërë vetëm për hir të miqësisë së madhe që ekziston midis dy vendeve tona. Por tani që veprimet e disa funksionarëve të ambasadës sovjetike kundër vijës së përgjithshme dhe unitetit të Partisë sonë po marrin përpjesëtime të padurueshme, ne e ndiejmë për detyrë t'ju informojmë shoqërisht me shpresë

se ju do të merrni masat përkatëse. Këto veprime të disa funksionarëve të ambasadës sovjetike nuk ndihmojnë në forcimin e miqësisë që ekziston midis të dy vendeve tona; ato dëmtojnë marrëdhëniet internacionale që ekzistojnë midis të dy partive tona.

Ne e ndiejmë për detyrë që t'ju informojmë mbi këto gjëra, të flasim me ju haptazi dhe drejt, siç kemi bërë kurdoherë, siç na mëson vetë Partia e Leninit të madh. Ne nuk kuptojmë se përse të ndodhë një ndryshim i këtillë në qëndrimin e këtyre funksionarëve të ambasadës sovjetike. Ata flasin me kuadrot tanë haptazi kundër qëndrimit që mbajti Partia jonë në Mbledhjen e partive komuniste dhe punëtore në Bukuresht dhe përpiqen intensivisht që të përçajjnë unitetin e Partisë sonë dhe të udhëheqjes së saj.

Qëndrimi i Partisë sonë në Mbledhjen e Bukureshtit është i qartë si drita e diellit. Partia jonë në atë mbledhje shprehu haptazi dhe qartë pikëpamjet e veta dhe askujt nuk i lejohet që të shtrembërojë realitetin mbi qëndrimet e Partisë sonë. Ashtu sikundër në Mbledhjen e Bukureshtit ne folëm haptazi dhe qartë mbi çështjet që u shtruan në atë mbledhje, ashtu do të flasim haptazi dhe qartë edhe në mbledhjen e ardhshme që do të bëhet në Moskë, sikurse është vendosur nga të gjitha partitë që morën pjesë në Mbledhjen e Bukureshtit. Nuk i lejohet askujt, për asnjë arsye, që të ndërhyjë në punët tona të brendshme për të ndryshuar qëndrimin e drejtë marksist-leninist të Partisë sonë, sikundër po orvaten ta bëjnë disa funksionarë të ambasadës sovjetike në Tiranë.

Partia jonë, sikurse të gjitha partitë e tjera marksiste-leniniste, ka të drejtë të ketë pikëpamjen e vet dhe t'i shfaqë pikëpamjet e veta lirisht, ashtu siç i mendon, siç na mëson Lenini i madh. Këtë të drejtë, për të thënë pikëpamjet e veta lirisht, Partisë sonë ia ka dhënë marksizëm-leninizmi dhe është krejtësisht e palejueshme që të bëhen orvatje për ta paraqitur Partinë tonë sikur gjoja ajo këto kohët e fundit qenka futur në rrugë të shtrembra, siç përpiqen «të vërtetojnë» disa funksionarë të ambasadës sovjetike në Tiranë. Kushdo që përpiqet të shtrembërojë realitetin mbi qëndrimin e Partisë sonë, gabon rëndë. Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë, është dhe do të jetë gjithë jetën besnike e marksizëm-leninizmit, për këtë dëshmon më së miri e gjithë rruga e lavdishme që ka përshkuar Partia jonë, që nga krijimi i saj dhe deri sot...

Partia e Punës e Shqipërisë, si kurdoherë, do të luftojë me të gjitha forcat e veta për t'i qëndruar besnike deri në fund marksizëm-leninizmit, siç na mëson i madhi Lenin...

Komiteti Qendror i Partisë sonë konsideron se ndryshimi në qëndrimin e mbajtur nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe nga Partia e Punës e Shqipërisë në Mbledhjen e Bukureshtit nuk duhet të bëhet shkak për të ndërhyrë në punët e brendshme të njëri-tjetrit nga asnjë person, sepse kjo nuk do t'i ndihmonte çështjes dhe do të cenonte interesat e përbashkëta midis të dy partive tona.

Ne kemi bindje se ju do të merrni masat e nevoj-

shme për të mos u përsëritur më raste të tilla në veprimtarinë e funksionarëve të ambasadës sovjetike në Tiranë.

Përshëndetje komuniste

Në emër të Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Sekretari i Parë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
«Dokumente kryesore të PPSH»,
vëll. III, 1970, f. 344*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**LETËR DREJTUAR TË GJITHA ORGANIZATAVE-
-BAZË TË PARTISË MBI ZHVILLIMIN E MBLEDHJES
SË BUKURESHTIT DHE MBI MOSMARRËVESHJET
MIDIS PARTISË KOMUNISTE TË BASHKIMIT
SOVJETIK DHE PARTISË KOMUNISTE
TË KINËS**

9 gusht 1960

Midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës kanë lindur disa mosmarrëveshje të rëndësishme ideologjike e politike. Për këto mosmarrëveshje ka filluar të flitet edhe në shtypin kinez e atë sovjetik si edhe në fjalimet e udhëheqësve të këtyre dy vendeve, natyrisht, pa përmendur njëri-tjetrin me emër, por duke bërë aluzione, të cilat çdo njeri është lehtë t'i kuptojë. Për këto çështje është folur e është diskutuar hapur edhe në Mbledhjen që patën në Bukuresht përfaqësuesit e partive komuniste e punëtore që ishin delegatë të partive të tyre në Kongresin III të Partisë Punëtore të Rumanisë.

Me anën e kësaj letre Komiteti Qendror i Partisë e quan të nevojshme t'u njoftojë të gjitha organizatave të Partisë qëndrimin tonë ndaj këtij problemi.

Në datën 2 qershor 1960 Komiteti Qendror i Par-

tisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik i dërgoi një letër Komitetit Qendror të Partisë sonë, me anën e së cilës propozonte që në fund të muajit qershor të bëhej një mbledhje e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtorë të vendeve të kampit të socializmit «për këmbimin e mendimeve mbi çështjet e gjendjes së sotme ndërkom-bëtare dhe për përcaktimin e vijës sonë të mëtejshme të përbashkët». Komiteti Qendror i Partisë sonë menjëherë iu përgjigj kësaj letre, duke theksuar se ishte plotësisht dakord të zhvillohej në fund të qershorit mbledhja që propozohej, dhe se delegacionin e Partisë sonë për këtë qëllim do ta kryesonte shoku Enver Hoxha. Mirëpo në datën 7 qershor Komitetit tonë Qendror i erdhi një letër tjetër nga ana e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Me këtë letër Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik njoftonte se të gjitha partitë ishin shprehur në parim dakord për zhvillimin e Mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtorë të kampit të socializmit, por disa prej tyre propozonin që mbledhja të shtyhej për një datë të mëvonshme. Lidhur me këtë në letrën e 7 qershorit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik thuhej: «Për kohën e thirrjes së mbledhjes do të mund të bisedonim në mënyrë paraprake me përfaqësuesit e Partisë suaj, në kohën që do të mbahet Kongresi III i Partisë Punëtorë të Rumanisë më 20 qershor, pas të cilit, në marrëveshje me komitetet qendrore të partive motra të vendosim përfundimisht datën e mbledhjes». Komiteti Qendror i Partisë sonë i ktheu përgjigje Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, me anën e së

cilës njoftonte se ishte dakord që mbledhja të shtyhej dhe që në Bukuresht të merreshin vesh për caktimin e datës se kur do të zhvillohej ajo. Për këtë Byroja Politike e Komitetit Qendror autorizoi shokun Hysni Kapo, i cili kryesoi delegacionin e Partisë sonë në Kongresin III të Partisë Punëtore të Rumanisë, që të shkëmbente mendime bashkë me përfaqësuesit e partive motra që ndodheshin në kongres, për caktimin e datës së mbledhjes që propozohej në letrat e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Por në fakt, delegacioni ynë, që shkoi për të marrë pjesë në Kongresin e Partisë Punëtore të Rumanisë dhe për t'u marrë vesh për caktimin e datës së Mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të kampit socialist, u gjend në Bukuresht përpara një mbledhjeje ndërkombëtare të përgatitur. Kjo mbledhje ishte në kundërshtim me çka ishte vendosur, ajo ishte në kundërshtim me vetë përmbajtjen e letrave të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, për të cilat bëmë fjalë më sipër. Edhe rendi i ditës ishte krejt tjetër: në vend që të shkëmbeheshin mendime për të caktuar datën e mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore, siç thoshte letra e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, atje akuzohej Partia Komuniste e Kinës. Për këtë qëllim vetëm 10 orë përpara mbledhjes iu shpërnda gjithë delegatëve të huaj (shumica e të cilëve ishin vetëm anëtarë të komiteteve qendrore), një material prej 65 faqesh, i përgatitur nga shokët sovjetikë, në të cilin shpreheshin pikëpamjet e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për mosmarrëvesh-

jet që kanë me shokët kinezë. Dhe për këtë çështje kaq të rëndësishme e delikate pas 10 orësh kërkohet që përfaqësuesit e më se 50 partive komuniste e punëtore të vendeve të ndryshme, të cilët kishin ardhur në Bukuresht për tjetër punë, të mbanin qëndrim, të akuzonin Partinë Komuniste të Kinës.

Është fare e qartë se kjo mbledhje ishte organizuar në mënyrë të nxituar dhe në kundërshtim me rregullat më elementare organizative leniniste. Ju e dini mirë, të dashur shokë, se edhe në organizatat-bazë të Partisë, ku shtrohet për diskutim çështja e një anëtari të thjeshtë, Partia na mëson që të jemi të kujdesshëm, të matur, të drejtë dhe asnjëherë të rixituar. Duke zbatuar këtë parim leninist të Partisë, organizatat-bazë mbledhen një herë, dy herë e shpesh edhe tri herë, njoftohen komunistët të paktën tri ditë përpara për rendin e ditës dhe për përmbajtjen e tij, caktohen komisione që përgatitin materialet e nevojshme etj. Dhe kjo, e vetëm kjo, është rruga e drejtë e Partisë, rruga organizative që na mëson marksizëm-leninizmi. Po, në qoftë se ne veprojmë kështu për një anëtar partie, a është e rregullt që një parti e tërë, e cila ka në radhët e saj disa miliona anëtarë partie, e cila udhëheq një popull prej gati 700 milicnësh, të akuzohet në mënyrë aq të shpejtuar e duke thyer çdo rregull organizativ?

Në këto rrethana, siç u përgatit dhe u zhvillua Mbledhja e Bukureshtit, Byroja Politike e Partisë sonë mbajti një qëndrim të drejtë, të vetmin qëndrim të drejtë, parimor e marksist-leninist, që mund të mbahej. Cili është ky qëndrim?

Me pak fjalë ai mund të përmbledhet: *e para*, mosmarrëveshjet për të cilat bëhet fjalë janë mosmarrëveshje midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e Partisë Komuniste të Kinës; *e dyta*, mbledhja e Bukureshtit ishte e parakohshme dhe e zhvilluar në kundërshtim me rregullat organizative leniniste; *e treta*, Partia jonë do ta thotë fjalën e saj për këto mosmarrëveshje në mbledhjen e ardhshme, e cila duhet të përgatitet sipas rregullave dhe praktikës që ekziston në partitë komuniste e punëtore.

Partia jonë e Punës mendon se mbledhja e organizuar në Bukuresht ishte e parregullt, ajo ishte në kundërshtim me marrëveshjen e arritur me anë të letërkëmbimit midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe partive të tjera motra, sipas të cilit, në Bukuresht, do të caktohej vetëm data e mbledhjes së ardhshme, ajo ishte e parakohshme dhe në kundërshtim me rregullat organizative që zbatojnë partitë komuniste e punëtore. Prandaj, nga njëra anë, duke pasur parasysh sa më sipër dhe, nga ana tjetër, duke qenë se vetëm 10 orë para mbledhjes morëm një material ku shprehej vetëm pikëpamja e shokëve sovjetikë, Partia jonë nuk mund të prononcohej në Bukuresht për mosmarrëveshjet që ka midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e Partisë Komuniste të Kinës. Partia jonë do ta thotë fjalën e saj, pikëpamjen e saj për mosmarrëveshjet në fjalë në mbledhjen e ardhshme të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore, që do të bëhet më vonë, pasi t'i ketë studjuar me kujdes, në mënyrë të matur dhe me drejtësinë marksiste-leniniste materialet e të dyja palëve. Partia jonë, e cila kurdoherë

ka luftuar e ka mbrojtur me besnikëri parimet e marksizëm-leninizmit, është e mendimit se vetëm në një mbledhje të organizuar sipas rregullave organizative leniniste, pasi të jenë dëgjuar argumentet e të dyja palëve, me durim e me gjakftohtësi, në një frymë shoqërore, mund të konkludohet se kush ka të drejtë e kush e ka gabim, se si duhet punuar bashkërisht në të ardhshmen për të mirën e socializmit dhe të komunizmit, për të mirën e unitetit të kampit tonë socialist.

Këtë qëndrim të urtë, parimor e leninist, sipas udhëzimeve të Byrosë Politike, mbajti në Mbledhjen e Bukureshtit shoku Hysni Kapo. Këtë qëndrim, siç jeni në dijeni nga komunikata e botuar në shtyp, e aprovoi tërësisht dhe njëzëri Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë që u mbajt më 11-12 korrik 1960. Komiteti Qendror është i bindur se këtë qëndrim të drejtë e parimor do ta aprovojë njëzëri edhe çdo anëtar i Partisë sonë heroike. Qëndrimi ynë i drejtë mund të mos u pëlqejë vetëm atyre që nuk duan të respektojnë normat leniniste.

Mosmarrëveshjet që ekzistojnë midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, kanë të bëjnë me dy vendet e partitë më të mëdha të kampit socialist. Partia jonë nuk mund të jetë indiferente ndaj tyre... Partia jonë, si më parë edhe në të ardhshmen, do të punojë për të forcuar në bazë të marksizëm-leninizmit dashurinë e miqësinë tonë të madhe me Bashkimin Sovjetik, me popujt sovjetikë, me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, sepse nuk ka dashuri më të fortë e më të sigurtë sesa ajo që bazohet në mësimet fitimtare të mark-

sizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar. Por në të njëjtën kohë është e pamohueshme dhe e padiskutueshme që për ne, ashtu si edhe për të gjitha vendet e kampit të socializmit, Kina e madhe, populli dhe partia e saj janë të dashura dhe të shtrenjta.

Prandaj Partia jonë, ashtu si të gjitha partitë e tjera, është e interesuar që kjo çështje e rëndësishme të zgjidhet drejt, mbi bazën e mësimëve të marksizëm-leninizmit. Partia jonë ka besim se kjo çështje do të zgjidhet në mbledhjen e ardhshme, që do të bëhet pas 2-3 muajsh, për përgatitjen e së cilës është ngarkuar edhe një komision me përfaqësues të shumë partive motra, midis të cilëve edhe të Partisë sonë. Ne e kemi këtë besim të patundur, sepse kemi besim në marksizëm-leninizmin, i cili u ka bërë ballë shumë furtunave dhe kurdoherë ka dalë fitimtar.

Partia jonë e Punës gjithnjë ka punuar dhe ka luftuar për triumfin e marksizëm-leninizmit, për zbatimin e tij në jetë, për ruajtjen e pastërtisë së parimeve të tij. Për këtë arsye, Partia jonë gjatë gjithë historisë së saj të lavdishme ka paësuar dhe ka një vijë krejtësisht të drejtë, një vijë që u përgjigjet mësimëve të Leninit, që u përgjigjet interesave të popullit shqiptar, interesave të socializmit dhe të komunizmit. Këtë vijë, të bazuar mbi këto parime, Partia jonë do ta ndjekë pa asnjë lëkundje edhe në të ardhshmen. Ne do të luftojmë e do të punojmë për fitoren e marksizëm-leninizmit, për zbatimin e parimeve të Deklaratës së Moskës të vitit 1957 dhe të Komunikatës së Bukureshtit, të cilën siç është njoftuar në shtyp, Komiteti Qendror i Partisë sonë e aprovoi njëzëri.

Partia jonë do të rritë e do të forcojë vigjilencën revolucionare, e cila kurdoherë duhet të jetë në nivelin e duhur, ashtu siç i ka hije Partisë sonë heroike, sepse armiqtë e Partisë e të popullit, elementët e dobët, oportunistët e frikacakë, si kurdoherë, do të përpiqen në mënyra të ndryshme të sulmojnë Partinë dhe vijën e saj të drejtë, të ngjallin dyshime dhe të shpifin për miqësinë tonë me Bashkimin e madh Sovjetik dhe me Republikën Popullore të Kinës, të përhapin parulla e pikëpamje të ndryshme, me qëllim që të shkaktojnë konfuzion ideologjik në radhët tona. Duke qenë vigjilentë, të gjithë anëtarët e Partisë sonë të lavdishme duhet të luftojnë me guxim e me vendosmëri kundër çdo përpjekjeje të armiqve për të arritur këto qëllime të poshtra.

Partia jonë duhet të forcojë edhe më shumë unitetin e çeliktë të radhëve të saj, unitetin e gjithë Partisë rreth Komitetit Qendror leninist të Partisë sonë, unitetin e Partisë me popullin tonë heroik. Kurdoherë uniteti ynë i pathyeshëm ka qenë kushti vendimtar për të kapërcyer me sukses çdo pengesë, për të shkuar përpara drejt sukseseve të reja. Ai edhe tani është kushti vendimtar për triumfin e vijës së Partisë, për të dërrmuar çdo veprimtari të armiqve tanë, për të shpartalluar oportunistët, elementët e dobët dhe frikacakë.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim të patundur se të gjitha organizatat-bazë, të gjithë anëtarët e Partisë, të cilët janë edukuar nga Partia si bij besnikë të saj dhe të popullit tonë, besnikë deri në vdekje të marksizëm-leninizmit, do të tregohen si gjithnjë edhe

në gjykimin e kësaj çështjeje të rëndësishme të matur, të drejtë, të guximshëm dhe parimorë dhe do të shtrëngojnë edhe më shumë radhët rreth Komitetit Qendror të Partisë sonë.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
«Dokumente kryesore të PPSH»,
vëll. III, 1970, f. 348*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**UNITETI I VËRTETË ARRIHET E FORCOHET
VETËM MBI BAZËN E PARIMEVE
MARKSISTE-LENINISTE**

Letër dërguar KQ të PK të BS dhe KQ të PK të Kinës¹

27 gusht 1960

Të dashur shokë,

Siç dihet, në Mbledhjen e Bukureshtit të përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore, që u mbajt në qershor të këtij viti, përsa u përket mosmarrëveshjeve të lindura midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, delegacioni i Partisë së Punës të Shqipërisë, sipas direktivave të Komitetit Qendror të Partisë sonë, mbajti një qëndrim të ndryshëm nga ai i delegacionit të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe i delegacioneve të shumicës së partive pjesëmarrëse në atë mbledhje.

Partia e Punës e Shqipërisë ushqen respektin më të thellë për të gjitha partitë komuniste dhe punëtore

¹ Kopja e kësaj letre iu dërgua edhe partive të vendeve të tjera socialiste.

të botës dhe shpreh keqardhjen e saj të madhe që, për herë të parë në historinë e vet revolucionare, u detyrua të merrte një qëndrim si ai që mori në Mbledhjen e Bukureshtit. i cili është në kundërshtim me qëndrimin e shumicës së delegacioneve të partive komuniste dhe punëtore. Partia jonë, sikurse çdo parti tjetër marksiste, ka të drejtë të shfaqë mendimin ashtu siç e ndien në ndërgjegjen e vet dhe të mbajë qëndrimin që ajo gjykon se është i drejtë.

Në Mbledhjen e Bukureshtit delegacioni i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik u shpërndau delegacioneve të partive të tjera një material të shkruar, me anën e të cilit deklarohej se Partia Komuniste e Kinës ka shkelur Deklaratën e Moskës të vitit 1957. Në atë mbledhje... u gjetëm përpara një konference të vërtetë ndërkombëtare të organizuar posaçërisht për të kritikuar Partinë Komuniste të Kinës për «shkelje» të Deklaratës së Moskës, duke u mbështetur në materialin e paraqitur nga ana e delegacionit të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, material i cili delegacionit të Partisë sonë iu dha vetëm 10 orë para mbledhjes.

Siç dihet, marksizëm-leninizmi na mëson se jo vetëm kur shqyrtohen gabimet e një partie marksiste, që ka në radhët e veta miliona anëtarë dhe një stazh të madh veprimtarie revolucionare konsekuente, siç është Partia Komuniste e Kinës, por edhe kur shqyrtohen gabimet e një komunisti duhet të jemi shumë të kujdesshëm, shumë të matur, të analizojmë thellë të gjitha shkaqet e gabimeve që ka bërë ky komunist, të përpiqemi ta bindim atë për gabimet e veta, ta çojmë çështjen e tij në organizatën-bazë ose në forumin për-

katës të Partisë, ku çështja të shqyrtohet me objektivitetin më të madh, në bazë të parimeve marksiste-leniniste, duke synuar arritjen e një qëllimi të vetëm: përmirësimin e këtij komunisti dhe vënien e tij në rrugë të drejtë. Në qoftë se për të analizuar gabimet e një komunisti dhe për ta shpëtuar atë nga këto gabime ne bëjmë kaq shumë përpjekje, atëherë kuptohet vetvetiu se çfarë përpjekjesh të mëdha duheshin bërë para se të «shkëmbeheshin mendime mbi gabimet e një partie» në një mbledhje komuniste ndërkombëtare, siç qe Mbledhja e Bukureshtit. Por ky veprim, për fat të keq, nuk u bë.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë nisët nga parimi marksist-leninist se, për të shfaqur mendimin e vet mbi gabimet ideologjike dhe politike të një partie tjetër marksiste, më parë duhet të bindet me fakte për ekzistencën e këtyre gabimeve dhe kjo bindje mund të krijohet duke analizuar në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë, me gjakftohtësi dhe në bazë të metodës marksiste-leniniste, të gjitha argumentet përkatëse në lidhje me këtë çështje, domethënë si argumentet që paraqit pala që kritikon, ashtu edhe argumentet që paraqit pala që kritikohet. Pasi të jetë bërë kjo analizë marksiste-leniniste nga Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë sonë, atëherë dhe vetëm atëherë ne do të jemi në gjendje të shfaqim objektivisht mendimin mbi gabimet e një partie tjetër. Ne mendojmë se kjo është metoda më e drejtë në shqyrtimin e gabimeve ideologjike të një partie motër. Komiteti Qendror i Partisë sonë këtë metodë do ta përdorë për të arritur në konkluzione përfundimtare për «gabimet» që Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik i atribuon

Partisë Komuniste të Kinës dhe për të shprehur mendimin e vet mbi këtë në mbledhjen e ardhshme të partive komuniste dhe punëtoresh, në nëntor të këtij viti. Ne mendojmë se të veprosh ndryshe, të veprosh sikurse u veprua në Mbledhjen e Bukureshtit, do të thotë ta dënosh një parti motër pa analizuar deri në fund dhe me gjakftohtësi të gjitha faktet për të arritur në konkluzion nëse partia në fjalë ka gabuar ose jo. Në këto raste shpejtimi është i dëmshëm.

Për këto arsye, në Mbledhjen e Bukureshtit delegacioni i Partisë sonë deklaroi se këto mosmarrëveshje kanë lindur midis Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe se për zgjidhjen e tyre duhej të bëheshin përpjekje nëpërmjet bashkëbisedimesh midis këtyre dy partive e, po të mos arrihej kjo, atëherë çështja të shtrohej para të gjitha partive të tjera motra për të shfaqur mendimin; se Mbledhja e Bukureshtit ishte e parakohshme dhe nuk pajtohej me normat leniniste; se përsa u përket mosmarrëveshjeve të lindura midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, Partia e Punës e Shqipërisë do ta shprehë pikëpamjen e vet në mbledhjen e ardhshme të partive komuniste dhe punëtoresh në muajin nëntor.

Natyrisht, mosmarrëveshjet e lindura midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës kanë rëndësi të madhe parimore, ideologjike e politike dhe zgjidhja e këtyre mosmarrëveshjeve ka rëndësi jetike për unitetin e kampit të socializmit dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Në zgjidhjen

e këtyre mosmarrëveshjeve sot jo vetëm që janë të interesuara të gjitha partitë marksiste, ndër të cilat edhe Partia e Punës e Shqipërisë, por, bile, të gjitha partitë marksiste e kanë për detyrë të japin kontributin e vet për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve, pasi, tashmë, këto mosmarrëveshje kanë dalë nga kuadri i marrëdhënieve midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës dhe kanë marrë karakter ndërkombëtar.

Pas Mbledhjes së Bukureshtit, disa parti komuniste dhe punëtorë të vendeve të kampit socialist, ndër të cilat edhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, i kanë dërguar Komitetit Qendror të Partisë sonë kopjet e letrave që ato i kanë drejtuar Partisë Komuniste të Kinës. Në këto letra arrihet në konkluzione, sipas të cilave Partia Komuniste e Kinës «ka devijuar nga teoria dhe praktika marksiste-leniniste»... bëhen afirmacione që ne na bindin akoma edhe më shumë se qëndrimi ynë në Mbledhjen e Bukureshtit ka qenë plotësisht i drejtë, marksist-leninist. Sipas pikëpamjes sonë, këto afirmacione vërtetojnë se Mbledhja e Bukureshtit nuk u kufizua në «shkëmbimin» e thjeshtë të mendimeve «mbi gabimet e Partisë Komuniste të Kinës», dhe se Partia Komuniste e Kinës është dënuar de fakto nga partitë që na kanë dërguar këto letra.

Veç kësaj, në këto letra theksohet se në Mbledhjen e Bukureshtit u vërtetua «unitet i plotë i të gjitha partive komuniste dhe punëtorë» në kritikën që ato u bënë «gabimeve» të Partisë Komuniste të Kinës. Një afirmacion i tillë le të nënkuptohet se edhe Partia e Punës e Shqipërisë është radhitur krahas shumicës së partive të

tjera komuniste dhe punëtorë përsa u përket «gabimeve» që i atribuohen Partisë Komuniste të Kinës. Në qoftë se bëhet fjalë për aprovimin e komunikatës së Mbledhjes së Bukureshtit, ne jemi dakord me atë që ka pasur unitet të të gjitha partive, sepse komunikatën e ka aprovuar edhe Partia jonë. Por, në qoftë se bëhet fjalë «për unitet të të gjitha partive» në lidhje me mosmarrëveshjet e lindura midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, kjo nuk i përgjigjet së vërtetës, të paktën përsa i përket Partisë sonë, pasi Partia e Punës e Shqipërisë nuk është bashkuar me shumicën e partive të tjera dhe mendimin e vet mbi këto mosmarrëveshje do ta thotë në mbledhjen e ardhshme të partive komuniste dhe punëtorë, në nëntor të këtij viti, sikurse e ka deklaruar shumë herë. Të afirmosh se në Mbledhjen e Bukureshtit ka pasur «unitet të plotë të të gjitha partive» në kritikën që iu bë «gabimeve» të Partisë Komuniste të Kinës, do të thotë të shtrembërosh faktet dhe të vërtetën.

Komiteti Qendror i Partisë sonë është sot edhe më i bindur se sa ishte në Mbledhjen e Bukureshtit që ajo mbledhje jo vetëm nuk i ka zhdukur mosmarrëveshjet e lindura midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, por i ka thelluar akoma më tej këto mosmarrëveshje duke i çuar ato deri në proporcione shqetësuese.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve të lindura midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, siç e thamë, ka rëndësi jetike për unitetin e kampit të socializmit dhe për unitetin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Prandaj, ne mendojmë

se duhen bërë të gjitha përpjekjet për t'i zgjidhur këto mosmarrëveshje në bazë të parimeve marksiste-leniniste. Është fakt që armiqtë e marksizëm-leninizmit, imperializmi dhe revizionizmi, qysh tani kanë filluar ta shfrytëzojnë ekzistencën e këtyre mosmarrëveshjeve për të sulmuar marksizëm-leninizmin, për të diskredituar e për t'i përçarë kampin e socializmit dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Komiteti Qendror i Partisë sonë mendon se sot nuk ka gjë më të rëndësishme për jetën e të gjitha partive komuniste dhe punëtoare të botës, për ruajtjen dhe për forcimin e unitetit të kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare sesa zgjidhja e këtyre mosmarrëveshjeve në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit.

Mbledhja e ardhshme e partive komuniste dhe punëtoare që do të mbahet në nëntor të këtij viti në Moskë, duhet t'i shërbejë zgjidhjes së këtyre mosmarrëveshjeve. Por, Komiteti Qendror i Partisë sonë mendon se, para mbledhjes së ardhshme të partive komuniste dhe punëtoare, do të ishte e arsyeshme dhe e drejtë që të bëheshin përpjekje akoma më të shumta për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve nëpërmjet bashkëbisedimesh në nivel të lartë midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës. Dihet nga të gjithë se Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe Partia Komuniste e Kinës janë partitë marksiste-leniniste më të mëdha dhe më me eksperiencë revolucionare. Kontributi i tyre i përbashkët duhet të jetë vendimtar në zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve dhe bashkëbisedimet midis tyre në nivel të lartë, para Mbledhjes së nëntorit, do të ndihmonin shumë në zgjidhjen përfun-

dimtare të këtyre mosmarrëveshjeve nga ana e Mbledhjes së nëntorit, ku do të japin kontributin e vet edhe partitë e tjera.

Ne shpresojmë se këto mosmarrëveshje do të zgjidhen në rrugën marksiste-leniniste dhe se Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe Partia Komuniste e Kinës, ashtu sikurse partitë e tjera, do të bëjnë në këtë drejtim të gjitha përpjekjet për të zgjidhur këto mosmarrëveshje në bazë të parimeve marksiste-leniniste.

Ne ju sigurojmë se Partia e Punës e Shqipërisë do të qëndrojë kurdoherë në pozitë të marksizëm-leninizmit dhe do ta mbrojë deri në fund marksizëm-leninizmin dhe unitetin e kampit të socializmit. . .

Partia jonë, ashtu si kurdoherë, do të luftojë me vendosmëri për zbatimin e plotë të vijës sonë të përbashkët të përcaktuar në Deklaratën e Moskës [1957]. . . Partia jonë do të jetë kurdoherë vigjilente kundër planeve dhe veprimeve luftënxitëse të imperializmit dhe kundër revizionizmit modern, i cili, sikurse përcaktohet në Deklaratën e Moskës, është rreziku kryesor për lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Përshëndetje vëllazërore

Për Komitetin Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**LETËR DREJTUAR KQ TË PK TË BS LIDHUR ME
PROPOZIMIN E BËRË NGA KQ I PK TË BS PËR
ORGANIZIMIN E NJË TAKIMI TË PËRFAQËSUESVE
TË PK TË BS DHE TË PPSH PARA MBLEDHJES SË
NËNTORIT TË VITIT 1960 TË PARTIVE KOMUNISTE
DHE PUNËTORE NË MOSKË**

M o s k ë

29 gusht 1960

Këto ditë morëm letrën tuaj të datës 13 gusht të këtij viti, në të cilën bëhet fjalë mbi Mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore në Bukuresht dhe me anën e së cilës ju propozoni që të organizohet një takim i përfaqësuesve të partive tona përpara Mbledhjes së nëntorit të partive komuniste dhe punëtore, me qëllim që «në mbledhjen e ardhshme të nëntorit Partia e Punës e Shqipërisë dhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik të shkojnë me një unitet të plotë mendimesh» dhe «të shuhej në kohën e duhur shkëndija e keqkuptimit të lindur, në mënyrë që ajo të mos ndizej. . .».

Siç dihet, marksizëm-leninizmi na mëson që, kur lindin keqkuptime, kontradikta dhe mosmarrëveshje

midis dy partive marksiste, këto duhet të zgjidhen me anën e bashkëbisedimeve midis të dy partive të interesuara, duke u bazuar në parimet e marksizëm-leninizmit. Marksizëm-leninizmi na mëson gjithashtu që do të ishte shkelje e normave elementare marksiste-leniniste që rregullojnë marrëdhëniet midis partive komuniste dhe punëtorë po të ndodhte që dy parti të zhvillonin bashkëbisedime që do të kishin për objekt kritikën ndaj vijës së përgjithshme të një partie tjetër marksiste.

Dihet se në Mbledhjen e partive komuniste e punëtorë në Bukuresht nuk u shqyrtuan marrëdhëniet midis Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Në atë mbledhje, në kundërshtim me çka qe vendosur qysh më parë nga të gjitha partitë e vendeve të kampit socialist mbi rendin e ditës, në mënyrë të papritur dhe me nxitim u diskutua një çështje kaq e madhe dhe jetike, siç janë mosmarrëveshjet parimore ideologjike dhe politike që kanë lindur midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës.

Në Mbledhjen e Bukureshtit qëndrimi ynë qe i qartë; ai nuk u muar nga ne si rezultat i ndonjë «keqkuptimi», sikurse bëhet aluzion në letrën tuaj, por u muar me ndërgjegje të plotë nga ana jonë dhe ne mbajmë të gjithë përgjegjësinë përpara popullit tonë dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare për këtë qëndrim.

Qëndrimi ynë në Mbledhjen e Bukureshtit është zbalimi konsekuent i vijës së përgjithshme ideologjike dhe politike të Partisë sonë, vijë që, sikurse është njohur edhe nga ana juaj, ka qenë kurdoherë parimore, mark-

siste-leniniste dhe në përputhje të plotë me Deklaratën e Moskës.

Kundërshtimi që lindi në Bukuresht midis qëndrimit tonë dhe qëndrimit tuaj është rezultat i shqyrtimit jo të marrëdhënieve midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, por si rezultat i «shkëmbimit të mendimeve» mbi gabimet që i atribuohen Partisë Komuniste të Kinës nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik.

Prandaj, në qoftë se do të bëhej një takim midis përfaqësuesve të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, sikurse propozohet me anën e letrës së mësipërme, në këtë takim do të bisedohej për gabimet që i atribuohen Partisë Komuniste të Kinës nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, dhe kjo do të bëhej nga përfaqësuesit e të dy partive tona pa qenë e pranishme partia e tretë e interesuar, domethënë Partia Komuniste e Kinës. Vetëkuptohet që një veprim i tillë nuk do të ishte i drejtë, nuk do t'i ndihmonte çështjes, por do ta dëmtonte atë.

Ashtu sikurse çdo parti tjetër marksiste, edhe Partia jonë e ndien për detyrë të japë kontributin e vet për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve. Indiferentizmi dhe neutraliteti mbi këto çështje kaq të mëdha nuk pajtohen me marksizëm-leninizmin. Prandaj, sikurse e kemi deklaruar shumë herë, përsa i përket çështjes së mosmarrëveshjeve të lindura midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, Partia jonë do ta thotë pikëpamjen e vet në mbledhjen e ardhshme të partive komuniste dhe punëtorë.

Ne ju sigurojmë se Partia e Punës e Shqipërisë do t'i qëndrojë kurdoherë besnike marksizëm-leninizmit... dhe interesave të popullit dhe të atdheut të vet.

Ne kemi bindjen se nuk jemi ne që prodhuam «shkëndijën e keqkuptimit» në Mbledhjen e Bukureshtit dhe ju sigurojmë se as që kemi për të qenë kurrë «ndezësit» e kësaj shkëndije.

Ne kemi besim se Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe të gjitha partitë e tjera motra do të na kuptojnë drejt për qëndrimin tonë marksist-leninist...

Përshëndetje vëllazërore

Për Komitetin Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
«Dokumente kryesore të PPSH»,
vëll. III, 1970, f. 353*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

MBI GABIMET E RËNDA POLITIKE DHE IDEOLOGJIKE TË LIRI BELISHOVËS

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

30 gusht 1960

Nga diskutimet që u zhvilluan në mbledhjen e ka-luar të Plenumit të Komitetit Qendror¹ Liri Belishova nuk doli me një autokritikë të shëndoshë. Për këto arsye u mendua që çështjen e saj ta rishikojë edhe një herë Byroja Politike.

Unë e prita Lirinë të vinte të bisedonim bashkë, duke menduar se, pas mbledhjes së Plenumit, ajo do të kishte reflektuar mbi gabimet e veta, por nuk erdhi. Më 9 gusht, gati një muaj pas Plenumit, më kërkoi një

¹ Plenumi i zhvilloi punimet më 11-12 korrik 1960. Ai dëgjoi raportin e anëtarit të Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror, shokut Hysni Kapo, mbi punimet e Mbledhjes së për-faqësuesve të partive komuniste dhe punëto-re që asistuan në Kongresin III të Partisë Punëto-re të Rumanisë. Në Plenum u kritikuan edhe qëndrimet e gabuara të Liri Belishovës.

takim dhe biseduam. Në këtë takim ishte edhe shoku Hysni.

Nga biseda që zhvilluam me Lirinë del se ajo nuk kishte menduar thellë mbi gabimet e saj, mbi shkaqet e këtyre gabimeve, me qëllim që të mos përsëriteshin më gabime të tilla. Pra, Liria qëndronte pak a shumë në po ato pikëpamje që i kishte shfaqur më parë edhe në Byronë Politike të Komitetit Qendror.

Unë mendoj që Liria të na thotë edhe një herë se si i kupton gabimet dhe fajet e saj, është apo jo dakord me vijën e Partisë, ka rezerva apo jo e të tjera. Liria është anëtare e Byrosë Politike dhe e di që këtë çështje, pasi ta rishikojë Byroja Politike, ne do t'ia raportojmë Plenumit për ta gjykuar.

Për ta ndihmuar Lirinë, doja t'i bëja ndonjë pyetje e t'i kujtoja disa gjëra, që t'i ketë parasysh kur të flasë.

Në fillim kam këto pyetje: Të na thotë Liria ç'pikëpamje ka për njerëzit që përbëjnë Byronë Politike dhe si e vlerëson ajo veten e saj në krahasim me anëtarë të tjerë të Byrosë Politike? Mos vallë në qëndrimin ndaj tyre adoptoi edhe ajo një farë taktike sipas orientimit të ambasadorit sovjetik? A ka besim ajo në pjekurinë dhe në aftësinë e tyre për të marrë vendime dhe për të mbajtur qëndrime të drejta në përputhje me vijën marksiste-leniniste të Partisë? Lidhur me këtë, ç'koncepte ka ajo për shokët e Byrosë Politike, sepse vijën e Partisë te ne nuk e cakton vetëm Enveri, por në radhë të parë Kongresi dhe Komiteti Qendror, ndërsa ai është një zbatues i kësaj vije dhe i vendimeve të Komitetit Qendror e të Byrosë Politike? A ka koncept të drejtë Liria për

udhëheqjen e Partisë që është zgjedhur në Kongres, se helbete, si është shprehur ajo, «ka shokë që janë më të aftë, ndonjë është më pak i aftë»? Këtë çështje mendoj që Liria ta ketë parasysh, sepse mund të ndodhë që të ngrihet ndonjëri në Plenumin e Komitetit Qendror dhe ta kritikojë atë për nënvleftësimin që u bën kuadrove kryesorë të Partisë. Prandaj kam mendimin që ajo të reflektojë më mirë në lidhje me trajtimin e kuadrove.

Po kështu, ç'përshtypje të bëri ty, informata që erdhi nga Moska mbi qëndrimin tënd atje për të cilën të thashë: reflekto në qëndrimet e tua lidhur me gabimet e sovjetikëve ndaj kinezëve? Për qëndrimet e tua ka folur ambasadori sovjetik dhe mos mendo se i ka shpifur njeri nga Partia jonë. Nga disa të dhëna që kemi mendohet se Liria është dakord me konceptet e ambasadorit sovjetik, i cili, midis të tjerave thotë: «Shoku Enver të mos përzihet në mosmarrëveshjet që ka midis Bashkimit Sovjetik dhe Kinës», «Shokun Enver ta rezervojmë». Pra, ajo është e mendimit që shokun Enver ta rezervojmë, kurse disa shokë të tjerë të Byrosë Politike t'i sakrifikojmë, sepse mund të ndodhë që mosmarrëveshjet që ekzistojnë midis dy partive të mëdha, Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës të sqarohen dhe të zgjidhen. Atëherë një pjesë e shokëve të Byrosë Politike, që do të angazhohen në debatin që ka lindur, do të digjen, por shoku Enver do të mbetet i pakomprometuar.

Po të pranojmë tezën e Lirisë, sipas së cilës «nuk duhet të përzihet Enveri në çështjet që kanë të bëjnë me Partinë Komuniste të BS dhe Partinë Komuniste të

Kinës», kjo do të thotë të pranojmë se janë të gabuara qëndrimet e Byrosë Politike në Bukuresht! Liria duhet të kuptojë mirë esencën e çështjes: ne nuk jemi dakord me qëndrimet e gabuara të udhëheqësve sovjetikë.

Disa udhëheqës sovjetikë kanë folur edhe herë të tjera kundër meje dhe ju e dini fare mirë qëndrimin tonë. Ka pasur edhe raste që ata i kanë thurur lëvdata Enver Hoxhës, por kjo ka qenë një dredhi sepse nga ana tjetër ata bëjnë gjithë këto gjëra kundër Partisë sonë.

Shokët më kanë njoftuar se Liria ka thënë që «duhet të pregatim disa variante qëndrimesh për në Mbledhjen e Moskës». Lidhur me këtë, unë dua të them se qëndrimi politik dhe taktik i Partisë sonë nuk është i tillë që të veprojmë me disa variante. Taktika e të vepruarit me disa variante është një taktikë oportuniste, që do të thotë: kthe krahun e mullirit andej nga fryn era. Kjo nuk është një taktikë marksiste. Këtë çështje ne duhet ta gjykojmë mirë, se kemi përgjegjësi të madhe. Prandaj të na e sqarojë Liria këtë çështje, të na thotë se nga ç'koncepte niset ajo për këto gjëra që i ka thënë pas Plenumit. Kjo ka shumë rëndësi, sepse ajo mund të thotë që «jam dakord me Byrosë Politike», por derisa mendon për disa variante, në fakt, s'është dakord me qëndrimin e drejtë të Partisë sonë.

Liria nuk ka qenë e një mendimi me ne, por kjo është gjysma e së keqes, ndërsa kur vepron dhe e konkretizon mendimin dhe qëndrimin e saj, kjo është një çështje tjetër. Ti, Liri, e ke konkretizuar qëndrimin tënd, sepse shkove te këshilltari i ambasadës sovjetike në

Pekin dhe e informove atë për çka të thanë shokët kinezë, gjë që, siç e theksuan edhe shokët në Plenum, është e palejueshme. Një anëtar i Byrosë Politike të një partie shkon dhe informon një këshilltar ambasade të një shteti tjetër për çështje që nuk i takojnë këtij të fundit! Kjo është në kundërshtim me parimet e Partisë, kjo është shkelje e rëndë e disiplinës së Partisë.

Ose le të shohim konceptin tjetër të Lirisë, nga i cili ajo nisët për të mos pasur mendime të drejta për qëndrimet e shokëve kinezë. Këtë koncept ajo duhet ta analizojë më thellë. Ne kemi pasur dhe kemi mendime shumë të mira për shokët kinezë, ndonjë vërejtje parimore për ta nuk kemi pasur, sepse qëndrimet e tyre janë të drejta, për shembull, për luftën kundër revizionizmit, për vlerësimin e vijës së Partisë sonë, sidomos për kontributin që dha Partia jonë në Mbledhjen e Moskës të vitit 1957 e të tjera. Përballë këtyre qëndrimeve të drejta të shokëve kinezë, del e natyrshme pyetja për Lirinë: ku e kanë burimin pikëpamjet e saj kundër Partisë Komuniste të Kinës? Kjo lidhet me atë që thanë të gjithë shokët: divergjencat e thella ideologjike midis PK të BS dhe PK të Kinës që janë vënë re në shtypin e tyre, Liria nuk i ka gzykuar në mënyrë objektive¹ dhe nga

¹ Duke vënë re qëndrimet e gabuara ideologjike të Liri Belishovës gjatë vizitave të saj në RP të Kinës, shoku Enver Hoxha, me radiogram «tepër urgjent» më 6 qershor 1960 e udhëzonte: «Për artikujt kinezë mbi leninizmin duhet të gjesh rastin t'u thuash se ato Komiteti Qendror i PPSH i ka gjetur shumë të mira dhe ti s'ke pse të mos prononcohesh për to. Vijën e Partisë sonë vazhdo ta shtrosh kudo dhe në të gjitha aspektet». (Marrë nga kopja e origjinalit të radiogramit që gjendet në AQP).

pozita marksiste, përkundrazi fajin ua ka hedhur shokëve kinezë, se ata gjoja janë në rrugë të gabuar. Pikëpamjet e gabuara të saj duken edhe në qëndrimet që mbajti ajo në Kinë, duke kritikuar padrejtësisht shokët kinezë.

Edhe në Moskë ti, Liri, ishe në dijeni të zhvillimit të situatës, ishe e parapregatitur, sepse jo vetëm kishe udhëzime, por t'u dërguan edhe letra nga ne si Byro Politike. Atëherë si shpjegohet qëndrimi yt oportunist në drekën që u shtrua në Moskë? Ti duhet të luftoje atje për të mbrojtur vijën e Partisë sonë, gjë që nuk e bërë dhe kjo të ngarkon me përgjegjësi të rëndë.

Në Kinë, ti u prite në mënyrë të shkëlqyer për hir të vlerësimit që shokët kinezë i bëjnë Partisë sonë. Ne nuk mund të themi se shokët kinezë e kanë bërë këtë formalisht. Megjithatë, në drekën që të shtruan sovjetikët, kur u fol se «puna e kinezëve bie erë...» ti nuk kundërshtove fare. Kjo do të thotë të jesh dakord me sovjetikët në akuzat e tyre kundër PK të Kinës. Ti duhej të thoshe: «Nuk është ashtu si thoni ju, se ne vijmë nga Kina dhe pamë se PK e Kinës qëndron në pozita marksiste». Por ti ishe në pozita të lëkundura dhe nuk deshe t'u prishje qejfin sovjetikëve.

Në situatën që kalojmë, ka shumë rëndësi të ruajmë unitetin e radhëve të Partisë sonë. Ky unitet, sot më shumë se kurrë, duhet të jetë i plotë dhe i palëkundur. Këtu synojnë edhe përpjekjet e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë sonë. Uniteti i Partisë në rrugën marksiste-leniniste është i domosdoshëm të ruhet vazhdimisht dhe të forcohet kurdoherë.

Tani ka filluar që «lakrorit t'i hiqet pëta». Ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm se situatat do të bëhen akoma më të vështira, këtë ta kemi mirë të qartë, të mos kemi iluzione, sepse kështu si qëndrojnë punët, kështu si po zhvillohen ngjarjet ndërkombëtare dhe si po interpretohet marksizëm-leninizmi nga udhëheqjet e shumë partive, është e kuptueshme se ndodhemi përpara evenimentesh shumë të rënda dhe tragjike për lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Prandaj duhet të armatosemi dhe t'u bëjmë ballë si marksistë këtyre ngjarjeve, pa marrë parasysh vështirësitë që mund të na ndodhin dhe do të na dalin përpara.

Komiteti ynë Qendror dhe Byroja Politike e tij, këto ngjarje i shohin qartë dhe drejt, në rrugën marksiste-leniniste. Të gjithë shokët kanë pjekuri dhe guxim marksist-leninist t'i luftojnë dobësitë dhe deviacionet që mund të shfaqen, të luftojnë rreziqet që i turren unitetit të Partisë, ndërtimit të socializmit në vendin tonë, gjithë komunizmit ndërkombëtar. Kjo është një meritë e madhe e Partisë sonë, e cila ka arritur të ketë një Komitet Qendror dhe një Byro Politike që u bëjnë ballë të gjitha furtunave dhe stuhive.

Ne sot po analizojmë gabimet ideologjike të Liri Belishovës që janë vërtetuar te ajo kohët e fundit. Shokët e Byrosë Politike të Komitetit Qendror po i bëjnë asaj kritika të drejta dhe parimore, kështu do të veprojmë edhe në Plenumin e Komitetit Qendror. Jemi të sigurtë se kritikata do të jenë si deri tani, reale, konstruktive, konkrete, marksiste-leniniste. Forcimi i unitetit të Partisë, kalitja dhe pregatitja e saj përpara furtunave, kërkojnë që ne, ashtu si kurdoherë, t'i shohim çësh-

tjet në prizmin e interesit të Partisë. Pra, kritikrat që zhvillojmë kanë një qëllim të vetëm: të forcojnë Partinë.

Shokë, le të flasim tani pak më haptazi për çështjet, si i ndiejmë dhe si i kuptojmë ato. Partia jonë, si çdo parti marksiste-leniniste ka politikën dhe taktikën e saj. Po kështu edhe shteti ynë. Por politika dhe taktika jonë zbatohen në përputhje me vijën e drejtë marksiste-leniniste. Duke qenë të qartë për ngjarjet që zhvillohen, për vështirësitë ose katastrofat dhe shkaqet e tyre, ne nuk do të gabojmë kurrë as në strategji, as në taktikë. Pikërisht këto gjëra Liria nuk i dallon mirë.

Ne jemi në rrugë të drejtë. Kemi luftuar e do të luftojmë kundër imperializmit. Imperializmi jo vetëm nuk i ka hedhur armët, por vazhdon të armatoset gjithnjë e më shumë për të shkatërruar komunizmin, për të rrëmbyer lirinë e popujve. I pëlqen ose jo Hrushovit, ky është realiteti i gjallë dhe pikëpamja jonë mbështetet mbi këtë realitet. Prandaj vija e Partisë sonë ka qenë, është dhe do të vazhdojë të jetë: luftë e vendosur kundër imperializmit me atë amerikan në krye. Mund të na akuzojë kush të dojë se ne qenkemi «luftënxitës», se gjoja jemi «me thikë në dhëmbë» e të tjera, ne nuk do të lëvizim nga pikëpamja jonë se imperializmi është armiku më i egër i popujve. Ne nuk kemi asnjë iluzion për imperializmin.

Ne themi: «kampi socialist me Bashkimin Sovjetik në krye». Kjo është e drejtë, por në qoftë se udhëheqja e Bashkimit Sovjetik nuk është në rregull dhe ecën në rrugë të gabuar, atëherë ajo ia ka hequr të drejtën Bashkimit Sovjetik të udhëheqë kampin socialist.

Ne jemi për paqen, kundër luftës dhe këtë nuk e themi me fjalë, por me vepra. Rrezikun e shpërthimit të një lufte të re nga imperializmi ne nuk e harrojmë dhe këtë rrezik as e mbivlerësojmë, as e nënvleftësojmë. Por kjo nuk do të thotë se ne nënvleftësojmë fuqinë e kampit të socializmit. Forcat e kampit tonë, po të vepronë në unitet të plotë, janë jashtëzakonisht të mëdha. Në këto situata, po të themi se në kampin tonë dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare ka unitet, do t'i binim daulles kot. Është tjetër gjë që këtë nuk e pohojmë në shtyp, për arsye politike, por në realitet uniteti që ekziston sot në kampin e socializmit dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, nuk është në lartësinë që e lyp marksizëm-leninizmi.

Po kush është shkaktar i prishjes së këtij uniteti? Kjo ne na ka shqetësuar dhe na shqetëson, sepse me unitetin është lidhur fati i komunizmit ndërkombëtar dhe i çdo vendi socialist. Përveç punës minuese të imperializmit kundër vendeve socialiste, unitetin tonë po e minojnë gjithashtu agjentët e imperializmit, revizionistët modernë.

Partia jonë e ka drejt kur thotë se revizionizmi modern është sot rreziku kryesor në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Për këtë ne nuk jemi vetëm spektatorë, po edhe dëshmitarë, sepse pas vdekjes së Stalinit shohim një shturje në kampin e socializmit dhe në gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Përse nuk ndodhnin edhe më parë shturje të tilla? Kjo nuk ndodhte, sepse Stalini ka vepruar me urtësi në marrëdhëniet me partitë e tjera komuniste e puçetore. Fakti është se lëvizja komuniste ndërkombë-

tare nuk shkoi në rrugën që kërkonin ta çonin revizionistët, sepse luftonin komunistët në të gjithë botën dhe ata kishin një besim të plotë në vijën marksiste-leniniste që ndiqte Bashkimi Sovjetik me Stalinin në krye.

Stalini nuk ka vepruar kurrë pa urtësi. Ndonjëri mund të thotë ç'të dojë për Stalinin, por e vërteta është se në kohën e tij, kampi ynë dhe lëvizja komuniste botërore ka pasur unitet të fortë. Le të marrim marrëdhëniet e Shqipërisë sonë të vogël me Bashkimin Sovjetik: «Hegjemonizmi i Stalinit», ashtu sikurse flet Titoja, nuk është dukur asnjëherë në jetën e Partisë dhe të shtetit tonë. Stalini kurrë nuk na ka folur neve duke na treguar kopaçen, kurrë nuk na ka thënë: «bëni kështu si them unë, se ndryshe ju preva bukën dhe nuk ju flas me gojë!», ose «ju hedh në erë për pesë minuta!». Partia jonë e ka shprehur dhe e shpreh se nuk ka qenë dhe nuk është dakord me qëndrimet dhe me veprimet që u ndërmorën ndaj Stalinit.

Këtu nuk është çështja e një udhëheqësi dosido, por e Stalinit që është një revolucionar i madh. Prandaj ne nuk do të pajtohemi asnjëherë me ata që fshinë meritat e tij dhe thurën gjithë ato shpifje për të.

Është interesante të theksojmë se ne na kanë akuzuar për qëndrimet që kemi mbajtur ndaj njerëzve që nuk janë në rrugë të drejtë, bile edhe për tradhtarët e Partisë, kurse ata i kanë mbrojtur elementë të tillë.

Ne pamë ç'ndodhi në Hungari, në Poloni, ç'po bëhet në Itali dhe në shumë parti të tjera. Tani, shihni ç'po bëhet ndaj PK të Kinës. Në këto momente, neve, si

marksistë, duke mbajtur një qëndrim të drejtë parimor, nuk na lejohet të mendojmë aq lehtë mbi këto ngjarje që po zhvillohen në disfavorin e kampit të socializmit e të mos i gjykojmë thellë. Ndodhemi përpara furtunave, prandaj duhet ta armatosim Partinë tonë politikisht dhe ideologjikisht në mbrojtje të marksizëm-leninizmit, pavarësisht ç'thonë të tjerët. Ne jemi përgjegjës përpara Partisë dhe popullit tonë, por edhe përpara lëvizjes komuniste ndërkombëtare nuk kemi pak përgjegjësi. Duke mbrojtur me vendosmëri marksizëm-leninizmin, ne mbrojmë interesat e larta të popullit tonë dhe të socializmit.

Duhet mbajtur mirë parasysh se revizionizmi nuk është vetëm te Titoja, i cili sot mban bajrakun, po ka edhe shumë revizionistë të tjerë, bile edhe në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Ne nuk jemi kundër qëndrimeve taktike në kushte të caktuara dhe për çështje të caktuara, por, në qoftë se udhëheqja e Bashkimit Sovjetik, nën pretekstin e «taktikave», kërkon të mbulojë gabimet e veta dhe nuk bën kthesë dhe autokritikë, kjo taktikë pas mbledhjes së nëntorit nuk do të ketë asnjë vlerë.

Taktikën ne e kemi zbatuar drejt, parimet nuk i kemi shkelur. Ne, kur e kërkon situata, edhe mund të ndryshojmë taktikë, po kurdoherë pa shkelur parimet dhe pa ulur kurrizin përpara sulmeve të padrejta të trockistëve ose të revizionistëve të çdo ngjyre. Po na ranë me shuplakë, edhe ne do t'u biem, po të na godasin me grushta, edhe ne do t'u përgjigjemi, faqen nuk e nderim kurrë e t'u themi: «Na bini!». Si udhëheqja e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ashtu dhe të

gjitha udhëheqjet e partive komuniste dhe punëtore e kanë kuptuar mirë se Partia e Punës e Shqipërisë është e papajtueshme me revizionizmin, prandaj mban një qëndrim revolucionar ndaj tij. Këtu flas për udhëheqjet, jo për partitë, sepse për to nuk jemi në korent. Çështja sot ka arritur deri aty sa nuk guxon t'i thuash një fjalë ndonjë shoku udhëheqës të një partie tjetër kundër revizionistëve jugosllavë, bile, po të shkruash ndonjë artikull për ta botuar në organe të partive të tjera, ky nuk botohet. Këtu duket fare qartë puna sabotuese e këtyre «ortakëve» të revizionistëve jugosllavë.

Revizionistët luftojnë duke qenë të maskuar dhe na sulmojnë indirekt. Sikur të dilnin haptazi, do të shkatërroheshin. Është shumë e vështirë për cilindo të atakojë direkt Partinë tonë, veçse revizionistët e nxjerrin dufin dhe shfryjnë kundër nesh duke na mbajtur mëri, duke u përpjekur të gjejnë rastin dhe të na dëmtojnë. Këtë duhet ta kemi të qartë, të kuptojmë se këto, që po ndodhin, nuk janë gjëra të thjeshta. Ne e themi pa frikë se nuk jemi dakord me udhëheqjen sovjetike jo vetëm për sa i përket luftës kundër revizionizmit jugosllav, por edhe për çështje të tjera, ndaj të cilave ajo mban një qëndrim oportunist. Vija e tyre revizioniste reflektohet jo vetëm në politikë, por edhe në drejtime të tjera.

Liria e di se me udhëheqjen e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ne kemi kundërshtime për shumë probleme parimore në çështje organizative dhe jo vetëm për sa ndodhën në Mbledhjen e Bukureshtit. Mbledhja e Bukureshtit hodhi dritë edhe në drejtime të tjera. Liria ka dijeni për metodat e tyre puçiste. Ajo e ka dëgjuar këtë nga goja e tyre. Poljanski, kur paska ardhur

në qejf në një drekë, i ka shpjeguar Lirisë se si është zhvilluar mbledhja kur u likuidua udhëheqja e vjetër e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, e të ashtuquajturit grup «antiparti». Ai ka thënë se ky veprim është bërë në formën e puçit ushtarak që, natyrisht, për ne është antimarksist. Këtu ne nuk bëjmë fjalë nëse ata që u rrëzuan nga udhëheqja kanë ose jo gabime, po për metodat antimarksiste që janë përdorur në këtë drejtim. Kjo është çështje e tyre e brendshme, por ne kështu kuptojmë më mirë se kush janë ata.

Qëndrimi i drejtë i Partisë sonë duket edhe një herë në Mbledhjen e Bukureshtit. Atje u shkelën të gjitha normat. Ne kemi të drejtë të mbajmë qëndrimin tonë. Por udhëheqjes sovjetike nuk i vjen mirë kur ne themi të drejtën. Ajo na thotë se «ju jeni kundër udhëheqjes jugosllave, prandaj jeni dakord me shokët kinezë». Ndërsa ne deklarojmë se jemi dakord me shokët kinezë, edhe ata janë dakord me ne, dhe këtë nuk e bëjmë për hatrin e njëri-tjetrit, po për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Le të thotë ç'të dojë udhëheqja sovjetike. Me qëndrimin e Partisë Komuniste të Kinës ndaj revizionizmit në përgjithësi e kundër revizionizmit jugosllav në veçanti, Partia jonë është plotësisht dakord.

Në Mbledhjen e Bukureshtit ne nuk u prononcuam se nuk kishim materiale nga të dyja palët. Pikërisht për këtë filloi një fushatë e madhe armiqësore kundër PPSH. Ky është një qëndrim antimarksist i udhëheqjes sovjetike ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë. Le të pranojmë sikur këtu ka një keqkuptim, po ky «keqkuptim» u shoqërua me akte sabotuese, që kanë për qëllim të për-

çajné udhëheqjen tonë. Kjo është antimarksiste. Dhe ne kemi një zinxhir të tërë faktesh për ta provuar këtë. Cilindo që ka shkuar në Bashkimin Sovjetik ose nëpërmjet tij në vende të tjera, sovjetikët janë përpjekur ta përpunojnë, me qëllim që të krijojnë të çara te ne. Pra, gjithë veprimtaria sabotuese e udhëheqjes sovjetike nuk mund të konsiderohet si një gjë e rastit.

Sëmundjet e theksuara oportuniste dhe gjithë ky revizionizëm që ekziston në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, nuk ka si të mos reflektohen edhe në politikën e jashtme të saj, bile edhe ndaj vendit tonë. Kështu si po zhvillohen situatat nuk janë revizionistë vetëm titistët, por në bazë të fakteve, revizionistë dhe me pikëpamje socialdemokrate ka edhe në udhëheqjen sovjetike. Lidhur me këtë ne kemi biseduar shumë herë në Byronë Politike dhe në takimet që kemi pasur. Prandaj edhe Liria, ka qenë në dijeni të këtyre çështjeve ashtu sikurse ne. Për këtë ajo nuk ka të drejtë kur thotë: «Nuk kam qenë në dijeni».

Le t'i gjykojmë qëndrimet e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ndaj PK të Kinës. Ajo është munduar të mos i japë kohë Partisë Komuniste të Kinës të mendohet dhe të shfaqë pikëpamjen e vet. Qëndrimi ynë ndaj kësaj çështjeje të madhe është i drejtë, sepse revizionizmi kërkon t'i përgatitë terren imperializmit, prandaj duhet të luftojmë si kundër imperializmit, ashtu dhe kundër revizionizmit. Do të ishte katastrofë e madhe, po të pranonim të hynim në rrugën revizioniste, ku kërkojnë të na çojnë udhëheqësit sovjetikë. Kjo do të kishte pasoja të rënda. Cilat do të ishin disa nga këto pasoja?

Së pari, do të ishte heshtja ndaj revizionizmit. Nga ana politike ky do të ishte një krim i rëndë që do t'i bëhej marksizëm-leninizmit. Gjatë gjithë ngjarjeve që zhvillohen, bëhen shumë përpjekje që ne të heshtim. Po heshtja do të qe etapa e parë.

Etapa tjetër do të ishte hapja e kufijve revizionizmit, siç po bën sistematikisht, për shembull, udhëheqja e Partisë Komuniste të Bullgarisë. Sigurisht, ajo e bën këtë për veten e saj dhe është keq për të. Ne nuk do ta ndjekim këtë rrugë. Sikur të ndjekim edhe ne një rrugë të tillë, kjo do të ishte vetëvrasje për vendin tonë. Zhivkovi po tregohet tolerant dhe shumë pajtues me revizionizmin. Kjo duket fare qartë, po ky qëndrim pajtues i Zhivkovit ndaj revizionizmit tregon se ai i mban ison Hrushovit. Ne kemi bindjen se udhëheqësit e Partisë Komuniste të Bullgarisë do të hasin patjetër vështirësi të mëdha dhe, në mos sot nesër, do të kenë të bëjnë medoemos me partinë dhe popullin e tyre, sepse hapja e kufijve bullgaro-jugosllavë dhe depërtimi i revizionizmit do të thotë për Bullgarinë përgatitje e një kundërrevolucionit si në Hungari, me ndryshim se në Hungari u bë edhe luftë, kurse në Bullgari kjo punë mund të bëhet në një mënyrë të heshtur.

Pra, nga heshtja, kalohet aty ku është Jugosllavia. Në qoftë se ne do ta lejonim një gjë të tillë, kjo do të thotë të humbasësh pavarësinë e atdheut e t'i vësh minat socializmit. Ç'do të thotë që ne të hapim kufijtë dhe t'i bëjmë lëshime parimore udhëheqjes jugosllave, gjoja për hir të miqësisë me popullin jugosllav? Për miqësi me popullin jugosllav ne kemi qenë e jemi, por kurrë nuk do t'u bëjmë lëshime revizionistëve. Partia

jonë e ka kuptuar drejt këtë, prandaj nuk e ka ndërprerë asnjëherë luftën kundër revizionizmit.

Në goftë se udhëheqësit sovjetikë kanë «ndjenja humanitare», dhe bëjnë çmos për ta afruar udhëheqjen jugosllave, atëherë si e hedhin kaq lehtë në oqean gjithë atë Kinë të madhe, duke ditur sidomos se udhëheqja e Kinës nuk është as agjente e imperializmit, as «kalë i Trojës», siç është Titoja? Edhe sikur shokët kinezë të ishin sektarë, siç akuzohen nga udhëheqja sovjetike, a do të thotë kjo që të shkojmë deri në përjashtimin e tyre nga kampi ynë socialist? A janë këto qëndrime komuniste dhe internacionaliste ndaj Kinës socialiste?

Përçarja e komunizmit ndërkombëtar është e një përgjegjësie shumë të madhe. E si mund të ecet kështu? Mund të shkohet duke u imponuar partive tona një rrugë antimarksiste dhe me shantazhe? Rruga e Partisë sonë është e drejtë dhe ne nuk futemi në rrugë qorre, ne nuk do të ndjekim vijën revizioniste të Hrushovit. Partia dhe populli ynë janë shumë të kalitur në luftë me revizionizmin e me imperializmin dhe kanë ndjekur e do të ndjekin vazhdimisht rrugën e drejtë marksiste-leniniste.

Ne do t'i mbrojmë parimet. Vështirësi, sigurisht, do të kemi dhe jemi të bindur se këto vështirësi do të vijnë duke u rritur, po ato nuk na trembin. Ne jemi të sigurtë se udhëheqja sovjetike me qëndrimet dhe me veprimet ndaj Partisë sonë nuk është në rrugë të drejtë. Veprimet e tij antimarksiste Ivanovi nuk i bën nga koka e tij, por sipas udhëzimeve të udhëheqjes sovjetike.

Kur flet Liria, na tregon procesverbalet e mbledhjeve. Deri tani, asnjë nga anëtarët e Byrosë Politike nuk

ka punuar me procesverbale, por me një frymë revolucionare, me besim të madh te njëri-tjetri. Asnjëri nuk ka shënuar me prapamendime në bllok se ç'fjalë ka thënë ky ose ai anëtar i Byrosë Politike, siç bën Liria, sepse shokët nisen si të mbrojnë vijën e Partisë. Kurse ajo, që ka bërë gjithë këto gabime, po i lexon kaq shumë procesverbalet e mbledhjeve, me qëllim që të vërtetojë se ne gjoja qenkemi lëkundur në qëndrimin ndaj BS.

Asnjë nga ne nuk është lëkundur në këto situata që kalojmë, asnjë nga ne nuk e do më pak Bashkimin Sovjetik sesa Liria. Bashkimin Sovjetik të gjithë e duam: Ne mund të kalojmë situata të vështira, mund të gjendem në momente të rënda, po Bashkimin Sovjetik ne do ta mbrojmë.

Ne qëndrojmë fort në pozitat tona. Sigurisht, revolucionin dhe socializmin ne i arritëm me luftën dhe me përpjekjet tona, por eksperiencën e madhe të Bashkimit Sovjetik, të Leninit dhe të Stalinit, ne e vlerësojmë drejt: Me ndihmën që na ka dhënë Bashkimi Sovjetik, ne ndërtoam kombinatë, si ai i tekstileve «Stalin», por aty u derdh dhe djersa e popullit tonë. Kush është marksist-leninist e internacionalist duhet ta dijë se revolucioni popullor dhe ndërtimi i socializmit janë vepër e popullit shqiptar dhe e Partisë së tij.

Ne duhet të jemi konsekuentë, të mos shkelim vijën tonë, të mos çorientohemi dhe të mos lëkundemi në vijën e drejtë të Partisë. Të mos e ngatërrojmë BS dhe eksperiencën e tij me qëndrimin oportunist të udhëheqjes së sotme. Një gjë të tillë ti, Liri, nuk e ke kuptuar drejt ose do dhe e ngatërron. Kundër veprimeve të tyre nuk duhen bërë lëshime. Lufta kundër revizionistëve, neve

na ka mprehur vigjilencën, ajo ka qenë një shkollë e madhe që na ka kalitur dhe na ka bërë t'i shikojmë veprimet si në një radar, pa gjaknxhtësi, pa *parti pris*. Prandaj të jemi konsekuentë dhe të pregatitur t'i bëjmë ballë çdo situatë, sepse me luftën e hapur kundër Hrushovit, ai do të kurdisë bllokada politike dhe ekonomike ndaj vendit tonë.

Ti, Liri, që je lëkundur në këto situata, të jesh e bindur si dhe ne, se vija e Partisë sonë është e drejtë dhe të mos impresionohesh as për çështjen e Bashkimit Sovjetik dhe as nga personaliteti i Hrushovit ose i kujtdo tjetër qoftë. Partia jonë nuk lëkundet edhe në këtë luftë të shtrënguar që po zhvillohet brendapërbrenda kampit tonë, luftë e cila ka hyrë në një fazë shqetësuese.

Pasi foli Liri Belishova, e cila nuk bëri aspak auto-kritikë, përkundrazi, u përpoq të zvogëlonte fajet e saj të rënda, dhe pas diskutimeve të anëtarëve të Byrosë Politike, që kritikuan ashpër fajet dhe qëndrimet e saj, e mori fjalën përsëri

SHOKU ENVER HOXHA: Diskutimet që u zhvilluan në Plenumin e Korrikut të Komitetit Qendror dhe këtu në Byronë Politike, ishin në rrugën marksiste-leniniste. Evolucioni që bëjnë shokët në mendimet e tyre është gjithashtu i drejtë dhe gjykimi i këtyre çështjeve na armatos. Teorikisht çështjet që diskutojmë i di edhe Liria, po kur vjen puna në praktikë, ajo gabon dhe pasojat rëndojnë mbi kurrizin e popullit e të Partisë.

Prandaj edhe unë, si të gjithë shokët e Byrosë Politike, mendoj se Liri Belishova ka gabuar rëndë, është lëkundur në besimin ndaj vijës ideologjike dhe politike të Partisë sonë. Ajo ruan akoma pikëpamjen se nuk

ka gabuar. Liria duhet të reflektojë më thellë. Në rast se Liria vazhdon edhe në Plenum të KQ të qëndrojë në këto mendime, të mos i kuptojë këto çështje në rrugën marksiste-leniniste, ajo do ta vështirësojë akoma më shumë pozitën e saj. Unë mendoj se Plenumi do ta ndihmojë, po dhe ajo duhet të ndihmojë Partinë dhe veten.

Ne po përpiqemi se si të të shpëtojmë ty, Liri, duke ditur edhe dobësitë e tua, kurse ti çuditesh me qëndrimin tonë. Mos u çudit që shokët të pyesin, ne duam sqarime dhe kemi për qëllim të të ndihmojmë.

Liria duhet ta dijë mirë se në Byronë Politike duhet të ketë unitet të plotë. Udhëheqjen e Partisë duhet ta kemi monolite, prandaj Liria nuk mund të qëndrojë në Byronë Politike, sepse ajo është lëkundur. Në Parti mund të qëndrojë, por në rast se në Plenum sillen argumente të tjera dhe Liria nuk do t'i realizojë drejt gabimet e saj të rënda, do të jetë Plenumi ai që do të vendosë qenien e saj në Parti. Shokët kanë mendimet e tyre dhe do të flasin. Në këtë mënyrë ne mbrojmë Partinë.

Në këtë mbledhje Lirisë iu dha një ndihmë e madhe. Ajo ka gabuar rëndë dhe gabimet e saj nuk janë të thjeshta. Jam plotësisht dakord me shokët se ajo nuk ka zbatuar direktivat e Partisë. Kjo ka ndodhur se nuk ka qenë dakord me udhëheqjen, e ka nënvleftësuar Byronë Politike. Drejt e thanë shokët se Liria është mendjemadhe dhe ambicioze, ajo do që të zërë vendin e Enverit, të Mehmetit ose të Hysniut. Me përjashtim të pak shokëve të Byrosë Politike, Liria për të tjerët nuk ka konsideratën e duhur. Por, në rast se nuk ke një konsideratë të drejtë për anëtarët e Byrosë Politike, për

shokët e Komitetit Qendror, për të gjithë kuadrot, atëherë do të dalësh në rrugë të gabuar dhe kjo do të shfaqet pastaj edhe në qëndrime politike dhe ideologjike. Sigurisht, ti, kur pe qëndrimin tonë ndaj udhëheqjes sovjetike, ke thënë me mendjen tënde: «Dale, se shokët e Byrosë Politike po gabojnë, tani është momenti të dal në krye». Dhe u shpejtove të mbaje qëndrime të ndryshme nga ato të Partisë. Në këtë rrugë të nxitën edhe të gjitha lajkat që të bënë disa udhëheqës sovjetikë. Të gjitha këto së bashku kanë ndikuar që ti të bësh gabime të rënda ideologjike dhe politike.

Jam plotësisht në një mendje me shokët, që ti ke gjykuar se Byroja Politike ka gabuar në mbajtjen e qëndrimeve dhe s'deshe të komprometohesh, por mbajte ndaj udhëheqësve sovjetikë një qëndrim oportunist, që në fakt të largonte nga rruga e drejtë e Partisë tënde. Ti mendove: «Unë do të shkoj në Shqipëri, do të them se qëndrimi i Byrosë ka qenë i shpejtuar, do të propozoj që Enver Hoxha të mënjanohet nga mosmarrëveshjet që kanë lindur midis PK të BS dhe PK të Kinës. Situata, në mos sot nesër do të ndryshojë. Koha do të punojë për mua». Ti i rezervove vetes vendin e shpëtimtarit të situatës. Prandaj nuk zgjodhe qëndrimin parimor, por hesh-tjen dhe aprovimin indirekt të veprimeve revizioniste të udhëheqësve sovjetikë. Ti vjen këtu e shpreh habinë: «Përse u bë ky ndryshim në qëndrimet ndaj Bashkimit Sovjetik!» dhe identifikon Bashkimin Sovjetik me udhëheqjen sovjetike. Ti ke menduar, pra: «ishalla punët marrin rrugën që dua unë!». Po ja që për të mirën e Partisë punët nuk shkuan ashtu si i mendoje ti.

E ç'është ai mendim që thua: «Enveri të qëndrojë

mënjandë? Mirë e thanë shokët, se këtu pleksen të gjitha gjykimet e tua jo të pjekura. Ti kujton se marksizmin e zotëron më mirë nga të tjerët. Shkollë kanë kryer edhe shokët e tjerë dhe nuk e kanë mbaruar keq, bile shumë nga ata kanë bërë shkolla akoma më lart se ti, pra kanë edhe një kulturë më të gjerë, po ashtu edhe stazh partie dhe lufte më të gjatë, por këta shokë unë nuk i kam parë e nuk i kam dëgjuar kurrë që të thonë: «Ne qëndrojmë më lart se të tjerët». Prandaj qëndrimet e tua ndaj shokëve janë qëndrime prej megalomani.

Në Byronë Politike nuk na ka zgjedhur njeri për sytë e bukur, por, kur nuk e bën punën mirë një herë, dy herë, atëherë çështja duhet parë. Ne të kemi dashur, të kemi mbrojtur, të kemi ndihmuar dhe do të të ndihmojmë, po ti je çorientuar dhe nuk e ke mbrojtur si duhet vijën e Partisë në këto situata të rënda. Bashkohem me mendimin e gjithë shokëve, se në Komitetin Qendror dhe në Byronë Politike duhet të ekzistojë një unitet i plotë mendimesh dhe veprimesh përsa i përket vijës politike, ideologjike, organizative dhe ekonomike të Partisë sonë. Kjo nuk përjashton diskutime të lira, po, kur merren vendime, të gjithë jemi ushtarë të Partisë dhe ato duhet t'i zbatojmë me rigorozitetin më të madh.

Çështjen tënde do t'ia paraqitim Plenumit të Komitetit Qendror, por varet shumë se sa do të reflektosh në këto gabime. Në rast se ti e thellon autokritikën, i gjykon drejt çështjet dhe i thua haptazi gabimet që ke bërë, atëherë ne mund të mendojmë se i ke kuptuar ato dhe do të ketë garanci se nuk do të gabosh më. Mundësitë që ke, vëri në shërbim të Partisë.

Situatat janë të koklavitura. prandaj nuk duhet

të jemi të frikshëm dhe pesimistë. Të mbajmë mirë në dorë si një busull marksizëm-leninizmin dhe kurrë nuk do të gabojmë në vijë.

*Botohet për herë të parë me ndonjë
shkurtim sipas tekstit të nxjerrë nga
procesverbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH që gjendet
në AQP*

AI QË NUK KA BESIM TE PARTIA, ARRIN NË KONKLUZIONE DHE NË VEPRIME TË GABUARA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH
mbi veprimet e Koço Tashkos në kundërshtim
me vijën e Partisë*

31 gusht 1960

Me anë të procesverbalit përkatës, ju, shokë të Byrosë Politike, jeni në dijeni të bashkëbisedimit që kam bërë unë dhe shoku Rita Marko me Koço Tashkon. Tani u mbledhëm që ta shqyrtojmë këtë çështje.

Sipas mendimit tim, Koço Tashkoja ka rënë, së pari, në gabime shumë të rënda antiparti, të cilat e vënë atë në opozicion të hapur me udhëheqjen e Partisë; së dyti, ai ka thyer të gjitha rregullat organizative të Partisë duke arritur që të bisedojë, jashtë saj, me ambasadorin sovjetik vendimet e Plenumit të fundit të Komitetit Qendror.

Nga bisedimi që bëmë me Koço Tashkon, mund të themi se ai, jo vetëm nuk i ka njohur gabimet e veta të rënda, po i quante të drejta qëndrimet e tij dhe, sikundër keni vënë re duke lexuar procesverbalin, edhe

toni i tij gjatë takimit ka qenë arrogant, megjithëse ne u përpoqëm ta ndihmonim që ai të reflektonte mbi këto gabime, t'i shikonte ato drejt, me syrin e Partisë.

Kanë kaluar shumë ditë që kur u takuam dhe biseduam me Koço Tashkon. Tani besoj se ai ka reflektuar më shumë në gabimet e tij dhe do të dalë si duhet para Byrosë Politike, e cila do ta ndihmojë sa të jetë e mundur më shumë për të njohur gabimet e rënda që ka bërë.

Tani, Koço, ne dëshirojmë të flasësh këtu, përpara Byrosë Politike dhe të na thuash si i shikon ti gabimet dhe qëndrimet e tua, për të cilat kemi biseduar.

Koço Tashkoja përsëri nuk reagoi drejt. Ai nuk kishte reflektuar në gabimet e tij dhe s'bëri autokritikë. Shokët e Byrosë Politike u përpoqën me durim ta ndihmonin për të kuptuar qëndrimet e tij antiparti, por ai në vend që të thellohej, kërkonte të zvogëlonte gabimet e veta dhe të mos fliste hapur.

SHOKU ENVER: Ne, Koço, nuk kemi ndonjë gjë personale me ty. Këtu flasim për çështje vije, vijën e Partisë duhet ta mbrojmë të gjithë. Prandaj mos na bëj teori, por hyr në thelbin e çështjeve, për të cilat kemi biseduar edhe bashkë.

Siç u përmend edhe në Plenum, ne i kemi thënë mendimet tona për revizionistët jugosllavë e të tjerë dhe Plenumi i mori vesh, pra i more vesh edhe ti. Edhe Hrushovit, për të cilin ty të ha merak, ia kemi thënë qëndrimin tonë, por ai nuk është dakord me luftën që bëjmë ne kundër revizionizmit jugosllav. Derisa pozita jonë është e qartë, atëherë pse ti u trubullove kaq shumë?

Çështjet që ngremë ne për udhëheqjen e Bashkimit

Sovjetik, gabimet, për të cilat e kritikojmë Hrushovin, nuk dalin sot, këto kanë kohë që kanë dalë e, megjithëkëtë, për ty Hrushovi s'ka gabime.

S'po na flet gjë akoma, Koço, megjithëse thua që «do të shprehem nga shpirti i brendshëm». Edhe ne këtë duam dhe do të të gjykojmë ashtu si do të flasësh, por kërkojmë nga ti respekt për Byronë Politike. Sikur të ishte Byroja Politike siç mendon ti, Shqipërinë do ta kishte marrë lumi me kohë. Prandaj ki më shumë respekt për shokët e Byrosë Politike dhe mos mbaj qëndrime prej megalomani. Fol drejt, sinqerisht e me gjakftohtësi, thuaj ç'ke «në shpirtin tënd të brendshëm», se deri tani po e shohim shumë të errët këtë shpirtin tënd.

Sipas teje, duhej që Torezi të na rregullonte të merreshim vesh me Hrushovin. Po pse, për çështje që kemi midis nesh nuk bisedonim dot vetë me Hrushovin? Kjo do të thotë të futnim një njeri tjetër në mes. Torezi është sekretar i përgjithshëm i një partie tjetër, ç'punë ka ai që të na rregullojë me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik?

Ne kemi thënë që çështjet midis PPSH dhe PK të BS nuk duhet të dalin jashtë Komitetit Qendror; me popujt sovjetikë të vazhdohet miqësia, dashuria dhe bashkëpunimi si dhe më parë. Kjo ka qenë dhe është vija e Partisë sonë, kurse ti vepron ndryshe, bën si të do qejfi, i bisedon çështjet me të tjerë dhe mendon që Torezin ta bëjmë një «ndërmjetës për të na pajtuar me Hrushovin!».

Pse nuk erdhe te unë, të më thoshe për «planet e mëdha» që kishe ndër mend të zbatoje? Në Plenum nuk

i the këto, se nuk ke respekt për të, dhe ishe kundër konkluzioneve të tij, me Enverin thua se do të bisedoje, kurse në fakt shkove dhe bisedove me sovjetikët. Tani s'të vjen mirë që të themi se s'ke besim te Plenumi i Komitetit Qendror i Partisë sonë marksiste-leniniste, por këtë le ta gjykojë Plenumi. Po të kishe ardhur te unë 10-15 ditë përpara se të shkoje te sovjetikët, puna mund të ishte ndryshe.

Dyshimet dhe mendimet e tua ti i kishe në kokë që kur dole nga Plenumi, por s'na the asnjë fjalë. Të na thoshe që, «unë, shoku Enver, mendoj të shkosh në Moskë sa më parë, që të mos mbeten çështjet për t'u biseduar në nëntor». Por ti, në vend që ta bëje këtë me Partinë tënde, bëre tri takime me sovjetikët.

Me të marrë letrën tënde unë i telefonova menjëherë Hysniut dhe i thashë: «Njoftoje Koçon se e mora letrën dhe të takohet me ty». Këtë letër unë mund të mos e kisha marrë fare se isha në pushime. Pastaj ti nuk kërkove të vije te unë përpara takimit me sovjetikët.

Atë ditë që ti erdhe në takim te unë, atashu ushtarak sovjetik, kolonel Rura, ka ardhur dhe ka njoftuar se gruaja e Koço Tashkos u ka thënë se i kanë arrestuar burrin. Si e shpjegon këtë? Ç'kërkon gruaja jote që shkon në ambasadën sovjetike? Pse jeni të alarmuar? Unë shfaq mendimin tim dhe them se ti ke mizën nën kësulë, prandaj alarmohesh; me sa duket, bisedon dhe me gruan. Ti kërkon një takim me Enverin, ai të dërgon një oficer të të lajmërojë për takim, ndërsa ju alarmoheni. Gruaja jote shkon dhe në ambasadë e ti për këtë s'paske dijeni!

Neve do të na i hedhësh këto? Po pse ti erdhe me 3 orë vonesë në takim? Ji serioz, Koço, dhe fol drejt. Pse të kesh frikë se mos arrestohesh? Ne i zbatojmë ligjet si duhet, po ai që ka mizën nën kësulë dhe nuk ka besim te Partia, arrin në konkluzione dhe në veprime të gabuara. E tërë kjo çështje tregon mosbesim të plotë te Partia, ndërsa ato që na thua janë përralla.

Sipas teje, ne jemi kundër Bashkimit Sovjetik, kurse ti je «mbrojtës» i tij. Ti nuk ke asnjë nocion për marksizëm-leninizmin. Kur një anëtar partie gabon, partia ka të drejtë ta kritikojë, kushdo qoftë ai. Këtë e ka shkruar me aq zjarr Lenini. Hrushovi paska të drejtë të kritikojë Stalinin pas vdekjes, kurse ne s'paskemi të drejtë të kritikojmë Hrushovin që është i gjallë dhe bile në sy! Sipas pikëpamjes tënde nuk duhet kritikuar një njeri që gabon.

Je dakord ti me ato që u shtruan në Plenum dhe me kritikën e drejtë që i bëmë Hrushovit, i cili ka dashur, përveç të tjerave, të na largojë nga lufta idologjike kundër revizionistëve jugosllavë? Po ç'kritikë tjetër bëmë ne kundër Hrushovit, që ti u alarmove? Në Plenum nuk u tha gjë tjetër që ti na ngre çështjen se gjoja ne folëm kundër Bashkimit Sovjetik. Këto i pjell imagjinata jote. Ndonjë shok s'bëri keq që tha se s'më ka pëlqyer kjo ose ajo shprehje e Hrushovit nëpër fjalimet që mban; vërejtje të tilla u bënë vetëm në Plenum. Prandaj pse i ngatërron çështjet, Koço Tashko, përse nuk i hap zemrën Partisë që kërkon të të ndihmojë? Ti po na thua këtu gjëra që nuk i ha njeri. Prandaj përpara Partisë fol ashtu si duhet. Si mund të të ndihmojë ty Byroja Politike? Ti duhet të bindesh

që ke nevojë për ndihmë dhe t'u japësh përgjigje të drejtë pyetjeve të natyrshme dhe shqetësuese të shokëve që duan të të ndihmojnë.

Nuk është e hijshme për ty si komunist t'i thuash Partisë tënde se nuk ke biseduar asgjë me Ivanovin, në një kohë që ai dhe shokët e tij kanë qëndruar si skifterë mbi njerëzit tanë duke bërë diversion. Ata kanë bërë e bëjnë çmos për të mësuar ndonjë gjë, ndërsa ty nuk të paskan pyetur se mos të të «komprometonin», siç the vetë! Po çfarë komprometimi do të të bëhej ty, kur ne të gjithë ishim në marrëdhënie të mira me shokët sovjetikë e bënim shakara me ta? Nuk thua më mirë që gjetën te ti një pikë të dobët dhe të kapën, sesa të thuash «nuk më pyetën për asgjë sepse nuk donin të më komprometonin»? Ndjaj kujt nuk donin të të komprometonin? Pse, ishe ti në kundërshtim me Partinë që mos të të komprometonin? Duhet të jesh në opozicion me Partinë që tjetri të veprojë fshehur e të ketë kujdes mos të të komprometojë.

Në nëntor ne do të vemë në Moskë në Mbledhjen e partive komuniste e punëtoare të botës. Deri atëherë ç'të bëjmë ne më tepër? Në qoftë se kampi është në rrezik të përçahet, si evitohet kjo? Ky rrezik evitohet duke u sqaruar çështja në rrugën marksiste-leniniste, duke diskutuar se kush ka të drejtë dhe kush jo. Ky diskutim do të bëhet në Mbledhjen e Moskës.

Pas diskutimeve që zhvilluan shokët e Byrosë Politike, të cilët dënuan njëzëri qëndrimin dhe veprimtarinë antiparti të Koço Tashkos, e mori përsëri fjalën

SHOKU ENVER: Jam dakord me të gjitha diskutimet e shokëve të Byrosë Politike dhe mendoj se Koço

Tashkon duhet ta gjykojmë drejt dhe ashpër. Ai vazhdon të mbajë qëndrime antiparti dhe armiqësore ndaj Partisë, Komitetit Qendror dhe Byrosë Politike. Siç thanë edhe shokët, me ndërhyrjet dhe me ngurrimet e tij për të thënë të vërtetën, Koço Tashkoja qëndron në gabimet e veta të rënda.

Sigurisht, gabimet e tij duhen vlerësuar siç janë, nuk na lejohet të mbështetemi në konsiderata të tilla si «ai është shok i vjetër» etj. Shokët e Partisë, të gjithë pa përjashtim, duhet të jenë konsekuentë dhe mbrojtës besnikë të vijës së Partisë, aq më shumë komunistët e vjetër që kanë një eksperiencë të gjatë. Por, kur ndonjëri, cilido qoftë, mban qëndrim armiqësor, ne duhet të jemi të drejtë dhe të ashpër.

Në takimin që pata me Koçon unë i thashë të fliste hapur, pa pritur që ne t'i bënim pyetje. Mirëpo me qëndrimet e tij ai jo vetëm na detyroi t'i bënim pyetje, por edhe sot përpara Byrosë Politike Koço Tashkoja përsëri nuk është në rrugë të drejtë, prandaj bashkohem me mendimet e shokëve se ai po e gënjen Partinë me tërë kuptimin e fjalës.

Ne jemi të bindur se ti, Koço, ia ke thënë Ivanovit të gjitha çështjet duke shkelur kështu direktivat e Komitetit Qendror, Statutin e Partisë. Në Plenum u tha shqip se çështjet që diskutuam duhet të mbeten në Komitetin Qendror, dhe, në qoftë se i duhej thënë Ivanovit ose Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Komiteti Qendror do të merrte vendim dhe do të autorizonte njerëz për t'ua thënë. Ty nuk të autorizoi njeri, por veprime me kokën tënde. Ky është një gabim i madh që nuk lejohet.

Dihet se, kur ka mosmarrëveshje midis dy partive, ato merren vesh midis tyre, diskutojnë, bëjnë debat, pra, veprohet në pajtim me normat organizative të njohura. Kurse ti i ke shkelur të gjitha këto norma.

Pse e bëre ti këtë? Unë jam plotësisht i bindur se ti, duke qenë në kundërshtim me vijën e Partisë dhe me Komitetin Qendror, mendove se erdhi koha që këta njerëz, «pa vlerë» në krye të Partisë që po izolojnë dhe po rrezikojnë Shqipërinë, të qërohen, prandaj, sipas teje, duhej përgatitur një udhëheqje e re, ku të sundonin oportunistët dhe trockistët e Shqipëria të shkonte në katastrofë. Ne nuk na bindin fjalët e tua. Vetë faktet tregojnë se ti je në kundërshtim qind për qind me vijën e Partisë, me udhëheqjen e saj, me vendimet e Komitetit Qendror dhe këtë nuk e luan as topi. Këtë e vërtetojnë më së miri edhe vetë fjalët e tua.

Sikurse tha shoku Pilo Peristeri, ti nuk mund të shkoje deri në fund me Partinë. Qëndrimi yt nuk është i rastit. Veprimtaria jote është antiparti, ti nuk je komunist, konceptet e tua për komunizmin nuk janë të drejta. Ti je një oportunist, një karrierist, një njeri me shumë mbeturina të theksuara mikroborgjeze, je edhe frikacak. Situatat e vështira ty të frikësuan. Këto ne t'i themi haptazi dhe jo prapa krahëve, t'i themi jo për të të ofenduar, por me qëllim që të korrigjohesh. Partia përpiqet të mos i lërë njerëzit të venë në greminë. Në qoftë se ti nuk i njeh gabimet e tua, keq për veten tënde. Ne po t'i themi këto, sepse janë shfaqur në jetën tënde më se një herë.

Në këto momente të vështira që po kalon kampi ynë i socializmit, duhet durim, pjekuri, ndershmëri. Ti

nuk i ke pasur këto cilësi, prandaj ke zgjedhur rrugën oportuniste, revizioniste, antiparti, për t'i thelluar këto kontradikta, për të dëmtuar Partinë, për të hedhur baltë në udhëheqjen e Partisë sonë. Këtë ti e ke bërë me bindje të plotë dhe me kokën tënde të sëmurë. Marrëzi në gjithë jetën tënde ne kemi konstatuar edhe më parë. Ne jemi përpjekur të të ndihmojmë, të të trajtojmë mirë, por ti nuk mendon fare se me ç'parti ke të bësh. Duke vepruar kundër Partisë, ti nuk mund të pretendosh se je me Partinë. Të jesh me Partinë dhe të thurësh plane kundër saj, kjo nuk mund të ndodhë.

Ti je për politikën e pajtimit me gabimet shumë të rënda të Hrushovit dhe kurdoherë kështu ke qenë ndaj armiqve. Parimi yt që gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ka qenë «me pak gjak ose pa gjak fare». Prandaj me të dëgjuar kritika të drejta ndaj Hrushovit, i cili akuzon Kinën si luftënxitëse, ti, pa gzykuar fare, mendove se «Kina qenka për gjak», prandaj «larg nga Kina» dhe t'u duk se shokët e Plenumit të KQ të PPSH janë në rrugë të gabuar. Kritikat e Plenumit për Hrushovin ti i merr sikur ne tani qenkemi kundër Bashkimit Sovjetik.

Në Plenum u tha qartë se qëndrimi ynë ndaj shokëve kinezë do të përcaktohet pasi të dëgjohet edhe fjala e tyre e jo vetëm fjala e udhëheqësve sovjetikë dhe, pasi ta kemi studjuar çështjen me kujdes deri në fund në Komitetin Qendror të Partisë, do të themi mendimin tonë në Mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtoreshë që do të zhvillohet në nëntor në Moskë. Fakti është se ky qëndrim ka gjetur aprovim

unanim në të gjithë Partinë tonë, gjë që u shpreh me rastin e punimit të letrës së fundit¹ në të gjitha organizatat-bazë. Ky qëndrim është pranuar me entuziazëm, me vendosmëri e me krenari për pjekurinë e Partisë sonë, për trimërinë e saj në mbrojtje të marksizëm-leninizmit. Me këtë qëndrim që është busull vendimtare dhe me këtë trimëri ne do të vemë në Mbledhjen e Moskës dhe, duke gjykuar drejt, do të themi atje fjalën tonë. Nëse Komiteti ynë Qendror do të krijojë bindje se Kina ka gabime, nuk do të ngurrojë t'ia thotë këto gabime, po, në rast se nuk ka gabime, atëherë Kinën do ta mbrojmë. Sigurisht, do të flasim edhe të tjerët. Në qoftë se do të dalë që Komiteti ynë Qendror ka bërë gabime, ne nuk do të kemi frikë të bëjmë autokritikë. Në këtë mënyrë kjo do të jetë një mbledhje marksiste-leniniste dhe jo si ajo e Bukureshtit, që nuk u zhvillua sipas normave organizative leniniste, po u organizua shpejt e shpejt me qëllim që të dënohej Kina. Ne nuk e pranuam dhe e dënuam një praktikë të tillë antimarksiste, sepse kemi përgjegjësi përpara Partisë dhe popullit tonë, përpara komunizmit ndërkombëtar.

Përpjekjet e Byrosë Politike kanë për qëllim që ty të të shmangin nga rruga dhe nga pikëpamjet e tua antiparti, por ti e mbushe vetë kupën. Partinë tonë nuk e ke dashur si duhet me vepra, por vetëm me fjalë. Të gjithë e duan Partinë, por bëjnë edhe sakrifica

¹ Është fjala për letrën e KQ të PPSH të 9 gushtit 1960 drejtuar të gjitha organizatave-bazë të Partisë, në lidhje me zhvillimin e Mbledhjes së Bukureshtit. (Shih në këtë vëllim f. 111).

për ta mbrojtur kurdoherë e jo për ta dëmtuar atë. Ti nuk mund të bësh dot fraksion në Komitetin Qendror, sepse s'të ndjek njeri. Me këto pikëpamje që ti ke në kokë, zor se të ndjekin edhe një ose dy vota. Këtë ti e di fare mirë. Prandaj mendove se erdhi koha dhe gjete rrugën të shkoje në ambasadën sovjetike. Metodat që përdore ti, ne i dënojmë rëndë. Ti nuk ke fare besim te Partia, prandaj fantazon duke thënë «më ruajnë» etj. Të gjitha këto janë krejtësisht në kokën tënde, janë imagjinata jote, marrëzia jote.

Ne kemi respekt për njerëzit, por vetëm në rrugë partie. Kjo tregon edhe një herë drejtësinë e udhëheqjes sonë. Është logjike se gjersa ti je në rrugë të drejtë, ne kemi respekt për ty, ndërsa, kur ti lufton kundër Partisë, atëherë mbaroi respekti, nuk ka më respekt. Interesi i Partisë dhe i popullit është mbi lidhjet e gjakut ose të miqësisë. Por ti këtë nuk e kupton, sepse ke koncepte mikroborgjeze, trillon pikëpamje që janë të huaja.

Në takimin që patëm bashkë, unë të këshillova që gabimet e tua t'i kuptosh drejt dhe sot këtu të flasësh sinqerisht. Por ti nuk e bërë këtë. Ato që thua se do të vije të bisedoje me mua, janë të qepura me pe të bardhë. As letra që më dërgove, as data e saj, as qëllimi nuk vërtetojnë se ti do të vije te unë. Ti do të vije te unë pasi të veje më parë te Ivanovi. Më parë se t'i sugjeroje atij që Enveri të shkojë në Moskë, të ma sugjeroje mua këtë mendim. Meqenëse ti s'veprove kështu, atëherë ne kemi plotësisht të drejtë të themi se këtë ta ka sugjeruar Ivanovi. Megjithatë, për ne nuk ka rëndësi çështja nëse ia the ti apo ta tha ai që të vejë Enveri në Moskë. Rëndësi ka ajo që gjithë këto

plane antiparti ti i ke bërë në shpinë të Partisë, prandaj duhen dënuar. Unë jam plotësisht dakord me shokët e Byrosë Politike që komunistë të tillë të lëkundshëm, antiparti, që nuk kanë respekt për vijën marksiste-leniniste të Partisë, për qëndrimet revolucionare dhe sakrificat e saj nuk meritojnë të jenë në Parti. Kështu, edhe ti të vësh mend duke qenë jashtë Partisë. Ne të këshillojmë të mos shkosh më thellë nga sa ke shkuar. Partia edhe jashtë saj do të të ndihmojë, se akoma kemi shpresë të ndreqesh. Faktet flasin se rruga jote nuk është e drejtë. Mos harro se edhe Ivanovi e Bepalovi nuk kanë se si të të mbrojnë. Edhe ata e kanë kuptuar se ç'kanë bërë dhe tani e kanë qepur gojën, sepse veprimet e tyre nuk janë marksiste. E kundër kujt i kanë bërë këto veprime? Kundër një partie që e ka dashur me gjithë zemër Bashkimin Sovjetik, popullin e tij të lavdishëm, që ka dëgjuar kurdoherë vërejtjet, kritikën dhe këshillat e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Po ama le të dëgjojnë edhe udhëheqësit sovjetikë një herë kritikën tona të drejtë.

Përpara marksizëm-leninizmit nuk ka të mëdhenj e të vegjël. Marksizëm-leninizmi është busulla që tregon vijën e drejtë të një partie. T'i bësh kritikë të drejtë Hrushovit nuk do të thotë se je antisovjetik, siç na akuzon ti. Dashurinë për Bashkimin Sovjetik ne e kemi treguar vazhdimisht me prova. Në të vërtetë ne themi se ti je antimarksist dhe kundër Bashkimit Sovjetik. Lakrat që ti ke në kokë e provojnë këtë. Pikëpamjet e tua do t'i gjykojë Komiteti Qendror, nga i cili ti ke frikë. Ti kërkove që çështjet të rregullohen në mënyrë social-demokrate. Ti kështu ke gjykuar kurdoherë, t'i bisedosh

çështjet në mënyrë «miqësore». Edhe përkrahjen që ne të kemi dhënë ty, ti e ke gjykuar në mënyrë subjektive, jomarksiste. Përse të kemi përkrahur? Sepse ti je kryetar i Komisionit Qendror të Revizionimit, për të cilin Komiteti Qendror ka respekt të madh, sepse është një organ që e ka zgjedhur Kongresi i Partisë. Kurse ti ke pasur mendimin që si kryetar i Komisionit duhet të kontrolloje çdo gjë dhe vetë t'i shpëtoje kontrollit të Partisë. Po edhe anëtarët e Komisionit Qendror të Revizionimit, kur shkelin rregullat e Partisë, nuk i shpëtojnë dot drejtësisë së saj. Të drejtat që kanë anëtarët e Partisë, ti kujton se i di, por, në qoftë se ti do t'i kishe të qarta, atëherë si kryetar i Komisionit Qendror të Revizionimit nuk do të shkoje me ftesën e Bespallovit në shtëpinë e Novikovit për t'u takuar me ambasadorin sovjetik.

Të më thërresë mua ambasadori nëpërmjet një njeriu tjetër dhe të vete të ha bukë me të te një i tretë unë nuk do të pranoja. Prandaj vajtja jote në këtë mënyrë është shumë misterioze, jashtë rregullave të Partisë dhe jashtë lidhjeve miqësore diplomatike dhe marksiste-leniniste.

Edhe funksionarët e ambasadës sovjetike kanë shumë faj në këto çështje. Ambasadori sovjetik, Ivanov, kërkoi takim me mua dhe unë e prita si gjithnjë. Por, kur më pyeti për çështjen e Plenumit, unë i tregova «kufirin te thana». Ne me atë kemi pasur lidhje shumë të çiltra e miqësore, po ai vetë e prishi këtë situatë. Pas Mbledhjes së Bukureshtit filloi të fliste në mënyrë arrogante. Atëherë u detyruam t'i tregojmë vendin.

Por pse Ivanovi i bëri gjithë këto gjëra, jashtë rre-

gullave miqësore dhe organizative? Zor t'i bëjë gjithë këto nga koka e tij, sidoqoftë qëllimi tij ishte që të përçante udhëheqjen e ta vinte në kontradiktë udhëheqjen e Partisë sonë me Partinë. Atëherë ti, Koço, që je burrë 60 vjeç, ku i ke trutë, në këmbë apo në kokë? Mendon ti përpara se të vesh te Ivanovi? Për të kaluar kohën duke luajtur bilardo ose për të ngrënë darka me miqtë nuk të ndalon njeri, po për qëllime të këqija nuk lejohet. Duhet gjykuar thellë këto çështje sidomos në momentet e tanishme. Veprimet e tua çojnë në rrugë antimarksiste, antiparti.

Botohet për herë të parë me disa shkurtime sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

**PUNA ORGANIZATIVE DUHET TË SHËRBEJE
PËR ZBATIMIN E TË GJITHA DIREKTIVAVE
E VENDIMEVE TË PARTISË NË FUSHËN
POLITIKE, IDEOLOGJIKE DHE EKONOMIKE**

Diskutim në Plenumin XVIII të KQ të PPSH

6 shtator 1960

Sikurse doli nga diskutimet, të gjithë shokët ishin dakord me konkluzionet që ka nxjerrë Byroja Politike në raportin që mbajti në këtë Plenum shoku Rita Marko «Mbi disa çështje të punës organizative të Partisë».

Sikundër e dini dhe siç u theksua në diskutime, çështjet organizative kanë rëndësi të jashtëzakonshme për forcimin e mëtejshëm të Partisë. Natyrisht, çështjet organizative nuk mund të ezaurohen dhe të shtrohen të gjitha në një raport, por në raportin e Byrosë Politike janë shtruar problemet kryesore, duke treguar situatën dhe masat e mëtejshme për forcimin organizativ të Partisë. Rëndësi ka çështja që vetë organizatat-bazë dhe komitetet e Partisë, të udhëhequra nga Komiteti Qendror, duhet të tregojnë shkathtësi dhe inisiativë, të zhvillojnë ato forma pune që jeta e organizatave të

Partisë të bëhet çdo ditë e më shumë luftarake për zbatimin e vijës politike, ekonomike dhe kulturore të Partisë dhe të shtetit tonë.

Është theksuar me të drejtë që në rast se ne do të kemi një Parti të fortë organizativisht, të ngritur politikisht e ideologjikisht, jo vetëm do të realizojmë detyrat që kemi përpara, por do të realizojmë suksese edhe më të mëdha e do të kapërcejmë vështirësitë që hasim.

Është fakt se Partia jonë është shumë e shëndoshë, luftarake, e guximshme e me inisiativë. Këtë e tregojnë rezultatet ekonomike, politike, ideologjike e kulturore.

Siç theksohet në raport, në radhë të parë, ne duhet të kujdesemi vazhdimisht për përbërjen e Partisë. Në raport janë caktuar normat e reja për pranimet në Parti, për të evituar disa situata negative që ishin krijuar nga interpretime kallëp të orientimeve, në parim të drejta, në lidhje me pranimet. Në mjaft organizata-bazë, veçanërisht në ato të kooperativave bujqësore, ka pasur, si të thuash, një qëndrim në vend në pranimet e anëtarëve të rinj, domethënë të ardhjes së gjakut të ri në Partinë tonë.

Orientimi kryesor, të cilit duhet t'i qëndrojmë kurdoherë fort në lidhje me pranimet në Parti, është që shumica e të pranuarve të jenë me prejardhje dhe gjendje shoqërore punëtore. Por orientimet e drejta të Partisë për pranimet në Parti nuk duhet të zbatohen në mënyrë automatike dhe formale, por në bazë të gjykimit të thellë e të shëndoshë të gjendjes, të sukseseve e të nevojave për t'i ndihmuar kështu forcimit të përbërjes së Partisë. Prandaj pranime duhet të bëhen në të gjithë

sektorët, veçanërisht në ato organizata-bazë, ku ndihet nevojë dhe është urgjente të vijë gjak i ri. Po të mba-hemi pas skicave, pa parë gjendjen dhe nevojën e zhvillimit të gjithanshëm të fshatit ose të fabrikës, do të gabojmë. Ne mund të dalim përpara Plenumit të Komitetit Qendror me rezultate të mira, nga pikëpamja e shifrave, në drejtim të përmirësimit të përbërjes së Partisë, por, po t'i futemi thellë çështjes, mund të gjejmë plot të meta në këtë drejtim. Dhe po të ketë gabime, natyrisht, punët nuk do të na ecin mirë.

Më konkretisht. Në Rafinerinë e Naftës në Cërrik, për shembull, organizata-bazë mund të mos ketë nevojë për pranime të reja, por për forcimin e jetës së organizatës, për kalitjen e komunistëve, për ngritjen e tyre të gjithanshme, për ta bërë më luftarake organizatën. Ndryshe mund të paraqitet gjendja në një organizatë partie tjetër. Në disa kooperativa bujqësore po në rrethin e Elbasanit, mund të paraqitet nevoja për një farë kohe për të forcuar punën në drejtim të pranimeve, sepse situata atje paraqitet e dobët dhe organizatat-bazë janë mbyllur në vetvete dhe nuk e çajnë lëvizhjen. Kjo gjë reflektohet në punën jo të shëndoshë që bëhet në atë terren dhe në rezultatet jo të mira në zhvillimin e ekonomisë ose në mbrojtjen e vijës politike, ideologjike dhe kulturore.

Prandaj komitetet e Partisë duhet t'i udhëheqin mirë organizatat-bazë në këtë drejtim dhe, ajo që ka rëndësi, është që të ndiqet me kujdes ky problem. Çështjet organizative të Partisë nuk duhet të kuptohen thjesht. Është e vërtetë se për këtë problem ne kemi sekretarë të veçantë në komitetet e Partisë dhe një

drejtori të veçantë edhe në aparatën e Komitetit Qendror, po ne do të bëjmë gabim në rast se punën për forcimin organizativ të Partisë nuk e matim me rezultatet në fushën ekonomike në prodhim dhe me një ngritje të vazhdueshme të punës politike, ideologjike dhe kulturore të masave punonjëse.

Në raport thuhet se sekretarët e komiteteve të Partisë interesohen shumë për problemet ekonomike dhe mirë bëjnë, por edhe për çështjet organizative të Partisë nuk duhet të interesohet vetëm sekretari i veçantë i ngarkuar me këtë sektor, por të interesohen të gjithë sekretarët. Kur një sekretar ose anëtar byroje i komitetit të Partisë shkon në një ndërmarrje ose në një kooperativë bujqësore dhe konstaton se në fushën e organizimit të prodhimit, të normave, të administratës etj., gjendja nuk është e mirë, atëherë ai duhet të interesohet medoemos për punët organizative të organizatës-bazë të Partisë. Ai duhet të interesohet në një rast të tillë e të shikojë se si është mobilizuar organizata-bazë e Partisë për këto probleme, nëse ajo u futet si një detashment i organizuar problemeve të bujqësisë, të administratës, të shkollës etj. Në këtë mënyrë ai do të nxjerrë konkluzionet përkatëse dhe, kur ka dobësi, do të thotë që edhe puna organizative e Partisë nuk është e mjaftueshme, sepse këto kanë lidhje me njëra-tjetrën.

Kur direktivat e Partisë mbështeten nga një punë organizative e shëndoshë, edhe rezultatet politike dhe ekonomike do të jenë pozitive. Në këtë mënyrë do ta kemi bërë Partinë një detashment pararojë, të aftë që të shikojë dhe të zgjidhë të gjitha problemet që i dalin

përpara. Prandaj të gjitha çështjet organizative të Partisë, duke filluar që nga disiplina, forcimi i ndërgjegjes komuniste, e deri në ruajtjen e konspiracionit dhe në çështjen e madhe të forcimit të unitetit të Partisë, duhet të reflektohen në luftën e përditshme që bën Partia, ndryshe nuk kemi bërë një punë të shëndoshë organizative.

Një çështje tjetër, që doja të theksoja, është çështja e formave të reja që kemi adoptuar për drejtimin e zonave. Këtu ne kemi pasur suksese dhe është vërtetuar në jetë se këto forma japin rezultate të mira, pasi shokët drejtues lidhen më mirë me bazën. Por komitetet e Partisë, sekretarët dhe byroja duhet të ndihmojnë më nga afër, më shumë dhe në mënyrë më të organizuar instruktorët e zonave.

Sekretarët e komitetit të Partisë që janë caktuar në zona, të mos e humbasin ndjenjën e përgjegjësisë kolektive, të drejtimin kolektiv të Partisë dhe të pushtetit. Ata duhet të kuptojnë se janë përgjegjës përpara Partisë për mbarëvajtjen e jetës në të gjithë rrethin dhe në mënyrë të veçantë janë përgjegjës përpara komitetit të Partisë për zonën e tyre. Në këtë drejtim vërehen mjaft të meta, prandaj këtu duhet të grumbullojmë eksperiencën dhe të bëjmë kritikën e punës. Këtu duhet të merren jo direktiva të përgjithshme, por çdo sekretar duhet të mbajë afër instruktorët e vet dhe sekretarët e organizatave-bazë për t'i ndihmuar që t'i zbatojnë si duhet këto direktiva. Prandaj në këtë drejtim njerëzit duhet të aktivizohen më mirë nga byroja, nga sekretarët dhe nga sekretari i parë i komitetit të Partisë, që ka përgjegjësinë më të madhe,

dhe të ndihmojnë që këto çështje të mos harrohen kurrë.

Një punë e organizuar do të lehtësonte edhe instruktorët e zonave që kanë nën vartësinë e tyre disa organizata-bazë. Instruktori duhet të dijë që t'u japë sekretarëve të organizatave-bazë në një mbledhje të organizuar, jo të zgjatur, problemet që preokupojnë komitetin e Partisë në atë zonë. Prandaj sekretari i komitetit të Partisë duhet ta mësojë dhe ta udhëzojë mirë instruktorin në mënyrë që ky, kur të mbledhë sekretarët e organizatave-bazë të zonës së tij, t'ua bëjë të qartë situatën që është krijuar dhe si të punojnë konkretisht për zgjidhjen e problemeve në rrugë të drejtë, mirë dhe sa më shpejt. Prandaj instruktori, duke vazhduar të mbajë lidhje të rregullta me bazën, të shkojë jo në të gjitha organizatat-bazë për këto çështje, por në ato që ai e shikon të nevojshme dhe mendon se pa nxitje ose pa ndihmën e tij këto nuk do të zbatohen si duhet. Në këtë mënyrë do t'u lihet edhe inisiativë sekretarëve të organizatave-bazë.

Këta, pra, duke u udhëhequr mirë, do t'i zbatojnë si duhet detyrat dhe instruktorët ose sekretarët e komitetit të Partisë do të mendojnë se ku duhet dhënë ndihma, ku duhet të peshojë më shumë puna e tyre.

Pra, punët të mos bëhen në mënyrë mekanike. Edhe çështja që ngriti një shok se dërgohen çdo vit nga qendra 35-40 vendime, do të zgjidhet drejt nëse punohet si duhet. Në rast se këto vendime nuk i asimilon në radhë të parë vetë komiteti i Partisë, byroja, punët nuk do të shkojnë mirë as në organizatën-bazë, pra

nuk do të kemi rezultate. Nëse këto vendime studjohen me kujdes, mendoj se jemi dakord që mund të lejohet që sekretari, në vend që t'i lexojë në mbledhje të gjitha vendimet e Komitetit Qendror, të thotë përmbajtjen kryesore të tyre lidhur kjo edhe me gjendjen e rrethit apo të zonës. Organizatat-bazë duhet të vihen në dijeni me doemos për udhëzimet që lëshon Komiteti Qendror, por në rast se punohet në mënyrë formale me këto vendime, në rast se ato lexohen në mënyrë mekanike nuk është mirë. Anëtarët e Partisë nuk mërzhiten të marrin udhëzimet e Komitetit Qendror, prandaj shokët drejtues në rrethe duhet t'i luftojnë metodat shabllone ose ato metoda që jeta ka vërtetuar se nuk japin rezultate.

Komiteti Qendror nuk mund të kritikojë një shok drejtues, një sekretar partie në rast se ai e përvetëson si duhet një direktivë të Komitetit Qendror dhe e çon atë mirë poshtë në ato forma që ai mendon se janë të përshtatshme. Ka organizata-bazë me nivel të ngritur ideopolitik e kulturor, ka nga ato që janë me nivel mesatar, prandaj në rast se një vendim i Komitetit Qendror shtrohet në atë mënyrë që mendohet si e përshtatshme për një organizatë të caktuar, kjo nuk duhet të konsiderohet si një shkelje e direktivës, por si gjetja e një forme të mirë për dhënien e direktivës së Komitetit Qendror.

Besoj se Plenumi është dakord me mendimin që drejtoritë e Komitetit Qendror vendimet që i dërgojnë bazës, t'i shkurtrojnë në një shkallë të madhe dhe, për ato që do t'i dërgohen bazës, të mos jemi shumë të ngurtë në format që kemi caktuar.

Por edhe format e reja të punës duhet përsëri të vërtetohen në jetë. Çështja e komisioneve që u ngrit këtu nga diskutantët, duhet t'i shërbejë byrosë dhe komitetit të Partisë për t'i ndihmuar në zgjidhjen e disa problemeve, por jo të gjitha punët të bëhen me komisione e të jenë permanente. Një komision ngarkohet të studjojë, fjala vjen, gjendjen e fabrikës së çimentos ose gjendjen e ullinjve që nuk prodhojnë çdo vit në mënyrë ritmike; në krye të tij vihet një shok, nën kujdesin e të cilit komisioni studjon çështjen dhe propozon masat konkrete që duhen marrë për përmirësimin e gjendjes, dhe ia njofton ato komitetit të Partisë. Me kaq të konsiderohet e përfunduar puna e komisionit. Ndryshe, pa dashje, komisionet permanente mund të na çojnë në fakt deri në zëvendësimin e punës, të kompetencave e të përgjegjësiave të byrosë dhe të komitetit të Partisë. Kjo mund të ndodhë se, duke ngarkuar komisione permanente, byroja mund ta flejë mendjen duke menduar se ka komisionin që e ndjek çështjen dhe tërë përgjegjësinë ia hedh atij. Është e vërtetë se në jetë duhen zbatuar forma të atilla organizimi të punës që japin rezultate, por ato të mos bëhen forma pune të përherëshme dhe të përgjithësohen. Prandaj në këtë drejtim duhet ecur me kujdes.

Me shumë kujdes duhet ndjekur edhe problemi i bashkimit të kooperativave bujqësore, forcimi organizativ në bazë brigade etj. Këto jo vetëm të forcohen nga ana organizative, por të mos harrohet as çështja e jetës morale, politike dhe kulturore në fshat. Këtë e them se në brigadat tona gjendja nuk është e tillë që ato të bëjnë edhe prashitjen, edhe çekankën e pambukut e

shërbimet e tjera, pastaj edhe punën kulturore e arsimore. Këto të fundit duhet të bëhen për kushtet tona në qendër të kooperativës.

Prandaj, po të mos kujdesemi ne, Partia në bazë, këto punë nuk kryhen. Punën kryesore organizata e Partisë e ka sigurisht në brigadë, por ka edhe punë politike e shoqërore që duhet bërë në fshat. Në rast se kjo nuk do të bëhet, atëherë do të kemi një dobësim të punës në organizatën-bazë. Prandaj në këtë drejtim ne duhet të bëjmë kujdes në shfrytëzimin e formave që zbatojmë.

Çështja tjetër që doja të ngrija, është ajo e disiplinës së punës dhe e disiplinës së ndërgjegjshme të Partisë. Në Partinë tonë, sikurse u tha në raport, ka disiplinë dhe disiplinë të mirë, por këtë duhet ta forcojmë akoma më shumë, ashtu sikurse duhet të luftojmë për ngritjen politike dhe ideologjike të Partisë.

Partia lufton për realizimin e detyrave të saj të përditshme, mëson dhe ecën përpara. Por në këtë drejtim hasen vështirësi dhe pengesa qoftë nga puna armiqësore që bëjnë kulakët ose armiqtë e tjerë të hapur apo të fshehtë, qoftë nga dembellëku, prapambetja, zakonet e këqija, të cilat shumë herë pengojnë punën që të ecë përpara dhe të kemi rezultatet që dëshirojmë. Natyrisht, kur anëtarët e Partisë janë të armatosur me teorinë marksiste-leniniste (dhe në këtë drejtim bëhen përpjekje e nuk jemi si përpara, se tani kemi mjaft shokë të ngritur, jo vetëm në qytete, po dhe në fshatra, me shkollë 7-vjeçare e të mesme), atëherë dinë edhe të punojnë më mirë dhe të mbrojnë më mirë vijën e Partisë. Të mësojmë edhe nga librat, por të mësojmë edhe

nga jeta, nga lufta e përditshme, se ka edhe njerëz që mbarojnë shkollën e bëjnë edhe gabime politike e ideologjike dhe gabimet në këto raste janë shumë të rrezikshme. Kurse më pak gabojnë ata që luftojnë me vësh-tirësitë, me pengesat dhe me armikun.

Është fakt se në momentet kritike e të vështira që ka kaluar Partia jonë, nuk kemi parë anëtar partie në bazë që të dalë në kundërshtim me marksizëm-leninizimin, me vijën e drejtë të Partisë sonë. Këto kundërshti-me kanë dalë nga ata njerëz që e quajnë veten të ngritur ose të vjetër në Parti, nga ata njerëz që i ka mbuluar megalomania dhe ambicia. Neve nuk na lejohet në asnjë mënyrë të lëmë pas dore edukimin marksist-leninist dhe kulturor në fshat.

Një punë e kujdesshme duhet të bëhet për eduki-min e anëtarëve të Partisë, për shpjegimin, ashtu siç na mëson Komiteti Qendror, pa frikë dhe pa druajtje, të ngjarjeve që ndodhin në lëmin ndërkombëtar ose për çështjet e brendshme të Partisë. Këto t'u shpjegohen anëtarëve të Partisë jo vetëm teorikisht, por edhe prak-tikisht me shembuj të qartë, të thjeshtë, që ta kuptojnë ku qëndron çështja. Atëherë ne do ta kemi Partinë kështu si e kemi, luftëtare, trime për mbrojtjen e mar-ksizmit dhe të vijës së Komitetit Qendror të Partisë kundër çdo rreziku. Prandaj, të mos lihet pas dore edukimi i anëtarëve të Partisë me ngjarjet e kohës dhe me luftën që bëjmë dhe do të bëjmë ne me armikun e hapur ose të fshehtë, politik dhe ideologjik.

Krahas kësaj edhe ngritja teorike e komunistëve me anë kursesh dhe shkollash është një ndihmë kolosale për Partinë që e ndihmon të luftojë me sukses në prak-

tikë kundër dobësive dhe punës armiqësore që mund të bëhet kundër saj.

Çështjet që u shtruan në Plenumin e muajit të kaluar, janë me rëndësi të jashtëzakonshme dhe askush të mos mendojë se nuk do të kemi vështirësi. Ne vështirësi do të kemi, sepse ata që kalojnë me ndërgjegje në rrugë të gabuar, antimarksiste është e zorshme, në mos e pamundur, që të bëjnë kthesë. Prandaj, përpara këtyre situatave Partia jonë, jo vetëm duhet të jetë e mobilizuar, por ta çelikosë akoma më shumë unitetin e saj rreth Komitetit Qendror dhe të mbrojë me të gjitha forcat e saj marksizëm-leninizmin.

Elementët armiq të maskuar do të përpiqen ta çajnë këtë unitet. Prandaj nëpër organizatat-bazë t'i vihet shumë kujdes luftës kundër grindjeve e tarafeve e të konsiderohen ato si çështje politike. Po s'u veprua në këtë mënyrë, armiqtë e pushtetit dhe të Partisë sonë do t'i shfrytëzojnë ato, për të na krijuar shqetësime politike ose ideologjike në Parti. Prandaj t'i dalim punës që në fillim dhe t'i evitojmë me kohë këto shfaqje të huaja, në mënyrë që shokë të mirë të mos i marrë armiku.

Uniteti nuk mund të realizohet me dekrete. Me unanimitet të plotë e priti Partia jonë qëndrimin e Komitetit Qendror ndaj ngjarjeve të Bukureshtit dhe askush nuk e detyroi për këtë. Partia jonë është e pjekur dhe e kupton ç'është e drejtë dhe çfarë nuk është e drejtë. Ka parti më të vjetra, por që bëjnë gabime dhe sipas mendimit tonë udhëheqja e Partisë Komuniste e Bashkimit Sovjetik po bën gabime. Përse të na çuditë një gjë e tillë? Ne kemi pasë krijuar një ide

të drejtë që PK e BS, nën udhëheqjen e Stalinit, i likuidoi deviatorët, trockistët, buharinistët, menshevikët. Kjo është e drejtë, por tani atje po shfaqen gabime dhe këto nuk po i shohim vetëm ne. Derisa udhëheqja sovjetike i çoi mosmarrëveshjet që kishte me një parti tjetër motër në rrugë ilegale në platformën e komunizmit ndërkombëtar, atëherë kjo çështje duhet diskutuar në mënyrë bolshevike, jo prapa krahëve. Çdo parti në këto ngjarje duhet të marrë përgjegjësi, të dëgjojë opinionin e njërës palë dhe të palës tjetër dhe pastaj, pasi të njohë situatën, të thotë mendimin e vet plotësisht e bindur. Ne nuk jemi dakord që të bëhen prapa krahëve veprime si ato që bën Hrushovi me shokë.

Të thuash se Kina është për luftë, siç thotë udhëheqja e sotme sovjetike, dhe ta shtrosh këtë në organizata-bazë në mënyrë tendencioze, kjo është monstruoze. Si është e mundur që Kina e madhe aq shumë e vuajtur dhe e udhëhequr nga një Parti marksiste-leniniste dhe Mao Ce Duni, të jetë për luftë? Nëse lejojmë që çështjet të shtrohen në këtë mënyrë, mendojmë se kështu bëhet një krim i madh jo vetëm ndaj Kinës, por ndaj gjithë lëvizjes punëtore, komuniste e nacionalçlirimtare.

Si rezultat i qëndrimit parimor të Partisë sonë, shokët tanë që venë tani në BS, megjithëse të ftuar, priten jashtëzakonisht ftohtë nga kuadrot e aparateve të qendrës, kurse takimet me njerëzit e thjeshtë e me kuadro të bazës, që nuk kanë marrë vesh akoma se ç'ka ngjarë, janë të prekshme, tregojnë një dashuri të zjarrtë për vendin tonë si dhe më parë.

Qëndrim marksist është ky që mban udhëheqja so-

vjetike, me Hrushovin në krye? Nuk ka të drejtë Partia jonë të thotë një mendim të saj që mosmarrëveshjet që kanë lindur në mes PK të BS e PK të Kinës të gjykohen në mbledhje të rregullta partish? Po, ka plotësisht të drejtë. Po të fillosh nga masat në parti dhe të krijosh situata të padrejta ndaj një partie marksiste-leniniste, kjo tregon se qëndrimi i udhëheqësve sovjetikë nuk është marksist. Nuk është aspak marksist qëndrimi i tyre edhe për faktin se në këtë thatësi të madhe nuk i janë përgjigjur kërkesës sonë për drithë, të bërë një muaj e gjysmë përpara. Ky është qëndrim antimarksist. Në qoftë se ke guxim na thuaj që nuk kam bukë, atëherë dimë edhe ne si të veprojmë, se ne nuk do të mbetemi pa bukë.

Në këtë Plenum ne do të shtrojmë edhe disa qëndrime të Liri Belishovës dhe të Koço Tashkos, që janë mjaft të rrezikshme. Partia do të marrë dijeni për këto. Këtu ka ndërhyrë edhe veprimtaria prej sabotatori dhe diversionisti e ambasadorit dhe e funksionarëve të ambasadës sovjetike. Prandaj ne, në rrugë marksiste-leniniste, i kemi drejtuar një letër KQ të PK të BS, ku theksojmë se miqësia duhet të jetë në rrugë marksiste.

Të gjithë ne duhet ta kalitim unitetin në Parti dhe ndaj atij që cenon këtë unitet, duhet të jemi të pamëshirshëm, veçanërisht tani që janë krijuar situata jo të mira e të vështira. Këto situata nuk janë krijuar nga ne, por do t'i përballojmë.

Ne jemi të sigurtë se do të fitojmë, derisa jemi në rrugë të drejtë marksiste-leniniste, se nuk gabojmë në këtë çështje, prandaj edhe e aprovon Partia qëndrimin tonë, ndryshe nuk do ta aprovonte. Partia jonë aprovon

plotësisht, si i ka hije, qëndrimin e drejtë marksist-leninist të Komitetit Qendror. Kjo tregon pjekurinë e saj.

Partia nuk di akoma shumë gjëra, sepse tani për tani nuk duhen thënë të gjitha; po t'i thoshim edhe ato që akoma nuk dihen, sa shumë do të forcohej uniteti i popullit rreth Partisë e Komitetit Qendror; po ne jemi marksistë dhe kemi shpresë se çështjet do të ndreqen duke qëndruar e duke luftuar në rrugë marksiste-leniniste.

Aprovimi i qëndrimit tonë nga e gjithë Partia tregon forcën dhe unitetin e Partisë sonë rreth Komitetit Qendror dhe unitetin e Partisë me popullin, të cilin duhet ta ruajmë si sytë e ballit.

Prandaj të gjitha format e punës: udhëzimet, këshillat, eksperiencia e përditshme e punës organizative, politike dhe ideologjike, duhet të shërbejnë për kalitjen e komunistëve dhe për kryerjen e detyrave. Thashë se do të na dalin vështirësi, prandaj duhet të mobilizojmë Partinë, popullin, gjithë patriotët për rrealizimin e planeve dhe të detyrave që na vihen përpara.

Ne duhet të shkojmë në Kongresin e Partisë me plan të realizuar dhe të tejkaluar. Të kemi parasysh gjithë këtë thatësi të madhe që nuk na ka ndodhur kurrë si sivjet dhe që është në dëmin tonë. Kemi 3 vjet që nuk po na qesh buza në bujqësi dhe nuk mund të themi se Partia dhe populli nuk kanë punuar dhe nuk kanë luftuar. Jo, këtë nuk mund ta themi. Të meta e gabime ne kemi në punën tonë, po kemi pasur edhe vështirësi të mëdha objektive që ishte e pamundur të kapërceheshin.

Prandaj në këtë drejtim edhe një kokërr gruri, misri, ulliri etj. t'i ruajmë, t'i grumbullojmë me kujdes dhe t'i ekonomizojmë, grurin e misrin në radhë të parë. Të bëhen të gjitha përpjekjet që të grumbullohet gruri dhe misri që u bë, sepse Partinë e kemi të fortë dhe popullin patriot. Mirëpo një thatësi si kjo e këtij viti e nxit fshatarin ta mbajë drithin brenda dhe të shkojë në qytet të blejë bukë ose, po të jetë larg, të kërkojë të furnizohet me drithë.

Kur të vijë koha e grumbullimit të tepricave, juve nuk ju lejohet të mos bëni një punë aktive për t'u blerë misrin e tepërt fshatarëve dhe për t'i sqaruar e për t'i bindur ata që ta çojnë misrin e tepërt në depot e shtetit.

Sivjet ne i kemi dhënë drithë fshatarësisë gati sa sasia e importit të një viti të rregullt. Prandaj, duke marrë parasysh situatat dhe thatësinë e madhe, Partisë nuk i lejohet të bëjë lëshime në lidhje me grumbullimet e detyrueshme dhe të tepricave. Nuk duhet të pranohet pikëpamja e disa drejtuesve, që na bombardojnë për t'u dhënë grurë se u kërkojnë fshatarët dhe kjo justifikohet me situatën politike. Situata politike nuk dobësohet pse u jepet fshatarëve ndonjë kilogram më pak në muaj. Fshatarësia jonë është patriotike, e lidhur ngushtë me Partinë dhe e kupton se gjithë kjo thatësi nuk lejon më shumë. Shteti po e furnizon atë, po kush do t'ia krijojë këto rezerva të mëdha në një kohë kur rezervat e krijuara mbaruan dhe tani po përpiqemi të sjellim drithë nga jashtë dhe do të sjellim. Miqtë për këtë janë angazhuar, pavarësisht se Bashkimi Sovjetik nuk na ka dhënë përgjigje akoma.

Sidoqoftë drithin e importuar e sjellim nga larg, prandaj duhet ta ekonomizojmë atë. Po si ta ekonomizojmë? Ja, për shembull, ka fshatra rreth qyteteve që kanë prodhuar bukë sa për të jetuar, të paktën derisa të dalë misri i ri. Këtë e konstatova në Korçë. Kur bisedova me disa fshatarë, ata më thanë se kishin në shtëpi kush më pak e kush më shumë se një kuintal e gjysmë grurë, e megjithatë, blenin bukë në furrë. Kjo ndodh se Partia nuk e shtrëngon çështjen t'i thotë atij që ka: «ha këtë një herë e pastaj shohim». Nga kjo ka njerëz që e mbajnë drithin në hambarë dhe blejnë bukë të gatshme, duke përdorur, në disa raste, edhe rrugë të shtrembra.

Shokët e rretheve duhet të heqin dorë nga mendimi që të kërkojnë kur të duan e sa të duan bukë nga qendra, se bukë ne nuk kemi. Fshatarët të luftojnë me të gjitha forcat për ta siguruar bukën vetë, ose në fshat ta ndajnë drithin me njëri-tjetrin dhe fshatarët e bëjnë këtë gjë.

Pra lidhur me këtë problem të rëndësishëm të luftohet për sigurimin e bukës dhe të grumbullimit të prodhimeve të tjera. Partia të kuptojë se këto deficite të mëdha në bukë na i shkaktoi thatësira, po duhet të mobilizohet që të realizohen planet e prodhimeve të tjera. Populli të punojë që asnjë fije pambuk të mos vejë dëm, pra të mos na krijohen deficite edhe për pambukun që të detyrohemi pastaj të importojmë edhe pambuk.

Neve na duhet të rishikojmë gjendjen e bukës për vitin tjetër dhe nuk është pak sasia që duhet të importojmë. Prandaj duhet menduar se nga dalin gjithë këto

fonde, se na duhet të shpenzojmë devizë që është rezervuar për të tjera gjëra, ndërsa thatësira na detyron t'ia kushtojmë bukës.

Për këtë problem të rëndësishëm ne duhet të mendojmë që tani për punimet dhe për mbjelljet e vjeshtës, të mobilizohet Partia, SMT-të, fshatarësia, i gjithë populli dhe të lërohen tokat në mënyrë sa më të përsosur që të mundim vitin e ardhshëm të mbulojmë deficitet e rënda të këtij viti.

Prandaj duhet një mobilizim i madh i Partisë në të gjitha drejtimet: ekonomike, politike, ideologjike dhe në ruajtjen e unitetit të shëndoshë të Partisë.

Mbledhja e këtij Plenumi do t'i shërbejë jashtëzakonisht Partisë që të kalitet akoma më shumë dhe t'i kryejë akoma më mirë detyrat. Ne mendojmë të mos dalë vendim për këtë çështje, por i propozojmë Plenumit të aprovojë raportin, pastaj në kuadrin e përgatitjeve për konferencat e Partisë të rretheve, të organizohen plenumë të zgjeruara. Në këto plenumë, duke u bazuar në raportin e Byrosë Politike, të shtrohen problemet e rrethit, ku të trajtohen edhe çështjet organizative në frymën e raportit të Komitetit Qendror. Në konferenca do të ketë edhe të deleguar të Komitetit Qendror, të cilët në diskutimet e tyre do të flasin dhe do ta orientojnë organizatën në frymën e raportit të Byrosë Politike. Kështu mendojmë ne të punohet për këtë çështje. Kur do të fillohet kjo punë, do t'ju njoftojnë më vonë shokët.

Jeni dakord që raporti i Byrosë Politike, i cili u diskutua këtu, të shërbejë si bazë për forcimin e mëtejshëm të punës organizative të Partisë?

Plenumi i Komitetit Qendror aprovon njëzëri raportin e Byrosë Politike «Mbi disa çështje të punës organizative të Partisë».

Botohet për herë të parë me ndonjë shkurtim sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Plenumit XVIII të KQ të PPSH që gjendet në AQP

**NE DO TË SHKOJME NË MOSKË JO ME DHJETË
FLAMURË, POR VETËM ME NJË, ME FLAMURIN
E MARKSIZËM-LENINIZMIT**

*Fjala në Plenumin XVIII të KQ të PPSH lidhur me
gabimet e rënda në vijë të Liri Belishovës*

6 shtator 1960

Përpara se të flasim për Liri Belishovën do të informoj Plenumin për disa vendime që ka marrë Byroja Politike.

Javët e fundit kemi zhvilluar korrespondencë me Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Ne jemi vënë në dijeni nga komitetet qendrore të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të Bullgarisë, të Rumanisë dhe të Çekosllovakisë për një letër që secili prej tyre i ka drejtuar Partisë Komuniste të Kinës. Këto letra në esencë e akuzojnë rëndë Partinë Komuniste të Kinës për deviacion nga marksizëm-leninizmi, për dogmatizëm, për sektarizëm dhe shovinizëm të një shteti të madh dhe akuza të tjera si këto. Në këto letra mbrohet njëkohësisht N. S. Hrushovi nga ato që thuhet në

një material që u kishte shpërndarë përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore të kampit të socializmit delegacioni i PK të Kinës në fund të Mbledhjes së Bukureshtit.

Në materialin e shokëve kinezë thuhej, përveç të tjerave, se Mbledhja e Bukureshtit u bë në forma jo të rregullta, se ndërhyrjet dhe veprimet e N. S. Hrushovit gjatë mbledhjes nuk ishin marksiste-leniniste dhe se këto çështje që ngrihen kanë një rëndësi të madhe për zhvillimin e mëtejshëm të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Më vonë ne morëm një letër nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ku, pasi pohohet se lidhjet në mes dy partive tona kanë qenë jashtëzakonisht të ngushta, thuhet se në Mbledhjen e Bukureshtit lindi në mes partive tona një «shkëndijë keqkuptimi», e cila nuk duhet të marrë zjarr. Prandaj na propozohet të bëhej një mbledhje e çfarëdo niveli që do të donim dhe kur të donim ne, për t'i diskutuar së bashku këto keqkuptime, me qëllim që në mbledhjen e ardhshme të nëntorit në Moskë, «Partia e Punës e Shqipërisë dhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik të shkojnë me një unitet të plotë mendimesh».

Ne i kemi drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik tri letra. Në letrën e parë i kemi vënë në dukje, në mënyrë shoqërore, veprimtarinë diversioniste, sabotuese, të ambasadorit sovjetik V. I. Ivanov, të këshilltarit Novikov dhe të sekretarit të parë Besspallov kundër Partisë sonë dhe udhëheqjes së saj. Të tre këta funksionarë të lartë të ambasadës sovjetike në Tiranë, pas Mbledhjes së

Bukureshtit, kanë zhvilluar jashtë çdo rregulli miqësie dhe partie një punë armiqësore kundër Partisë dhe udhëheqjes sonë. Qëllimi i tyre ka qenë të përçajjnë udhëheqjen. Për këtë qëllim ata u përpoqën dhe përdorën të gjitha format e metodat për një pjesë të të cilave ju jeni në dijeni. Ata u përpoqën të gjenin një të çarë në udhëheqjen e Partisë sonë dhe të mësonin në radhë të parë ç'u diskutua në Plenumin e muajit korrik, ç'qëndrime u mbajtën dhe po të ishte e mundur të mësonin çfarë kishte thënë secili diskutant.

Ne kemi qenë jashtëzakonisht të durueshëm ndaj këtyre veprimeve në këtë situatë, sepse udhëhiqeshim nga parimi i ruajtjes së miqësisë me popujt e Bashkimit Sovjetik. Por Partia dhe njerëzit tanë kanë qenë jashtëzakonisht vigjilentë ndaj këtyre veprimeve që nuk bien erë marksiste dhe miqësore. Është fakt që gjithë shokët tanë, të cilët ata i kanë provokuar, kanë qëndruar shumë mirë dhe u kanë dhënë përgjigjen e merituar. U ndodh vetëm Koço Tashkoja, te i cili arritën të kenë sukses dhe ta zbërthejnë në mënyrë shumë të poshtër, sikundër do ta shohim. Vetëm ai u ka folur për gjithçka u diskutua në Plenumin e KQ të PPSH të muajit korrik.

Duke parë se ata e mbushën kupën, Byroja Politike i drejtoi Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik letrën e parë ku vihet në dukje kjo veprimtari dhe theksohet se këto janë veprime jomiqësore, antimarksiste që i bëhen Partisë sonë dhe i kërkuam Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të merrte masa për hir të miqësisë dhe të bashkëpunimit të sigurtë midis dy vendeve dhe partive

tona që të mos bëhen më veprime si këto. Pas kësaj letre Ivanovin e thirrën në Moskë. Do të kthehet ai ose jo, këtë ne nuk e dimë.

Ne duam të jemi miq të sinqertë me ambasadorin dhe me gjithë njerëzit sovjetikë, brenda caqeve të miqësisë dhe të normave marksiste-leniniste. Funkcionarët e tjerë të ambasadës sovjetike ndodhen këtu dhe konstatojmë se edhe ata bëjnë veprime të palejueshme.

Letrën e dytë që ia drejtuam Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ia kemi drejtuar njëkohësisht edhe Partisë Komuniste të Kinës. Pas Mbledhjes së Bukureshtit, sidomos në letrat që udhëheqjet e partive komuniste të Bashkimit Sovjetik, të Çekosllovakisë, të Bullgarisë dhe të Rumanisë i drejtojnë KQ të Partisë Komuniste të Kinës, thuhet se të gjitha partitë komuniste dhe punëtorë paskan qenë plotësisht solidare në Mbledhjen e Bukureshtit në qëndrimin ndaj PK të Kinës, gjë që nuk është e vërtetë. Prandaj në këtë letër ne i vëmë pikat mbi i-të. Ne shfaqim mendimin tonë për qëndrimin që mbajtëm në Bukuresht dhe themi se përsa u përket gabimeve të pretenduara për PK të Kinës, Partia jonë nuk ka qenë solidare në Mbledhjen e Bukureshtit.

Në letër ne shfaqim pikëpamjen se nuk mund të dënohet me shpejtësi, në këto forma dhe mënyra siç u veprua në Bukuresht, një parti e madhe revolucionare sikurse është Partia Komuniste e Kinës. Edhe për një komunist të thjeshtë që ka bërë faj të rëndë nuk mund të procedohet ashtu, po vetëm në bazë të rregullave organizative leniniste dhe në këtë rast, pasi bëhen të

gjitha përpjekjet për ta shpëtuar, atëherë merret vendimi përfundimtar. Prandaj ne nuk e kemi gjetur me vend të akuzohet në mënyrë të padrejtë një parti e madhe revolucionare dhe të dënohet jashtë rregullave organizative, sidomos nga udhëheqjet e atyre partive që i kanë drejtuar Partisë Komuniste të Kinës ato letra.

Në letër shprehet ideja se këto probleme, që u bënë të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, u interesojnë të gjitha partive ashtu sikundër edhe Partisë sonë. Prandaj mendimin tonë mbi këto çështje ne do ta themi në mbledhjen që është vendosur të bëhet në nëntor, do ta themi mendimin tonë në mënyrë revolucionare dhe në rrugë marksiste-leniniste. Kontradiktat që kanë lindur përbëjnë një çështje shumë të madhe për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, prandaj, para se të shkojmë në Mbledhjen e Moskës, pasi të kemi marrë materialin e nevojshëm dhe ta studjojmë, do t'ia shtrojmë Plenumit të Komitetit Qendror për diskutim e vendim dhe pikëpamjen e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë sonë ne do ta shtrojmë në atë mbledhje. Kjo, mendojmë ne, është rruga marksiste-leniniste për zgjidhjen e një çështjeje me karakter ndërkombëtar. Tjetër rrugë mendojmë se nuk ka dhe nuk do të ishte e drejtë të ndiqej.

Një çështje tjetër, që parashtrojmë në letrat tona drejtuar partive komuniste të Bashkimit Sovjetik e të Kinës dhe që ka rëndësi, është se problemet që kanë lindur, që janë zhvilluar dhe që kanë marrë një karakter shumë serioz, jo vetëm duhen zgjidhur, së pari, në mes dy partive, po ne mendojmë dhe propozojmë se, sa nuk është vonë, të dyja partitë e mëdha, Partia Komuniste e

Bashkimit Sovjetik dhe Partia Komuniste e Kinës të bëjnë një takim në nivel të lartë përpara mbledhjes së komisionit që do të mbahet në fund të shtatorit, për të diskutuar çështjet kryesore që janë bërë objekt i mosmarrëveshjeve të tyre. Në letër ne themi se kjo do të ishte një ndihmë e madhe për punimet e komisionit, ose për mbledhjen plenare të Moskës. Këtë propozim ne e bëjmë duke u nisur nga interesat e komunizmit ndërkombëtar. Tani ne jemi informuar se ideja jonë ka qenë e arsyeshme dhe mbledhja me përfaqësuesit e të dyja partive do të bëhet rreth datës 15-17 shtator, por se në çfarë niveli këtë nuk e dimë.

Letra e tretë ka të bëjë me propozimin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për takim me përfaqësuesit e Partisë sonë. Ne u përgjigjemi në letër se është e drejtë që, kur lindin mosmarrëveshje në mes dy partive, çështjet duhet të diskutohen dhe të shohiten sa të jetë e mundur më drejt, në rrugën marksiste-leniniste. Por mosmarrëveshje midis dy partive tona nuk ka, se këto mosmarrëveshje ekzistojnë midis tyre dhe një partie tjetër. Prandaj të shkojmë ne në Moskë dhe të bisedojmë për «gabimet» e një partie tjetër, pa qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e saj, nuk është aspak marksiste dhe ne nuk mund të bëjmë një gjë të tillë. Një mënyrë e tillë pune nuk ndihmon për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që ekzistojnë, përkundrazi një punë e tillë mund ta vështirësojë më shumë gjendjen. Me një fjalë, u themi që ne nuk bisedojmë prapa krahëve.

Përsa i përket asaj që thonë udhëheqësit sovjetikë se ka lindur një «shkëndijë keqkuptimi» midis dy par-

tive tona, ne u jemi përgjigjur se Partia jonë as shkëndijë, as zjarr nuk ka ndezur.

Këto tri letra, pra, ia ka drejtuar Byroja Politike Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Për përgatitjen më të mirë të Plenumit në lidhje me çështjet që do të diskutojmë, unë rekomandoj që të gjithë anëtarëve dhe kandidatëve të Komitetit Qendror t'u vihen në dispozicion artikujt kinezë «Rroftë leninizmi», materiali që shpërndanë sovjetikët në Mbledhjen e Bukureshtit, Deklarata e Moskës e vitit 1957, kopjet e letrave që i kemi drejtuar ne tani së fundi KQ të PK të BS, për të cilat fola më lart, si dhe materialet që janë rekomanduar e s'janë lexuar akoma. Të gjitha këto të studjohen me kujdes në mënyrë që, kur të diskutojmë në Plenum, shokët të jenë të përgatitur. Po të kemi materiale të tjera nga Partia Komuniste e Kinës për pikëpamjet e saj, edhe këto do t'ju vihen në dispozicion për studim.

Të vijmë tani konkretisht te çështja e Liri Belishovës.

Ju e dini se në Plenumin e korrikut, përveç të tjerave, Liria u kritikua për gabimet e mëdha serioze që bëri gjatë qëndrimit të saj në Kinë dhe në Bashkimin Sovjetik. Por në atë mbledhje të Plenumit këto gabime u prekën shkarazi në mes diskutimesh. Mirëpo Liria, pasi u ngritën këto çështje për të cilat diskutuan disa shokë, nuk doli përpara Plenumit me autokritikë, megjithëse e dinte që Byroja Politike kishte arritur në konkluzionin se autokritika e saj para Byrosë nuk ishte e plotë, kishte shumë boshllëqe. Pikërisht për këto arsye

thashë në Plenum që çështja e saj, pasi të rishqyrtohej edhe një herë në Byronë Politike, t'i paraqitej Plenumit. Në fakt ne çështjen e Lirisë e shqyrtuam¹.

Ne i dhamë asaj mundësinë të reflektonte thellë, të mendonte mbi gabimet e rënda që ka kryer në situata kaq të komplikuar e të vështira dhe të dilte me konkluzione të drejta, të zbulonte shkaqet që e shtynë t'i bënte këto gabime.

Në mbledhjen e Byrosë Politike ajo manifestoi disa shenja nervozizmi në lidhje me pyetjet që i bënë shokët, të cilat shërbyen për të zbuluar dhe për të sqaruar më tej lëkundjen e Lirisë në vijën politike dhe ideologjike të Partisë sonë. Më vonë e thirra edhe unë, veçanërisht, për ta ndihmuar që të reflektonte mbi këto çështje, bile dhe i kujtova metodat jomarksiste që kanë përdorur udhëheqësit sovjetikë për përçarjen e udhëheqjeve të disa partive komuniste dhe punëtorë, prandaj e këshillova të reflektonte mbi këto çështje.

Dua të them se Byroja Politike e Komitetit Qendror, e udhëhequr kurdoherë nga parimi që t'i sqarojë dhe t'i shpëtojë shokët nga rruga e shtrembër dhe nga gabimet, ka pasur durimin dhe gjakftohtësinë për ta ndihmuar Lirinë. Gabimet e saj nuk janë të vogla e të lehta, por janë gabime të thella që në rast se nuk i kupton, atëherë është rrezik të bëhen edhe më të rënda edhe më të dëmshme si për Partinë, ashtu edhe për pozitën e saj në Parti.

¹ Në datën 3 shtator Byroja Politike u shpërndau gjithë anëtarëve të Plenumit një material, në të cilin flitej për gabimet e Liri Belishovës dhe për qëndrimin që kishte mbajtur ajo në Byronë Politike.

Nga ana tjetër, Partia duke kritikuar atë që gabon, e ndihmon atë të armatoset, të bëjë përpjekje për të nxjerrë arsytet e gabimeve të veta, për të mos rënë më në gabime të tilla. Kjo ka qenë rruga e Komitetit Qendror, e Byrosë Politike dhe imja, për korrigjimin e atyre që gabojnë.

Byroja Politike mendon se gabimet e Liri Belishovës janë shumë të mëdha e serioze, ato tregojnë se ajo është në fakt në kundërshtim me vijën e Partisë sonë, ajo nuk është dakord dhe në unitet mendimi e veprimi me disa çështje ideologjike dhe politike me Komitetin Qendror të Partisë, me gjithë Partinë tonë. Ajo nuk kupton sa rëndësi jetike ka për Partinë tonë ashtu si për çdo parti marksiste çështja e unitetit ideologjik dhe politik në Parti dhe aq më tepër çështja e unitetit të vetë Komitetit Qendror dhe të Byrosë Politike. Kjo çështje ka veçanërisht një rëndësi jetike në situatën aktuale të krijuar, kur armiqtë imperialistë dhe revizionistët modernë përpiqen me çdo kusht të përçajnë udhëheqjen e Partisë sonë, qoftë edhe sikur të shkaktojnë çarje të vogla, për ta dobësuar e pastaj për ta goditur Partinë. Prandaj prishësit e këtij uniteti të çeliktë, që ka farkëtuar Partia me luftë dhe me gjak e nëpër furtuna, duhen dënuar rëndë, siç e meritojnë, ashtu sikurse e duan interesat e mëdha të Partisë dhe të popullit.

Cilat janë gabimet e Liri Belishovës?

Sikurse e dini, Liria vajti në Kinë. Kjo vajtje kishte karakter shtetëror, dhe në delegacionin ku bënte pjesë ajo nuk kishte njerëz sidokudo, por kishte njerëz partie. Pra delegacioni nuk përbëhej nga njerëz apolitikë, po nga personalitete të njohura të Partisë dhe të shtetit tonë.

Para se të nisej për në Kinë, ajo ishte në dijeni të mosmarrëveshjeve që ekzistonin në mes të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, në mos në tërë gjerësinë si u zhvilluan ato më vonë, po dinte mjaft gjëra. Kur iu rekomandua që, sa të ishte e mundur, të mos shprehte mendime për këto çështje akoma të pazgjdhura, kjo do të thotë se ajo ishte në dijeni të objektit të mosmarrëveshjeve midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës. Mirëpo Liri Belishova vajti në Kinë dhe nuk veprroi ashtu si iu rekomandua.

Gjatë qëndrimit në Kinë, Liri Belishova ka manifestuar një frikë të çuditshme dhe ka evituar çdo bisedim me shokët kinezë, kur ishte fjala për të shprehur mendimin e Partisë sonë për revizionizmin modern, për miqësinë me PK të Kinës e qeverinë e saj dhe për kuptimin e drejtë të lidhjeve me Bashkimin Sovjetik. Bile në forma të ndryshme ajo kërkoi prej tyre që, sa të ishte e mundur, të mos bisedohej për çështje partie, sepse gjoja «nuk ishte e autorizuar»¹ etj.

¹ Ky qe një justifikim i gënjeshtërt i Liri Belishovës. Ajo jo vetëm që kishte udhëzimet e duhura nga Byroja Politike e KQ të PPSH për qëndrimin që duhej të mbante në RP të Kinës, por edhe me radiogram të veçantë më 4 qershor 1960 shoku Enver Hoxha i tërhiqte vërejtjen dhe e porosiste: «Po lexojmë në gazeta përshëndetjet tuaja dhe këto na çuditin. Ato janë jashtëzakonisht të thata dhe me gabime.

Pikësëpari duhet të flitet më gjatë dhe jashtëzakonisht ngrohtë për Kinën; të demaskohen ashpër imperialistët dhe revizionistët jugosllavë... Është krejt e papranueshme të flitet për një farë revizionizmi modern. Sukseset e vendit tonë dhe politika e drejtë e Partisë në çdo fushë duhet të vihen mirë dhe gjatë

Përse e bënte ajo këtë, do ta shohim më vonë, po fakti është që shokët kinezë donin të bisedonin me ne çështje partie. Ata ne nuk mund t'i ndalojmë të mos bisedojnë, po ne kemi qëndrimin tonë dhe ky qëndrim mund të shprehet në çdo rast. Nuk është aq thjesht të kërkojë që të mos bisedosh për çështje partie. Megjithëse Liria kërkonte me çdo kusht që në bisedimet me shokët kinezë të mos trajtoheshin probleme partie, ata e quajtën të arsyeshme të na flitnin neve mbi një çështje kaq të madhe e delikate. Këtë ata e bënë sigurisht se kishin besim të madh dhe respekt të thellë për Partinë tonë. Siç duket, Liri Belishova nuk e vlerësoi kështu këtë çështje.

Ajo, në vend që të mbante qëndrimin që duhej mbajtur në këto bisedime me shokët kinezë, i kundërshtoi pikëpamjet e tyre për disa çështje dhe u la të kuptojnë sikur ne anonim nga udhëheqësit sovjetikë, pa u udhëzuar për ta bërë një gjë të tillë. Partia jonë jo vetëm që nuk ishte shprehur për një qëndrim të tillë, por të gjithë shokët e Byrosë Politike nuk ishin dakord me mjaft qëndrime të udhëheqësve sovjetikë për probleme politike dhe ideologjike që dukeshin si në veprimtarinë praktike ashtu edhe në shtypin e tyre. Prandaj, Partia jonë asnjëherë nuk ishte prononcuar kundër Kinës. Me qëndri-

në dukje kudo. Fjalimet të jenë politikisht dhe ideologjikisht të ngritura dhe jo me fraza banale... Përsëritet dhe fjalimet bajate që keni përgatitur i grisni dhe formuloni krejt të reja».

Kurse në radiogramin tjetër të datës 6 qershor i thuhet: «Bisedime me shokët kinezë për çështjet ideologjike në diskutim bëj vetëm ti». (Marrë nga kopjet e origjinaleve të radiogramëve që gjenden në AQP).

met e saj Liri Belishova u la shokëve kinezë të kuptonin sikur Partia jonë nuk ishte dakord me pikëpamjet e tyre.

Gabimi tjetër i Liri Belishovës ishte se shkoi e mori takim me këshilltarin e ambasadës sovjetike në Pekin dhe i tregoi për ato që i thanë shokët kinezë. Nga kjo del fare i qartë qëllimi i saj. Udhëheqësit sovjetikë, që nga Hrushovi deri te Poljanski, e kuptuan si mendonte Liria, se ato ishin mendimet e saj personale, se ajo ishte kundër pikëpamjeve kineze dhe pro qëndrimeve sovjetike në këto çështje.

Liri Belishova u konsiderua prej tyre «heroinë» e situatës. Udhëheqësit sovjetikë, veprimet e saj i përdorën për të krijuar një situatë të vështirë në Partinë, në udhëheqjen dhe në kuadrot tanë. Pas Mbledhjes së Bukureshtit të gjithë shokët që ishin në BRSS, ata i kapën për t'u shtruar pikëpamjet e tyre dhe për t'u marrë mendimin në një mënyrë ose në një tjetër nëse ishin me Komitetin Qendror të PPSH. Një nga këto pikëpamje ishte se Liri Belishova në Kinë ka qëndruar si «heroinë», se «ajo u është përgjigjur si duhet shokëve kinezë dhe nuk i lejoi ata të nxjerrin komunikatë për bisedimet që kanë pasur me të». Këto janë fjalët që kanë dalë nga udhëheqësit sovjetikë.

Liri Belishova jo vetëm ishte e predispozuar për të mbajtur një qëndrim të tillë, por ajo bëri edhe një gabim tjetër organizativ, theu disiplinën e Partisë. Nuk kërkoi aspak të merrte mendimin e Byrosë Politike. Ajo nuk e kuptoi se ky ishte një veprim i dëmshëm për të ndezur zjarr në këtë situatë mosmarrëveshesh që ekzistonin midis këtyre dy partive. Ajo e dinte se mosmarrëveshje ekzistonin midis Partisë Komuniste të Bash-

kimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës e jo midis Partisë Komuniste të Kinës dhe gjithë komunizmit ndërkombëtar, sikurse u shtrua kjo çështje në Mbledhjen e Bukureshtit.

Ne kemi pasur marrëdhënie të singërta me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për çdo gjë. Po kështu si u zhvilluan ngjarjet dhe kur është çështja për një parti të tretë që akuzohet, ne nuk duhej t'i hidhnim benzinë zjarrit. Para se të nisej për në Kinë, unë bisedova me Lirinë për çka na kishte thënë Mikoiani për Partinë Komuniste të Kinës. E porosita gjithashtu që këtë çështje të mos e bisedonte me asnjëri, sa kohë që ne akoma nuk kishim njoftuar as KQ të Partisë sonë për këto mosmarrëveshje. Liria duhej ta kishte kuptuar se, derisa ne nuk vumë në dijeni Partinë tonë, nuk na përkiste neve të vinim në dijeni Partinë Komuniste të Kinës për ato që kishte thënë Mikoiani për ta. Jo vetëm që Liria u porositi, po edhe sikur asnjë porosi të mos kishte, ajo si anëtare e Byrosë Politike duhej të mendonte se çështjet që i shtruan shokët kinezë nuk mund të bëheshin objekt bisede me një parti të tretë pa marrë pëlqimin e Komitetit Qendror.

Përse Liria nuk kërkoi mendimin e udhëheqjes së Partisë? Sepse ajo nuk ka pasur një kuptim të drejtë për udhëheqjen, për Byronë Politike. Ajo ka pasur mendjemadhësi dhe mbivlerësonte aftësitë dhe zgjuarsinë e saj, ndryshe ajo, si çdo anëtar i Komitetit Qendror, kur të haste vështirësi për një problem të rëndësishëm, duhet të këshillohej me udhëheqjen e Partisë dhe të mos vepronte pa marrë këshillat e saj. Liria këtë nuk e bëri, sepse i pëlqente pozicioni që mbajti.

Në Byronë Politike ajo u përpoq shumë të justifikojë për gabimet e saj në Pekin. U kap pas argumentesh të tilla se ishte vetëm dhe s'kishte me cilin të konsultohet. Po fakti është se ajo vazhdoi të gabojë edhe në Moskë, bile deri në mbledhjen e Byrosë Politike pasi u kthye. Ajo nuk do t'i kuptojë gabimet e saj të rënda dhe nuk i pranon ato.

Kur Liria ishte në Pekin unë i bëra një radiogram. Cila që përmbajtja e tij? Kur na u bë propozimi për Mbledhjen e Bukureshtit në muajin qershor, kishim marrë një radiogram nga ambasada jonë në Pekin, ku shkurtimisht njoftoheshim përsa kishte ndodhur në mbledhjen e Këshillit të Federatës Sindikale Botërore, për kundërshtimet e mëdha parimore në mes delegacioneve të Bashkimit Sovjetik dhe të Kinës. Ne e dinim se Liria do të kishte takime me shokët kinezë, prandaj bëmë një radiogram lidhur me mbledhjen e partive komuniste e punëtore që mendohej të mbahej në qershor. Ne i thoshim asaj se shokët kinezë kishin propozuar shtyrjen e mbledhjes së qershorit, por, nëse Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe partitë e tjera do të jenë dakord me propozimin e tyre, ne nuk kemi ndonjë kundërshtim. Në rast se ajo do të mbahet në qershor, thoshim në radiogram, të njoftohen shokët kinezë që, po të na lejojnë të themi mendimin tonë modest, është e domosdoshme pjesëmarrja e Partisë së madhe Komuniste të Kinës në këtë mbledhje.

Gjatë kësaj kohe ne morëm një letër tjetër, nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, me të cilën njoftoheshim për shtyrjen e mbledhjes që do të bëhej në qershor. Atëherë përsëri i bëmë radiogram Lirisë

me të cilin i thoshim se nuk ishte nevoja t'u transmetonte shokëve kinezë përmbajtjen e radiogramit të parë, pasi frika që kishim se mos shokët kinezë nuk do të vinin në mbledhjen që kishin propozuar të shtyhej, u zhduk. Liria e lexoi dhe e interpretoi radiogramin sipas qejfit dhe planit që bluante në kokën e vet.

Gjithashtu ne e porositim atë që të gjente rastin dhe t'i njoftonte shokët kinezë se artikujt e botuar prej tyre, me rastin e 90-vjetorit të lindjes së Leninit, i kishim lexuar dhe na kishin pëlqyer.

Këtë porosi që i bënte Byroja Politike, Liria nuk e plotësoi, sepse ajo kishte pikëpamjet e veta. Por pavarësisht se këta artikuj nuk i pëlqenin asaj, ajo duhej t'ua transmetonte shokëve kinezë pikëpamjen e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë sonë. Kur të kthehej ajo mund t'ia thoshte Byrosë Politike pikëpamjen e saj personale. Kjo tregon se Liri Belishova ka vajtur në Kinë me mendime të caktuara, të ndryshme nga ato të shokëve të Byrosë Politike që, ato ditë, diskutonin shpesh në lidhje me qëndrimet politike dhe ideologjike të PK të BS dhe PK të Kinës.

Kur erdhi në Moskë Liria ishte më e armatosur. Ju e dini që Lirisë i nisëm dy letra të thjeshta, po shumë të qarta, armë plotësisht të mjaftueshme që të mos gabohesh¹. Duke marrë parasysh qëndrimet e saj në Kinë

¹ Është fjala për letrat e 23 dhe 28 qershorit, botuar në këtë vëllim f. 17, 31. Kur u kthye në Shqipëri, Liri Belishovës iu kërkua nga Byroja Politike dhe nga organizata-bazë ku bënte pjesë t'i dorëzonte këto letra. Ajo deklaroi se gjoja i kishte asgjësuar. Në fakt letrat ajo duhet t'ua ketë dorëzuar udhëheqësve sovjetikë gjatë takimeve që pati me ta.

dhe sidomos të metat që ekzistojnë në karakterin e Lirisë, si mendjemadhësia e ambicia, duke u shtuar këtyre edhe lajkat që iu bënë nga udhëheqja sovjetike që e kishte quajtur «heroinë», ne kishim frikë për qëndrimin e saj dhe morëm këtë masë që ajo të mos binte përsëri në gabime. Pra këto dy letra i bëmë për ta shpëtuuar Lirinë. Mirëpo ajo udhëzimet e dërguara nuk i zbatoi.

Në letrën e parë, të cilën e mori sapo arriti në Ulan-Bator, Byroja Politike i vinte në dukje se ajo kishte gabuar rëndë në Kinë dhe për këtë arsye duhej të kishte kujdes që të mos i rritej mendja nga lajkat dhe nga epitetet bombastike që mund t'i atribuoheshin nga udhëheqësit sovjetikë. Në letrën e dytë, të cilën e mori me të zbritur në Moskë, ajo njoftohej për zhvillimin e Mbledhjes së Bukureshtit, për qëndrimin që mbajti atje Partia jonë dhe i theksohej se ky qëndrim nuk u ka pëlqyer udhëheqësve sovjetikë, prandaj ajo duhej të kishte kujdes të mbronte vijën e Partisë, të theksonte se ajo ishte plotësisht dakord me qëndrimin e Komitetit Qendror të Partisë, të shprehur në Bukuresht nga shoku Hysni. Ky qëndrim do të ishte i drejtë dhe do t'u priste rrugën të gjitha përpjekjeve të kujtdo qoftë që do të orvatej për përçarjen e udhëheqjes sonë.

Liri Belishova, pra, ishte e parapregatitur të mos gabonte, në rast se do të ishte dakord me vijën e Komitetit Qendror. Por fakti është se nuk ndodhi kështu.

Ne e dimë taktikën që ndoqën udhëheqësit sovjetikë. A'ua e thirrën Lirinë në drekë, po atje ajo nuk mbajti qëndrimin për të cilin ishte udhëzuar nga Byroja Politike. Liria përdori atje taktikën e shakave, «të bëjmë

shakara, mendoj ajo, që të dalim nga kjo situatë», por në fakt as shakaja nuk i ndihmoi asaj dhe u krijua një situatë e tillë që ishte në favor të udhëheqësve sovjetikë, në disfavor dhe në kundërshtim me qëndrimin e Komitetit Qendror të Partisë sonë dhe i pajtueshëm në fund të fundit me pikëpamjet e Liri Belishovës.

Udhëheqësit sovjetikë gjatë drekës filluan me lëvdata e me dollira për Lirinë dhe me sulme për Partinë tonë, po çështjeve delikate, grushteve dhe helmeve kundër Partisë sonë, të drejtuara veçanërisht nga Kozlllovi, Liria u bëri bisht. Kozlllovi shprehu pakënaqësinë për qëndrimin e shokut Hysni [Kapo] në Bukuresht dhe ajo nuk ia përplasi fytyrës menjëherë. Ajo hiqet sikur nuk e kishte të qartë këtë çështje, por i paska thënë Kozlllovit se «Enver Hoxha nuk ka asnjë hije në jetën e tij ashtu sikurse ka te Gomulka» për të cilin ata thanë se ka mbajtur një qëndrim «pravilno», «jasno». Ajo duhej të kishte ndërhyrë menjëherë e të thoshte se Partia jonë në Bukuresht ka mbajtur qëndrim të drejtë e të qartë dhe se ishte dakord me atë qëndrim.

Pastaj Kozlllovi tha se «ne duam të kemi miqësi, po pa zigzage». Po kush e zhvillon miqësinë me zigzage? As kësaj Liria nuk i dha përgjigjen e duhur. Në letër ne i thoshim Lirisë që Hrushovit nuk i pëlqeu qëndrimi i Partisë sonë në Mbledhjen e Bukureshtit, prandaj ajo duhej ta kishte kuptuar se kur flitej për zigzage atakohej Partia jonë dhe duhej të ishte përgjigjur se Partia jonë nuk bën zigzage.

Një qëndrim i tillë i Liri Belishovës është pra i vetëdijshëm.

Gjatë drekës u hodhën edhe thumba të tjerë si: «me

200 apo me 600 milionët jeni ju shqiptarët?». Po edhe kjo mbeti pa përgjigjen e duhur nga Liria. Në takimin që pata me Ivanovin unë i thashë se thënia e Kozllovit është antimarksiste. E ç'do të thotë ai «me 200 apo me 600 milion»? Partia jonë është në rrugë marksiste, prandaj ajo është me të gjitha vendet e kampit tonë socialist. Mirëpo në Plenum Liria na tha se nuk e ka dëgjuar ose nuk e ka kuptuar mirë këtë çështje. Por nuk është e mundur t'i shpëtonte kjo gjë asaj pa e dëgjuar, se ai e tha këtë në drekë dhe afër saj dhe ne nuk jemi dakord me një justifikim të tillë. Çështjet ata mund t'i thoshin edhe të ngatërruara, indirekt, po në fund të drekës ajo mund të ngrihej e të thoshte: «Shokë, vija jonë nuk është me zigzage, ne jemi për një unitet të të gjitha vendeve të kampit tonë, prandaj le ta pijmë këtë dolli për triumfin e marksizëm-leninizmit!». Po në fakt nuk u veprua kështu, dreka dhe të gjitha këto thënie plot helm të sovjetikëve kaluan si me shaka.

Po pse me shaka? Sepse Liri Belishova nuk ishte dakord me vijën e Partisë sonë për këto çështje, ajo kish'e një pikëpamje tjetër dhe mendonte se pikëpamja e saj ishte e drejtë dhe në fund të fundit, sipas saj, pikëpamjet e udhëheqjes së Partisë sonë nuk ishin të drejta dhe se në këtë situatë ne po gabonim.

Prandaj edhe kur u kthye, Liria pati disa shfaqje dhe bëri disa veprime që e vërte'ojnë një gjë të tillë. Ajo filloi sidomos t'u thotë shokëve: «Shoku Enver të mënjanohet, të mos e nxjerrim në këtë situatë, që të mos kompromet'ohet për këto çështje». Kjo shqip do të thotë që «konflikti në mes Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik s'dihet si

do të përfundojë. Prandaj shokun Enver ta lëmë mënjatë, të mos përzihet dhe kur të marrë fund kjo çështje, atëherë shikojmë kush ka të drejtë ju apo unë, atëherë të dalë shoku Enver dhe u futim drunë të tjerëve që gabuan dhe kështu jemi në rregull», sipas pikëpamjes së saj.

Domethënë edhe pasi u kthye në Tiranë, me gjithë këshillat që iu dhanë në mbledhjen e Byrosë Politike, Liri Belishova qëndroi përsëri në të njëjtat pozita dhe vazhdoi të thurte intriga për të përçarë udhëheqjen e Partisë.

E lidhur me këto është edhe thënia tjetër e Lirisë sipas së cilës «ne duhet të përgatitim disa variante për në mbledhjen e Moskës» dhe, pasi të shohim nga fryn «era», të përdorim atë që do të na duket më i leverdisshmi. Kjo është një pikëpamje shumë e gabuar, oportuniste dhe krejtësisht e papranueshme nga Partia jonë e Punës. Në Mbledhjen e Moskës ne duhet të shkojmë jo me «disa variante», por me një qëndrim të prerë, jo me dhjetë flamurë, por me një, me flamurin e marksizëm-leninizmit.

Një tjetër pikëpamje e Lirisë ishte që të mos u jepeshin shokëve të Plenumit ose kandidatëve të Byrosë Politike dokumentet e shkëmbyera midis Byrosë Politike dhe shokut Hysni Kapo në Bukuresht, i cili udhëzohej me anën e tyre për qëndrimin që duhej të mbante atje. Ç'do të thotë kjo? Kjo lidhet me faktin se «këto dokumente kanë firmën e Enverit, prandaj të mos e nxjerrim atë në shesh». E përse të mos e vinim në dijeni Komitetin Qendror për praktikën e ndjekur nga Byroja Politike dhe për ta gjykuar Plenumi punën e saj? Ç'të keqe ka këtu?

Po në të vërtetë në kokën e Liri Belishovës ka dhe duhej të kishte prapamendime. Shpjegimet që ka dhënë nuk e kanë bindur Byronë Politike se ajo i ka kuptuar mirë dhe thellë gabimet e vetë. Ajo duhej të nxirrte arsyen pse veprimi ashtu siç veprimi dhe kush e shtyu, nga ç'baza i lindën këto mendime, domethënë t'u bënte një analizë të thellë gabimeve të saj. Prandaj e morëm përsëri në analizë këtë çështje në Byronë Politike.

Qëllimi i këtij diskutimi në Byronë Politike ka qenë ta ndihmonim Lirinë. Diskutimet kanë qenë të zjarra, të rrepta, sepse kishin të bënin me mbrojtjen e interesave të Partisë, të vijës së saj, të jetës së saj. Përpara interesave të Partisë duhet të qëndrojmë të palëkundur. Të themi të drejtën, Lirisë iu dha mjaft ndihmë nga shokët dhe Liria duhej të kishte bërë një autokritikë të hapur, pa dorashka. Por, autokritika e saj në Byronë Politike nuk ishte e kënaqshme. Liria nuk tha gjë, bile, me ndërhyrjet e saj, indirekt shprehu pakënaqësi dhe dyshime për qëndrimin që po mbahej ndaj saj.

Liria gabimet e saj i nxjerr shumë të thjeshta. Ajo nuk bëri një analizë marksiste-leniniste të këtyre gabimeve, të burimeve të tyre, gjë që pritej prej saj. Ajo nuk u nis nga parimi që t'i thotë Partisë shkaqet e vërteta që e shtynë atë në gabime, por u kap pas argumentesh të tilla se «ishte vetëm dhe s'kishte me kë të konsultohesh». Kjo taktikë e Lirisë nuk është e shëndoshë. Ajo duhej t'i thoshte haptas Byrosë Politike përse janë bërë këto gabime dhe ku e kanë burimin ato.

Shokët e Byrosë Politike i analizuan gabimet e Liri Belishovës dhe arritën në konkluzionin se gabime të tilla nuk bëhen lehtë, po të mos kishte ajo disa pikë-

pamje të shtrembra për të tjerët dhe mbivlerësim për veten e saj.

Liri Belishova duhej ta kishte të qartë se revizionizmi nuk është vetëm në Jugosllavi, se ka edhe në parti të vendeve të tjera pikëpamje revizioniste dhe që po devijojnë nga rruga e drejtë marksiste-leniniste.

Me Lirinë kemi biseduar shumë herë që shumë veprime të udhëheqësve sovjetikë nuk janë në rrugë të drejtë, por në rrugë oportuniste, që shkojnë në favor të revizionistëve, veçanërisht të revizionistëve jugosllavë.

Dhe këtu nuk ka qenë fjala vetëm për qëndrime taktike nga ana e tyre. Ne konstatojmë se udhëheqësit sovjetikë e kanë shuar luftën kundër revizionistëve jugosllavë. Ata herë pas here shkruajnë artikuj teorikë kundër revizionistëve jugosllavë, por edhe ata me shumë boshllëqe, kurse përsa i përket luftës konkrete kundër tyre, këtë luftë ata e kanë shuar. Bile ka parti, si Partia Komuniste e Bullgarisë, ku është marrë edhe vendim për të mos folur kundër revizionistëve jugosllavë.

Nuk mund të themi se për Liri Belishovën këto çështje ranë nga qielli dhe prandaj ajo s'ka të drejtë të thotë: «Si mund të imagjinoj unë që në vijën e udhëheqësve sovjetikë ka pikëpamje të tilla revizioniste». Ne çdo ditë për këto probleme po bisedojmë, por Liri Belishovës i janë errur sytë përpara lajkave dhe epiteteve të mëdha që i janë bërë nga udhëheqësit sovjetikë dhe është pajtuar me ta. Ajo ka harruar që për një çështje kaq të rëndësishme si ajo e mosmarrëveshjeve midis PK të BS dhe PK të Kinës nuk mund të pengohet asnjë parti marksiste të thotë pikëpamjen e vet ashtu si nuk

mund të pengohet ta thotë këtë edhe për veprimet e Hrushovit apo të Kozllovit, që ne mendojmë se nuk janë aspak të drejta.

Kur flasim për dashurinë ndaj BRSS nuk duhet të futim këtu ata që gabojnë, kushdo qofshin ata, sovjetikë, çekë, bullgarë ose shqiptarë. Çdo marksist dhe udhëheqës duhet të ketë të qartë se ne BRSS nuk e duam për sytë e bukur të Ivanovit. Ai nuk e do Bashkimin Sovjetik, miqësinë tonë me Bashkimin Sovjetik, sa kohë që vepron në një mënyrë armiqësore kundër një populli dhe një partie që ushqejnë një dashuri të sinqertë për popullin sovjetik dhe që ai e ka parë me sytë e tij gjatë qëndrimit për tre vjet me radhë në vendin tonë. E përse t'ia mbajmë hatrin Ivanovit, se mos priset miqësia? Po kështu edhe Kozllovit, Hrushovit e të tjerëve.

Ne kemi pikëpamjet tona që i kemi thënë dhe do t'i themi. Por Liri Belishova nuk u pajtua me këtë qëndrim, se është lëkundur në vijën e Partisë. Në këto pozita e çoi atë mendjemadhësia. Asaj i është rritur mendja shumë, mbivlerëson kapacitetet e veta dhe nënvleftëson të tjerët. Për këtë është kritikuar disa herë.

Me gjithë këshillat që i janë dhënë, ajo mban një qëndrim shumë arrogant ndaj kuadrove, i ka ofenduar dhe i ofendon, i ka goditur rëndë, sa që edhe në aparatit e Komitetit Qendror ka shokë që kanë kërkuar të largohen për këtë shkak. Me gjithë kritikën që i janë bërë, arrogancën ndaj kuadrove e demostroi edhe në mbledhjen e fundit të Komitetit Qendror të BRPSH. Edhe në konferencën e arsimtarëve ajo kështu ka vepruar. Të vepruar kështu pas gjithë këtyre kritikave që të bëhen do të thotë të mos reflektosh mbi gabimet e tua.

Këto shfaqje tregojnë se kur ke një kuptim të tillë përbuzës për kuadrin që ke në vartësi, një kuptim të tillë do të kesh edhe për ata me të cilët je në një radhë. Në fakt, edhe me shokët e Byrosë Politike Liri Belishova shpeshherë nuk ka mbajtur qëndrim të drejtë dhe të shëndoshë. T'i nënvleftësosh shokët e udhëheqjes dhe ta shfaqësh këtë në shumë raste bile edhe publikisht, kjo nuk lejohet. Është tjetër kritika që u bëhet kuadrove përpara masës; ne këtë e kemi bërë e do ta bëjmë, dhe është tjetër gjë të përçmohesh e të diskreditosh kuadrat.

Fakte të kësaj natyre për Liri Belishovën ka shumë. Prandaj kur ke një kuptim të tillë për kuadrat, në situata kryq, bën gabime, ashtu si bëri ajo që gaboi edhe në vijë. Kur ke pikëpamje të tilla për kuadrin deri në udhëheqje, sigurisht nuk do të kesh pikëpamje të shëndosha as për vendimet që merr kjo udhëheqje, që janë një konkretizim i shumanshëm i vijës politike të Partisë.

Prandaj në qoftë se ecën me këto lakra në kokë, në qoftë se jcton me këtë mbivlerësim të vetes, do të gabosh me siguri edhe në vijën politike.

Liri Belishova, pra, ka gabuar në këto çështje dhe akoma nuk i ka kuptuar gabimet e saj të rënda. Byroja Politike doli me konkluzionin që Liria të reflektonte akoma mbi gabimet e saj. Ne nuk kemi mbetur të kënaqur nga autokritika e saj, ajo na premtoi se do të reflektonte dhe duhet të ketë reflektuar. Tani varet nga autokritika që do të bëjë përpara Plenumit dhe nga ajo se sa ka përfituar nga ndihma e Byrosë Politike.

Çështja e saj tani varet nga vlerësimi që do t'u bëjë

përpara Plenumit të Komitetit Qendror këtyre problemeve. Ne e këshillojmë që t'i shikojë drejt dhe thellë gabimet e saj, nga baza të shëndosha marksiste-leniniste, se asnjë shok nuk ia ka dashur dhe nuk ia do të këqen, jo Lirisë po asnjë njeriu të thjeshtë që ka gabuar. Ne i duam vetëm të mirën, prandaj edhe po përpiqemi që ta ndreqim. Por ajo me këto pikëpamje nuk mund të jetë në Byronë Politike, sepse është një gjë shumë e rëndë të mos jesh dakord me vijën e Komitetit Qendror. Byroja Politike ka vendosur t'i propozojë Plenumit që Liri Belishova të shkarkohet nga funksioni si anëtare e Byrosë Politike dhe sekretare e Komitetit Qendror për propagandën, sepse në këto forume të larta të Partisë nuk duhet të ketë shokë që të shkojnë në kundërshtim me pikëpamjet dhe me vijën ideologjike dhe politike të Komitetit Qendror. Në Byronë Politike dhe në Komitetin Qendror duhet të ketë unitet të plotë mendimesh dhe veprimesh dhe në radhë të parë për çështjet kryesore, siç është çështja aktuale që ka një rëndësi të jash-tëzakonshme për ndërtimin e socializmit në vendin tonë dhe për komunizmin ndërkombëtar.

*Botohet për herë të parë me
ndonjë shkurtim sipas origji-
nalit që gjendet në Arkivin
Qendror të Partisë*

**FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN XVIII TË KQ
TË PPSH LIDIUR ME QËNDRIMIN ARMIQËSOR
DHE NË OPOZICION ME VIJËN E PARTISË
TË LIRI BELISHOVËS**

7 shtator 1960

Sido që ne, shokët e Byrosë Politike, i parashtruam pikëpamjet tona në lidhje me gabimet e Liri Belishovës ndaj vijës së Partisë, si dhe mendimin tonë për masën që duhej të merrej ndaj saj, tani pas punimeve të Plenumit mbi këtë çështje, në emër të Byrosë Politike unë jam plotësisht dakord me pikëpamjet unanime dhe shumë të drejta, të vendosura, marksiste-leniniste të Plenumit të Komitetit Qendror.

Pra, në këtë çështje kaq të rëndësishme jo vetëm për gabimet që ka bërë Liri Belishova, por për çështjet shumë të rëndësishme për riafirmimin dhe për mbrojtjen e vijës së drejtë të Komitetit Qendror, për mbrojtjen me konsekuencë në rrugën marksiste-leniniste të vijës së drejtë të Partisë sonë, Plenumi i Komitetit Qendror tregoi edhe një herë tjetër unitetin e plotë, të çeliktë, monolit të udhëheqjes së Partisë sonë.

Kjo, shokë, ka rëndësi të madhe për Partinë tonë, për forcimin e saj, për ndërtimin e socializmit në Shqi-

përi. Rëndësi shumë të madhe ka gjithashtu edhe për Lirinë, edhe për Maqo Çomon¹, që të kuptojnë mirë se çështja e mbrojtjes së vijës së Partisë, në të gjitha aspektet e saj, është jetike për popullin e vendin tonë dhe për komunizmin ndërkombëtar.

Të flasim këtu si marksistë, jo si udhëheqje e një shteti të vogël. Pra, si marksistë, ne kemi të drejtë të themi fjalën tonë, të mbrojmë komunizmin aq sa kanë të drejtë edhe sovjetikët dhe çdo parti marksiste-leniniste e madhe apo e vogël qoftë. Nuk është këtu çështje mendjemadhësie, kur themi se mbrojmë dhe ndihmojmë me qëndrimin tonë konsekuent, të drejtë, çështjen e komunizmit ndërkombëtar. Marksistët këtë e kuptojnë drejt. Ata që nuk janë marksistë dhe i fshehin pikëpamjet e tyre antimarksiste, borgjeze, ata mund të thonë me ironi: «Po kush jeni ju që po flitni kështu dhe që mbronin komunizmin ndërkombëtar? Ju për ne nuk keni asnjë vlerë». Por se ç'mund të thonë të tjerët, neve pak punë na prish, sikurse na prish pak punë që na quajnë ose do të na quajnë «dogmatikë», «sektarë» e me epitete të tjera të tilla që nuk i përkasin Partisë sonë.

Vija e Partisë sonë ka qenë e drejtë, marksiste-leniniste, ajo është provuar gjatë afro 20 vjetëve në jetë, në luftë të përditshme për çlirimin e atdheut, për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit nga armiqtë e çdo kallëpi dhe nga revizionistët jugosllavë. Këtë e kanë provuar sukseset e mëdha që ka arritur populli ynë, ndryshimet e mëdha që ka bërë

¹ Maqo Çomo, ish-anëtar i KQ të PPSH, bashkëshort i Liri Belishovës, nuk mbajti qëndrim partie ndaj gabimeve të saj.

Shqipëria nga ana ekonomike, politike, kulturore etj. Për të gjitha këto suksese flet me admirim populli shqiptar.

Gjëja kryesore që sheh te populli ynë është bindja e tij, kuptimi i tij i drejtë se këto transformime të mëdha ekonomike, shpirtërore, shoqërore ia ka sjellë atij marksizëm-leninizmi, vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë. Kjo ka rëndësi shumë të madhe. Këtë e vërtetojnë lidhjet jashtëzakonisht të ngushta të Partisë me popullin tonë.

Pra jeta dhe vepra e Partisë sonë tregojnë se vija e saj është e drejtë, ajo ka gjetur aprovimin dhe mbështetjen e popullit tonë dhe nuk është as dogmatike, as sektare. Këtë epitet, që na e ngjitin, tani me gjysmë zëri apo nesër me zhurmë të madhe, ne e hedhim poshtë dhe vazhdojmë rrugën tonë marksiste-leniniste. Ata që do të tentojnë të bëjnë gjëra të tilla, janë të destinuar të dështojnë, ata do t'i demaskojë lufta, jeta.

Për vijën e drejtë të Partisë sonë, për sukseset e mëdha të vendit tonë, flasin me admirim jo vetëm komunistët dhe populli ynë, por edhe partitë komuniste e punëtore të shumë vendeve të botës. Ato flasin kështu për faktin se Partia e Punës e Shqipërisë e çliroi vendin dhe e futi atë në rrugën e përparimit, në rrugën e socializmit. Ato shohin vitalitetin e madh dhe heroizmin e popullit shqiptar e të Partisë sonë, që u bëjnë ballë me vendosmëri të madhe gjithë këtyre furtunave.

Prandaj të mos mendojë ndokush, qoftë edhe Liria, se ky admirim që kanë komunistët e gjithë botës për Partinë tonë të vogël, por heroike, i detyrohet Hrushovit. Në asnjë mënyrë. Po të ishte në dorën e Hrushovit dhe të udhëheqjes së sotme sovjetike, Shqipëria nuk do të

ishte kjo që është sot dhe nuk do të ekzistonte ky vlerësim e admirim që kanë partitë e tjera për Partinë dhe vendin tonë.

Këtu jemi në Komitetin Qendror, prandaj është e drejtë që bëhen diskutime të hapëta marksiste. Liria mund të habitet se ka pasur raste që në mbledhje të Byrosë Politike kemi bëri aluzione të hapëta. Ne kemi thënë, për shembull, që ka udhëheqës partie që çmojnë vlerën e udhëheqjes së një partie tjetër nga sasia e prodhimit të patates e të domates e jo nga vija politike që ndjek. Liria ka ndërhyrë e ka thënë: «si mund të flitet kështu për këta shokë!». Ne i kemi thënë se flasim për ta me fakte dhe jo në rrugë, por këtu në Komitetin Qendror dhe flasim hapur. Por do të vijë koha që këto mendime dhe ky opinion, bashkë me fakte të tjera të nxjerra nga jeta, do të zihen patjetër në gojë edhe në konferenca ndërkombëtare.

Shumë parti të tjera e kanë përkrahur Partinë e Punës të Shqipërisë për qëndrimet e saj të vendosura kundër revizionizmit modern, veçanërisht kundër atij jugosllav. Kjo tregon se në këto parti ka me të vërtetë forca të mëdha e të shëndosha, pavarësisht se në udhëheqjet e disave prej tyre është futur krimbi i revizionizmit dhe po i bren përbrenda. Sidoqoftë, është shumë vështirë që të mposhten forcat marksiste-leniniste që kanë të gjitha partitë. Ato e kanë kuptuar qëndrimin tonë pavarësisht se ne nuk kemi dalë hapur kundër gabimeve të udhëheqësve sovjetikë.

Të mos mendojë Liri Belishova se kjo është një taktikë për të ruajtur Hrushovin, në asnjë mënyrë jo. Ne kemi vazhduar dhe vazhdojmë të luftojmë kundër revi-

zionizmit. Komunizmi ndërkombëtar e ka parë se ne jemi kundër Hrushovit dhe marksistë-leninistët e vërtetë e kanë vlerësuar qëndrimin dhe taktikën e drejtë të Partisë sonë. Qëndrimet tona kanë qenë të drejta dhe për këtë nuk ka guxuar njeri të na sulmojë hapur, por orvatje janë bërë dhe këto kanë ardhur duke u rritur deri në kërcënime, në presione e shantazhe, po ne u kemi treguar vendin.

Atëherë ata kanë përdorur taktikën e diskreditimit të Partisë së Punës të Shqipërisë. Po si? Na thonë se «ju po bërtitni e po çirreni shumë kundër revizionizmit dhe po bëni që atyre t'u rritet mendja». Kjo parullë është përhapur në të gjitha udhëheqjet e vendeve të demokracisë popullore, bile ka arritur edhe gjer te udhëheqjet e disa partive komuniste të Evropës Perëndimore. Kjo që thonë ata nuk ka asnjë bazë. Në fakt kjo është një thirrje për të shuar luftën kundër revizionizmit jugosllav.

Tani kjo taktikë vazhdon, ajo është kthyer në një formë tjetër dhe do të kthehet në sulme kundër Partisë sonë, meqenëse ne nuk u radhitëm ashtu si dëshironte udhëheqja sovjetike, domethënë që të ndiqnim një rrugë tjetër. Por asnjë nga këto taktika nuk u ndezi dhe as që ka forcë që ta frikësojë Partinë tonë, edhe pse do të na quajnë «dogmatikë», «sektarë», ose «nacionalistë të ngushtë» e do të përpiqen të na futin në qorrsohak. Këtë e tregon forca e Partisë sonë dhe e Komitetit Qendror të saj. Është e qartë se janë të kota orvatjet për të na futur në këtë rrugë.

Këtu nuk është çështje respekti. Respekt dhe dashuri ne kemi për popujt e Bashkimit Sovjetik, por jo

për Pospjellovin. Derisa ai qëndronte në rrugën marksiste-leniniste, ne kishim respekt, por tani që mban qëndrime të tilla antimarksiste ndaj Partisë sonë i themi: «Dale, të lutem». Kur nuk gjen asnjë shkelje të vogël të marksizmit nga ana jonë, përse të na thotë: «Lexoni Leninin!». Kështu i ka thënë Pospjellevi ambasadorit tonë në Moskë, shokut Nesti Nase, i cili ka qëndruar shumë mirë ndaj sulmeve të Pospjellevit dhe Liria të marrë shembull prej tij.

Ne duam që mosmarrëveshjet në mes partive të zgjidhen në rrugën e drejtë. Por ata nuk kanë bërë dhe nuk duan të bëjnë përpjekje që këto mosmarrëveshje të zgjidhen. Jo vetëm kaq, por Pospjellevi duhet të dijë se marksizëm-leninizmi na mëson se nuk duhen bërë bisedime në shpinën e një partie tjetër, se duhet folur haptazi për gabimet që ka bërë një shok, sipas rregullave marksiste-leniniste. Ç'respekt do të kemi ne për atë që vepron ndryshe? Nëse mbron marksizëm-leninizmin, duhet të jesh konsekuent deri në fund. Dhe ne i themi Pospjellevit: «Ju e keni lexuar gjithë jetën Leninin, por faktet po tregojnë që tani po e shtrembëroni».

Çështja e drejtësisë së vijës së Partisë sonë gjatë gjithë kohës është e qartë. Ka gabuar Partia jonë për çështjen jugosllave? Faktet kanë treguar se ajo nuk ka gabuar. Janë të tjerë ata që kanë gabuar, dhe në radhë të parë Hrushovi. Ai nuk është marksist që të ketë kurajën dhe të thotë se kam gabuar. Meqë ka gabuar, atëherë duhet të kthehet të bëjë autokritikë e të thotë që «unë e kam akuzuar Stalinin se ka gabuar ndaj jugosllavëve». Jeta vërtetoi se Stalini ka pasur të

drejtë. Atëherë, nëse je marksist dil e thuaj se Stalini nuk ka gabuar për këto çështje.

Ç'do të thotë që ne të heshtim, të mos i demaskojmë revizionistët jugosllavë, sepse iu rritka mendja? Kjo do të thotë heshtni, se po të flitni kundër revizionistëve jugosllavë do t'u dalin lakrat të tjerëve, sepse revizionistë nuk janë vetëm jugosllavët. Të mprehësh luftën kundër revizionistëve jugosllavë, kjo të bën që të mos jesh qorr edhe kundër elementëve të tjerë revizionistë, në çfarëdo forme që ata të paraqiten.

Udhëheqësit çekë thonë: «Partia juaj mban qëndrime ndaj revizionistëve, por nuk mban një qëndrim të tillë edhe ndaj PK të Kinës, që nuk respekton parimin e bashkekzistencës». Po përse të jemi ne kundër Partisë Komuniste të Kinës? Cila është vija e Partisë sonë në këtë çështje? Ne jemi për bashkekzistencën paqësore, por Lenini, kur fliste për bashkekzistencë, nuk na këshillonte të putheshim e të përqafoheshim me përfaqësuesit e borgjezisë monopoliste.

Po të shikoni një film që ata e kanë prodhuar tani, me të vërtetë do të revoltoheni. Ky film që quhet, më duket, «SOS», tregon se si një marinar dhe një kolkozian shkojnë dhe bashkëjetojnë me një miliardë anglez. Bija e tij i jep dhomën më të mirë kolkozianit, dashurohet me marinarin sovjetik, ndërsa lordi dëbon nga shtëpia dhëndrin e tij pijanec, vagabond etj. etj.

Ne jemi për bashkekzistencë paqësore, jo për një bashkëjetesë të tillë si në këtë film, por për atë leniniste, që të demaskojmë imperializmin dhe revizionizmin, të demaskojmë çdo manovër e orvatje të tyre për të na shkatërruar ne. Qëllimi i tyre është të shkatë-

rrojnë komunizmin, qëllimi ynë është të shkatërrojmë imperializmin dhe agjenturën e tij, revizionizmin. Ne duam të bashkekzistojmë, për shembull, me Greqinë e pse jo, por jo që t'i japim Greqisë Gjirokastrën dhe Korçën, që duan ata; në asnjë mënyrë jo! Ne në asnjë mënyrë nuk mund t'u bëjmë lëshime shovinistëve grekë nën maskën e bashkekzistencës paqësore. Njerëzve të tillë, që kanë qëllime aneksioniste ndaj nesh, nesër Hrushovi mund t'u japë edhe medaljen e paqes, por këto çështje ne do t'i shtrojmë në mbledhje.

Ne nuk jemi për t'u hapur dyert spiunëve amerikanë, artit dekadent e mënyrës amerikane të jetesës. Jo, ne nuk jemi për këtë rrugë. Me ideologjinë tonë ne duhet të luftojmë të gjitha manovrat dhe të dënojmë planet dhe vijën e pajtimit me ideologjinë borgjeze. Imperializmi jo vetëm që synon shkatërrimin e vendeve tona me mjete të tjera, por edhe me anën e ideologjisë, nëpërmjet teatrit, muzikës, baletit, shtypit, televizionit etj. Ne nuk e kuptojmë bashkekzistencën duke përhapur amerikanadat, nuk jemi dakord që nëpunësit çekë ose sovjetikë, nëpër ambasada, të bëjnë pritje dhe të kërcëjnë alla amerikançe. Shokët që punojnë në përfaqësitë tona jashtë shtetit, janë skandalizuar nga këto gjëra. Ne nuk jemi për një rrugë të tillë.

Ne i kemi thënë edhe Mikojanit se pikëpamjen që kanë për çështjet kufitare midis Kinës dhe Indisë, ta revizionojnë. Ne u themi atyre që, në rast se grekët do të na futen në kufijtë tanë, në Gramoz, ne në asnjë mënyrë nuk do të qëndrojmë me duar lidhur. Edhe kinezët këtë gjë bënë me indianët.

Mirëpo tani sovjetikët e akuzojnë Kinën për luf-

tënxitëse dhe që nuk ka pyetur fare njeri për veprimet e saj. Po ata kë pyetën kur deklaruan për Kubën që në rast se do ta sulmojnë Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Sovjetik do t'i qëllojë me raketa. E para e punës, po të bëhet luftë në Kubë, në këtë luftë do të angazhohemi të gjithë. Atëherë, në rast se udhëheqësit sovjetikë i respektojnë vendet e tjera të kampit tonë, të paktën të na pyesin edhe ne për këta hapa kaq të rëndësishëm. Është e vërtetë se Kuba është vendi i një populli që ka luftuar. Por në rast se mbrojtjen e Kubës udhëheqësit sovjetikë e quajnë një qëndrim të drejtë, pse e akuzojnë atëherë Kinën për çështjen e Tajvanit një ishull i madh me 10-12 milion banorë me rëndësi të madhe strategjike. Në këtë ishull që është pjesë e pandarë e Kinës, ka vendosur fletën e vet Flota VII Amerikane. E përse të këtë durim Kina të mos kërkojë t'i kthehet toka e saj? Megjithatë, Kina nuk e ka humbur durimin, por nga ana jonë duhet të bëhen përpjekje dhe presione kundër imperializmit, se jemi një forcë e madhe.

Si ne, ashtu edhe kinezët, themi se kampi ynë është i fortë, por është një çështje tjetër që për shkak të vijës oportuniste në të kuptuarit e bashkekzistencës paqësore nuk mbrohen çështje me rëndësi kaq të madhe jo vetëm nacionale, po që do të shërbenin për forcimin e gjithë kampit tonë. Nuk është aspak e drejtë që të mos tregohet kujdesi i duhur për interesat e Kinës së madhe. Ata mund të thonë se e kanë ngritur zërin për këtë qëllim në OKB, po sa situata të tjera ka që mund të flasësh për mbrojtjen e interesave të Kinës.

Thuhet nga të katër anët se kampi ynë është monolit, ka unitet etj. Por ne e dimë shumë mirë se ekzistenca e mosmarrëveshjeve kaq të rënda në gjirin e kampit tonë, nuk është aspak e mirë. Dhe në rast se nuk bëhen përpjekje në rrugën marksiste-leniniste për t'i zhdukur këto mosmarrëveshje, atëherë udhëheqësit sovjetikë do të futen në një rrugë shumë të rrezikshme revizioniste.

Kush e ka fajin këtu? Ne kemi kërkuar që në marrëdhëniet midis partive të respektohen normat marksiste-leniniste. Udhëheqësit sovjetikë na akuzojnë se ne gjoja i japim shumë rëndësi formës dhe i futim çështjet në kallëpe. Por çështjet që kemi ngritur ne nuk janë çështje forme. Hrushovi shkoi 4 herë në Brioni për të biseduar me jugosllavët për çështjen hungareze, përse nuk bisedoi të paktën një herë edhe me ne dhe përse nuk u bë në atë kohë mbledhja e partiëve, anëtare të Byrosë Informative, ku të dëgjohej edhe zëri i Partisë sonë dhe ne të raportonim për manovrat e revizionistëve jugosllavë e të merrnin eksperiencë edhe partitë e tjera? A mos është kjo çështje forme?!

Përse çështja shumë e rëndësishme e Polonisë u zgjidh në mënyrë bilaterale.

Partia jonë ka mbajtur qëndrime të drejta në të gjitha këto situata, përndryshe ata do ta atakonin drejtpërdrejt. Megjithatë ataku erdhi pas Mbledhjes së Bukureshtit. Deri atëherë nga udhëheqësit sovjetikë nuk thuhej gjë e keqe për vijën e Partisë sonë, me përjashtim të qëndrimit të rreptë që mbanim ndaj revizionistëve jugosllavë, se gjoja ne jemi gjaknxehtë etj. Kurse tani për ata Partia jonë u bë «sektare», «nacio-

naliste e ngushtë». Po ne nuk jemi as sektarë, as nacionalistë, as dogmatikë, por jemi marksistë. Vijën e drejtë të Partisë sonë e ka provuar jeta, lufta jonë, prandaj ajo gëzon simpatinë e gjithë komunistëve të botës dhe na inkurajon të ecim përpara.

Këto çështje kanë qenë dhe janë të qarta, ato ne do t'i konkretizojmë më mirë dhe do të vëmë në dukje që askush nuk ka pse ta akuzojë Kinën dhe se ne jemi kundër akuzave që i janë bërë asaj. Do të dalin gjithashtu edhe gabimet oportuniste e revizioniste të udhëheqësve sovjetikë dhe të tjerë.

Liri Belishova të gjitha këto gjëra i ka ditur, por ajo nuk ka vepruar si duhet, sepse ka qenë shumë e lëkundur në vijën e Partisë. Kjo lëkundje e bëri atë të adoptojë metodat dhe sugjerimet e udhëheqësve sovjetikë. Ajo u nxit në këtë rrugë edhe nga pikëpamjet e gabuara si dhe nga të metat e saj, siç janë: megalomania, ambicia si dhe nënvleftësimi që ajo u bën shokëve të tjerë udhëheqës, deri anëtarë të Byrosë Politike.

Këto pikëpamje e bënë atë të lëkundet. Dhe më e keqja është se ajo nuk pati guximin t'ia thotë haptazi Komitetit Qendror qëndrimet e saj të shtrembra.

Gabimi që bëri ajo, duke i njoftuar këshilltarit të ambasadës sovjetike në Pekin ato që i kishin thënë përfaqësuesit e PK të Kinës, është i rëndë, por akoma më i rëndë është fakti që ajo ka dalë krejt nga binarët e vijës së drejtë të Partisë, fakti që ajo nuk ka qenë dakord dhe akoma nuk është dakord me vijën e Partisë dhe nuk është e bindur për drejtësinë e kësaj vije. Kjo ka rëndësi, të tjerat janë fakte që e vërtetojnë këtë

qëndrim të Liri Belishovës, megjithëse ajo me fjalë thotë se «jam me vijën politike, ideologjike dhe ekonomike të Partisë» etj.

Liria nuk i ka kuptuar aspak gabimet e saj të rënda. Ajo nuk ka asnjë arsye që të mos i kuptojë, sepse ka qenë në krye të një sektori të rëndësishëm ideologjik të Partisë dhe i dinte të gjitha këto çështje. Prandaj ne themi me bindje se këto gabime i ka bërë me ndërgjegje dhe nuk e ka shtyrë në këtë rrugë vlerësimi subjektiv i kritikave që i kanë bërë shokët.

Të gjithë shokët e Plenumit kanë qenë në marrëdhënie të mira e parimore me Lirinë, pavarësisht se çfarë mendonte ajo për njërin apo për tjetrin. Pra, gabimet nuk e kanë burimin te vlerësimi subjektiv i qëndrimeve të shokëve.

Liri Belishova u fut në rrugën e gabimeve, sepse u trondit, u shkëput nga vija e drejtë e Partisë. Ajo mendoi se kjo vijë nuk është e drejtë, se shokët kanë gabuar, se ata po shkojnë kundër Bashkimit Sovjetik dhe për vete mendoi se është në rregull me Bashkimin Sovjetik dhe me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Por Partia dhe Komiteti ynë Qendror nuk janë kundër Bashkimit Sovjetik, por janë kundër atyre udhëheqësve sovjetikë, që vazhdojnë të gabojnë në lidhje me Kinën, me komunizmin ndërkombëtar dhe me Partinë tonë. Këtë Liri Belishova nuk e kupton dhe jam dakord me pohimin e shokëve se nuk do ta kuptojë këtë gjë.

Ky pësim le të bëhet mësim. Punimet e këtij Plenumi janë një shkollë e madhe me rëndësi të veçantë, dhe, me të drejtë, kemi 3-4 ditë që po merremi me këtë çështje, përveç punës që u bë në Plenumin e mëpar-

shëm. Në këtë çështje Plenumi i Komitetit Qendror ka fituar një eksperiencë jashtëzakonisht të madhe.

Prandaj dhe Lirisë t'i shërbejë si shkollë e madhe ky Plenum. Përsa i përket vendimit për përjashtimin e saj nga Plenumi i Komitetit Qendror atë ta marrim, se ai është i drejtë, por, me qëllim që t'i japim edhe një herë dorën, Liria të mbetet anëtare partie¹ dhe Partia do ta ndihmojë të ecë përpara. Për këtë qëllim ajo duhet, në radhë të parë, të luftojë pikëpamjet e saj të gabuara që i ka në karakterin e vet, të luftojë veset negative, të kuptojë se ajo ka qenë dhe është e gabuar dhe jo Komiteti Qendror, sepse Komiteti Qendror i Partisë sonë ka dhënë prova dhe Partia jonë kritikën udhëheqësve sovjetikë ua bën në bazë të fakteve. Prandaj Liria të mendojë më thellë për këto çështje, ndryshe as nuk mund të ndihmohet dhe pra nuk do të ndreqet që të ecë përpara.

Liria është e re, por Partinë dhe normat e saj i njeh. Çdo njeri mund të gabojë, por Partia e ndihmon, prandaj nëse Liri Belishova do të vazhdojë me pikëpamjen se nuk ka gabuar dhe i gjykon çështjet jo në thellësi, jo ky tha kështu e ai tjetri ashtu, se në procesverbal është shkruar kështu etj., nuk do të veprojë mirë. Çështjet ajo duhet t'i shohë në esencë, në frymë revolucionare, të drejtë, marksiste-leniniste. Ndryshe përsëri do të gabojë, nuk do të korrigjohet, kurse ne duam dhe do të bëjmë përpjekje që të ndreqet.

¹ Më vonë organizata-bazë e Partisë ku bënte pjesë Liri Belishova e përjashtoi nga radhët e Partisë për qëndrimin e saj antimarksist, antiparti dhe armiqësor.

Prandaj punimet e këtij Plenumi t'i shërbejnë si një mësim i madh.

Edhe Maqo Çomoja duhet të reflektojë thellë në këtë situatë. Nuk është ndonjë gjynah që ai dhe Liri Belishova, si anëtarë të Plenumit të Komitetit Qendror, të shkëmbenin pikëpamjet mbi probleme të ndryshme, përkundrazi, po të diskutonin në frymë të shëndoshë, do të ndihmohej Komiteti Qendror. Ka edhe çështje të Byrosë Politike që duhet t'i dinte vetëm ajo. Disa nga shokët e Plenumit janë martuar me anëtare të Plenumit të Komitetit Qendror dhe duke i konsideruar ato si shokë të Komitetit Qendror, natyrisht bisedojnë me njëri-tjetrin për çështje politike e të tjera. Si të mos bisedoj, fjala vjen, unë me shoqen time Nexhmije për çështje politike? Pra, për çështje të politikës së përgjithshme mund të bisedojmë, se ne dimë të çmojmë çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet biseduar, kurse Liria nuk paska biseduar fare!

Si Maqoja, ashtu edhe ajo të mos na thonë këtu se nuk kanë biseduar mbi këto çështje, kjo nuk është e vërtetë. Edhe Maqoja duhet të reflektojë thellë mbi këto çështje, se janë shumë serioze për vijën e Partisë dhe për atë vetë, ato janë çështje shumë të rëndësishme politike.

Njerëzit në Komitetin Qendror duhet të jenë me zemër të hapur dhe të vendosur deri në fund për mbrojtjen e vijës së Partisë.

Komiteti Qendror pret nga Maqoja që ai t'i flasë hapur Partisë, në mos në këtë Plenum të paktën t'ia thotë Byrosë Politike. Ai ka kohë të reflektojë dhe Byroja Politike do ta ndihmojë.

Përsa i përket funksionit të Maqos, Plenumi dhe Byroja Politike duhet të marrë parasysh vërejtjet kritike të kësaj mbledhjeje. Duhet theksuar se Byroja Politike e ka kritikuar shumë herë Maqo Çomon për dobësi në kryerjen e funksionit të tij si ministër : Bujqësisë. Ai shumë herë haptazi në Byro e në Qeveri ka lënë të kuptohet se është «specialist i mbaruar» për problemet e bujqësisë dhe me zor pranon vërejtjet e kritikën e shokëve. Në disa raste është vënë në kundërshtim me vendimet e Komitetit Qendror e të Qeverisë.

Një qëndrim i tillë i Maqo Çomos e ka burimin te mendjemadhësia e tij, ashtu si edhe te Liri Belishova, në kuptimin e në zbatimin e vijës politike të Partisë. Kështu mund të themi se ka gjetur tenxherja kapakun dhe të dy këta kanë ndihmuar shoku-shokun në këtë situatë të vështirë. Prandaj në këtë drejtim Byroja Politike do ta këshillojë Maqon të reflektojë dhe përsa i përket vërejtjes së Plenumit në lidhje me funksionin e tij, ne jemi dakord që kjo çështje të merret në studim në mbledhjen e ardhshme të Plenumit.

*Botohet për herë të parë me
ndonjë shkurtim sipas origji-
nalit që gjendet në Arkivin
Qendror të Partisë*

RAPORT NË PLENUMIN XVIII TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI VEPRIMTARINË ANTIPARTI TË KOÇO TASHKOS»

7 shtator 1960.

Byroja Politike i paraqit për diskutim Plenumit të Komitetit Qendror dhe Komisionit të Revizionimit çështjen e kryetarit të Komisionit të Revizionimit, Koço Tashkos. Koço Tashkoja ka rënë në gabime shumë të rënda antiparti, të cilat konsistojnë: së pari, në qëndrimin e tij në opozicion të hapur me udhëheqjen e Partisë në lidhje me problemet që u shtruan në Plenumin e fundit, në korrik, dhe, së dyti, ai ka rënë në një gabim tjetër shumë të madh antiparti, sepse duke thyer të gjitha rregullat organizative të Partisë si dhe sekretin e saj të pranuar në Statutin e Partisë dhe në vendimet e mbledhjes së fundit të Plenumit të Komitetit Qendror, ai, çështjet që u diskutuan në këtë Plenum, domethënë vijën politike e ideologjike të Partisë, i ka diskutuar jashtë Partisë me ambasadorin dhe me punonjës të tjerë të ambasadës sovjetike në Tiranë.

Ai nuk ka qenë dakord me punimet e me konkluzionet e Plenumit të korrikut, si dhe me vijën dhe me qëndrimin që u caktua atje. Duke qenë i molepsur

nga ndjenja e karrierizmit, duke pasur pakënaqësi të vjetra ndaj Partisë dhe duke qenë prej kohësh në opozicion me të, ai kujtoi se erdhi koha për të rrëmbyer flamurin antiparti, sepse, sipas tij, Komiteti Qendror i Partisë sonë gaboi rëndë, u bë «antisovjetik», se fatet e socializmit në Shqipëri janë «në fill të perit» etj. dhe shpëtimtari i situatës do të ishte Koço Tashkoja. Ai nuk ka as besimin më të vogël te Partia jonë dhe te Komiteti Qendror i saj; ai vetë e tha se për mendimin e tij «udhëheqësit e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik nuk kanë asnjë gabim ndaj nesh, se ata nuk mund të gabojnë, kurse ne, sipas Koços, kemi gabuar».

Të gjitha këto pikëpamje antiparti dhe, nga ana tjetër, frika që e mbërtheu Koço Tashkon në këto situata serioze që u krijuan në lëvizjen komuniste, si rezultat i mosmarrëveshjeve të mëdha që ka midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, e shtynë atë që pas Plenumit të Komitetit Qendror të fillonte të vepronte në kundërshtim me çdo rregull partie, të vihej në rrugën antiparti. Ai pas shpinës së Komitetit Qendror dhe kundër këtij ka zhvilluar tri herë me radhë bisedime me ambasadorin sovjetik dhe punonjës të ambasadës sovjetike në Tiranë, gjatë të cilave është marrë nëpër gojë vija e Partisë sonë, është folur kundër saj. Ky është një veprim i hapur antiparti, sepse është një komplot, që një anëtar i Partisë sonë, e aq më keq një kuadër i rëndësishëm i Partisë, siç është kryetari i Komisionit të Revizionimit, e bën kundër Partisë bashkë me përfaqësues të një vendi tjetër. Ky fakt tregon se Koço Tashkoja theu rëndë edhe rregullat elementare të disiplinës e të ruaj-

tjes së sekretit të Partisë dhe vendimet e Plenumit të Komitetit Qendror, i cili në fund të punimeve të tij theksoi se çështjet që u biseduan në Plenum, nuk duhen bërë objekt bisedash me të tjerët dhe aq më shumë me të huajt.

Koço Tashkoja, duke qenë i tronditur në palcë nga situatat e krijuara dhe i ushqyer nga fryma antiparti, krijoi në kokën e tij gjithfarë legjendash e fantazish, të cilat vinin në dyshim vijën e Partisë sonë dhe tregonin se ai ka humbur besimin te Partia jonë. Ai shpiku sikur Plenumi i Korrikut i Komitetit Qendror u tregua i njëanshëm dhe mori qëndrim antisovjetik etj. Dihet mirë se Plenumi i fundit i Komitetit Qendror diskutoi dhe aprovoi vetëm një çështje: qëndrimin tonë në Mbledhjen e Bukureshtit dhe vendosi që Komiteti Qendror të përgatitej me kujdes për Mbledhjen e nëntorit të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore, ku me drejtësi marksiste-leniniste, pa *parti pris*, Partia jonë të prononcohej lidhur me mosmarrëveshjet që ekzistojnë midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës.

Duhet theksuar se, ndërsa në kokën e tij Koço Tashkoja bluante gjithfarë mendimesh, asnjëherë nuk mori mundimin që të vinte te Sekretari i Parë i Komitetit Qendror apo te ndonjë shok tjetër i Byrosë Politike, me të cilin të diskutonte çështjet që, sipas tij, e preokuponin. Ai e quajti më të nevojshme dhe më të arsyeshme të fliste për këto gjëra me ambasadorin e punonjës të tjerë sovjetikë. Dhe vetëm pas këtyre takimeve ai kërkoi të bisedojë me mua. Kjo tregon se Koço Tashkoja nuk kishte besim te Partia e tij dhe te

udhëheqësit e saj dhe se në veprimet e tij ai nisej nga qëllime të këqija, nga qëllime antiparti dhe jo siç kërkon të na bindë ai, gjoja nga qëllime të mira, si «ndërmjetës», midis Partisë sonë e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Në vetvete edhe vetë konceptet e tilla të «ndërmjetësve», janë krejt të huaja për Partinë tonë, e cila nuk njeh veçse një «ndërmjetës» dhe ky është marksizëm-leninizmi, i cili si në pasqyrë nxjerr në shesh se kush ecën në rrugë të drejtë e kush gabon.

Para se të thirrej në Byronë Politike të Komitetit Qendror, Koço Tashkoja u thirr nga shoku Hysni Kapo dhe më vonë nga unë. Duhet thënë se në të dyja rastet, e veçanërisht në takimin me shokun Hysni, ai mbajti një qëndrim jo prej komunisti po prej zotnie, një qëndrim arrogant dhe të huaj për Partinë. Në të dyja takimet, me gjithë përpjekjet e mëdha dhe të durueshme të shokëve për ta ndihmuar që të kuptonte gabimet e tij dhe shkaqet e tyre, ai u tregua shumë konfuz, inkonsekuent dhe shumë kokëfortë. Ai nuk bëri kurrfarë autokritike.

Edhe në Byronë Politike Koço Tashkoja mbajti pak a shumë të njëjtin qëndrim. Ai nuk u thellua në gabimet e tij, nuk u përpoq të reflektonte mbi gabimet dhe fajet e tij, të gjente burimet e tyre dhe të bënte autokritikë. Në fakt edhe në Byro ai nuk bëri autokritikë, megjithëse ndihma e shokëve të Byrosë qe shumë e madhe dhe shoqërore.

Burimi i gabimeve të Koço Tashkos, i veprimeve të tij antiparti janë mungesa e besimit te Partia dhe te organet udhëheqëse të saj, janë konceptet e gabuara që ka ai për Partinë, të cilën e gjykon jo si një kolektiv

luftarak, por si një rreth miqsh, janë pakënaqësitë e tij të vjetra ndaj Partisë dhe karrierizmi i tij, është tronditja e tij e thellë, frika e madhe që nuk pajtohet aspak me vendosmërinë marksiste-leniniste që duhet të karakterizojë, veçanërisht në këtë situatë, çdo komunist dhe në radhë të parë kuadrot udhëheqës të Partisë. Por Koço Tashkoja nuk do t'i njohë këto të meta, që e shtynë të gabojë aq rëndë sa të kalojë në veprime antiparti. Dëmi që ai i ka sjellë Partisë sonë është shumë i madh. Duke komplotuar në kurriz të Partisë, duke shtrembëruar përpara punonjësve të ambasadës sovjetike qëndrimet e vërteta të Partisë, duke i interpretuar ato sipas koncepteve të tij dhe fantazisë së tij, duke dekonspiruar punimet e Plenumit të Komitetit Qendror, u ka dhënë shkas sulmeve kundër vijës së Partisë sonë edhe nga ana e njerëzve që nuk janë anëtarë të Partisë sonë.

Byroja Politike e Komitetit Qendror duke e paraqitur për diskutim çështjen e Koço Tashkos i propozon Plenumit të Komitetit Qendror si dhe Komisionit të Revizionimit të Partisë që ai, për veprimtarinë e tij antiparti, për thyerjen e disiplinës, të sekretit dhe të normave organizative të Partisë, për shtrembërimin e vijës së Partisë dhe për faktin se prej kohësh ka qenë dhe është në opozicion me Partinë, të shkakohet nga funksioni i kryetarit të Komisionit të Revizionimit si dhe të përjashtohet nga radhët e këtij Komisioni.

Nuk ka dyshim se Partia jonë, ashtu si edhe vetë kjo mbledhje e përbashkët e Plenumit të Komitetit Qendror dhe e Komisionit të Revizionimit, pasi të dë-

gjojë edhe autokritikën e Koço Tashkos, do ta ndihmojë atë me ngrohtësi dhe në frymë shoqërore që të ndreqë gabimet, që t'i shërbejë mirë Partisë dhe popullit të tij.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TË RUHEMI NGA PROVOKACIONET DIJE TË MBROJMË PARTINË

*Diskutim në Plenumin XVIII të KQ të PPSH mbi
qëndrimin armiqësor dhe antiparti të Koço Tashkos*

8 shtator 1960

Plenumi me të drejtë u shpreh njëzëri për përjashtimin e Koço Tashkos nga Partia. Tani nuk ka më asnjë dyshim se kemi të bëjmë jo vetëm me një element antiparti, por dhe me një provokator, me një vegël në duart e të tjerëve për të çarë unitetin e Partisë sonë.

Koço Tashkoja nuk ka vepruar me kokën e tij. Për këtë flasin faktet. Pas bisedës që pati me mua, e këshillova të reflektonte dhe t'i jepte me shkrim mendimet e tij, me qëllim që Byroja Politike dhe Komiteti Qendror të njiheshin me këto mendime dhe të ishin në gjendje të gjykonin. Për këtë qëllim i lamë 2-3 ditë kohë që të mendonte dhe të shkruante. Po ai refuzoi duke na thënë: «Nuk kam pse të shkruaj, ato që kisha, i thashë të gjitha».

Në Byronë Politike nuk tha asgjë të re. Kurse në Plenum, megjithëse kishte refuzuar të shkruante, na

doli me diskutim të shkruar. Siç duket, «miqtë» nuk e kanë lënë në baltë. Ju e patë se diskutimi ishte përgatitur nga të tjerët¹. Kjo tregon qartë se ata (sovjetikët), duke mos pasur ku të kapen kundër Partisë sonë në vijën dhe në qëndrimet e saj të drejta, në lidhjet e saj të ngushta me leninizmin dhe me popullin sovjetik, gjetën një provokator dhe e vunë në veprim. Por ne duhet të ruheni nga provokacionet, të kemi kujdes jashtëzakonisht të madh prej tyre.

Udhëheqësit sovjetikë duan dhe punojnë që të na akuzojnë ne si antisovjetikë, prandaj të gjitha tezat e Koço Tashkos, në radhë të parë, janë tezat e tyre. Shikoni sa të poshtra janë këto qëllime trockiste, të cilat ata kërkojnë t'i vënë në veprim me anën e provokatorëve. Prandaj ne duhet të bëjmë një luftë me radhë jashtëzakonisht të shtrënguara kundër provokatorëve dhe të forcojmë unitetin.

Koço Tashkon ne e njohim kush është, prandaj ç'të flasim për të.

Por Koço Tashkoja ka marrë «sigurime» dhe kjo duket nga qëndrimet e tij. Kur e thirra unë në takim, i hyri frika në palcë, se kujtoi që do ta arrestonin, në mbledhjen e Byrosë ishte i tronditur, kurse këtu na

¹ Koço Tashko, gjatë diskutimit, pas mbarimit të një fjalie lexoi edhe shenjëën e pikësimit: «pikë». Në sallë shpërtheu gazi dhe pjesëmarrësit, menjëherë pas tij, shtuan: «toçka», që në rusisht do të thotë «pikë». Ky veprim qesharak i Koço Tashkos ishte një dëshmi e mjaftueshme për të kuptuar se teksti i diskutimit ishte diktuar nga punonjësit e ambasadës sovjetike dhe ai gjatë përkthimit ishte ngatërruar duke mos dalluar tekstin nga shenjat e pikësimit.

vjen me arrogancë, plot sharje e provokime. Ata i kanë thënë: «shko në Komitetin Qendror dhe hidhi atje këto idera të «larta», sepse mund të ketë njerëz që edhe në qoftë se nuk janë pro nesh tani, ata duhet ta njohin vijën tonë të vërtetë dhe do të reflektojnë për të ardhshmen». Ata janë gati të tatojnë pulsën e njerit dhe të tjetrit për të na përçarë. Ata do të tentojnë të na lënë edhe pa bukë. Shikoni, pra, çfarë pune të poshtër po bëjnë këta njerëz!

Shokë, çështja jonë e drejtë do të fitojë, po vështirësi kemi dhe do të kemi; këto janë të paevitueshme. Ne do të përpiqemi t'i shpëtojmë njerëzit, por njerëz si Koço Tashkoja, megjithëse edhe për këta duhet të bëjmë përpjekje t'i shpëtojmë, duhen flakur menjëherë jashtë Partisë.

Nuk ka asnjë dyshim që dhe Ivanovi me shokë nuk i bëjnë me kokën e tyre këto gjëra; këto vijnë nga lart e bile jo nga njëri e tjetri, po nga vetë Hrushovi, sepse deri edhe për drithin që duhet t'i jepet Shqipërisë, duhet të urdhërojë Hrushovi, megjithëse ne e marrim me para në dorë.

Ne duhet të mbajmë gjakftohtësinë, duke ditur se këta njerëz duan ta dëmtojnë miqësinë tonë me popujt e Bashkimit Sovjetik, por ajo nuk do të dëmtohet, dallgë do të ketë, po komunistët shqiptarë dhe komunistët internacionalistë në Bashkimin Sovjetik do t'i kapërcejnë ato. Prandaj të ruajmë unitetin e Partisë si sytë e ballit, të jemi vigjilentë, kundër çdo orvatjeje të jepet grushti i menjëhershëm dhe ta ruajmë miqësinë me popujt e Bashkimit Sovjetik. Të propagandohet për këtë si gjithnjë në popull.

Me këtë nuk dua të them të mos flasim kundër qëndrimeve revizioniste të udhëheqësve sovjetikë, se do të vijë koha që edhe hapur të flasim, por çdo gjë në kohën e vet. Të ruhemi nga provokacionet dhe të forcojmë Partinë!

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Plenu-
mit XVIII të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË VENDOSËT NË ÇDO SEKTOR KONTROLLI I PARTISË DHE DISIPLINA E FORTË PËR ÇËSHTJET E NAFTËS

Fjala në takimin me një grup përfaqësuesish të kolektivit punonjës të kombinatit të naftës «Stalin»

13 shtator 1960

Pasi takohen e zënë vend shokët e grupit përfaqësues të kolektivit punonjës të kombinatit të naftës «Stalin» dhe pasi informojnë për realizimin e planit dhe për gjendjen e kërkimeve të burimeve të reja të naftës, e mori fjalën shoku Enver Hoxha, i cili tha:

Ju falenderoj shumë për informacionin që më dhatë dhe ju përgëzoj nga zemra për punën që keni bërë e për zotimet e reja që merrni! Ne jemi të bindur se ju do ta realizoni zotimin që keni marrë për tejkalimin e planit me 20 mijë tonë. Megjithatë, unë mendoj, siç thatë edhe ju, se do ta tejkaloni edhe këtë zotim, gjë që do të thotë se ju akoma ruani mjaft rezerva.

Ju duhet ta shikoni çështjen e naftës në kuadrin e gjithë ekonomisë së vendit tonë. Sipas llogarive që bëjmë ne, del se nafta është rentabël, por në bazë të

nevojave që ka shteti ynë ne duhet të prodhojmë më shumë naftë, sepse kemi kaq kohë që bëjmë kërkime. Po të kishim punuar më me kujdes, do të ishte e mundur ta rritnim edhe më tepër sasinë e naftës këtë pesëvjeçar.

Mirëpo puna në naftë nuk është e lehtë, bile është shumë delikate. Kjo varet nga të gjithë sektorët e naftës e në radhë të parë nga studimet gjeologjike. Prandaj, Byroja Politike, që e ka marrë këtë çështje në studim, ka konkluduar se ka pasur neglizhenca nga drejtuesit e gjeologjisë në studimin e në dhënien e pikave si dhe një përgatitje jo të kujdesshme nga gjeologët. Kjo natyrisht ka bërë që edhe të holla të kemi harxhuar shumë, edhe të dhënat për shpim-shfrytëzimin t'i kemi më të pakta. Prandaj u kemi rekomanduar atyre të mos hapen si vaji në lakra, por t'i hedhin hapat sipas të dhënave dhe të shpojnë atje ku sigurohemi në një përqindje të madhe se puna që bëjmë, do të na japë naftë.

Sigurisht, këtu kemi të bëjmë me nëntokën, me gjëra që nuk i shohim, por shkenca sot ka nxjerrë metoda që, po të zbatohen e të studjohen në rregull shtresat e nëntokës, arrihet në atë që të japësh sigurim për të nxjerrë naftë në një përqindje të madhe. Kjo ka shumë rëndësi se na lejon të diktojmë ku gjendet nafta. Por shokët e gjeologjisë nuk i kanë zbatuar si duhet të gjitha metodat për zbulimin e naftës, ata kanë neglizhuar, kanë mbetur në rajone të ngushta dhe kanë menduar aproksimativisht se punimet duhet të shtrihen edhe në sipërfaqe të tjera. Kështu nuk janë përcaktuar si duhet shtresat, strukturat.

Po të mos i përcaktojmë drejt këto gjëra mund të kemi humbje. Prandaj ka rëndësi çështja që qysh nga drejtuesit e ndërmarrjeve të naftës e deri në ministri t'i kushtohet kujdes studimit të strukturave të përgjithshme e pastaj edhe atyre të veçanta, të çdo pusi. Kudo duhet të bëhet metodë pune studimi për të vërtetuar strukturat e pastaj të shpojme. Kjo është e para. E dyta, është çështja e studimit të mirë të karotazheve, të kampioneve dhe kjo të bëhet jo vetëm nga ata që rrinë mbi kokë të puseve, por edhe nga grupet e studimit të kombinatit. Edhe aty është si puna e të sëmurit, të cilit mjeku mund t'ia përcaktojë diagnozën, por rëndësi ka që t'i japë edhe ilaçin e duhur dhe ta ndjekë atë derisa të shërohet.

Körkimet gjeologjike tregojnë se ka naftë, por duhet ta gjesh ku është, pastaj të ndiqen edhe studimet e karotazhit me kujdesin më të madh dhe të zbatohen të gjitha normat shkencore në studimin e karotazheve, që, kur të vijë puna për të bombarduar, bombardimi të bëhet atje ku duhet, me precizionin më të madh. Kur bëhet qitje, edhe ushtarakët bëjnë gabime, nuk qëllojnë kurdoherë në shenjë, disa i hedhin predhat më lart, disa më poshtë. Ca më keq është kur goditja bëhet në një vend që nuk e sheh, siç është nëntoka. Aty po të mos bëhen matjet e duhura, nga neglizhenca më e vogël, pusi mund të të bllokohet. Në këto drejtime duhet bërë shumë kujdes që atje ku të shpojme, të gjejmë dhe të marrim naftë.

Ju, punonjësit e Kombinatit të Naftës, keni arritur suksese në punë; për të metat dhe vështirësitë Partia ka marrë masa dhe ju ka ndihmuar. Sidoqoftë, në

përgjithësi mund të themi se puna juaj ka qenë e kënaqshme, veçanërisht puna e mjeshtërive, e inxhinierëve, e punëtorëve. Ju duhet të keni parasysh që vazhdimisht të mësoni, jo vetëm zanatin e thjeshtë, për shembull, si ta përforconi si duhet këtë zanat ose si të zotëroni sondën, por të mësoni edhe që të mos jeni të huaj në lidhje me atë që shponi, duke mësuar nga gjeologët, inxhinierët e teknikët me të cilët jeni në kontakt të vazhdueshëm. Duke qëndruar afër tyre ju duhet të kuptoni atje çdo gjë, në mos sa ata, të paktën të jeni në gjendje të kuptoni vlerësimin që i bëhet nga ana e tyre materialit që jep nëntoka. Pra, ti, shoku naftëtar, nuk duhet të jesh vetëm nxjerrës i thjeshtë i naftës, por edhe një ndihmës i gjeologut ose i inxhinierit në studimin e këtyre materialeve. Të vepronit ashtu si duhet të bëjë edhe traktoristi, aftësia e të cilit nuk qëndron vetëm në punimin e tokës 20 ose 25 centimetra thellë, por të dijë edhe arsyet përse duhet punuar kaq thellë, ç'dëme i sjell bimës një punim në kundërshtim me rregullat e shkencës agroteknike etj. Pra, nuk duhet të jeni të huaj në lidhje me vlerësimin e këtyre çështjeve. Unë jam i bindur se, po të kujdeseni siç duhet për këtë çështje, ju do t'u vini në ndihmë gjeologëve me këshillat tuaja të vlefshme. Prandaj duhet t'i zgjeroni njohuritë tuaja që edhe për problemet e vështira ta thoni fjalën e mendimin tuaj me kompetencë.

Ju, mjeshtrit, që jeni të lidhur drejtpërdrejt me makineritë, me sondat, me vështirësitë e punës dhe me aplikimin e rregullave, duhet të jeni shembull për të gjithë edhe për ata më lart. Të jeni të disiplinuar,

studjozë e skrupulozë në punë dhe jo liberalë e të përciptë në mendimin dhe në verifikimin e çështjeve. Në qoftë se ti neglizhon makinerinë, kjo nuk ecën. Duhet të mbash një regjim rigoroz të makinerisë, që ajo të punojë mirë, të mos ketë avari, të shfrytëzohet sa më shumë etj. Kjo varet nga kujdesi, nga disiplina, nga regjimi, nga fryma komuniste në punë. Edhe inxhinierët ose gjeologët duhet të kenë një disiplinë të tillë në punë, në studimin dhe në vlerësimin e çështjeve. Në këtë mënyrë duhet të punojë kolektivi juaj, ju duhet të jeni të parët që të jepni shembullin në të gjitha këto çështje të rëndësishme.

Ne nuk themi se të gjithë inxhinierët dhe gjeologët janë liberalë e nuk i vihen punës, apo nuk punojnë rregullisht. Por te ata mund të ketë frymë lëshimesh. Për shembull, ka raste kur inxhinieri vjen pak me vonesë në punë, studimin mund të mos e bëjë në kohën e duhur etj., ndaj ju, si mjeshtër që jeni më të lidhur me veglat, me makinat, me sondat, duhet të jepni shembullin që të zhduket fryma e lëshimeve.

Zbatimi i shumë studimeve për çështjet e naftës është neglizhuar krejtësisht nga grupet e gjeologjisë, mjaft studime bëhen dhe futen në dollap. Prandaj ata që janë caktuar për këto gjëra të mos i harrojnë, por t'i studjojnë me kujdes të madh. Nuk është shaka të mbyllet një pus, se kushton shumë shtrenjtë dhe, kur nuk del me sukses, duhet të na vrasë ndërgjegjja, sepse nuk kemi bërë sa duhet dhe kemi neglizhuar.

Prandaj kujdes duhet të ketë nga drejtorja, nga ministria, nga inxhinierët, nga gjeologët dhe të vendoset një kontroll i fortë edhe nga Partia, kontroll i

mbështetur në zgjuarsi dhe kompetencë. Dhe kur them Partia, domethënë nga të gjithë ju e jo vetëm nga komiteti i Partisë. Komiteti i Partisë jep udhëzime, por kontrolli i përket gjithë Partisë, gjithë anëtarëve të saj, kudo që punojnë. Prandaj, duhet të vendoset në çdo sektor disiplinë e fortë për çështjen e naftës, se nafta kërkon precizion. Sidoqoftë, detyrat që janë caktuar për nxjerrjen e naftës këtë vit ju do t'i plotësoni dhe jeni zotuar edhe t'i tejkaloni.

Këto zotime përpquni t'i tejkaloni se duhet pasur parasysh që viti bujqësor ka qenë aq i keq për prodhimin e drithërave, sa nuk do të marrim as gjysmën e prodhimit të planifikuar. Edhe në kulturat e tjera si panxhari, ullinjtë etj. nuk jemi mirë. Pambuku mund të realizohet, por të tjerat nuk po na ecin. Këta tre vjetët e fundit nuk na ka favorizuar koha dhe thatësira e këtij viti na ka shtuar akoma më tepër vështirësitë. Kini parasysh se kemi sjellë dhe do të sjellim bukë nga jashtë me klering, domethënë me naftë e me prodhime të tjera. Prandaj, duke e parë çështjen në këtë prizëm, unë jam i bindur që ju jo vetëm do t'i realizoni zotimet, por duhet të bëni përpjekje që edhe t'i tejkaloni ato. Ju duhet të tejkaloni edhe zërat e tjerë, si uljen e kostos, rendimentin, ekonomizimin e makinerive, pa kërkuar nga importi.

Problemin e importit ta shikoni në prizmin e gjithë shtetit. Kjo nuk do të thotë të lëmë naftën pa makineri ose pa mjete që duhen për realizimin e planit, por varet shumë nga kërkesat që hartoni ju. Ju mund të thoni se ju duhen 10 mijë bulona, por duhet pasur parasysh të bëjmë ekonomi, se ato blihen me rubla

ose dollarë. Prandaj bëni kërkesa minimale, ato më të domosdoshmet. Mjetet që keni, i ruani e i shfrytëzoni derisa të dalin krejtësisht jashtë përdorimit, mos bëni kërkesa jashtë normave dhe pa i parë ato në mënyrë shumë të shtrënguar. Fakti është se deri tani ju e konsideroni si sukses që keni ekonomizuar 13 milion rubla nga importi, po mendoni se kishit kërkuar 13 milion më shumë dhe kjo nuk është një gjë e mirë për ju dhe për ekonominë tonë. Prandaj, në të gjitha drejtimit, bëni përpjekje që të realizoni dhe të tejkaloni planin.

Perspektiva e naftës është e mirë dhe mendojmë se te ne ka naftë. Të gjitha këto shpenzime që po bëhen, do të japin me siguri frytet që presim, por kjo çështje varet edhe nga investimet që do të bëjmë, të cilat tani duhet t'i kemi shumë të kufizuara, sepse për naftën kemi investuar mjaft. Prandaj, me këto sa kemi bërë, ne duhet të arrijmë shifrat që kemi caktuar për pesëvjeçarin e tretë.

Pastaj, duhet të vazhdojnë më tej kërkimet për sigurimin e vendburimeve të reja të naftës. Për këtë qëllim ne kemi dhënë fonde, por duhet të shkojmë me llogari, se kemi shumë nevoja. Te ne sektori i naftës është i ri. Specialistët na këshillojnë të kemi durim dhe shpresë, sepse zona ku bëhen kërkimet është naf-tëmbajtëse. Sipas këshillave të tyre punimet duhet t'i vazhdojmë nga... Ato që thanë ju këtu tregojnë se atje ka naftë, prandaj të mos na alarmojë çështja se atje na doli një pus me ujë.

Naftë, pra, ne do të kemi, por drejtorja dhe organizata e Partisë te ju duhet t'i kushtojnë kujdes të madh

pregatitjes së kuadrove. Nuk mund të themi se kemi kuadro me bollëk, por tani ne kemi grupe kuadrosh me eksperiencë, që mund t'u besosh plotësisht punë jo të lehta dhe që mund t'i kryejnë si duhet detyrat që u ngarkohen. Në këtë çështje duhet punuar në dy drejtime. Shokët që kanë arritur pjekuri dhe kanë grumbulluar eksperiencë në nxjerrjen e naftës, e kam fjalën për mjeshtrit, duhet t'i rritin njohuritë e tyre teknike dhe teorike, ata duhet të bëhen kuadro të lartë në një të ardhshme jo të largët. Ne do të përgatitim gjeologë e inxhinierë të rinj në universitet nga ata që mbarojnë gjimnazet dhe teknikumet, por këtyre do t'u duhet një punë e madhe dhe kohë e gjatë që të zotërojnë praktikën, kurse ju që e keni këtë, duhet të bëni përpjekje të mësoni teorinë. Inxhinierëve të rinj të mos u rritet mendja, po t'i përvishen punës dhe, në bashkëpunim të ngushtë me specialistët e tjerë, të fitojnë eksperiencën në praktikë. Në këtë drejtim ju duhet të udhëzoni e të ndihmoni brezin e ri që mbaron shkollat.

Situata politike është e mirë. Sot ju vini re se një numër i madh shtetesh si në Afrikë, që deri dje ishin nën sundimin imperialist, po shkëputen dhe fitojnë pavarësinë shtetërore, ndërsa në Amerikën Latine lëvizja përparimtare kundër imperializmit amerikan po forcohet. Në ato vende ku ekzistonin më parë qeveri ultrareaksionare populli po ngrihet e bën demonstrata dhe i rrëzon këto qeveri. Të gjitha këto janë shenja të kalbëzimit të imperializmit.

Por kjo nuk do të thotë se imperializmi ka hedhur armët. Ai përgatitet të kafshojë, është agresiv, ai ka akoma bazë ekonomike për të bërë luftëra, në shumë

vende ekzistojnë gjithashtu rryma ultrareaksionare që kërkojnë luftë. Derisa ekzistojnë këta faktorë imperialistët mund të futen edhe në aventura. Për këtë qëllim ata po armatosen dita-ditës, po a do të arrijnë ta bëjnë luftën apo jo, kjo varet nga forca, vigjilenca dhe lufta jonë për paqe, nga mobilizimi i të gjithë popujve për t'i vënë fre imperializmit. Imperialistët kanë për qëllim të hedhin botën në zjarr, kurse qëllimi dhe lufta jonë është e kundërta, t'i çarmatosim ata dhe të vendosim paqen.

Imperializmi bën të gjitha përpjekjet për të pasur prapavijat e tij të qeta, që të ruajë sundimin e vet, ndryshe nuk mund të futet në aventura, domethënë ai kërkon të shtypë çdo lëvizje përparimtare brenda vendit, të shuajë luftën e klasës duke shtypur kështu partitë komuniste dhe ta mbajë klasën punëtore nën një zgjedhë të egër, që të mos mund të ngrihet për të goditur bazat ekonomike të imperializmit, që e ka militarizuar ekonominë për qëllime luftarake. Imperializmi dëshiron dhe lufton që klasa punëtore e Francës, e Italisë, e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe e vendeve të tjera të mos hidhet në revolucion.

Kurse kampi ynë i socializmit dhe lëvizja komuniste ndërkombëtare duhet të luftojnë për ta çarmatosur imperializmin, për ta dobësuar bazën e tij ekonomike. Për këtë qëllim komunizmi ndërkombëtar, partitë komuniste, klasa punëtore në vendet kapitaliste, duhet të mos rrinë duarkryq, por të organizojnë lëvizjen që të vijë duke u rritur për t'i shkëputur armikut me forcë të drejtat e tyre, për të penguar shpërthimin e luftës, sepse sigurimi i paqes nuk arrihet vetëm me

fjalë. Një parti komuniste nuk duhet të thotë vetëm me fjalë «rroftë paqja!», ajo duhet të sabotojë përgatitjet për luftë të imperializmit, të organizojë greva, të kërkojë jo vetëm me fjalë, por të arrijë, me aksione revolucionare, ngritjen e pagave të punëtorëve, sepse vetëm me luftë të pandërprerë dëmtohet imperializmi.

Imperializmi lufton që të dobësohet kampi ynë, se ai është mburoja kryesore e paqes, kurse ne duhet të luftojmë ta forcojmë kampin tonë. Kampi ynë do të jetë i fortë, vetëm kur të ketë unitet të plotë ideologjik, politik, ekonomik midis vendeve tona, unitet që imperializmi me të gjitha mënyrat kërkon ta shthurë. Imperializmi përpiqet gjithashtu të shthurë unitetin tonë edhe me anën e agjentëve të tij.

Në Deklaratën e Moskës theksohet shumë drejt se revizionizmi është sot armiku kryesor i lëvizjes komuniste ndërkombëtare, për çështjen e socializmit dhe të komunizmit, për unitetin e lëvizjes komuniste e punëtorë ndërkombëtare. Prandaj kundër çdo shfaqjeje revizionizmi të gjitha partitë komuniste dhe punëtorë duhet të jenë vigjilente, të luftojnë pa asnjë lëshim. Revizionizmi lind kurdoherë atje ku ekzistojnë tendencat zbutjeje të luftës së klasave nga të cilat përfiton imperializmi. Imperializmi dhe agjencia e tij ideologjike punojnë për të zhvilluar tendencat e zbutjes së luftës së klasave në vendet tona, për të trubulluar këkën e njerëzve, duke propaganduar se «tani është qetësi e madhe, po shkojmë drejt paqes, prandaj nuk duhet të kemi frikë», pra ta ulim vigjilencën. Zbutja e luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit bën që të përhapen edhe konceptet e qëndrimit liberale që

janë shumë të rrezikshme për fatet e socializmit. Ne nuk kemi frikë prej tyre, por tendencat që zhvillon revizionizmi janë jashtëzakonisht të dëmshme dhe të rrezikshme në një kohë kur imperializmi armatoset për të goditur kampin tonë.

Të rrezikshme janë edhe dogmatizmi, sektarizmi dhe sëmundje të tjera, por rrezik kryesor është revizionizmi. Revizionistët përpiqen që vigjilenca revolucionare e partive komuniste dhe punëtorë të shuhet dhe që lufta për demaskimin ideologjik e politik të imperialistëve e të revizionistëve të pushojë. Ata njerëz ose ato parti që tregohen vigjilentë kundër tyre, revizionistët i akuzojnë si sektarë ose dogmatikë.

Ç'do të thotë të jesh sektar ose dogmatik? Disa e akuzojnë Partinë tonë si sektare, sepse ajo mban qëndrime të ashpra kundër revizionistëve jugosllavë. Partia jonë nuk është sektare, ajo udhëhiqet si kurdoherë nga një vijë e drejtë marksiste-leniniste. Ne e dimë shumë mirë dhe shumë më mirë nga ata që e akuzojnë Partinë tonë, se ç'rrezik sjell revizionizmi. Këtë e kemi parë në fytyrën e tradhtarëve të marksizëm-leninizmit që bëjnë ligjin në Beograd. Prandaj, këshilla që na japin, që të mos demaskohen ata në sytë e popujve, është një krim i madh për komunizmin ndërkombëtar.

Të jesh sektar do të thotë të jesh i shkëputur nga populli, të frenosh ndërtimin e socializmit. Ekziston një sëmundje e tillë në Partinë tonë? Jo! Në ka parti të lidhur ngushtë me masat e popullit është Partia jonë. Partia jonë në asnjë mënyrë nuk e ka frenuar hovin revolucionar të masave në vendin tonë, ky hov tani është më i madh se kurdoherë tjetër. Të gjitha

partitë motra; kanë pohuar shumë herë me plot gojën se Partia e Punës e Shqipërisë ka pasur dhe ka një vijë të drejtë marksiste-leniniste.

Por tani ka disa gjëra që nuk ecin si duhet në vendet tona. Në Bukuresht Partia jonë mbajti një qëndrim të drejtë marksist-leninist, në lidhje me PK të Kinës që u akuzua si dogmatike. Në qoftë se PK e Kinës paska bërë gabime, ato le të gjykoen brenda normave organizative leniniste e jo të gjykoet brenda disa orëve një parti e madhe që ka luftuar 26 vjet me armë kundër reaksionit të brendshëm dhe imperializmit dhe tani po e çon popullin kinez me sukses në socializëm. Një gjë e tillë nuk mund dhe nuk duhet të bëhet. Për të gjykuar një parti duhen zbatuar normat organizative, ashtu sikurse na mëson Lenini, prandaj t'i jepet edhe PK të Kinës e drejta të mendojë dhe të flasë, se ka edhe ajo mendimet e veta për të thënë.

Partia Komuniste e Kinës nuk mund të akuzohet se gjoja do luftë. Si dëshiroka Kina luftën?! E doni ju luftën? Jo! E duam ne luftën? Në asnjë mënyrë! Ne u vramë e u dogjëm, prandaj jemi kundër luftës. Por që ta fitojmë paqen, duhet të mos i bëhen koncesione as imperializmit e as revizionizmit, duhet të mbështetim luftërat e drejta të popujve dhe me forcat tona kolosale të arrijmë të vendosim paqen.

Si të mos jetë Kina për bashkekzistencën? Këtë ajo kurdoherë e ka thënë, por ka edhe ajo për të thënë fjalën e vet se si zbatohet kjo bashkekzistencë paqësore nga disa parti. Prandaj për qëndrimet dhe pikëpamjet e veta ajo nuk mund të gjykoet brenda disa orëve. Edhe për një komunist të thjeshtë në organiza-

tën-bazë çështja diskutohet me kujdes dhe jo kështu si deshi të bënte Hrushovi në Bukuresht për PK të Kinës.

Qëndrimi i Partisë sonë në Mbledhjen e Bukureshtit ishte i drejtë. Atje disave nuk u erdhi mirë, por sa më shumë kohë që kalon, aq më tepër duket drejtësia e këtij qëndrimi. Disa parti, grupe dhe organizata të tëra nuk janë dakord me qëndrimin e udhëheqjes së tyre në Mbledhjen e Bukureshtit. Në organizatat-bazë të partisë në disa kryeqytete të vendeve socialiste, bile, flitet se Partia e Punës e Shqipërisë ka të drejtë në qëndrimin e saj. Kështu që ne mendojmë se, sa më tepër kalon koha, aq më mirë do të reflektojnë njerëzit, sepse kjo nuk është një gjë e vogël. Këtu kemi të bëjmë me qenien ose jo në kampin tonë socialist të një vendi prej 650 milion njerëzish. Imperialistët dhe revizionistët duan që ne të përçahemi. Por ne nuk duhet ta lejojmë këtë. Këto çështje duhen zgjidhur në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Partitë tona do t'i diskutojnë këto në nëntor dhe Partia jonë do ta thotë pikëpamjen e vet të matur, marksiste-leniniste. Ne mendojmë se edhe partitë e tjera do të arrijnë në konkluzione të drejta për forcimin e unitetit të kampit tonë socialist se kjo është një çështje që ka rëndësi shumë të madhe për komunizmin ndërkombëtar. Kur u krijua Bashkimi Sovjetik, u vendos e para diktaturë e proletariatit në botë. Me vendosjen e diktaturës së proletariatit edhe në një sërë vendesh të tjera u krijua kampi socialist, që do të shpejtojë triumfin e socializmit dhe të komunizmit. Epoka jonë është epoka e triumfit të socializmit dhe të komunizmit, por kjo kërkon që

diktatura e proletariatit të vazhdojë të forcohet mbi bazat e çeliktë të marksizëm-leninizmit. Në këtë situatë, pra, imperializmi dhe revizionizmi përdorin çdo mjet për të na përçarë, por ne duhet të luftojmë që të gjitha përpjekjet e tyre të dështojnë.

Në këto situata të vështira Partia duhet të jetë e zgjuar dhe vigjilente; të forcohen uniteti i çeliktë i Partisë rreth Komitetit Qendror dhe uniteti i popullit tonë rreth Partisë. Kjo është detyra jonë kryesore. Po patëm Partinë kështu si e kemi, të çeliktë, monolite, nuk do të ketë forcë që të shkaktojë të çarën më të vogël në unitetin tonë Parti-popull dhe ndërtimi i socializmit në vendin tonë do të ecë me ritme akoma më të shpejta.

Ne Partinë e kemi të mrekullueshme. Qëndrimin e delegacionit të Partisë sonë në Mbledhjen e Bukureshtit e aprovoi unanimisht e gjithë Partia jonë. Natyrisht, kur ndodhin gjëra të tilla, ka edhe lëkundje të mëdha, po lëkundje të tilla në Partinë tonë nuk ka. Vetëm dy veta dolën kundër këtij qëndrimi, Liri Belishova dhe Koço Tashkoja.

Liri Belishova u lëkund në drejtësinë e vijës së Partisë; ajo nuk ishte dakord me qëndrimin e delegacionit të Partisë sonë në Mbledhjen e Bukureshtit. Po pse mbajti këtë qëndrim ajo? Një qëndrim i tillë erdhi nga shumë të meta subjektive të saj. Lirisë iu rrit mendja, ajo kishte të meta serioze personale. Në radhë të parë ishte arrogante e madhe ndaj kuadrove dhe mbivlerësonte veten e saj. Shumë herë ne e kishim kritikuar se nuk i trajtonte mirë kuadrot. I ishte rritur shumë mendja, sepse edhe disa nga udhëheqësit sovje-

tikë, me qëllime të caktuara, i bënë asaj mjaft lajka. Nga të gjitha këto ajo mendoi se erdhi koha që të shtronte haptazi pikëpamjet që i kishte sugjeruar udhëheqja hrushoviane se gjoja qëndrimi i Partisë sonë dhe i Komitetit Qendror të saj në këto situata nuk ishte i drejtë, prandaj, sipas saj, duhej mbajtur menjëherë qëndrim duke marrë anën e PK të BS, pa e gjykuar thellë çështjen.

Me disa veprime që u bënë kohët e fundit nga udhëheqësit e PK të BS ne nuk jemi dakord. Ne jemi komunistë, ti ke mendimin tënd dhe unë mendimin tim, ti e ke të drejtën ta thuash mendimin tënd, po këtë të drejtë marksizëm-leninizmi ma jep edhe mua që jam i vogël. Atëherë përse të armiqësohemi ne? Kështu duhet të ndodhë edhe në marrëdhëniet ndërmjet partive. Ne themi që çështja e PK të Kinës nga ana e sovjetikëve nuk u shtrua drejt. Duhet t'u jepet mundësi përfaqësuesve të saj dhe të partive të tjera të thonë pikëpamjen e tyre. Partia jonë ka të drejtë ta thotë këtë mendim. Prandaj askush nuk ka ç'të thotë për ato që rekomandoi Partia jonë në Bukuresht.

Partia jonë ka bërë dhe përçapje të tjera pas Mbledhjes së Bukureshtit. Ajo u ka rekomanduar edhe PK të BRSS edhe PK të Kinës që të bisedojnë së bashku. Mendojmë se udhëheqja e PK të BRSS ka bërë gabim që për mosmarrëveshjet që kishte me PK të Kinës nuk kërkoi të bisedoheshin dhe të zgjidheshin më përpara në mes të dy partive. Ato çështje që nuk do të ishte e mundur të zgjidheshin në mes të dy partive, të shtroheshin në një mbledhje të të gjitha partive.

Por, për të fshehur gabimet dhe mospajtimin me

vijën e Partisë sonë, Liri Belishova dhe Koço Tashkoja menduan se çështja është delikate, prandaj «të shpejtojmë të marrim flamurin e prosovjetizmit duke deklaruar se ne nuk jemi dakord me Komitetin Qendror» dhe vepruan. Por Komiteti Qendror nuk lejoi të futen kunja në unitetin e Partisë, sidomos në këto momente vendimtare për lëvizjen punëtore ndërkombëtare.

Lufta kundër revizionizmit duhet të jetë mjaft e ashpër, e zgjuar dhe konsekuente dhe Partia jonë këtë luftë ka bërë. Luftën e Partisë sonë kundër revizionizmit e njohin dhe e çmojnë shumë parti motra. Sot ka disa parti që kanë hequr dorë fare nga kjo luftë, mirëpo nga kjo rrjedhin gjëra të papëlqyera. Kështu ka ndodhur në Bullgari, ku është botuar një hartë e Ballkanit, ku Shqipëria paraqitet si pjesë e Jugosllavisë. Duhet parë përse ndodhin atje gjëra të tilla? Këto ndodhin ngaqë atje është shuar lufta kundër revizionizmit. Revizionistët atje kanë mundur të mblidhen e të liva-dhisin si të duan dhe të arrijnë derisa të shtypet edhe një hartë e tillë. Dhe kur Komiteti Qendror i Partisë sonë protestoi për këtë çështje, ata na dhanë të drejtë që jemi indinjuar për këtë gabim dhe deklaruan se do të përpiqen t'i zbulojnë fajtorët. Mirë, ta zëmë se kjo do të bëhet, por puna është pse ndodhin këto «gabime» tani e nuk kanë ndodhur më parë?! Sigurisht kjo ka ndodhur se atje është dobësuar vigjilenca kundër revizionistëve. Kështu mund të thuhet edhe për gjëra të tjera.

Ne kemi parë ç'bënë revizionistët jugosllavë kur u dobësua vigjilenca në Hungari dhe ç'deshën ata të bënin në Shqipëri, kurse, nga ana tjetër, udhëheqësit

sovjetikë na thonë mos flitni kundër revizionistëve jugosllavë se u rritet mendja. Po të të thotë dikush që je tradhtar, je antimarksist, të duket sikur të përpin dhe dhe jo të të rritet mendja. Prandaj ne mendojmë se revizionistët duhen demaskuar për çdo veprimtari të tyre, ashtu sikurse bënte Lenini.

Partia jonë është e fortë dhe nuk është më një parti e re. Ajo tani ka gati 20 vjet jetë, por ama 20 vjet luftë. Partia jonë nuk e ka gjetur sofrën të shtruar, ajo e ka filluar nga buka e kripa dhe ka qëndruar këta 16 vjetët e pasçlirimit sy hapur nga të katër anët se mos na gllabëronin imperialistët amerikano-anglezë dhe monarko-fashistët grekë, revizionistët jugosllavë, neo-fashistët italianë. Kjo situatë e bëri Partinë tonë të fortë, vigjilente dhe të aftë për të parë të gjitha manovrat politike e ideologjike të armiqve tanë si në radar dhe jo vetëm t'i shohë gabimet kur bëhen, por edhe të mos gabojë kur gjykon përse i bëjnë armiqtë ato veprime.

Revizionistët jugosllavë i kanë bërë dëme të mëdha Partisë sonë, por lufta e pandërprerë kundër tyre na ka bërë të mprehim vigjilencën. Ne kemi mësuar shumë nga lufta kundër tyre, kurse ka të tjerë që kanë fjetur dhe, po fjete, revizionistët ta hedhin.

Ne kemi besim se të gjitha këto çështje do të zgjidhen, sepse asnjë gjë e shtrembër nuk mund t'i rezistojë drejtësisë së marksizëm-leninizmit. Nganjëherë ne hasim në vështirësi, na dalin përpara pengesa, por marksizëm-leninizmi i eliminon ato. Nuk mund të qëndrosh mbi dy karrige, po të jesh marksist; po të kesh një vijë të shtrembër me siguri që 100 pozicione ideologjike dhe politike do të mbash, se nuk di ku ke kokën. Kurse, po

e mbajte drejt vijën, nuk ka as kështu, as ashtu, nuk ke as shqetësime. Anëtarët e Partisë sonë nuk kanë shqetësime, se të gjithë janë të bindur që ne ecim drejt; ndërsa në partitë e tjera nuk është kështu.

Të marrim, për shembull, Hungarinë. Atje, megjithëse situata tani është më e mirë se përpara, prapë ka shqetësime, sepse gjithë ai kundërrevolucion që ndodhi, gjithë ato forca reaksionare, ndarja e partisë në grupe të ndryshme (disa thoshin se partia kishte të drejtë, disa jo, një pjesë e quanin atë sektarë, një pjesë se ishte centriste etj.), të gjitha këto, krijuan vështirësi, pasojat e të cilave po ndihen edhe sot. Edhe në Poloni po kështu, kurse në Partinë tonë nuk kanë ndodhur gjëra të tilla; sepse ajo lufton me konsekuencë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit.

Prandaj, ta ruajmë unitetin e Partisë sonë dhe të realizojmë planet se kjo është një çështje me rëndësi të madhe. Ne do të dalim përpara Kongresit të Partisë me plan të realizuar. Vetëm bujqësinë kemi prapa dhe atje kemi akoma mjaft të meta, por ka influencuar shumë edhe koha. Me gjithë situatat e vështira detyrat e caktuara nga Kongresi III i Partisë në industri do të kapërcehen, kurse në bujqësi jo. Plani ynë ekonomik do të realizohet në industri dhe në Kongresin IV të Partisë do të shkojmë me plot suksese. Plani i ardhshëm është akoma më i madh dhe shumë i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë, të bujqësisë, të kulturës etj. Investime kolosale do të bëhen në planin e ardhshëm, rritjet në përqindje, në krahasim me këtë pesëvjeçar, do të jenë shumë të mëdha.

Prandaj, shokë, edhe ju duhet të mobilizoni të gji-

tha forcat për nxjerrjen e naftës, se është një prodhim shumë i rëndësishëm për ekonominë, për industrinë tonë. Atje ne kemi punëtorë të lavdishëm dhe kuadro me eksperiencë, atje kemi organizatën e Partisë të gatshme për të kryer çdo detyrë.

Edhe një herë ju falenderoj dhe ju uroj nga zemra suksese të reja të mëtejshme, të dilni faqebardhë me zotimet dhe të arrini të merrni flamurin e Kongresit IV të Partisë!

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbajtur në këtë ta-
kim që gjendet në AQP*

R A D I O G R A M

SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK¹

20 shtator 1960

I dashur Mehmet,

1) Andej nga e di ti, morëm një material të nreku-luëshëm, por fatkeqësisht s'mund ta dërgojmë ta këndosh, se je larg. Por mjaft që e lexuam ne që ty të të zhduket çdo mërzi nga mizerjet e Nju-Jorkut. Materiali është i atillë sikur ta kemi shkruar vetë. Besoj se shpjegimet janë të mjafta që çdo gjë atje të të duket mizë.

2) Për çdo propozim të ri që mund të bëhet në OKB, por që sipas mendimit tënd nuk është në rregull, jo vetëm politikisht, por edhe ideologjikisht, jo vetëm me efekt imediat, por edhe me efekt të largët, mos u ngut të japësh aprovimin e menjëhershëm, gjoja për të mos u ndarë nga «tufa». Prandaj, siç kemi vendosur, na vur edhe ne në korent, pse mundet për eventualitet politik të rreshtohemi, por njëkohësisht t'u pa-

¹ Shoku Mehmet Shehu, Kryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH kishte shkuar në Nju-Jork për të marrë pjesë në punimet e sesionit të 15-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

rashtrosh «miqve» vërejtjet tona me gojë dhe me shkrim.

3) Përsa u përket fjalimeve të tua zyrtare, duke ruajtur kurdoherë formën diplomatike dhe pavarësisht se të tjerët mund ta zbutin, zëri të tëra kyçet, kundër imperializmit amerikan e të tjera e të tjera. Kështu që askush dhe në asnjë kohë të mos guxojë të na akuzojë për zbutje. Të tjerat i di vetë. Këtëj çdo gjë është shumë në rregull. Po përgatitim vajtjen e delegacionit në Moskë.

Shumë të fala

*S h p a t i*¹

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

1. Një nga pseudonimet e shokut Enver Hoxha gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

R A D I O G R A M

SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK

23 shtator 1960

Shoku Mehmet,

Radiogramet i marrim, vazhdoni të na dërgoni se janë «zbavitëse».

1) Delegacioni zyrtar gjerman e shtyu ardhjen e tij për një datë të pacaktuar. Jep arsye, por që s'pijnë ujë. Arsyet janë ato që dimë.

2) Me ata që të tregohen të afruar dhe që s'kanë ndryshuar qëndrim ndaj nesh, afrohu dhe gjej mënyrat me shpartallue frontin dhe me ju krijue trubullira në kokë, pse ata duhet të kenë lëkundje.

3) ...

4) ...

5) Sovjetikët, pas kërkesës sonë që ti e di, rishikuan vendimin për drithë dhe na akorduan një sasi me klering dhe me ar. U thamë që prapë s'jemi të kënaqur, por do t'i blejmë. Rumunët s'japin gjë fare.

6) ...

7) Këtej çdo gjë është fare mirë, mos u bëj merak.

Radioja jonë protestoi te sovjetikët, pse në emisionin e Radio Moskës në gjuhën shqipe as të zë fare në gojë ku je, flet a s'flet, por këto i jep në emisionet arabisht. U thamë se protestojmë dhe në rast se vazhdon ky qëndrim i poshtër, atëherë nuk do t'i ritransmetojmë më emisionet e Radio Moskës nga Radio Tirana.

Po përgatitemi për dërgimin e delegacionit. Shira kanë rënë këto ditë. Në familje i ke shumë mirë, shokët janë mirë, të bëjnë të fala.

Përqafime

S h p a t i

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

R A D I O G R A M

SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK

26 shtator 1960

Shoku Mehmet,

1) Nesër nisct delegacioni ynë për në Moskë. Do të jenë Hysniu e Ramizi, si dhe disa ndihmës nga sektori i agjitpropit. Delegacionin kinez thonë se do ta kryesojë Ten Hsiao Pini. Si do të zhvillohen situatat do të të mbaj në korent.

2) Nesër gjithashtu nisct për në Kinë një delegacion për muajin e miqësisë shqiptaro-kineze, do të marrë pjesë edhe në festimet.

3) ...

4) Sovjetikët vazhdojnë të bëjnë provokacione; na bënë edhe në personelin e marinës. Tanët iu dhanë përgjigjen e merituar. Mos u bëj merak, poshtërsirat u bien në fytyrat e tyre. Ata tërhiqen me bisht në shalë.

5) Me gjakftohtësi, por qëndroju top të gjithë atyre që do të lehin ose do të provokojnë. Qëndro i patundur në ato që kemi vendosur.

6) Fjalimet i kënduam. Shumë mirë ua ke bërë

për «krajlin» e Beogradit¹. Ai e tregoi edhe një herë që s'është veçse një agjent i imperializmit, për të cilin, në gjithë fjalimin e tij, nuk foli as edhe një herë. Demaskoje pa mëshirë, jo vetëm te duaxhinjtë e tij të kampit tonë, por demaskoje edhe te të tjerët.

7) Ne kemi avantazhin këtej të vemi edhe për gjah. Vajta të shtunën, vrava 18 rosa. Po të kisha qëlluar më mirë mund të kisha vrarë edhe më shumë. Asnjë rosë nuk vrava në ujë, por të tëra në flur. Kishte rosa shumë dhe të majme. Kadriu qëndroi në kënetën e kashtës dhe vrau edhe ai mjaft. Mos u mërzit se kemi lënë edhe për ty kur të vish. Lajmet që na japin tregojnë se në Sukth fazanët janë shtuar aq shumë sa të marrin kapelen nga koka. Por atje s'do të vëmë dorë, do të të presim edhe ty. Beharit të fala. Presim sonte të dëgjojmë fjalimin tënd.

Përqafime

S h p a t i

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Është fjala për J. B. Titon.

R A D I O G R A M

SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK

28 shtator 1960

I dashur Mehmet,

1) Fjalimi yt na pëlqeu shumë. TASS-i na e vonoi dhe nuk e dhamë dot po atë ditë që e mbajte, as në radio dhe as në gazeta. E botuam të nesërmen në gazeta dhe e përsëritëm disa herë në radio. Në gazeta do të shkruhen disa artikuj duke u bazuar në fjalimin.

2) Fjalimi i Kastros që i mirë. Botuam aq sa dha TASS-i. Fjalime të miqve të tjerë s'kemi botuar. Do të veprojmë në mënyrë reciproke: sa radhë do të shtypin ata nga yti, aq do të shtypim edhe ne nga të tyret.

3) Shokët tanë, Behari ose Reizi, të na dërgojnë komunikata me telegrame të hapura të bisedimeve dhe të kontakteve që mund të kesh me udhëheqës të ndryshëm, që kështu t'i shtypë Agjensia Telegrafike Shqiptare.

4) Komiteti Qendror i PK të Kinës na dorëzoi letrat përgjigje për partitë që i kishin bërë letra asaj dhe që ti i di. I djeg me zjarr, veçanërisht komshiun tënd në OKB, Zhivkon.

5) Delegacionin tonë në Moskë e kishte pritur Pos-

pjellovi, shumë ftohtë, vetëm fjalët si je, si jam dhe asgjë tjetër. Ata i çuan në hotel. Atje i kanë çuar të gjitha delegacionet. . .

6) Nga Bullgaria vijnë informata se. . .

Në panairin e Plovdivit libri i fundit i Kardelit në gjuhën bullgare shitet me okë.

7) Më 30 bëjmë mbledhjen e Byrosë për arsimin dhe për direktivat e planit. Plenumin mund ta bëjmë më 3 ose më 5 tetor.

8) Materialin kinez e dhamë në mënyrë të organizuar ta këndojnë të gjithë kuadrot kryesorë të Partisë dhe të pushtetit. Tok kënduan edhe materialin sovjetik. Te të gjithë kuadrot është krijuar entuziazëm dhe besim i madh për vijën e drejtë të Partisë. Kuadrot janë top.

9) Më 30 është festa e kinezëve. Në fjalim¹ do të hedh disa «parabomba», për «miqtë» sovjetikë, do t'i bie pragut të dëgjojë dera.

10) Fiqreti me fëmijët janë mirë. E mbaj në korent për ty. Të gjithë shokët janë mirë, të bëjnë të fala. Pres me padurim radiogramin, me të cilin do të më vësh në korent si shkoi dreka e famshme.

Të përqafoj

S h p a t i

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Shih në këtë vëllim f. 268.

R A D I O G R A M

SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK

29 shtator 1960

I dashur Mehmet,

1) Fjalimet e të gjithëve po i ndjekim me kujdes dhe mund t'i karakterizojmë me fjalët e Shekspirit «shurmë zhurmë për asgjë». Në fakt zhurma bëhet e madhe edhe sidomos kur «vetëzhurma», në qoftë se mund ta adaptojmë këtë term, është shurdhuese. Na rrofshin jehonat edhe estradat, se asgjë mbi ujë nuk do të ketë dhe ne jemi plotësisht të një mendimi me ty, se doli ashtu siç e kishim parashikuar. Natyrisht në fund, si konkluzion, do të thuhet që mbledhja ishte pozitive dhe, sikundër e shfaqti që tash «Rrapo Leloja»¹ në drekë, «bëmë mirë që erdhëm».

2) Tratativat e ngushta me kryerevizionistin e Beogradit janë të turpshme. Bisedimet e tyre të vazhdueshme dhe legale sigurisht na pregatitin veprime të reja katastrofale. . .

¹ Nënkupton Hrushovin, me ironi. Rrapo Leloja ka qenë një armik i popullit, kulak nga krahina e Mallakastrës.

Influenca e Bashkimit Sovjetik, e Kinës dhe e të gjitha vendeve tona po minohet. Këtu duhet të shohim sidomos minimin e influencës kineze në shtetet e reja, të së ashtuquajturës «botë e tretë». Me manovrën e madhe «Rrapo Leloja» ka për qëllim të godasë Kinën ideologjikisht dhe ta minojë atë politikisht. Ai me këto veprime ndihmon zhvillimin e kapitalizmit, forcon imperializmin, dobëson kampin dhe pozitat tona në OKB...

Këtë kapitullim të tmerrshëm duaxhinjtë dhe sahanlëpirësit e «Rrapo Lelos» e quajnë sukses të madh. Unë mendoj që pikëpamjet tona mbi këto manovra t'ua lëshosh me takt atyre që ti mendon se i preokupon kjo gjendje, por s'kanë kurajë të thonë asnjë fjalë. Për ç'arsye t'i mbajmë kaq mbyllur pikëpamjet tona të drejta? Mundet që ndonjë prej tyre t'ia thotë «Rrapo Lelos» pikëpamjet tona, por neve s'na prishet gjiza. «Rrapoja» do të kuptojë se për këto çështje s'bisedojmë me të dhe po të dojë le të hidhet përpjetë.

3) Përsa i përket fjalimit të Gomulkës edhe ne kemi arritur po në ato konkluzione si edhe ti. Në asnjë mënyrë nuk mund t'i pranojmë. Statukuoja në favor të imperialistëve kurrsesi nuk mund të pranohet. Ti mbaj qëndrimin që kemi vendosur, ndërsa përsa u përket propozimeve të Gomulkës, jo vetëm mos i prano, por u thuaj se do t'i denoncojmë në mbledhjen plenare të partive komuniste e punëtorë në Moskë në rast se vihen në rezolucion.

4) ...

5) ...

6) Mbrëmë isha në familjen tënde. Fiqretit i dashë të lexonte radiogramet e tua dhe u zbavit. Nënë

e fëmijët i ke mirë. Mos u bëj merak. Bashkimit i është thyer shpata, prandaj kur të vish i sill një shpatë, besoj se do të gjesh atje, pse të tëra shpatat nuk do të jenë kthyer në parmenda.

Beharit i jep të fala. Djalin e ka mirë. I thuaj të ruajë mirë Llukanovin¹, se mos ia marrë era.

Të përqafoj me mall

S h p a t i

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Në atë kohë ministër i Jashtëm i RP të Bullgarisë.

RADIOGRAM

SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK

30 shtator 1960

Shoku Mehmet,

1) Po të informoj mbi rezultatet e bashkëbisedimeve të dy delegacioneve që dimë.

Delegacioni kinez kritikoi ashpër sovjetikët dhe veçanërisht Hrushovin, që kanë krijuar këtë situatë ndërkombëtare midis armiqve dhe nesh, marrëdhënie të pabarabarta, prej mëme e bir, në mes partive komuniste dhe shteteve sovjetik e kinez. U mbrojtën parimet në këto çështje. Me fakte demostroi se Hrushovi sulmon Kinën, zbukuron imperializmin dhe vë në pozita të gabuara çështjen e armiqve dhe tonën. Hrushovi shkel principin e barazisë, shkel kriteret në marrëdhëniet në mes partive dhe shteteve vëllezër. Delegacioni kinez deklaroi solemnisht se Partia Komuniste e Kinës është gati të merret vesh me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në bazë të marksizëm-leninizmit dhe të Deklaratës së Moskës të vitit 1957 dhe se partia e populli kinez do të qëndrojnë kurdoherë bashkë me Bashkimin Sovjetik në luftë kundër imperializmit. Komunistët ki-

nezë nuk do të përulen përpara asgjëje dhe nuk do të heqin dorë nga parimet marksiste-leniniste.

2) Delegacioni sovjetik justifikoi me të gjitha forcat sulmet e Hrushovit kundër Kinës dhe zbulimin e imperializmit — qëndroi me të gjitha forcat në pikëpamjet e tyre mbi çështjen kino-indiane, në shkeljen e kufijve të Bashkimit Sovjetik nga avionët amerikanë, justifikoi me forcë gabimet që janë vërtetuar në çështjen e Stalinit, në Poloni e në Hungari. Këto tri çështje dhe shumë të tjera, për dijeninë tënde, janë ngritur shumë drejt në materialin e fundit kinez që ti, natyrisht, nuk e ke kënduar. Sovjetikët sulmuan pikërisht këtë material të fundit kinez, si gjoja antimarksist, se ky material gjoja thëllon mosmarrëveshjet, se «i hedhin baltë Bashkimit Sovjetik, përçajnë unitetin, kinezët kërkojnë pozita të privilegjara, duan të vënë Hrushovin kundër Partisë së tij dhe përpiqen të vënë Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik kundër partive të tjera».

Siç e sheh, të dyja palët qëndruan në pozitat e tyre. As një çap s'u bë përpara dhe as që mund të bëhej.

Parashikohet që në komisionin pregatitor, që do të mbledhet në datën 30 shtator, të ketë luftë të rreptë.

Partia Komuniste e Kinës dhe Partia jonë do të presin sulme nga të gjitha anët, por do të qëndrojmë si shkëmb, për të mbrojtur partitë tona, marksizëm-leninizmin, për të sqaruar të drejtën dhe për të demaskuar gabimet.

Delegacionin kinez në komisionin pregatitor e kryeson shoku Ten Hsiao Pin dhe përbëhet prej 9 vetash.

Si duket sovjetikët do të paraqitin një projektdeklaratë. Këto janë informatat që kam unë, dhe këto ia komunikova dhe Hysniut. Nga Hysniu s'kam lajme të reja. Mos u bëj merak. Lufta e drejtë as na ka trembur kurrë dhe as nuk do të na trembë. Këtej çdo gjë është në rregull.

Përqaftime

S h p a t i

SHOKUT HYSNI¹

Për çdo hollësi për këto çështje, shokët kinezë janë gati të të informojnë. Projektdeklaratën, në qoftë se do të ketë, na e dërgo menjëherë.

Shumë të fala dhe përqaftime ty dhe Ramizit.

S h p a t i

Botohet për herë të parë si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Një kopje e këtij radiogrami me këtë shtesë i dërgohet në Moskë dhe shokut Hysni Kapo.

**POPULLI DHE PARTIA JONË DO TË VENË
TË GJITHA FORCAT QË TA RUAJNË E TA
ZHVILLOJNË MË TEJ MIQËSINË
ME RP TË KINËS**

*Fjala në pritjen e dhënë nga Ambasada e RP të Kinës
me rastin e 11-vjetorit të shpalljes së RP të Kinës*

30 shtator 1960

Të dashur shokë dhe shoqe, miq,

Është gëzim i madh për mua që në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të Qeverisë dhe të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të përshëndes nga zemra popullin e madh heroik kinez, Partinë e lavdishme Komuniste të Kinës dhe qeverinë kineze me rastin e 11-vjetorit të shpalljes së Republikës Popullore të Kinës dhe t'u uroj atyre suksese gjithnjë më të mëdha në ndërtimin e socializmit dhe në luftën e vendosur që ata bëjnë për mbrojtjen e socializmit dhe të paqes në të gjithë botën!

Fitorja e Revolucionit Popullor dhe shpallja e Republikës Popullore të Kinës më 1 tetor 1949 është një ngjarje me rëndësi të madhe historike jo vetëm për

popullin vëlla kinez, por edhe për gjithë njerëzimin. Pas fitores së Revolucionit të madh Socialist të Tetorit, që e udhëhoqi me lavdi Partia Bolshevike dhe Lenini i madh, Revolucioni Popullor Kinez shënon ngjarjen më të rëndësishme historike të këtij shekulli. Shpallja e Republikës Popullore të Kinës është kurorëzimi i aspiratave dhe i luftërave shekullore të popullit kinez për liri dhe për pavarësi, për bukë dhe për paqe, është rezultat i udhëheqjes së drejtë marksiste-leniniste të Partisë Komuniste të Kinës që e shpuri Kinën në fitoren më të madhe të saj, në shpalljen e Republikës Popullore.

Populli më i madh i botës në numër, populli heroik kinez prej 650 milionësh, nën udhëheqjen e Partisë së lavdishme Komuniste të Kinës, me birin e saj të madh në krye, shokun Mao Ce Dun, pas një lufte të gjatë revolucionare dhe në kushte jashtëzakonisht të vështira, theu dhe përmbysi përgjithmonë, 11 vjet më parë, imperialistët japonezë, çankaishistët, shërbëtorë të imperialistëve, kapitalistët dhe çifligarët gjakpirës të çdo kallëpi dhe vendosi regjimin e tij të demokracisë popullore. Me lindjen e Kinës së re Popullore imperializmi ndërkombëtar pësoi një goditje shumë të rëndë dhe sistemi i urryer kolonial i tij mori rrugën e shembjes së shpejtë. Ky është një kontribut me rëndësi të madhe historike botërore për gjithë njerëzimin, për çlirimin nacional dhe shoqëror. Lëvizja revolucionare, jo vetëm në Azi, por në të gjithë botën mori një hov të ri dhe u mbështet e vazhdon të mbështetet gjithashtu edhe në rezultatet e kësaj fitoreje kolosale.

V. I. Lenini dhe J. V. Stalini e kanë vlerësuar shumë lart potencialin e madh revolucionar të popullit kinez,

kontributin e tij të fuqishëm në luftën çlirimtare të popujve nga kthetrat e imperializmit. Në rezolucionet e Konferencës së Pragës të Partisë Punëtoare Socialdemokrate Ruse, V. I. Lenini shkruan:

«Konferenca... konstaton rëndësinë botërore të luftës revolucionare të popullit kinez, që po i sjell çlirimin Azisë dhe po e minon sundimin e borgjezisë evropiane, i përshëndet revolucionarët republikanë të Kinës, shpreh entuziazmin dhe simpatinë e plotë, me të cilën proletariati i Rusisë është duke i ndjekur sukseset e popullit revolucionar në Kinë...»¹.

«Forcat e lëvizjes revolucionare në Kinë, ka thënë J.V. Stalini, janë tepër të mëdha. Ato akoma nuk janë shfaqur si duhet. Ato do të shfaqen në të ardhshmen. Sundimtarët e Lindjes dhe të Perëndimit, të cilët nuk i shohin këto forca dhe nuk i përfillin në masën e duhur, do të pësojnë konsekuencat... Këtu e vërteta dhe e drejta janë kryekëput me revolucionin kinez. Ja sepse ne e simpatizojmë dhe do ta simpatizojmë revolucionin kinez në luftën e tij për çlirimin e popullit kinez nga zgjedha e imperialistëve dhe për bashkimin e Kinës në një shtet të vetëm. Ai që nuk e përfill këtë forcë dhe nuk do ta përfillë, me siguri do të humbasë»².

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 17, f. 548.

² J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 296-297.

Reaksioni i brendshëm kinez dhe imperialistët humbën në llogaritë e tyre me forcat revolucionare të popullit kinez, i cili fitoi një herë e përgjithmonë mbi ta dhe më 1 tetor 1949 shpalli Republikën Popullore.

Kina e vjetër, ku sundonin imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, sundimtarët gjakpirës reaksionarë, megjithëse ishte një vend me pasuri kolosale e me një kulturë të lashtë, me një sipërfaqe të gjerë dhe me popullsinë më të madhe të botës, ka qenë jashtëzakonisht e prapambetur nga pikëpamja ekonomike. Shfrytëzimi barbar kolonial dhe ai i klasave sunduese i kishin ndrydhur energjitë e pashtershme të këtij populli shumë të talentuar dhe me aftësi të mëdha krijuese. Ky popull i madh dhe trim, vetëm brenda një kohe të shkurtër prej 11 vjetësh, pas marrjes së pushtetit, i tregoi gjithë botës aftësitë dhe talentet e tij të mrekullueshme dhe arriti suksese të pashembullta në historinë e tij mijërvjeçare. Ai po e transformon me shpejtësi atdheun në një vend të përparuar socialist dhe frymëzon me shembullin e tij të shkëlqyer popujt e tjerë të botës që porsa janë çliruar nga zgjedha koloriale e imperializmit ose që vuajnë akoma nën shfrytëzimin e egër të imperializmit.

Gjatë viteve të pasçlirimit ekonomia kombëtare kineze është zhvilluar me ritme shumë të shpejta, karakteristike kjo që vihet re vetëm në vendet socialiste, ku udhëheqin partitë marksiste-leniniste.

Republika Popullore e Kinës, pasi zbatoi me sukses planin e parë pesëvjeçar në vitin 1957, gjatë viteve 1958 dhe 1959 ka arritur suksese të mahnitshme, duke plothësuar tre vjet para afatit treguesit kryesorë të planit të

dytë pesëvjeçar 1958-1962. Vetëm gjatë vitit të kaluar, vlera e përgjithshme e prodhimit industrial u rrit 39,3 për qind më shumë se në vitin 1958 dhe ajo e prodhimit bujqësor — 16,7 për qind. Sot Kina e madhe, nga një vend ku më parë sundonte varfëria e uria kronike, ku sundonin çifligarët, kapitalistët vendës si edhe imperialistët që nga ata japonezë, anglezë, francezë dhe deri te ata amerikanë, transformohet dita-ditës në një vend të përparuar socialist, ku përmirësohet vazhdimisht niveli material dhe kulturor i masave punonjëse.

Ka marrë fund përgjithmonë ajo kohë kur në Kinë populli nuk gëzonte asnjë të drejtë. Masat e gjera popullore vetëm tani gëzojnë të gjitha të mirat e demokracisë socialiste dhe marrin pjesë aktive në shkallë të gjerë në zgjidhjen e problemeve aktuale të vendit. Në Kinën Popullore shumëkombëshe është zhdukur, bashkë me përmbysjen e pushtetit të vjetër, shtypja nacionale dhe sot të gjitha kombësitë e ndryshme rrojnë në harmoni si në një familje të madhe, gëzojnë të drejta të barabarta, ndihmojnë njëra-tjetrën në mënyrë vëllazërore dhe jetojnë kështu në një unitet të plotë shembullor.

Ndryshimet e thella ekonomike dhe shoqërore që janë bërë në Republikën motër Popullore të Kinës gjatë këtyre 11 vjetëve i detyrohen vendosmërisë në zbatimin e drejtë dhe në mënyrë krijuese të parimeve të marksizëm-leninizmit nga Partia Komuniste e Kinës, lidhjeve të saj të ngushta me masat punonjëse, autoritetit e dashurisë së zjarrtë që ushqen i gjithë populli kinez për Partinë Komuniste, Komitetin e saj Qendror dhe birin e madh të popullit dhe të partisë, shokun

Mao Ce Dun. Sukseset e vazhdueshme dhe shumë të mëdha të popullit të talentuar kinez në ndërtimin me sukses të socializmit i detyrohen gjithashtu luftës së drejtë, parimore dhe pa lëkundje të Partisë Komuniste të Kinës, për mbrojtjen e pastërtisë së parimeve marksiste-leniniste, luftës kundër revizionizmit modern dhe kundër çdo shfaqjeje tjetër të dëmshme antimarksiste. Fitoret kolosale, të arritura në Republikën Popullore të Kinës gjatë këtyre 11 vjetëve, e kanë bërë Kinën e re një fuqi të madhe botërore, një luftëtare të vendosur të paqes dhe të socializmit, me një autoritet të madh ndërkombëtar që rritet vazhdimisht.

Në politikën e saj të jashtme Partia Komuniste e Kinës është udhëhequr dhe udhëhiqet nga parimet e larta të politikës leniniste të paqes dhe të miqësisë midis popujve, nga parimet e larta të internacionalizmit proletar. Kjo parti e madhe e lavdishme, në gjirin e së cilës militojnë rreth 14 milion anëtarë, është një forcë kolosale në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe ecën krah për krah në radhë të shtrënguara me të gjitha partitë komuniste dhe punëtoresh të botës, duke mbajtur lart të papërlyer flamurin e marksizëm-leninizmit. Republika e madhe Popullore e Kinës, që bën pjesë në familjen e madhe të kampit të socializmit, luan një rol të madh e të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare. Ajo lufton vazhdimisht për forcimin dhe për çelikosjen e unitetit të kampit të socializmit dhe jep një kontribut shumë të madh në luftën që bëjnë të gjithë popujt e botës për mbrojtjen e paqes dhe për zgjidhjen e drejtë të të gjitha problemeve ndërkombëtare, të mbetura pezull. Partia Komuniste e Kinës dhe populli i madh

kinez shikojnë drejt, në rrugën revolucionare, çështjen e çlirimit të popujve të robëruar nga imperializmi e kolonizatorët dhe i ndihmojnë ata me të gjitha mundësitë që kanë për çlirimin e tyre nacional.

Pikërisht për këtë luftë të drejtë Republika Popullore e Kinës ka fituar respekt dhe simpati jo vetëm në kontinentin e Azisë, por në të gjithë botën. Prandaj janë të kota përpjekjet e imperialistëve agresorë, sidomos të atyre amerikanë dhe të shërbëtorëve të tyre besnikë, revizionistëve jugosllavë, që shpifin dhe trillojnë një mijë e një poshtërsi për ta paraqitur Kinën si «një vend që s'do paqen, por do luftën, që s'është për bashkëzistencën paqësore në mes vendeve me sisteme të ndryshme shoqërore» etj.

Për të minuar simpatinë dhe influencën e madhe që fiton vazhdimisht Republika Popullore e Kinës në arenën ndërkombëtare, imperialistët amerikanë luftojnë me këmbëngulje për të mos i dhënë asaj vendin e ligjshëm në Organizatën e Kombeve të Bashkuara ose në organizatat e tjera ndërkombëtare. Imperialistët grabitqarë amerikanë kanë pushtuar tokën shekullore kineze të Tajvanit dhe luftojnë me çdo mjet për ta izoluar Kinën nga pjesëmarrja në zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare. Të gjitha këto veprime të imperialistëve amerikanë bëjnë pjesë në politikën e tyre agresive kundër kampit të socializmit në tërësi dhe kundër Kinës Popullore në veçanti. Prandaj mbrojtja e Republikës Popullore të Kinës nga çdo orvatje e imperialistëve, këmbëngulja jonë që ajo të fitojë të gjitha të drejtat që i përkasin në arenën ndërkombëtare, i shërbejnë forcimit të kampit socialist dhe zbrapsjes së një lufte

të re botërore. Të lejohet imperializmi amerikan të vazhdojë në këtë rrugë ndaj Republikës Popullore të Kinës, do të thotë të lejohet ai të godasë një nga pozitivet më të shëndosha të kampit tonë socialist, të godasë paqen dhe bashkekzistencën paqësore midis popujve. Çdo tentativë, e çdo natyre qoftë, nga ana e imperialistëve dhe e shërbëtorëve të tyre, për të prekur Kinën e madhe Popullore, do të gjejë përpara goditjen e rëndë të kampit të socializmit, të të gjithë komunistëve të botës, të të gjithë njerëzimit përparimtar. Kina e madhe do të triumfojë në të drejtat e saj legjitime mbi imperialistët dhe shërbëtorët e tyre.

Me qëllim që të gënjejnë popujt dhe t'i vënë në gjumë, imperialistët amerikanë bëjnë shumë zhurmë se gjoja janë për bashkekzistencën paqësore midis shteteve me sisteme të ndryshme politiko-shoqërore, por fjalët e tyre janë vetëm blofe. Këtë e vërteton më së miri qëndrimi i qeverisë amerikane ndaj Kinës, ndaj Shqipërisë dhe shumë shteteve të tjera. Qeveria e Republikës Popullore të Kinës ka luftuar dhe lufton sinqerisht për të jetuar në paqe me të gjitha shtetet, pavarësisht nga regjimi i tyre, këtë e vërtetojnë lidhjet e shumta miqësore që Republika Popullore e Kinës ka me një numër të madh shtetesh të Azisë, të Afrikës, me Kubën e të tjera. Këtë e vërtetojnë lidhjet tregtare dhe kulturore që Kina mban dhe zhvillon çdo ditë e më shumë me një numër të madh shtetesh. Por imperialistët do të dështojnë me turp në politikën e tyre ashtu sikundër kanë dështuar.

Në Nju-Jork, sikundër dihet, është hapur dhe vazhdon punimet sesioni i zakonshëm i Organizatës së

Kombeve të Bashkuara. Kryetari i Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, shoku Mehmet Shehu, shprehu atje vullnetin e popullit shqiptar, të Partisë dhe të Qeverisë sonë, që konsiston në ruajtjen e paqes në botë. Ai dënoi kolonializmin. Shoku Mehmet Shehu mbrojti dhe kërkoi me këmbëngulje që të pranohet në Kombet e Bashkuara Kina e madhe dhe të flaket jashtë kukulla e Çan Kai Shisë, duke theksuar me të drejtë se pa pjesëmarrjen e Kinës asnjë problem i madh ndërkombëtar nuk mund të marrë zgjidhjen e drejtë e të vërtetë. Imperializmi është në kalbëzim. Megjithatë marksizëm-leninizmi na mëson se derisa ekziston imperializmi, ekzistojnë dhe shkaqet e luftërave grabitqare. Prandaj kurdoherë duhet të jemi vigjilentë ndaj tyre, pse vetëm kështu ne do t'u imponojmë vullnetin e njerëzimit paqedashës këtyre bishave imperialiste me fytyrë njeriu. Kjo do të arrihet vetëm me rrugë revolucionare, pa u bërë imperialistëve lëshime nga ana parimore, duke qëndruar kurdoherë vigjilentë kundër të gjitha orvatjeve të tyre për të dobësuar pozitat tona politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake. Ne duhet të bashkojmë përpjekjet tona me luftën çlirimtare revolucionare të vendeve koloniale dhe të varura, si dhe me të gjitha forcat paqedashëse dhe përparimtare në të gjithë botën. Duhet demaskuar pa mëshirë imperialistët amerikanë dhe shërbëtorët e tyre për përgatitjet e ethshme për luftë; atyre dhe revizionistëve të Beogradit t'u bëhet një luftë dhe një demaskim i pamëshirshëm politik e ideologjik, pse vetëm kështu i kemi shërbyer si duhet çështjes së paqes së vërtetë, çështjes së bashkekzistencës, çështjes së çlirimit

të popujve nga zgjedha koloniale, çështjes së triumfit të socializmit e të komunizmit. Partia jonë këtë rrugë ka ndjekur dhe këtë rrugë marksiste-leniniste do të ndjekë pa asnjë lëkundje.

Ashtu sikurse Republika Popullore e Kinës, Republika jonë Popullore ndjek dhe do të ndjekë me konsekuencë politikën e paqes dhe të bashkekzistencës paqësore midis popujve, ashtu si na e ka caktuar Lenini i madh, që paralelisht me përpjekjet për vendosjen e marrëdhënieve miqësore midis shteteve, të mos heqim dorë asnjëherë nga lufta politike dhe ideologjike kundër kapitalistëve dhe tradhtarëve të marksizëm-leninizmit, revizionistëve modernë.

Populli shqiptar është i lidhur me një miqësi të pathyeshme me popullin e madh kinez dhe ndjek me simpati dhe admirim luftën e tij për paqe dhe socializëm. Partia dhe Qeveria jonë kanë përkrahur dhe do të përkrahin me të gjitha forcat e tyre politikën paqësore dhe të drejtat e Republikës Popullore të Kinës në arenën ndërkombëtare. Populli dhe Partia jonë gëzohen që kanë te populli kinez një mik të madh e besnik dhe do të vënë të gjitha forcat që ta ruajnë dhe ta zhvillojnë gjithnjë e më shumë miqësinë e shëndoshë, të bazuar në marksizëm-leninizmin, që lidh të dy popujt tanë vëllezër.

Të mbledhur sot me rastin e këtij përvjetori të lavdishëm, përfitoj nga ras'i t'i shpreh edhe një herë, në emër të Partisë dhe të popullit tonë, Partisë Komuniste, Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës dhe gjithë popullit të madh vëlla kinez, mirënjohjen e thellë dhe falenderimet më të përzemërta për ndihmën

që i kanë dhënë dhe i japin vendit tonë për ndërtimin e socializmit. Në këto çaste të gëzueshme për popullin mik kinez ne i dërgojmë atij urimet më të nxehta për realizimin e aspiratave të tij, për ndërtimin e socializmit dhe triumfin e paqes në të gjithë botën!

Më lejoni shokë dhe miq të pimë një dolli:

Për popullin e madh dhe të talentuar kinez!

Për Partinë e lavdishme Komuniste të Kinës me marksist-leninistin e shquar, shokun Mao Ce Dun në krye!

Për Qeverinë e Republikës Popullore të Kinës, të kryesuar nga shoku Çu En Lai!

Për miqësinë e përjetshme midis dy popujve tanë!

Për paqen në të gjithë botën!

Për shëndetin tuaj, shokë dhe miq!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 235 (3764), 1 tetor 1960

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË

1 tetor 1960

I dashur shoku Hysni,

Letrën dhe materialin që më dërgove, i mora dje në kohën kur po bënim mbledhjen e Byrosë Politike për të shqyrtuar projekt-direktivat e Kongresit IV të Partisë mbi planin e tretë pesëvjeçar si dhe raportin mbi riorganizimin e shkollës. Kur e mora materialin, arriti edhe radiogrami yt, me të cilin na njoftove që ky material duhet të të kthehet prapë, prandaj e dhamë për të shtypur. Të gjitha këto t'i them për të kuptuar se tash që po të shkruaj, nuk e kam filluar leximin e materialit që më dërgove, prandaj s'kam se ç'të të them tash për tash. Do të të jap mendim me radiogram ose me letër më të gjatë, të cilën do të ta nis me avion.

Duke u bashkuar me pikëpamjen tënde, edhe unë mendoj se sovjetikët po luajnë një manovër të poshtër me qëllime të caktuara.

Materiali që kanë dhënë, mund të jetë deri diku i pranueshëm, gjithashtu i hartuar dhe i predispozuar që të bëhen dhe korrigjime edhe më të forta. S'prish shumë punë për ta ky fakt!! «Po të doni, mund të thonë, e

bëjmë edhe barut, por vetëm të mos bëjmë polemikë, çdo gjë të shkojë urtë e butë, pa sa për zbatimin e atyre që vëmë në kartë, e kemi merak vetë, me një fjalë vazhdojmë rrugën tonë, ta shkelim edhe këtë deklaratë, si atë të Moskës [1957] dhe, po të na akuzoni prapë, prapë mbledhim një Bukuresht të dytë dhe jua rregullojmë qejfin».

Në qoftë se sovjetikët kanë bërë disa lëshime ose janë të predispozuar që deklaratat të forcohet akoma, ata e bëjnë këtë jo se kanë ndërruar pikëpamje, jo se njohin gabimet, por këto janë gjoja koncesione që na bëhen për t'u mbyllur muhabeti me kaq. Ata mendojnë se ne vuajmë dhe jemi sëmurë për deklaratat. Ne kemi marksizëm-leninizmin. Ne kemi nevojë dhe ngulim këmbë që sovjetikët të ndreqin gabimet e tyre oportuniste. Deklaratat duhet të jetë konkluzioni i këtyre diskutimeve. Pikërisht kjo i tremb sovjetikët, pikërisht kjo s'na tremb ne.

Sovjetikët kanë frikë nga diskutimet, pse jo vetëm që pas Bukureshtit kanë ndodhur tronditje në partitë e tjera, por këto tronditje do të bëhen edhe më të forta pas nëntorit. Atëherë ata i dalin punës përpara, japin këtë deklaratë: «E forcojmë akoma po të doni», dhe, kështu, të gjithë duaxhinjtë e tyre bërtasin dhe brohorasin: «Eureka! Kjo është, ka qenë e do të jetë vija jonë. Kurrë s'kemi gabuar. Kina reflektoi, rishikoi gabimet dhe erdhi në rrugë të drejtë! *Pra, Bukureshti qe shumë «paljezno»¹. Në partitë tona ne e dënuam Kinën dhe Shqipërinë si dogmatike etj. Me dy gurë vramë dy*

¹ Nga rusishtja, që do të thotë i dobishëm.

zogj, edhe i demaskuam, edhe i shëruam, edhe hapëm rrugën që t'u themi prapë partive nesër, që të sëmuret nuk u shëruan plotësisht, sepse sëmundja e dogmatizimit u është ringjallur. Fundi, fituam në të dyja tablotë dhe vazhdojmë rrugën që kemi ndjekur». Ky është pak a shumë arsyeimi i sovjetikëve dhe i duaxhinjve të tyre, mendoj unë. Nikita ia gjeti ilaçin Zhivkos e kompani.

Ne në asnjë mënyrë nuk mund të biem në manovrat dredharake të revizionistëve sovjetikë. Ne duhet t'u lëmë të kuptojnë sovjetikëve dhe të tjerëve se jemi dakord ta përpunojmë këtë material, t'i heqim ose t'i shtojmë, por ky material do të jetë si konkluzion i diskutimeve të gjithanshme në nëntor dhe që do të synojnë: si janë zbatuar parimet e marksizëm-leninizmit dhe vendimet e Mbledhjes së Moskës [1957], kush është larguar dhe kush i ka zbatuar me konsekuencë. Do të ribëhet rivlerësimi i Bukureshtit në bazë të fakteve dhe jo vetëm sovjetike, por në bazë edhe të fakteve që do të sjellin për këtë çështje edhe partitë e tjera.

Mbledhja e ardhshme e Moskës s'mund të jetë një mbledhje formale, as një mbledhje shterpë polemike, por një mbledhje me rëndësi të madhe konstruktive në bazë të marksizëm-leninizmit dhe të normave leniniste. Ajo nuk do të ketë kuptimin e një mbledhjeje pajtuese «pacifiste», për të mbuluar me një cipë gabimet e rënda, por një mbledhje që t'i zbulojë dhe t'i shërojë rrënjësisht gabimet. Tjetër rrugë s'ka, dhe nga ne të mos presin asnjë rrugëzgjdhje tjetër. Në qoftë se nuk shihen drejt në sy këto gabime, ne jemi të sigurtë që revizionistët do të vazhdojnë më tej me vrull punën shkatë-

rrimtare. Prandaj për ne ka vetëm një rrugë — luftë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe jo pajtim me gabimet oportuniste dhe revizioniste në ideologji dhe në politikë, siç bën Hrushovi dhe grupi i tij. Unë mendoj që lufta të fillojë që në komision, ku partitë e tjera, veç asaj të Kinës, kanë dërguar njerëz të dorës së katërt, pse, natyrisht, sovjetikët janë marrë vesh me ta, kanë adoptuar një taktikë dhe kërkojnë që hendekun që vetë e kanë thelluar, ta kapërcejnë me lehtësi dhe duke akuzuar Kinën e ne për një mijë gjëra. Por ne s'i hamë këto.

Tash ç'të të shkruaj më gjatë se ti i di vetë çështjet. Kur të të dërgoj vërejtjet për materialin, mund të shkruaj më gjatë.

Ramizit dhe shokëve të fala.

Përqafime

E n v e r

Të shkruaj me shpejtësi pse ikën avioni, prandaj do të kesh zor në lexim. Dje ishim te shokët kinezë dhe në fjalimin tim i hodha «parabombat».

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM

SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË

1 tetor 1960

Shoku Hysni,

1) Problemi shtrohet kështu: Në ç'rrugë duhet të ecë lëvizja komuniste ndërkombëtare në situatat aktuale dhe si ka ecur që prej Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e deri tash.

2) Kinezët dhe ne mendojmë se janë bërë gabime të rënda parimore, taktike dhe strategjike, nga grupi i Hrushovit. Ky grup ka devijuar nga parimet marksiste-leniniste dhe ka shkelur Deklaratën e Mbledhjes së Moskës të vitit 1957. Ky grup jo vetëm thelloi gabimet e veta, por bëri edhe Mbledhjen e Bukureshtit dhe akuzoi direkt Kinën dhe indirekt ne për dogmatizëm etj. Pra kinezët edhe ne do të luftojmë që të vërtetohen dhe të pranohen nga të gjithë tezat tona të drejta dhe plus gabimi i madh i udhëheqjes sovjetike në Mbledhjen e Bukureshtit.

3) Grupi i Hrushovit dhe ata që ka komprometuar, mbrojnë tezën e kundërt. Ai në Bukuresht i rreshtoi

pothuajse të gjithë ata që ishin të pranishëm atje dhe i bëri të paktën udhëheqjet të pranojnë se «Hrushovi s'ka gabuar dhe kinezët kanë gabuar, se Bukureshti ishte i nevojshëm dhe i drejtë».

4) Për ne, në Mbledhjen e ardhshme të Moskës [1960] duhet të gjitha problemet të zgjidhen. Kurse grupi i Hrushovit për qëllimet e tij i ka zgjidhur në Bukuresht. Në Mbledhjen e Moskës grupi i Hrushovit vjen, pra, me pikëpamjen se rruga dhe veprimet e tij kanë qenë të drejta dhe ne duhet të pranojmë një deklaratë, në të cilën të thuhet se ku duhet të shkojë lëvizja komuniste ndërkombëtare; por kush ka devijuar, kush ka faj dhe ç'përfaqëson Mbledhja e Bukureshtit, mbeten në heshtje, domethënë Kina mbetet e dënuar.

5) Tash të supozojmë se Deklarata e Mbledhjes së ardhshme të Moskës mund të rregullohet mirë dhe mund të caktojë rrugën e drejtë të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Një deklaratë e tillë do të jetë një farë kopje e asaj që adoptoi Mbledhja e Moskës më 1957. Po kështu, të supozojmë se komisioni, që është mbledhur aty për të përgatitur Mbledhjen e Moskës, e rregulloi deklaratën, por nuk sqaroi konkretisht kush ka devijuar dhe pse u dënua Kina në Bukuresht. Edhe kështu po të ndodhë qëllimi i drejtë yni nuk arrihet.

6) Qëllimi ynë dhe detyra jonë nuk qëndron në shtimin e koleksioneve të deklaratave, por në ndreqjen dhe në dënimin e gabimeve dhe kjo ka rëndësi, pse vetëm atëherë ka siguri që, qoftë Deklarata e vitit 1957, qoftë e reja, do të zbatohen drejt dhe në rrugën marksiste-leniniste.

7) Për grupin e Hrushovit, marksizëm-leninizmi,

Deklarata e Mbledhjes së Moskës e vitit 1957 dhe e reja që do të dalë nga Mbledhja e ardhshme e Moskës, s'kanë asnjë vlerë. Pra, edhe po të përpiqemi ta bëjmë këtë të fundit të mirë, kjo s'ka asnjë vlerë pa u analizuar dhe pa u njohur nga ana e tyre gabimet. Prandaj mbledhja juaj të fillojë luftën kundër gabimeve dhe jo të mbetet vetëm në diskutimin e deklaratës. Deklarata të diskutohet nëpërmjet demaskimit të gabimeve të grupit të Hrushovit. Mund të mos arrihet në asnjë përfundim deri në konferencë. Pra, manovra u dështon.

8) Dokumenti i ri ka shumë dobësi, për atë do të flasim më vonë, por lëshimet e zbeta të grupit të Hrushovit kanë për qëllim të na vënë në gjumë dhe të mendojmë se me rregullimin e deklaratës u pritet rruga diskutimeve për gabimet e grupit.

9) Në Mbledhjen e Moskës ne do t'i shtrojmë problemet ashtu si thamë më lart, pse nga ana jonë problemi qëndron i tëri. Ne u kemi dhënë grupit të Hrushovit dhe gjithë partive një projektdeklaratë të drejtë, mbi bazën e së cilës kërkojmë të zhvillohen punimet. Ne do të dalim në mbledhje nga kufijtë e deklaratës, pse këtë e konsiderojmë si konkluzion të debateve që do të zhvillohen, kurse grupi i Hrushovit e konsideron ndryshe, synon të kundërtën. Shumë përfaqësues të partive të tjera në këtë mbledhje, në një mënyrë ose në një tjetër, janë që më parë të komprometuar, kush më shumë e kush më pak, dhe, duke u gjendur përpara një deklaratë të parapregatitur mirë nga komisioni, do të habiten nga diskutimi ynë i drejtë, nga kritikrat tona të ashpra dhe të drejta, të cilat grupi i Hrushovit do t'i kundërshtojë, në pamundësi t'i ndalojë; dhe më në fund

do të arrihet në konkluzion që ne s'jemi dakord me grupin e Hrushovit dhe me përkrahësit e tij, por me projektdeklaratën e parapregatitur jemi dakord.

10) Nga një anë ne arrijmë në mosmarrëveshje, pse grupi i Hrushovit s'pranon kurrë gabimet dhe, nga ana tjetër, Mbledhja e Moskës do të na vërë përpara çështjen: e firmosni këtë deklaratë, që është e drejtë (por ku nuk flitet se kush ka gabime në vijë etj.), apo nuk e firmosni? Po ta firmosim një deklaratë të tillë me gabime parimore dhe pa arritur qëllimin tonë që të vihen mirë në dukje gabimet e grupit të Hrushovit, atëherë ky grup ka triumfuar dhe Kina mbetet e dënuar. Po të mos e firmosim, u japim një armë tjetër grupit të Hrushovit dhe atyre që e pasojnë, për të na akuzuar që ne s'firmosim një deklaratë të drejtë.

Kjo përbën një taktikë të menduar mirë nga grupi i Hrushovit. Kjo taktikë është përpunuar me siguri nga i gjithë grupi i sovjetikëve dhe i Zhivkos me shokë, të cilët kanë dijeni që më parë për këtë material. Prandaj, bëni përpjekje të ndreqni deklaratën, sipas pikëpamjeve tona. Po s'u bë kjo, atëherë dalim në rrugën që u shpjegua më lart dhe që ka rreziqe.

Në deklaratën e përpunuar drejt të njihen gabimet e grupit të Hrushovit dhe të dënohen qëllimet e tij në Mbledhjen e Bukureshtit. Grupi i Hrushovit s'i pranon gabimet, dokumenti do të mbetet pezull dhe pra, çdo gjë do të vendoset pas diskutimeve në mbledhje.

Si përfundim, këto janë disa ide të para. Ju vetë reflektoni dhe veproni sipas vijës së drejtë të Partisë sonë, sipas udhëzimeve që ju ka dhënë dhe ju jep Byroja Politike. Na vini edhe ne në korent.

Për vërejtjet e materialit po punojmë dhe, me sa mundësi që kemi, do t'ju ndihmojmë.

Shumë të fala ty, Ramizit e gjithë shokëve.

E n v e r

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM

SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK

1 tetor 1960

I dashur Mehmet,

1) Mbledhja në Moskë hapet sot. Delegacionet shumë të zbeta, veç kinezit edhe tonit, 50 veta gjithsejt. Morëm vesh se delegacioni bullgar do të veprojë si t'i thonë sovjetikët që të mos nxiten polemikat. Kjo është parulla e përgjithshme e lëshuar nga «miku» që ke atje.

2) Sovjetikët dorëzuan një material në formë të një deklarate prej 36 faqesh, mbi të cilën të diskutohet në drejtim të shtesave, ose të heqjes së ndonjë pjese. Sa e përkthym dhe e shtypëm, se dje na crdhi dhe sa mbarova shpejt e shpejt leximin e parë. Mbledhje pune e vërtetë në Moskë do të fillojë të martën që vjen, në datën 4.

3) Përshtypja e parë për materialin: Manovër e poshtë e revizionistëve, jo ton polemik, por disa insinuata të holla e të poshtra, mjaft boshllëqe të mëdha, rregullimi i qosheve të rrezikshme për ta, disa zbythje taktike për të hedhur hi syve, disa afrime me tezat tona, gjoja «ja po bëjmë koncesione përpara kokëfor-

tësisë suaj dhe kemi një armik të egër përpara, prandaj nani këtë deklaratë, kënaquni dhe e përdorni si temjan». Por ajo duhet lexuar prapë me vëmendje dhe do t'i bëj rekomandime Hysniut për fondin.

4) Ku konsiston manovra e revizionistëve sipas mendimit tim: T'i mbulojnë me një duvak të gjitha gabimet dhe duvaku është kjo deklaratë. Ata mendojnë se neve na u dogj barku për deklarata, sikur s'kemi ideologjinë tonë, marksizëm-leninizmin. Pra, sipas tyre, na «plotësojnë dëshirën» me një deklaratë, ku lihet shtegu të bëhen korrigjime, bile «mund të futim edhe barut» brenda. Ata, besoj unë, do të lëshojnë pe dhe më në fund të thonë: «e shikoni, kjo ka qenë vija jonë, ju bëtë disa shtesa, ne qemë dakord, tash asgjë s'na ndan dhe urra! Por kush ka devijuar nga marksizëm-leninizmi, kush është revizionist apo dogmatik, ç'u bë në Bukuresht dhe si u bënë punët më vonë etj. etj., këto janë punë të vendosura dhe të vendosura drejt dhe unanimisht; ju rrëshqitët në dogmatizëm, ju ju dënuam me të drejtë, ju ju demaskuam në partitë tona, kjo ju shërbeu, reflektuat në gabimet tuaja dhe erdhët, diskutuam dhe ramë dakord e nxorëm edhe deklaratën. Tani shkoni në shtëpi, djema, bëni autokritikë në partitë tuaja dhe mos bëni gabime më të na kritikoni, se prapë do t'ju çojmë në një Bukuresht të dytë dhe këtë herë do të jeni recidivistë». Ky është afërsisht qëllimi i «Rrapo Lelos». Ky arsyetim dhe kjo taktikë e «Rrapos» ka kënaqur sigurisht në kulm Zhivkon me shokë, pse sigurisht në mos sot, mot do të kishte tërmet nën këmbët e tyre, por me këtë manovër ata mendojnë se do ta evitojnë. Kjo natyrisht është

rruga e tyre, por jo jona. Rruga jonë është ajo që kemi vendosur dhe që është e drejtë.

5) Hysniun e lajmërova që qysh në komision të fillojë lufta dhe t'u lërë të kuptojnë hapur që ne mund ta diskutojmë deklarata'n, t'i heqim ose t'i bëjmë shtesa, por kjo deklaratë do të jetë konkluzioni i diskutimeve marksiste-leniniste për çështjet në diskutim: kush e ka zbatuar drejt marksizëm-leninizmin dhe Deklaratën e Moskës [1957] dhe kush e ka tradhtuar; kush janë revizionistët dhe kush nuk është dogmatik; kush e bëri Bukureshtin dhe pse e bëri; kush krijoi këtë përçarje dhe pse e krijoi. Të gjitha çështjet do të hidhen në bango dhe do të studjohen jo vetëm në bazë të fakteve të gënjeshtërtë të sovjetikëve, por në bazë të argumenteve edhe të kinezëve, edhe tonave, edhe të të tjerëve, kush të ketë. Paqe për paqe në lëvizjen komuniste nuk pranojmë; të mbulohen fajet nuk lejojmë. S'mund të lejojmë që Mbledhja e Moskës të jetë një «mbledhje e revizionistëve» dhe e pacifistëve të djathtë; ne do të luftojmë që ajo të jetë një mbledhje marksiste, luftarake, konstruktive. Tjetër rrugë s'ka. Në këtë mënyrë të zhduket çdo iluzion i hrushovianëve, të prishet manovra dhe t'i shkohet deri në fund. Besoj se kinezët do të veprojnë si ne.

Qaq për tani. Po të kesh vërejtje e sugjerime na i shkruaj.

Të përqafoj

S h p a t i

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

DEKLARATA E MOSKËS TË BËHET SA MË E FORTE, ME BARUT E JO ME PAMBUK

Letër drejtuar shokut Hysni Kapo në Moskë

4 tetor 1960

I dashur shoku Hysni,

Letrën e mora sot në mëngjes dhe i kuptova pikëpamjet tuaja. Jam dakord me këto pikëpamje dhe me propozimet që bëni, të cilat në përgjithësi përputhen edhe me ato që unë ju kam shkruar.

Pra edhe një herë po e theksoj, sikundër biseduam kur ike nga Tirana, ju do të luftoni që Deklarata e Mbledhjes së Moskës të bëhet sa më e fortë, me barut e jo me pambuk dhe të përmbajë çështje të formuluar drejt, sipas pikëpamjes sonë dhe jo pikëpamje ekuivoke e të shpëlara, siç do të përpiqet të vërë delegacioni sovjetik, idetë e të cilit janë oportuniste dhe revizioniste.

Ju duhet të keni parasysh një gjë që, me anë të deklaratës, ne, jo vetëm të shprehim pikëpamjet e drejta marksiste-leniniste të Partisë sonë mbi problemin, por çdo komunist në botë, kur ta këndojë këtë dokument, të kuptojë menjëherë se «në konfliktin

ideologjik» që trumbetoi në kamp dhe jashtë kampit grupi i Hrushovit, ky humbi dhe kursi i tij revizionist u dënua. Këtë gjë ta kuptojnë duke lexuar deklaratën, në radhë të parë anëtarët e atyre partive ku çështjet u shtruan shtrembër, duke shpifur kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, të cilat u dënuan padrejtësisht dhe kundër tyre u hodh baltë. Kjo ka shumë rëndësi, pse shpifësit nuk kanë kurrë ndër mend të rikthehen në partitë e tyre dhe të bëjnë autokritikë. Prandaj, varet shumë nga diskutimet tuaja që do të zhvillojë aty, varet shumë nga formulimet që do të propozohen nga ju. U vini shumë kujdes formulimeve të çështjeve kryesore. Në këto formulime, të keni parasysh të mos u qëndroni caqeve të tekstit sovjetik dhe formës që ata i kanë dhënë shtruarjes së një problemi. Me këtë dua të them mos u përpiqni të rregulloni çështjen mbi frazën e ndërtuar nga sovjetikët ose të mos prishni «kuadrin» e përgjithshëm ose të pjesshëm të strukturës së tekstit sovjetik. Një mënyrë ndërtimi e tillë do t'ju pengojë në formulimin e ideve siç i konceptojmë ne, sepse sovjetikët e kanë ndërtuar atë tekst konform pikëpamjeve të tyre, janë zgjeruar në disa vende për të futur një copë helm, ose helmin e kanë shpërndarë në një «tiradë» të tërë, ku kanë hedhur rrugës edhe një çikë pluhur sheqeri. Prandaj as mos çani kokën për strukturën dhe për ndërtimin e tekstit sovjetik, ju preokupohuni për problemet kyçe, hiqni ato që janë lakra dhe profka, pastaj Sekretariati le ta ndreqë strukturën e Deklaratës.

Deklarata sipas mendimit tim qelbet në çështjet kryesore dhe është ashtu si mendoni edhe ju. Unë e

lexova një herë me kujdes dhe duke e kënduar kam bërë edhe shënime përbri tekstit. T'i përmblihdja të gjitha këto vërejtje e t'i përpunoja s'më lejonte koha. Kështu që vendosa t'ju dërgoj tekstin, ku kam bërë shënimet. Mos mendoni se çdo shënim në këtë tekst është xhevahir, atje ka edhe gjëra të tepërta, të shpejtuara, të bëra nën presionin e zemërimit, prandaj i shikoni vetë, më tepër qëllimi është për t'ju kujtuar diçka që ju mund të mos ju ketë rënë në sy dhe më ka rënë mua e anasjelltas. Jam i sigurtë se ju i keni nxjerrë ujë materialit sovjetik, dhe të gjitha çështjet delikate i keni parë, prandaj nga ajo anë jam i qetë. Por sidoqoftë, megjithëse do të hiqni ca keq për t'i lexuar shënimet e mia, se i kam shkarravitur, do të jem i kënaqur në rast se do t'ju ndihmojnë ndopak.

Në rast se keni ndonjë gjë të veçantë që të konsultohemi, më bëni radiogram. Përsa i përket fjalimit që do të mbani, do të jetë shumë mirë të na dërgoni një kopje, siç e thoni edhe vetë, se mund t'ju ndihmojmë me ndonjë vërejtje qoftë me radiogram, qoftë duke ju kthyer tekstin me vërejtje, në qoftë se do të kemi të tilla dhe në qoftë se na lejon koha e kthimit të avionit.

...Grupi i Hrushovit i ka rreshtuar në anën e tij një numër të madh partish, të cilat i kapi në befasi dhe i shfrytëzon në besimin dhe në dashurinë që kanë për Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Do të jetë zor për këto parti dhe për këta komunistë që të kenë guximin e menjëhershëm e të mbajnë qëndrim të prerë. Kjo është e vërtetë. Por bëhet shumë e rrezikshme ta lësh këtë çështje të zvarritet, pse revizionizmi do të bëjë punën e vet të tmerrshme, do të komprometojë

njerëz dhe parti, do të zhvillojë demagogji të madhe me propagandë dhe me fonde materiale të mëdha. Brenda dhjetë vjetëve klika e Titos e shturi fare partinë dhe komunistët e patriotët e vërtetë i rrsi në burgje ose i vrau. Prandaj qëndrimi më i drejtë është që në këtë mbledhje t'i vemë çështjes deri në fund, si marksistë. Të dalë lakuriq kush është në rrugë antimarksiste, kush po e tradhton marksizëm-leninizmin dhe po shkel Deklaratën e Moskës të vitit 1957. Ky është grupi i Hrushovit. Prandaj mbledhja t'i vërë pikat mbi i-të. Të vihen pikat mbi i-të, mbi Bukureshtin dhe ata që kanë bërë gabime, t'i njohin këto në mbledhje si marksistë dhe të shkojnë në partitë e tyre t'i korrigjojnë. Grupi i Hrushovit nuk do t'i pranojë gabimet, atëherë ai është shkaktar i përçarjes së unitetit ideologjik të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ne jemi në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Grupi i Hrushovit ka devijuar në revizionizëm, prandaj do ta demaskojë lufta jonë dhe koha. Por ka një gjë veç, se kërcënimi dhe përçarja do ta shpejtojnë procesin e falimentimit të grupit të Hrushovit dhe izolimin e tij nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe partitë e tjera, të cilat do të tronditen dhe do t'i vënë më mirë dhe më shpejt gishtin kokës. Ndryshe, këto parti e heqin veten si jashtë konfliktit, bile e quajnë një sukses që nuk u arrit përçarja, ia lënë kohës ta vërtetojë drejtësinë e vijës sovjetike apo të vijës sonë. Parulla që «vijën ta vërtetojë koha», si predikojnë disa..., i vjen për hosh Hrushovit, është parullë oportuniste, revizioniste dhe antimarksiste. Ajo përmban në vetvete frikën për mos me u shkue gjërave deri në fund dhe për mos me i

shërue rrënjësisht gabimet. Ky mendim shërben për të mbajtur statukuonë hrushoviane me disa arnime, të cilat as i ka peshuar dhe as i peshon e do t'i peshojë fare Hrushovi. Kjo parullë u jep dorë revizionistëve të veprojnë më tej, të përhapin revizionizmin. Me një fjalë, po të adoptohet kjo parullë, duhet të jemi të bindur se ka rreziqe të mëdha.

Revizionizmi është rreziku kryesor, duhet goditur, sado të mëdha që të jenë «kokët» që e kanë brenda këtë sëmundje të qelbur. Absesi duhet spastruar me bisturi. Të gjithë ata që thonë «t'ia lëmë kohës», i kuptojnë situatat, por nuk e kanë guximin e revolucionarëve që t'i vënë gishtin plagës dhe të përdorin mjetet efikase për ta spastruar atë.

Nga ana tjetër, duhet të dimë se grupi i Hrushovit i trembet situatës së krijuar, i trembet përçarjes. Ai e sheh se politika e tij pëson disfata, se ka krijuar situata të rënda, jo të drejta, se ideologjikisht ai është me vetëdije të plotë në rrugën e greminës, pa shpresa. Pra, në këto situata, a na lejohet neve ta lëmë këtë grup revizionist të marrë frymë, të kapërcejë këtë hendek të madh që krijoi? Mua më duket se nuk duhet ta lejojmë. Do të bëjmë gabim po të mos e demaskojmë grupin e Hrushovit, sepse ky do të përfitojë për të dëmtuar më shumë Bashkimin Sovjetik, Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe komunizmin ndërkombëtar. Hrushovi është përlivan panairesh. Shihni se ç'bën në OKB. Kjo është arsyeja që unë të bëra atë radiogram të gjatë parmbremë.

Por, sidoqoftë, i dashur Hysni, ju vazhdoni punën që keni zënë, drejt e keni.

Viton e ke mirë, u grinë së mësuari me Nexhmijen¹. Besnikun gjithashtu e ke mirë, e kisha për drekë të dielën.

Nga Mehmeti marr çdo ditë radiograme «zbavitëse». Punët vazhdojnë si më parë. Asnjë rezultat konkret. As çarmatim, as riorganizim të Sekretariatit të OKB-së, as takim, as droq. Vetëm «suksesi» ka qenë krijimi i forcës së tretë me Titon në krye dhe pagëzimi nga ana e «djadja» Hrushovit. . .

Ramizit dhe shokëve shumë të fala. Shokët këndeju përshëndesin.

Ju përqafoj

E n v e r

*Botohet për herë të parë.
Marrë nga origjinali që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

¹ Shoqet Vito Kapo e Nexhmije Hoxha, në atë kohë ndiqnin me korrespondencë studimet në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës.

RADIOGRAM

SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK

4 tetor 1960

Shoku Mehmet,

Të gjitha radiogramet i kam marrë. Po e ndjekim «fiaskon» e OKB-së.

1) Mbledhja në Moskë filloi të shtunën. Vetëm sa u hap. E hapi Suslovka. Asistonin Kozlovka, Andropovka, Muhitdinovka dhe Pospjellovka e të tjerë. Ftohtë dhe akull. U la kohë për të studjuar materialin dhe sot, të martën, në orën 14, mbledhja do të hapet përsëri. Ten Hsiao Pini do të flasë më parë nga Hysniu, kurse ky parashikohet të flasë të enjten ose të premtën.

2) Projektdeklaratën e studjova me kujdes dhe vërejtjet ia dërgova të gjitha Hysniut bashkë me taktikën që duhet të ndjekë në komision. Deklarata është e qelbur, revizioniste, përsëritje bajate, zgjatje të çështjeve për të shpërndarë helmin që të mund ta gëlltitim ne dhe rrugës është pudrosur me ca sheqer toz që të na duket helmi i ëmbël. Bën disa «finta», gjoja tërheqjeje, por që s'na kënaqin aspak, prandaj e vura në

roje Hysninë dhe e udhëzova se si duhen formuluar çështjet.

3) Hysniu më shkruan se fjalën e hapjes do të ma dërgojë ta shoh. Hysniu është krejt i aftë dhe i armatosur mirë për qëndrimet që duhet të mbajë.

... Në mbledhje ka disa që ia kanë frikën asaj, që ne s'ia kemi, në rast se grupi i Hrushovit nuk vjen në islá. Për këtë nuk jemi dakord me ta, por duhet të diskutojmë dhe t'i bindim, pse ne e shikojmë më drejt, më radikalisht dhe grupi i Hrushovit duhet t'i trembet asaj që mendojmë ne dhe jo t'i trembemi ne. Ne i kemi pozitát të drejta dhe të forta. Ata i kanë revizioniste dhe të dobëta. Prandaj duhet rrahur hekuri sa është i nxehtë, se, po të iku pëhlivani i panairëve nga dora, të bën një mijë e një iluzionizma dhe jo më brenda 10-15 vjetëve që të bën hatara. Por sidoqoftë kjo është etapa e fundit, ti do të kthehesh dhe do të bisedojmë këtu, para se të vemi në Moskë.

4) Hysniu më shkruante se dje Kozllovka e thirri për drekë, por Hysniu e falenderoi e s'vajti. Duke marrë parasysh ç'na ka bërë ai neve, kjo i vajti bukur, që të kuptojë me kë ka të bëjë.

5) Marrim vesh nga burime të sigurta se Mbledhja e Bukureshtit ishte parapregatitur në shpinën e Partisë sonë dhe Partisë Komuniste të Kinës. Hrushovi kishte informuar, kishte diskutuar, kishte marrë aprovimin e të gjithë djemkave të tij se si do të shtroheshin çështjet në Bukuresht, çfarë do të bisedohej dhe si duhej vendosur. Kjo është hapur, jo fraksion, por komplot. Këtu e kishte të gjithë qëllimin lufta e Ivanovit me Koço Tashkon që ngulmonin të shkoja për

pushime: të më komprometonin dhe të më futnin në llucë. Po na rruan...

6) Plenumin për arsimin e hapim më 7 tetor. Në Byro vendosëm përfundimisht për çështjet në diskutim lidhur me riorganizimin e shkollës. Nuk vendosëm vetëm nëse shkolla të jetë 11 ose 12 vjet, pse mendimet ishin të ndara. Do të shohim ç'do të thotë edhe Plenumi. Unë anova për 12 vjet, besoj se edhe ti je për 12 vjet. Por unë mendova një variant që s'i prish asgjë riorganizimit të shkollës dhe përgatitjes së programeve të reja, ne mund të mos vendosim qysh tani për vitet. Kemi një afat prej 3-4 vjetësh të bëjmë eksperimentin me ato klasa që kemi vendosur që sivjet të futim edhe punën dhe, gjatë kësaj kohe, mësuesit të studjojnë programet e reja e kështu do të përcaktohet më drejt kjo çështje. Çështje e drejta nuk është lehtë të rrëzohet varianti i shkollës 12-vjeçare, por edhe ai i asaj 11-vjeçare ka avantazhet dhe disavantazhet e veta. Sidoqoftë, do ta vendosim si më mirë.

Fiqretin dhe fëmijët i ke mirë.

Të përqafoj dhe të presim sa më parë.

S h p a t i

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM

SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK

6 tetor 1960

Shoku Mehmet,

1) Mirë i je përgjigjur Vinogradovit për çështjen e çarmatimit. «Rrapo Leloja» dëshiron të fshehtë dështimin në OKB, të torolisë miletin dhe të mobilizojë shtypin se në vitin e ardhshëm do të ketë donomara të reja. Që opinioni publik t'u bëjë presion amerikanëve, kjo është gjë e mirë, se ngrihet urrejtja dhe vigjilenca, por ky e ka për t'u dukur vetë, të marrë inisiativën vetë, të shkojë vetë e të gjitha vetë. Prandaj drejt veprime që s'ia refuzove në parim. Por sa për ta deklaruar kemi kohë. Ai do ta deklarojë, se nuk pyet për mendimin tonë. Dhe këtë e bën për ndonjë shejtanllëk.

2) Mbledhja e komisionit në Moskë u hap dje, folën nja pesë veta, delegatë të bindur, të cilët kishin marrë parullën: «Asnjë fjalë për kontradiktat», sikur s'kishte ngjarë asgjë. S'përmendin as Bashkim Sovjetik, as Kinë. Fjalë të përgjithshme dhe solidarizim me projektdeklaratën sovjetike. Folën finlandezi, hun-

garezi, gjermani perëndimor, mongoli dhe italian. Sot do të flasë kinezi.

3) ...

4) Nga fronti i brendshëm s'ka gjë të re. Tokat po punohen; panxhari po shkulet, por shumë i dobët. Një tërmet i vogël ka rënë në zonën e Kardhiqit, por pa dëme në njerëz, vetëm disa shtëpi u rrëzuan. Gjendja nuk është shqetësuese. Regjistrimi i popullsisë u bë në rregull. Spiroja [Koleka] është mbyllur dhe po punon për raportin.

Nënën tënde shkova e takova prapë sot dhe i dhashë sihariqin e kthimit tënd. U gëzua. Fiqretin me fëmijë i ke mirë, të bëjnë të fala. Shokët dhe Nexhmija të bëjnë gjithashtu të fala. Beharit, Reizit dhe shokëve të fala.

Yti

S h p a t i

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË

7 tetor 1960

Ora 24⁰⁰

I dashur shoku Hysni,

Sot hapëm Plenumin, punimet shkojnë mirë, vazhdojnë diskutimet mbi reformën e shkollës. Diskutimet janë të mira. Edhe nesër do të vazhdojmë me diskutimin e këtij problemi dhe pastaj me projektdirektivat e pesëvjeçarit.

Sot në drekë mora pakon me materialin që më dërgove. Ti e kupton se efektivisht kam pasur shumë pak kohë, por me shpejtësi u hodha një sy letrave të tua, fjalimit tënd si edhe riformulimeve dhe korigjimeve që do t'i bëni projektdeklaratës.

1. — Përsa i përket fjalimit tënd, më pëlqeu, ishin prekur mirë problemet dhe toni ishte në rregull. Në qoftë se ju vjen rasti, qoftë në mbledhje plenare, qoftë Ramizi në komision, me mbrojtë më fort Partinë Komuniste të Kinës, se lufta kryesore i bëhet asaj, bateritë kryesore janë drejtuar kundër asaj. Ne na kanë mëri sa edhe kinezëve dhe s'ka dyshim se do të

na sulmojnë, por sulmi kryesor i tyre do të përqëndrohet te Partia Komuniste e Kinës, pse ata mendojnë, dhe ashtu është, se rreziku më i madh, si potencial për ta, është Partia Komuniste e Kinës dhe mendojnë «*po e mposhtëm këtë, puna e shqiptarëve s'ka rëndësi*».

Prandaj ne, tash për tash, jemi në pozita të paatakueshme, por do të atakohemi, sidomos kur të lëshojmë kúcurat mbi kokën e Hrushovit, do të na akuzojnë dhe ne si «dogmatikë», pse mbajmë anën e Kinës. Ne duhet t'u tregojmë sovjetikëve dhe përkrahësve të tyre, se kemi një vijë marksiste-leniniste, se ne e mbrojmë Partinë Komuniste të Kinës, sepse ajo ka një vijë të drejtë marksiste-leniniste, ne luftojmë pikëpamjet revizioniste, oportuniste të djathta si dhe shpifësit e falsifikatorët.

Nga këto pozita ne atakojmë të gjithë ata që do të guxojnë në mënyrë të maskuar ose haptazi të na sulmojnë.

Ato parti, përveç atyre që dimë se janë në pozita të gabuara, që hezitojnë, që s'kanë kurajë të flasin hapur, që s'flasin për Partinë tonë ose thonë ndonjë fjalë pa zarar për ne, mos i ngitni, mos i hidhni në luftë të hapur me ne, manovroni. Sulmi të përqëndrohet kundër kryesorëve, që janë shkaktarët e deviacionit oportunist dhe që godasin vijën tonë të drejtë. Në qoftë se këto, përveç asaj sovjetike, bullgare, polake e ndonjë si këto, sulmojnë vetëm me ndonjë fjalë Partinë Komuniste të Kinës, pse s'bëjnë dot ndryshe, ju mos i ngitni, lini kinezët të gjykojnë vetë taktikën që duhet të ndjekin.

2) ...

Sipas mendimit tim sovjetikët kanë interes t'i mbyllin gjërat, t'u vënë kapakun qelbësirave të tyre, pse nuk është në interesin e tyre hëpërhë që t'i thellojnë kontradiktat. Ata janë gati të bëjnë disa lëshime, veç ta kalojnë lumin pa u lagur: të bëjnë korrigjimet e kërkuara, në një formë ose në një tjetër dhe «s'keni pse bëni debate e diskutime». «Jemi dakord». «Shkoni në shtëpi!»

Mundet që gabohem në vlerësimin që i bëj manovrës që mund të luajnë sovjetikët. Ta thashë edhe në fillim që vetëm sa u hodha shpejt e shpejt një sy materialeve. Fjalimi yt nuk ua jep këtë mundësi sovjetikëve pse andej del hapur që «kemi hesape për të larë». Fjalimet tona në fillim mund të jenë si «prelud», por që më pas duhet të shpërthejnë si simfonitë e Bethovenit; ne s'jemi për «serenada nocturne».

3) Lexova gjithashtu formulimet e vërejtjeve të projektdeklaratës. Mua më duken të mira. Konsultohuni dhe bashkëpunoni me shokët kinezë. Përse sovjetikët e të tjerë të bëjnë një punë të koordinuar në mes tyre dhe ne jo?

Unë do të thosha të rishikoni edhe një herë formulimet e «kalimit në socializëm» që të dalë më mirë fryma e pikëpamjes sonë. Ju kujtoj edhe një herë çështjen e «kultit» që duhet të formulohet në një mënyrë tjetër, se në nëntor do ta prekim në lidhje me Stalinin e qëndrimin e Hrushovit. Në një vend flitet për «fraksione», shiheni edhe një herë se mos është vënë me djallëzi. Edhe një vërejtje të fundit: në faqen 27, paragrafi 2 i projektdeklaratës së shtypur në Tiranë

ose faqe 14 e formulimeve tuaja, duhet të dalë ideja e Leninit: «... derisa borgjezia nuk pengon lëvizjen punëtore dhe pararëjën e vet në luftën e saj ideologjike, politike dhe ekonomike...» (ky është citat i Leninit), por duhet saktësuar ideja që kanë futur sovjetikët më pas, se e kanë fjalën të Nehru i të tjerë, për të justifikuar ndihmat që u japin.

4) Është vështirë të të them se çfarë t'u hedhësh në fytyrë, e çfarë të mos u hedhësh. Kjo varet nga situatat. Ti shko nga parimi, mbro Partinë dhe vijën e saj pa druajtje, pa hezituat «ta them këtë apo ta rezervoj?» Si ta gjykosh vetë. Ti duhet, kundërshtarin ta demaskosh me argumente të drejta dhe ta dërrmosh. Për këtë mund të të mjaftojë vetëm një fakt i përdorur me kohë dhe me vend, që ai (kundërshtari) të bjerë me fytyrë në ballë. Prandaj mos i lidh duart dhe mos u preokupo se mos bësh ndonjë gabim.

Çështja është vetëm këtu, që disa gjëra t'i ruanim për në Mbledhjen e Moskës në vend që t'i hedhim në komision, sepse, po t'i dinin sovjetikët, do të përpunonin taktikën për kundërsulm.

Bullgarëve, rumunëve dhe polakëve, numërojua pa hezitim, se ata janë bythë e brekë me sovjetikët. Edhe të tjerët atje vërtiten, por shih e bëj. Më i rezervuar ji me çekët, në rast se nuk na sulmojnë; ta them këtë se Novotni u suall me Mehmetin në Nju-Jork si ngahera, sikur s'kishte ngjarë gjë. Dhe hungarezët, me sa dimë ne, nuk tregohen aktivë, pavarësisht nga fjalimi i tyre atje.

Me francezët, derisa hezitojnë, thuajuni në forma

të ndryshme: «ku po shkoni? Ne e ndiejmë që ju i kuptoni ku janë gabimet dhe duhet të ndihmoni që të mos bëhen gabime akoma më të rënda etj. etj.». Përpiguni në këtë drejtim.

Një nga diplomatët e një vendi të demokracisë popullore në Romë i tha një shokut tonë se ato që u shtruan në Bukuresht, udhëheqësit e partive komuniste e punëtore të kampit, me përjashtim të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Partisë Komuniste të Kinës, i dinin, sepse Hrushovi ishte konsultuar me ta. Pra Bukureshti ishte organizuar që më parë në prapaskenë si fraksion ndërkombëtar (këtë argument do ta përdorim në Mbledhjen e Moskës).

Tjetër ç'të të them, punë të mbarë. E di që lodheni dhe vuani nga «akulli», por s'kemi ç'bëjmë, lufta për të drejtën, s'ta shtron fushën me lule. Kur lufton për Partinë, për popullin e komunizmin s'ka as lodhje as mërzi.

Shokët shkuan në «prijom» te gjermanët, unë nuk shkova, se të shkrova këtë letër që të ta çoj nesër me avion. S'vajta te gjermani në pritje edhe për t'u lënë të kuptojnë se s'na erdhi mirë që delegacioni i tyre nuk na ktheu vizitën zyrtare, megjithëse e kishin vendosur datën dhe përbërjen. Ata dhanë arsye të kota për mosardhje, por arsyet janë ato që dimë e për të cilat luftoni ju atje.

Në OKB «fiasko»! Me F të madhe. Mehmeti nisët nga Nju-Jorku më 11 tetor dhe arrin në Tiranë më 20-21.

Më 25 tetor mbledhim Kuvendin Popullor dhe me

këtë rast do të flasë Mehmeti për «triumfin» e çarmatimit dhe të bashkekzistencës së «Rrapo Lelos» në OKB. Ramizit i bëj shumë të fala.

Ju përqafoj me mall

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PËR PROBLEMET E SHKOLLËS TË KUJDESEN JO VETËM ARSIMTARËT, POR GJITHË SHOQËRIA

Fjala e mbylljes në Plenumin XIX të KQ të PPSH¹

8 tetor 1960

Së pari, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, dua të shpreh mirënjohjen dhe respektin e madh të Partisë për mësuesit dhe për pedagogët e shkollave tona dhe për të gjithë punonjësit e tjerë të arsimit që, në një formë ose në një tjetër, ndihmojnë rininë tonë të mësojë.

Partia dhe Qeveria jonë janë kujdesur gjithmonë për problemet e arsimit, por duhet njohur se mësuesve dhe pedagogëve tanë u takon merita dhe roli vendimtar

¹ Plenumi XIX i KQ të PPSH, që zhvilloi punimet më 7-8 tetor 1960, në pikën e parë të rendit të ditës dëgjoi, diskutoi dhe aprovoi raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH, «Mbi riorganizimin e shkollës dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit arsimor», mbajtur nga shoku Manush Myftiu, anëtar i Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe në atë kohë ministër i Arsimit dhe i Kulturës.

në zhvillimin e në përhapjen e arsimit, pa punën e tyre nuk do të kishim gjithë këto përparime të mëdha që janë arritur në fushën e arsimit e të kulturës.

Ne themi me të drejtë se kemi një rëni të shëndoshë, patriote, të flaktë. Natyrisht, kjo i detyrohet kujdesit dhe punës së palodhur politike dhe ideologjike të Partisë sonë dhe kushteve që ka krijuar ndërtimi i socializmit në Shqipëri. Por, edukimi dhe frymëzimi i rinisë me dashuri të madhe për popullin, atdheun dhe socializmin, i detyrohet gjithashtu punës së mësuesve dhe të pedagogëve tanë.

Ne, që na ka ngarkuar Partia për drejtimin e shtetit dhe të Partisë, mund të themi pa hezitur që në tërë punën tonë, në asnjë kohë dhe asnjëherë, nuk na ka preokupuar çështja morale, politike ose ideologjike e arsimtarëve. Një gjë e tillë do të thotë se kjo pjesë e rëndësishme e inteligjencës sonë qëndron lart nga ana politike dhe ideologjike dhe është e lidhur ngushtë me popullin e me pushtetin popullor, me Partinë e Punës dhe me vijën e saj të drejtë për ndërtimin e socializmit. Ky është qëndrimi i gjithë arsimtarëve të vjetër e të rinj, me parti dhe pa parti dhe ky është një sukses i madh për vendin tonë dhe një e mirë e madhe për popullin tonë.

Prandaj, arsimtari në vendin tonë duhet të nderohet e të respektohet nga të gjithë. Arsimtarët duhet të ndihmohen me të gjitha forcat nga Partia dhe nga pushteti ynë, të ndihmohen ata për kryerjen e misionit të tyre fisnik në edukimin e rinisë e për forcimin e shkollës, të ndihmohen në përpjekjet e tyre për ngritjen e nivelit profesional, të ndihmohen në krijimin e kush-

teve më të mira për punë e jetesë, sidomos në fshatra e në zona të largëta.

Njerëzit e Partisë dhe të pushtetit duhet të kenë parasysh se arsimtarët tanë nuk kanë kërkesa të tepruara. Kjo, natyrisht, ndodh se intelektualët tanë, veçanërisht mësuesit dhe pedagogët, janë njerëz të popullit, që jetojnë dita-ditës me popullin dhe janë realistë e modestë. Ata e kanë të qartë se jeta në vendin tonë përmirësohet me punën dhe me përpjekjet e gjithë punonjësve dhe me ngritjen e nivelit ekonomiko-kulturor të vendit.

Të kemi parasysh, shokë, se mësuesve dhe pedagogëve u kemi dhënë në dorë për të edukuar brezin e ri, të ardhshmen e vendit tonë. Tani ata që edukohen në shkolla janë të rinj, po nesër do të rriten dhe do të marrin në duart e tyre drejtimin e vendit, ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit. Prandaj, Partia duhet të tregojë një kujdes të veçantë për mësuesit dhe për pedagogët, t'i mbajë afër dhe t'i ndihmojë në punë dhe në vështirësitë që hasin në jetë, t'i edukojë ata të jenë të thjeshtë e të dashur me popullin dhe me nxënësit e tyre dhe që tërë kujdesin dhe punën e tyre t'ia kushtojnë shkollës, përparimit të saj.

Me këto masa që po marrim për arsimin, shokë, ne i kemi hyrë një punë me rëndësi të madhe, që e kërkon situata dhe zhvillimi i vendit tonë. Ne përfitojmë nga eksperiencia e Bashkimit Sovjetik dhe e vendeve vëllezër të demokracisë popullore edhe në fushën e arsimit. Ne bëjmë Reformën Arsimore, sepse ajo është e domosdoshme për ndërtimin e socializmit në vendin tonë, ajo do të shërbejë për edukimin e për pregatitjen

më të mirë të rinisë për jetën dhe detyrat e ndërtimit të shoqërisë socialiste e komuniste. Tani ne kemi krijuar baza të tilla që mund dhe është e nevojshme ta bëjmë këtë reformë.

Tezat e Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë për riorganizimin e për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit arsimor u shtruan gjerësisht për diskutim nga masat. Këtë punë ne e bëmë për dy qëllime: jo vetëm për t'u këshilluar me masat, gjë që buron nga karakteri demokratik i pushtetit tonë popullor, por edhe për të popullarizuar në shkallë të gjerë këtë reformë dhe për të ngjallur interesimin e inisiativën e masave popullore për arsimin. Për shkollën të kujdesen jo vetëm arsimtarët, po dhe punëtorët, fshatarët, gjithë intelektualët, specialistët e çdo dege, gjithë kuadrot e Partisë, të pushtetit, organizatat ekonomike, shoqërore e të tjera.

Por duhet pasur parasysh se nuk është i mjaftueshëm popullarizimi që i kemi bërë gjer tani kësaj reforme shumë të rëndësishme. Ne kemi akoma dy vjet përpara për vënien në jetë të saj, prandaj duhet të vazhdojmë edhe në të ardhshmen popullarizimin dhe konkretizimin e kësaj Reforme të madhe Arsimore dhe jo vetëm me fjalë, por sidomos me masa organizative në praktikë, sikurse është organizimi i shkollave eksperimentale, ashtu siç kemi bërë dhe do të bëjmë gjatë kësaj kohe, organizimi i bashkëpunimit konkret ndërmjet shkollave e ndërmarrjeve ekonomike, industriale, kooperativiste etj., diskutimi e gjetja e rrugëve për të siguruar lidhjen sa më të ngushtë të shkollës me jetën, lidhjen e mësimit me prodhimin.

E rëndësishme është gjithashtu që gjatë dy vjetëve të ardhshëm ne të përgatitim shpirtërisht dhe praktikisht mësuesit dhe pedagogët për një revolucion të tillë në shkollat tona. Një punë e madhe dhe me shumë përgjegjësi duhet bërë për përgatitjen e programeve dhe të teksteve.

Në këtë reformë, shokë, ka dy çështje kryesore që janë mbështetja e njëra-tjetrës. Me rëndësi është çështja që në shkollë ne futim praktikën, punën dhe, duke e lidhur këtë ngushtë me teorinë, ne duam t'ia arrijmë qëllimit që të përvetësohen më thellë dijenitë teorike, në mënyrë që të rinjtë e të rejtat e vendit tonë të jenë të pajisur me një kulturë të mjaftueshme dhe të jenë të aftë për punën dhe për të përballuar detyrat që do t'u ngarkohen në jetë, të jenë në gjendje të mësojnë më tej në shkollat e larta, të përvetësojnë profesionet e nevojshme për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë.

Riorganizimi i shkollës parashikon që në shkallën e parë t'u jepet masave të gjera të rinisë dhe moshave mesatare, që nuk kanë pasur rast të ndiqnin shkollat në kohën e duhur, një kulturë pak a shumë e plotë gjatë 8 vjetëve. Me vendosjen e 8-vjeçares, si sistem i arsimit të detyrueshëm, çdo i ri ose e re do të jetë i përgatitur në mënyrë të mjaftueshme të ndjekë shkollat e ulëta e të mesme profesionale ose të arsimit të përgjithshëm, me shkëputje ose pa shkëputje nga puna. Por njëkohësisht në shkollë ne duhet të ngjallim te të rinjtë dhe të rejtat tona dëshirën e madhe për punën, për atë që zbukuron njeriun dhe jetën. Kështu, kur nxënësi të mbarojë 8-vjeçaren, të ketë edhe dituri më të

plotë, të jetë edhe i përgatitur gjer në një farë shkalle për të punuar. Kur t'i kemi të dyja këto, atëherë do të rrojmë më mirë dhe do të përparojmë më shpejt. Ky, pra, është qëllimi i kësaj reforme të rëndësishme.

Byroja Politike e ka marrë në shqyrtim dhe e ka diskutuar disa herë çështjen e riorganizimit të shkollës, përpara se t'i paraqitej Plenumit të Komitetit Qendror, sepse kjo nuk është një çështje e vogël. Një reformë e tillë nuk bëhet vetëm për një vit ose për dy, ajo bëhet për një periudhë pak a shumë të gjatë. Që të mund të shohim përmirësimet që sjell një reformë e tillë duhet të shihen rezultatet e saj pas një farë periudhe, pasi të kemi fituar një eksperiencë të gjatë dhe vetëm pas kësaj mund t'i bëjmë ndryshimet e nevojshme.

Byronë Politike, sikurse dhe shumë shokë të tjerë, e ka preokupuar çështja se mos me këtë reformë dobësohet ana teorike e shkollës. Prandaj ndoqi me vëmendje diskutimet e arsimtarëve dhe, veçanërisht, mendimet e tyre lidhur me afatin e shkollës së mesme. Ne mendojmë se duhet peshuar me kujdes sa kulturë do të marrë një nxënës dhe si do ta përvetësojë atë brenda 11 vjetëve dhe brenda 12 vjetëve. Ne duhet të kemi parasysh nivelin e shkollës, të kuadrit arsimor, të familjes sonë, si dhe kërkesat gjithnjë në rritje lidhur me zhvillimin e shkencës e të teknikës. Ne duhet të kemi parasysh edhe shëndetin e nxënësve, edhe kjo është një çështje me shumë rëndësi, sepse rendi ynë socialist kujdeset që njerëzit jo vetëm të jenë të kulturuar dhe të aftë për t'i shërbyer shoqërisë dhe vetes,

por edhe të rrojnë sa më shumë. Duhet studjuar me kujdes që puna dhe mësimi, lodhja mendore e fizike, të vijë duke u rritur gradualisht në përshtatje me moshën.

Natyrisht duhen pasur parasysh gjithashtu edhe shumë probleme të tjera të ndërtimit të socializmit, mjaft nevoja të vendit tonë. Për shembull, vendi ynë ka nevoja të mëdha për kuadro. Këto nevoja kanë qenë shumë të mëdha 10-12 vjet përpara, në krahasim me tani, por ne mund të themi se edhe tani nevojat tona për kuadro janë të mëdha. Por me masat e shumanshme që janë marrë, me shkolla, kurse dhe me anën e formave të tjera, kemi arritur që përgatitja e kuadrove tanë të ecë me ritme të shpejta.

Në vitin shkollor 1970-1971, kur do të dalë kontingjenti i parë i djemve dhe i vajzave nga shkolla e re, nevojat e vendit tonë për specialistë nuk do të jenë në gjendjen e tanishme. Por, ajo që tha këtu një nga shokët diskutantë, duhet pasur parasysh: jeta gjer atëherë do të ketë përparuar shumë në vendin tonë, në krahasim me tani, ne do të kemi atëherë makineri shumë më të përsosura, njohja dhe shfrytëzimi i të cilave do të kërkojë njerëz me kulturë më të lartë dhe përgatitje më të mirë.

Le të marrim, për shembull, çështjen e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare. Kur u krijua ushtria jonë kërkesat e saj nuk ishin ato të sotmet. Atëherë kishim nga një dyfek të vjetër të Italisë ose të Gjermanisë dhe kujdesi ynë ishte të luftonim analfabetizmin në radhët e partizanëve dhe të fshatarësisë. Mirëpo pas Çlirimit ndryshoi gjendja. Për ne u bë e domosdoshme të

pregatitnim kuadrin oficer nëpër shkolla të mesme e të larta ushtarake, mbasi pas Çlirimit teknika ka ndryshuar vazhdimisht, ajo ka ecur shumë përpara, prandaj ushtria tani i kërkon ushtarët të kenë, po të jetë e mundur, shkollë të mesme.

Kjo nuk do të thotë se ne duam luftën, po ama barutin duhet ta mbajmë kurdoherë të thatë, ushtrinë ta kemi të përfeksionuar dhe të gjitha llojet e armëve duhet t'i kemi në gatishmëri të plotë, sepse imperializmi armët nuk i hedh poshtë. Pavarësisht se ç'thonë disa, imperializmi do t'i hedhë armët vetëm kur të gjithë popujt, në radhë të parë popujt e vendeve tona të kampit të socializmit, të ngrihen në këmbë dhe t'ia imponojmë këtë gjë.

Kjo do të arrihet me një luftë të pandërprerë politike dhe ideologjike, duke e demaskuar gjer në fund imperializmin dhe intrigat e tij, duke ndihmuar luftën nacionalçlirimtare të popujve që vuajnë akoma nën sundimin e huaj, në mënyrë që prapavijat e imperializmit të ziejnë, domethënë kur popujt e këtyre vendeve, me klasën punëtore përpara dhe të udhëhequr nga partitë marksiste-leniniste, t'u bëjnë një luftë të paepur imperializmit dhe kapitalizmit për të fituar të drejtat e tyre politike dhe ekonomike, gjer në marrjen e pushtetit në dorë.

Por, të mos largohemi nga tema, le të kthehemi në çështjen e shkollës. Reforma jonë Arsimore ka parasysh ato që thuhet në tezat, domethënë që në shkollat tona të zënë vendin e përshtatshëm si teoria, ashtu edhe praktika, në mënyrë që djemtë dhe vajzat

tona të dalin të armatosur mirë për të përballuar detyrat dhe kërkesat që do t'u paraqiten.

Nuk kam asnjë kundërshtim me ata që thonë se ka rëndësi çështja e vjetëve, po rëndësi në radhë të parë ka çështja se si mësuesit dhe pedagogët do t'i japin dhe do t'i zhvillojnë këto lëndë dhe si do të bëjnë që nxënësit t'i përvetësojnë ato sa më thellë. Kjo është kryesorja.

Prandaj, shokë, kur flasim për kujdesin e Partisë dhe të organeve të pushtetit për arsimin, përveç të tjerave, ato duhet ta kenë në vëmendjen e tyre të vazhdueshme këtë çështje, të ndihmojnë me të gjitha mjetet dhe format, që mësuesit dhe pedagogët tanë të zhvillojnë njohuritë e tyre në forma të organizuara dhe në mënyrë individuale, për perfeksionimin e metodave të dhënies së mësimit.

Këtë duhet ta bëjnë organet e pushtetit dhe Ministria e Arsimit. Kjo punë duhet të jetë e koordinuar mirë nën drejtimin e Partisë. Nuk është i drejtë qëndrimi i disa organizatave të Partisë në bazë, që mendojnë se ato nuk janë në gjendje të merren me problemet e shkollës. Natyrisht, atyre nuk u kërkohet të merren me drejtimin e punës metodiko-pedagogjike, por ato, si për çdo sektor tjetër, mund dhe duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në organizimin e punës dhe në krijimin e kushteve për zbatimin e detyrave që u janë ngarkuar shkollës, arsimtarëve, nxënësve dhe shoqërisë. Organizatat e Partisë duhet të aktivizojnë të gjitha levat dhe të ngjallin interesimin shoqëror të masave për arsimin, Partia duhet të tregojë kujdes veçanërisht për aktivizimin e organizatave të rinisë.

Të gjitha këto bëhen për rininë. Partia kujdeset që të rinjtë e të rejat të mësohen, të edukohen, të bëhen luftëtarë të aftë të pararojës për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Dëshira për të mësuar dhe për t'u zhvilluar, respekti dhe dashuria për shkollën, për mësuesit dhe për pedagogët, nuk mund të rrënjosen thellë në ndërgjegjen e të rinjve, në rast se organizatat-bazë të rinisë nuk u japin rëndësi çështjeve të shkollës, nuk mbështeten te mësuesit dhe te pedagogët dhe nuk bashkëpunojnë si duhet e sa duhet për të kapërcyer vështirësitë që u dalin atyre dhe shkollës në përgjithësi. Po të mos punojë kështu organizata e rinisë, ajo nuk e ka bërë si duhet detyrën e saj.

Në drejtim të shkollave vërehen nganjëherë neglizhenca dhe mungesë interesimi jo vetëm nga organizatat-bazë të rinisë, po edhe nga udhëheqja e Partisë dhe nga organet e pushtetit dhe të Ministrisë së Arsimit. Dobësi të tilla duhet të luftohen më me këmbëngulje, sepse çështja e arsimit është jetike për zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit tonë.

Edhe organizata e gruas ka detyra të rëndësishme lidhur me shkollën. Gruaja si nënë luan një rol të madh në edukimin e fëmijëve. Sigurisht edhe neve, burrave, na bie barra të punojmë për edukimin e brezit të ri, po në këtë drejtim nderi më i madh i takon gruas, sepse ajo është nënë dhe është pajisur me ato cilësi që janë aq karakteristike për gruan, dashuria e thellë për fëmijën, durimi, që shpesh na mungon neve, burrave. Kështu, kur vjen rasti e thonë se ky ose ai fëmijë «mëson shumë mirë», «është i edukuar» etj., nuk ka pse të krenohemi ne, baballarët, lëvdatat e meritat i

takojnë në radhë të parë nënës së tij. Sidoqoftë, shokë, prindërit, familja duhet të interesohen shumë më tepër për përparimin e fëmijëve të tyre e të bashkëpunojnë shumë më ngushtë me shkollën.

Për këtë çdo prind duhet ta gjejë kohën. Është për t'u theksuar dhe vihet re se prindërit që janë më të ngritur e kanë punë më shumë dhe nënat që punojnë, interesohen më shumë se ato që nuk punojnë ose që kanë më pak punë. Është e qartë se kjo vjen edhe nga niveli kulturor i prindërve. Por ka prindër, në mes tyre dhe komunistë, që nuk interesohen aq shumë për fëmijët, që nuk i vlerësojnë takimet e prindërve me mësuesit në ditët e caktuara, ose të shkojnë vetë në shkolla dhe të interesohen për sjelljen dhe për përparimin e fëmijëve të tyre. Është vënë re që në këto takime shkojnë më në rregull prindërit, fëmijët e të cilëve shkojnë mirë me mësime, sesa të atyre që janë të prapambetur. Kjo nuk është e drejtë. Prandaj duhet të kombinohet ndihma për edukimin e fëmijëve, në mënyrë që arsimtarë dhe prindër së bashku të punojnë për të nxjerrë nga duart e tyre njeriun që kërkon epoka e ndërtimit të socializmit e të komunizmit.

Me rëndësi të madhe për reformën është çështja e kujdesit që duhet të tregojnë ministritë, ndërmarrjet ekonomike etj. Në shkolla tani do të futet puna praktike, e cila do të bëhet në fabrika, në uzina, në kooperative bujqësore e të tjera. Organet e pushtetit dhe dikasteret, këtë çështje duhet ta marrin me seriozitetin më të madh, ta mbështetën jo vetëm nga ana parimore, po edhe praktikisht, se në këtë drejtim do të dalin mjaft probleme dhe vështirësi, prandaj shkollat duhet

të ndihmohen në mënyrë të gjithanshme, që t'i zgjidhin dhe t'i kapërcejnë ato.

Një nga shokët arsimtarë ngriti këtu çështjen e vazhdimit të mësimit të punës së nxënësve në fabrika e në qendra pune dhe rezultatet që kanë arritur. Kjo punë kështu duhet bërë. Mirëpo, shumë drejtorëve të shkollave të mesme përgjegjësit e ndërmarrjeve u thonë që nuk kanë ku t'i futin nxënësit. Përgjegjësit e ndërmarrjeve jo vetëm duhet t'u gjejnë vend nxënësve për të bërë mësimin e punës praktike, por edhe t'i shpërndajnë drejt ata nëpër reparte sipas prirjeve, të kujdesen që të bëhet me ta një punë serioze, jo vetëm nga shkolla, po edhe nga qendra e punës, nga specialistët e saj, në mënyrë që këta nxënës të bëhen njerëz të kualifikuar, të fitojnë shprehitë e punëtorëve të kategorive sa më të larta. Por nuk duhet të ndodhë që, porsa të dalë nxënësi nga shkolla, të marrë menjëherë kategorinë më të lartë. Ata duhet të bëjnë shumë përpjekje, të derdhin shumë mund e djersë kur t'u jepet, për shembull, kategoria e pestë dhe, kur kjo kategori t'u jepet, ta meritojnë atë me të vërtetë plotësisht.

Kjo do të bëhet në rast se drejtori i ndërmarrjes ose kryetari i kooperativës bujqësore dhe sekretari i organizatës-bazë të Partisë i qendrës së punës, ku do të shkojnë këta nxënës për të bërë praktikën do të mendojnë mirë për këtë çështje të rëndësishme, do të tregojnë kujdes të madh për organizimin e kësaj pune dhe do të vënë mjeshtrit e punonjësit më të dalluar të tyre për të mësuar nxënësit që u janë caktuar.

Nga ana tjetër, Ministria e Arsimit dhe vetë arsimtarët duhet të kenë kujdes të jashtëzakonshëm për këtë problem. Këtu nuk është vetëm çështja t'u futim nxënësve frymën e dashurisë për punën, frymën e rregullit dhe të organizimit, po edhe vetë arsimtarët, duhet të kuptojnë rëndësinë e punës.

Komiteti Qendror i Partisë është i bindur se arsimtarët tanë, ashtu siç kanë kapërcyer mjaft vështirësi në punë dhe në jetë, duhet ta kapërcejnë menjëherë edhe pikëpamjen e mbetur nga shkolla e vjetër se mësuesi është vetëm për t'u mësuar nxënësve teorinë.

Çështja e afatit 11 apo 12 vjet mendojmë se luan një rol të madh. Shumë nga ju tani presin të mësojnë se cili është edhe mendimi im për këtë çështje. Unë mendoj se pikëpamjet e të dyja palëve, si të atyre që mendonin për të qënë shkolla 12-vjeçare, ashtu edhe të atyre të tjerëve që thonë të jetë 11-vjeçare, janë tërheqëse. Nuk është për t'u hedhur poshtë pikëpamja e atyre që mendojnë se shkolla duhet të jetë 12-vjeçare, se arsyet ku mbështetet kjo pikëpamje janë të shëndosha, po edhe pikëpamjet e atyre që mbrojnë shkollën 11-vjeçare prapë nuk i hedh dot poshtë.

Nga të dhënat, që kemi ne, rezulton se shumica e arsimtarëve janë për shkollën 12-vjeçare, po ka edhe një numër të madh mësuesish e pedagogësh që janë për 11-vjeçaren. Prindërit në shumicë janë për 11-vjeçaren, po ka edhe mjaft prindër që janë për 12-vjeçaren.

Disa që mbrojnë shkollën 11-vjeçare kapen pas anës ekonomike. Por, po të jetë vetëm kjo, këtë anë

ne do ta kapërcejmë. Kur u ngritën shkollat 7-vjeçare dhe u thoshim prindërve t'i dërgonin djemtë dhe vajzat për t'i ndjekur këto shkolla, gjenim rezistencë, kishë shumë nga ata, sidomos në fshatra, që i dërgonin fëmijët me bagëti pasi mbaronin filloren, po tani kjo pengesë u kapërcye, të gjithë i dërgojnë fëmijët për të kryer 7-vjeçaren, atje ku ka, bile sot po i dërgojnë me shumicë djemtë e vajzat edhe në shkollat 11-vjeçare.

Jeta në vendin tonë do të përmirësohet çdo vit, nevojat me kuadro do të plotësohen çdo vit e më shumë, prandaj anën ekonomike ne do ta kapërcejmë. Atëherë mirë, mund të thotë dikush, le ta bëjmë shkollën 12-vjeçare.

Por Byroja Politike mendon që, për ta vendosur sa më drejt çështjen e afatit të shkollës, 11 apo 12-vjeçare, të mos nxitohemi, pasi kjo nuk është parimore. Parimore është çështja e futjes së punës në shkollë dhe e kthimit të shkollës 7-vjeçare në 8-vjeçare. Ne mendojmë se mund të na lejohet të presim edhe dy-tre vjet për çështjen e afatit, ta shohim më me kujdes në jetë eksperimentin që kemi filluar. Reforma parashikohet të vihet në zbatim në vitin 1963 dhe klasa IX e shkollës së mesme me programet e reja do të fillojë në vitin 1967. Prandaj kemi kohë që brenda disa vjetëve nga kontingjentet që do të na dalin nga shkollat eksperimentale që kemi ngritur për zbatimin e reformës, të shikojmë në praktikë si janë shpërndarë lëndët, si i përvetësojnë ato nxënësit dhe sa përgatiten ata nga ana kulturore, të ndjekim përgatitjen e nxënësve me shprehitë e punës e nga

ana profesionale, si edhe të studjojmë ngarkesën reale të nxënësve.

Gjatë kësaj kohe ne do të përgatitim programet, pasi tani bazat u hodhën, mësuesit e pedagogët që kanë një farë eksperience, po fillojnë të bëjnë llogaritë për këto probleme.

Prandaj, gjatë kësaj kohe që ne do t'i punojmë programet, kemi kohë të shohim se si i përvetësojnë nxënësit këto programe, pastaj të shohim nëse ato mund të përvetësohen në 11 vjet apo duhen 12 vjet për ta zbatuar drejt reformën.

Tani ne duhet të punojmë për programet e 8-vjeçares, duke pasur parasysh sikur shkolla jonë të jetë 11-vjeçare. Pastaj në rast se shohim që ajo nuk na jep rezultatet e duhura, sepse nxënësit nuk i përvetësojnë dot ose për arsye të tjera që u përmendën, atëherë ne mund të bëjmë korigjimet e nevojshme, marrim vendim dhe e bëjmë shkollën 12 vjet.

Ne mendojmë se duke vepruar kështu nuk ka ndonjë të keqe dhe nuk ka as ndonjë pengesë për të marrë më vonë vendimin përkatës nga ana e Kuvendit Popullor. Prandaj në qoftë se Komiteti Qendror është dakord që të përfitojmë nga koha për ta parë në praktikë punën e shkollës, për të përgatitur programet dhe specialistët e arsimit ta shikojnë edhe një herë më me kujdes këtë problem, atëherë ne mund të vendosim më të bindur dhe më të sigurtë nëse shkolla duhet të jetë 11 apo 12-vjeçare.

Përsa u përket propozimeve të shumta që u bënë këtu nga shumë diskutantë, ato duhet të studjohen me kujdes dhe të kihen parasysh.

Më lejoni në fund, shokë, që në emër të Komitetit Qendror të falenderoj gjithë shokët arsimtarë dhe kuq-drot, të ftuar në këtë Plenum, për diskutimet dhe për sugjerimet e tyre të vlefshme.

*Botuar për herë të parë në
broshurën «Mbi riorganizimin e
shkollës dhe zhvillimin e më-
tejshëm të sistemit arsimor»,
Tiranë 1960*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

RADIOGRAM

SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË

9 tetor 1960

Shoku Hysni,

Mora radiogramin dhe kuptova si zhvillohen situatat. Shumë mirë shkon puna. U nxehën gjakërat. Të demaskohen plehurat. Përveç të tjerave që ti i di vetë, Susllovit i thua edhe këtë: «Zor do të jetë për falsifikatorët të akuzojnë komunistët shqiptarë se nuk e kuptojnë dhe se janë kundër bashkekzistencës. Ata kanë qenë dhe do të jenë kurdoherë për bashkekzistencën, ashtu siç na mëson Lenini dhe Stalini. Por më zor akoma është që përkrahësit e tradhtarit fashist kundërrevolucionar, Imre Nagit, të akuzojnë Partinë e Punës të Shqipërisë për një parti borgjeze dhe komunistët shqiptarë për kerenskë. Sidoqoftë, me fakte së shpejti ne do të vërtetojmë kush janë kerenskët dhe kush janë marksistë-leninistët e vërtetë».

Të tjerat i shiko vetë, por ta hajë këtë Susllovka, të shohin edhe të tjerët se kanë qenë sovjetikët të parët

që na atakuan në këtë mënyrë dhe të mos çuditen për ato që do të rrëzohen në kokën e hrushovianëve në nëntor. Të gustojnë parathënien.

Shumë të fala

E n v e r

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

RADIOGRAM

SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK

9 tetor 1960

Shoku Mehmet,

Lufta u nxeh, pra punët shkojnë mirë. Të demaskohen plehurat një herë e mirë. Të gjithë që kanë diskutuar na kanë sulmuar, edhe Kinën, edhe ne, me përjashtim të japonezitet, korcanit dhe vietnamezitet, të cilët nuk thanë asnjë fjalë, as për ne, as për sovjetikët, por vërejtjet e tyre për projektdeklaratën gati u afrohen vërejtjeve tona për të gjitha çështjet, si edhe për ato kundër revizionizmit modern dhe revizionizmit jugosllav.

Bagdashi veçanërisht ka sulmuar Kinën edhe ne. Për ne ai tha: «Nuk marrim vesh çfarë lloj komunizmi duan shqiptarët». Por më poshtërsisht deri tash ka folur rumuni dhe sidomos Suslovka. Suslovi tha se ne qenkemi kundër bashkekzistencës dhe na barazoi me partitë borgjeze e me Kerenskin.

Të hënën do të marrin grushte edhe nga ne, edhe

nga kinezi. Bullgari akoma nuk dimë të ketë folur, as edhe çeku.

Të presim. Të vish shëndoshë.

S h p a t i

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë



RADIOGRAM

SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË

11 tetor 1960

Shoku Hysni,

Jam dakord me ty. Mos i harxhoni argumentet e mëdha në një mbledhje të atillë. Vetëm futjuni disa thika paralajmëruese të gjithë atyre që e meritojnë. «Fronti» që kanë krijuar, në nëntor do të shpartallohet më shumë se tash. Bravo indoneziani! Ka shumë rëndësi që të shohin sovjetikët e lakejtë e tyre se jo të gjithë hanë bar. Ramizi, në komision, t'ua heqë turinjve provokatorëve e shpifësve. Avioni vjen sot.

Të fala

Enver

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË

13 tetor 1960

I dashur Hysni,

...Ne s'jemi të një mendimi me ata që përpiqen që çështjet të rregullohen me anën e frazave nëpër rezolucione ose deklarata.

Ne s'jemi për pikëpamjen «të ndreqet ç'mund të ndreqet, të tjerat t'i ndreqë koha». Ne jemi për atë që t'i shkohet çështjes deri në fund.

Po të mos kuptohet kjo, do të thotë se nuk kuptohet se ç'rrezikshmëri paraqit grupi i Hrushovit për lëvizjen komuniste botërore.

S'varet nga ne nëse duhet të vazhdojë të jetë në fuqi apo jo ky grup, por nga ne është e domosdoshme të demaskohet ky grup me Hrushovin në krye, ashtu si o meriton.

Ne po shohim se ky grup i rrezikshëm revizionistësh i ka pozitrat shumë të dobëta si ideologjikisht, ashtu dhe politikisht.

Ne nuk na preokupon përshtypja dhe atmosfera që mund të krijohet në delegatët e komisionit ose më vonë në Mbledhjen e Moskës.

Ne nuk duhet t'u lëmë sovjetikëve fushë të lirë ku të kullosin si të duan.

...Dakord që duhet të bëjmë një deklaratë të mirë, por a është e mjaftueshme kjo? **Ne nuk mund të jemi të kënaqur vetëm me këtë.** Do të kënaqemi vetëm duke u mbrojtur apo të sulmojmë?... Revizionisti i vendosur nuk ndërron rrugë. Revizionistët s'do të pranojnë asnjë nga gabimet e tyre. Kompromisi me ta nuk i shërben çështjes sonë. Ashtu si na «ndihmoi» Tito revizionisti, duke shkuar çdo ditë nga tradhtia në tradhti, ashtu do të bëjnë edhe këta, revizionistët e rinj.

... Unë po përgatit fjalimin për në Mbledhjen e Moskës, ashtu si e kemi vendosur... Në këtë mbledhje, përveç shokëve kinezë, qëndrimi ynë do të jetë unikal. Shumica do të na zemërohen, do të na shajnë, por **ne kemi të drejtë dhe koha do të na japë të drejtë.** Në mbledhje të jesh i sigurtë, s'do të guxojnë njerëzit të na japin hakë... Por ne do të bëjmë detyrën tonë, do të mbrojmë marksizëm-leninizmin. **Grupi i Hrushovit, ka bërë faj.** Në rast se nuk u vë gishtin fajtorëve, të ndash shapin nga sheqeri, atëherë i lidhe duart dhe dëmtove. Jo, ne nuk do të impresionohemi nga ata që thonë: «Si mund të atakohet Bashkimi i lavdishëm Sovjetik ose Partia Komuniste e madhe e Leninit për fajin e disa horrave?». Ne themi: **Tamam për të mbrojtur Bashkimin Sovjetik e Partinë e Leninit, duhen demaskuar këta «horr» o jo të zbutet kritika e të mbulohen deviatorët.** Në këtë rast, pavarësisht se polle një deklaratë «atliçno», rreziku qëndron, bile bëhet më kërcënues si për kampin tonë, ashtu dhe për të gjithë lëvizjen komuniste e punëto-re.

Por do të shohim, «dhëntë zoti», si thotë Hrushovi, dhe gabo hem në gjykimet e mia. S'po na thoni kur parashikohet të mbarojë akti i parë, se po vete afro tri javë?!

Kütej s'kemi gjë të re (nga ato të zakonshmet lidhur me sovjetikët e këtushëm ka plot). Mehmeti u nis nga Nju-Jorku më 11 dhe do të arrijë në Tiranë nga 20-21 tetori.

Shumë të fala ty e Ramizit nga unë dhe Nexhmija.

E n v e r

Botohet për herë të parë me disa shkurtime. Marrë nga origjinali që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**EDHE PA BUKË TË MBETEMI NE SHIQIPTARËT,
PARIMET NUK I SHKELIM, MARKSIZËM-
-LENINIZMIN NUK E TRADHITOJME**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

31 tetor 1960

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë sonë na ngarkoi të përgatitim projekt-fjalimin që do të mbahet në Mbledhjen e Moskës. Ky projekt-fjalim u përgatit dhe ju është shpërndarë për shqyrtim e për diskutim. Siç e shihni, aty flitet shumë për udhëheqjen sovjetike. Sipas mendimit tonë kjo është e drejtë, sepse udhëheqësit sovjetikë kanë devijuar nga marksizëm-leninizmi dhe kanë rënë në oportunizëm e në revizionizëm.

Ne mendojmë se në Mbledhjen e Moskës, që do të zhvillohet në nëntor, mund të mos ketë ndonjë fjalim tjetër të tillë si ky yni. Me sa jemi njoftuar, edhe fjalimi

¹ Në këtë mbledhje u aprovua Fjala e KQ të PPSH që do të mbahej në Mbledhjen e partive komuniste e punëtore në Moskë, në nëntor 1960.

i shokëve kinezë nuk do të jetë me sheqer, në të do të demaskohet vija oportuniste e udhëheqjes sovjetike. Shokët kinezë do të trajtojnë gjerë edhe çështjet teorike, për të cilat ata janë akuzuar pa të drejtë nga udhëheqja sovjetike, me Hrushovin në krye. Fjalimi i tyre nuk do të jetë një fjalim akademik, por do të ketë edhe fakte konkrete, që do të ilustrojnë gabimet e rënda të udhëheqësve sovjetikë.

Edhe fjalimi ynë nuk mbetet vetëm në fakte të tharta, por këto fakte lidhen me probleme e me konkluzione teorike. Faktet tona argumentojnë se udhëheqësit sovjetikë kanë shkëlur parimet e marksizëm-leninizmit dhe vendimet e përbashkëta. Po këto probleme ne nuk i trajtojmë sipas strukturës së projektdeklaratës të Mbledhjes së Moskës të pregatitur nga komisioni.

Pse mendojmë të veprojmë në këtë mënyrë? Ne e kemi parasysh faktin që Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, më parë, derisa jetonte J.V. Stalini, e ka mbrojtur kurdoherë Partinë tonë, po ndryshe ndodh sot. Veprimet aktuale të udhëheqësve sovjetikë ndaj Partisë sonë duhen konsideruar negative. Udhëheqësit e sotëm të Bashkimit Sovjetik janë kundër nesh, sepse ne po i kritikojmë drejt dhe fort. Mirëpo ata nuk e pranojnë kritikën, janë mendjemëdhenj dhe kryesorja është se kanë devijuar nga marksizëm-leninizmi. Për këtë ne nuk duhet të kemi asnjë iluzion. Kjo është një vijë e tërë e Hrushovit me shokë, prandaj qëndrimi i tyre ndaj nesh nuk do të jetë i drejtë.

Udhëheqësit sovjetikë gjatë gjithë veprimtarisë sonë kanë parë se ku qëndrojnë kundërshtimet midis nesh dhe atyre. Një nga këto është qëndrimi i kundërt që

mbajmë ne dhe ata ndaj revizionizmit modern, sidomos ndaj atij jugosllav. Në shumë çështje të tjera parimore të politikës së jashtme ne kemi qenë në kundërshtim me ta. Ata e kanë kuptuar se ne nuk jemi dakord edhe me qëndrimin që mbajnë ndaj Stalinit. Po kundërshtimet më të mëdha politike dhe ideologjike ne i kemi pasur me ta sidomos në çështjen e qëndrimit ndaj revizionizmit. Pas Mbledhjes së Bukureshtit, udhëheqja sovjetike filloi kundër nesh sulme të poshtira armiqësore. Ajo ka vazhduar edhe më tej, gjersa i kanë thënë Ten Hsiao Pinit që «Shqipërinë do ta trajtojmë njëllë si Jugosllavinë».

Rëndësi, pra, ka çështja që ne mbajmë një qëndrim marksist-leninist për të tashmen dhe për të ardhshmen e Partisë sonë. Prandaj të jemi të ndërgjegjshëm për politikën e vendosur që po ndjekim dhe për vështirësitë që do të na dalin në rrugën tonë. Në këto drejtime ne duhet të mobilizojmë të gjitha forcat, të organizojmë luftën dhe qëndresën tonë, se punët nuk do të shkojnë si në gjalpë.

Ne kemi qenë dhe jemi të rrethuar. Tani na krijohet një situatë e vështirë edhe me vendet e demokracisë popullore, edhe me BS. Një gjendje e tillë do të vijë duke u keqësuar, me synim që vendi ynë të izohet politikisht dhe ekonomikisht. Kjo situatë që po krijohet nuk kalon pa u vënë re nga imperializmi, i cili, bashkë me revizionistët, do të përpiqet të godasë lidhjet tona të sigërtë me Kinën, sepse ne kemi unitet pikëpamjesh me të dhe me një sërë vendesh të tjera si të Azisë dhe të Amerikës Latine. Armiqtë imperialistë e revizionistë do të përgatiten në shkallë të gjerë për të na sulmuar, por ne do të luftojmë pa u thyer deri në fund, duke

mbrojtur me konsekuencë marksizëm-leninizmin, atdheun dhe socializmin.

Komiteti Qendror, Byroja Politike, gjithë Partia jonë e thanë fjalën e vet, qysh me informacionin paprapak që u punua për zhvillimin e Mbledhjes së Bukureshtit, se ne do të qëndrojmë të patundur në vijën marksiste-leniniste dhe nuk do të bëjmë asnjë lëshim në parime. Të mos kemi frikë të kritikojmë cilëndo që i shtrembërojnë këto parime, siç veprojnë aktualisht udhëheqja e Bashkimit Sovjetik dhe udhëheqjet e disa partive të tjera. Drejtësia e vijës sonë do të fitojë, marksizëm-leninizmi do të triumfojë.

Lufta e drejtë parimore e Partisë sonë kundër revizionizmit ka treguar dhe tregon drejtësinë e vijës së saj. Kanë kaluar disa vjet, janë bërë kthesa, janë krijuar situata edhe në favor të revizionizmit, por çdo gjë ka vërtetuar drejtësinë e vijës sonë. Nga kjo rrugë e drejtë ne nuk tërhiqemi. Mëritë personale dhe hakmarrja e Hrushovit dhe e udhëheqësve të tjerë që e pasojnë, nuk na trembin, parimet marksiste-leniniste ne do t'i mbrojmë dhe jemi të bindur se rruga e tyre është e gabuar. Hrushovi dhe pasuesit e tij kanë përgjegjësi të madhe ndaj kampit tonë dhe marksizëm-leninizmit; me qëndrimet e tyre ata kanë shkaktuar përçarje në gjirin e kampit tonë. Dhe tani mendojnë se këto gjëra mund të mbulohen me një cipë, duke nxjerrë nga Mbledhja e Moskës një deklaratë me disa fraza të përgjithshme që s'janë as mish as peshk.

Nga të gjitha të dhënat del se udhëheqja sovjetike nuk po bën asnjë hap përpara, por ngul këmbë në pikëpamjet e veta. Në deklaratë mund të thuhet ndonjë

frazë edhe kundër imperializmit; por është fakt se në thelb udhëheqja sovjetike nuk ndryshon qëndrimet e veta, bile, ka bërë një hap të madh prapa që nga takimi me shokët kinezë në shtator e deri në mbledhjen e komisionit të redaktimit të projektdeklaratës së Mbledhjes së Moskës, ku ata shprehën se gjoja nuk kanë gabime. Ky nuk është qëndrim marksist-leninist. Prandaj fjalimi ynë në nëntor në Mbledhjen e Moskës do të gjejë kundërshtim të fortë nga ana e udhëheqjes sovjetike. Këtë ne duhet ta kemi parasysh.

Natyrisht, do të ketë udhëheqje të partive të tjera që do ta mbështetin udhëheqjen e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe këto nuk do të jenë të pakta. Do të ketë edhe disa që do të qëndrojnë në dy karrige.

Disa parti vazhdojnë të rrojnë me mitin mbi pagabueshmërinë e udhëheqjes sovjetike. Ato janë në stadin që kemi qenë edhe ne më parë. Kur jetonte Stalini ne ishim plotësisht të bindur shpirtërisht e moralisht se rruga e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ishte e drejtë, prandaj e mbështetnim atë me besim të plotë. Por koha do t'i nxjerrë në shesh të palarat e udhëheqësve aktualë sovjetikë, të këtyre revizionistëve të sotëm. Deri tani ne kemi mbrojtur parimet, por pa i hedhur gurin udhëheqjes sovjetike. Mirëpo sot ka ardhur koha që t'i vëmë gishtin plagës. Çështja është që ta shkulum të keqen nga rrënjët. Dhe kjo nuk do të jetë një punë e lehtë, lufta do të zgjatë.

Revizionizmi duhet luftuar nga pikëpamja teorike, ndryshe do të bëhet një gangrenë. Revizionistët jugosllavë, në vitet e fundit i kanë forcuar pozitat e tyre të ndihmuar nga përkëdheljet dhe nga politika e pajtimit

që kanë ndjekur ndaj tyre udhëheqësit sovjetikë me Hrushovin në krye, prandaj po nuk i luftuam, do të bëhen akoma më të rrezikshëm. Po ashtu, derisa ne jemi të bindur se udhëheqësit sovjetikë janë në rrugë revizioniste, atëherë duhet të jemi të vendosur në luftën kundër tyre, sepse vetëm me luftë parimore e konsekuente arrihet uniteti i vërtetë e jo me fraza që mbulojnë të vërtetën. Prandaj, në qoftë se në projektdeklaratën e Mbledhjes së Moskës do të flitet për unitet, kur unitet nuk ka, kjo do të thotë të gënjesh partitë dhe popujt.

Gjendja e udhëheqjes sovjetike do të keqësohet, do të rrokulliset. Në politikën e saj të brendshme e të jashtme do të thellohen gabimet, të cilat ajo do të përpiqet t'i mbulojë. Titoja ka dalë hapur si demagog dhe agjent i imperializmit dhe ai vazhdimisht bën demagogji, ndërsa Hrushovi dhe të tjerë kanë filluar ta afrojnë sa që edhe fjalimet e tij i punojnë deri në shkollën e partisë. Ne e kup'ojmë sa vështirë është të demaskohet udhëheqja aktuale sovjetike, që ka në dorë një potencial kaq të madh ekonomik e propagandistik, por ne nuk do të pajtohemi me të, do të fitojmë, sepse kemi të drejtë. N.S.Hrushovi është mjaft i diskredituar, por ai mund të fitojë nam duke bërë ndonjë gjest aventuresk, për shembull, të kërcënojë amerikanët që mund të ndërhyjnë në Kubë dhe të kërkojë tërheqjen e tyre. Me këto veprime vështirësohet më shumë lufta kundër Hrushovit në shkallë ndërkombëtare, sepse ai jep një kokërr sheqer e pastaj njëzet helme për komunizmin.

Ne nuk kemi pretendimin se do të ndërrojmë balancën e forcave, por fjalën tonë do ta themi, kush të

dojë le ta dëgjojë e ta gjykojë me gjakftohtësi. Do të ketë edhe të tillë që qëndrimet tona parimore do t'i quajnë «çmenduri». Por s'ka gjë, ata që sot do të mendojnë kështu, nesër do të ndryshojnë mendim, sepse do të shohin se sa i drejtë është qëndrimi i Partisë sonë. Këtë do ta provojë koha. Edhe këto gjëra duhet t'i kemi parasysh.

Me fjalën dhe me veprën tonë ne duhet t'u japim të kuptojnë të gjitha partive të tjera se Partia e Punës e Shqipërisë kërkon unitet, por unitet vetëm në bazë të marksizëm-leninizmit dhe në asnjë bazë tjetër. Ne duhet të mbrojmë pa lëkundje marksizëm-leninizmin dhe personalitetin e Partisë sonë. Partia jonë nuk është dakord edhe me pikëpamjen e Kozllovit që e shtroi çështjen: «ose me Bashkimin Sovjetik, ose me Kinën». Do të ketë njerëz që do të bëjnë konkluzione në këtë frymë e do të mendojnë se Shqipëria u shkëput nga Bashkimi Sovjetik dhe shkoi me Kinën. Kjo është parimisht e shtrembër. Ne jemi kundër cilitdo që shkel parimet e marksizëm-leninizmit dhe mbrojmë cilindo që i ruan këto parime.

Edhe pa bukë të mbetemi ne shqiptarët, parimet nuk i shkelim, marksizëm-leninizmin nuk e tradhetojmë. Këtë ta kenë të qartë të gjithë, miq e armiq.

Personalitetin e vet të drejtë, marksist-leninist Partia jonë e ka fituar me luftë të paepur në mbrojtje të parimeve, me punë revolucionare, duke kaluar në provat e kohës, sidomos tani që janë shfaqur haptazi qëndrime revizioniste në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Koha dhe lufta i dhanë Partisë sonë një pjekuri gjithnjë e më të madhe, prandaj

sot problemet ajo i kupton shumë më mirë. Partia jonë ishte në gjendje të kuptonte qëndrimet armiqtësore jo vetëm në Partinë tonë, por edhe në partitë e tjera, prandaj personalitetin e vet Partia jonë e tregoi në shumë çështje, në kundërshtim edhe me vijën e tanishme të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Këtë çështje ne duhet ta vëmë në dukje qartë. Ne e themi me gojën plot se në gabimet e udhëheqjes së tanishme sovjetike e kanë burimin të gjitha të këqijat që vihen re sot në kampin socialist. Kjo është pikëpamja jonë, të cilën nuk mund të na e ndryshojnë as me kërcënimet që do të na bëhen se «Shqipëria është një vend i rrethuar, ka nevoja ekonomike» etj. Por le ta dinë këta zotërinj që flasin kështu se Shqipëria dhe komunistët shqiptarë nuk shiten as me rubla, as me grurë, as me dollarë. Kush do unitet me ne, le t'i ndërtojë marrëdhëniet vetëm mbi bazën e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar. Sa për ndihmën, ata që janë marksistë e miq të popullit tonë duhet të na e japin. Edhe ne duhet të mbajmë angazhimet tona ndaj miqve të vërtetë. Përsa u përket pseudomiqve që shkelin zotimet, ata i bëjnë dëm në radhë të parë vetes së tyre, ndërsa prestigji i Partisë sonë rritet.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

KUSH NUK ECËN DREJT NË RRUGËN E PARTISË, AI ME SIGURI DO TË GABOJË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ
të PPSH mbi të metat në punë e qëndrimet
e gabuara të Maqo Çomos*

31 tetor 1960

Përpara se të flasë Maqo Çomoja doja të theksoja që ai të mos ketë asnjë dyshim se propozohet për t'u hequr nga funksioni si ministër, për shkak se është i shoqi i Liri Belishovës. Liria u dënua sepse kapitulloi dhe shkeli rëndë vijën politike dhe ideologjike të Partisë, kurse ai nuk mendohet të shkarkohet si ministër i Bujqësisë automatikisht se është burri i saj. Po të kishim arritur në një konkluzion të tillë, nuk ka asnjë dyshim se do ta shënonim në relacionin që u është shpërndarë shokëve të Byrosë.

Qëndrimi i Maqo Çomos, lidhur me fajet dhe me dënimin e Liri Belishovës, nuk mund të themi se ka qenë i drejtë dhe në atë frymë sikurse u shpreh njëzëri i gjithë Komiteti Qendror. Diskutimi i tij mbi këto çështje ndryshonte shumë nga diskutimet

dhe nga mendimet e të gjithë shokëve të tjerë që folën.

Faji kryesor i tij është se ai nuk ka punuar mirë në Ministrinë e Bujqësisë. Çështja është se gjatë kohës që ai ka punuar si ministër, i janë bërë vazhdimisht kritika, bile është thirrur edhe në Byronë Politike e në Sekretariat, ku është kritikuar, duke iu vënë në dukje gabimet dhe të metat, për t'i përmirësuar ato¹.

Mund të them, se shokë me përgjegjësi në Byronë Politike dhe në Qeveri, shumë kohë përpara, me vite të tëra, kanë ardhur te unë dhe më kanë parashtruar e më kanë kërkuar shumë herë që çështja e tij të shqyrtohej në Byronë Politike, sepse ai ka të meta dhe gabime të shumta, prandaj punët në Ministrinë e Bujqësisë nuk ecin. Por mendimi im dhe i shokëve të tjerë të Byrosë ka qenë që ta kritikojmë e ta ndihmojmë atë. Kurdoherë unë kam qenë dakord me kritikën që shokët i kanë bërë Maqo Çomos dhe kemi vënë re se ai nuk i ka korrigjuar të metat dhe gabimet në punë dhe prandaj Ministria e Bujqësisë vazhdon të mos shkojë mirë. Ne mendojmë dhe propozojmë që të marrim masa për ta përmirësuar rrënjësisht punën në bujqësi. Në radhë të parë të shkarkojmë Maqo Çomon si ministër dhe ta zëvendësojmë me një shok tjetër, me qëllim që t'i jepet një hov akoma më i madh bujqësisë.

Ne nuk ia hedhim atij të tëra fajet për dobësitë që kemi në bujqësi. Ne i ngarkojmë atij ato që i takojnë, se e dimë që bujqësia varet edhe nga shumë faktorë të

¹ Shih mbi këtë çështje në këtë vëllim raportin e mbajtur në Plenumin XX të KQ të PPSH mbi të metat kryesore në punën e Maqo Çomos, f. 346.

tjerë. Por shkarkimi i tij të jetë një mësim i madh për të dhe për cilindo tjetër që nuk kryen mirë detyrën.

Pasi foli Maqo Çomoja, dhe pas diskutimeve që zhvilluan anëtarët e Byrosë Politike, e mori fjalën përsëri

SHOKU ENVER HOXHA: Jam dakord për të tëra sa folën shokët e Byrosë Politike. Eksperienca e Partisë sonë na ka mësuar që në jetë të shohim shumë gjëra. Një nga mësimet që kemi nxjerrë nga jeta është se me gjithë ndihmat dhe kritikën e drejta që u janë bërë disa njerëzve nga ana e Partisë, ka pasur prej tyre që nuk janë ndrequr, por përkundrazi kanë shkarë më tej, derisa kanë arritur në pozita antiparti. Një rrezik i tillë ekziston sidomos për ata që janë mendjemëdhenj, që kanë besim të madh në mendjen dhe në pikëpamjet e tyre, aq sa nganjëherë këto i vënë mbi pikëpamjet e drejta të Partisë.

Mendjemadhësia sjell shumë rreziqe. Shokët i thanë atij sinqerisht se te ai ekziston në doza të forta mendjemadhësia. Kjo kritikë i është bërë edhe herë të tjera, por si duket nuk do që ta kuptojë, të reflektojë e të përmirësohet. Ne do ta ndihmojmë atë që të ecë në rrugën e Partisë, po kjo varet nga vetë ai. Me mendjemadhësinë e tij, ka rrezik që ai të mos mbajë qëndrim të drejtë ndaj Partisë, vijës e udhëheqjes së saj, për të cilën u dënua edhe Liri Belishova. Po të mos kishe kontakte me Lirinë e të mos bashkëjetoje me të, s'kisha ndër mend të ta thosha këtë, megjithatë thuaj dhe asaj që të mos shkojë më tej! Të dy të keni kujdes që të mos shkoni më tutje!

Liri Belishova ka shfaqur pikëpamje të kundërta me vijën e Komitetit Qendror, por konstatojmë se ajo

akoma nuk i ka kuptuar gabimet e saj, që janë shumë të rënda. Liria duhet ta kuptojë se nuk është në rrugën e Partisë. Ne kemi bindje të plotë se ajo ka qenë në rrugë të gabuar, ndërsa Komiteti Qendror i Partisë është në rrugë të drejtë. Sa ditë që kalojnë, aq më shumë grumbullohen fakte të mëdha, të cilat dëshmojnë se udhëheqja sovjetike është në rrugë të gabuar. Liria le t'i mbajë iluzionet që ka, ne nuk ia heqim ato me zor, megjithëse e këshillojmë t'i heqë. Vetëm duhet ditur se vijën e Partisë, shtetin tonë dhe fitoret e socializmit në Shqipëri ne do t'i mbrojmë dhe jemi të sigurtë se Liria nuk ka aspak të drejtë, përkundrazi ajo është vënë në opozicion me vijën e Partisë dhe në këtë situatë ka rreziqe që të gabohesh edhe ti. Prandaj të këshillojmë, që të mos gabosh, bile ne duam që ti të ndihmohesh edhe Lirinë për të njohur fajet e saj të rënda dhe rrugën e gabuar. Ka qenë koha kur ajo duhej të ishte në e rreptë ndaj teje përse u përket kritikave që të janë bërë në Komitetin Qendror për punën tënde, por ne konstatojmë se ajo nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Kanë kaluar ato kohë, kur Partisë sonë mund t'i imponoheshin pikëpamjet e gabuara të të tjerëve. Partia jonë ka një eksperiencë lufte të gjatë dhe nuk ecën qorrazi. Ajo mat mirë çdo hap që hedh përpara. Prandaj vullneti i njërit apo i tjetrit për të shtrembëruar vijën e Partisë sonë, qoftë duke e minuar nga brenda, qoftë nga jashtë, nuk shkon te ne. Gjithsecili duhet të ecë në vijën e drejtë të Partisë, që e mbron njëzëri e gjithë Partia jonë.

Duhet thënë se mendjemadhësia te ti, Maqo Çomo, është nxitur edhe nga specialistët sovjetikë. Përveç të

tjerave, te ti është konstatuar një farë mendjemadhësie për të kryer në bujqësi punë jashtë mundësive tona, janë propozuar disa plane të mëdha, të papërshtatshme për kushtet tona aktuale ekonomike. Ne kemi të tjera kushte nga ato të Bashkimit Sovjetik, kurse në bisedat me specialistët e bujqësisë, te ti janë dukur disa ide fantastike për zhvillimin e bujqësisë sonë. Komunist i mirë është ai që ecën në rrugën e Partisë dhe jo me fjalët e të tjerëve. Mackieviçi¹ nuk i di kushtet tona, prandaj disa mendime të tij s'kanë asnjë vlerë për Partinë tonë.

Rruga e Partisë sonë është që të ecim drejt. Kush nuk ecën drejt në rrugën e Partisë, ai me siguri do të gabojë. Kush reflekton në gabimet e veta dhe i pranon ato, ka mundësi të korrigjohet. Liri Belishova, për shembull, nuk po e bën një gjë të tillë. Unë nuk mendoj që Liria të bëhet murgeshë, të mos dalë shëtitje, të mos shkojë në park, në kinema etj., por mënyra demonstrative si i bën ajo këto gjëra tani, tregon se do t'u thotë të tjerëve: «Do të shikoni, pritni, pa do të dëgjoni se ç'do të bëhet!». Unë them se një njeri që i ka kuptuar gabimet, ecën me ndërgjegje të vrarë, me kokë ulur dhe punon ndershëmërisht.

Partia është e drejtë, ajo e ndjek komunistin në punë dhe në jetë dhe i jep dorën kur ka filluar të ecë në rrugë të mbarë, po në qoftë se shkohet me mendime e provokacione si ato të Lirisë, fajin nuk e ka Partia. Asnjërit prej atyre që kanë kaluar në rrugën an'iparti nuk u ka pasur faj Partia. Përkundrazi, Partia jonë

¹ Në atë kohë ministër i Bujqësisë në BS.

është treguar shumë zemërgjerë. Të tërë ata që kanë bërë faje, Partia jonë i ka dënuar drejt dhe pas dënimit ajo është treguar shumë e durueshme, marksiste dhe koha ka zbuluar më vonë për ta edhe shumë gjëra të tjera.

Unë i shtroj këto çështje se duam që t'i shpëtojmë njerëzit. Është tjetër çështje pastaj në rast se ata nuk duan të shpëtojnë. A nuk kemi bërë ne gjithë ato përpjekje për ta shpëtuar, për shembull, Tuk Jakovën? Mirëpo ai vazhdoi me komplotet e tij kundër Partisë dhe, sa kohë që kalon, gjëra të reja zbulohen.

Këto i them sepse rreziqe të tilla ekzistojnë edhe për ty, Maqo Çomo, prandaj ruaju, dilu përpara rreziqeve, mendohu mirë e qëndro drejt, në rrugën e Partisë!

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verball i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**RAPORT I MBAJTUR NË PLENUMIN XX TË KQ
TË PPSH MBI TË METAT KRYESORE
NË PUNËN E MAQO ÇOMOS**

1 nëntor 1960

Lidhur me porosinë e Plenumit të fundit të Komitetit Qendror të Partisë që të shikohet puna e Maqo Çomos si ministër i Bujqësisë, më poshtë paraqitim shkurtimisht të metat kryesore që janë vënë re vazhdimisht në punën e tij.

Bujqësia është një sektor shumë i gjerë, degë kryesore dhe shumë e rëndësishme e ekonomisë popullore të vendit tonë, për të cilën kujdeset vazhdimisht Byroja Politike dhe Qeveria. Për plotësimin e planeve të bujqësisë punon ditë e natë gjithë Partia; një pjesë shumë të madhe të kohës komitetet e Partisë në rrethe merren me problemet e bujqësisë.

Megjithëkëtë, Maqo Çomoja, në përgjithësi, problemet e bujqësisë i ka parë shumë ngushtë, përciptas dhe jo në tërë gjerësinë e tyre, siç porosit Komiteti Qendror. Ai karakterizohet nga një mendjemadhësi e theksuar, që shprehet në mbivlerësimin e aftësive personale në njohjen e të gjitha problemeve të bujqësisë, por kjo gjë nuk është vërtetuar në praktikë. Ai mendon se

bujqësinë e bën të ecë përpara vetëm ministria me aparatën e saj. Në punën e tij ka mjaft raste indisciplinimi si dhe nënvleftësimi të aparateve qendrore, të organizatave të masave dhe të komiteteve të Partisë në rrethe. Është për t'u vënë në dukje edhe fakti se këto të meta të ai nuk kanë mbetur vetëm si pikëpamje të tij personale, por kanë infektuar dhe disa shokë të tjerë të këtij aparati.

1. — Dihet se mosrealizimi i planeve të bujqësisë varet nga faktorë të ndryshëm, të cilët Komiteti Qendror i ka parasysh. Por këtu ka influencuar shumë edhe puna e dobët e tij si ministër i Bujqësisë, i cili, lidhur me të metat e përmendura më lart, nuk e ka kryer detyrën siç duhet. Duke mos qenë vetë në pozita luftarake, si rregull, Maqo Çomoja, në vend që të dalë me propozime e me masa të rëndësishme për realizimin e direktivave të Partisë lidhur me rritjen e shpejtë të prodhimit bujqësor, rri «në pozita mbrojtëse» ndaj rekomandimeve që bëhen nga lart ose nga baza. Kjo është një lloj opozite ndaj vijës së Partisë në bujqësi.

Për të vërtetuar këtë mjafton të përmendim qëndrimin e tij në fillim të vitit 1957 kur përgatitej Plenumi i shkurtit, kundërshtimet e tij për të filluar aksionin e përmirësimit të shpejtë të racës së dheneve me anën e ndërzimit artificial. Duke iu referuar «shkençës» dhe «njohurive» të tij, ai thoshte se ky plan do të dështojë, por praktika tregoi të kundërtën. Kështu ndodhi edhe me çështjen e shtimit të planit të agrumeve, që vendosi ky Plenum, për të cilin u bënë kundërshtime të mëdha nga Ministria e Bujqësisë, që i frymëzonte vetë ministri.

Ai dhe disa kuadro të Ministrisë së Bujqësisë, të frymëzuar prej tij, kanë mbajtur vazhdimisht një qëndrim mospërfillës dhe nënvleftësues ndaj propozimeve të bazës për avancimin e planit të frutikulturës (Plenumi i Shkurtit 1958). Duke mos i vlerësuar këto inisiativa të bazës, shokët e ministrisë nuk i dhanë asaj ndihmën e duhur teknike dhe nuk u mobilizuan për të siguruar një cilësi të lartë në mbjelljet e pemëve frutore që bënë rrethet.

Komiteti Qendror i BRPSH dhe organizatat e rinisë në rrethe kanë qenë vazhdimisht të pakënaqura dhe të revoltuara ndaj qëndrimit nënvleftësues dhe disa herë tallës që mbante Maqo Çomoja ndaj punës së rinisë, sidomos për aksionin e saj të madh lidhur me realizimin e planit 15-vjeçar të ullirit në 13 vjet.

Tipik është edhe rasti me masat që mori Komiteti Qendror i Partisë për shtimin e prodhimeve blegtorale në Plenumin e Nëntorit 1958, me të cilin ai ka qenë në fakt në opozitë.

Në këto, si dhe në mjaft raste të tjera, Maqo Çomoja ka treguar mosbesimin të forcat e Partisë e të bazës, të cilat, duke u mobilizuar siç duhet, mund të plotësojnë me sukses çdo detyrë që u shtron Komiteti Qendror. Në këto tregohet gjithashtu mosbesimi i tij ndaj drejtimit dhe kompetencave të Komitetit Qendror përsa u përket problemeve të bujqësisë. Lidhur me këtë, kur merreshin zakonisht vendime të rëndësishme për bujqësinë, ai, në vend që të aktivizonte kuadrot për zhvillimin dhe për shfrytëzimin e rezervave të brendshme të bujqësisë, i mobilizonte ata që «të argumento-

nin» me çdo mënyrë pamundësinë e plotësimit të detyrave që shtroheshin.

Nga ana tjetër, Maqo Çomoja si ministër i Bujqësisë nuk ka bërë që Ministria e Bujqësisë të ndërmarrë ndonjë aksion të rëndësishëm, me inisiativën e saj, për shtimin e sipërfaqes së ujitshme, të farërave etj.

Është e kuptueshme se, duke qenë në këto pozita, ai nuk ka luftuar për plotësimin e detyrave që i ka ngarkuar Partia si ministër i Bujqësisë dhe është bërë pengesë në këtë drejtim.

2. — Në organizimin dhe në metodën e punës së Ministrisë së Bujqësisë ka mjaft të meta, për të cilat mban përgjegjësi Maqo Çomoja.

Të influencuar nga këto pikëpamje jo të drejta dhe nga metoda e gabuar e punës së tij, kuadrot kryesorë të Ministrisë së Bujqësisë nuk ndihmojnë sa duhet bazën. Zakonisht shkohet në disa rrethe kryesore, por edhe atje nuk qëndrohet për disa ditë me radhë për të shqyrtuar së bashku me shokët e atjeshëm mundësitë dhe rezervat për shtimin e prodhimit bujqësor. Në këtë mënyrë, duke bërë disa vizita të shpejta dhe duke dërguar me shërbim nëpunës pa shumë kompetenca, fondi i dietave tejkalohet dhe baza nuk ndihmohet (shokët e rretheve janë ankuar vazhdimisht për këtë). Nga një kontroll i bërë në muajin shtator 1959 doli se nga janari e deri atëherë Ministria e Bujqësisë nuk kishte dërguar në bazë asnjë ekip të saj in me ndonjë kuadër kryesor në krye, se në një të tretën e rretheve të Shqipërisë nuk kishte shkuar asnjë shok drejtues dhe se kuadrot përgjegjës të ministrisë gjatë kësaj kohe nuk kishin asistuar në asnjë mbledhje të komiteteve

ekzekutive, të këshillave popullore, të byrove, të plenumeve të komiteteve të Partisë në rrethe apo në mbledhje të kryesive e të asambleve të kooperativave bujqësore. Gjithashtu nga të dhënat e llogarisë së ministrisë del se vetëm rreth 2 për qind e kohës së shërbimit është qëndruar në fshat. Kjo nuk është një gjë e rastit, por karakteristikë e përgjithshme e punës së ministrisë që drejton Maqo Çomoja. Në këtë mënyrë puna e gjallë është zëvendësuar me një lumë të pambaruar shkresash.

Ministria e Bujqësisë dërgon shumë materiale për shqyrtim në Qeveri, por në këto vendin kryesor e zënë raportet dhe projektet që duhen dhënë sipas planeve të punës. Në to ka edhe shumë kërkesa për materiale e fonde, por shumë rrallë ka materiale dhe studime mbi kontrollet e ministrisë, apo rekomandime të specialistëve të saj.

Maqo Çomoja dhe zëvendësit e tij nuk i japin si duhet dhe sa duhet një ndihmë të organizuar aparatit vartës. Nga kontrolli i përmendur, doli se gjatë vitit 1959 ministri nuk kishte marrë pjesë në asnjë mbledhje të drejtorive, të cilat zakonisht punojnë pa plan, nuk organizojnë përgjithësimin e eksperiencës dhe ngritjen tekniko-profesionale të specialistëve.

Në funksionimin e aparatit vihen re edhe të meta të tjera, që formojnë shkelje të disiplinës shtetërore. Kërkesat e bazës nuk studjohen shpejt dhe me kujdes. Kështu, në muajin gusht 1959 u gjetën 90 lutje të përfunduara, nga të cilat 45 ishin të muajve janar-maj.

3. — Duke mos pasur pikëpamje të drejta mbi rolin e aparatit qendror dhe duke mbivlerësuar forcat e veta, në punën e tij ka munguar fryma e partishmërisë.

Maqo Çomoja është kritikuar vazhdimisht për mungesë bashkëpunimi me forumet e aparatit e Komitetit Qendror; shumë rrallë ka ardhur këtu për të ngritur çështje të rëndësishme. Akoma më nënvleftësues është qëndrimi i tij ndaj organizatës së rinisë e të gruas, të cilat me gjithë insistimet e shumta, me shumë vështirësi sigurojnë bashkëpunimin e ministrisë për aksionet që ato kanë marrë përsipër.

Duke i munguar fryma e partishmërisë, ai ka insistuar vazhdimisht për të marrë kompetenca më të mëdha si ministër, duke dashur t'i shpëtojë kontrollit si nga aparati qendror, ashtu edhe nga baza. Ai e ka quajtur burokraci dhe pengesë nomenklaturën e kuadrit që është aprovuar nga Byroja Politike, duke dashur që këto çështje t'i vendosë vetë. Po kështu edhe për çështjen e administrimit të fondeve e të materialeve.

Maqo Çomoja tregohet shumë zemërgjerë e liberal dhe i ka munguar vigjilenca e duhur me kuadrin në përgjithësi dhe sidomos me elementin që ka përbërje ose të kaluar të keqe. Kështu, nën pretekstin për t'i inkurajuar këta në punë, nuk tregohet vigjilent. Përveç kësaj, ai nuk dëgjon si duhet zërin e bashkëpunëtorëve të vet, të cilët, disa herë, direkt ose indirekt, janë ankuar për këtë. Ai në shumë raste vë në dukje disa gjëra që i bën me inisiativën e vet dhe lë pas dore gjëra të tjera më të rëndësishme që i rekomandohen nga të tjerët.

4. — Në punën e tij janë vënë re vazhdimisht thyerje të disiplinës. Duke mos qenë i bindur për disa vendime të rëndësishme të Partisë mbi bujqësinë, ai ka lejuar moszbatimin e tyre. Kështu, për shembull,

kanë mbetur pa u zbatuar detyrat e Kongresit III të Partisë për çështjen e farës, vendimi i Plenumit të Shkurtit 1957 për agrumet, ka shkelur disa herë nomenklaturën e kuadrit etj.

Ai, gjithashtu, që në fillim nuk ka qenë dakord me vendimet e Plenumit të Nëntorit 1958 për blegtorinë, por, në të kundërtën, pas aprovimit të planit shtatëvjeçar të blegtorisë nga Plenumi, ai, duke qëndruar në mendimet e veta konservatore, nuk e mobilizoi si duhet aparatën e vet për të shfrytëzuar çdo mundësi për shtimin e prodhimit të blegtorisë. Përkundrazi, me qëndrimin e vet, futi në të një frymë mosbesimi dhe e nxori atë jashtë luftës që bënte Partia për zbatimin e vendimeve të Plenumit.

Në punën e Maqo Çomos ka pasur edhe mjaft gabime të tjera, për të cilat ai gjithashtu është kritikuar disa herë.

Nën pretekstin për t'i vënë ndërmarrjet bujqësore në kondita normale, ai u ka dhënë atyre kuadro, mjete financiare e makineri më shumë sesa marrin rrethet për të njëjtat detyra. Kjo gjë është kritikuar nga vetë rrethet ku janë këto ndërmarrje dhe Komiteti Qendror mori masat për ta riparuar këtë çështje.

Maqo Çomoja që një nga inisiatorët e punës së shpejtuar që u bë në janar-shkurt 1959 për zmadhimin e kooperativave në një mënyrë të rrezikshme, gjë që u ndalua dhe u dënua nga Byroja Politike dhe nga Plenumi i Komitetit Qendror.

Kohët e fundit ai, pa qenë aspak i bindur, paraqiti projektplanin e pesëvjeçarit të tretë me disa shifra shumë të fryra, gjoja për t'iu përmbajtur kuotave që

ishin caktuar më parë, ndërsa në fakt ishte një punë e përciptë, pa përgjegjësi dhe shumë e dëmshme.

Këto dhe të tjera të meta i janë vënë në dukje vazhdimisht Maqo Çomos. Për to ai është thirrur në mënyrë të posaçme para sekretarëve të Komitetit Qendror, është kritikuar nga Sekretariati dhe nga Byroja Politike e Komitetit Qendror. Një kritikë shumë e ashpër dhe me paralajmërim iu bë atij në Plenumin e Dhjetorit 1959, kur u analizuan rezultatet katërvjeçare të planit ekonomik.

Duke u mbështetur në të metat e shumta që u përmendën më lart, të cilat pengojnë mbarëvajtjen e bujqësisë, mendojmë që Maqo Çomoja duhet shkarkuar nga detyra si ministër dhe në krye të bujqësisë të vihet një shok me partishmëri të lartë.

Çështjet e paraqitura më lart përbëjnë faje të rënda, jo vetëm për ta shkarkuar atë si ministër, por duhet parë edhe qenia e tij si anëtar i Komitetit Qendror.

Ne e këshillojmë Maqo Çomon të reflektojë thellë mbi gabimet e tij dhe mbi kritikën e drejta që i bënë shokët e Plenumit të Komitetit Qendror, të punojë si duhet atje ku do ta caktojë Partia, të ecë në rrugë të drejtë, të ketë besim te Partia dhe ta mbështetë vijën e drejtë të saj në çdo situatë. Në qoftë se ai do të ecë si duhet në këto drejtime, Partia do ta ndihmojë atë kurdoherë¹.

Pas diskutimeve të shokëve të Plenumit të Komitetit Qendror, shoku Enver Hoxha tha:

¹ Më vonë, faktet treguan se Maqo Çomoja ishte armik i Partisë e i popullit dhe si i tillë, mori dënimin e merituar nga organet e drejtësisë.

Tani kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: Fjala që do të mbahet në emër të KQ të PPSH në Mbledhjen e partive komuniste dhe punëtorë që do të zhvillojë punimet gjatë këtij muaji në Moskë.

Plenumi pasi dëgjoi dhe diskutoi Fjalën e shokut Enver Hoxha e aprovoi atë njëzëri¹.

Plenumi njëkohësisht caktoi delegacionin e PPSH që do të marrë pjesë në Mbledhjen e Moskës të përbërë nga shokët ENVER HOXHA, MEHMET SHEHU, HYSNI KAPO, RAMIZ ALIA.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Shih në këtë vëllim, f. 382.

**TË JETË OSE JO SHQIPËRIA VEND SOCIALIST,
KËTË NUK E VENDOS HRUSHOVI, POR E KA
VENDOSUR POPULLI SHQIPTAR ME LUFTËRAT
DHE ME GJAKUN E TIJ**

Nga biseda e zhvilluar me J. Andropovin në Moskë

8 nëntor 1960

SHOKU ENVER HOXHA: Sot më lajmëruan se Hrushovi ka shfaqur dëshirën të takohet me mua nesër në orën 11. Unë kisha vendosur t'i përgjigjesha pozitivisht kësaj kërkesë, por sot lexova materialin sovjetik, në të cilin Shqipëria nuk figuron si vend socialist.

J. ANDROPOVI: Çfarë materiali është ky, nuk po ju kuptoj. tregomëni konkretisht cilin material keni parasysh, ku është thënë kjo?!

SHOKU ENVER HOXHA: Ky është materiali i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik drejtuar Partisë Komuniste të Kinës¹.

¹ Është fjala për letrën prej 125 faqesh që KQ i PK të BS i drejtoi më 5 nëntor 1960 KQ të PK të Kinës, në të cilën KQ i

J. ANDROPOVI: Po çfarë lidhje ka kjo, ajo është letër për Kinën, ç'lidhje ka Kina me Shqipërinë?

SHOKU ENVER HOXHA: Dhe kjo i preu përfundimisht rrugët e takimit tim me Hrushovin.

J. ANDROPOVI: Nuk po ju kuptoj, çfarë është thënë në atë material për ju?

SHOKU ENVER HOXHA: Lexojeni dhe do ta shihni.

J. ANDROPOVI: Unë e kam lexuar dhe e njoh shumë mirë atë material, pasi kam marrë pjesë vetë në përpunimin e tij. Por deklarata juaj, shoku Enver, është një deklaratë shumë serioze.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, serioze. I thoni Hrushovit se, që të jetë ose të mos jetë Shqipëria vend socialist, këtë nuk e vendos Hrushovi, këtë e ka vendosur vetë populli shqiptar me luftërat e tij, me gjakun e tij. Këtë e ka vendosur Partia e Punës e Shqipërisë, e cila ka ecur dhe do të ecë në rrugën marksiste-leniniste.

J. ANDROPOVI: Unë nuk ju kuptoj, shoku Enver, ai është një material për Kinën, ç'lidhje ka kjo me Shqipërinë.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë flas për atdheun tim, për popullin tim, për vendin tim.

J. ANDROPOVI: Kjo është një deklaratë shumë serioze, dhe për këtë unë vetëm mund të shfaq keqardhjen.

PK të BS, përveç akuzave kundër PK të Kinës, injoronte ekzistencën e RP të Shqipërisë si vend socialist dhe denigronte Partinë e Punës të Shqipërisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne do të kemi Mbledhjen e partive, atje Partia jonë do të shfaqë mendimin e vet. Ja kështu, mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura gjatë
bisedës që gjenden në Arkivin
Qendror të Partisë*

MARKSIZËM-LENINIZMIN DHE INTERESAT E POPULLIT NE DO T'I MBROJMË ME ZJARR

*Nga biseda e delegacionit të PPSH me përfaqësuesit
e PK të BS, A. Mikojan, F. Kozllor, M. Susllor,
P. Pospjellov, J. Andropov, në Moskë¹*

10 nëntor 1960

I pari e merr fjalën A. Mikojan, i cili, duke shprehur «keqardhjen» për mosmarrëveshjet që kanë lindur midis PK të BS dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, akuzon Partinë tonë sikur gjoja kjo është shkaktare e mosmarrëveshjeve, kjo «nuk ushqen» më ndaj PK të BS «atë besim që ushqente më parë...»; oficerët tanë gjoja janë sjellë krejt ndryshe me oficerët sovjetikë në bazën ushtarake detare në Vlorë, «mos doni të dilni nga Traktati i Varshavës?...» etj., dhe se udhëheqja sovje-

¹ Këtë takim me delegacionin e PPSH, që ishte në Moskë e kërkuan udhëheqësit sovjetikë me qëllim që të «bindnin» delegacionin tonë për të mos ngritur në Mbledhjen e 81 partive çështjet për të cilat PPSH nuk ishte dakord me ta e veçanërisht me veprimet e tyre antimarksiste e armiqësore ndaj vendit tonë pas Mbledhjes së Bukureshtit.

tike gjoja dëshiron zgjidhjen e këtyre «keqkuptimeve» në rrugën më të drejtë. «Na thoni, vazhdoi ai, ku i kemi gabimet, ne nuk zemërohemi. Ne zemërohemi, kur ju bisedoni prapa shpine».

SHOKU ENVER HOXHA: Na thoni kur dhe ku ne kemi biseduar prapa shpine kundër jush? Ne shqiptarët e kemi zakon, asnjëherë nuk bisedojmë prapa shpine.

Lidhur me bazën ushtarake të Vlorës: s'është e vërtetë ajo që thatë. Atje ekziston një miqësi e ngushtë midis marinarëve dhe oficerëve sovjetikë e shqiptarë. Kështu ka qenë deri në Mbledhjen e Bukureshtit, dhe nga ana jonë kështu vazhdon të jetë edhe tani: Komiteti Qendror i Partisë sonë u ka dhënë udhëzime njerëzve tanë për të mbajtur në bazë qëndrim korrekt ndaj njerëzve sovjetikë. Por disa nga marinarët tuaj edhe kanë goditur marinarët tanë. Ministria e Mbrojtjes e RPSH ka udhëzuar që këto gjëra të rregullohen nëpërmjet organizatave-bazë të Partisë. Ka ngjarë diçka me një oficerin tonë të marinës dhe një kundëradmiral sovjetik të ardhur nga Sevastopoli për inspektim, i cili kishte zakon të pinte. Në mënyrë jo të drejtë ai kishte kapur një oficerin tonë, shok i mirë që ka studjuar në Bashkimin Sovjetik, dhe i kishte kërkuar që ai t'i tregonte se ç'u vendos në Plenumin e Komitetit Qendror, pasi, thoshte ai, «do të mbaj leksione për këtë në Sevastopol, atje do të më pyesin». Oficeri ynë iu përgjigj se komunikata e Plenumit të Komitetit Qendror është botuar në gazetë¹, ç'kërkoni tjetër. Mori kapelen dhe iku, i ra-

¹ Komunikata e Plenumit XVIII të KQ të PPSH, botuar në gazetën «Zëri i popullit» më 9 shtator 1960.

portoi komandantit të tij. Shokët tuaj i hoqën veshin kundëradmiralit, ai kërkoi ndjesë dhe gjithçka u rregullua.

Lidhur me marrjen në dorëzim të nëndetëseve: ushtarakët tanë 2 vjet e gjysmë mësuan dhe u përgatitën në Sevastopol, u dalluan në qitje. Shtabi dhe marinarët tanë ishin përgatitur të prisnin në mënyrë solemne nëndetëset. Në shtabin tonë është një kundëradmiral sovjetik, ne nuk e dimë ç'është ai, por kundëradmiral ai s'është. Ai tha se «nëndetëset nuk mund t'ju dorëzohen, sepse nuk jeni të përgatitur». Shokët e Ministrisë së Mbrojtjes iu përgjigjën se, si është e mundur një gjë e tillë, në qoftë se duhet që ushtarakët tanë të mësojnë edhe disa muaj, mund të na e thoni. Por vetë shtabi sovjetik ka thënë se ekuipazhet shqiptare janë të përgatitura.

Na u tha pastaj se erdhi dimri, deti ka dallgë të mëdha. Shokët tanë erdhën këtu, në admiraliatin tuaj, e shtruan problemin dhe morën përgjigjen se «nëndetëset do t'ju dorëzohen». Por përsëri erdhi urdhër prej njerëzve tuaj të mos na jepen. Kur ishim në Tiranë Ministria jonë e Mbrojtjes i bëri një letër Gorshkovit, i shpjegoi çështjen shoqërisht, kështu si jua përkrova. Në letër thuhet se, në qoftë se duhen edhe disa muaj për përgatitjen e ushtarakëve tanë, mund të na e thoni. Por nuk është këtu arsyeja.

A. MIKOJANI: Po ku është arsyeja?

SHOKU ENVER HOXHA: Këtë duhet të na e thoni ju. Por nuk është kjo çështja kryesore. . . Le të vijmë tani te çështja e daljes nga Traktati i Varshavës, meqë në fillim folët lidhur me këtë gjë. . .

A. MIKOJANI: Jo, por krijohet përshtypja.

SHOKU ENVER HOXHA: Si krijohet përshtypja, në bazë të të dhënave të një farë kundëradmirali?! Le ta shohim këtë çështje se ka gjëra më serioze.

A. MIKOJANI: Ashtu?! Ne nuk dimë gjë.

SHOKU ENVER HOXHA: Si nuk e dini? Në qoftë se është ashtu, nuk është mirë që Komiteti juaj Qendror nuk ka dijëni. E dini se ne na kanë kërcënuar të na përjashtojnë nga Traktati i Varshavës? Këtë e ka bërë Greçko.

A. MIKOJANI: Ne s'dimë gjë, na e thoni.

SHOKU ENVER HOXHA: Do t'jua themi dhe me forcë, se është çështje parimore. Dy mareshalët tuaj, Malinovski dhe Greçko e kanë thënë një gjë të tillë. Ju duhet ta dini.

SHOKU HYSNI KAPO: Në datën 22 tetor unë ia kam thënë këtë Poljanskit.

A. MIKOJANI: Ju mund të mos më besoni, por unë nuk e di.

SHOKU ENVER HOXHA: Nëse e shtroni çështjen kështu, se nuk dini gjë, duhet t'ju kujtojmë se 4 muaj më parë ju kemi shkruar lidhur me ambasadorin. Përse nuk përdorët praktikën leniniste të partisë suaj e të na përgjigjeshit?

F. KOZLLOVI: Ne do t'ju dërgojmë një ambasador tjetër.

SHOKU ENVER HOXHA: Tani thoni kështu, por pse s'na keni shkruar? Ne ju kemi shkruar 4 muaj më parë, por përgjigje s'kemi marrë.

A. MIKOJANI: Kemi bërë mirë që nuk ju përgjigjëm. Ja sepse: Ka 15 vjet që ambasadorët tanë shkojnë

e pyesin nëpër komitetet e partive, kështu ka qenë edhe në Shqipëri. A mos është ndërhyrje nga ana e ambasadorit tonë që të pyesë kryetarin e Komisionit të Revizionimit¹ se ç'ndodhi në Plenum?

SHOKU ENVER HOXHA: Është ndërhyrje dhe kreyt e palejueshme. Unë mund të them se në vendin tonë nuk ka pasur gjë të fshehtë për njerëzit sovjetikë. Ka 16 vjet që kemi ndjekur praktikën që për vendimet dhe dokumentet me rëndësi të Komitetit Qendror të Partisë sonë ose të Qeverisë ne ju kemi vënë në dijeni. Përse e kemi bërë këtë? Sepse ne kemi qenë të sinqertë, të çiltër me Bashkimin Sovjetik dhe me PK të BS. Ju s'keni të drejtë ta akuzoni Partinë tonë se është sjellë keq ndaj PK të BS. Me shokët sovjetikë, që nga ambasadori e deri te specialisti më i thjeshtë, ne kemi qenë shumë të lidhur, të gjitha dyert ishin të hapura për ta.

A. MIKOJANI, M. SUSLLOVI: Tamam, ashtu është.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne mendojmë se s'mund të ketë parti tjetër që të jetë sjellë kështu ndaj PK të BS. Përse e kemi bërë këtë? Sepse PK të BS e kemi konsideruar si partinë, që nën udhëheqjen e Leninit bëri Revolucionin e madh Socialist dhe hapi e para rrugën drejt socializmit e komunizmit.

Para Bukureshtit ne kemi pasur mosmarrëveshje, ne do t'i themi ato. Për shembull, lidhur me revizionizmin jugosllav. Por ne kemi vepruar në mënyrë të tillë që jashtë të mos kuptohej asgjë. Përse u prishën marrëdhëniet pas Bukureshtit? Ç'thamë ne në Bukuresht? Ne shfaqëm qëndrimin tonë, duke thënë se mosmarrëveshjet

¹ Është fjala për Koço Tashkon.

që u parashtruan në Mbledhjen e Bukureshtit nga Hrushovi janë mosmarrëveshje që kanë lindur midis PK të BS dhe PK të Kinës dhe që për këto Partia e Punës e Shqipërisë rezervon të drejtën të shfaqë mendimin e saj në Mbledhjen e Moskës. Atëherë, pse u sulmua Partia jonë?

Ne s'jemi dakord me Bukureshtin, por ne nuk bëmë ndonjë gjë që të ndryshonte qind për qind qëndrimi juaj ndaj nesh. Në radhë të parë, ambasadori juaj u suall në mënyrë të poshtër. Ne e donim atë. Pas Bukureshtit dhe veçanërisht pas kthimit të tij nga Moska, ai filloi të na sulmojë dhe u suall me përbuzje ndaj nesh.

A. MIKOJANI: Kurrë nuk kam menduar që ai të arrijë gjer atje.

SHOKU ENVER HOXHA: Pra, ju nuk na besoni. Kini parasysh se jam Sekretar i Parë i KQ të Partisë së Punës. Kam qenë dhe jam mik i Bashkimit Sovjetik. Ju mund të mos më besoni mua, por u besoni «çinovnikëve» tuaj. Cili është interesi i PPSH që të krijojë mosmarrëveshje e të thotë gjëra të paqena për ambasadorin e Bashkimit Sovjetik?!

A. MIKOJANI: E besoj se ju s'jeni të interesuar për këtë. Ambasadori nuk na ka folur ndonjë gjë të keqe për ju. Ai, si njeri, është i mirë.

M. SUSLLOVI: Jo shumë i zgjuar, sidomos politikisht.

A. MIKOJANI: Na thoni, ç'duhet të bëjmë që të rregullohen marrëdhëniet tona. Ambasadorin do ta ndërrojmë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk është ashtu, ne s'kemi marrëdhënie thjesht diplomatike, por lidhje partie e

këto duhet të jenë mbi baza marksiste-leniniste. Për shembull, ambasadori Ivanov i kishte lidhjet me mua. Përse ai duhet të takonte kryetarin e Komisionit të Revizionimit?!

Unë jam Sekretar i Parë i KQ të Partisë. Ju kam pyetur përse e përjashtuat Zhukovin? Deri tani s'di gjë. Ambasadori sovjetik gjithnjë ka ardhur te unë dhe më ka pyetur për plenumet e Partisë sonë, unë i kam treguar. Erdhi e më pyeti edhe për punimet e këtij Plenumi¹. Unë i thashë atë që duhej thënë. Përderisa Sekretari i Parë i KQ të Partisë i tha kaq, ai duhet të shkonte në shtëpi e të flinte. Ndryshe, në qoftë se ambasadori juaj kap njërin e tjetrin, ai e shokët e tij s'janë diplomatë e përfaqësues të një vendi socialist, por zbulues. Punonjësit e ambasadës, nëpërmjet Besspallovit, kapën kryetarin e Komisionit të Revizionimit dhe e përpunuan në dy takime, pastaj radhën e tretë e thirrën për drekë në emër të ambasadorit, në shtëpinë e sekretarit të parë të ambasadës. Dhe ishin të tre, ambasadori, këshilltari, sekretari. Dhe atje shoku ynë, i cili para 15 ditësh ishte dakord me vendimin e Plenumit, me vijën e Komitetit tonë Qendror, iu kundërvu vijës së Partisë. Tani ju pyes ju: A mund të lejohet që një ambasador të veprojë në mënyrë të tillë dhe nga koka e tij?!

Ne mendojmë se qëllimi i këtyre veprimeve ka qenë të krijohet diversion në Partinë tonë. Ambasadori juaj shkoi edhe më larg. Ai u tha në aerodrom gjenera-

¹ Është fjala për Plenumin XVII të KQ të Partisë, i cili i zhvilloi punimet më 11-12 korrik 1960 dhe aprovoi veprimtarinë e delegacionit të PPSH në Mbledhjen e Bukureshtit.

lëve tanë, duke bërë aluzion për ngjarjet e Bukureshtit: «Me kë do të jetë ushtria?».

A. MIKOJANI, F. KOZLLOVI: Ai është budalla.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë ju respektoj, por ne nuk mund t'i hamë «justifikime» të tilla, megjithëse nuk kemi eksperiencën tuaj.

Lidhur me ftesën që më bëri Hrushovi, kjo është kryesore. Unë në fillim vendosa të takoheshim. Po, kur mora materialin tuaj, letrën drejtuar shokëve kinezë më 5 nëntor, shikoj se atje Shqipëria është përjashtuar nga kampi socialist. Atje numërohen të gjitha vendet e demokracisë popullore të Evropës, me përjashtim të Shqipërisë.

M. SUSLLOVI: Atje nuk përmendet as Bashkimi Sovjetik.

SHOKU ENVER HOXHA: Ç'janë këto që na thoni. Unë, po të isha në vendin tuaj, do ta pranoja se është gabim. Ivanovi ka vepruar kështu, Greçko gjithashtu, në dokument janë shkruar gjëra të tilla, Hrushovi i ka folur Ten Hsiao Pinit gjëra të ulëta për Shqipërinë, por ju asgjë s'pranoni. Kurse ne kemi qenë gjithnjë të sinqertë me ju. Edhe Kosigini nuk u suall mirë me mua në një bisedë që patëm. Ai u suall me mua sikur të ishte padron. Tha se «ka armiq në Partinë tuaj që duan të na përçajjnë».

Këtë vit ne kemi qenë keq për bukë, nga kushtet shumë të rënda natyrore. Kishim bukë vetëm për 15 ditë. Ju kërkuam 50 mijë tonë drithë, 45 ditë pritëm, por përgjigje nuk morëm. Blemë në Francë me valutë të lirë. Tregtari francez erdhi menjëherë në Shqipëri për të matur pulsën. Ai tha se «si është e mundur një gjë e tillë,

Shqipëria s'ka blerë bukë në vendet perëndimore, Bashkimi Sovjetik shet drithë kudo?». Ne, për të zhdukur dyshimet e tij, i thamë se «Bashkimi Sovjetik na ka dhënë drithë, na ka dhënë misër, por ne e përdorim për ushqimin e derrave». Ne e dimë ku shitni ju drithë, ku shesin rumunët, gjermanët: në Angli e gjetkë. Ju na vutë kushte dhe ne u detyruam t'ju ofrojmë flori për të blerë drithin që na duhej.

A. MIKOJANI: Ne nuk kemi refuzuar t'ju japim juve drithë. Unë e di se juve ju është dërguar çdo muaj drithë me vapor. Ju u propozuat njerëzve tanë të blini me ar, ata e pranuan. Ç'na duhet valuta juaj?!

SHOKU ENVER HOXHA: Shoku Pospjellov, ju e keni parë se ç'dashuri ushqen populli ynë për Bashkimin Sovjetik, kur ishit në Shqipëri. Por ju këtë dashuri tani e kërkonit te Koço Tashkoja e Liri Belishova e jo te ne.

Taktika që ndiqni ju është krejtësisht e shtrembër. Përpara se ju t'i shkruanit këto gjëra në letrën që përmenda, duhet të bisedonit më parë me mua. Por kur ju Partinë tonë dhe udhëheqjen e saj e akuzoni për anti-sovjetizëm, për kriminele, siç thoni ju «për metoda staliniste» e, pasi e keni akuzuar në sytë e të gjithëve, tani doni të bisedoni me mua, unë këtë nuk mund ta pranoj kurrë.

A. MIKOJANI: Ne ju ftuam që më parë të bisedonim, por ju nuk deshët.

SHOKU ENVER HOXHA: Çështja nuk është ashtu. Unë kisha pak ditë për të pushuar, ky ishte një gjysmë pushimi, sepse punoja për raportin e Kongresit të Par-

tisë¹. Shoku Hysni Kapo më tha se Ivanovi i kishte transmetuar që shoku Enver, po të dojë, mund të shkojë për të pushuar në Bashkimin Sovjetik. Por s'më tha për takimin me Hrushovin.

SHOKU HYSNI KAPO: Përsa i përket letrës suaj, me të cilën na ftonit për të biseduar, në të dilte qartë se për se duhej të bisedonim.

SHOKU ENVER HOXHA: Letra fliste të takoheshim në lidhje me çështjen e Kinës.

A. MIKOJANI: Jo për çështjen e Kinës; atje fjala «Kinë» as që përmendet². Ju refuzuat të takoheshit.

SHOKU MEHMET SHEHU: Si mund të mohohet një gjë e tillë? Si mund të silleni në këtë mënyrë ndaj vendit tonë? Rëndoftë turpi mbi ju, shoku Kozllov që i lejoni vetes t'i jepni ultimatum Shqipërisë së vogël, «me ne, ose me Kinën»!

F. KOZLLOVI: Kur kaloi këtu delegacioni juaj, unë vetëm thashë se më çuditi pozita e shokut Kapo. Qëndrimi juaj ishte i ndryshëm nga ai i partive të tjera. Ne

¹ Është fjala për Kongresin IV të PPSH, punimet e të cillit ishte vendosur të zhvilloheshin në nëntor të vitit 1960. Më pas, për shkak të Mbledhjes së 81 partive komuniste e punëtore në Moskë, punimet e Kongresit u vendos të shtyheshin për në shkurt të vitit 1961.

² Kjo që një gënjeshtër sy për sy nga ana e A. Mikojanit. Në letrën e 13 gushtit që KQ i PK të BS i drejtonte KQ të PPSH thuhej shprehimisht se: «Mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore që u mbajt në Bukuresht tregoi se midis Partisë Komuniste të Kinës dhe partive të tjera motra ka një kuptim të ndryshëm të një varg çështjesh të rëndësishme të situatës ndërkombëtare dhe të taktikës së partive komuniste...».

Lexo edhe f. 128 të këtij vëllimi.

jemi sjellë kaq mirë me ju. Shoku Enver, kur ka folur në Leningrad, ka thënë se populli shqiptar e ndien se është jo një milion, por 201 milion.

SHOKU ENVER HOXHA: E them edhe tani, por jo në qoftë se ju nuk keni parasysh Kinën. Edhe ne, edhe ju, duhet të jemi për unitetin e kampit, për një miliard. Ne e duam Bashkimin Sovjetik, por edhe popullin kinez, edhe PK të Kinës e duam shumë. Por pse pas Bukureshtit ju, shoku Kozllov, flitni për «zigzage» të Partisë sonë, me kë do të jemi, «me 200 apo me 600 milionët»? Edhe në takimin ku asistonin ambasadorë të tjerë, ju keni thënë se mjafton një bombë për ta bërë Shqipërinë shkumb e hi...

SHOKU HYSNI KAPO: Ju thoni se ne gjoja flasin pas shpine. Por Hrushovi, në datën 22 tetor, i ka thënë shokut Ten Hsiao Pin se këtej e tutje ndaj Shqipërisë do të sillet si dhe ndaj Jugosllavisë.

J. ANDROPOVI: Ja se si ka qenë kjo çështje: në bisedën me shokët kinezë shoku Hrushov tha se disa udhëheqës shqiptarë s'janë të kënaqur që çështja e Berlinit nuk ka përfunduar.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe unë e kam thënë një gjë të tillë. Pasi u kthye Hrushovi nga Parisi, Ivanovi më pyeti për çështjen e Berlinit. Unë iu përgjigja: Sipas mendimit tim personal, imperializmi është tronditur, pozitat tona janë të forta, është krijuar një situatë politike e favorshme në Amerikë, e cila mund të shfrytëzohet për zgjidhjen e problemit të Berlinit. Ky ishte mendimi im personal.

A. MIKOJANI: Këtu s'ka gjë të keqe, por jo si e ka bërë ndonjëri, i cili na ka ofenduar, u ka thënë oficerë-

ve tanë, ju u trembët në Berlin, nuk e mbajtët fjalën etj. . .

J. ANDROPOVI: Hrushovi tha lidhur me këto fjalë se me shqiptarët kemi pasur marrëdhënie të mira, po ja që, siç tregojnë punët, ne s'mund t'u besojmë, e humbëm Shqipërinë. . .

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe kështu nuk është aspak shoqërore. Si na ka mësuar partia e bolshevikëve? Të gjitha këto gjëra kanë një bûrim. Marksizëm-leninizmi nuk njeh që ngjarjet të zhvillohen spontaneisht. Prandaj duhet të thelloheni në këto gjëra. Cilat janë arsytet që sollën në këto gjëra pas Bukureshtit? Ne mendojmë se ju duhet të na i thoni ato.

A. MIKOJANI: Mundet që ne jemi njerëz të këqij, por ne s'jemi budallenj. Përse të na duhet keqësimi i marrëdhënieve me ju?

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe ne e kemi bërë këtë pyetje. Le që ne s'kemi gabuar, por, edhe sikur të kishim bërë gabime, PK e BS që ka parë shumë gjëra, pse nuk tregoi durim me ne shqiptarët dhe udhëheqja e saj të thoshte: mirë, shqiptarët kanë gabuar, të shohim ç'do të thonë nesër pasi të mendohen.

Duhet ta dini shokë, se neve nuk na vjen mirë kur shohim këto që po ndodhin në qëndrimet e udhëheqësve e të personave të tjerë zyrtarë sovjetikë ndaj Shqipërisë e Partisë sonë të Punës. Ne ju themi se duhet ndryshuar krejt fryma jo e shëndoshë që ekziston në njerëzit tuaj në Shqipëri. Që pas Mbledhjes së Bukureshtit, pas atyre që po bën Ivanovi me shokë, unë s'kam takuar e s'do t'i takoj njerëzit tuaj në Tiranë.

A. MIKOJANI: Kuadrot tuaj kanë ndryshuar që-

ndrimin ndaj nesh. Komiteti Qendror i Partisë sonë nuk përmendet, Hrushovi përmendet vetëm se vepron jo drejt.

SHOKU ENVER HOXHA: Duhet t'ju them shoqërisht se Hrushovi na akuzon shpesh për «gjaknxehtë». Por vetë Hrushovi duhet të kontrollojë fjalët që thotë, sepse çdo shtet, çdo njeri ka dinjitetin e tij. Ai ka thënë se Shqipërinë do ta trajtojmë njëlloj si Jugosllavinë. Ju nuk duhet të shkruani gjëra të tilla në dokument.

P. POSPJELLOVI: Shoku Kapo në Bukuresht me replikat e tij ka vepruar jo drejt.

SHOKU ENVER HOXHA: Bukureshtin, ashtu si e organizuat ju, ne s'e pranojmë edhe tashti.

A. MIKOJANI: Bukureshti është një çështje tjetër. Tani çështja shtrohet nëse duhet t'i përmirësojmë ose jo marrëdhëniet tona. Sot shoku Hrushov, në fjalinë e tij, tha se ne do të kemi miqësi edhe me partitë me të cilat kemi mosmarrëveshje. Ne duhet të takohemi dhe të bisedojmë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne s'jemi kundër takimeve. Por nga shokët e udhëheqjes së PK të BS ne kërkojmë të jenë më të kujdesshëm, sepse t'u shpërndani një dokument 80 e ca partive ku lini Shqipërinë jashtë vendeve socialiste dhe pastaj të na ftoni: «ejani të bisedojmë», kjo është krejt e papranueshme nga ne.

M. SUSLLOVI, A. MIKOJANI: Le të takohemi për të biseduar se si të përmirësojmë marrëdhëniet tona.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne gjithashtu kërkojmë që të përmirësojmë marrëdhëniet tona.

M. SUSLLOVI: Por jo me një ton të tillë.

SHOKU ENVER HOXHA: Dua t'ju jap një këshillë:

hiqeni nga mendja se ne jemi gjaknxehtë. Kur është çështja për të mbrojtur marksizëm-leninizmin dhe interesat e popullit tonë, ne do t'i mbrojmë ato me zjarr.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në Arkivin
Qendror të Partisë*

**NE KEMI LUFTUAR EDHE PA BUKË E TË
ZBATHUR, POR ASNJËHERË NUK I JEMI
PËRKULUR ASKUJT**

*Biseda e delegacionit të PPSH të kryesuar nga shoku
Enver Hoxha, në takim me N. S. Hrushovin
në Moskë, Kremlin¹*

12 nëntor 1960

N.S. HRUSHOVI: Mund të merrni fjalën, ne ju
dëgjojmë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju na keni ftuar, i zoti
i shtëpisë duhet ta marrë fjalën i pari.

N. S. HRUSHOVI: Ne pranojmë kushtet e shqiptarëve.

Nuk e kuptoj, ç'ka ngjarë pas vizitës sime në Shqipëri në vitin 1959! Nëse edhe atëherë ju ishit të pakënaqur ndaj nesh, unë duhet të jem i trashë dhe shumë naiv që nuk e kuptova këtë. Përveç fjalëve të mira, ne atëherë

¹ Në datën 12 nëntor 1960 delegacioni i PPSH pranoi të takohet edhe një herë me përfaqësuesit e PK të BS. Nga pala sovjetike në këtë takim morën pjesë edhe A. Mikojan, F. Kozllov, J. Andropov.

rë nuk kemi thënë asgjë, në qoftë se nuk përmendim shakatë e veçanta siç është ajo që bëra me shokun Mehmet Shehu lidhur me plepat¹.

SHOKU ENVER HOXHA: Nëse kjo është hyrje për bisedim, është një çështje tjetër. Shakaja lidhur me plepat këtu s'mund të ketë vend.

N. S. HRUSHOVI: Por çfarë arsye tjetër mund të jetë atëherë, pse e keni ndryshuar qëndrimin ndaj nesh?

SHOKU ENVER HOXHA: Jo ne, por ju e keni ndryshuar qëndrimin. Ne dhe më parë kemi pasur mosmarrëveshje, si për shembull, lidhur me qëndrimin ndaj revizionistëve jugosllavë. Por ky ndryshim i qëndrimit ndodhi pas Bukureshtit dhe pikërisht nga ana juaj.

N.S. HRUSHOVI: Dua të përcaktoj diçka. Unë kam menduar se lidhur me Jugosllavinë ne nuk kemi pasur ndonjë mosmarrëveshje. Ju keni folur më shumë se ne për këtë çështje, edhe ne kemi shkruar, por pa pasion. Ne e kemi thënë se sa më shumë të flitet kundër tyre, aq më shumë atyre do t'u rritet vlera. Dhe kështu ka ndodhur.

SHOKU ENVER HOXHA: Për ne, nuk ka ndodhur kështu.

N. S. HRUSHOVI: Unë e them për ne. Pastaj, dua t'ju pyes: me ç'ton do të flasim? Në qoftë se nuk doni miqësi me ne, na e thoni.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne duam të jemi gjithnjë miq, duam të bisedojmë në mënyrë miqësore. Por

¹ E vetmja vërejtje që gjeti të bënte N. Hrushovi gjatë vizitës së tij në Shqipëri në maj të vitit 1959 ishte që plepat ndanë rrugëve tona automobilistike të zëvendësoheshin me fiq e kumbulla!...

kjo s'do të thotë se ne duhet të jemi dakord me ju për të gjitha çështjet.

N. S. HRUSHOVI: Ne ju kemi ftuar tri herë për bisedime, mos doni t'i presim marrëdhëniet?!

SHOKU ENVER HOXHA: Ju jeni ata që shkaktuat prishjen e marrëdhënieve tona pas Bukureshtit. Ne u kemi treguar shumë fakte shokëve tuaj, ata duhet t'ju kenë thënë.

N. S. HRUSHOVI: Nuk e kuptoj mirë këtë gjë, në Bukuresht unë me Hysni Kapon nuk pata ndonjë konflikt. Ai tha se nuk ishte i autorizuar nga Komiteti Qendror për të mbajtur qëndrim ndaj çështjeve që diskutoheshin.

SHOKU HYSNI KAPO: Në Bukuresht unë shpreha qëndrimin e Partisë sonë duke deklaruar se Mbledhja e Bukureshtit që e parakohshme dhe u zhvillua në kundërshtim me rregullat organizative leniniste; se mosmarrëveshjet për të cilat u bë fjalë atje qenë mosmarrëveshje midis PK të BS dhe PK të Kinës dhe se Partia e Punës e Shqipërisë do ta thotë fjalën e saj për këto çështje në mbledhjen e ardhshme. Atëherë ju thatë se çuditëni nga pozita e Partisë së Punës të Shqipërisë. Këtë e thatë si në mbledhjen e 12 partive të vendeve socialiste, ash'u dhe në mbledhjen e gjerë të 50 e ca partive. Ne në të vërtetë jua thamë pozitën tonë qysh para se të flitnim në mbledhjen e 12 partive. Për këtë unë kam folur me Andropovin. Pasi ai ju tregoi për këtë, ju i thatë Andropovit t'u transmetonte shqiptarëve që të mendoheshin për të ndryshuar qëndrimin e tyre.

SHOKU ENVER HOXHA: Komiteti Qendror i Partisë sonë nuk ka qenë kurrë dakord me Mbledhjen e Bu-

kureshtit. Unë qysh në fillim kam qenë në korent të të gjitha atyre që ndodhnin në Bukuresht.

N. S. HRUSHOVI: Kjo s'ka shumë rëndësi. Çështja genka se edhe para Bukureshtit ju nuk keni qenë dakord me ne, por një gjë të tillë nuk na e keni thënë. Kurse ne ju kemi konsideruar si miq. Fajin e kam unë që ju kam besuar shumë.

SHOKU MEHMET SHEHU: I lutem shokut Hrushov të kujtojë bisedimet tona në vitin 1957. Ne me zëmër të hapur ju folëm për të gjitha çështjet, midis tyre edhe për veprimtarinë e revizionistëve jugosllavë. Ju na dëgjuat, pastaj, pas një replike që ju bëri shoku Enver, ju u ngritët në këmbë dhe na thatë: «Mos doni të na vini në rrugën e Stalinit!». Domethënë ju, qysh më parë, e dinit se ne mendojmë ndryshe nga ju për revizionistët jugosllavë. Ju këtë e dini të paktën qysh nga prilli i vitit 1957. Por, ju kujtohet se, kur ju do të shkonit në Jugosllavi në vitin 1955, letrës suaj, ku propozonit për ndryshimin e qëndrimit që duhej mbajtur ndaj revizionistëve jugosllavë, ne iu përgjigjëm se kjo çështje më parë duhet të analizohet nga Informbyroja e ajo të vendoste.

A. MIKOJANI: Po, kështu ka ndodhur.

N. S. HRUSHOVI: Ju thoni se në Bashkimin Sovjetik kanë ardhur në fuqi njerëz të rinj pa eksperiencë. Mos doni të na mësoni ju ne?

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, nuk është nevoja. Kjo është çështje juaj e brendshme. Po ju a e dini se çfarë ka thënë ambasadori juaj? Përveç të tjerave, po them vetëm një fakt, që ka të bëjë me ushtrinë. Ai ka bërë pyetjen se kujt do t'i qëndrojë besnike ushtria

shqiptare. Këtë ua tha gjeneralëve tanë në aeroport, në prezencë të gjeneralit tuaj. Oficerët tanë iu përgjigjën se ushtria shqiptare do t'i qëndrojë besnike marksizëm-leninizmit, Partisë së Punës dhe socializmit.

N. S. HRUSHOVI: Nëse ambasadori e ka thënë një gjë të tillë, ai ka bërë budallallëk.

SHOKU ENVER HOXHA: Por ky është një budallallëk politik.

N. S. HRUSHOVI: Ky është çdo lloj budallallëku.

A. MIKOJANI: Mos vallë kjo sjellje e ambasadorit shprehte vijën tonë?

SHOKU ENVER HOXHA: Budallallëku i një budallai një herë mund të falet, edhe në qoftë se ka karakter politik, por, kur ai përsëritet shumë herë, atëherë kjo është vijë.

N. S. HRUSHOVI: Po, kjo është e vërtetë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ambasadori juaj ka qenë në mik i Partisë sonë dhe yni personalisht. Budalla ai nuk ishte. Këtë «budallallëk» ai e bëri pas Mbledhjes së Bukureshtit. Përse nuk bëri «budallallëq» të tilla para Bukureshtit, tre vjet me radhë që qëndroi në Shqipëri? Kjo është e çuditshme!

A. MIKOJANI: Nuk është e çuditshme, por ai më parë mernte të dhëna nga ju rregullisht dhe nuk kishte parë një sjellje të tillë nga ana juaj.

SHOKU ENVER HOXHA: Më duket se ju keni thënë se ai nuk e dinte që midis nesh ka mosmarrëveshje...

A. MIKOJANI: Shoku Enver na tha se më parë ai i tregonte gjithçka Ivanovit, por pastaj jo, nga kjo ka rrjedhur dhe ndryshimi i qëndrimit të ambasadorit. Këto gjëra ne i biseduam.

SHOKU ENVER HOXHA: Nëse këto gjëra i kemi biseduar, siç thotë Mikojani, atëherë pse rrimë këtu? Në qoftë se, pasi t'i diskutojmë çështjet, do të themi se ne nuk jemi dakord me ju, ju mund të na thoni se «i kemi biseduar».

A. MIKOJANI: Por ne e thirrëm ambasadorin, përse e fryni këtë çështje?

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, e lëmë ambasadorin, por ato që keni shkruar për Shqipërinë e Partinë e Punës në letrën tuaj drejtuar shokëve kinezë për ne janë monstruoze.

A. MIKOJANI: Ne kemi shprehur mendimin tonë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Ju na akuzoni përpara të gjithëve për antisovjetizëm. (*Lexon faqen 46 të letrës*).

N. S. HRUSHOVI: Ky është mendimi ynë. Ju mos u nxehni.

SHOKU MEHMET SHEHU: Ju na goditni, kurse ne duhet të mos nxehemi.

N. S. HRUSHOVI: Neve na vjen keq për atë që ngjau me këta njerëz¹. Ju s'jeni dakord. Koço Tashkon unë nuk e kam njohur, ndoshta mund ta kemi parë, por, po të më tregoni dhe fotografinë, mua nuk do të më kujtohet.

SHOKU ENVER HOXHA: Nëse e doni fotografinë, mund t'jua dërgojmë.

N. S. HRUSHOVI: Belishovën unë e njoh më pak se ju. Di se ajo ishte anëtare e Byrosë. Ajo na tregoi për bisedën që kishte pasur në Kinë. Kosigini ia tha këtë shokut Mehmet kur ishte në Moskë, i cili, kur e dë-

¹ Liri Belishovën e Koço Tashkon.

gjoj, u zbardh nga zemërimi. Ajo ishte grua burrërore, na e tha hapur atë që ndiente. Kjo është një tragjedi, ju e përjashtuat atë, sepse ishte për miqësinë me ne! Prandaj ne shkruam për këtë në dokument.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë ju e quani të drejtë këtë që është shkruar këtu, në materialin tuaj?

N. S. HRUSHOVI: Po.

SHOKU ENVER HOXHA: Këtu ka dy gjëra. Së pari, thuhet nga ju se ne e përjashtuam anëtarin e Byrosë në rrugë jodemokratike. Kush ju ka thënë se kjo nuk është bërë sipas rregullave demokratike dhe normative leniniste, por, siç i quani ju, sipas «metodave staliniste»?! Së dyti, ju thoni se ne e përjashtuam atë për prosovjetizëm, dhe këndej del se ne jemi antisovjetikë. Mund të na e shpjegoni këtë?

N. S. HRUSHOVI: Nëse ju keni ardhur këtu qysh më parë me mendjen për të mos rënë dakord, por për prishjen e marrëdhënieve, na thoni të mos harxhojmë kohë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju nuk iu përgjigjët pyetjes sonë. Dhe këtë material ua keni shpërndarë të gjitha partive.

N. S. HRUSHOVI: Atyre partive që kinezët u kanë shpërndarë materialin e vet.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe ne kemi pikëpamjen tonë, e cila nuk i përgjigjet tuajës. Ju dy-tri herë na keni shtruar pyetjen nëse ne jemi për miqësinë apo për prishjen e marrëdhënieve. Ne kemi ardhur këtu për të forcuar miqësinë. Por ju nuk po pranoni asgjë nga gabimet tuaja. Ju keni kritika ndaj nesh, edhe ne kemi ndaj jush. Ju na keni bërë kritika të mbyllura dhe të

hapura, përpara të gjithëve. Ju mund të keni edhe kritika të tjera. Na i thoni, edhe ne do t'i themi, që t'i dinë komitetet tona qendrore. Komiteti Qendror i Partisë sonë na ka dërguar që të forcojmë miqësinë tonë.

N. S. HRUSHOVI: Një shoku juaj u ka thënë ushtarakëve tanë se Hrushovi nuk është marksist.

SHOKU ENVER HOXHA: Lidhur me çështjen e ushtarakëve ne u kemi folur shokëve tuaj. Ç'interes kemi ne që ushtarakët tanë të grinden në bazën e Vlorës! Kurse ju nxirrni «dokumente» se një shoku ynë paska thënë kështu e ashtu. Shikojini mirë ushtarakët tuaj. Unë i thashë Mikojanit se kundëradmirali juaj në bazën ushtarake në Vlorë nuk është kundëradmiral.

N. S. HRUSHOVI: Në qoftë se doni ne mund ta heqim bazën.

SHOKU ENVER HOXHA: Atëherë del e vërtetë ajo që kanë thënë Malinovski dhe Greçko. Mos doni të na kërcënoni? Po të dëgjojë populli sovjetik se ju kërkoni të hiqni bazën nga Vlora, kur ajo shërben për mbrojtjen e Shqipërisë dhe të vendeve të tjera socialiste të Evropës, këtë nuk do t'juja falë...

N. S. HRUSHOVI: Shoku Enver, mos e ngrini zërin!

SHOKU ENVER HOXHA: Nëse do të hiqni bazën, do të bëni një gabim të madh. Ne kemi luftuar edhe pa bukë e të zbathur, por asnjëherë nuk i jemi përkulur askujt.

N. S. HRUSHOVI: Nëndetëset janë tonat.

SHOKU ENVER HOXHA: Tuajat dhe tonat, ne luftojmë për socializmin. Territori i bazës është yni. Për nëndetëset ne kemi marrëveshje të firmuara që i njohin të drejta shtetit shqiptar. Unë mbroj interesat e vendit tim.

A. MIKOJANI: Toni juaj është i tillë, sikur Hrushovi s'ju ka dhënë gjë. Ne kemi biseduar midis nesh lidhur me bazën. Hrushovi nuk ishte për heqjen e saj. Unë i thashë, nëse oficerët tanë do të zihen me shqiptarët, atëherë ç'na duhet ta mbajmë bazën?!

SHOKU MEHMET SHEHU: Ju na keni konsideruar ne si armiq. Edhe këtu në Moskë keni zhvilluar veprimtari zbulimi ndaj nesh. Ju e dini mirë këtë¹.

SHOKU ENVER HOXHA: Si u shtrua këtu çështja, mund ta diskutojmë atë në Traktatin e Varshavës. Unë dua të them se juve ju ka shkuar ndër mend një gjë e tillë, kurse neve jo. Pastaj thoni që «në qoftë se doni, ne e heqim». Në bazën e Vlorës kanë ekzistuar gjithnjë marrëdhënie të mira midis shqiptarëve dhe sovjetikëve, vetëm pas Mbledhjes së Bukureshtit ka pasur disa raste të veçanta, të shkaktuara nga oficerët tuaj jo të mirë. Nëse ju insistoni, mund të mbledhim Traktatin e Varshavës. Po baza e Vlorës është jona e do të mbetet jona.

N. S. HRUSHOVI: Ju nxeheni, ju më keni pështyrë, me ju nuk mund të bisedosh.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju gjithnjë thoni se ne jemi gjaknxehtë.

N. S. HRUSHOVI: Ju shtrembëroni fjalët e mia. Përkthyesi a e di rusishten?

SHOKU ENVER HOXHA: Mos u kapni pas për-

¹ Është fjala për aparatet e përgjimit të bisedave, të vendosura në mënyrë të fshehtë nga revizionistët sovjetikë si në selinë e caktuar për të strehuar delegacionin e PPSH, në Zareçje të Moskës, ashtu edhe në zyrat e Ambasadës së RP të Shqipërisë në Moskë.

kthyesit, ai e di fort mirë rasishten. Unë ju respektoj, edhe ju duhet të më respektoni.

N. S. HRUSHOVI: Kështu me mua ka dashur të fliste Makmilani.

SHOKËT MEHMET SHEHU E HYSNI KAPO: Shoku Enver nuk është Makmilan, prandaj merreni fjalën mbrapsht.

N. S. HRUSHOVI: Po ku ta fus?

SHOKU MEHMET SHEHU: Futeni në xhepin tuaj.

SHOKU HYSNI KAPO: (duke iu drejtuar shokëve të delegacionit tonë) Unë nuk jam dakord të zhvillohen kështu bisedimet.

Shoku Enver Hoxha dhe shokët e tjerë ngrihen e largohen nga salla.

Botohet për herë të parë me ndonjë shkurtim sipas shënimeve të mbajtura gjatë bisedës që gjenden në Arkivin Qendror të Partisë

FJALA E MBAJTUR NË EMËR TË KQ TË PPSH NË MBLEDHJEN E 81 PARTIVE KOMUNISTE DHE PUNËTORE NË MOSKË¹

16 nëntor 1960

Të dashur shokë,

Kjo mbledhje e partive komuniste dhe punëtoare ka një rëndësi historike për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, pse po i bën një analizë të hollësishme situatës politike ndërkombëtare, po bën bilancin e sukseseve dhe të gabimeve që mund të jenë vërtetuar në rrugën tonë

¹ Mbledhja e 81 partive komuniste e punëtoare u mbajt në Moskë prej 10 nëntorit deri më 1 dhjetor 1960. Ajo u zhvillua në një gjendje tepër të ndërlikuar të lëvizjes komuniste ndërkombëtare si pasojë e përhapjes së revizionizmit modern dhe sidomos e veprimtarisë përçarëse antimarksiste të udhëheqjes sovjetike me Hrushovin në krye.

Delegacionin e PPSH e kryesonte shoku Enver Hoxha. Fjala që mbajti ai në Mbledhjen e Moskës u aprovua nga Plenumi XXI i KQ të PPSH më 1 nëntor 1960.

Veprimtaria e delegacionit të KQ të PPSH në Mbledhjen e Moskës u aprovua plotësisht dhe njëzëri nga Plenumi XXI i KQ të PPSH më 19-20 dhjetor 1960.

dhe na ndihmon ne të përcaktojmë më qartë vijën që duhet të ndjekim paskëtaj për të korrur suksese të reja në dobi të socializmit, të komunizmit dhe të paqes.

Në botë tashmë ekziston kampi i socializmit, me Bashkimin Sovjetik në krye. Lëvizja komuniste në përgjithësi është zgjeruar, është forcuar dhe është kalitur. Partitë komuniste dhe punëtore në të gjithë botën janë bërë një forcë kolosale, që çon njerëzimin përpara drejt socializmit, drejt paqes.

Siç theksohet edhe në projektdeklaratën që është përgatitur, kampi ynë i socializmit është shumë më i fortë se kampi i imperializmit. Socializmi çdo ditë forcohet dhe ngjitet, kurse imperializmi dobësohet, kalbëzohet. Ne me të gjitha mjetet dhe forcat duhet ta shpejtojmë këtë proces. Kjo do të ngjasë në qoftë se i qëndrojmë besnikë të patundur marksizëm-leninizmit dhe e zbatojmë atë drejt. Përndryshe, në do ta frenojmë këtë proces, pse kemi përpara armiq të egër, që duhet t'i mundim dhe t'i shkatërrojmë, kemi imperializmin, me imperializmin amerikan në krye.

Ne e duam paqen, kurse imperializmi nuk e do paqen dhe po përgatitet për një luftë të tretë botërore. Ne duhet të luftojmë me të gjitha forcat që të shmangët lufta botërore dhe të triumfojmë në botë një paqe e drejtë dhe demokratike. Kjo do të arrihet kur imperializmin do ta detyrojmë të çarmatoset. Me vullnetin e tij imperializmi nuk i lëshon armët. Të besosh një gjë të tillë, është njësoj si të gënjësh veten dhe të tjerët. Duhet t'i vëmë, pra, imperializmit përballë forcën kolosale ekonomike, ushtarake, moralopolitike dhe ideologjike të

kampit të socializmit dhe njëkohësisht forcën e bashkuar të popujve të të gjithë botës, për të sabotuar me të gjitha mënyrat luftën që pregatitin imperialistët.

Partia e Punës e Shqipërisë këtë situatë dhe kërcënimin që i turret njerëzimit paqedashës nga imperialistët as nuk ia ka fshehur dhe as do t'ia fshehë popullit të vet. Populli shqiptar, i cili e urren luftën, mund t'ju sigurojmë se nuk është frikësuar nga ky veprim i drejtë i Partisë së tij: as pesimist nuk është bërë, as në vend nuk ka ngecur përse i përket ndërtimit të socializmit. Perspektivat e së ardhmes ai i ka të qarta dhe punon me besim të plotë, duke qenë kurdoherë vigjilent, duke mbajtur në njërën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën.

Pikëpamja jonë është se imperializmi, me imperializmin amerikan në krye, duhet demaskuar pa mëshirë, politikisht dhe ideologjikisht dhe asnjëherë nuk duhet lejuar t'i bëhen lajka, përkëdhelje, lustrime imperializmit. Asnjë lëshim parimor nuk duhet t'i bëhet imperializmit. Taktikat dhe kompromiset e lejueshme nga ana jonë duhet të ndihmojnë çështjen tonë dhe jo të armikut.

Përpara armikut të egër garanci për fitoren e çështjes sonë është uniteti ynë i plotë, i cili do të sigurohet duke zhdukur mosmarrëveshjet e thella ideologjike që janë shfaqur, dhe duke e bazuar këtë unitet në bazat e marksizëm-leninizmit, në barazi, në vëllazërim, në frymën shoqërore dhe të internacionalizmit proletar. Partia jonë mendon se jo vetëm nuk duhet të ketë asnjë të çarë ideologjike, por rrjedhimisht duhet të kemi edhe një qëndrim politik unik për të gjitha çështjet. Taktika dhe strategjia jonë ndaj armiqve duhet të jenë të përpunuara prej të gjitha partive tona, të mbështetura në pa-

rimet marksiste-leniniste, në kritere të drejta politike dhe që t'u përshtaten situatave konkrete dhe reale...

Të gjithë popujt e botës aspirojnë dhe luftojnë për liri, për pavarësi, për sovranitet, për drejtësi shoqërore, për kulturë, për paqe. Këto aspirata të shenjta ua ka shtypur dhe po ua shtyp kapitalisti, feudali, imperialisti dhe është, pra, e natyrshme që lufta e këtyre popujve të zhvillohet me rreptësi të madhe kundër kapitalistëve, kundër feudalëve, kundër imperialistëve. Është gjithashtu e natyrshme që popujt e botës të kërkojnë ulyeatët e tyre në këtë luftë për jetën, që bëjnë kundër xhelatëve të tyre...

Prandaj, në luftën për paqën, për çarmatimin, për përparimin shoqëror në botë, kampi i socializmit nuk është i vetëm përballë kampit imperialist; ai është në aleancë të ngushtë me të gjithë popujt përparimtarë të botës, kurse imperialistët ndodhen të vetëmuar përballë kampit të socializmit.

Po jetojmë në një kohë, kur shohim të shkatërrohet fund e krye kolonializmi, të zhduket kjo murtajë që shfaroste popujt nga faqja e dheut. Shtete të reja po lindin në Afrikë, në Azi. Shtete ku sundonte kapitali, këмбаçi dhe plumbi po zhdukin zgjedhën e robërisë dhe popujt po marrin në dorë fatet e tyre. Kjo gjë u arrit dhe po arrihet në saje të luftës së këtyre popujve dhe të ndihmës morale që u japin këtyre popujve Bashkimi Sovjetik, Kina Popullore dhe vendet e tjera të kampit të socializmit.

Tradhtarë të marksizëm-leninizmit, agjentë të imperializmit dhe intrigantë, si Josif Broz Titoja, përpi-

qen me një mijë mënyra, duke kurdisur plane djallëzore, për të çorientuar popuj dhe shtete të reja, për t'i shkëputur këta nga aleatët e tyre të natyrshëm, për t'i lidhur këta drejtpërdrejt me imperializmin amerikan. Ne duhet të vëmë të gjitha forcat për t'ua shpartalluar këto plane këtyre shërbëtorëve të imperializmit.

Ne po asistojmë në shthurjen e imperializmit, të kalbëzimit të tij, të agonisë së tij. Ne rrojmë dhe luftojmë në epokën që karakterizohet nga kalimi i pandalshëm nga kapitalizmi në socializëm. Po vërtetohen të gjitha mësimet gjeniale të Karl Marksit dhe të Vladimir Iliç Leninit, të cilat kurrë nuk janë vjetruar, siç pretendojnë revizionistët.

Imperializmi botëror po ha grushte të rënda, të atilla që tregojnë qartë se ai nuk është më në «moshën e artë» të tij, kur bënte ligjin kur të donte dhe si të donte. Inisiativa i iku tani nga duart dhe këtë nuk e la nga qejfi dhe me dëshirën e vet. Kjo inisiativë nuk iu muar atij me fjalë dhe vetëm me fjalime, por iu muar pas një procesi të gjatë luftërash dhe revolucionesh të përgjakshme, që kapitalizmi vetë provokoi kundër proletariatit, kundër forcës së popujve që po ngriheshin për të shkatërruar botën e urisë dhe të mjerimit, botën e skllavërisë. Këtë faqe të lavdishme e hapi Revolucioni i madh Socialist i Tetorit, e hapi Bashkimi i madh Sovjetik, e hapi Lenini i madh.

Imperializmi botëror, me imperializmin amerikan në krye, edhe tani, kur shikon se i afrohet vdekja, kur shikon se përpara tij ka kundërshtarë të fortë dhe të vendosur, siç janë kampi i socializmit dhe aleanca e tij e madhe me të gjithë popujt e botës, po përqëndron,

organizon dhe armatos forcat e tij të sulmit. Ai pregatitet për luftë. Kush nuk e sheh këtë ai është qorr. Kush e sheh, por e mbulon, ai është tradhtar në shërbim të imperializmit.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se, me gjithë vështirësitë e mëdha që hasim në rrugën për vendosjen e paqes në botë, për çarmatimin dhe për zgjidhjen e problemeve të tjera ndërkombëtare, nuk ka pse të jemi pesimistë. Vetëm armiqtë tanë, që po pësojnë humbje, janë dhe duhet të jenë pesimistë. Ne kemi fituar, fitojmë dhe do të fitojmë, prandaj kemi qenë dhe jemi optimistë dhe jemi të bindur se përpjekjet tona do të kurorëzohen me sukses. 1

Por ne mendojmë se optimizmi i tepruar, jorealist, jo vetëm s'është i mirë, por është i dëmshëm. Kush mohon, kush zvogëlon, kush s'ka besim në forcën tonë të madhe ekonomike, politike, ushtarake, morale, ai është disfatist dhe s'meriton të quhet komunist. Por edhe ai, që, i dehur nga forca jonë, i duken kundërshtarët miza, kujton se armiku ka humbur çdo shpresë, se ai u bë i parrezikshëm dhe është plotësisht në mëshirën tonë, ai nuk është realist dhe blofon, i vë në gjumë njerëzit, vë në gjumë popujt përpara këtyre situatave të ndërlikuara dhe plot rreziqe, që kërkojnë prej të gjithëve një vigjilencë shumë të madhe, që kërkojnë ngritjen e hovit revolucionar të masave dhe jo uljen, shthurjen, dekompozimin dhe rehatinë. Populli ynë i vuajtur thotë: Uji fle, por armiku nuk fle.

Le të shohim drejt në sy faktet. Imperializmi botëror, me repartin e tij më agresiv, imperializmin amerikan në krye, po drejton ekonominë e tij drejt përgatit-

jes së luftës. Ai po armatoset deri në dhëmbë. Imperializmi amerikan po armatos me çfarëdo arme Gjermaninë e Bonit, Japoninë dhe të gjithë aleatët dhe satelitët e tij. Ai ka organizuar dhe i përsos organizatat ushtarake agresive, ai ka krijuar dhe po krijon baza ushtarake nga të katër anët rreth kampit të socializmit. Ai po i shton stoqet e armëve bërthamore, ai s'pranon të çarmatoset, ai s'pranon t'i ndalojë provat e armëve bërthamore, ai punon në ethe për shpikje të reja armësh të shfarosjes në masë. Të gjitha këto përse i bën? Për të shkuar në dasmë? Jo! Për të shkuar në luftë kundër nesh, për të zhdukur socializmin dhe komunizmin, për të skllavëruar popujt.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se po të flasin dhe po të mendojmë ndryshe, atëherë gënjejmë veten dhe të tjerët. Ne nuk do të quheshim komunistë, në rast se do të na trembnin vështirësitë e jetës. Ne komunistët e urrejmë luftën, ne komunistët do të luftojmë deri në fund që t'i shkatërrojmë planet djallëzore dhe të luftës, që pregatit imperializmi amerikan, por po na shpalli ai luftë, ne duhet t'i japim grushtin përfundimtar, që imperializmi të zhduket përgjithmonë nga faqja e dheut.

Përpara kërcënimeve të imperializmit botëror, të kryesuar nga imperializmi amerikan, për luftë atomike, ne duhet të jemi plotësisht të pregatitur si ekonomikisht, politikisht, moralisht, ashtu edhe ushtarakisht, për t'i bërë ballë çdo eventualiteti.

Luftën botërore ne duhet ta shmangim, ajo nuk është fatalisht e pashmangshme, por askush nuk do të na falë kurrë në rast se rrojmë me ëndrra dhe armiku

na gjen në befasi, sepse s'ka ndodhur kurrë që armiku të jetë ose të quhet *loyal*¹, ndryshe s'do të quhej armik. Armiku është dhe qëndron armik dhe i pabesë. Kush i zë besë armikut, ai e humb shpejt ose vonë davanë...

Politika paqësore e vendeve të kampit të socializmit ka ndikuar shumë në demaskimin e qëllimeve agresive të imperializmit, në mobilizimin e popujve kundër luftënxitësve, në zhvillimin e luftës së tyre të lavdishme kundër shtypësve imperialistë dhe veglave të tyre...

Por, megjithëkëtë, shumë probleme konkrete, të cilat janë shtruar në tavolinë, si propozimet për çarmatimin, konferenca e nivelit të lartë² etj. nuk janë zgjidhur dhe po sabotohen sistematikisht nga imperialistët amerikanë.

Ç'konkluzione duhet të nxjerrim nga këto? Partia e Punës e Shqipërisë mendon se imperializmi, dhe në radhë të parë imperializmi amerikan, s'e ka ndërruar lëkurën, as qimen, as natyrën. Ai është agresiv, ai do të jetë agresiv, sikur edhe një dhëmb t'i mbetet në gojë. Dhe duke qenë agresiv, ai mund ta hedhë botën në luftë. Prandaj ne, ashtu siç theksuam edhe në komisionin redaktues, vazhdojmë të ngulim këmbë se duhet t'u

¹ *Loyal* — shpirtgjerë.

² Në dhjetor të vitit 1959, ish-kryetari i qeverisë sovjetike N. Hrushov, i cili ishte për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme ndërkombëtare vetëm nëpërmjet bisedimeve me krerët e imperializmit, siguroi, nëpërmjet kanaleve diplomatike, thirrjen e një konference të nivelit të lartë me pjesëmarrjen e kryetarëve të BRSS, të SHIBA-së, të Anglisë dhe të Francës. Kjo konferencë do të mbahej në maj të vitit 1960, por nuk mundi të zhvillonte punimet për shkak të sabotimit nga ana e imperialistëve amerikanë dhe të qëndrimit të lëkundshëm prej aventurieri të N. Hrushovit.

böhet e qartë popujve se garanci absolute që nuk do të ketë luftë botërore, mund të kemi vetëm pasi të ketë triumfuar socializmi në të gjithë botën, ose në pjesën më të madhe të vendeve të botës. Hapur flasin amerikanët, ata s'pranojnë çarmatim, përkundrazi po i shtojnë armatimet, ata përgatitin luftën, prandaj duhet të jemi vigjilentë.

Armikut s'duhet t'i bëjmë asnjë lëshim parimor, të mos krijojmë asnjë iluzion për imperializmin, pse duke menduar se i vëmë vetulla, mund t'i nxjerrim sytë çështjes. Armiku jo vetëm po armatohet dhe po përgatit luftën kundër nesh, por zhvillon edhe një propagandë të shfrenuar për të helmatisur shpirtërat, për t'i hutuar njerëzit. Ai harxhon me miliona dollarë për të blerë agjentë dhe spiunë, harxhon me miliona dollarë për të organizuar në vendet tona akte spiunazhi, diversioni dhe atentate. Imperializmi amerikan u ka dhënë dhe po u jep miliarda dollarë agjentëve të tij besnikë, bandës tradhtarë të Titos. Të gjitha këto ai i bën që të dobësojë frontin tonë të brendshëm, të na përçajë ne, të dobësojë dhe të çorganizojë prapavijat tona.

Shumë diskutohet rreth çështjes së bashkekzistencës paqësore, bile disa afirmojnë edhe absurditete të atilla, sikur Kina Popullore dhe Shqipëria qenkan kundër bashkekzistencës paqësore. Më duket se duhen hedhur poshtë një herë e mirë pikëpamje të tilla të dëmshme dhe të gabuara. Nuk mund të ketë shtet socialist, nuk mund të ketë komunist që të jetë kundër bashkekzistencës paqësore, që të jetë luftëdashës. Lenini i madh ka shtruar i pari parimin e bashkekzistencës paqësore të shteteve me rende shoqërore të ndryshme si një do-

mosdoshmëri objektive, derisa në botë krahas njëri-tjetrit ekzistojnë si shtetet socialiste, ashtu edhe ato kapitaliste. Partia jonë e Punës, duke i qëndruar besnike këtij parimi të madh të Leninit, gjithnjë ka menduar dhe mendon se politika e bashkekzistencës paqësore u përgjigjet interesave rrënjësore të të gjithë popujve, i përgjigjet qëllimit të forcimit të mëtejshëm të pozitave të socializmit, prandaj këtë parim të Leninit ajo e ka në bazë të politikës së jashtme të shtetit tonë popullor. Bashkekzistenca paqësore midis dy sistemeve të kundërta nuk do të thotë, siç pretendojnë revizionistët modernë, se duhet hequr dorë nga lufta e klasave. Përkundrazi, lufta e klasave duhet të vazhdojë, lufta politike dhe ideologjike kundër imperializmit, kundër ideologjisë borgjeze dhe asaj revizioniste duhet të forcohet gjithnjë e më shumë. Duke luftuar me konsekuencë për vendosjen e bashkekzistencës paqësore leniniste, duke mos i lëshuar aspak në parimet imperializmit, duhet të zhvillohet më tej lufta e klasave në vendet kapitaliste, si edhe lëvizja nacionalçlirimtare e popujve të vendeve koloniale dhe të varura.

Sipas pikëpamjes sonë, partitë komuniste dhe punëtores të vendeve kapitaliste duhet të luftojnë që të vendoset bashkekzistenca paqësore në mes të vendit të tyre, që është akoma me sistem kapitalist dhe vendeve tona socialiste... Por detyra e tyre s'mbaron me kaq. Në këto vende duhet të zhvillohet, të rritet, të forcohet lufta e klasave, dhe masat punonjëse, të udhëhequra nga proletariati vendës me partinë komuniste në krye dhe në aleancë me të gjithë proletariatin botëror, t'ia bëjnë jetën të pamundur imperializmit, t'i dërrmojnë

atij bazat e luftës dhe të ekonomisë, t'i rrëmbejnë atij nga duart forcën ekonomike dhe politike dhe të shkojnë drejt shkatërrimit të pushtetit të tij të vjetër dhe të vendosin pushtetin e ri të popullit. Këtë do ta bëjnë me dhunë apo me rrugën paqësore e parlamentare?

Kjo çështje ka qenë e qartë, kot na e ngatërroi shoku Hrushov në Kongresin XX dhe e ngatërroi në atë drejtim që u pëlqeu në fakt oportunistëve. Përse duhej t'u bëheshin gjithë këto parodi tezave të qarta të Leninit dhe të Revolucionit Socialist të Tetorit? Partia e Punës e Shqipërisë e ka pasur të qartë dhe nuk lëviz nga mësimet e Leninit në këtë çështje. Deri tani asnjë popull, asnjë proletariat dhe asnjë parti komuniste ose punëtore s'e ka marrë pushtetin pa gjak dhe pa dhunë.

Është e padrejtë kur disa shokë pretendojnë se ata e kanë marrë pushtetin pa gjak; ata harrojnë që për ta ka derdhur gjakun si lumë Ushtria e lavdishme Sovjetike në Luftën e Dytë Botërore.

Partia jonë mendon për këtë çështje se duhet të përgatitemi për të dyja rrugët dhe të përgatitemi mirë, sidomos për marrjen e pushtetit me anën e dhunës, pse, po të përgatitemi mirë nga kjo anë, edhe mundësia e parë ka më tepër shans të ketë sukses. Borgjezia mund të të lërë të psallësh, pastaj të fut një grusht fashist në kokë dhe të dërrmon, pse s'ke përgatitur as kuadrot e sulmit, as punën në ilegalitet, as vendet ku të ruhesh dhe të punosh, as mjetet me se të luftosh. Këtij eventualiteti tragjik duhet t'i dalim përpara.

Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë, është, do të jetë dhe do të luftojë në rrugën marksiste-leniniste dhe në bazë të Deklaratës së Moskës për paqen, për bashk-

ekzistencën paqësore, ashtu sikurse na mëson Lenini. Ajo ka qenë, është dhe do të jetë e do të luftojë në mënyrë aktive për çarmatimin e përgjithshëm. Në asnjë rast dhe për asnjë çast Partia e Punës e Shqipërisë nuk do të pushojë t'u bëjë një luftë politike dhe ideologjike veprimeve të imperializmit dhe të kapitalistëve si dhe ideologjisë borgjeze, nuk do të pushojë t'i bëjë një luftë të ashpër, të pandërprerë dhe pa asnjë kompromis revizionizmit modern dhe në veçanti revizionizmit titist jugosllav. Mund të ketë shokë që të na akuzojnë ne, shqiptarët, për kokëfortë, për piper të kuq, për gjaknxehë, për sektarë, për dogmatikë e për çfarë të duash, por ne i hedhim poshtë të gjitha këto akuza false dhe u themi këtyre se ne s'lëvizim nga këto pozita, se janë marksiste-leniniste.

Thuhet se ne duam luftën dhe jemi kundër bashkëzistencës. Bile shoku Kozllov neve, shqiptarëve, na ka vënë këtë alternativë: ose bashkëzistencë, siç e kupton këtë ai, ose një bombë atomike nga imperialistët, e cila do ta bëjë hi Shqipërinë dhe asnjë shqiptar s'do të mbetet i gjallë. Një kërcënim të tillë atomik asnjë përfaqësues i imperializmit amerikan nuk ia ka bërë deri tani popullit shqiptar. Por ja që atë ia bën një anëtar i Presidiumit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Dhe kujt ia bën? Një popull të vogël, heroik, që në shekuj ka luftuar me armiq të egër dhe të panumërt dhe që kurrë s'është përkulur, një popull të vogël, që luftoi me heroizëm të pashoq kundër hitlerianëve dhe fashistëve italianë, ia thotë një partie që i qëndron besnike konsekuente deri në fund marksizëm-leninizmit. Por, shoku Froll Kozllov, ti ke

gabuar adresë, ti nuk na frikëson dot ne, që t'i përulemi vullnetit tënd të gabuar dhe ne s'e ngatërrojmë kurrë Partinë e lavdishme të Leninit me ju, që silleni kaq keq dhe kaq paturpësisht me popullin shqiptar dhe me Partinë e Punës të Shqipërisë. Partia e Punës e Shqipërisë do të luftojë dhe do t'i mbështetë të gjitha propozimet e drejta dhe paqësore të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera të kampit të socializmit, si dhe të vendeve të tjera paqedashëse.

Partia e Punës e Shqipërisë do të vërë të gjitha forcat, do t'i përdorë të gjitha të drejtat dhe do t'i kryejë të gjitha detyrat e saj për forcimin e unitetit të kampit të socializmit, të një uniteti marksist-leninist. Është absurde të mendohet që Shqipëria e vogël socialiste kërkon të shkëputet dhe të rrojë jashtë kampit të socializmit, jashtë vëllazërisë së popujve tanë socialistë. Qenien në gjirin e kampit të socializmit s'ia ka falur njeri Shqipërisë, por atë e kanë vendosur vetë populli ynë dhe Partia e Punës e Shqipërisë me gjak, me punë, me sakrifica, me djersë, me sistemin e qeverimit që kanë vendosur dhe me rrugën marksiste-leniniste që ndjekim. Por askujt gjithashtu të mos i shkojë ndër mend se, meqë Shqipëria është e vogël, meqë Partia e Punës e Shqipërisë është e vogël, duhet të bëjë ashtu si thotë ndokush, kur ajo është e bindur se ai ndokushi gabohet.

Sikundër u shpreha edhe më lart, Partia e Punës e Shqipërisë mendon se kampi ynë i socializmit, që ka një qëllim, që udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi, duhet të ketë edhe strategjinë e taktikën e vet dhe këto të përpunohen së bashku nga partitë dhe nga shtetet tona të kampit të socializmit. Në gjirin e kampit tonë ne ke-

mi krijuar disa forma organizimi pune, por është e drejtë të themi se këto kanë mbetur disi formale ose, më mirë me thënë, nuk funksionojnë në nënnyrë kolegjiale, si për shembull organet e Traktatit të Varshavës dhe Këshilli i Ndhmës Ekonomike Reciproke. Të kuptohemi. Këtu s'e kemi çështjen të pyetemi ose jo edhe ne. Natyrisht, asnjëri nuk na e mohon të drejtën të pyetemi, por duhet të mbliidhemi që të pyetemi. Çështjen e ngremë në parim dhe themi se këto forma organizimi duhet të funksionojnë rregullisht, atje të shtrohen problemet, të merren vendime dhe të kontrollohet zbatimi i këtyre vendimeve.

Zhvillimi dhe fuqizimi i mëtejshëm i ekonomisë së vendeve të socializmit kanë qenë dhe janë kurdoherë në planin e parë të partive dhe të qeverive tona dhe përbëjnë një nga faktorët vendimtarë të forcës së pamposhtur të kampit të socializmit.

Ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit po ecën me hapa të vrullshëm në vendet tona. Kjo u detyrohet përpjekjeve të mëdha të popujve tanë dhe ndihmës që i jepet shoku-shokut.

Republika Popullore e Shqipërisë s'i ka dhënë ndihmë ekonomike njeriu deri tani, e para, se jemi të varfër dhe, e dyta, se s'ka njeri nevojë për ndihmën tonë ekonomike. Por brenda normave të drejta ne kemi bërë dhe bëjmë të gjitha përpjekjet që me eksportin tonë të ndihmojmë, sado pak, vendet miq dhe vëllezër. Ne jemi ndihmuar nga miqtë tanë dhe në radhë të parë nga Bashkimi Sovjetik...

Këtë ndihmë të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera të demokracisë popullore, Partia e Punës e

Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë e kanë shfrytëzuar sa më mirë në interes të popullit. Për këtë ndihmë populli ynë u është përjetë mirënjohës popujve sovjetikë dhe popujve të vendeve të demokracisë popullore. Ne këtë ndihmë e kemi kuptuar, e kuptojmë dhe do ta kuptojmë jo sikur na është dhënë si lëmoshë, por si ndihmë vëllazërore, si ndihmë internacionaliste.

Populli ynë, si një popull që ka qenë i varfër në kulm, si një popull që luftoi me heroizëm, si një popull që u vra e u dogj, e kishte për detyrë t'u kërkonte ndihmë miqve dhe vëllezërve më të mëdhenj e më të pasur ekonomikisht se ai. Edhe miqtë e kishin dhe e kanë për detyrë internacionaliste ta japin këtë ndihmë. Prandaj duhet hedhur poshtë çdo pikëpamje e errët dhe antimarksiste që mund të shfaqet në lidhje me karakterin dhe me qëllimin e kësaj ndihme nga ndokush. Presionet ekonomike mbi Partinë e Punës të Shqipërisë, mbi Qeverinë Shqiptare dhe mbi popullin tonë s'do të kenë kurrë sukses.

Unë dëshiroj të shtroj këtu çështjen që ndihmat nga vendet ekonomikisht më të forta për vendet më të dobëta ekonomikisht, sikurse është rasti i vendit tonë, duhet të jenë më të mëdha. Populli shqiptar nuk mendon aspak që të lidhë duart dhe të hapë gojën ta ushqejnë të tjerët. Ky s'është zakoni i tij. Populli ynë, gjithashtu, nuk ka ato pretendime që niveli i jetesës në vendin tonë të ngrihet menjëherë në nivelin e jetesës së shumë prej vendeve të demokracisë popullore, por një ndihmë më e madhe duhet t'i jepet vendit tonë për zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhuese. Ne men-

dojmë se vendet ekonomikisht të forta të kampit të socializmit duhet t'u japin kredi edhe vendeve kapitaliste asnjëse, edhe popujve të porsaçliruar nga kolonializmi, kur udhëheqjet e këtyre vendeve kapitaliste janë kundër imperializmit, mbështetin politikën paqësore të kampit të socializmit dhe nuk pengojnë e nuk kundërshtojnë luftën legjitime të forcave revolucionare, por në radhë të parë duhet të shikohen më me kujdes dhe të plotësohen nevojat e vendeve të kampit të socializmit. Sigurisht ka nevojë India për hekur dhe për çelik, por ka nevojë më shumë dhe më përpara Shqipëria socialiste, ka nevojë për ujitje dhe për energji elektrike Egjipti, por ka nevojë më shumë dhe më përpara Shqipëria socialiste.

Në shumë probleme politike të dorës së parë kampi ynë i socializmit ka pasur dhe ka pikëpamje të njëjta. Por, duke mos i bërë në rregull konsultimet kolegjiale, mjaft herë është vënë re, se shtete të kampit tonë të socializmit marrin inisiativa politike (në parim ne s'jemi kundër marrjes së inisiativave), të cilat shumë herë prekin edhe shtete të tjera të kampit të socializmit. Disa nga këto inisiativa nuk janë të drejta dhe kjo ndodh, sidomos, kur këto nuk merren në formë kolegjiale nga pjesëtarët e Traktatit të Varshavës.

E tillë është inisiativa e qeverisë bullgare, e cila i njoftoi qeverisë greke, pa e përfillur aspak Shqipërinë, se vendet e demokracisë popullore të Ballkanit pranojnë të çarmatosen në rast se vepron të kështu edhe qeveria greke. Kjo inisiativë ka qenë e gabuar për pikëpamjen tonë, sepse, edhe sikur ta pranonte Greqia një propozim të tillë, atë nuk do ta pranonte Qeveria Shqiptare.

Shqipëria është dakord me propozimin sovjetik që bëri Nikita Hrushovi në muajin maj 1959¹, por jo me propozimin bullgar që dëshiron të çarmatosë vendet e Ballkanit, duke lënë pa prekur Italinë. Apo harruan shokët bullgarë se Italia borgjeze dhe fashiste e ka sulmuar disa herë gjatë këtij shekulli Shqipërinë?

A mund t'u lejohet shokëve bullgarë rasti tjetër, që, duke mos u konsultuar aspak me Qeverinë Shqiptare, me të cilën ata janë të lidhur me një traktat mbrojtjeje, t'i propozojnë qeverisë greke një traktat miqësic dhe mossulmimi, në një kohë kur Greqia mban me Shqipërinë gjendjen e luftës dhe ka pretendime territoriale mbi atdheun tonë? Të tilla veprime neve na duket se janë të rrezikshme të merren në mënyrë të njëanshme.

Nga këto kundërshtime të drejta dhe legjitime tonat mundet që shokët bullgarë të kenë arritur në konkluzionet se gjoja ne shqiptarët nuk kuptojmë mirë bashkekzistencën, duam luftën etj. Këto pikëpamje janë të gabuara.

Veprime të tilla janë shfaqur gjithashtu nga shokët polakë në Kombet e Bashkuara, ku shoku Gomulka deklaroi në mënyrë të njëanshme përpara Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara se Polonia propozon «të ruhet statukuoja aktuale e vendosjes së forcave ushtarake në botë dhe konkretisht të mos kri-

¹ Me anën e këtij propozimi dhe të notave që qeveria sovjetike u dërgoi më 25 maj 1959 qeverive të Shqipërisë, Bullgarisë, Rumanisë, Jugosllavisë, Turqisë, Greqisë, Italisë, Francës, Anglisë dhe SHBA-së kërkohej që të krijohet në Ballkan dhe në rajonin e Adriatikut një zonë pa armë bërthamore dhe pa raketa.

johen më baza ushtarake, po të qëndrojnë këto që janë, të mos vihen më raketa, por të qëndrojnë këto që janë, të ruajnë sekretin e bombës atomike ato shtete që e kanë dhe të mos ua japin atë shteteve të tjera». Një propozim i tillë, sipas mendimit tonë, është në kundërshtim me interesat e kampit tonë. Të mos vihen më raketa, po kush e ku? Të gjithë anëtarët e NATOS-s, duke përfshirë edhe Italinë, Gjermaninë Perëndimore e Greqinë, janë pajisur me raketa. Të mos i jepet sekretin e bombës atomike, kujt? Atë e ka Anglia, e ka Franca e ka edhe Gjermania Perëndimore. Është e qartë se një propozim i tillë do të na detyrojë ne, vendet e demokracisë popullore, të mos vendosim raketa, ose ndonjë vend tjetër i kampit socialist, veç Bashkimit Sovjetik, të mos e ketë bombën atomike.

Ne shtrojmë çështjen, përse Kina komuniste të mos e ketë bombën atomike? Ne mendojmë se ajo duhet ta ketë dhe, kur edhe Kina t'i ketë bombën dhe raketat, atëherë do të shohim se me çfarë gjuhe do të flasë imperializmi amerikan, do të shohim se a do të vazhdohet t'i mohohen të drejtat Kinës në arenën ndërkombëtare, do të shohim se a do të guxojnë imperialistët amerikanë të vringëllojnë armët siç bëjnë sot.

Pse, duke e pasur bombën dhe duke e hedhur bombën do t'i fitojë këto të drejta Kina mbi Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mund të na pyesë ndokush? Jo, Kina, nuk e hedh bombën kurrë, në rast se nuk sulmohemi nga ata që e kanë në gjak agresionin dhe luftën. Po të mos e kishte Bashkimi Sovjetik bombën, imperializmi do të fjalosej ndryshe me të. Me bomba ne kurrë nuk do të sulmojmë, ne jemi kundër luftës, ne

jemi gati t'i shkatërrojmë ato, por bombën në duhet ta kemi për t'u mbrojtur. Frika i ruan vreshtat, thotë populli ynë. Imperialistët duhet të na e kenë frikën dhe, bile, të na e kenë shumë.

Partia e Punës e Shqipërisë, e mbështetur në marksizëm-leninizmin dhe në Deklaratën e në Manifestin e Paqes të Moskës, në çështjet e politikës ndërkombëtare dhe në problemet e rëndësishme të ndërtimit të socializmit ka ndjekur një vijë të drejtë marksiste-leniniste. Në marrëdhëniet ndërkombëtare vija e Partisë sonë ka qenë në përputhje me politikën e kampit të socializmit...

Problemet e mëdha të kohës e kanë preokupuar edhe Partinë e Punës të Shqipërisë, edhe popullin tonë të vogël. Republika jonë Popullore ka qenë dhe është e rrethuar gjeografikisht nga shtete kapitaliste dhe nga revizionistët jugosllavë; neve na është dashur të jemi shumë vigjilentë, të gozhdojmë njerëz dhe fonde të konsiderueshme për mbrojtjen e kufijve tanë, për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së atdheut nga tentativat e panumërta të imperialistëve dhe të satelitëve, shërbëtorë të tyre.

Ne jemi një vend i vogël dhe një popull i vogël, që kemi vuajtur jashtëzakonisht shumë, por që kemi luftuar gjithashtu shumë. Lirinë që kemi sot s'na e ka falur kurrkush, por e kemi fituar me gjak. I kemi njohur dhe vazhdojmë t'i njohim çdo ditë armiqtë imperialistë, manovrat e tyre kundër kampit të socializmit dhe kundër vendit tonë në veçanti, prandaj asnjë iluzion s'kemi pasur dhe as do të kemi se ata do të ndërrojnë natyrën dhe qëllimet kundër popujve, kundër kampit tonë dhe kundër Shqipërisë socialiste në veçanti...

Imperialistët amerikanë dhe anglezë na kanë akuzuar dhe na akuzojnë ne, shqiptarët, për «të egër dhe luftëdashës». Kjo është e kuptueshme, pse populli shqiptar u ka rënë duarve dhe turinjve tentativave të tyre të shumta për të na robëruar dhe u ka prerë kokën agjentëve të tyre, që komplotonin kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe regjimit tonë të demokracisë popullore...

As është e rastit, na duket neve, të vërtetojmë këtu, në këtë mbledhje, që lufta është e huaj për vendet socialiste, për partitë tona marksiste-leniniste, por çështja qëndron në atë: pse imperialistët dhe agjentët e tyre akuzojnë Kinën dhe Shqipërinë për luftëdashëse dhe kundër bashkekzistencës paqësore?

Të marrim çështjen e Shqipërisë. Kundër kujt do të bëjë luftë Shqipëria dhe përse? Do të jetë qesharake të rrimë dhe t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje. Por atyre që na akuzojnë ne për këtë, u duhet të mbulojnë qëllimet e tyre agresive ndaj Shqipërisë.

Rankoviçi dëshiron që ne t'i bëjmë kufijtë tanë han me dy porta, ku të hyjnë e të dalin «pa vizë» agjentë dhe armë jugosllave, italiane dhe greke, për të na sjellë «kulturën e tyre të thikës në dhëmbë», për të realizuar Titoja ëndrrën e tij që Shqipëria të bëhet republikë e shtatë e Jugosllavisë, ose borgjezia reaksionare italiane të vërë në zbatim për të tretën herë qëllimet e saj grabitqare kundër Shqipërisë, ose monarko-fashistët grekë të realizojnë ëndrrën e tyre të çmendur për grabitjen e Shqipërisë së Jugut. Pse ne s'i kemi lejuar dhe s'do t'i lejojmë kurrë këta, prandaj jemi «luftënxitës»? Ata e dinë fare mirë që në rast se i prekin

kufijtë tanë, atëherë do të kenë luftë me ne dhe me gjithë kampin e socializmit.

Qëllimi i tyre, pra, ka qenë dhe është të na izolojnë nga kampi dhe nga miqtë, të na akuzojnë si «luftënxitës dhe të egër», pse ne nuk u hapim kufijtë tanë të livadhisin lirisht, të na akuzojnë që ne s'jemi për bashkekzistencën. Por, për ironi të fatit, ka shokë që e besojnë këtë lodër të revizionistëve dhe këto shpifje kundër Partisë së Punës të Shqipërisë. Natyrisht, ne jemi kundër një bashkekzistence të atillë, për hir të së cilës ne, shqiptarët, duhet t'i bëjmë koncesione territoriale dhe politike Sofokli Venizellosit. Jo, ato kohëra, kur tokat e Shqipërisë bëheshin monedhë tregu, kanë vdekur përgjithmonë. Ne jemi kundër një bashkekzistence të atillë me shtetin jugosllav, që vë si konditë shuarjen e luftës ideologjike e politike kundër revizionistëve jugosllavë, këtyre agjentëve të imperializmit ndërkombëtar, këtyre tradhtarëve të marksizëm-leninizmit. Ne jemi kundër një bashkekzistence të atillë me anglezët apo amerikanët, për hir të së cilës ne duhet t'u njohim, siç kërkojnë, koncesionet e vjetra politike, diplomatike e tregtare që u kishte akorduar atyre regjimi i mbretit Zog.

Si konkluzion i përgjithshëm, Partia e Punës e Shqipërisë është plotësisht e bindur se çështja jonë e madhe, ajo e fitores së socializmit dhe të paqes do të triumfojë. Forcat e bashkuara të kampit socialist, me Bashkimin Sovjetik në krye, të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe të të gjithë njerëzve e popujve paqedashës me aksione të vendosura kanë mundësi të detyrojnë imperialistët për të pranuar bashk-

ekzistencën paqësore e të shmangin luftën botërore. Por, në të njëjtën kohë ne do të forcojmë gjithnjë e më shumë vigjilencën revolucionare, me qëllim që asnjëherë armiqtë të mos na kapin në befasi. Ne jemi të bindur se fitorja në këtë luftë fisnike për paqen në botë dhe për triumfin e socializmit do të jetë jona. Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë, ashtu si deri tani, nuk do të kursejnë asgjë për të ndihmuar me të gjitha forcat e veta triumfin e çështjes sonë të përbashkët. Ne, si gjithnjë, do të ecim përpara në unitet të çeliktë me të gjithë kampin socialist, me Bashkimin Sovjetik, me të gjithë lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Të dashur shokë,

Uniteti i lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare është faktori vendimtar për realizimin e qëllimeve fisnike të triumfit të paqes, të demokracisë, të pavarësisë kombëtare dhe të socializmit. Kjo çështje theksohet në mënyrë të posaçme si në Deklaratën e Moskës të vitit 1957, ashtu edhe në projektdeklaratën që është përgatitur për mbledhjen tonë. Në Deklaratën e vitit 1957 theksohet: «partitë komuniste e punëtore mbajnë një përgjegjësi historike veçanërisht serioze për fatet e sistemit socialist botëror dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Partitë komuniste e punëtore, që marrin pjesë në mbledhje, deklarojnë se ato do të forcojnë pa u lodhur unitetin e tyre dhe bashkëpunimin shoqëror, në interes të bashkimit të mëtejshëm të familjes së shteteve socialiste, në interes të lëvizjes

punëtore ndërkombëtare, të çështjes së pages dhe të socializmit»¹.

Duhet thënë se, veçanërisht kohët e fundit, në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe në marrëdhëniet midis disa partive kanë lindur mosmarrëveshje të thella ideologjike e politike, thellimi i të cilave mund t'i sjellë vetëm dëm çështjes sonë të madhe. Prandaj Partia e Punës e Shqipërisë mendon se, që të shkojmë përpara, të bashkuar, drejt fitoresh të reja, duhet të dënojmë gabimet dhe shfaqjet negative që janë vënë re deri tani dhe t'i ndreqim ato.

Këtu ne duam të ndalemi në çështjen e Mbledhjes së Bukureshtit, në të cilën Partia jonë, siç dihet, nuk shfaqi mendimin e saj përse u përket mosmarrëveshjeve që kanë lindur midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, por rezervoi qysh atëherë të drejtën ta bëjë një gjë të tillë në këtë mbledhje të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore. Atëherë Partia e Punës e Shqipërisë u akuzua nga shokët sovjetikë dhe nga disa shokë të partive të tjera motra për çdo gjë që mund të imagjinohet, por askujt nuk i shkoi ndër mend që të mendonte për një çast përse kjo Parti mbajti një qëndrim të tillë kundër të gjithë korentit, pse kjo Parti, që ka qëndruar deri në fund besnike e marksizëm-leninizmit dhe e Deklaratës së Moskës, akuzohet papritur se gjoja është «kundër marksizëm-leninizmit dhe Deklaratës së Moskës», pse kjo Parti, e lidhur kaq ngushtë me Bashkimin Sovje-

¹ Deklaratë e Mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste. Tiranë, 1958, f. 24.

tik dhe me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, përnjëherë del në kundërshtim me udhëheqjen e Bashkimit Sovjetik.

Tani që të gjithë shokët kanë në duar si materialin informativ sovjetik, ashtu edhe materialin e Partisë Komuniste të Kinës, le të reflektojnë vetë. Ne kemi lexuar e kemi studjuar si materialin sovjetik, ashtu edhe atë kinez, i kemi diskutuar me aktivin e Partisë me kujdes këto dokumente dhe vijmë kështu në këtë mbledhje me pikëpamje unanime të të gjithë Partisë.

Siç dihet, më 24 qershor të këtij viti, me rastin e Kongresit III të Partisë Punëtore të Rumanisë, pa pritur dhe pa pasur asnjë paralajmërim paraprak, të paktën përsa i përket Partisë sonë, me inisiativën e shokëve të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik u organizua Mbledhja e Bukureshtit. Në vend që ajo, sipas marrëveshjes së arritur me letrat e datave 2 e 7 qershor¹, «të shkëmbente mendime» dhe të caktonte datën e kësaj mbledhjeje që mbajmë sot, u muar me një çështje tjetër, me akuzën ideologjike e politike drej-

¹ Më 2 qershor 1960 KQ i PK të BS me anën e një letre propozonte që në fund të muajit qershor të bëhej një mbledhje e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të kampit socialist «për këmbimin e mendimeve mbi çështjet e gjendjes së sotme ndërkombëtare dhe për përcaktimin e vijës sonë të mëtejshme të përbashkët». Ndërsa më 7 qershor 1960 KQ i PK të BS me një letër tjetër shprehte mendimin që mbledhja të mos mbahej në qershor, kurse data e mbledhjes të caktohej në një takim paraprak që do të bënin përfaqësuesit e partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste në Bukuresht, gjatë kohës që do të zhvillonte punimet Kongresi III i Partisë Punëtore të Rumanisë.

tuar kundër Partisë Komuniste të Kinës, në bazë të materialit «informativ sovjetik». Mbi këtë material, krejtësisht të panjohur deri disa orë përpara mbledhjes duhej të prononcoheshin në favor të pikëpamjeve të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik delegatët e partive komuniste dhe punëtorë motra që ndodheshin në Bukuresht për çështje tjetër dhe që s'kishin (të paktën delegacioni i Partisë sonë) asnjë mandat nga partitë e tyre për të diskutuar, pa le për të vendosur për një çështje kaq të rëndësishme të komunizmit ndërkombëtar. As mund të mendohej për një diskutim serioz të këtij materiali që mbante akuza kaq të mëdha kundër një partie tjetër marksiste-leniniste, kur nuk u lejohej delegatëve dhe sidomos udhëheqjeve të partive komuniste dhe punëtorë ta studjonin atë nga të gjitha anët dhe t'i lihej koha e duhur palës së akuzuar të parashtronte edhe ajo me kohë dhe në të gjitha format që përdor edhe pala akuzuese, pikëpamjet e saj. Fakti është se udhëheqja sovjetike kishte vetëm si preokupim dominues të kalonin me shpejtësi akuzat e saj kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe të dënohej me çdo kusht Partia Komuniste e Kinës.

Ky ishte preokupimi i shokut Hrushov dhe i shokëve të tjerë sovjetikë në Bukuresht dhe aspak çështjet e politikës ndërkombëtare që preokuponin kampin tonë dhe të gjithë botën në tërësi, të krijuara pas dështimit të konferencës së nivelit të lartë në Paris.

Partia jonë do të ishte plotësisht dakord me një konferencë ndërkombëtare të partive komuniste e punëtorë, do të ishte dakord edhe me çfarëdo konference tjetër, me çfarëdo rend-dite që mund të caktohej, por

me kusht që këto konferenca të ishin të rregullta, të kishin aprovimin e të gjitha partive, të përcaktohej qartë dhe më parë rendi i ditës, t'u jepej partive komuniste dhe punëtorë materiali i nevojshëm dhe t'u lihej kohë e përshtatshme për të studjuar materialet, për t'u përgatitur dhe për të marrë byrotë politike të partive, në qoftë se e lypte nevoja, edhe aprovimin e plenumeve të komiteteve qendrore për vendimet që eventualisht mund të merreshin në këto konferenca. Konferencat duhet të zhvillohen, pra, brenda normave leniniste që rregullojnë marrëdhëniet në mes partive komuniste dhe punëtorë, duhet të zhvillohen në barazi të plotë në mes partive, në frymën shoqërore komuniste, internacionaliste dhe me moral të lartë komunist.

Mbledhja e Bukureshtit nuk u përgjigjej këtyre normave, prandaj Partia jonë, megjithëse mori pjesë në të, e dënoi dhe e dënon si të parregullt këtë mbledhje, në të cilën u thyen normat leniniste.

Ne mendojmë se Mbledhja e Bukureshtit i shërbeu shumë keq çështjes së lëvizjes komuniste ndërkombëtare, çështjes së solidaritetit ndërkombëtar të punonjësve, çështjes së forcimit të unitetit të kampit të socializmit, çështjes së shembullit marksist-leninist të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ideologjike, politike dhe organizative, që mund të ngjasin në gjirin e partive komuniste dhe punëtorë dhe që dëmtojnë marksizëm-leninizmin. Faji për këtë u bie shokëve të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që e organizuan këtë mbledhje, që e konceptuan në këto forma dhe që zbatuan këto norma jomarksiste për këtë çështje.

Qëllimi ka qenë të dënohej Partia Komuniste e

Kinës nga lëvizja komuniste ndërkombëtare për gabime dhe faje të paqena dhe pa baza. Kjo është bindja e plotë e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në bazë të studimit të fakteve, në bazë të materialit sovjetik dhe të atij kinez, që Partia e Punës e Shqipërisë disponon tani, në bazë të një analize të hollësishme që Partia e Punës e Shqipërisë u ka bërë zhvillimit të situatës ndërkombëtare dhe qëndrimeve zyrtare të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Komuniste të Kinës.

E gjithë Partia e Punës e Shqipërisë mendon njëzëri se shokët sovjetikë kanë gabuar rëndë në Bukuresht, ata kanë dënuar padrejtësisht Partinë Komuniste të Kinës se gjoja ajo ka devijuar nga marksizëm-leninizmi, se gjoja ka shkelur dhe ka braktisur Deklaratën e Moskës të vitit 1957, ata e kanë akuzuar Partinë Komuniste të Kinës si «dogmatike», «sektare», se është «për luftën», se është «kundër bashkekzistencës paqësore», se «do vend të privilegjuar në kamp dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare» etj.

Shokët sovjetikë kanë gabuar rëndë gjithashtu edhe në drejtimin që, duke përfutur nga dashuria dhe besimi i madh që kanë komunistët për Bashkimin Sovjetik dhe për Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, u përpoqën t'ua impononin edhe partive të tjera komuniste dhe punëtorë pikëpamjet e tyre jo të drejta ndaj Partisë Komuniste të Kinës.

Për Partinë e Punës të Shqipërisë ka qenë e qartë që në momentet e para, që kur filloi përpunimi i ethshëm dhe i palejueshëm nga ana e shokëve sovjetikë ndaj shokëve të delegacionit tonë në Bukuresht, se

shokët sovjetikë dëshironin me argumentime të pabaza e me presion ta tërhiqnin delegacionin e Partisë së Punës të Shqipërisë në kurthin që përgatitnin, ta radhitnin atë në pikëpamjet e shtrembra të shokëve sovjetikë.

Rëndësi për shokun Hrushov ka pasur fakti (edhe këtë shoku Andropov ia tha shokut Hysni Kapo) «nëse do të radhiteshim në anën sovjetike apo jo». Këtë mendim shoku Hrushov e shfaqti edhe në forma të tjera, në ndërhyrjet që bëri kundër Partisë sonë në Mbledhjen e Bukureshtit. Këtë e vërtetuan edhe shumë qëndrime të padrejta dhe jomiqësore të udhëheqjes sovjetike dhe të njerëzve të ambasadës sovjetike në Tiranë, pas Mbledhjes së Bukureshtit, për të cilat do të flas më vonë. Për shokët udhëheqës sovjetikë nuk kishte asnjë rëndësi pikëpamja e një partië marksiste-leniniste, siç ishte Partia jonë, por rëndësi kishte që ajo të mbante po atë qëndrim që mbajti Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në Bukuresht.

Asnjë paralajmërim nuk i është bërë Partisë së Punës të Shqipërisë nga ana e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që organizoi Mbledhjen e Bukureshtit, se me rastin e Kongresit të Partisë Punëtore të Rumanisë do të ngriheshin akuza kundër Partisë Komuniste të Kinës për gjoja gabime të rënda në vijë. Kjo gjë i erdhi në mënyrë krejt të papritur Partisë së Punës të Shqipërisë. Kurse tani ne po marrim vesh se partitë e tjera të kampit, me përjashtim të Partisë së Punës të Shqipërisë, Partisë Komuniste të Kinës, Partisë së Punës të Koresë, Partisë së Punonjësve të

Vietnamit, ishin në dijeni se në Bukuresht do të organizohej mbledhja për të akuzuar Kinën. Në qoftë se ka ndodhur kështu, atëherë është fare e qartë se çështja bëhet shumë më serioze dhe merr formën e një fraksioni me karakter ndërkombëtar.

Por, megjithatë, Partia jonë nuk u gjend në befasi dhe asaj nuk i mungoi vigjilenca, e kjo ngjau pse ajo respekton kurdoherë normat leniniste në marrëdhëniet midis partive, se ka respekt të madh marksist për Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, për Partinë Komuniste të Kinës dhe për të gjitha partitë e tjera komuniste dhe punëtorë, pse respekton ndjenjën e barazisë në mes partive, barazi që duhet ta respektojnë edhe partitë e tjera ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë, pavarësisht se ajo është e vogël në numër.

Partia jonë pa që në fillim se të gjitha këto norma u shkelën në Mbledhjen e Bukureshtit dhe prandaj mbajti qëndrimin që dihet nga të gjithë, dhe e quajti e e quan të vetmin qëndrim të drejtë në ato rrethana si u zhvilluan ngjarjet.

Disa udhëheqës të partive motra na quajtën ne «neutralistë», disa na akuzuan se «u shkëputëm nga vija e drejtë marksiste-leniniste» dhe këta udhëheqës shkuan gjer atje saqë në partitë e tyre ndërmorën diskreditimin e Partisë sonë. Të gjitha këto ne i hedhim poshtë me përbuzje, pse këto janë shpifje, këto s'janë të ndershme dhe as pajtohen me moralin komunist.

U bëjmë pyetjen atyre që ndërmorën këto veprime të dënueshme kundër Partisë së Punës të Shqipërisë: A ka të drejtë një parti të shfaqë lirisht mendimin e vet, ashtu si e gjykon ajo? Çfarë mendimi shfaqti Partia

e Punës e Shqipërisë në Bukuresht? Ne shprehëm besnikërinë tonë ndaj marksizëm-leninizmit, dhe këtë e vërteton gjithë jeta dhe lufta e Partisë së Punës të Shqipërisë; ne shfaqëm besnikërinë tonë ndaj vendimeve të Deklaratës së Moskës dhe Manifestit të Paqes të vitit 1957 dhe këtë e vërteton vija e ndjekur me konsekuencë nga Partia e Punës e Shqipërisë; ne shfaqëm besnikërinë tonë dhe mbrojtëm unitetin e kampit të socializmit, dhe këtë e vërteton e gjithë lufta e Partisë së Punës të Shqipërisë; ne shfaqëm dashurinë, besnikërinë ndaj Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe popujve sovjetikë, dhe këtë e vërteton gjithë jeta e Partisë së Punës të Shqipërisë. Ne nuk pranuan të gjykonim «gabimet» e Partisë Komuniste të Kinës dhe ca më pak ta «dënonim» Partinë Komuniste të Kinës, pa pasur parasysh edhe pikëpamjet e Partisë Komuniste të Kinës për çështjet që ngriheshin kaq shtrembër, në mënyrë të shpejtuar dhe antimarksiste kundër saj. Ne këshilluam të tregoheshim të matur, gjakftohtë dhe shoqërorë në zgjidhjen e kësaj çështjeje jetike dhe jashtëzakonisht serioze për komunizmin ndërkombëtar. Ky ishte i gjithë «krimi» ynë, për të cilin na u hodh guri. Por ne mendojmë se guri, që u ngrit për të na goditur ne, u ra vetë në kokë atyre që e lëshuan. Sa ditë shkuan dhe sa kohë do të shkojnë po vërtetojnë drejtësinë e qëndrimit të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Pse u shpejtuan kaq shumë shoku Hrushov dhe shokët e tjerë sovjetikë për të akuzuar pa baza dhe pa fakte Partinë Komuniste të Kinës? A mund t'u lejohet komunistëve dhe veçanërisht udhëheqësve krye-

sorë të një partie kaq të madhe, siç është Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, të bënin një veprim të tillë të shëmtuar? Ata le të përgjigjen vetë, por edhe Partia e Punës e Shqipërisë ka plotësisht të drejtën të thotë mendimin e vet.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se Mbledhja e Bukureshtit jo vetëm që ishte një gabim i madh, por edhe se ky gabim u thellua me ndërgjegje. Mbledhja e Bukureshtit në asnjë mënyrë nuk duhet lënë në harrësë, por duhet të dënohet rreptësisht si një njollë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

S'ka as më të voglin dyshim që mosmarrëveshjet ideologjike kanë qënë dhe janë të mëdha dhe këto kanë lindur e janë zhvilluar në mes Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës. Këto duhej të ishin zgjidhur në kohë dhe në rrugën marksiste-leniniste në mes të dy partive.

Në bazë të dokumentit kinez, Partia Komuniste e Kinës thotë se këto mosmarrëveshje parimore kanë lindur fill që pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe këto janë ngritur nga shokët kinezë. Disa janë marrë parasysh nga shokët sovjetikë, disa janë hedhur poshtë.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se për këto mosmarrëveshje, në rast se nuk zgjidheshin në mes të dy partive, duhej kërkuar organizimi i një mbledhjeje të partive komuniste dhe punëtoje, ku të shtroheshin këto çështje, të diskutoheshin dhe të mbahej qëndrim. S'është e drejtë që këto çështje u lanë dhe faji u bie shokëve sovjetikë, që i dinin këto mosmarrëveshje, që s'i përfillnin, pse ata ishin të bindur në vijën e tyre

dhe në «paprekshmërinë» e saj dhe kjo është pikëpamje idealiste dhe metafizike, mendojmë ne.

Në rast se shokët sovjetikë ishin të bindur për drejtësinë e vijës së tyre dhe të taktikës së tyre, përse nuk organizuan me kohë një mbledhje të tillë dhe të zgjidheshin këto mosmarrëveshje? A ishin të vogla çështjet që ngriheshin, si për shembull dënimi i J.V. Stalinit, çështja e madhe e kundërrevolucionit hungarez, çështja e formave të marrjes së pushtetit, për të mos folur për shumë çështje të tjera shumë të rëndësishme siç dolën më vonë? Jo! S'ishin aspak të vogla. Të gjithë kemi pikëpamjet tona për këto probleme, pse të gjithëve si komunistë na interesojnë, pse të gjitha partitë tona janë përgjegjëse përpara popujve të tyre, por janë përgjegjëse edhe përpara komunizmit ndërkombëtar.

Për të dënuar Partinë Komuniste të Kinës për faje dhe mëkate imagjinare, shoku Hrushov dhe udhëheqësit e tjerë sovjetikë ishin shumë të interesuar që çështjet të shtroheshin sikur mosmarrëveshjet ishin në mes të Kinës dhe të gjithë komunizmit ndërkombëtar, por çështjet si ato që përmendëm më lart i ka gjykuar dhe i ka vendosur vetëm shoku Hrushov e shokët e tij përreth, duke menduar se s'ka qenë nevoja të diskutoheshin në mënyrë kolegjiale nga një mbledhje e përfaqësuesve të të gjitha partive, megjithëse çështjet ishin me karakter të madh ndërkombëtar.

Ngjau kundërrevolucionin hungarez, por çështjet nuk u zbuluan. Pse kjo taktikë e mbylljes së gjërave, kur nuk u intereson shokëvet sovjetikë, ndërsa kur u intereson atyre jo vetëm që organizojnë mbledhje si ajo e

Bukureshtit, por bëjnë çmos që t'u imponojnë të tjerëve pikëpamjen se Kina «është në kundërshtim vije me të gjitha partitë komuniste dhe punëtore të botës»?

Një përpjekje të tillë shokët sovjetikë bënë edhe ndaj nesh. Në muajin gusht të këtij viti udhëheqja sovjetike i drejtoi një letër Partisë sonë, me anën e së cilës na propozonte që «me qëllim që shkëndija e mosmarrëveshjeve të mos ndizet» të takoheshin përfaqësuesit e të dyja partive tona, në mënyrë që Partia jonë të radhitej në anën e Bashkimit Sovjetik, kundër Partisë Komuniste të Kinës, dhe të dyja partitë tona të shkonin në një front të bashkuar në këtë mbledhje. Natyrisht, Komiteti Qendror i Partisë sonë nuk e pranoi një gjë të tillë dhe në përgjigjen e tij zyrtare e konsideroi këtë si një punë aspak marksiste, si një veprim fraksionist të drejtuar kundër një partie të tretë motër, kundër Partisë Komuniste të Kinës. Sigurisht, ky qëndrim i drejtë e parimor i Partisë sonë nuk i ka pëlqyer udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Që këto çështje janë të një rëndësie të dorës së parë, kjo s'ka dyshim; që këto na interesojnë shumë të gjithëve, kjo s'ka dyshim, por s'ka aspak dyshim, gjithashtu, për Partinë e Punës të Shqipërisë që çështjet si u shtruan në Bukuresht kundër Kinës ishin tendencioze dhe kishin për qëllim të dënonin dhe të veçonin Partinë Komuniste të Kinës nga gjithë lëvizja komuniste ndërkombëtare.

Kjo për Partinë e Punës të Shqipërisë ishte e tmerrshme dhe e papranueshme, jo vetëm se ajo nuk ishte e bindur për një gjë të tillë, por dyshoi me të drejtë se po organizohej një veprim jo në rrugën marksiste

kundër një partie motër të madhe e të lavdishme, siç është Partia Komuniste e Kinës, se po organizohej nën petkun e akuzës për dogmatizëm kundër Kinës një sulm kundër marksizëm-leninizmit.

Në mbledhje u akuzua Partia Komuniste e Kinës për shumë faje. Kjo duhej të pasqyrohej në komunikatë. Pse s'u bë? Në qoftë se akuzat ishin me baza, pse u hezitua dhe doli një komunikatë që s'i përgjigjej qëllimit të mbledhjes? Pse nuk u fol atje për «rrezikun e madh të dogmatizmit» që kërcënonte gjoja komunizmin ndërkombëtar?

Jo, shokë, Mbledhja e Bukureshtit nuk mund të mbrohet, ajo s'ishte parimore, ajo ishte tendencioze për të arritur disa qëllime dhe qëllimi kryesor ishte, sipas mendimit të Partisë së Punës të Shqipërisë, që, duke u akuzuar Partia Komuniste e Kinës për dogmatizëm, të mbuloheshin disa gabime të rënda në vijë, që i kanë lejuar vetes shokët udhëheqës sovjetikë.

Shokët sovjetikë kishin nevojë për përkrahjen e partive të tjera për këtë çështje, prandaj tentuan hapur për t'i zënë ato në befasi. Shokët sovjetikë ia arritën një gjysmë qëllimi dhe fituan të drejtën të shtronin në partitë e tyre dënimin e Kinës, si fryt i një «konference ndërkombëtare të komunizmit». Në partitë komuniste dhe punëtore, me përjashtim të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të disa partive komuniste e punëtore të tjera, u shtruan «gabimet e rënda në vijë të bëra nga ana e Partisë Komuniste të Kinës», u raportua dënimi «unanim» që u muar kundër Kinës në Bukuresht, u luftua për të krijuar opinionin në parti dhe në popull në këtë drejtim. Në disa nga këto mble-

dhje partie u dënua gjithashtu edhe Partia e Punës e Shqipërisë.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë vendosi, dhe vendosi drejt, që, pas Mbledhjes së Bukureshtit, në Parti të punonte vetëm komunikatën, t'i thoshte Partisë së tij se ekzistojnë divergjenca parimore në mes Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, të cilat duhet të shtrohen dhe të zgjidhen në mbledhjen e ardhshme që do të bëhet në nëntor në Moskë. Dhe kështu u bë.

Por ky qëndrim i Partisë sonë nuk u pëlqeu shokëve të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe këtë ne shumë shpejt filluam ta ndiejmë. Fill pas Bukureshtit, kundër Partisë sonë dhe Komitetit të saj Qendror filloi një sulm i papritur, joparimor, një ndërhyrje brutale dhe presion i gjithanshëm. Sulmin e filloi shoku Hrushov në Bukuresht dhe e vazhdoi shoku Kozllov në Moskë. Shokët e Byrosë Politike, që rastësisht kalonin nëpër Moskë, iu nënshtruan një përpunimi, me qëllim që të viheshin kundër udhëheqjes së Partisë sonë, duke ua shtruar çështjen se «udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë tradhtoi miqësinë me Bashkimin Sovjetik», se «vija që ndjek udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë karakterizohet nga «zig-zage»», se «Shqipëria duhet të vendosë që të shkojë ose me 200 milionët (pra me Bashkimin Sovjetik) ose me 650 milionët (pra me Kinën Popullore)» dhe, më në fund, se «e vetëmuar Shqipëria është në rrezik, se mjafton një bombë atomike të hidhet nga amerikanët dhe e shuan fare Shqipërinë dhe gjithë popullsinë e saj» e të tjera kërcënime të tilla. Është fare e qartë se qëllimi

ka qenë që të krijohej përçarje në udhëheqjen e Partisë sonë, të eleminoheshin nga udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë ata elementë që udhëheqësit sovjetikë mendonin se i pengonin në ndërmarrjen e tyre të shtrembër e jo të ndershme.

Rezultat i kësaj pune përçarëse ishte kapitullimi i Liri Belishovës, ish-anëtare e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, përpara lajkave të udhëheqësve sovjetikë, përpara shantazheve e frikësimeve, dhe vënia e saj në opozicion të hapur me vijën e Partisë.

Përpyekja që bëjnë shokët sovjetikë në letërn. që i drejtojnë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës për ta paraqitur këtë çështje sikur në Shqipëri po dënohen miqtë e Bashkimit Sovjetik, është false. Miq përjetë të popujve sovjetikë janë të njëmilion e gjysmë shqiptarët dhe Partia e Punës e Shqipërisë, që e kanë farkëtuar dhe e kanë çelikosur këtë miqësi të kalitur me gjak, dhe jo kapitullantët, përçarësit dhe deviatorët e ndryshëm.

Por përpyekjet për të ngjallur dyshime në qëndrimin e drejtë të Partisë sonë në Bukuresht nuk u kufizuan vetëm në Moskë. Ato u bënë, bile me zjarr të madh, edhe në Tiranë nga punonjës të ambasadës sovjetike me në krye vetë ambasadorin sovjetik në Tiranë.

Siç e thashë më lart, para Mbledhjes së Bukureshtit nuk mund të imagjinoheshin lidhje më të ngushta, më të sinqerta, më vëllazërore në mes nesh dhe shokëve sovjetikë. Nuk kishte asgjë të fshehtë për shokët sovjetikë nga ana jonë, qoftë të fshehta partie, qoftë shtetërore. Ky ishte vendimi i Komitetit Qendror të Partisë

sonë. Këto lidhje pasqyronin dashurinë dhe besnikërinë e madhe që kaliti me gjak Partia jonë në mes të popullit shqiptar dhe atij sovjetik.

Mbi këto ndjenja të shenjta të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të popullit tonë shkelën disa elementë të sëmurë, me ambasadorin sovjetik në krye. Ata, duke përfutur nga lidhjet miqësore, duke përfutur nga mirëbesimi i kuadrove, filluan me ethe dhe me intensitet të sulmonin vijën marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë, të përçanin Partinë, të krijonin panik dhe konfuzion në radhët e saj, të ndanin udhëheqjen nga Partia, dhe puna arriti deri atje sa ambasadori sovjetik në Tiranë tentoi të nxiste gjeneralët e ushtrisë sonë për të ngritur Ushtrinë Popullore të Shqipërisë kundër udhëheqjes së Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të shtetit shqiptar. Por sharra u hasi në gozhdë, pse uniteti i Partisë sonë është i çeliktë. Kuadrot tanë, të kalitur në Luftën Nacionalçlirimtare dhe në luftën e ashpër për jetë a për vdekje me revizionistët jugosllavë, mbrojtën në mënyrë marksiste Partinë e tyre heroike dhe ata dinë fare mirë të ndajnë Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të Leninit nga përçarësit. Dhe në fakt këtyre denigruesve ua treguan vendin.

Punonjësit e ambasadës sovjetike në Tiranë, me ambasadorin në krye, arritën, megjithëkëtë, që me anë të metodave të palejueshme e antimarksiste, të bënin që kryetari i Komisionit të Revizionimit në Partinë e Punës të Shqipërisë, i cili 15 ditë më parë u tregua solidar me vijën e ndjekur nga Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë në Bukuresht, të bjerë në kthetrat e këtyre intrigantëve dhe të dalë plotësisht nga

binarët e marksizëm-leninizmit dhe në kundërshtim flagrant me vijën e Partisë. Është e qartë se këto përpjekje të dënueshme të këtyre shokëve sovjetikë synonin të përçanin udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, ta ndanin atë nga masat e Partisë. Dhe kjo si dënim për «krimin» që bëmë ne në Bukuresht, për guximin që morëm për të shfaqur lirisht pikëpamjen tonë, ashtu siç e quanim ne të drejtë.

Në këtë rrugë funksionarët e ambasadës sovjetike në Tiranë vazhduan edhe më tej. Ata u sulën te njerëzit shqiptarë që kishin mbaruar studimet në Bashkimin Sovjetik për t'i nxitur kundër udhëheqjes shqiptare, duke menduar se ata ishin kontingjente të përshtatshme për qëllimet e tyre të shtrembra. Por njerëzit shqiptarë, qofshin ata që kanë mbaruar studimet në Bashkimin Sovjetik, qofshin ata që s'kanë mbaruar atje, dinë e do të dinë se të tilla metoda të ulëta, që përdorin punonjësit e ambasadës sovjetike në Tiranë, janë krejt të huaja për marksizëm-leninizmin. Njerëzit shqiptarë janë bijtë e popullit të vet, janë bijtë e Partisë së tyre, janë marksistë-leninistë, janë internacionalistë.

Mund të radhitim edhe shumë shembuj të tjerë; por, për të mos i marrë shumë kohë kësaj mbledhjeje të rëndësishme, do të përmend edhe dy raste të tjera tipike. Presionet mbi Partinë tonë vazhduan edhe në ditët kur këtu në Moskë ishte mbledhur komisioni për redaktimin e projektdeklaratës që na është paraqitur, kur shokët sovjetikë thoshin se duhet të shohim përpara dhe jo prapa. Ato ditë në Moskë, në një mbledhje të gjerë të shefave të shtatmadhorive të vendeve të Traktatit të Varshavës, anëtar i Komitetit Qendror dhe mi-

nistri i Bashkimit Sovjetik, mareshali Malinovski, sulmoi hapur popullin shqiptar, Partinë e Punës të Shqipërisë, Qeverinë Shqiptare dhe udhëheqjen tonë. Ky sulm jomiqësor e publik është i ngjashëm me sulmin diversionist të ambasadorit sovjetik në Tiranë, që kërkonte të nxiste Ushtrinë tonë Popullore kundër udhëheqjes së Partisë dhe të shtetit tonë. Por, ashtu si edhe ambasadori sovjetik, gabohet shumë rëndë edhe mareshali Malinovski. Askush nuk mund t'ia arrijë këtë qëllimi dhe aq më pak prishjes së miqësisë së popullit tonë me popujt e Bashkimit Sovjetik. Lufta e drejtë e Partisë së Punës të Shqipërisë kundër këtyre veprimeve minuese e forcon miqësinë e singërtë të popullit tonë me popujt e Bashkimit Sovjetik. Këtë miqësi nuk mund ta prishin as deklaratat e çuditshme të mareshalit Greçko, kryekomandantit të Traktatit të Varshavës, i cili i tha delegacionit tonë ushtarak se jo vetëm paska vështirësi që të plotësojë nevojat e ushtrisë sonë me disa armatime shumë të nevojshme që parashikoheshin sipas kontratave të nënshkuara, por tha hapur se «ju hëpërhë jeni në Traktatin e Varshavës», duke lënë të kuptohet se mareshali Greçko paska vendosur të na nxjerrë jashtë. Por për fat të mirë nuk është shoku mareshal që e vendos një gjë të tillë.

Në tetor të këtij viti shoku Hrushov, me seriozitetin më të madh, u deklaroi shokëve kinezë se «ne do ta trajtojmë Shqipërinë si Jugosllavinë». Ne ia themi këtë kësaj mbledhjeje të komunizmit ndërkombëtar, me qëllim që të shihet se sa larg po shkojnë punët, se ç'qëndrime po mbahen kundër një vendi të vogël socialist. Cili është «krimi» i Partisë së Punës të Shqipërisë që

vendi ynë të trajtohet si Jugosllavia titiste? Mos vallë ne tradhtuam marksizëm-leninizmin, siç bëri klika e Titos? Apo u larguam nga kampi socialist dhe u lidhëm me qerren e imperializmit amerikan, siç është lidhur revizionizmi jugosllav? Jo, dhe për këtë është dëshmitare gjithë lëvizja komuniste ndërkombëtare, për këtë është dëshmitare gjithë veprimtaria konkrete politike, ideologjike dhe ekonomike e Partisë dhe e shtetit tonë gjatë gjithë Luftës Nacionalçlirimtare dhe gjatë këtyre 16 vjetëve që nga çlirimi i atdheut, për këtë dëshmon edhe vetë Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, i cili në letrën drejtuar Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë në datën 13 gusht 1960 thekson: «Marrëdhëniet midis Partisë së Punës të Shqipërisë e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të bazuara në parimet e internacionalizmit proletar, kanë qenë gjithnjë me të vërtetë vëllazërore. Miqësia midis partive dhe popujve tanë nuk është errësuar asnjëherë nga ndonjë mosmarrëveshje ose largim. Pozitat e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik mbi të gjitha çështjet më të rëndësishme të lëvizjes komuniste dhe punëtoresh ndërkombëtare dhe të politikës së jashtme janë përputhur».

Atëherë, cili është faji ynë? «Krimi» ynë i vetëm është se ne në Bukuresht nuk pranuan të dënohej padrejtësisht një parti motër komuniste siç është Partia Komuniste e Kinës, «krimi» ynë i vetëm është se ne hapur dhe në një mbledhje komuniste ndërkombëtare (dhe jo në pazar) patëm guximin të kundërshtojmë veprimin e padrejtë të shokut Hrushov, «krimi» ynë i

vetëm është se ne jemi një Parti e vogël e një populli të vogël dhe të varfër, i cili, sipas pikëpamjes së shokut Hrushov, vetëm duhet të duartrokasë, të aprovojë dhe të mos shfaqë mendim. Por kjo nuk është as marksiste, as e pranueshme. Të drejtën që të themi fjalën tonë, na e ka dhënë marksizëm-leninizmi dhe këtë të drejtë ne nuk mund të na e heqë askush, as me presione politike apo ekonomike, as me kërcënime apo epitete që mund të na ngjiten. Me këtë rast donim të pyesnim shokun Hrushov: pse një deklaratë të tillë nuk na e bëri neve, por një përfaqësuesi të një partie të tretë? Apo shoku Hrushov mendon se Partia e Punës e Shqipërisë nuk ka pikëpamjet e saj, por ka bërë kauzë të përbashkët me Partinë Komuniste të Kinës në mënyrë të paprincipitë dhe prandaj për çështjet e Partisë sonë mund të bisedohet me shokët kinezë? Jo, shoku Hrushov, ju vazhdoni të gaboni dhe të keni pikëpamje shumë të këqija për Partinë tonë. Partia e Punës e Shqipërisë ka pikëpamjet e saj dhe për to përgjigjet si përpara popullit të saj, ashtu edhe përpara lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Ne jemi të detyruar t'i njoftojmë kësaj mbledhjeje se në fakt udhëheqja sovjetike nga kërcënimet për ta trajtuar Shqipërinë si Jugosllavinë titiste ka kaluar në veprime konkrete. Sivjet në vendin tonë na kanë ngjarë shumë fatkeqësi të natyrës. Tërmet i madh ra te ne, në tetor patl përmytje, por sidomos thatësira ka qenë e tmerrshme, 120 ditë vazhdimisht nuk ra një pikë shi. Gati i gjithë drithi u dogj. Popullin e kërcënonte uria. Rezervat shumë të pakta u konsumuan. Qeveria jonë i kërkoi të blinte me urgjencë bukë Bashkimit Sovjetik,

duke i shpjeguar situatën shumë të rëndë. Kjo ngjau pas Mbledhjes së Bukureshtit. Ne pritëm 45 ditë përgjigje nga qeveria sovjetike, kurse për popullin kishim vetëm 15 ditë bukë. Pas 45 ditësh dhe pas disa kërkesave të përsëritura zyrtare qeveria sovjetike, nga 50 mijë tonë që i kërkuam, na akordoi vetëm 10 mijë tonë, që do të thotë 15 ditë bukë, dhe këtë sasi do të na e livronte në muajt shtator-tetor. Ky ishte presion i hapët mbi Partinë tonë për t'iu përrulur vullnetit të shokëve sovjetikë.

: Në ato ditë të vështira ne provuam shumë gjëra. A s'kishte Bashkimi Sovjetik, që i shet drithë gjithë botës, t'i jepte popullit shqiptar, besnik ë vëlla i popullit sovjetik, besnik i marksizëm-leninizmit dhe i kampit të socializmit, 50 mijë tonë drithë, në një kohë kur jo për fajin e tij e kërcënonte uria? Shoku Hrushov na kishte thënë dikur: «Mos u bëni merak për bukë, atë që ju konsumoni në një vit, te ne e hanë minjtë». Minjtë në Bashkimin Sovjetik, pra, mund të hanin, por populli shqiptar le të vdiste nga uria, derisa udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë t'i nënshtrohej vullnetit të udhëheqjes sovjetike. Kjo është e tmerrshme, shokë, por kështu është. Populli sovjetik nuk do t'ua falë këtë, në qoftë se e merr vesh, pse kjo s'është as marksiste, as Internacionaliste, as shoqërore. Nuk është as miqësore, gjithashtu, që të mos pranohet kleringu ynë për të blerë bukë në Bashkimin Sovjetik dhe të detyroheshim të nxirrnim rezervën e vogël të floririt të Bankës sonë Kombëtare për të blerë misër për bukën e popullit në Bashkimin Sovjetik.

Këto veprime janë të lidhura me njëri-tjetrin; ato

nuk janë diçka e rastit. Veçanërisht ditët e fundit sulmet e shokut Hrushov kundër Partisë sonë të Punës kanë arritur kulmin. Ju, shoku Hrushov, në datën 6 nëntor deklaruat se «shqiptarët sillen me ne, ashtu siç sillet Titoja me ne». Ju u thatë shokëve kinezë se «ne humbëm një Shqipëri, kurse ju kinezët fituat një Shqipëri». Dhe, më në fund, deklaruat se «Partia e Punës e Shqipërisë është hallka jonë e dobët».

Ç'janë këto akuza monstruoze, këto trajtime prej «tregtari» ndaj Partisë sonë, popullit tonë dhe një vendi socialist, i cili u humbka dhe u fituaka si një lojë bixhozi? Ç'janë këto konsiderata për një Parti motër, e cila, sipas jush, qenka hallkë e dobët në lëvizjen komuniste ndërkombëtare? Ne e kemi të qartë dhe e kuptojmë fare mirë se qëndrimi ynë i drejtë e parimor marksist-leninist, guximi ynë për të mos rënë dakord me ju dhe për të dënuar ato veprime tuajat që janë të shtrembra, ju shtyn të sulmoni Partinë tonë, të bëni gjithfarë presionesh kundër saj, të thoni edhe monstruoze të më ekstreme në adresë të Partisë sonë. Por këtu nuk ka asgjë shoqërore, asgjë komuniste. Ju na krahasoni ne me revizionistët jugosllavë. Por të gjithë e dinë se si ka luftuar e lufton kundër revizionistëve jugosllavë Partia jonë. Nuk jemi ne që veprojmë si jugosllavët, por jeni ju, shoku Hrushov, që po përdorni kundër Partisë sonë metoda që janë të huaja për marksizëm-leninizmin. Ju e konsideroni Shqipërinë si plaçkë tregu, që mund të fitohet ose të humbitet nga njëri apo nga tjetri. Ka qenë një kohë kur Shqipëria konsiderohej si plaçkë tregu, kur të tjerët mendonin se varej nga ata nëse Shqipëria do të ekzistonte apo jo, por ajo kohë

ka marrë fund qysh me triumfin e ideve të marksizëm-leninizmit në vendin tonë. Ju po përsëritni të njëjtën gjë, derisa arritët në përfundimin se e «humbët» Shqipërinë ose se dikush tjetër e «fitoi» atë dhe se Shqipëria nuk është më vend socialist, siç del nga letra që na dorëzuar më 8 nëntor, ku nuk përmendet vendi ynë si vend socialist.

Faktin që Shqipëria ecën në rrugën e socializmit dhe bën pjesë në kampin e socializmit nuk e përcaktoni ju, shoku Hrushov, kjo nuk varet nga dëshira juaj. Këtë e ka vendosur populli shqiptar me Partinë e tij të Punës në krye, me luftën e tij, dhe nuk ka forcë që ta largojë atë nga kjo rrugë.

Përsa i përket çështjes se Partia jonë e Punës qenka hallka më e dobët në kampin socialist dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, ne themi se historia njëzetvjeçare e Partisë sonë, lufta heroike e popullit dhe e Partisë sonë kundër pushtuesve fashistë dhe 16 vjetët që nga Çlirimi e këtej, gjatë së cilës Partia dhe populli ynë i vogël u kanë bërë ballë të gjitha furtunave, tregojnë të kundërtën. E rrethuar nga armiq, si ishull në mes të dallgëve, Republika Popullore e Shqipërisë u ka qëndruar me guxim të gjitha sulmeve dhe provokacioneve të imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre. Ajo, si shkëmb graniti, ka mbajtur dhe mban lart flamurin e socializmit në prapavijat e armikut. Ju, shoku Hrushov, ngritët dorën kundër popullit tonë të vogël dhe Partisë së tij, por ne jemi të bindur se populli sovjetik, i cili ka derdhur gjak edhe për lirinë e popullit tonë, se Partia e madhe e Leninit nuk do të jenë dakord me këtë veprim tuajin. Ne kemi besim të plotë në mark-

sizëm-leninizmin, ne jemi të sigurtë se partitë motra, të cilat kanë dërguar përfaqësuesit në këtë mbledhje, do ta shikojnë dhe do ta gjykojnë këtë çështje me drejtësinë marksiste-leniniste.

Partia jonë e ka quajtur kurdoherë Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik si parti mëmë, dhe këtë e ka thënë pse ajo është partia më e vjetër, partia e lavdishme e bolshevikëve, e ka thënë për eksperiencën e saj universale, për pjekurinë e saj të madhe. Por Partia jonë kurrë nuk ka pranuar dhe kurrë nuk do të pranojë që ndonjë udhëheqës sovjetik t'i imponojë asaj pikëpamjet e tij që ajo i gjykon të gabuara.

Udhëheqja sovjetike e shikoi këtë çështje me rëndësi parimore krejt gabim, në mënyrë idealiste dhe metafizike; asaj i është rritur mendja nga sukseset kolosale të arritura nga popujt sovjetikë dhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe shkel parimet marksiste-leniniste, e quan veten të pagabueshme, e quan të pagabueshëm dhe të palëvizshëm çdo vendim, çdo veprim, çdo fjalë dhe çdo gjest të saj. Të tjerët mund të gabojnë, të tjerët janë të dënueshëm, kurse ajo jo. «Vendimet tona janë të shenjta, ato janë të paprekshme», «Asnjë lëshim, asnjë kompromis nuk mund t'i bëjmë ne Partisë Komuniste të Kinës», u thoshin njerëzve tanë udhëheqësit e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Atëherë përse po na mblidhnin në Bukuresht? Sigurisht të votonim me symbyllur për pikëpamjet e udhëheqjes sovjetike. A është marksiste kjo? A është normale kjo?

A mund të lejohen akte diversioni në një parti nga një parti tjetër për të përçarë unitetin, për të rrëzuar udhëheqjen e një partie ose të një shteti tjetër? Kurrë

sesi. Udhëheqësit sovjetikë akuzuan shokun Stalin gjoja për ndërhyrje në partitë e tjera dhe për t'u imponuar të tjerëve pikëpamjet e Partisë Bolshevike. Ne mund të dëshmojmë se asnjëherë nuk e bëri shoku Stalin një gjë të tillë kundër nesh, ai në çdo kohë u suall me popullin shqiptar dhe me Partinë e Punës të Shqipërisë si një marksist i madh, si një internacionalist i shquar, si një shok, vëlla dhe mik i sinqertë i popullit shqiptar. Shoku Stalin më 1945, kur populli ynë rrezikohet nga uria, i ktheu nga rruga vaporët me bukë, që ishin destinuar për popullin sovjetik, që atëherë gjithashtu ishte keq për bukë, dhe ia dërgoi menjëherë popullit shqiptar. Kurse udhëheqja e sotme sovjetike i lëjoi vetes veprime të shëmtuara.

A mund të lejohen të atilla presione ekonomike, a mund të lejohet që të kërcënohet populli shqiptar, siç bëri udhëheqja sovjetike pas Bukureshtit? Në asnjë mënyrë...

Ne e dimë se ndihma që i jepet popullit tonë të vogël, i cili para luftës vuante në mjerim të madh nga çdo pikëpamje, që në Luftën e Dytë Botërore u dogj, u shkatërrua, por nuk u përkul, dhe që nën udhëheqjen e lavdishme të Partisë Komuniste Shqiptare luftoi me heroizëm të madh derisa u çlirua, është një ndihmë internacionaliste.

Por pse ndryshoi qëndrimi i udhëheqjes sovjetike ndaj nesh pas Bukureshtit, derisa ta linte popullin shqiptar të vuante nga uria? Këtë gjë e bëri edhe udhëheqja rumune, e cila nuk dëgjoi t'i jepte me klering asnjë kokërr grurë popullit tonë, në një kohë kur Rumania bën tregti me drithëra me vendet kapitaliste dhe

ne u detyruam të blejmë misër me valutë nga fermerët francezë.

Disa muaj përpara Mbledhjes së Bukureshtit, shoku Dezh Itoi apostafat një delegacion të Partisë sonë për të biseduar për zhvillimin në perspektivë të Shqipërisë. Ky ishte një preokupim i lavdërueshëm dhe marksist. Shoku Dezh i tha Partisë sonë se «ne, vendet e tjera të demokracisë popullore, nuk duhet më të diskutojmë se duhet t'i jepet Shqipërisë kaq ose aq kredi, por se në Shqipëri duhet të vendoset të ndërtohen këto e këto fabrika, të ngrihen në një shkallë të lartë mjetet e prodhimit, pa sa milion rubla kushtojnë këto, kjo s'ka rëndësi». Këtë gjë, tha shoku Dezh, «e kemi biseduar edhe me shokun Hrushov dhe kemi qenë dakord».

Por erdhi Mbledhja e Bukureshtit dhe Partia jonë mbajti qëndrimin që dihet. Shokët rumunë harruan ç'kishin thënë më parë dhe zgjodhën rrugën e lënies së pullit shqiptar të vuante nga uria.

Këto gjëra ne ia kemi bërë të njohura më parë zyrtarisht Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, këto gjëra ne nuk i kemi shtruar as i kemi diskutuar pazarit, as vesh më vesh, por po i themi për herë të parë në një mbledhje partie, siç është mbledhja jonë e sotme. Përse atëherë i shtrojmë ne këto çështje? Ne nisemi nga qëllimi që t'u jepet fund këtyre shfaqjeve negative, të cilat nuk e forcojnë, por e dobësojnë unitetin tonë. Ne nisemi nga dëshira që midis partive komuniste e punëtore, midis shteteve socialiste të forcohen marrëdhëniet dhe lidhjet marksiste-leniniste, duke flakur tej çdo shfaqje të keqe që ka lindur deri tani. Ne jemi optimistë dhe kemi bindje të

plotë e besim të patundur se shokët sovjetikë, si edhe shokët e tjerë, kritikën tona i kuptojnë drejt, ato janë të ashpra, por të hapëta dhe të sigërtë dhe synojnë në forcimin e marrëdhënieve tona. Partia dhe populli ynë, pavarësisht nga këto qëndrime të padrejta dhe të dëmshme që mbahen ndaj nesh, të cilat ne kemi besim se do të ndalohen në të ardhshmen, do të çelikosin edhe më shumë dashurinë dhe besnikërinë e pafund ndaj popujve sovjetikë, Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ndaj popujve dhe partive komuniste e punëtore të kampit të socializmit, kurdoherë duke pasur në themel mësimet marksiste-leniniste.

Miqësinë Partia jonë e kupton vetëm në drejtësi, në respektin reciprok në baza marksiste-leniniste. Kështu thuhet në Deklaratën e Moskës të vitit 1957, kështu theksohet edhe në projektdeklaratën që na është paraqitur. Ne deklarojmë me seriozitetin më të madh se Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar do të jenë si gjithnjë luftëtarë të vendosur për forcimin e marrëdhënieve dhe të unitetit të kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Për miqtë me kokë populli shqiptar hidhet në zjarr. Dhe këto s'janë fjalë boshe të miat, por unë shpreh këtu ndjenjat e popullit dhe të Partisë sonë dhe duhet të dihet mirë se Bashkimin Sovjetik dhe Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik nuk e duam për sytë e bukur të ndonjërit, apo për t'i bërë qejfin ndonjë personi.

Të dashur shokë,

Në Deklaratën e Moskës të vitit 1957, si dhe në projektin e deklaratës që na është paraqitur, konstatohet se revizionizmi përbën sot rrezikun kryesor në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Në Deklaratën e Moskës të vitit 1957 theksohet me të drejtë se burimi i brendshëm i revizionizmit është ekzistenca e influencës borgjeze, kurse kapitullimi përpara presionit të imperializmit është burimi i tij i jashtëm. Jeta ka vërtetuar plotësisht se revizionizmi modern, i maskuar nën parulla pseudomarksiste e revolucionare, me të gjitha mjetet është përpjekur të diskreditojë doktrinën tonë të madhe, marksizëm-leninizmin, të cilën e ka shpallur si «të vjetruar» dhe që nuk i përgjigjet më zhvillimit shoqëror. Duke u fshehur prapa parullës së marksizmit krijues, të kushteve të reja, revizionistët janë përpjekur, nga njëra anë, të hedhin poshtë frymën revolucionare të marksizmit dhe të minojnë besimin e klasës punëtore dhe të popullit punonjës ndaj socializmit dhe, nga ana tjetër, me të gjitha mjetet kanë punuar që të zbukurojnë imperializmin, ta paraqitin atë si të zbutur e paqësor. Të tre vjetët që kanë kaluar, qysh nga Mbledhja e Moskës, kanë vërtetuar plotësisht se revizionistët modernë nuk janë tjetër veçse përçarës të lëvizjes komuniste dhe të kampit të socializmit, shërbëtorë besnikë të imperializmit, armiq të vendosur të socializmit dhe të klasës punëtore.

Flamurtarë të revizionizmit modern, përfaqësuesit më agresivë dhe më të rrezikshëm të tij, siç ka treguar deri tani vetë jeta, janë revizionistët jugosllavë, klika

tradhtare e Titos me shokë. Në kohën kur u aprovua Deklarata e Moskës, megjithëse për mendimin tonë kishte fakte dhe të dhëna të mjaftueshme, ky grup armiqësor dhe kjo agjunkturë e imperializmit amerikan nuk u denoncua publikisht. Dhe jo vetëm kaq, por edhe më vonë, kur filloi të duket më qartë rrezikshmëria e tij, lufta kundër revizionizmit jugosllav, lufta konsekuente dhe e pandërprerë për shkatërrimin e tij ideologjik e politik, nuk është bërë me forcën e duhur. Përkundrazi. Dhe kjo ka qenë dhe është burimi i shumë të këqijave e dëmeve në lëvizjen tonë komuniste e punëtore ndërkombëtare. Sipas pikëpamjes së Partisë sonë, në mosdemaskimin total të grupit revizionist të Titos, në mbjelljen e «shpresave» false për një gjoja «përmirësim» dhe «kthesë» pozitive të këtij grupi tradhtar ka influencuar prirja pajtuese, pikëpamja e gabuar dhe vlerësimi jo i drejtë nga ana e shokut Hrushov dhe e disa udhëheqësve të tjerë sovjetikë për grupin e rrezikshëm revizionist titist.

Është thënë se në vlerësimin e revizionistëve jugosllavë si edhe në ashpërsimin e qëndrimit ndaj tyre, ka gabuar J.V. Stalini. Partia jonë asnjëherë nuk ka qenë dakord me një pikëpamje të tillë, sepse koha dhe jeta kanë vërtetuar të kundërtën. Stalini shumë drejt e ka vlerësuar rrezikun e revizionistëve jugosllavë, ai është përpjekur ta zgjidhë në kohën e duhur dhe në rrugën marksiste këtë çështje: u mblodh Informbyroja, si organ kolegjal në atë kohë, dhe pas demaskimit të grupit titist iu bë një luftë e pamëshirshme këtij grupi. Koha përsëri vërtetoi dhe vërteton se një gjë e tillë ishte e domosdoshme dhe e drejtë.

Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë kurdoherë e mendimit dhe është e bindur se grupi i Titos është tradhtar i marksizëm-leninizmit, agjenturë e imperia- lizmit, armik i rrezikshëm i kampit socialist dhe i gjithë lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, prandaj kundër tij duhet zhvilluar një luftë e pamëshirshme. Nga ana jonë, ne e kemi bërë dhe e bëjmë këtë luftë si komunistë internacionalistë dhe sepse ne e kemi ndierë dhe e ndiejmë përditë mbi kurrizin tonë peshën e ve- primtarisë armiqësore të klikës revizioniste të Titos kundër Partisë dhe vendit tonë. Por ky qëndrim i Par- tisë sonë nuk u ka pëlqyer dhe as u pëlqen shokut Hrushov e disa shokëve të tjerë.

Grupi titist është një grup trockistësh dhe renega- tësh prej shumë kohësh. Të paktën për Partinë e Punës të Shqipërisë ai është i tillë që prej vitit 1942, domethënë 18 vjet më parë.

Që në vitin 1942, kur lufta e popullit shqiptar mori një hov të madh, grupi trockist i Beogradit, nën maskën e miqësisë dhe në mirëbesimin tonë, u përpoq me të gjitha mjetet të pengonte zhvillimin e luftës sonë të armatosur, u përpoq të pengonte krijimin e reparteve të fuqishme sulmuese partizane shqiptare dhe, në pa- mundësi t'i ndalonte, u përpoq të merrte drejtpërdrejt drejtimin e tyre politik dhe ushtarak. Ai tentoi që çdo gjë të varej nga Beogradi dhe Partia jonë, ushtria jonë partizane të ishin apendise të thjeshta të Partisë Ko- muniste Jugosllave dhe të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave.

Partia jonë, duke e ruajtur miqësinë me partizanët jugosllavë, u bëri ballë me sukses këtyre qëllimeve

djallëzore. Që në atë kohë grupi titist përpiqej të vinte themelet e Federatës Ballkanike, nën drejtimin e titistëve të Beogradit, të lidhte partitë komuniste pas qerres së Partisë Komuniste Jugosllave, të bënte që ushtritë partizane të popujve të Ballkanit të ishin nën vartësinë e shtabit titist jugosllav. Për këtë qëllim ai, dakord që në atë kohë me anglezët, u përpoq të krijonte shtabin ballkanik dhe ta lidhte e ta vinte atë, domethënë ushtritë tona, nën drejtimin e anglo-amerikanëve. Partia jonë u rezistoi me sukses këtyre planeve djallëzore. Dhe kur valoi Flamuri i Çlirimit në Tiranë, banda titiste e Beogradit u dha urdhër agjentëve të saj në Shqipëri të diskreditonin suksesin e Partisë Komuniste Shqiptare dhe të organizonin puçin¹ për të rrëzuar udhëheqjen e Partisë, atë që organizoi Partinë, që udhëhoqi Luftën Nacionalçlirimtare dhe që e çoi popullin shqiptar në fitore. Dhe puçi i parë u organizua nga Titoja, tok me agjentët e tij të fshehtë në Partinë tonë. Por komplotin e Titos e shkatërroi Partia Komuniste Shqiptare.

Komplotistët e Beogradit s'i hodhën armët dhe tok me kryeagjentin e tyre në Partinë tonë, tradhtarin Koçi Xoxe, vazhduan riorganizimin e komplotit kundër Shqipërisë së re me forma të tjera, me forma të reja. Qëlli-

¹ Në Plenumin II të KQ të PKSH, që u mbajt më 23 nëntor të vitit 1944 në Berat, i dërguari i KQ të PKJ organizoi në prapaskenë një komplot kundër PK të Shqipërisë me pjesëmarrjen e elementëve antiparti Sejfulla Malëshova, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo. Qëllimi kryesor i këtij komploti ishte përmbysja e udhëheqjes së Partisë me shokun Enver Hoxha në krye dhe zëvendësimi i saj me një udhëheqje të re projugosllave.

mi ishte: Shqipëria të bëhej republikë e shtatë e Jugosllavisë.

Në një kohë kur vendi ishte i shkatërruar dhe i djegur e duhej rindërtuar nga e para, kur populli ishte pa bukë e pa strehë, por me një moral të lartë, kur popull e ushtri me armë në dorë bënë roje vigjilente kundër komplotëve të reaksionit që organizoheshin nga misionet anglo-amerikane dhe që e kërcënonin Shqipërinë e re me invazione të reja, kur një pjesë e madhe e Ushtrisë Partizane Shqiptare kapërceu kufirin e atdheut dhe u vajti në ndihmë vëllezërve jugosllavë, luftonte krah për krah me ta dhe së bashku çlironin Malin e Zi, Bosnjën, Hercegovinën, Kosovën e Maqedoninë, komplotistët e Beogradit kurdisnin plane për të robëruar Shqipërinë.

Por Partia jonë u bëri ballë heroikisht këtyre agjentëve të fshehur nën maskën e komunistit. Kur panë troçkistët e Beogradit se e humbën davanë, se komplotet po ua shkatërronte Partia jonë, provuan kartën e fundit: të invadonin Shqipërinë me ushtritë e tyre, të mbytnin rezistencën, të arrestonin udhëheqësit e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të shtetit shqiptar dhe ta deklaronin Shqipërinë republikë të shtatë të tyre. Partia e prishi edhe këtë plan djallëzor të tyre. Ndihma dhe ndërhyrja e J.V. Stalinit në ato çaste që vendimtare për Partinë tonë dhe për lirinë e popullit shqiptar.

Ishte tamam koha e demaskimit të klikës së Titos nga Informbyroja. Byroja Informativë bëri të dështojnë veprimet komplotiste të klikës së Titos jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet e tjera të demokracisë

popullore. Renegati dhe agjenti i imperializmit, Titoja dhe banda e tij, duke vepruar nën maskën e komunis-tëve, u përpoqën të shkëputnin vendet e demokracisë popullore të Ballkanit dhe të Evropës Qendrore nga miqësia dhe nga aleanca e luftës me Bashkimin Sovjetik, të shkatërronin partitë komuniste dhe punëtore të vendeve tona dhe t'i shndërronin shtetet tona në rezervë të imperializmit anglo-amerikan.

Kush ishte ai që nuk i dinte dhe nuk i pa në veprim këto plane armiqësore të imperializmit dhe të shërbëtorit të tij besnik Tito? Të gjithë i dinin, të gjithë i mësu-uan dhe të gjithë njëzëri aprovuan vendimet e drejta të Byrosë Informative, të gjithë aprovuan, pa përjash-tim, rezolutat e Byrosë Informative, të cilat pa për-jashtim ishin dhe mbeten të gjitha të drejta, sipas pikëpamjes sonë.

Ata që s'deshën t'i shihnin e t'i kuptonin këto ve-prime të kësaj bande provuan për të dytën herë me kundërrevolucionin në Hungari dhe me komplotet e pareshtura në Shqipëri se ujku qimen ndërron, por prapë ujk mbetet, se Titoja dhe banda e tij mund të bëjnë dredhira, mund të vënë maska, por prapë tradh-tarë dhe agjentë të imperializmit, vrasës të komunistëve heroikë internacionalistë jugosllavë mbeten, veprojnë dhe kështu do të jenë, derisa të zhduken.

Vendimet e marra kundër grupit renegat të Titos nga Informbyroja, Partia e Punës e Shqipërisë nuk i konsideron të marra personalisht nga shoku Stalin, por nga të gjitha partitë që bënin pjesë në Byronë Informa-tive. Por jo vetëm prej këtyre partive, pjesëtare të Byrosë Informative, por edhe nga partitë komuniste dhe

punëtore që s'bënin pjesë në Informbyro. Si një çështje që u përkiste të gjitha partive komuniste dhe punëtore, ajo i përkiste, pra, edhe Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila, duke pasë marrë e studjuar letrën drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave nga Stalini dhe Molotovi, ishte treguar plotësisht solidare me këtë letër dhe me vendimet e Informbyrosë.

Pse, pra, «kthesa» që u bë nga ana e shokut Hrushov dhe e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik më 1955 ndaj revizionistëve jugosllavë nuk u bë çështje e një konsultimi të rregullt me partitë e tjera komuniste e punëtore, por u konceptua e u zbatua në mënyrë aq të shpejtë dhe të njëanshme? Kjo ishte një çështje që na përkiste të tërëve. Revizionistët jugosllavë o ishin vënë në luftë kundër marksizëm-leninizmit dhe partive komuniste e punëtore të botës, o nuk ishin vënë; o ata kishin gabuar, ose kishim gabuar ne kundrejt tyre dhe jo vetëm Stalini. Këtë gjë s'mund ta zgjidhte dhe s'lejohej ta zgjidhte vetëm me dëshirën e tij shoku Hrushov. Por ky në fakt kështu bëri dhe kthesën në marrëdhëniet me revizionistët jugosllavë e lidhte me vajtjen e tij në Beograd. Partisë së Punës të Shqipërisë kjo i ra si bombë e papritur dhe ajo e kundërshtoi menjëherë kategorikisht. Para nisjes së shokut Hrushov për në Beograd, në maj të vitit 1955, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë i drejtoi një letër Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ku i shfaqte kundërshtimin e Partisë sonë për vajtjen e tij në Beograd, duke theksuar se çështja jugosllave nuk mund të zgjidhej në mënyrë të njëanshme, por duhej të mblidhej Byroja

Informative, ku kërkonim të merrte pjesë si e ftuar edhe Partia e Punës e Shqipërisë. Atje të vendosej kjo çështje, pasi të diskutohej gjatë dhe drejt.

Sigurisht në formë ne s'kishim të drejtë të vendosnim nëse duhej të vente shoku Hrushov në Beograd ose jo dhe për këtë ne u tërhoqëm, por në esencë dhe që çështja jugosllave nuk duhej zgjidhur kështu në këmbë ne kishim të drejtë dhe koha këtë e vërtetoi.

U hodh parulla e «mbishtresave», u hoq me të shpejtë Rezolucioni i dytë i Byrosë Informative, u hap «epoka e pajtimit» me «shokët jugosllavë» u rishikuan e u rehabilituan komplotistët, «shokët jugosllavë» andej, «shokët jugosllavë» këtej dhe «shokët jugosllavë» na dolën të larë, u ngrehën si gjela, trumbetuan se «çështja e tyre e drejtë» triumfoi, se «krimineli Stalin» i kishte kurdisur të gjitha këto dhe u krijua situata që ai që nuk ecte në këtë rrugë të re, ishte «stalinist» dhe duhej likuiduar.

Partia jonë nuk e pranoi një rrugë të tillë pajtuese dhe oportuniste. Ajo qëndroi në pozitat e drejta ideologjike marksiste-leniniste, në pozitat e luftës ideologjike dhe politike me revizionistët jugosllavë. Partia e Punës e Shqipërisë qëndroi e patundur në pikëpamjet e veta se grupi titist ishte tradhtar, renegat, trockist, diversionist dhe agjenturë e amerikanëve, se Partia e Punës e Shqipërisë nuk kishte gabuar ndaj tij.

Partia e Punës e Shqipërisë qëndroi e patundur në pikëpamjen se shoku Stalin nuk kishte gabuar në këtë çështje, se revizionistët me vijën e tyre tradhtarë ishin përpjekur të skllavëronin Shqipërinë, të shkatërronin Partinë e Punës të Shqipërisë dhe me kurdisjen nga ata

të një sërë komplotesh ndërkombëtare me imperialistët anglo-amerikanë kërkonin ta futnin Shqipërinë në konflikte ndërkombëtare.

Partia e Punës e Shqipërisë ishte, nga ana tjetër, dakord që me Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë të vendoste marrëdhënie shtetërore të fqinjësisë së mirë, marrëdhënie tregtare dhe kulturore, në rast se respektoheshin normat e bashkekzistencës paqësore në mes të shteteve me regjime të ndryshme, pse për Partinë e Punës të Shqipërisë Jugosllavia titiste s'ka qenë, s'është dhe s'do të jetë kurrë një vend socialist, derisa të ketë në krye grupin renegat dhe agjent të imperializmit.

Asnjë tentativë, e hapur ose e maskuar, nuk e përuli Partinë e Punës të Shqipërisë nga këto qëndrime të drejta. Më kot u lodh Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, nëpërmjet shokut Suslov, të na bindte ne që në raportin e Kongresit tonë III, që u mbajt në maj 1956, të zhduknim çështjen e Koçi Xoxes, që do të thoshte të mohonim luftën dhe qëndrimet tona parimore.

Në Shqipëri titistëve u hasi sharra në gozhdë, ose, si thotë Titoja, «Shqipëria iu bë ferrë në këmbë» dhe natyrisht grupi tradhtar titist e vazhdoi luftën kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe mendonte se na demaskonte duke na cilësuar «stalinistë».

Grupi i Beogradit s'na luftoi vetëm me propagandë, por ai vazhdoi spiunazhin, diversionin, komplotet, dërgimin e bandave të armatosura në vendin tonë dhe vepronte më fort se para vitit 1948. Këto janë të faktuara. Por tragjedia qëndron këtu, që Partia e Punës e

Shqipërisë, nga një anë, ishte në mbrojtje kundër sulmeve të ashpra dhe të paprera të revizionistëve jugosllavë, nga ana tjetër, qëndrimi i patundur, parimor, marksist-leninist i Partisë sonë ishte në kundërshtim me qëndrimet pajtuese që mbaheshin ndaj revizionistëve jugosllavë nga ana e udhëheqësve sovjetikë dhe e disa partive të tjera komuniste e punëtore.

Atëherë me të madhe thuhej e shkruhej se «Jugosllavia është një vend socialist dhe ky është një fakt», se «komunistët jugosllavë kanë një eksperiencë të madhe dhe merita të mëdha», se «eksperiencia jugosllave është e denjë për interesimin më të madh dhe për ta studjuar me vëmendje», se «periudha e grindjeve dhe e keqkuptimeve nuk ishte shkaktuar nga Jugosllavia dhe se i ishte bërë asaj një padrejtësi e madhe» etj. etj. Këto qëndrime, natyrisht, i dhanë zemër klikës së Titos, e cila kujtoi se çdo gjë e fitoi, vetëm se i kishte ngelur një «ferrë në këmbë», të cilën mendonte ta izolonte e pastaj ta likuidonte. Por jo vetëm nuk mundi ta izolojë e ca më pak ta likujdojë Partinë tonë, por përkundrazi koha vërtetoi se pikëpamjet e Partisë sonë, ishin të drejta.

Kundrejt Partisë sonë, për këtë qëndrim, janë bërë shumë presione. Udhëheqja shqiptare konsiderohej si «gjaknxehëtë», «kokëfortë», se «i ekzagjeronte» çështjet me Jugosllavinë, se i nxiste pa të drejtë jugosllavët etj. Në radhë të parë në këtë drejtim Partia jonë është sulmuar nga shoku Hrushov.

Më sipër unë përmenda shkurtimisht ç'bënë revizionistët jugosllavë kundër Partisë dhe vendit tonë në kohën e luftës, pas luftës, pas 1948-s, por do të ndalem pak edhe para kundërrevolucionit në Hungari, që është

vepra e agjentëve jugosllavë. Grupi tradhtar i Beogradit filloi organizimin e kundërrevolucionit edhe në Shqipëri. Sikur Partia jonë të kishte bërë gabimin e futjes në «vallen e pajtimit» me revizionistët jugosllavë, siç predikohej pas vitit 1955, atëherë demokracinë popullore të Shqipërisë do ta kishte marrë lumi. Ne, shqiptarët, nuk do të ishim sot këtu në këtë sallë, po do të luftonim ende nëpër male.

Partia dhe populli, në një unitet të çeliktë, qëndronin shumë vigjilentë dhe zbuluan e demaskuan spiunët e Titos në Komitetin tonë Qendror, që punonin në bashkëpunim me legatën jugosllave në Tiranë. Titoja u dërgoi lajm këtyre tradhtarëve, duke u thënë se ishin ngutur, se duhej të kishin pritur udhëzimet e tij. Këta spiunë e tradhtarë i dërguan letër edhe shokut Hrushov që të ndërhynte kundër Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Këto janë të faktuara me dokumente. Qëllimi i Titos ishte që kundërrevolucioni në Shqipëri të koordinohet me atë në Hungari.

Pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik do të mbahej Kongresi ynë III. Agjentura jugosllave mendoi se kishte ardhur çasti ta rrëzonte udhëheqjen «kokëfortë dhe staliniste shqiptare» dhe organizoi komplotin, i cili u zbulua dhe u dërrmua në Konferencën e Partisë në Tiranë, në prill 1956. Komplotistët morën dënimin e rreptë të merituar.

Agjentët e tjerë të rrezikshëm të Titos në Shqipëri, Dali Ndreu dhe Liri Gega, morën urdhër nga Titoja të arratiseshin në Jugosllavi se «ishin në rrezik» dhe se veprimet kundër Partisë sonë «duheshin organizuar nga territori jugosllav». Partia ishte plotësisht në dijeni

të veprimtarisë dhe të urdhrimit sekret të Titos. Ajo ishte vigjilente dhe i kapi tradhtarët mu në kufi, kur tentonin të arratiseshin. Tradhtarët shkuan në gjyq dhe u pushkatuan. E gjithë agjentura jugosllave që përgatiste kundërrevolucionin në Shqipëri u zbulua dhe u asgjësua. Për çudi, shoku Hrushov doli përpara nesh në mbrojtje të këtyre tradhtarëve dhe agjentëve jugosllavë: ai na akuzoi ne se gjoja kishim pushkatuar agjentin jugosllave, tradhtarin Liri Gega, «kur ajo ishte me barrë, gjë që nuk ndodhte as në kohë të carit dhe kjo kishte bërë figurë të keqe në opinionin botëror». Këto ishin shpifje të jugosllavëve, te të cilët shoku Hrushov kishte besim më shumë se te ne. Natyrisht ne i hodhëm poshtë këto insinuata të shokut Hrushov.

Por s'mbaroi me kaq qëndrimi jo i drejtë, joparimor dhe jomiqësor i shokut Hrushov ndaj Partisë sonë dhe udhëheqjes së saj. Agjenti tjetër jugosllav dhe tradhtari i Partisë së Punës të Shqipërisë e i popullit shqiptar, Panajot Plaku, u arratis në Jugosllavi, u vu në shërbim të jugosllavëve. Ai organizonte emisionet armiqësore të radiostacionit të ashtuquajtur «Shqipëria socialiste». Ky tradhtar i shkroi letër renegatit Tito dhe shokut Hrushov dhe i kërkonte këtij të fundit që me autoritetin e tij ta likuidonte udhëheqjen e Shqipërisë, me Enver Hoxhën në krye, për arsye se ne qenkemi «antimarksistë», «stalinistë». Shoku Hrushov jo vetëm që s'u indinjua nga letra e këtij tradhtari, por ishte i mendimit që ai mund të kthehej përsëri në Shqipëri, me kusht që ne të mos i bënim asgjë, ose ai mund të shkonte që të gjente strehim politik në Bashkimin Sovjetik. Neve sikur na ranë muret e Kremlinit mbi krye,

pse s'mund ta imagjinonim kurrë që Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të arrinte deri atje sa të përkrahte agjentët e Titos dhe tradhiarët e Partisë sonë, kundër Partisë dhe popullit tonë.

Por kulmi i kundërshtimeve tona parimore për çështjen jugosllave me shokun Hrushov u arrit kur, përpara këmbënguljes sonë parimore për demaskimin e agjenturës titiste të Beogradit, ai u revoltua aq shumë, sa që gjatë bisedimeve zyrtare midis dy delegacioneve tona, në prill 1957, i inatosur, na tha: «Presim bisedimet, nuk mund të merremi vesh me ju. Ju kërkoni të na çoni në rrugën e Stalinit!».

Ne u revoltuam përpara një qëndrimi të tillë jomiqësor të shokut Hrushov, i cili kërkonte të priste bisedimet, që do të thoshte të acaronte marrëdhëniet me Partinë dhe me shtetin shqiptar për çështjen e tradhtarëve të marksizëm-leninizmit, grupit të Titos. Ne s'mund të ishim kurrsesi dakord për këtë çështje, por ne, që akuzohemi për gjaknxehësi, u treguam gjakftohtë, pse ishim të bindur se kishim ne të drejtë dhe jo shoku Hrushov, se vija që ndiqnim ne ishte e drejtë dhe jo ajo e shokut Hrushov, se vija jonë do të vërtetohej përsëri në jetë, siç u vërtetua shumë herë.

Kundërrevolucionin në Hungari është kryesisht vepër e titistëve, sipas mendimit tonë. Imperialistët amerikanë kishin te Titoja dhe renegatët e Beogradit, në radhë të parë, armën më të mirë për të shkallmuar demokracinë popullore në Hungari.

Pas vajtjes së shokut Hrushov në Beograd, më 1955, veprimtaria minuese e Titos u la pas dore. Orga-

nizimi i kundërrevolucionit në Hungari nuk plasi papritur e pakujtuar; ai u përgatit, mund të themi, fare hapur dhe sheshit dhe do të jetë e papranueshme të na bindë ndokush se ky kundërrevolucion u organizua në fshehtësinë më të madhe. Kundërrevolucioni u përgatit nga agjencia e bandës së Titos në bashkëpunim me tradhtarin Imre Nagi, në bashkëpunim me fashistët hungarezë dhe të gjithë këta vepronin hapur nën drejtimin e amerikanëve.

Titistët, që ishin kryesorët, kishin në plan që Hungaria të shpërbëhej nga kampi ynë i socializmit, të shndërrohej në një Jugosllavi të dytë, të lidhej me aleancë me NATO-n nëpërmjet Jugosllavisë, Greqisë dhe Turqisë, të merrte ndihma nga Amerika dhe të vazhdonte luftën, tok me Jugosllavinë, nën drejtimin e imperializmit, kundër kampit të socializmit.

Haptas punonin kundërrevolucionarët në Hungari. Por si nuk ra në sy veprimtaria e tyre? Ne nuk mund të kuptojmë si është e mundur që në një demokraci popullore motër si Hungaria, ku në fuqi ishte partia, e cila kishte në dorën e saj armët e diktaturës, ku ishte edhe Ushtria Sovjetike, të vepronin kaq lirisht, siç vepruan, Titoja dhe bandat hortiste.

Ne mendojmë se qëndrimet e shokut Hrushov dhe të shokëve të tjerë sovjetikë ndaj Hungarisë nuk kanë qenë të qarta, pse pikëpamjet e tyre shumë të gabuara që kishin ata për bandën e Beogradit nuk i linin t'i shikonin drejt këto çështje.

Shokët sovjetikë kishin besim te Imre Nagi, njeriu i Titos. Këtë ne nuk e themi kot dhe pa baza. Para se të bëhej kundërrevolucioni dhe kur në klubin «Petëf»

po ziente kazani, unë kalova nga Moska dhe në bisedë me shokun Suslov i thashë çka pashë duke kaluar në Budapest, i thashë gjithashtu se revizionisti Imre Nagi po ngre krye dhe po organizon kundërrevolucionin në klubin «Petëf». Shoku Suslov ma kundërshtoi kategorikisht pikëpamjen time dhe për të më provuar mua se Imre Nagi është njeri i mirë më nxori nga sirtari «autokritikën e freskët të Imre Nagit». Megjithatë i thashë shokut Suslov se Imre Nagi është tradhtar.

Ne na çudit dhe bëjmë pyetjen legjitime: Pse shoku Hrushov dhe shokët sovjetikë shumë herë shkuan në Brioni për të biseduar me renegatin Tito për çështjen e Hungarisë? Në qoftë se shokët sovjetikë kishin dijeni se titistët po përgatitnin kundërrevolucionin në një vend të kampit tonë, a u lejohet udhëheqësve të Bashkimit Sovjetik të venë të bisedojnë me një armik, që organizon komplete dhe kundërrevolucione në vendet socialiste?

Është e drejtë që, si Parti komuniste, si shtet i demokracisë popullore, si anëtar i Traktatit të Varshavës dhe pjesëtar i kampit të socializmit të kërkojmë nga shoku Hrushov dhe shokët sovjetikë, të na thonë pse gjithë këto mbledhje me Titon në Brioni në vitin 1956, me këtë tradhtar të marksizëm-leninizmit dhe asnjë mbledhje me vendet tona, asnjë mbledhje të pjesëmarrësve të Traktatit të Varshavës?

Me ndërhy, apo mos me ndërhy me armë në Hungari ne mendojmë se nuk është vetëm në kompetencën e një personi; derisa kemi krijuar Traktatin e Varshavës, duhet të vendosim bashkërisht, pse atëherë është bajate të flasim për aleancë, për kolegjalitet, për

bashkëpunim në mes partive. Kundërrevolucionit në Hungari i kushtoi gjak kampit tonë, i kushtoi gjak Hungarisë dhe Bashkimit Sovjetik.

Si u lejua të derdhej ky gjak dhe s'u morën masat që më parë? Ne jemi të mendimit se asnjë masë nuk mund të merrej më parë, derisa te organizatori i kundërrevolucionit në Hungari, tradhtari Tito, tregohej besim nga shoku Hrushov dhe shokët sovjetikë i nënvleftësonin kaq keq mbledhjet e rregullta të domosdoshme të miqve, të aleatëve të tyre, sa vendimet e veta të njëanshme për çështjet që na përkitnin të gjithëve, i quanin si të vetmet të drejta dhe as peshonin fare punën dhe vendimet kolegjiale.

Partia e Punës e Shqipërisë nuk është aspak e qartë për këtë çështje, si janë zhvilluar dhe si janë vendosur gjërat. Në një kohë kur titistët bisedojnë në Brioni me shokët sovjetikë, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, organizojnë në ethe kundërrevolucionin në Hungari dhe në Shqipëri, shokët sovjetikë as marrin mundimin më të vogël të vënë në korent udhëheqjen tonë se ç'po ngjet, se ç'masa mendohet të merren prej tyre, të paktën formalisht, si aleatë që jemi. Por këtu s'është çështje formale. Shokët sovjetikë e dinë fare mirë ç'mendonte banda e Beogradit për Shqipërinë dhe ç'qëllime kishte. Me të vërtetë ky qëndrim i shokëve sovjetikë jo vetëm që është i dënueshëm, por edhe i pakuptueshëm.

Hungaria ishte një mësim i madh për ne, për çka u bë, për çka u luajt në skenë e në prapaskenë. Pas kundërrevolucionit në Hungari ne besonim se ishte më se e qartë tradhtia e Titos dhe e bandës së tij. Ne dimë se shumë dokumente mbahen në sirtare dhe nuk hidhen

në dritë, dokumente që demaskojnë veprimtarinë barbare të grupit të Titos në çështjen hungareze. Pse ngjet kjo, nuk e kuptojmë. Çfarë interesash fshihen prapa këtyre dokumenteve, që nuk hidhen në dritë, por ruhen fort në sirtare? U kërkuan dhe u zbuluan dokumentet më të vogla, për të dënuar pas vdekjes shokun Stalin, ndërsa dokumentet për të demaskuar këtë tradhtar të poshtër, siç është Titoja, po mbahen në sirtare.

Por edhe pas kundërrevolucionit në Hungari lufta politike dhe ideologjike kundër bandës titiste, në vend që të shkonte kreshendo, ashtu siç e lyp marksizëm-leninizmi, shkoi duke u shuar, shkoi drejt ripajtimit, drejt buzëqeshjeve, drejt kontakteve, drejt zbutjes, gati drejt puthjes. Në fakt, titistët nga ky qëndrim oportunist, e kapërcyen edhe këtë hendek.

Partia e Punës e Shqipërisë ishte në kundërshtim me vijën që ndiqte shoku Hrushov dhe shokët e tjerë ndaj revizionistëve jugosllavë. Lufta e Partisë sonë kundër revizionistëve vazhdoi edhe më me forcë. Shumë miq dhe shokë, në radhë të parë shokët sovjetikë dhe shokët bullgarë, në pamundësi të sulmonin vijën tonë të drejtë, na tallnin, buzëqeshnin dhe në kontaktet miqësore me titistët kudo izolonin njerëzit tanë.

Ne shpresonim se pas Kongresit VII titist edhe qorrat, pa le marksistët, do të shihnin me kë kishin të bënin dhe çfarë duhej të bënin. Mjerisht kjo s'ngjau kështu. Nuk shkoi shumë kohë dhe pas Kongresit VII titist demaskimi i revizionizmit u zbut. Revistat teorike sovjetike flitnin për çfarëdo revizionizmi, edhe për revizionizmin në Honolulu, por për revizionizmin jugosllav flitnin pak. Kësaj i thonë mos shikoni ujkun

që kemi përpara, por kërkonte gjurmët. Dolën parullat «Të mos flasim më për Titon dhe grupin e tij, se u rritet mendja», «Të mos flasim më për Titon dhe grupin e tij, se i bëjmë dëm popullit jugosllav», «Të mos flasim për renegatët titistë, se Titoja i përdor fjalët tona për të mobilizuar popullin jugosllav kundër kampit tonë» etj. Mjaft parti i adoptuan këto parulla, kurse Partia jonë jo, dhe ne mendojmë se vepruam drejt.

Situata u krijua e tillë që shtypi i vendeve mike pranonte artikuj nga njerëzit shqiptarë, por vetëm pa përmendur emrin e revizionistëve jugosllavë. Kudo në vendet e demokracisë popullore të Evropës, me përjashtim të shokëve çekoslovakë, të cilët i kanë gjukuar në përgjithësi drejt veprimet tona, ambasadorët tanë tërthorazi u izoluan, pse diplomatëve të vendeve mike u pëlqente muhabeti me diplomatët titistë, kurse tanët i urrenin dhe s'donin as t'i shikonin me sy.

Dhe çështja arriti deri atje, sa shoku Hrushov kondicionoi ardhjen e tij në Shqipëri, në maj të 1959-s, në krye të delegacionit të partisë dhe të qeverisë sovjetike, me çështjen jugosllave. Fjala e parë e shokut Hrushov në fillimin e bisedimeve në Tiranë ishte të lajmëronte të gjithë mbledhjen se ai nuk do të fliste kundër revizionistëve jugosllavë, gjë për të cilën as që e detyronte kush dhe me një thënie të tillë donte të tregonte hapur mospajtimin e tij në këtë çështje me Partinë e Punës të Shqipërisë.

Ne e respektoam dëshirën e mikut, derisa qëndroi në Shqipëri, pavarësisht nga shtypi titist, i cili u gëzua pa masë dhe s'mungoi të thoshte se Hrushovi ua mbylli gojën shqiptarëve. Kjo në fakt i përgjigjej realitetit,

por shoku Hrushov ishte shumë larg të na mbushte mendjen për këtë çështje, dhe titistët e mësuan fare qartë se, pas ikjes së mikut nga vendi ynë, Partia e Punës e Shqipërisë s'ishte më e lidhur me konditat që na vuri miku dhe vazhdoi rrugën e vet marksiste-leniniste.

Shoku Hrushov, në bisedimet që ka bërë me Vukmanoviç Tempon, në mes të të tjerave, i ka barazuar qëndrimet tona, nga pikëpamja e tonit, si të njëllojta me ato të jugosllavëve dhe nuk ka qenë dakord me tonin e shqiptarëve. Ne e konsiderojmë të gabuar dhe të dënueshme thënien e shokut Hrushov Vukmanoviç Tempos, armik i marksizmit, i kampit të socializmit dhe i Shqipërisë. Ne themi «ajo mushkë ato dru do» dhe ne nga ana jonë nuk jemi dakord me tonin pajtues të shokut Hrushov ndaj revizionistëve. Populli thotë se përpara armikut ngrihet toni, përpara së dashurës del mjaltë nga goja.

Disa shokë që mendojnë gabim, pretendojnë se ne mbajmë këto qëndrime ndaj titistëve, ngaqë gjoja dashkemi të mbajmë flamurin e luftës kundër revizionizmit, ose ngaqë e shohim këtë problem ngushtë, nga pikëpamja thjesht nacionale, prandaj qenkemi futur, në mos në «rrugën shoviniste», të paktën në atë të «nacionalizmit të ngushtë». Partia e Punës e Shqipërisë çështjen e revizionizmit jugosllav e ka parë dhe e sheh nën prizmin e marksizëm-leninizmit, e ka parë, e sheh dhe e lufton si rrezikun kryesor për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, si rrezik për unitetin e kampit socialist.

Por ne, duke qenë internacionalistë, jemi njëkohësisht edhe komunistë të një vendi të caktuar, të

Shqipërisë. Ne, komunistët shqiptarë, nuk do të queshim komunistë, në qoftë se nuk do të mbronim me konsekuencë dhe më vendosmëri lirinë e atdheut tonë të shtrenjtë nga komplotet dhe sulmet diversioniste të klikës revizioniste të Titos, të cilat synojnë invadimin e Shqipërisë dhe që tashmë njihen mirë nga të gjithë. A mundet dhe a është e lejueshme që ne, komunistët shqiptarë, ta lëmë vendin tonë që të bëhet gjahu i Titos, i amerikanëve, i grekëve, apo i italianëve? Jo, kurrë!

Disa të tjerë na këshillojnë të mos flasim kundër jugosllavëve; ata thonë «Pse keni frikë? Ju ju mbron Bashkimi Sovjetik». Ne u kemi thënë dhe u themi këtyre shokëve se s'kemi frikë as nga trockistët jugosllavë, as nga kurrkush. Ne jemi marksistë-leninistë, luftën kundër revizionistëve dhe imperialistëve për asnjë çast nuk duhet ta dobësojmë, derisa t'i zhdukim. Se që të të mbrojë Bashkimi Sovjetik, duhet më parë të mbrohesh vetë.

Jugosllavët na akuzojnë se gjoja ne jemi «shovinistë, ndërhyjmë në punët e tyre të brendshme dhe kërkojmë rektifikimin e kufijve shqiptaro-jugosllavë». Mjaft nga miqtë tanë mendojnë dhe lënë të kuptohet se ne, komunistët shqiptarë, jemi në këto ujëra. Ne u themi miqve që mendojnë kështu se gabohen rëndë. Ne s'jemi shovinistë, ne as kemi kërkuar dhe as kërkojmë rektifikim kufijsh. Por ajo që ne kërkojmë dhe do të kërkojmë vazhdimisht nga titistët dhe për të cilën do t'i demaskojmë ata deri në fund është të heqin dorë nga krimi i genocidit kundër popullsisë shqiptare të Kosovës, të heqin dorë nga terrori i bardhë kundër

shqiptarëve të Kosovës, të heqin dorë nga dëbimi i shqiptarëve nga tokat e tyre dhe dërgimi në masë i shqiptarëve në Turqi; ne kërkojmë që popullsisë shqiptare në Jugosllavi t'i njihen të drejtat, në bazë të kushtetutës së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë. Shoviniste është kjo kërkesë apo marksiste?

Këto janë pozitat tona në këtë çështje. Por në rast se titistët, nga njëra anë, flasin për bashkekzistencën, për paqen, për marrëdhënie të fqinjësisë së mirë dhe, nga ana tjetër, organizojnë komplete, organizojnë ushtri mercenarësh dhe fashistësh në Jugosllavi për të sulmuar kufijtë tanë dhe për të copëtuar së toku me Greqinë monarko-fashiste Shqipërinë tonë socialiste, atëherë të jeni të bindur se jo vetëm populli shqiptar i Shqipërisë së re do të ngrihet me armë në dorë, por me armë në dorë do të ngrihen edhe një milion shqiptarë që jetojnë nën robërinë titiste, për t'i ndalur dorën kriminelit. Dhe kjo është marksiste dhe kështu do të bëhet, po të ngjasë gjëkafshë. Partia e Punës e Shqipërisë nuk lejon kërkend të luajë ose të bëjë politikë me të drejtat e popullit shqiptar.

Ne nuk ndërhyjmë në punët e brendshme të të tjerëve, por, kur, si rezultat i zbutjes së luftës kundër revizionistëve jugosllavë, arrin puna që në një vend mik si Bullgaria të shtypet harta e Ballkanit, duke përfshirë Shqipërinë brenda kufijve të Jugosllavisë Federative, nuk mund të rrimë pa folur. Na thuhet se kjo ndodhi për gabimin teknik të një nëpunësi, po pse këto nuk ndodhën më parë?

Po: ky s'është një rast i izoluar. Në një miting në Sremska Mitrovica, banditi Ranković e sulmoi si zako-

nisht Shqipërinë duke e quajtur atë «një skëterrë, ku mbretëron teli me gjemba dhe çizmja e kufitarit» dhe duke thënë se demokracia e neofashistëve italianë është më e përparuar nga ajo jona.

Fjalët e Rankoviçit s'do të kishin asnjë rëndësi për ne, por këto fjalë i dëgjuan me serenitetin më të madh, pa bërë as protestën më të vogël ambasadori sovjetik dhe ambasadori bullgar në Beograd, që asistonin në këtë miting. Ne protestuam shoqërisht për këtë pranë komiteteve qendrore të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Komuniste Bullgare.

Shoku Zhivkov, në letërpërgjigjen që i drejton Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, ka guximin ta hedhë poshtë protestën tonë dhe ta quajë fjalimin e banditit Rankoviç si pozitiv. Ne nuk mund të imagjinonim kurrë që Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë të quajë si pozitiv fjalimin e një banditi si Rankoviçi, që fyen kaq rëndë Shqipërinë socialiste duke e cilësuar si skëterrë. Ne jo vetëm e hedhim poshtë me përbuzje këtë fyerje të palejueshme të Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë, por jemi plotësisht të bindur se do të revoltohej pa masë Partia Komuniste e Bullgarisë dhe populli heroik bullgar, po ta merrte vesh një gjë të tillë. Në qoftë se lejojmë gabime të tilla të rënda ndaj njëri-tjetrit, atëherë punët nuk do të shkojnë mirë.

Ne nuk mund të jemi kurrsesi dakord me shokun Hrushov, dhe këtë protestë ia bëmë atij në kohën e duhur, për bisedimet që ai pati me Sofokli Venizellosin në lidhje me minoritetin grek në Shqipëri. Shoku Hru-

shov e di se kufijtë e Shqipërisë janë të paprekshëm dhe të shenjtë; kush i prek ata është agresor. Populli shqiptar do të derdhë gjak, po t'ia prekë kush kufijtë. Shoku Hrushov gaboi rëndë kur i tha Venizellosit se ai pa në Korçë grekët dhe shqiptarët që punonin si vëllezër. Në Korçë s'ka fije minoriteti grek, por ka lakmi shekullore të grekëve për krahinën e Korçës, si për gjithë Shqipërinë. Një minoritet shumë të vogël grek ka në Gjirokastër. Shoku Hrushov e di se ata kanë të gjitha të drejtat, kanë gjuhën greke, shkollat greke dhe veç këtyre po ato të drejta që kanë edhe të gjithë nënshtetasit e tjerë shqiptarë.

Rivendikimet e grekëve, midis të cilëve edhe të Sofokli Venizellosit, birit të Elefter Venizellosit, vrasësit të shqiptarëve, djegësit të krahinave shqiptare të Jugut, shovinistit më të tërbuar grek dhe babait të megaliidhësë greke, të copëtimit të Shqipërisë dhe të aneksimit të saj nën parullën e autonomisë, janë të njohura fare mirë. Shoku Hrushov e njeh fare mirë qëndrimin e Partisë së Punës të Shqipërisë, të Qeverisë Shqiptare dhe të popullit shqiptar për këtë çështje. Atëherë të mos i përgjigjesh, siç e meriton, t'i lësh shpresa e iluzione dhe t'i thuash se do t'u transmetoj shokëve shqiptarë dëshirat e një agjenti anglez, të një shovinisti, të një armiku të komunizmit dhe të Shqipërisë, kjo është e papranueshme nga ne dhe është e dënueshme.

Ne ia dhamë përgjigjen Sofokli Venizellosit, shoku Hrushov, dhe me anën e shtypit besojmë se ke marrë dijeni. Ne s'jemi në kundërshtim të bëni politikë me Sofokli Venizellosin, por me kufijtë dhe të drejtat tona duhet të mos bëni politikë, pse ne as kemi lejuar, as

do të lejojmë. Dhe për këtë nuk jemi nacionalistë, por internacionalistë.

Dikush mund t'i gjykojë këto që them unë si gjëra pa vend, si deklarata që s'janë në lartësinë e mbledhjes. Nuk do të ishte rëndë për mua të ndërtoja një fjalim gjoja me ton teorik, të thoshja fjalë dhe citate të përgjithshme, t'ju bëja një referat të përgjithshëm, t'ju bëja qejfin dhe të shkoja radhën. Por Partisë së Punës të Shqipërisë i duket se s'është rasti i tillë. Këto që thashë dikujt mund t'i duken si sulme, por këto janë kritika që kanë ndjekur rrugën e tyre normale, që janë bërë më parë kur duhej dhe ku duhej, brenda normave leniniste, por tani që gabimet po trashen, do të jetë gabim të heshtësh, se qëndrimet, veprat, praktikat, vërtetojnë, pasurojnë dhe krijojnë teorinë.

Sa shpejt u organizua Mbledhja e Bukureshtit dhe sa shpejt u dënua Partia Komuniste e Kinës për «dogmatizëm»! Por pse vallë s'është organizuar shpejt edhe një konferencë për të dënuar revizionizmin?

Por revizionizmi a mos vallë është demaskuar krejtësisht, siç pretendojnë shokët sovjetikë? Në asnjë mënyrë jo. Revizionizmi ka qenë dhe është rrezik kryesor, revizionizmi jugosllav nuk është likuiduar dhe, kështu si po sillemi ndaj tij, atij i lihet fushë e gjerë veprimi në të gjitha format.

Por vallë në partitë e tjera nuk ka shfaqje shqetësuese të revizionizmit modern? Kush thotë jo, mbyll sytë përpara këtij rreziku dhe një mëngjes do të na ngjasin të papritura. Ne, jemi marksistë, ta analizojmë punën tonë ashtu siç na mësonte dhe si vepronte Lenini. Ai s'kishte frikë nga gabimet, ai i shikonte në sy dhe i

korrigjonte ato. Kështu u kalit Partia Bolshevike, kështu janë kalitur edhe partitë tona.

Ç'po ngjet në gjirin e partive tona? Ç'po ngjet në kampin tonë që pas Kongresit XX? Shoku Suslov mund të jetë shumë optimist, siç u shpreh ai në komisionin e tetorit, duke akuzuar delegacionin e Partisë së Punës të Shqipërisë, shokun Hysni Kapo, për pesimizëm në vështrim të ngjarjeve. Ne, komunistët shqiptarë, nuk kemi qenë pesimistë as në kohët më të errëta të historisë së Partisë dhe të popullit tonë dhe as do të jemi kurrë, por realistë do të jemi kurdoherë.

Shumë fjalë thuhën për unitetin tonë. Ky është i domosdoshëm dhe duhet të luftojmë ta forcojmë, ta kalitim. Por fakt është që ne për shumë çështje të rëndësishme parimore nuk kemi unitet.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se duhet të rishikohen çështjet në dritën e analizës marksiste-leniniste dhe të ndreqen gabimet ku janë. Le të marrim çështjen e kritikës ndaj Stalinit dhe veprës së tij. Partia jonë, si Parti marksiste-leniniste, është plotësisht e ndërgjegjshme se kulti i individit është një shfaqje e huaj dhe e dëmshme për partitë dhe për vetë lëvizjen komuniste. Partitë marksiste jo vetëm nuk duhet të lejojnë zhvillimin e kultit të individit, i cili frenon aktivitetin e masave, mōhon rolin e tyre, është në kundërshtim me zhvillimin e vetë jetës së partisë dhe të ligjeve që e rregullojnë atë, por duhet të luftojnë me të gjitha forcat për ta shkullur nga rrënjët, kur ky nis e shfaqet ose është shfaqur në një vend. Në këtë prizëm ne jemi plotësisht dakord që duhej kritikuar kulti i individit të Stalinit si shfaqje e dëmshme në jetën e

partisë. Por, sipas mendimit tonë, Kongresi XX dhe veçanërisht raporti sekret i shokut Hrushov çështjen e shokut Stalin nuk e shtroi drejt dhe në mënyrë objektive marksiste-leniniste.

U dënua rëndë dhe pa të drejtë Stalini për këtë çështje nga shoku Hrushov dhe nga Kongresi XX. Shoku Stalin dhe veprimtaria e tij nuk i përket vetëm Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe popullit sovjetik, por na përket të gjithëve. Ashtu sikundër shoku Hrushov e shtroi çështjen në Bukuresht, se mosmarrëveshjet nuk janë në mes të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, por janë në mes të Partisë Komuniste të Kinës dhe komunizmit ndërkombëtar, ashtu sikundër i pëlqen të thotë se vendimet e Kongresit XX dhe XXI u adoptuan nga të gjitha partitë komuniste dhe punëtore të botës, ashtu duhet të jetë zemërgjerë dhe konsekuent për gjykimin e veprimeve të Stalinit që të adoptoheshin me plot ndërgjegje nga partitë komuniste dhe punëtore të botës.

S'mund të ketë as dy masa, as dy pesha për këto çështje. Atëherë pse u dënua shoku Stalin në Kongresin XX pa u konsultuar më parë edhe me partitë e tjera komuniste dhe punëtore të botës? Pse përpara partive komuniste dhe punëtore të botës, papritur e pakujtuar, u hodh «anatema» kundër Stalinit dhe shumë parti mostra këtë gjë e morën vesh kur imperializmi shtypi raportin e fshehtë të shokut Hrushov me okë nëpër tregje?

Botës komuniste dhe botës përparimtare iu imponua dënimi i shokut Stalin nga shoku Hrushov. Çfarë

të bënin partitë tona në këtë situatë, kur papritmas, duke përdorur autoritetin e madh të Bashkimit Sovjetik, u imponohej në bllok një çështje e tillë?

Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë në dilemë të madhe. Ajo s'ishte e bindur dhe s'do të jetë kurrë e bindur për çështjen e dënimit të shokut Stalin në atë mënyrë dhe në ato forma siç u bë nga shoku Hrushov. Partia jonë adoptoi formulimet e Kongresit XX në përgjithësi për këtë çështje, por megjithatë nuk u qëndroi caqeve të kufizuara nga ky kongres, ajo nuk iu përul shantazheve dhe frikësimeve që i bëheshin nga jash-të vendit.

Partia e Punës e Shqipërisë tregohej realiste në çështjen e Stalinit, tregohej e drejtë dhe mirënjohëse ndaj këtij marksisti të lavdishëm, që, sa qe gjallë ai, nuk doli asnjë «trim» nga ne ta kritikonte, por, kur vdiq, shumë baltë u hodh mbi të. U krijua e është krijuar një situatë e padurueshme që për një epokë të tërë të lavdishme të Bashkimit Sovjetik, që kur u mëkëmb shteti i parë socialist në botë, u forcua Bashkimi Sovjetik, u mposhtën me sukses komplotet imperialiste, u dërrmuan trockistët, buharinistët, kulakët si klasë, triumfoi ngritja e industrisë së rëndë, triumfoi kolektivizimi, me një fjalë Bashkimi Sovjetik u bë një fuqi kolosale që ndërtoi me sukses socializmin e që në Luftën e Dytë Botërore, luftoi me heroizëm legjendar dhe mposhti fashizmin, u krijua kampi i fuqishëm i socializmit etj. etj., pra në të gjithë këtë epokë të lavdishme të Bashkimit Sovjetik të mohohet roli udhëheqës i J.V. Stalinit.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se s'është e

drejtë, normale dhe marksiste që për të gjithë këtë epokë të shuhet emri dhe vepra e madhe e Stalinit, siç po bëhet. Veprën e mirë dhe të pavdekshme të Stalinit duhet ta mbrojmë të tërë, kush nuk e mbron, ai është oportunist dhe frikacak.

Shoku Stalin, si person dhe si udhëheqës i Partisë Komuniste Bolshevike, është njëkohësisht udhëheqësi më i shquar i komunizmit ndërkombëtar pas vdekjes së Leninit, që influençoi në mënyrë shumë pozitive dhe me autoritet të madh në konsolidimin dhe në zhvillimin e fitoreve të komunizmit në të gjithë botën. Gjithë veprat teorike të shokut Stalin janë një dëshmi e zjarrtë e besnikërisë së tij ndaj mësuesit gjenial, Leninit të madh dhe leninizmit.

Stalini luftoi për të drejtat e klasës punëtore dhe të punonjësve në të gjithë botën, ai luftoi me konsekuencë të madhe deri në fund për lirinë e popujve të vendeve tona të demokracisë popullore.

Duke e shikuar vetëm nga këto anë, Stalini i përket gjithë botës komuniste dhe jo vetëm komunistëve sovjetikë, u përket gjithë punonjësve të botës dhe jo vetëm punonjësve sovjetikë.

Sikur shoku Hrushov dhe shokët sovjetikë ta kishin shikuar këtë çështje në këtë frymë, do të ishin shmangur gabimet e mëdha që u bënë. Por ata e shikuan çështjen e Stalinit shumë thjesht dhe vetëm në prizmin e brendshëm të Bashkimit Sovjetik. Por, sipas mendimit të Partisë së Punës të Shqipërisë, edhe në këtë prizëm ata e shikuan në mënyrë të njëanshme, panë vetëm gabimet e tij, lanë gati krejt mënjanë veprimtarinë e tij të madhe, kontributin e tij të madh në forcimin e

Bashkimit Sovjetik, në kalitjen e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në ngritjen e ekonomisë së Bashkimit Sovjetik, të industrisë, të bujqësisë kolkoziane, në drejtimin e popullit sovjetik në fitoren e madhe mbi fashizmin gjerman.

A ka pasur gabime Stalini? Është e pashmangshme që në një periudhë kaq të gjatë, mbushur me heroizma, me përpjekje, me luftëra, me fitore, të mos kishte edhe gabime, jo vetëm personale të Josif Stalinit, por edhe të udhëheqjes si organ kolektiv. Cila është ajo parti dhe cili është ai udhëheqës që e quan veten të pagabueshëm në punën e vet? Kur bëhen kritika për udhëheqjen e sotme sovjetike, dhe shokët e udhëheqjes sovjetike na këshillojnë të shikojmë përpara, ata thonë ta lëmë mënjandë polemikën, por kur ishte puna për Stalinin, ata jo vetëm që nuk shkuan përpara, por u kthyen shumë, shumë prapa, për të gërmuar vetëm anët e dobëta të punës së Stalinit.

Kulti i individit të Stalinit duhej kapërcyer patjetër. Por a mund të thuhet, siç u tha, se Stalini është artizani vetë i këtij kulti të individit? Kulti i individit duhej kapërcyer patjetër, por a ishte nevoja dhe a ishte e drejtë që të arrihej deri atje, sa që kush përmendte emrin e Stalinit të treguhej menjëherë me gisht, kush përdorte një citat të Stalinit të shikohej me sy të shtrembër? Me shpejtësi dhe me zell disa i thyen statujat e Stalinit, ndërruan emrat e qyteteve që i kishin pagëzuar me emrin e tij. Po pse të shkojmë më tej? Në Bukuresht shoku Hrushov, duke iu drejtuar shokëve kinezë, u tha: «Po kapeni prej kalit të ngordhur», «Po

të doni, e jani merrni edhe koskat e tij». Këto gjëra thuheshin në adresë të Stalinit.

Partia e Punës e Shqipërisë deklaroi solemnisht se është kundër këtyre veprimeve dhe këtyre gjykimeve mbi veprën dhe personin e J. V. Stalinit.

Po pse u vunë në dukje këto çështje, shokë sovjetikë, në këtë mënyrë dhe në këto forma të shtrembra, kurse kishte mundësi edhe gabimet e Stalinit, edhe ato të udhëheqjes të viheshin në dukje si duhej, të ndreqeshin këto gabime, por të mos krijohet ajo tronditje e madhe që u krijua në zemrat e komunistëve të të gjithë botës, që vetëm ndjenja e disiplinës dhe autoriteti i Bashkimit Sovjetik i frenoi të buçitnin?

Shoku Mikojan na ka thënë se ne s'guxonim ta kritikonim shokun Stalin, sa ishte gjallë, se na priste kokën. Ne jemi të sigurt se shoku Hrushov kokën s'na e pret, po ta kritikojmë drejt.

Pas Kongresit XX ndodhën ngjarjet që dihen në Poloni, kundërrevolucioni ndodhi në Hungari, sulme filluan të bëhen kundër sistemit sovjetik, tronditje ngjanë në shumë parti komuniste dhe punëtore të botës dhe, më në fund, kjo që po ngjet.

Bëjmë pyetjen, përse ndodhën këto gjëra në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, në gjirin e kampit tonë pas Kongresit XX? Apo mos këto ngjasin pse udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë është sektare, dogmatike dhe pesimiste?

Ne duhet të na shqetësojë jashtëzakonisht një gjë e tillë dhe duhet t'i gjejmë burimin sëmundjes e ta shërojmë. Sigurisht, sëmundja nuk shërohet as duke i fërkuar krahët renegatit Tito, as duke shënuar në dekla-

ratë se revizionizmi modern është shpartalluar përfundimisht, siç pretendojnë shokët sovjetikë.

Autoriteti i leninizmit ka qenë dhe është vendimtar. Ai duhet të vendoset në atë mënyrë që të spastrojë kudo dhe në mënyrë radikale pikëpamjet e gabuara. Tjetër rrugë s'ka për ne, komunistët. Në qoftë se mund dhe duhet të thuhet drejt gjërat, ashtu siç janë, duhet të bëhet tani sa s'është vonë, në këtë mbledhje. Komunistët, mendojmë ne, duhet të flenë me ndërgjegje të qetë, të forcojnë unitetin marksist, por pa ruajtur rezerva, hatëre, mëri. Komunisti, ç'ka në zemër, ta thotë haptas dhe çështjet të gjykohen drejt.

Mund të ketë njerëz që të mos u pëlqejë çka thotë Partia jonë e vogël, mund të izolohet Partia jonë e vogël, mund t'i bëhen presione ekonomike vendit tonë, për t'i vërtetuar popullit tonë se udhëheqja e saj gjoja nuk bën, mund të sulmohet dhe po sulmohet Partia jonë, Mihail Suslovi e barazon Partinë e Punës të Shqipërisë me partitë borgjeze dhe udhëheqësit e saj me Kerenskin. Por kjo s'na frikëson. Jemi mësuar. Rankoviçi s'ka thënë më shumë për Partinë e Punës të Shqipërisë, Titoja na ka quajtur Gebelsë, por prapë ne jemi leninistë dhe ata janë trockistë, tradhtarë, shërbëtorë dhe agjentë të imperializmit.

Dëshiroj të theksoj se Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar e ka treguar me vepra sa e do, sa e respekton Bashkimin Sovjetik dhe Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe kur Partia e Punës e Shqipërisë kritikon veprimet e gabuara të disa udhëheqësve sovjetikë, kjo nuk do të thotë se ka ndryshuar pikëpamja dhe qëndrimi ynë. Ne, shqiptarët, kemi kurajën

marksiste t'i kritikojmë këta shokë, me ashpërsinë tonë marksiste ne u themi atyre çdo gjë në mënyrë shoqërore, ne u hapim zemrën sinqerisht, ua themi hapur çfarë mendojmë dhe hipokritë as kemi qenë dhe as do të jemi.

Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik do të na dojë, me gjithë ashpërsinë tonë që tregojmë, pavarësisht se mundet edhe të gabojmë, por për një gjë Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe partitë komuniste dhe punëtorë të botës nuk do të na dënojnë, për sinqeritetin tonë dhe që prapa krahëve nuk llomotitim ose që të 100 flamurëve nuk jemi.

Në fund dëshiroja të flitja pak mbi projektdeklaratën që na është paraqitur nga komisioni i redaktimit. Delegacioni ynë u njoh me këtë projekt dhe e studjoi atë me vëmendje. Në projektin e ri që na është paraqitur janë bërë mjaft ndryshime, në krahasim me variantin e parë të paraqitur nga delegacioni sovjetik, i cili u muar si bazë për punën e komisionit të redaktimit. Me ndryshimet që u bënë, projekti i ri është përmirësuar mjaft, janë forcuar shumë ide të rëndësishme, janë formuluar më drejt mjaft teza, u hoqën në shumicën dërrmuese aluzionet kundër Partisë Komuniste të Kinës.

Delegacioni i Partisë sonë në mbledhjen e komisionit të redaktimit bëri shumë vërejtje, të cilat pjesërisht u pranuan. Megjithëse për disa çështje të rëndësishme e parimore delegacioni ynë nuk ishte i mendimit që të mbeteshin në projekt, ai dha pëlqimin që ky dokument t'i paraqitej kësaj mbledhjeje, duke ruajtur të drejtën që të shfaqë mendimin e tij edhe një herë për të gjitha ato gjëra për të cilat ai nuk ishte dakord. Para së

gjithash ne mendojmë që ato pesë çështje që kanë mbetur të pakoordinuara duhet të zgjidhen, me qëllim që të nxjerrim një dokument të aprovuar nga të gjithë me unanimitet.

Ne mendojmë se është e nevojshme të dalë qartë në deklaratë ideja e Leninit, e shprehur kohët e fundit nga shoku Moris Torez, si dhe nga shoku Suslov në fjalimin e tij të mbledhjes së komisionit të redaktimit, se garanci absolute për ndalimin e luftës mund të ketë vetëm atëherë kur socializmi të ketë fituar në të gjithë botën ose të paktën në një sërë vendesh të tjera të mëdha imperialiste. Gjithashtu, duhet të hiqet paragrafi që flet për veprimtari fraksioniste e grupazhi në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, pasi kjo, siç e kemi shpjeguar edhe në mbledhjen e komisionit, nuk i shërben forcimit të unitetit, përkundrazi e minon atë. Ne jemi gjithashtu për heqjen e fjalëve ku flitet mbi kapërcimin e pasojave të dëmshme të kultit të individit, ose pas tyre të shtohen fjalët «që kishte vend në një sërë partish», gjë që i përgjigjet më mirë realitetit.

Për këto çështje dhe për vërejtjet e tjera që ne kemi për projektdeklaratën unë nuk dua t'i ha kohën mbledhjes. Vërejtjet tona konkrete delegacioni ynë do t'i bëjë kur të shqyrtohet vetë projekti i deklaratës.

Do të bëjmë mirë dhe do të jetë shpëtimtare që në këtë mbledhje t'i shohim me guxim në sy gabimet dhe të shërojmë plagët ku janë, sepse ka rrezik të majisen e të bëhen të rrezikshme. Ne nuk e quajmë fyerje kur shokët na kritikojnë me të drejtë dhe me fakte, por nuk do të pranojmë kurrsesi që të na quajnë pa fakte «dogmatikë», «sektarë», «nacionalistë të ngu-

shtë», vetëm sepse ne luftojmë me këmbëngulje kundër revizionizmit modern e veçanërisht kundër revizionizmit jugosllav. Në qoftë se ndokush luftën tonë kundër revizionizmit e quan dogmatizëm ose sektarizëm, ne i themi atij: hiq syzat revizioniste dhe do të shikosh më qartë.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se kjo mbledhje do të mbetet historike, pse do të jetë një mbledhje në traditën e mbledhjeve e të konferencave leniniste që ka organizuar Partia Bolshevike për të demaskuar dhe për të shfarosur nga rrënjët pikëpamjet e shtrembra, për të forcuar dhe për të çelikosur mbi bazën e marksizëm-leninizmit unitetin e lëvizjes sonë komuniste e punëtore ndërkombëtare. Partia jonë e Punës do të luftojë edhe në të ardhshmen me vendosmëri për të çelikosur unitetin tonë, lidhjet vëllazërore, veprimin e përbashkët midis partive komuniste e punëtore, sepse kjo është garancia e fitores së çështjes së paqes dhe të socializmit. . .

*Botuar për herë të parë në
«Dokumente kryesore të
PPSH», vëll. III, 1970, f. 414*

*Botohet me ndonjë shkurtim
sipas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

RADIOGRAM

SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË

30 nëntor 1960

Ora 10.^{40'}

Shoku Hysni,

Radiogramin e morëm. Në qoftë se hiqen nga projektdeklarata të gjitha ato që ju na shkruani në radiogram, shtohet propozimi kinez dhe ngelet vetëm Kongresi XX sipas Deklaratës së Moskës [1957], ju mund ta nënshkruani Deklaratën. Për këto çështje jini kurdoherë në akord të plotë me shokët kinezë. Në qoftë se duhet lëshuar deklaratë për mospranimin e vënies së Kongresit XX ose të formulimit sipas Mbledhjes së Moskës, bëj deklaratë me shkrim, dorëzoje dhe firmose Dokumentin e Mbledhjes.

Ne erdhëm mirë. Mbrëmë asistua në darkë në Pallatin e Brigadave. Entuziazëm i papërshkruar. Shokët janë mirë. Ramizit të fala. Ju presim.

Të përqafoj

E n v e r

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MIRËMBAJTJA E BANESAVE ËSHTË NJË ÇËSHTJE SHUMË SERIOZE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

10 dhjetor 1960

Problemi i ndërtimeve duhet të na preokupojë shumë. Le të marrim banesat shtetërore. Pa u futur në çështjen e ndërtimit, mirëmbajtja e tyre është një problem shumë serioz dhe duhet rishikuar me kujdes. Mendoj se puna për edukimin e njerëzve lidhur me mirëmbajtjen e banesave është shumë e dobët. Prandaj, në qoftë se nuk marrim masa praktike e konkrete për ta forcuar këtë punë, diskutimet tona dhe detyrat që shtrajmë janë pa efekt.

Këtu u ngrit çështja e lokaleve të kooperativave të artizanatit dhe u tha që këto, ose të jenë veç e veç, ose të jenë bashkë, të organizuara si një ent i fortë.

¹ Në këtë mbledhje u diskutua për gjendjen dhe për mirëmbajtjen e banesave në qytetin e Tiranës.

Kam mendimin se kjo çështje duhet studjuar se si është më mirë. Po ta kemi të organizuar mirë artizanatin, mendoj se mund të zgjatet shumë jeta e shtëpive shtetërore dhe e atyre private. Por, është e nevojshme që për shtëpitë shtetërore të bëhet nomenklatura. Kjo do të jetë një punë shumë më konkrete sesa shumë konferenca që zhvillohen e s'japin gjë. Një ent i organizuar, ka mundësi të ushtrojë kontroll në banesa për të parë çfarë meremetimesh duhen kryer dhe për disa meremetime si, për shembull, për thyerje xhamash, pllakash, prishje bravash etj., shpenzimet mund t'i ngarkohen qiramarrësit. Po kështu, kur ka raste, për shembull, që në shkallën e përbashkët të bancesës është thyer llamba elektrike dhe nuk ka dritë, ose parrmakët janë prishur etj. ndërmarrja e banesave, i ndreq me shpenzimet e saj dhe, në bazë të nomenklaturës, ua ngarkon këto shpenzime atyre që u takojnë ligjërisht. Po të bëhet kështu, do të shihet sa bukur do të mbahen banesat. Kështu do të aktivizohen edhe këshillat e ndërtesave të banimit, do të qortohen e do të këshillohen edhe kalamanët për të qenë të kujdesshëm. Duke bërë këto veprime, nuk duhen injoruar ato shërbime që duhen kryer nga shteti. Për shembull, herë pas here apartamentet duhen lyer edhe nga jashtë, por këto shpenzime nuk duhet t'i paguajnë qiramarrësit. Kjo arrihet në qoftë se edhe ndërmarrja e banesave forcon punën e saj, shërbimin, kontrollin për mirëmbajtjen e ndërtesave.

Është e domosdoshme ta shikojmë sa më mirë këtë organizim, t'i edukojmë kuadrot që të drejtojnë gjith-

një e më mirë, të punohet për edukimin e banorëve për të mirëmbajtur banesat. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe, sepse shumë banesa që ndërtojmë, po na prishen.

Tani të vijmë në çështjen e shtëpive private. Ky është një fond i madh. Shteti nuk ka interes që shtëpitë private të prishen, ai nuk ka mundësi t'i zëvendësojë ato brenda 15-20 vjetëve. Edhe pronarët e shtëpive private, me këto qira të vogla që janë te ne, nuk kanë interes t'i meremetojnë. Atëherë si duhet bërë? Lidhur me këtë, unë bisedova me Mehmetin që kjo çështje të shihet në Qeveri. Shteti, me përjashtim të barakave e të kasolleve, do të marrë përsipër të meremetojë shtëpitë private në bazë të kontratave dhe, një pjesë e qirasë do të kalojë në favor të shtetit, për të shlyer me afat të gjatë shpenzimet e tij, ndryshe ky fond do të shkatërrohet shpejt. Ne kemi interes ta bëjmë një gjë të tillë, sepse kështu zgjatet edhe jeta e shtëpive private. Këto meremetime, sigurisht, do të na kushtojnë 200-300 milion lekë në vit, prandaj tani për tani ne të marrim përsipër shtëpitë që janë më të mëdha, kurse për ndërtesat private, kur i zoti banon vetë në to, shteti nuk mund të marrë përsipër kryerjen e meremetimeve.

Lidhur me propozimet që u bënë këtu, për familjet e atyre që janë transferuar nga Tirana edhe unë mendoj që të merren masa. Ato të largohen, duke u dhënë 4-5 muaj afat. Në këtë drejtim nuk duhet hyrë në konsideracione, për këtë ose për atë kuadër. Është më mirë që gjithë familja të grumbullohet në një vend.

Për ata që janë të papashaportizuar të zbatohen rregullat dhe të largohen nga Tirana.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

ME SHUMË KUJDES PËR QARKULLIMIN E MONEDHËS

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

15 dhjetor 1960

Qarkullimi i monedhës është një çështje që ka rëndësi të dorës së parë për ne. Prandaj Partia duhet të bëjë shumë kujdes për këtë problem kaq të madh. Për të mos u rrezikuar monedha jonë është e domosdoshme të merren një sërë masash të forta për realizimin e planeve në cilësi dhe në kohë në sektorin e tregtisë, të krediteve etj. sepse të gjithë këta janë faktorë që ndihmojnë ose pengojnë qarkullimin monetar.

Por në këto çështje ka të meta serioze. Të marrim sektorin e tregtisë. Ka 7-8 muaj që ne duam të dimë

¹ Në këtë mbledhje u muar në shqyrtim relacioni mbi qarkullimin monetar, pagën reale të punëtorëve dhe nëpunësve, të ardhurat reale të fshatarësisë, për vitin 1959 dhe plotësimin e pritshëm të vitit 1960.

përse nuk realizohet xhiroja në këtë sektor dhe akoma nuk i dimë shkaqet. Na jepet një shpjegim me vitin e keq bujqësor. Natyrisht edhe kjo ka ndikuar, por nuk është i vetmi shkak, sepse në tregti ka edhe të meta të tjera serioze, sidomos në furnizim, në shpërndarjen e rrjetit të tregtisë, në specializimin e tij në ndarjen e mallrave, në dorëzimin e tyre nga furnitorët. Të gjitha këto e të tjera bëjnë të mos realizohet xhiroja.

Një tjetër problem i rëndësishëm lidhur me qarkullimin e monedhës, është edhe mbulimi i humbjeve nga ana e disa ndërmarrjeve. Me këtë mënyrë fshihen shumë gjëra që ndërmarrjet nuk i realizojnë. Kjo dëshmon se ministritë nuk tregojnë kujdes për ndërmarrje të tilla, për të parë me vëmendje humbjet e paplanifikuara në to dhe kur vjen fundi i drejtohen vazhdimisht Qeverisë t'u mbulojë humbjet. Qeveria duhet të jetë e rreptë në këtë drejtim, të mbulojë vetëm humbjet e atyre ndërmarrjeve, që arsyetohen me të vërtetë dhe të marrë masa kundër atyre ndërmarrjeve ose dikastereve, që kërkojnë padrejtësisht të mbulohen humbjet si dhe kundër atyre që shtojnë humbjet e planifikuara. Duhet kuptuar mirë se shtimi i humbjeve dëmton situatën tonë financiare.

Është e vërtetë se viti bujqësor sivjet ka qenë i keq. Shteti ka bërë mjaft favore për të lehtësuar fshatarësinë nga fatkeqësitë natyrore të këtij viti, sidomos duke mos i marrë detyrimet, duke i dhënë më shumë bukë etj. Natyrisht kjo për shtetin ka krijuar vështirësi, prandaj të shohim me kujdes nevojat e saj dhe t'u

japim bukë vetëm atyre fshatarëve që me të vërtetë u mungon.

Vështirësitë e këtij viti bujqësor i kanë shtuar forcat e punës të lira edhe me njerëz që vijnë nga fshati. Në këto kushte Qeveria, nëse e sheh të mundur, të investojë në kooperativat bujqësore fonde për ndërtim rrugësh, për ndërtim objektesh të reja etj., gjë që do t'u jepte mundësi njerëzve të dilnin më shumë në punë. Tani, për shembull, koha është shumë e përshtatshme për të hapur rrugë pyjore. Natyrisht, fshatarët duhet të shkojnë atje ku është puna. Këtë masë ne mund ta marrim. Por duhet mbajtur parasysh që të mos marrim punëtorë nga fshati dhe të harrojmë qytetet, se edhe këtu ka forca pune të lira.

Mua më duket se nuk ka shumë përpjekje në mes të Bankës së Shtetit dhe Ministrisë së Financave nga njëra anë dhe dikasterëve e ndërmarrjeve apo institucioneve nga ana tjetër. Kam përshtypjen se ka një farë pajtimi me të metat në këtë drejtim. Mos ka familjaritet midis tyre?

Për çështjen e lekut të popullit dhe për zbatimin e vendimeve të Qeverisë duhet të jemi shumë të rreptë. Mund të duket rreptësi nga ana e bankës për kreditet e ndërmarrjeve, të cilat mund të ankohen se nuk po u ecën puna, por në rast se kredia nuk i jepet një herë, dy herë, tri herë për faj të ndërmarrjes, kjo nuk është e rastit, por do të thotë se ndërmarrja e ka bërë vijë që nuk zbaton rregullat e caktuara të kreditit. Po të tregohet e rreptë banka, çdo ndërmarrje do të

vërë rregull në të gjitha drejtimet. Prandaj të jemi të rreptë në administrimin e parasë, pse mund të gjendemi në situata të vështira.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

DISA REKOMANDIME PËR SEKTORIN E NAFTËS

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

15 dhjetor 1960

Kisha edhe unë disa çështje për naftën, sidomos lidhur me gjendjen e krijuar. Në këto situata dhe me marrëdhëniet e tanishme që kemi me udhëheqësit sovjetikë është e domosdoshme që drejtuesve të ndërmarrjeve të naftës t'u bëjmë disa rekomandime, të cilat kanë karakter të rëndësishëm ekonomik dhe politik si për aktualitetin, ashtu dhe për perspektivën.

Byroja Politike ka theksuar kurdoherë se çështja e nxjerrjes së naftës ka rëndësi të jashtëzakonshme për ekonominë tonë. Prandaj si kurdoherë dhe sidomos akoma më shumë tani, ju, shokë drejtues të Kombinatit të Naftës, duhet t'u vini një rëndësi të veçantë zbulimit të fushave të reja të naftës dhe shfrytëzimit në mak-

¹ Në këtë mbledhje u diskutua materiali «Mbi rekomandimet kryesore të grupit të specialistëve sovjetikë mbi punimet e kërkimit për naftën» dhe relacioni «Mbi organizimin e kërkimeve të naftës».

simum të makinerive dhe të materialeve, duke filluar që nga sondat, tubat, energjia elektrike e kamionat dhe deri në pjesët më të vogla të tyre. Kësaj çështjeje duhet t'i kushtoni një rëndësi të jashtëzakonshme, sepse mund të gjendemi përpara vështirësive, mungesave ose vonesave lidhur me ardhjen e materialeve nga importi.

Makineritë dhe materialet që dispononi dhe ato që do të na vijnë, duhet të ruhen si sytë e ballit, t'i shfrytëzoni si jo më mirë, t'i mirëmbani që t'u zgjatet sa më shumë jeta, me qëllim që ne të mund të përballojmë të gjitha vështirësitë që mund të na dalin. Këtë e them për ju, se jeni kuadrot kryesorë të naftës dhe duhet t'i kuptoni mirë situatat në të cilat kalojmë. Në bisedimet që kemi zhvilluar në Moskë, jemi paralajmëruar se sovjetikët do të jenë jashtëzakonisht të shtrënguar me ne, sepse qëndrimi i Partisë sonë në Mbledhjen e Moskës atyre nuk u ka pëlqyer. Se si do të shfaqet nga ana e tyre kjo shtrëngesë, do ta shohim në jetë, po ne duhet të jemi të përgatitur dhe të armatosur që t'i përballojmë vështirësitë, sado të mëdha që të jenë. Në qoftë se ne ju kemi bërë lëshime, ose kritikën për këto çështje kanë qenë të rralla, për shembull për mungesa, për vonesa, për mosshfrytëzim të materialeve, për mosvlerësimin e tyre në kohë etj. etj., këtej e tutje do të jemi jashtëzakonisht të rreptë. Prandaj këtë ta keni parasysh edhe ju, shokë drejtues të naftës.

Çështja tjetër që kam për të theksuar, ka të bëjë me kërkimet dhe me shfrytëzimin. Edhe kjo është e lidhur me bashkëpunimin e specialistëve sovjetikë. Bashkëpunimi me specialistët sovjetikë të naftës nga ana jonë nuk duhet të ndryshojë nga e kaluara. Nga

kjo anë ne të jemi në rregull, nga vija e Partisë sonë në këtë drejtim të mos lëvizim asnjë milimetër. Është ndryshe, në qoftë se një ose dy prej specialistëve sovjetikë të naftës do të bëjnë tentativa të atakojnë ose të godasin vijën apo udhëheqjen e Partisë sonë; në këtë rast ju nuk duhet ta mbani gojën mbyllur. E them këtë se ka edhe specialistë sovjetikë që nuk punojnë mirë. Ju keni eksperiencën e atij specialisti sovjetik që drejtonte disa specialistë të tjerë, me të cilin keni rënë në kundërshtim me të drejtë, sepse ai nuk ishte njeri i mirë, mbillte disfatë në specialistët sovjetikë, u thoshte atyre se do të prishen marrëdhëniet me Shqipërinë, po e gjithë kjo punë dëmtonte ekonominë tonë, i çmbilizonte njerëzit e tyre dhe tanët dhe krijonte edhe situata të vështira politike. Kuadrot tanë duhet t'i hapin sytë mirë. Vigjilenca është kurdoherë e domosdoshme, jo vetëm ndaj specialistëve sovjetikë, po edhe ndaj cilitdo, sepse mund të ketë edhe në radhët e specialistëve tanë nga ata që gabojnë, bile mund të ndodhë që ndonjë të jetë edhe armik e të sabotojë, siç ka treguar eksperiencia.

Njerëz të tillë mund të fshehin edhe të dhënat, sidomos ato të perspektivës së naftës. Ne nuk mund të themi se kemi kuadro të mjaftueshëm, por tani në udhëheqje të Kombinatit të Naftës ne kemi një sërë inxhinierësh me eksperiencë të pasur dhe gjeologë. Por specialistët tanë gjeologë ose inxhinierë, duhet të perfeksionohen vazhdimisht, t'u punojë koka dhe të kenë besim te vetja, te njëri-tjetri. Kështu ne do të bëhemi të zotët e mallit të vendit tonë, duke dhënë mendime edhe për probleme të mëdha që preokupojnë sektorin

e naftës. I them këto, sepse ka specialistë ose gjeologë çekë që punojnë në vendin tonë, të cilët zbulojnë shtresa mineralesh, gjejnë në përbërjen e tyre edhe minerale të rralla të dobishme me një përqindje industriale të mjaftueshme, po i fshehin që të mos paguajnë diferencën e mineralit të rrallë të dobishëm. Kjo nuk është e ndershme. Prandaj drejtuesit e Kombinatit të Naftës, sidomos ata që janë specialistë, të jenë të zgjuar, të punojnë me mend në kokë dhe të mësojnë që perspektiva e naftës sonë të sqarohet si duhet.

Rezultatet në çështjen e shpimeve e të kërkimeve lënë shumë për të dëshiruar dhe në këtë drejtim ne nuk mund të përjashtojmë përgjegjësinë e specialistëve sovjetikë, të cilët ishin kryesorë në këtë çështje, sepse gjatë gjithë kësaj kohe shpim-kërkimet nuk na kanë dhënë asgjë. Pra ata janë përgjegjës, por përgjegjës janë edhe shokët tanë të naftës, që duhet të punojnë më me seriozitet, për të mirën e ekonomisë sonë.

Duke parë materialin e paraqitur, që është një situatë e dhënë nga ekipi i specialistëve sovjetikë, doja të theksoja disa gjëra. Cilat janë këto?

Çështja është që ju, drejtuesit e sektorit të naftës dhe të Ministrisë së Gjeologjisë e të Minierave, çështjen e shpim-shfrytëzimit dhe të kërkimeve duhet ta merrni në dorë më mirë se deri tani. Në radhë të parë ministrinë nuk duhet ta zërë gjumi, por të kontrollojë si duhet gjithë këtë punë serioze. Por edhe ju, shokë drejtues të Kombinatit të Naftës, duhet të jeni shumë më seriozë në detyrat tuaja dhe t'i shqyrtoni çështjet deri në detajet më të vogla, sepse çështja e nxjerrjes së naftës është një punë shkencore dhe jo rutine.

Prandaj, ju, që drejtoni punën në naftë, duhet ta ndiqni çështjen këmba-këmbës, që kërkimet nga të dyja anët të bëhen me përgjegjësinë më të madhe, sepse në këtë sektor investohen me miliarda dhe komprometohen planet tona. Ky kujdes duhet të jetë kurdoherë, por sidomos në situatën që ndodhemi.

Vija e Partisë sonë është e drejtë dhe ajo ka gjetur e do të gjejë aprovim në lëvizjen komuniste ndërkom-bëtare. Kjo vijë, në mos sot, nesër, do t'ua bëjë të gjithëve të qartë se udhëheqësit sovjetikë nuk janë në rregull me qëndrimet e tyre ndaj Partisë dhe ekonomisë sonë popullore.

Byroja Politike është dakord që ne kërkimet t'i zhvillojmë në zonën që na propozohet nga Ministria e Gjeologjisë dhe e Minerave. Unë do të isha i mendimit se detyrat e vëna për zonën e... janë të vogla, sepse ajo është një zonë më e komplikuar, me shtresa të thella gëlqerore. Në këtë zonë duhet t'i zhvilloni kërkimet, prandaj t'i vini një kujdes të madh, duke menduar perspektivën. Të keni parasysh se atje mund të ketë gjëra shumë interesante, prandaj të mos e lëmë pas dore, le të na thonë të tjerët se këto zona janë të vështira, të thella e të pastudjuara. Përkundrazi, kësaj detyre ne do t'i shkojmë deri në fund, sepse mund të gjejmë një pasuri të jashtëzakonshme. Prandaj kërkimet e naftës në..., sot për sot, të mos na preokupojnë shumë. Kjo të lihet për një perspektivë të largët. Detyra kryesore për ju të jetë ajo që thamë, këto zona të mos i lëmë pas dore.

Një çështje tjetër që dua të theksoj është ajo e pasurimit të puseve që po flenë dhe e ngritjes së pre-

sionit në to. Ne duhet të zbatojmë procedura të reja. Kjo është një punë e re, mjaft delikate, po e domosdoshme për t'u bërë, për të mbajtur presionin dhe për të pasuruar pusët, në mënyrë që të arrijmë shifrat e caktuara e bile t'i tejkalojmë ato.

Të merret me seriozitetin më të madh aplikimi i metodave sa më shkencore, të përgatiten sa më parë kuadro që këto metoda t'i vëmë sa më shpejt në zbatim, t'i bëjmë sa më pak të kushtueshme dhe t'i shfrytëzojmë me mjetet që disponojmë. Pra një nga faktorët për shtimin e naftës është edhe vënia në zbatim e metodave të reja, e cila duhet të merret më seriozisht.

Kini parasysh, shokë, çështjen e materialeve. Makineri e materiale do të kemi më tepër, po të jepni më shumë naftë. Me sa duket BS dhe vendet e demokracisë popullore të Evropës nuk do të na ndihmojnë si më parë, por do të na ndihmojë RP e Kinës. Prandaj kërkesat për materiale janë të lidhura proporcionalisht me dhënien e naftës. Po të na jepni naftë, do të kemi edhe sonda, po të ecim ngadalë, edhe materiale do të kemi më pak. Këtë, pra, ta keni mirë parasysh.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSII
që gjendet në AQP*

**LËVIZJA PËR SHPIKJE E PËR RACIONALIZIME,
KËRKON MË TEPËR PUNË IDEOPOLITIKE,
ORGANIZUESE E DREJTUESE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

16 dhjetor 1960

Siç dihet, Byroja Politike mori një vendim për zhvillimin e mëtejshëm të shpikjeve e të racionalizimeve. Ky vendim u kthye në ligj, me qëllim që të nxiste këtë lëvizje dhe të frenonte çdo abuzim. Ligji që doli është hartuar në detaje dhe është i drejtë. Në qoftë se lëvizja për shpikje e për racionalizime nuk po ecën si duhet, fajin nuk e ka ligji. Ligji edhe mund të ndryshohet, vendimet edhe mund të ndërrohen, por për këtë ligj është akoma herët të flasim, sepse jeta nuk e ka thënë fjalën e saj.

Ne nuk mund të ndryshojmë ligjin dhe vendimin e Byrosë Politike derisa nuk është punuar që t'i sillen

¹ Në këtë mbledhje u muar në shqyrtim problemi mbi gjendjen e shpikjeve e të racionalizimeve.

Byrosë Politike mendime, se ç'tregon praktika, sa e ka vërtetuar jeta drejtësinë ose jo të këtij ligji apo të një dispozite të tij. Është e qartë se komisionet e shpikjeve e të racionalizimeve nuk kanë vepruar kudo si duhet për t'i dhënë hov zhvillimi kësaj lëvizjeje të madhe. Në rast se nuk punojnë si duhet komisionet në qendrat e punës, ne mund të bëjmë shumë fjalë, por pa rezultate. Edhe organizatat e Partisë e ato të bashkimeve profesionale nuk e kanë marrë seriozisht këtë çështje kaq të rëndësishme. Prandaj drejtuesit, njerëzit më me përgjegjësi dhe me kompetenca, shokët që janë më të pregtatur nga ana politike, ideologjike e morale, të punojnë me ata punëtorë, teknikë e inxhinierë që nuk e kanë kuptuar mirë detyrën e tyre në lëmin e shpikjeve e të racionalizimeve. Duke qenë se kjo punë s'është bërë si duhet, kritika më e rëndë duhet t'u drejtohet shokëve më me përgjegjësi.

Zhvillimi i shpikjeve e i racionalizimeve nuk ka vetëm karakter ekonomik, por edhe politik e moral, prandaj këto anë duhen kuptuar mirë nga masa e punëtorëve, e teknikëve dhe e inxhinierëve. Është e rëndësishme të kuptohet që vendimi i Byrosë Politike dhe ligji janë të drejtë dhe kanë për qëllim të shpjen përpara shpikjet e racionalizimet duke u vënë fre abuzimeve që janë bërë e që mund të bëhen në këtë fushë. Prandaj, si kundërpeshë të ngrihet ndërgjegjja e njerëzve për të bërë shpikje e racionalizime, natyrisht jo për të marrë lekë, por për të ndihmuar më shumë në rritjen e mirëqenies së përgjithshme të popullit. Njëkohësisht interesi material të vihet në rrugë të drejtë socialiste. Por duhet parë më shumë e në radhë të

parë interesi i përgjithshëm shoqëror. Kjo do të thotë që të punohet për t'i kursyer sa më tepër ekonomisë me anë të shpikjeve e të racionalizimeve dhe, në këtë kuadër, të shihet edhe interesi personal i punëtorëve, i teknikëve e i inxhinierëve.

Ministritë, Komisioni i Planit të Shtetit dhe deri komisionet për shpikje e për racionalizime pranë ndërmarrjeve, duhet të shkunden dhe të nxjerrin mësimë për të interpretuar drejt ligjet. E them këtë sepse ligji nuk duhet interpretuar në mënyrë automatike, por mobilizuese, krijuese. Nuk duhet parë vetëm si pasqyrohet në ligj stimuli material për shpikje e për racionalizime, por në radhë të parë ana morale, patriotike, psikologjike. Të punohet që njerëzve t'u dalë emri në shtyp, në radio, në mbledhje, t'u akordohen medalje, të nxiten moralisht. Njerëzit tanë janë patriotë dhe bëjnë mrekullira. Të popullarizohen më gjerë rezultatet dhe eksperiencat e tyre. Të gjithë nxiten shumë, kur shohin se propozimi që kanë bërë, po vihet në jetë. Kur njeriu sheh se po inkurajohet, ndien satisfaksion.

Te ne s'duhet të ndodhë që racionalizimi, kur është me të vërtetë i tillë, të trajtohet si zbatim i një detyre të planit, ashtu siç nuk duhet të ndodhë që edhe kryerja e një detyre të planifikuar të quhet padrejtësisht racionalizim. Ligji mund të ketë ndonjë dispozitë edhe të ngurtë ose ndonjë përkufizim mund të mos jetë shumë i goditur, por kjo s'duhet të presë hovin e njerëzve për shpikje e për racionalizime. Çështjet e ligjit dhe të jetës t'i interpretojmë kurdoherë drejt dhe njerëzit të marrin atë që u takon. Është thënë të mos jepen shpërblime pa kriter, kur ndonjeri s'e meriton, por jo të kalohet

në ekstrem, duke i ngrënë hakën edhe atij të cilit i përket e drejta të shpërblehet për një shpikje ose për një racionalizim me vlerë. Në këtë drejtim duhet vep-ruar pa shkelur ligjin. Kjo do të sjellë një nxitje të re te punonjësit tanë, të cilët do ta vrasin më shumë mendjen, do të lexojnë edhe literaturë të huaj tekniko-shkencore, do të mësojnë nga eksperiencia e të tjerëve, sepse është fakt që vetëm disa merren me studime. Prandaj komisionet t'i shohin këto çështje me një pjekuri më të madhe, t'i interpretojnë drejt ligjet, që të mos dëmtohet as shteti as njerëzit. Në qoftë se për një problem lindin diskutime, të shkohet në Kryesinë e Këshillit të Ministrave, në Presidiumin e Kuvendit Popullor ose ejani në Sekretariatit e Komitetit Qendror, deri në Byronë Politike dhe bëni propozime për ndryshimet përkatëse.

Ne do t'i shpërblejmë punonjësit kur i japin pa kursim ekonomisë popullore. Në qoftë se ecim qorrazi dhe nuk shohim në jetë përpjekjet e njerëzve për të mirën e popullit, çështjen e shpikjeve e të racionalizimeve mund ta shqyrtojmë shumë herë, por pa sukses. Duket sikur njerëzit nuk përpiqen në këtë drejtim, por faktet flasin ndryshe. Punonjësit i ha merakun për të shtyrë përpara prodhimin, për të zhvilluar teknikën, por puna kërkon më tepër organizim e drejtim. Po të punojnë më mirë komisionet, po të interpretohen më drejt vendimet dhe ligjet, po të propagandohen më gjerrë ato, punonjësit do të bëjnë më shumë, rezultatet do të jenë më të mëdha.

Nga të gjitha këto del se çështja e shpikjeve dhe e racionalizimeve është një kompleks i tërë. Prandaj or-

ganizatat e Partisë dhe të bashkimeve profesionale ta shtrojnë drejt këtë problem, ta trajtojnë më thellë nga ana politike, ideologjike e morale, që njerëzit të punojnë dhe propozimet e tyre të vijnë duke u rritur në interes të popullit. Duke vënë në plan të parë stimujt moralë, kjo nuk do të thotë që të hiqet dorë fare nga stimujt materialë.

Shqyrtimi i këtij problemi në Sekretariatit e Komitetit Qendror të Partisë, të na shërbejë që këtej e tutje ta përmirësojmë punën dhe të arrihet që shpikjet e racionalizimet të shtohen. Lidhur me disa interpretime të ligjit përkatës, unë bisedova edhe me Mehmetin, i cili më tha se kjo çështje do të shihet në Qeveri, në interes kryesisht të ekonomisë popullore. Besoj se, kur ta marrim përsëri në shqyrtim këtë çështje, do të jenë bërë më shumë përparime.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**RAPORT NË PLENUMIN XXI TË KQ TË PPSH
«MBI MBLEDHJEN E PËRFAQËSUESVE TË
PARTIVE KOMUNISTE E PUNËTORE, QË U BË
NË MOSKË NË NËNTOR 1960»**

19 dhjetor 1960

Prej datës 10 nëntor deri më 1 dhjetor 1960, në Moskë, zhvilloi punimet Mbledhja e përfaqësuesve të 81 partive komuniste e punëtoresh të vendeve të ndryshme të botës. Në këtë mbledhje u aprovuan Deklarata dhe Thirrja drejtuar gjithë popujve, si program pune për lëvizjen komuniste e punëtoresh ndërkombëtare në luftën për socializmin, për paqen dhe demokracinë.

**I. — MBI MOSMARRËVESHJET THEMELORE NË
GJIRIN E LËVIZJES KOMUNISTE E PUNËTORE
NDËRKOMBËTARE**

Sikurse dihet, kohët e fundit, në gjirin e lëvizjes komuniste e punëtoresh ndërkombëtare kanë lindur kontradikta të thella, që kanë karakter politik e ideologjik; ato kanë të bëjnë me disa probleme të rëndësishme të gjendjes ndërkombëtare, si dhe me strategjinë e me taktikën e lëvizjes komuniste.

Dihet se në Mbledhjen e Moskës të vitit 1957 u aprovuan Deklarata dhe Manifesti i Paqes, që u konsideruan si një program pune për të gjitha partitë komuniste e punëtoare. Mirëpo jeta provoi se disa parti, dhe në radhë të parë udhëheqja e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, nuk iu përmbajtën zbatimit të plotë të disa parimeve themelore të Deklaratës së Moskës [1957]. Kjo gjë pa dyshim shkaktoi konfuzion ideologjik dhe politik në radhët e lëvizjes, gjë që do ta dëmtonte rëndë çështjen tonë, në qoftë se kundër shtrembërimeve, kundër shkelësve të Deklaratës së Moskës, nuk do të ishte ngritur zëri, në qoftë se parimet e Deklaratës nuk do të ishin mbrojtur me vëndosmëri nga partitë që i qëndronin besnike asaj dhe mësimëve të marksizëm-leninizmit.

Në fillim, në mënyrë të hapur, pikëpamjet e kundërta, kontradiktat në lëvizjen komuniste e punëtoare ndërkombëtare, u shfaqën si kontradikta midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, e cila me konsekuencë mbronte pikëpamjen e drejtë marksiste-leniniste të shprehur në Deklaratën e Moskës [1957].

Cilat ishin çështjet në diskutim, ku konsistonin kontradiktat?

1. — Lidhur me përcaktimin e karakterit të epokës sonë. Kjo çështje nuk ka vetëm një rëndësi thjesht teorike, por ka rëndësi të madhe praktike, sepse nga përcaktimi i drejtë i karakterit të epokës varet përcaktimi i strategjisë dhe i taktikës së lëvizjes komuniste

ndërkombëtare, i çdo partie komuniste në veçanti, për probleme konkrete si: çështja e qëndrimit ndaj imperializmit, ndaj problemit të paqes dhe të luftës, ndaj kuptimit dhe zbatimit në jetë të politikës leniniste të bashkekzistencës paqësore, ndaj çështjes së revolucionit e të rrugëve për në socializëm etj. Një interpretim oportunist i karakterit të epokës së sotme do të çonte në përpunimin e një vije oportuniste për të gjitha çështjet e sipërme. Një interpretim i drejtë, realist, marksist-leninist, i karakterit të epokës së sotme do të ishte garanci për një vijë të drejtë revolucionare në gjithë lëvizjen komuniste, për të gjitha çështjet e strategjisë dhe të taktikës.

Në fakt, lidhur me përcaktimin e karakterit të epokës, ka pasur dy vlerësime:

Vlerësimi i parë, të cilit i përmbahen shokët kinezë dhe Partia jonë, nisët nga metoda marksiste-leniniste e analizës klasore, nga kuptimi materialist i historisë dhe nga studimi shkencor i realitetit objektiv. Sipas këtij vlerësimi, epoka jonë karakterizohet nga epërsia e forcave të socializmit mbi ato të imperializmit, nga epërsia e forcave të paqes mbi ato të luftës, nga epërsia e forcave të demokracisë mbi forcat e reaksionit, nga epërsia e forcave të lëvizjes nacionalçlirimtare mbi forcat e kolonialistëve. Pra, epoka jonë është epoka e revolucioneve, e shembjes së imperializmit, e triumfit të socializmit dhe të komunizmit.

Duke shtrembëruar me qëllim pikëpamjen e vërtetë të shokëve kinezë, udhëheqësit sovjetikë, në mënyrë arbitrare, thonin se gjoja kinezët i përmbahen formulës së njohur të Leninit: «epoka jonë është epoka e impe-

rializmit, e luftërave dhe e revolucioneve». Dhe këtë nxjerrin konkluzionin dhe akuzën false se gjoja shokët kinezë nuk shohin ndryshimet e mëdha që janë bërë në botë në raportin e forcave që nga koha kur Lenini ka dhënë atë përcaktim, pra që 50 vjet më parë. Këtë sipas tyre, buron «dogmatizmi» dhe të gjitha pikëpamjet e «gabuar» të kinezëve (!!). Në të vërtetë, PK e Kinës, siç del qartë nga shumë materiale të saj, asnjëherë nuk ka mohuar ndryshimin e raportit të forcave në botë në favor të socializmit e kundër imperializmit dhe nuk e ka parë epokën e sotme thjesht si epokë të imperializmit, a të luftërave e të revolucioneve, por si epokën kur imperializmi shkon drejt shkatërrimit të mëtejshëm, si epokën e revolucioneve proletare dhe të triumfit të socializmit e të komunizmit. Pra kemi të bëjmë me një falsifikim nga ana e udhëheqësve sovjetikë, të cilin as ata vetë dhe as përkrahësit e tyre nuk e mbrojtën dot në komision dhe në Mbledhjen e Moskës.

Po pse ngritën udhëheqësit sovjetikë një akuzë të tillë kundër vijës së drejtë të Partisë Komuniste të Kinës? Ata e bënë këtë për të provuar gjoja drejtësinë e vlerësimit të tyre të epokës. *Ky vlerësim, i dytë*, nuk niset nga metoda marksiste-leniniste e analizës klasore, por nga kuptimi idealist i historisë dhe nga gjykimet subjektive. Këtë rrjedhin të gjitha shtrembërimet që janë bërë nga udhëheqësit sovjetikë në lidhje me epokën, të cilat konsistojnë në këto gjëra kryesore:

a) Në disa raste janë mbivlerësuar forcat tona e janë nënvleftësuar forcat e armiqve dhe është lënë përshtypja se ne jemi në gjendje t'u imponojmë armiqve vullnetin tonë, se ne mund të bëjmë si të duam me ta,

kurse ata nuk janë në gjendje të bëjnë asgjë. Kjo ka çuar në mjaft raste në dobësimin e vigjilencës. Kjo të çon në aventurizëm politik.

b) Nga ana tjetër, disa herë janë mbivlerësuar forcat e armiqve dhe janë nënvleftësuar forcat tona, është ngjallur panik e frikë në masa nga kërcënimet e imperializmit, nga bazat e tij atomike, blloqet ushtarake etj. Si rezultat i kësaj, lëvizja për paqe shpesh i është kundërvënë lëvizjes nacionalçlirimtare dhe revolucionare, nga frika se mos këto të fundit çojnë në luftë botërore. Një pikëpamje e tillë të çon në lëshime e në qëndrime oportuniste. Kjo tendencë është sot më e rrezikshmja.

c) Duke mbivlerësuar e duke interpretuar shtrembër ndryshimin e raportit të forcave në botë, si edhe për të justifikuar qëndrimet oportuniste, është lënë përshtypja se ka ndryshuar natyra e imperializmit. Për këtë dëshmojnë qartë disa deklarata të Hrushovit për «botën pa armë, pa ushtri e pa luftëra», për «përdorimin nga kapitalistët të mjeteve të çliruara nga çarmatimi për ngritjen e nivelit të jetesës së popullit e për të ndihmuar zhvillimin e vendeve të prapambetura», për krerët e imperializmit si «partizanë të paqes dhe që gëzojnë besimin absolut të popullit» etj. etj.

ç) Që këtej del edhe konkluzioni tjetër i gabuar se gjoja leninizmi është vjetruar, se tezat themelore mbi imperializmin, klasat dhe luftën e klasave, shtetin dhe revolucionin, diktaturën e proletariatit, gjithashtu janë vjetruar. Tendenca të tilla për ta paraqitur leninizmin si të vjetruar ka pasur në fjalimet e udhëheqësve sovjetikë dhe aq më tepër në shkrimet e shtypit sovjetik.

2. — Për çështjet e luftës dhe të paqes. Rreth këtyre çështjeve themelore të kohës sonë qëndrojnë mosmarrëveshjet më të mëdha. Si shfaqen ato konkretisht?

a) *Mbi burimin e luftërave të sotme.* Sipas mësimave të marksizëm-leninizmit, luftërat janë produkt i vetë rendit kapitalist e sidomos i imperializmit. Vendet socialiste, nga vetë natyra e rendit që përfaqësojnë, janë kundër luftërave agresive. Por ato pranojnë dhe përkrahin me vendosmëri luftërat e drejta revolucionare, luftërat çlirimtare të popujve të shtypur ose të sulmuar nga imperializmi, luftërat e klasave të shtypura kundër shfrytëzuesve. Në kundërshtim me këtë, ideologët borgjezë dhe revizionistët jugosllavë predikojnë rrezikun e luftës edhe nga vendet socialiste. Por është gabim i madh, kur edhe disa udhëheqës të partive komuniste, si për shembull, Hrushovi, flasin se rrezik për paqen qenka Kina socialiste, e cila dashka luftë dhe është kundër bashkekzistencës paqësore, pasi përkrah luftërat revolucionare! Kjo akuzë që u bë në Mbledhjen e Bukureshtit dukej shpesh edhe në shtypin sovjetik. Një akuzë e tillë u bë hapur, edhe kundër Partisë sonë, sidomos në komisionin e redaktimit, në tetor, dhe nga disa edhe në Mbledhjen e nëntorit. Që kjo është një shpifje, duket sheshit.

Shkurt çështja shtrohet kështu: Ne themi se duhen mbështetur luftërat revolucionare e çlirimtare; a'ia, duke u nisur nga teza se «nga një shkëndijë mund të plasë lufta botërore», nuk u kushtojnë vëmendjen e duhur këtyre luftërave. Ne themi se politika e bashkekzistencës paqësore të shteteve socialiste me ato kapitaliste nuk duhet të na pengojë që të përkrahim luftërat çlirimtare

dhe revolucionare të popujve, se edhe në kushtet e bashkekzistencës paqësore lufta e klasës dhe ajo e popujve të shtypur duhet zhvilluar; ata na thonë se «ju jeni kundër politikës së bashkekzistencës dhe partizanë të luftës». Ne themi se në rast të një lufte të re botërore do të zhduket imperializmi dhe fitorja do të jetë e socializmit; ata na thonë «ju jeni për luftë, sepse me anën e saj doni të shpejtoni fitoren e socializmit». Tezat tona janë marksiste-leniniste dhe mbështeten te mësimet e Leninit mbi luftërat e revolucionin, tezat e udhëheqësve sovjetikë bien erë oportunistem.

b) *Mbi mundësinë e ndalimit të luftërave.* Kur flasim për këtë problem, duhet bërë mirë dallimi se për çfarë lloj lufte është fjala. Në fjalimet e Hrushovit dhe në shtypin sovjetik shpesh fjala ka qenë për mundësinë e ndalimit të çdo lufte. Kurse luftërat e drejta nacional-çlirimtare dhe civile-revolucionare janë të pashmangshme përderisa ekziston imperializmi, sistemi i shtypjes dhe i shfrytëzimit social e nacional. Prandaj është e gabuar të thuhet se sot janë kushtet për një botë pa luftëra, se nga një shkëndijë e vogël mund të shpërthejë lufta botërore. Në këtë gabim kanë rënë udhëheqësit sovjetikë.

c) *Mbi dy mundësitë në lidhje me problemin e luftës.* Në fjalimet e Hrushovit dhe në shkrimet e shtypit sovjetik kjo çështje nuk trajtohet drejt. Shpesh, duke mbivlerësuar forcat tona, nuk vihet në dukje si duhet rreziku i luftës që vjen nga imperializmi, nuk përgatiten si duhet masat për këtë, nuk ngrihet vigjilenca e tyre dhe nuk demaskohet me forcën e duhur imperializmi, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye. Kjo gjë u vu re, sidomos, para dhe pas vajtjes së Hrushovit në

Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në bazë të mësimëve leniniste, është e nevojshme të theksohen qartë të dyja mundësitë: si mundësia e ndalimit të luftës që vjen nga imperializmi, sepse kjo forcon besimin e popujve, bën të qartë perspektivën, i jep hov lëvizjes për paqe, ashtu edhe mundësia e shpërthimit të saj, sepse kjo forcon vigjilencën, e bën më aktive dhe më të vendosur luftën e popujve për paqe, forcon gatishmërinë luftarake të vendeve socialiste për të mos u gjendur në befasi.

Duke nxjerrë në pah rrezikun e një lufte të re botërore, nuk duhet ekzagjeruar me propagandimin e tmerreve të saj, sepse një gjë e tillë nuk sjell asnjë dobi, ajo ngjall vetëm ndjenjën e dëshpërimit, të frikës, fut panik në masa, i demoralizon dhe i çmobilizon ato. Kjo do të thotë të biesh në kurthin e shantazhit atomik të Imperializmit. Në këtë drejtim, në propagandën sovjetike dhe të disa vendeve të tjera, ka pasur shumë gabime serioze.

ç) *Mbi forcat ku duhet të mbështetemi për ndalimin e luftës.* Sot ka forca të mëdha që qëndrojnë në roje të paqes. Këto janë para së gjithash forcat e socializmit e të popujve. Në kundërshtim me këtë, shpesh nga Hrushovi e të tjerë, shpresat janë mbështetur në «arsyen» e «qëllimet e mira» të krerëve të imperializmit, me Ajzenhauerin në krye, në bisedimet me qeveritë imperialiste, në rolin e disa politikanëve e personaliteve të veçantë, si Sukarno, Nehru, Itoni e të tjerë. Sigurisht ne nuk jemi kundër kontakteve e bisedimeve. Këto janë të nevojshme dhe të dobishme, por rreth tyre nuk duhen krijuar iluzione në popujt dhe nuk duhet zëvendësuar me to lufta e popujve, e cila i detyron

imperialistët të shkojnë edhe në takime e në bisedime me ne.

d) *Mbi problemin e çarmatimit*. Në lidhje me këtë problem janë bërë shtrembërime në tri drejtime:

Së pari, «bota pa armë, pa ushtri e pa luftëra» është paraqitur si një parullë që mund të realizohet qysh sot, kur ekziston akoma imperializmi. Po kështu është paraqitur edhe parulla tjetër që lidhet me këtë, se «në kohën e sotme mund të arrihet çarmatim i plotë». Kurse marksizmi na mëson se, derisa ekziston imperializmi, ekziston edhe burimi social-ekonomik i luftërave, për pasojë do të ekzistojnë edhe ushritë, edhe armët, do të ekzistojë shteti i diktaturës së borgjezisë me të gjitha anekset e tij.

Së dyti, është propaganduar në shtypin sovjetik dhe në fjalime të ndryshme të udhëheqësve sovjetikë se «mjetet e çliruara nga çarmatimi mund të përdoren edhe nga qeveritë kapitaliste e imperialiste për ngritjen e nivelit të jetesës së popullit, si dhe për të ndihmuar vendet e prapambetura të zhvillojnë ekonominë dhe kulturën e tyre kombëtare».

Së treti, revizionistët shpresat për realizimin e çarmatimit i mbështetin në mbledhjet e në bisedimet midis fuqive të mëdha, ndërsa nuk përfillin luftën e popujve për ta detyruar imperializmin të bëjë lëshime në këtë fushë.

Në të vërtetë, pa likuidimin përfundimtar të imperializmit, pa fitoren e socializmit në të gjithë botën ose në pjesën më të madhe të saj, imperialistët nuk mund të çarmatosen plotësisht. Parulla e «botës pa armë, pa ushtri e pa luftëra», duhet të lidhet me idealet e luftës

për socializëm, sepse vetëm me fitoren e socializmit në shkallë botërore mund të realizohet një botë e tillë. Ndryshe, largohemi nga marksizëm-leninizmi.

Programi i çarmatimit mund të realizohet me sukses vetëm me kusht që vendet socialiste, e sidomos Bashkimi Sovjetik, të kenë epërsi gjithnjë e më të madhe në armët moderne dhe vetëm kur popujt të luftojnë me vendosmëri për t'u imponuar imperialistëve çarmatimin.

3. — **Mbi bashkekzistencën paqësore.** Edhe për këtë problem ka shumë mosmarrëveshje. Këto mosmarrëveshje nuk janë sepse Kina apo Shqipëria qenkan gjoja kundër bashkekzistencës paqësore, por sepse nga ana e udhëheqësve sovjetikë e nga disa të tjerë ka shtrembërime në lidhje me kuptimin dhe më zbatimin e politikës së bashkekzistencës paqësore.

a) Politika e bashkekzistencës paqësore nuk përfshin gjithë përmbajtjen e politikës së jashtme të vendeve socialiste, siç përpiqen ta paraqitin udhëheqësit sovjetikë dhe as parimin themelor të saj. Politika e jashtme e vendeve socialiste përfshin tri aspekte kryesore:

e para, bashkëpunimin vëllazëror dhe ndihmën e përkrahjen reciproke midis vendeve të sistemit socialist;

e dyta, mbështetjen dhe përkrahjen e luftës revolucionare të punonjësve për çlirimin shoqëror, si edhe të luftës antiimperialiste, antikolonialiste e çlirimtare të popujve dhe të kombeve të shtypura;

e treta, bashkekzistencën paqësore me vendet me sisteme të ndryshme dhe luftën kundër politikës imperialiste të luftës e të agresionit.

b) Politika e bashkekzistencës paqësore nuk shtri-

het në marrëdhëniet midis klasave, brenda vendeve kapitaliste, si dhe midis popujve të shtypur e shtypësve të tyre imperialistë. Ajo nënkupton luftën kundër imperializmit si në fushën politike, ekonomike e ideologjike, ashtu edhe përkrahjen morale e materiale të lëvizjes nacionalçlirimtare e revolucionare të popujve nga ana e vendeve socialiste. Lufta nacionalçlirimtare dhe revolucionare e popujve forcon çështjen e paqes, përdërisa ajo dobëson pozitën e imperializmit. Kurse nga udhëheqësit sovjetikë dhe nga disa të tjerë, bashkekzistencën paqësore midis shteteve me sisteme të ndryshme propagandohet në mënyrë oportuniste si shuarje e luftës së klasave ose e luftës politike e ideologjike me imperializmin. Në disa fjalime të vetë Hrushovit përjashtohet lufta politike kundër imperializmit. Dihet se për shumë kohë në shtypin e disa vendeve, duke përfshirë edhe shtypin sovjetik, nuk flitej fare për imperializmin amerikan, pra nuk luftohej për demaskimin e tij, por filluan lajkat dhe përkëdheljet. E njëjta frymë u fut edhe në organizatat ndërkombëtare. Teodor Zhivkovi, politikën e bashkekzistencës paqësore, e paraqiti si «rrugën reale të kalimit në socializëm në shkallë botërore».

c) Rruga për arritjen e bashkekzistencës është lufta për t'ua imponuar atë imperialistëve dhe jo duke i lutur, duke i zbukuruar ata, duke i përkëdhelur e duke u fërkuar krahët. Lëshimet dhe kompromiset e caktuara mund të jenë të nevojshme në disa rrethana, por pa prekur parimet tona politike e ideologjike: Por megjithëkëtë, duke qenë se imperializmi, si i tillë, kurrë nuk heq dorë nga politika e luftës dhe e agresionit,

lufta për bashkekzistencën paqësore duhet të jetë në radhë të parë luftë kundër politikës imperialiste të agresionit e të luftës. Ne duhet ta demaskojmë vazhdimisht imperializmin, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye, dhe të frymëzojmë popujt në luftën kundër tij. Kjo është politika e vetme leniniste.

ç) Me problemin e bashkekzistencës paqësore lidhet edhe qëndrimi i vendeve socialiste ndaj vendeve ku në fuqi është borgjezia kombëtare. Edhe për këtë ka mosmarrëveshje. Sovjetikët dhe të tjerë shohin vetëm një rën anë të borgjezisë kombëtare, anën përparimtare, por ata lënë mënjanë, pothuajse krejtësisht, anën tjetër të saj, anën reaksionare që shfaqet si në politikën e brendshme, ashtu edhe në të jashtmen. Vetëm kështu shpjegohet qëndrimi i udhëheqësve sovjetikë në lidhje me konfliktin kufitar kino-indian, ku ata mbajtën anën e Nehrui dhe dënuan Kinën. Qëndrimi i vetëm i drejtë është që, duke marrë parasysh karakterin e dyfishtë të borgjezisë kombëtare, të ndiqet një politikë e matur, e kujdesshme dhe njëkohësisht parimore, duke mos lënë të zhvillohen tendencat e saj reaksionare.

4. — **Për çështjen e rrugëve të kalimit në socializëm.** Në epokën tonë, përmbajtja themelore e së cilës është kalimi nga kapitalizmi në socializëm, problemi i rrugëve të kalimit në socializëm merr një rëndësi të veçantë. Mosmarrëveshjet në lidhje me këtë problem qëndrojnë në sa vijon:

a) Në faktin që në Kongresin XX, dhe më vonë, rruga paqësore u shtrua si një rrugë thjesht parlamentare, si fitim i shumicës në parlament dhe u la mënjanë mësimi themelor i marksizmit mbi nevojën e armatosjes

së proletariatit, të shkatërrimit të makinës së vjetër të shtetit borgjez dhe të zëvendësimit të saj me makinën e re të shtetit të diktaturës së proletariatit. Domethënë mosmarrëveshjet lindën nga interpretimi oportunist, reformist, i rrugës paqësore.

b) Në faktin që rruga paqësore, të cilën Lenini e shihte si një përjashtim të rrallë, u absolutizua, u konsiderua si rruga më reale, më e mundshme në kushtet e sotme dhe pothuajse u mohua fare nevoja e përgatitjes njëherësh për të dyja mundësitë, paqësore e jopaqësore. Kjo i orientoi keq shumë parti dhe në fakt ka penguar çështjen e zhvillimit të mëtejshëm të revolucionit.

c) Në predikimin që në të ardhshmen, si rezultat i politikës së bashkekzistencës paqësore, mundësitë e rrugës paqësore do të vijnë duke u shtuar gjithnjë e më shumë. Në kushtet kur jo vetëm shtetet imperialiste, por edhe shtetet e porsaçliruara nga sundimi kolonial i imperializmit po rritin aparatet e tyre burokratiko-ushtarake dhe kur po bëhen gjithnjë më të theksuara tendencat fashiste, reaksionare e despotike, është e shtrembër të thuhet se mundësitë e rrugës paqësore vijnë duke u shtuar.

Eksperiencia historike tregon se klasat sunduese nuk janë larguar kurrë vullnetarisht, pa rezistencë, nga arena historike. Duke mbajtur parasysh edhe mundësinë e rrugës paqësore, Partia duhet të përgatitet vetë, të përgatitë edhe klasën e masat në mënyrë të gjithanshme për rrugën jopaqësore, bile duke u përgatitur mirë për rrugën jopaqësore, rriten shanset edhe për shfrytëzimin e mundësisë së rrugës paqësore, në rast se paraqitet.

5. — Për revizionizmin dhe dogmatizmin. Mosma-

rëveshjet në lidhje me këtë çështje janë për faktin se cili prej tyre është rrezik kryesor sot në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Udhëheqësit sovjetikë, me Nikita Hrushovin në krye, si edhe disa parti të vendeve socialiste dhe kapitaliste të Evropës, kohët e fundit mundohen të krijojnë përshtypjen se rrezik kryesor sot nuk është më revizionizmi, por «dogmatizmi», «sektarizmi», «majtizmi». Këtu kemi të bëjmë me një largim të hapur nga mësimet e marksizëm-leninizmit dhe nga Deklarata e Moskës, e cila përcakton qartë se revizionizmi është sot rreziku kryesor në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Sipas udhëheqësve sovjetikë, revizionizmi është shpartalluar ideologjikisht. Prandaj ata e kanë dobësuar luftën kundër revizionizmit dhe kanë ndërmarrë një sulm të përgjithshëm kundër «dogmatizmit», duke shpifur se gjoja bartës kryesorë të tij qenkan Partia Komuniste e Kinës dhe Partia e Punës e Shqipërisë.

Është e vërtetë se në luftën kundër revizionizmit janë arritur suksese të konsiderueshme nga partitë komuniste e punëtore. Por ai nuk është shpartalluar akoma ideologjikisht, siç pretendojnë udhëheqësit sovjetikë. Ai ekziston para së gjithash në një shtet të tërë, në Jugosllavi, ku revizionistët janë në fuqi dhe zhvillojnë një veprimtari të gjithanshme minuese. Revizionizmi ka rrënjë të thella shoqërore, ai është një fenomen ndërkombëtar, është pasqyrim i ideologjisë borgjeze. Në epokën tonë, që karakterizohet nga kalimi prej kapitalizmit në socializëm, kur partitë komuniste zhvillojnë politikën e alcancave të ndryshme, kur vendet socialiste luftojnë për sigurimin e bashkekzistencës pa-

qësore dhe kur borgjezia imperialiste nuk është në gjendje të sulmojë hapur forcat e socializmit e as të mbytë me anën e dhunës lëvizjen punëtore revolucionare dhe nacionalçlirimtare, revizionizmi, oportunizmi i djathtë, është gjithnjë rrezik kryesor.

Prandaj, megjithëse dogmatizmi dhe sektarizmi mund të bëhen rrezik kryesor në një periudhë të caktuar të zhvillimit të kësaj apo të asaj partie, për gjithë lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, lufta kundër revizionizmit ka qenë dhe mbetet detyra më e rëndësishme.

Akuzat për «dogmatizëm» e «sektarizëm» kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe tani së fundi kundër Partisë së Punës të Shqipërisë janë krejt të pathemelta. Partia Komuniste e Kinës, si gjatë revolucionit ashtu edhe gjatë kohës së ndërtimit socialist, ka bërë një luftë të vendosur kundër dogmatizmit dhe ka dhënë prova të shkëlqyera të një zbatimi krijues të teorisë së marksizëm-leninizmit për të cilin kanë folur me admirim si Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, ashtu edhe të gjitha partitë e tjera të botës. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Partinë tonë. Partia jonë, gjithashtu, gjatë gjithë historisë së saj ka zbatuar në mënyrë krijuese marksizëm-leninizmin. Këtë e vërteton vija e saj gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, në saje të së cilës, me anë të organizimit të Frontit Nacionalçlirimtar dhe të lidhjes së ngushtë me masat, ajo ngriti në këmbë gjithë popullin tonë. Edhe pas Çlirimit e deri sot lidhjet e ngushta me popullin, uniteti i çeliktë me masat e gjera punonjëse janë shprehje jo e dogmatizmit, karakteristikë dalluese e të cilit është shkëputja e par-

tisë nga masat, por shprehje e zbatimit konkret, krijues të marksizmit në kushtet e vendit nga Partia jonë.

Në të vërtetë, çështja është se revizionistët, nën pretekstin e luftës kundër «dogmatizmit», ngrihen kundër marksizëm-leninizmit; nën pretekstin e luftës kundër devijimit «të majtë», heqin dorë nga revolucioni; nën pretekstin e luftës kundër «sektarizmit», mbajnë një qëndrim kapitullues; nën pretekstin e taktikës së «zhdërvjelltë», predikojnë pajtimin e paprincipitë me borgjezinë imperialiste.

Marksizëm-leninizmi është një shkencë krijuese, ai zhvillohet e pasurohet vazhdimisht me zhvillimin e praktikës revolucionare. Teza dhe konkluzione të veçanta të tij, me ndryshimin e situatës, ndryshojnë e zëvendësohen me teza e me konkluzione të reja. Të mos e shohësh marksizmin kështu, do të thotë të biesh në dogmatizëm. Por në qoftë se teza dhe konkluzione të veçanta të marksizmit ndryshojnë, parimet e tij themelore mbeten të paprekura, ruajnë plotësisht rëndësinë e tyre aktuale. Gjithë revizionistët e oportunistët, duke filluar që nga Bernshtajni, nën pretekstin e ndryshimeve të situatës e të fenomeneve të reja në jetën shoqërore, kanë mohuar ligjet themelore të marksizmit mbi zhvillimin e shoqërisë, e kanë paraqitur atë «dogmatik» dhe «të vjetruar».

6. — Për çështjen e unitetit të kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, mosmarrëveshjet qëndrojnë në sa vijon:

a) Mbi kuptimin dhe vendin e mosmarrëveshjeve në lidhje me unitetin. Vërejtjet tona kritike ndaj një sërë tezash politike të udhëheqësve sovjetikë e të disa

partive të tjera janë parimore dhe shumë të rëndësishme. Nga kjo pikëpamje është krejt e gabuar të mendohet, siç mendojnë në fakt udhëheqësit sovjetikë, se diskutimet dhe kritikët janë të papajtueshme me unitetin. Kritika dhe autokritika është një ligj i zhvillimit, jo vetëm i çdo partie të veçantë, por dhe i gjithë lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Prandaj udhëheqësit sovjetikë dhe ata të disa partive të tjera gabojnë rëndë kur i quajnë kritikët tona e të kinezëve si të papajtueshme me unitetin, si veprimtari fraksioniste. E keqja është pikërisht atëherë kur kontradiktat brenda radhëve tona identifikohen ose vihen mbi kontradiktat midis nesh dhe armiqve tanë dhe, në vend të kritikës, ndiqet metoda e sulmeve, ashtu siç u veprua në Mbledhjen e nëntorit, sidomos në lidhje me Partinë tonë.

b) *Mbi bazat e parimet e unitetit.* Baza ideologjike e unitetit të mendimeve është marksizëm-leninizmi. Këtë buron edhe uniteti i veprimeve. Për forcimin e unitetit, në kushtet e sotme, rëndësi të madhe ka, gjithashtu, zbatimi me përpikëri i vendimeve të aprovuara kolektivisht dhe njëzëri nga partitë në mbledhjet e tyre. Të gjitha partitë janë të barabarta e të pavarura. Ato i japin njëra-tjetrës ndihmë e përkrahje reciproke. Këto parime nuk janë respektuar gjithnjë nga ana e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Ajo në fakt e ka vënë veten mbi partitë e tjera, është orvatur t'u diktojë pikëpamjet e veta partive të tjera, të krijojë mitin e pagabueshmërisë, çdo kritikë kundër saj është parë si një sulm antisovjetik i papajtueshëm me unitetin, është përpjekur që marrëdhëniet e saj me partitë e tjera t'i kishte si midis «mëmës dhe bijës»,

midis «instancave më të ulëta dhe më të larta», është orvatur që vendimet e kongreseve të saj t'i bëjë norma të detyrueshme për të gjithë, të marrë vendime për çështje të rëndësishme ndërkombëtare si për kritikën e «kultit të Stalinit», rrugët e kalimit në socializëm etj., pa u konsultuar më parë me partitë e tjera. Duhet theksuar se edhe në vetë Mbledhjen e Moskës udhëheqësit sovjetikë insistonin të flitej për rëndësinë e kongreseve XX e XXI të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

c) *Mbi rrugët për arritjen e për forcimin e unitetit.* E keqja në lëvizjen komuniste të sotme nuk qëndron te divergjencat, por te metodat dhe rrugët antimarksisiste që ndiqen nga udhëheqësit sovjetikë për t'i kapërcyer këto divergjenca, gjë që i thellon e i acaron ato edhe më tepër. Për këtë dëshmon qartë Mbledhja e Bukureshtit, që u bë në kundërshtim me rregullat më elementare të marrëdhënieve midis partive. Për këtë dëshmon, gjithashtu, shtrirja e mosmarrëveshjeve ideologjike në marrëdhëniet shtetërore, për të bërë presion, siç është heqja e specialistëve nga Kina, çështja e bukës dhe çështje të tjera lidhur me ne. Po për këtë dëshmon orvatja për të dënuar botërisht në Deklaratë Partinë Komuniste të Kinës dhe Partinë e Punës të Shqipërisë për veprimtari fraksioniste e grupazhi në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, si dhe për të futur në këtë dokument të lëvizjes komuniste ndërkombëtare parimin e nënshtrimit të pakicës ndaj shumicës, në vend të arritjes së unitetit me anën e konsultimeve të barabarta e shoqërore, si e vetmja rrugë e drejtë në kushtet e sotme.

Rreth këtyre çështjeve kaq të rëndësishme u bë një luftë e madhe parimore më parë në Bukuresht, ku, siç dihet, udhëheqësit sovjetikë dhe ata të disa partive të tjera deshën ta bëjnë fakt të kryer «dënimin» e marksizmit, dënimin e pikëpamjeve të drejta që mbroreshin nga Partia Komuniste e Kinës, duke e quajtur këtë «dogmatike» e «sektare». Partia jonë nuk u bashkua me këtë prapaskenë antimarksiste, sepse ajo në parim nuk ishte dakord as me metodat që u ndoqën nga organizatorët e Mbledhjes së Bukureshtit, as me përmbajtjen e çështjeve që ata shtronin. Rreth çështjeve të sipërme parimore u bë një luftë më e madhe në mbledhjen e komisionit në Moskë, gjatë muajit tetor dhe, më në fund, për kuptimin e drejtë marksist të këtyre çështjeve, për mbrojtjen e leninizmit në shpjegimin, në kuptimin dhe në interpretimin e tyre, u bë luftë e vendosur në Mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore, në nëntor, në Moskë.

Në këtë luftë, në këtë proces të gjatë, u përcaktua edhe pozita e partive të ndryshme ndaj këtyre çështjeve. Kështu që në Mbledhjen e nëntorit u pa qartë se mosmarrëveshje për këto probleme nuk kishte vetëm midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës, dhe aq më pak midis Partisë Komuniste të Kinës dhe gjithë komunizmit ndërkombëtar, siç pretendonin në Bukuresht udhëheqësit sovjetikë, por mosmarrëveshjet përfshinin shumë parti, ato

u bënë mosmarrëveshje midis marksistëve dhe oportunistëve, midis partive që mbronin pastërtinë e marksizëm-leninizmit dhe partive që po shtrembëronin dhe interpretonin në mënyrë të njëanshme disa teza të tij. Në qoftë se në Bukuresht, hapur në mbrojtje të parimeve marksiste, kundër rrymës që po shtrembëronte parimet e marksizëm-leninizmit dhe Deklaratën e Moskës [1957], ishin Partia Komuniste e Kinës dhe Partia jonë e Punës, në komisionin e tetorit, nga 26 parti që përfaqësoheshin, qëndronin në pozita të drejta 7 parti...

Në Mbledhjen e Moskës ky raport forcash u ndryshua. Në pozita të drejta, për të gjitha çështjet që ishin në diskutim, u vunë veç 7 partive edhe 4-5 parti të tjera... Por jo i vogël ishte dhe numri i partive që për çështje të veçanta, si, për shembull, për problemin e rrugëve të kalimit për në socializëm, për agresivitetin e imperializmit, për nevojën e luftës kundër revizionizmit dhe veçanërisht kundër revizionizmit jugosllav etj., përkrahnin tezat tona. Të tillë pozitë zunë thuajse të gjitha partitë e Amerikës Latine, si...

Ndryshimi në raportin e forcave tregon luftën e vendosur që bënë në mbledhje delegacioni kinez, delegacioni i Partisë sonë e të tjera, që, me argumente bindëse, hodhën poshtë pikëpamjet e shtrembra dhe bënë të qartë para të gjithëve pozitën e tyre parimore mbi çështjet në diskutim. Fakti që në pozita të drejta, plotësisht ose pjesërisht, u vunë një numër i konsiderueshëm partish, tregon se e drejta marksiste-leniniste është në anën tonë, se ajo po përqafohet me shpejtësi edhe nga të tjerë, se e drejta do të triumfojë mbi të shtrembrën, marksizëm-leninizmi si kurdoherë do të

fitojë mbi oportunizmin e mbi revizionizmin. Me këtë besim e bindje të plotë Partia jonë, ashtu si deri tani, do të vazhdojë të luftojë me vendosmëri për pas'ërtinë e ideologjisë sonë marksiste-leniniste, për triumfin e socializmit dhe të komunizmit.

II. — QËNDRIMI I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË NDAJ MOSMARRËVESHIJEVE QË LINDËN NË GJIRIN E LËVIZJES KOMUNISTE

Partia jonë e Punës ka ndjekur kurdoherë një vijë të drejtë marksiste-leniniste dhe u është përmbajtur parimeve të Deklaratës së Moskës [1957]. Në të gjitha çështjet themelore që përmendëm më parë, domethënë, në lidhje me përcaktimin e epokës, për çështjen e luftës kundër imperializmit, për problemin e luftës dhe të paqes etj., Partia jonë ka mbrojtur dhe ka zbatuar pikëpamjen e drejtë marksiste-leniniste. Kurrë ndonjëherë Partia jonë nuk ka pranuar, as ka thënë se leninizmi është «vjetruar», përkundrazi ajo ka luftuar pa pushim e me vendosmëri kundër revizionistëve jugosllavë, të cilët, për të justifikuar tradhtinë e tyre, e shpallin «të vjetruar» marksizmin. Partia jonë kurrë ndonjëherë nuk ka pasur iluzione për karakterin e imperializmit amerikan dhe të udhëheqësve të tij, por vazhdimisht ka edukuar masat me urrejtje e me vigjilencë ndaj tij; asnjëherë ne nuk kemi menduar se paqja do të na dhurohet, se pa u likuiduar imperializmi mund të krijohet bota pa armë, pa ushtri e pa luftëra. Përkundrazi, duke e parë drejt problemin e luftës dhe të paqes, rrezikun që i kanoset

njerëzimit nga imperializmi dhe reaksioni, Partia jonë ka mobilizuar popullin nën parullën «Në njërën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën». Partia jonë ka luftuar me konsekuencë për demaskimin e imperializmit dhe të shërbëtorëve të tij, revizionistëve jugosllavë, dhe nuk ka aprovuar asnjëherë politikën e «butë», politikën e «madhe» të udhëheqësve sovjetikë apo edhe atë të udhëheqësve bullgarë, si kundrejt imperializmit amerikan, ashtu edhe kundrejt revizionizmit jugosllav. Partia jonë kurrë ndonjëherë nuk ka menduar se, për hir të bashkekzistencës, duhet shuar lufta e klasave në vendet kapitaliste, ose duhet likuiduar lufta politike dhe ideologjike kundër imperializmit dhe borgjezisë. Përkundrazi, Partia jonë ka qenë kundër çdo kuptimi të tillë oportunist të bashkekzistencës paqësore.

Pra, pozita e Partisë sonë në këto çështje parimore përputhej plotësisht me mësimet e marksizëm-leninizmit dhe prej kohësh ka qenë në kundërshtim me pozitën e udhëheqësve sovjetikë. Por Partia jonë ka qenë në kundërshtim parimor me pikëpamjet dhe me veprimet e udhëheqësve të tanishëm sovjetikë edhe për një sërë çështjesh të tjera parimore, për të cilat është në dijeni Komiteti ynë Qendror.

Kështu, ne nuk kemi qenë dakord me udhëheqësit sovjetikë në lidhje me qëndrimin e tyre ndaj revizionizmit jugosllav. Kjo ka filluar qysh nga maji i vitit 1955, atëherë kur Hrushovi e Bulganini shkuan në Beograd dhe në mënyrë të njëanshme, duke mënjanuar Informbyronë, vendosën të rehabilitojnë klikën e Titos, gjë që, siç dihet, solli më pas shumë të këqija në lëvizjen komuniste e punëtorë ndërkombëtare. Që atëherë Partia

jonë u shpreh kundër këtij rehabilitimi dhe më vonë nuk ka qenë dakord asnjëherë me taktikën dhe me qëndrimin e udhëheqësve sovjetikë ndaj Titos e klikës së tij, klikë e cila përkëdhelej, konsiderohej si socialiste e me të cilën konsultoheshin për çdo gjë etj. etj.

Partia jonë nuk ka qenë dakord me Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, veçanërisht me kritikën kundër Stalinit dhe me shpjegimin e rrugës paqësore të kalimit në socializëm. Për çështjen e parë ne nuk kemi qenë e nuk jemi dakord, së pari, sepse kritika kundër «kultit të Stalinit» u bë pa u konsultuar më parë edhe me partitë motra, meqenëse Stalini ishte jo vetëm udhëheqës i Bashkimit Sovjetik, por edhe i proletariatit ndërkombëtar, dhe së dyti, sepse u fol vetëm për gabime të Stalinit dhe asnjë fjalë s'u tha për anët pozitive të veprimtarisë së tij. Për çështjen e dytë, në fakt Kongresi XX u dha armë ideologjike oportunistëve për të propaganduar vetëm rrugën paqësore të marrjes së pushtetit.

Çështjen e kalimit në socializëm Hrushovi në Kongresin XX e shtroi shtrembër. Ai në mënyrë të veçantë theksoi marrjen e pushtetit me rrugën paqësore dhe me anë të parlamentit, gjë që është në kundërshtim me mësimet e marksizëm-leninizmit dhe me eksperiencën historike të deritanishme.

Përveç këtyre çështjeve, Partia jonë nuk ka qenë dakord me udhëheqësit sovjetikë lidhur me ngjarjet në Hungari, me vlerësimin e tyre, me ngurrimin që u tregua për likuidimin e kundërrevolucionit dhe për demaskimin e plotë të revizionistëve jugosllavë në këtë çështje. Komiteti Qendror është

në dijëni të kësaj çështjeje, prandaj nuk është nevojë të zgjatemi.

Më në fund, Partia jonë nuk ka qenë dakord dhe ka pasur kundërshtime me udhëheqësit sovjetikë edhe për shumë çështje të tjera që kanë të bëjnë me kuptimin e drejtë leninist të marrëdhënieve midis partive motra, të cilat janë të barabarta, të pavarura nga njëra-tjetra. Lidhur me këtë, Komiteti Qendror është gjithashtu në dijëni të ndërhyrjeve të padrejta të udhëheqësve sovjetikë në punët e brendshme të Partisë sonë, si në rastin me armiqtë e Partisë sonë, Liri Gega, Tuk Jakova, Panajot Plaku e të tjerë.

Pra, siç shihet, në çështjet themelore të politikës së jashtme, të taktikës dhe të strategjisë së lëvizjes komuniste, Partia jonë ka pasur kurdoherë një vijë të drejtë marksiste-leniniste, vijë e cila ka qenë në kundërshtim me vijën që ndiqte udhëheqja sovjetike. Por Komiteti Qendror i Partisë sonë, duke ndjekur me konsekuencë vijën e mësipërme, duke ruajtur me vendosmëri parimet e drejta marksiste-leniniste, pa bërë lëshime në to, me gjithë presionet e shumta që i bëheshin nga ana e udhëheqësve sovjetikë, nuk i shfaqti publikisht kundërshtimet e tij. Pse e bëri këtë Komiteti Qendror?

E para, sepse pas Kongresit XX të gjitha sulmet e armiqve imperialistë dhe revizionistë ishin përqëndruar për të përçarë unitetin e lëvizjes sonë komuniste. Prandaj, për hir të këtij uniteti, ne duhej të përmbaheshim dhe të zbatonim me konsekuencë vijën marksiste-leniniste, duke evituar kritikën e hapëta në drejtim të udhëheqjes sovjetikë.

E dyta, sepse, siç dihet, si rezultat i kritikës ndaj Stalinit, kur reaksioni dhe revizionistët filluan të vinin në dyshim gjithë sistemin sovjetik dhe, veçanërisht, si rezultat i ngjarjeve në Poloni e në Hungari, përpjekjet e gjithë reaksionit botëror për të ulur autoritetin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe prestigjin e vetë Bashkimit Sovjetik ishin shumë të mëdha. Në këto situata, detyra internacionaliste kërkonte që të mbrohej Bashkimi Sovjetik dhe Partia e tij Komuniste, të mos i jepej asnjë armë reaksionit dhe të ndihmohej udhëheqja sovjetike me anë të kritikave shoqërore që të vihej në rrugë të drejtë. Kështu veproi edhe Partia jonë. Ajo e mbrojti publikisht Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, vetë Bashkimin Sovjetik, por disa vërejtje kritike, veçanërisht lidhur me qëndrimin ndaj revizionizmit jugosllav, ndaj ngjarjeve në Hungari, ndaj ndërhyrjeve në punët e brendshme të Partisë sonë, qysh më 1957 e më vonë, sipas rastit, ua kemi vënë në dukje udhëheqësve sovjetikë.

Ky qëndrim i Partisë sonë është qëndrim i drejtë, internacionalist, marksist-leninist. Të veprohej ndryshe në atë kohë do të thoshte të bëje lojën e armikut, të dëmtoje çështjen e përgjithshme të socializmit dhe të klasës punëtore ndërkombëtare.

Por udhëheqësit sovjetikë vazhduan më thellë në gabimet e tyre. Puna arriti deri atje sa, jo vetëm po përkëdhelnin Titon e klikën e tij, por po mbulonin me lajka edhe Ajzenhauerin, duke treguar kështu se po shtrembëronin konceptin marksist-leninist mbi imperializmin dhe mbi luftën e klasave. Shokët kinezë, me shumë të drejtë, e panë të arsyeshme që me anë të

disa artikujve të vinin pikat mbi i-të për çështjet themelore të situatës ndërkombëtare dhe të strategjisë e të taktikës së lëvizjes komuniste, duke i shpjeguar ato në bazë të mësimeve marksiste-leniniste. Por udhëheqësit sovjetikë nuk i vunë gishtin kokës, përkundrazi, organizuan prapaskenën antimarksiste të Bukureshtit, për të qeruar hesapet me Partinë Komuniste të Kinës dhe me çdo parti tjetër që ishte bërë pengesë në rrugën e tyre të gabuar.

Nuk do të ndalemi te zhvillimi i Mbledhjes së Bukureshtit, sepse për këtë Plenumi i Komitetit Qendror është vënë mirë në dijeni, por do të përmend shkurt qëndrimin tonë në këtë mbledhje.

Partia jonë, siç e thamë edhe pak më parë, nuk ishte dakord me organizatorët e Mbledhjes së Bukureshtit, me udhëheqësit sovjetikë, jo vetëm për metodën antimarksiste që u ndoq atje, por në esencë nuk ishte dakord edhe me akuzat që i bëheshin Partisë Komuniste të Kinës. Prandaj mbajti qëndrimin e drejtë e parimor që dihet.

Si ndodhi që Partia jonë mbajti atë qëndrim? A ishte ai i rastit? Qëndrimi i Partisë sonë në Bukuresht nuk ishte i rastit. Ai i përgjigjej vijës konsekuente që ndiqte vazhdimisht Partia jonë, u përgjigjej pozitive parimore që mbronte kurdoherë Partia jonë në çështjet themelore që ishin në diskutim. Në Bukuresht ne mbrojtëm marksizëm-leninizmin, mbrojtëm vijën e Partisë sonë dhe, duke bërë këtë luftë parimore e të guximshme, ne, nga njëra anë, u gjendëm në një krah me shokët kinezë dhe mbrojtëm partinë e tyre të lavdishme, e cila, ashtu si edhe ne, luftonte për mbrojtjen e

pastërtisë së marksizëm-leninizmit, dhe nga ana tjetër, ramë në kundërshtim me udhëheqësit sovjetikë dhe me gjithë përfaqësuesit e partive të tjera që organizuan Mbledhjen e Bukureshtit, të cilët mbronin një çështje të gabuar dhe në kundërshtim me mësimet e marksizëm-leninizmit. Këtu qëndron rëndësia parimore e qëndrimit tonë në Bukuresht, qëndrim që ishte rrjedhim logjik e konsekuent i gjithë vijës marksiste-leniniste që ndiqte Partia jonë, qëndrim që i ka rritur autoritetin dhe personalitetin Partisë sonë në sytë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Partia jonë e dënoi Mbledhjen e Bukureshtit dhe e quajti me të drejtë atë një njollë në lëvizjen komuniste. Sa i drejtë ishte qëndrimi ynë në Bukuresht dhe vlerësimi ynë për prapaskenën antimarksiste që u organizua atje, e tregoi Mbledhja e Moskës dhe dokumentet që aprovoi ajo. Asnjë përfaqësues i asnjërës parti nuk pati guximin të mbronte Mbledhjen e Bukureshtit, t'u përgjigjej kritikave tona dhe të shokëve kinezë për punën fraksioniste që u bë atje. Jo vetëm kaq, por askush nuk pati guximin të propozonte që të vihej ndonjë fjalë e mirë për Mbledhjen e Bukureshtit në deklaratën që u botua dhe që përbëhej nga 52 faqe. Mbledhjes së Bukureshtit s'i mbeti as nam as nishan.

Por Mbledhja e Bukureshtit, nga ana tjetër, shënon fillimin e acarimit të hapur të marrëdhënieve midis Partisë sonë dhe udhëheqësve sovjetikë, gjë që shpejt filloi të shprehet edhe në marrëdhëniet politike e ekonomike midis dy vendeve e shteteve tona. Faji për gjendjen e krijuar rëndon plotësisht mbi palën sovjetike, e cila nuk ishte e kënaqur me qëndrimin parimor të Partisë

sonë në Bukuresht. Këtë pakënaqësi ajo filloi ta shfaqë në shumë veprime të gabuara, të cilat filluan të dëmtojnë seriozisht miqësinë dhe lidhjet vëllazërore midis dy partive e dy vendeve tona. Kështu filluan ndërhyrjet antimarksiste të njerëzve sovjetikë në punët e brendshme të Partisë sonë, që synonin të përçanin Partinë, të ngjallnin pakënaqësi ndaj udhëheqjes së saj, të vinin në dyshim drejtësinë e vijës së Partisë sonë, të atakonin udhëheqjen e Partisë sonë, duke pasur si qëllim likuidimin e saj. Në këtë drejtim punuan njerëzit e ambasadës sovjetike në Tiranë, me ambasadorin në krye, në këtë drejtim veproi Kozllovi në Moskë ndaj shokëve tanë që kalonin andej, këtë synonin fjalët e mareshalit Malinovski në drekën e shefave të shtabeve të Traktatit të Varshavës, për këtë qëllim filluan presionet ekonomike lidhur me bukën dhe pakësimi i ndihmave ekonomike, me këtë kanë lidhje kërcënimet e mareshalit Greçko për të nxjerrë vendin tonë nga Traktati i Varshavës, apo provokacionet në bazën ushtarake të Vlorës etj.

Qëllimi i këtyre veprimeve të gabuara e antimarksiste është i qartë: *udhëheqja sovjetike synonte që ose ne të ndryshonim qëndrim, pra të hiqnim dorë nga rruga e drejtë marksiste-leniniste, nga pozitat parimore ku qëndronte Partia jonë, ose, si rezultat i vështirësive që do të krijoheshin, sipas mendimit të udhëheqësve sovjetikë, të ndodhte ndonjë përçarje në Parti, të rritejshin pakënaqësitë në radhët e saj dhe të popullit dhe, si rrugëdalje, të likuidohej udhëheqja e Partisë për të ardhur në krye të saj «shpëtimtarët», që do të ishin besnikë të vijës antimarksiste të udhëheqjes sovjetike.*

Por, siç dihet, të gjitha llogaritë ishin bërë pa han-

xhinë, të gjitha këto qëllime dështuan. Ata nuk patën sukses në saje të besnikërisë së Partisë sonë ndaj marksizëm-leninizmit, në saje të qëndrimit të saj burror e parimor, në saje të unitetit të çeliktë marksist-leninist të Partisë me masat e popullit, të Partisë me Komitetin e saj Qendror, të Komitetit Qendror me Byronë Politike. Ky unitet i pathyeshëm ka qenë dhe është garanci për të gjitha fitoret e popullit e të Partisë sonë, prandaj detyra jonë kryesore është që gjithnjë e më shumë ta forcojmë dhe ta ruajmë si shtëpi të ballit këtë unitet.

Burimi i veprimeve të gabuara të udhëheqjes sovjetike ndaj Partisë sonë duhet gjetur te pikëpamjet e saj jomarksiste ndaj çështjeve themelore dhe te mosmarrëveshjet parimore që ka Partia jonë me udhëheqësit sovjetikë për çështjet parimore të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Në veprimet e gabuara të udhëheqësve sovjetikë kundrejt Partisë sonë shprehet edhe koncepti antimarksist që kanë ata për marrëdhëniet midis partive motra e vendeve vëllezër, koncepti që kanë për kritikën dhe unitetin marksist-leninist të lëvizjes komuniste dhe të kampit socialist. Ne u shprehëm në Bukuresht kundër qëndrimit të udhëheqësve sovjetikë, ne kritikuan në rrugë të drejtë parimore veprimet e tyre të shtrembra.

Për marksistët kritika e drejtë e parimore nuk është në kundërshtim me unitetin, përkundrazi, kritika ndihmon forcimin e unitetit, është një forcë lëvizëse, një ligj i zhvillimit. Udhëheqësit sovjetikë nuk e shohin kështu problemin. Ata nuk janë mësuar të dëgjojnë kritika, po vetëm të bëjnë. Ata me fjalë pranojnë të drejtat e barabarta në marrëdhëniet midis partive, por

në fakt njohin vetëm të drejtën e tyre që të thonë fjalën e fundit, kurse të tjerët të zbatojnë qorrazi. Prandaj, sipas tyre, nëse ndonjë parti ka guxim dhe i kritikon, ajo parti është në pozita antisovjetike, është fraksioniste, është kundër unitetit të lëvizjes komuniste etj. Ky koncept i shtrembër i shtyn ata edhe në veprime të gabuara si ato që përmendëm më sipër. Në konceptet dhe në veprimet e mësipërme dialektika marksiste është zëvendësuar me metafizikën, me idealizmin.

Veprimet që përmendëm dhe qëndrimi i gabuar që mbajtën udhëheqësit sovjetikë ndaj Partisë e vendit tonë pas Mbledhjes së Bukureshtit, na forcuan edhe më shumë bindjen se Partia jonë ishte në pozita të drejta marksiste-leniniste, se pozita e saj në të gjitha çështjet themelore ishte parimore, prandaj ajo duhej mbrojtur me vendosmëri duke kundërshtuar çdo presion.

Këtë qëndrim të drejtë e parimor mbajti delegacioni i Partisë sonë në tetor në Moskë, në mbledhjen e komisionit që përgatiti projektin e deklaratës që aprovoi Mbledhja e nëntorit. Në këtë mbledhje delegacioni ynë hapur paraqiti pikëpamjen e drejtë të Partisë sonë për të gjitha çështjet parimore që ishin në diskutim dhe me argumente e me vendosmëri, bashkë me shokët kinezë dhe shokët e atyre partive të tjera që qëndronin gjithashtu në pozita të drejta, mbrojti mësimet marksiste-leniniste. Në komision u bë një luftë e madhe parimore, për çdo çështje, për çdo paragraf, për çdo fjalë. Kjo punë zgjati afro 25 ditë.

Për të krijuar një ide për luftën e drejtë që bëri atje delegacioni ynë, si dhe delegacionet e tjera që qëndronin në pozita të shëndosha, mjafton të përmën-

dim këto fakte: për përpilimin e projektdeklaratës u muar për bazë projekti i paraqitur nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Ky projekt prej 36 faqesh përmbante shumë pikëpamje të gabuara dhe në shumë vende kishte sulme të maskuara kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë. Për shembull, na akuzonte për «komunizëm nacional», si kundërshtarë të politikës së bashkekzistencës paqësore, na krahasonin me Jugosllavinë, na akuzonin si «fraksionistë» etj. Veç kësaj, projekti nuk theksonte si duhet luftën kundër imperializmit, kishte një frymë të butë dhe shpesh oportuniste, theksonte shumë rrugën paqësore të kalimit në socializëm, borgjezia nacionale paraqitej gati si partizane e socializmit, për revizionizmin jugosllav nuk flitej, dogmatizmi paraqitej më i rrezikshëm se revizionizmi, megjithëse thuhej për këtë si rrezik kryesor etj. Për këtë projekt u paraqitën 175 faqe vërejtje, prej të cilave vetëm delegacioni ynë paraqiti 20 faqe dhe delegacioni kinez 40 faqe. Duhet theksuar se asnjë nga vërejtjet tona nuk u hodh dot poshtë me argumente si e padrejtë, por ato që nuk u përfshinë në deklaratë u rrëzuan nën pretekstin e taktikës ose me shumicën e votave. Megjithatë, projekti-bazë ndryshoi thuajse krejtësisht. Ai u zgjerua nga 36 në 52 faqe. U hodhën poshtë sulmet e maskuara kundër nesh, u forcua pjesa mbi imperializmin, u shtua paragrafi mbi revizionizmin jugosllav, u rregullua çështja e luftës kundër revizionizmit dhe dogmatizmit etj. Megjithatë, mbetën disa çështje si ajo e rëndësisë së kongreseve XX e XXI, ajo e fraksioneve, e kultit të individit etj., me të cilat delegacioni ynë, ai

kinez dhe delegacionet e disa partive të tjera nuk ishin dakord, por që do t'i ridiskutonte Mbledhja e nëntorit.

Në mbledhjen e komisionit u duk qartë se sa të drejta e parimore ishin pozitat tona dhe sa të shtrembra ishin pozitat e udhëheqësve sovjetikë e të partive që i përkrahnin. Atje dukej sheshit fryma oportuniste që ka mbërthyer disa parti, si Partinë Komuniste të Italisë, të Sirisë, të Anglisë, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të tjera, gjë që doli më qartë edhe në Mbledhjen e nëntorit. Udhëheqësit sovjetikë u përpoqën shumë të manovronin, duke përdorur gjithfarë metodash: që nga puna individuale me delegacionet e ndryshme dhe deri te makinacionet proceduriale. Tipik është fakti i mëposhtëm: komisioni aprovoi që të vihej në projekt-deklaratë një frazë që kishte thënë ato ditë në një fjalim Moris Torezi dhe pikërisht: «Garanci absolute për likuidimin e çdo lloj lufte do të ketë vetëm atëherë kur të triumfojë socializmi në të gjitha vendet ose në vendet kryesore kapitaliste». Kjo tezë u fut me propozimin e delegacionit francez dhe u mbështet nga delegacioni ynë dhe ai kinez. Mirëpo nuk shkuan dy ditë dhe me propozimin e sovjetikëve u kërkua që të rishikohej, sepse, siç duket, presidiumi i tyre nuk e kishte aprovuar. Me gjithë rezistencën tonë, shumica e mbledhjes vendosi ta heqë, por në Mbledhjen e nëntorit, në një formë tjetër, u detyruan ta vënë përsëri.

Puna në komisionin përgatitor dhe pikëpamjet që u shfaqën atje treguan qartë se Mbledhja e Moskës në nëntor do të ishte arenë e luftës midis pikëpamjes së drejtë marksiste-leniniste dhe tendencës për t'u larguar nga pozitat revolucionare të ideologjisë sonë.

Për këtë luftë u pregatit Partia jonë dhe delegacioni që caktoi Komiteti Qendror i Partisë. Komiteti Qendror i Partisë sonë e porositi delegacionin e tij që në Mbledhjen e Moskës, hapur dhe sinqerisht, me kurajë marksiste-leniniste, të shtronte pikëpamjen parimore të Partisë sonë për të gjitha çështjet në diskutim, të njoftonte mbledhjen për veprimet e gabuara të udhëheqësve sovjetikë pas Mbledhjes së Bukureshtit kundrejt Partisë sonë dhe t'i kritikonte ata ashpër me qëllim që veprime të tilla të mos përsëriteshin më në të ardhshmen. Ne i raportojmë Komitetit Qendror të Partisë sonë se delegacioni e zbatoi këtë direktivë dhe të gjitha çështjet, ashtu siç i kishte vendosur Komiteti Qendror i Partisë, i shtroi përpara Mbledhjes së përfaqësuesve të 81 partive komuniste e punëtore që u mbledh në nëntor të këtij viti në Moskë.

A veprimi drejt Komiteti Qendror i Partisë kur vendosi që të gjitha çështjet t'i shtronte hapur në Mbledhjen e nëntorit? Ne përgjigjemi: Po, Komiteti Qendror vendosi shumë drejt, për këto arsye:

1. — Sepse ne e kishim për detyrë, si Parti marksiste-leniniste, të mbronim pozitën parimore të Deklaratës së Moskës [1957], të cilat po shkeleshin. Ne nuk do t'i thoshim vetes komunistë, në qoftë se do të heshtnim përpara shtrembërimeve të marksizëm-leninizmit, përpara veprimeve që ishin në kundërshtim me parimet themelore të ideologjisë sonë, pavarësisht se shkelësit e deviatorët, në rastin konkret, ishin udhëheqësit e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Për të mbrojtur pas-tërtinë e marksizëm-leninizmit, për të mbrojtur çështjen e socializmit dhe të komunizmit, ne duhet të jemi

kurdoherë parimorë dhe asnjëherë as sentimentalë, as të njëanshëm.

2. — Sepse në shkeljen e Deklaratës së Moskës [1957] dhe të parimeve të marksizëm-leninizmit, si dhe në veprimet konkrete, nga udhëheqja sovjetike u shkua aq larg sa, po të mos flitej për këto gabime e faje të rënda, do të ishte vetëvrasje, krim ndaj çështjes sonë të përbashkët. Mbledhja e Bukureshtit dhe prapaskena antimarksiste që u organizua atje nga udhëheqësit sovjetikë, presionet dhe veprimet e dëmshme kundër Partisë sonë, nga njëra anë, dhe kundër Partisë Komuniste të Kinës, nga ana tjetër (kam parasysh largimin e specialistëve, anulimin e porosive të makinerive të ndryshme etj.), ishin shenjat e para të një aksioni shumë të rrezikshëm, që, po të mos demaskohej, do të kishte pasoja akoma më serioze për lëvizjen komuniste dhe për kampin socialist.

3. — Sepse kritika jonë e sigurtë dhe parimore, kishte një qëllim të mirë: ajo, duke dënuar pikëpamjet dhe veprimet e gabuara, synonte t'i likuidonte ato, t'u mbyllte derën për të mos u përsëritur më, të pastronte atmosferën nga shfaqjet negative dhe mbi këtë bazë të ndihmonte për forcimin e lëvizjes sonë komuniste, për çelikosjen e unitetit tonë që po rrezikohej. Ky, dhe asnjë qëllim tjetër, e shtyu me të drejtë Komitetin Qendror të Partisë që pikëpamjen e tij ta thoshte hapur.

4. — Më në fund, ne themi me bindje të plotë se Komiteti Qendror veproi drejt kur vendosi t'i shtronte këto çështje në Mbledhjen e Moskës edhe për një arsye tjetër. Ne e pamë vetë, si para mbledhjes, ashtu edhe gjatë zhvillimit të saj, se udhëheqësit sovjetikë nga ana e tyre, ishin të vendosur të vazhdonin në rrugën që ki-

shin nisur kundër Partisë sonë, se ata, në qoftë se ne do të heshtnim, ishin përgatitur për të na bërë ne për çdo gjë fajtorë dhe për këtë arsye ushtruan mbi delegacionin tonë një presion të jashtëzakonshëm, me qëllim që të na mbyllnin gojën.

Është e qartë se, po të heshtnim ne në mbledhje për veprimet e gabuara të udhëheqësve sovjetikë, kjo jo vetëm do të thoshte heqje dorë nga e gjithë vija jonë parimore, por do të ishte fatale për Partinë tonë dhe për fatet e socializmit në Shqipëri.

III. — MBI QËNDRIMIN E UDHËHEQËSVE SOVJETIKË NDAJ DELEGACIONIT TONË DHE TAKIMET TONA ME TA

Siç dihet, delegacioni ynë vajti në Bashkimin Sovjetik si delegacion zyrtar, i ftuar nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për festimin e 43-vjetorit të Revolucionit Socialist të Territorit. Duke qenë kështu nga ana formale na u bënë të gjitha nderimet. Por qëndrimet me ne ishin të ftohta dhe bisedat jomiqësore. Kështu ne biseduam me Kozllovin ditën që arritëm në Moskë, me Kosiginin e me Poljanskin në darkën e 7 nëntorit dhe u duk qartë pozita e tyre: ata në çdo gjë kërkonin të bënin fajtorë Partinë tonë. Të nesërmen, domethënë më 8 nëntor, çdo gjë u bë akoma më e qartë.

Më 8 nëntor neve na u dorëzua kopja e letrës që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik i dërgonte Komitetit Qendror të Partisë Komu-

niste të Kinës si përgjigje të letrës së shtatorit të Partisë Komuniste të Kinës. Në vetvete ky fakt nuk na pëlqeu, sepse ishte një parathënie e keqe për zhvillimin e mbledhjes, por për këtë do të flasim më poshtë. Ajo që na bëri përshtypje ishin faktet e mëposhtme: Në letër, në një paragraf ku përmendeshin të gjitha vendet socialiste të Evropës, radhiteshin me emër të gjitha, me përjashtim të Shqipërisë. Kjo do të thoshte se udhëheqja e Bashkimit Sovjetik e kishte fshirë Shqipërinë nga defteri si një vend socialist. Më poshtë, megjithëse letra i drejtohej Partisë Komuniste të Kinës, kishte një sulm të hapur dhe tendencioz kundër Partisë sonë. Duke pretenduar se në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që pas kritikës kundër «kullit të individit», çështjet gjoja zgjidhen sipas rregullave të centralizmit demokratik, në letër thuhej:

«Por për fat të keq ka edhe shembuj të tjerë. Ne mund të biem një shembull të tillë të freskët siç është zgjidhja e çështjeve të tilla nga shokët shqiptarë. Në shtator të këtij viti ata përjashtuan nga Komiteti Qendror dhe shkarkuan nga posti i sekretarit të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, shoqen Liri Belishova, ndërsa shokun Koço Tashko e shkarkuan nga posti i kryetarit të Komisionit Qendror të Revizionimit të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e përjashtuan nga Partia. Dhe për çfarë? Vetëm sepse këta shokë shprehën mendimet e tyre se është e palejueshme të shahet Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Ne shprehim dyshime, se mund të ketë një mbarim të keq për të gjithë ata njerëz, «faji» i të cilëve që-

ndron vetëm në atë, se ata janë miqtë e Bashkimit Sovjetik, kuptojnë në mënyrë të drejtë situatën dhe shprehin simpatinë e tyre ndaj popullit sovjetik, ndaj Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik».

Sipas kësaj mënyre të shtruarjes së çështjes del: *Së pari*, se Komiteti Qendror i Partisë sonë nuk paska zbatuar rregullat e demokracisë së brendshme të Partisë, kur përjashtoi nga radhët e tij Liri Belishovën e nga radhët e Komisionit Qendror të Revizionimit Koço Tashkon. Më duket se është e tepërt të provojmë këtu, në Komitetin Qendror të Partisë, se kjo është shpifje tendencioze. *Së dyti*, del se në Partinë tonë po dënohen e persekutohen miqtë e Bashkimit Sovjetik, pra, se Komiteti Qendror i Partisë sonë qenka në pozita antisovjetike etj. Që edhe kjo është një shpifje tjetër, gjithashtu nuk është nevoja të provohet. Por në këto akuzat tendencioze duket qartë qëllimi i udhëheqjes sovjetike: të diskreditojë Partinë tonë, ta paraqitë atë sikur ka dalë nga binarët e leninizmit, sikur ka marrë rrugën e Jugosllavisë (prandaj, po në të njëjtin dokument, Shqipëria nuk përmendet si vend socialist).

Kjo tregon se udhëheqësit sovjetikë nuk interesoheshin që të zgjidheshin mosmarrëveshjet që kishin lindur midis nesh, përkundrazi ata donin t'i thëllonin dhe, bile, t'i përdornin ato për të diskredituar Partinë tonë. Nga ana tjetër, që të kishin sukses të plotë në veprimin e tyre kundër Partisë sonë, ata përdorën të gjitha mjetet që të na mbyllnin gojën.

Metoda e parë ishte ajo e kërcënimit. Për këtë qëllim vetë Nikita Hrushovi dy herë u foli shokëve kinezë për Shqipërinë. Herën e parë më 25 tetor [1960] i tha

shokut Ten Hsiao Pin se «ne do ta trajtojmë Shqipërinë si Jugosllavinë», dhe herën e dytë i tha një përfaqësuesi tjetër të PK të Kinës se «shqiptarët sillen me ne ashtu siç sillet Titoja me ne», se «ne humbëm një Shqipëri, kurse ju kinezët fituat një Shqipëri», se «Partia e Punës e Shqipërisë është hallka jonë e dobët».

Cili ishte qëllimi i tyre?

Së pari, udhëheqësit sovjetikë synonin që të na frikësonin ne, të na bënin të rishikonim pozitën tonë dhe të hiqnim dorë nga shtrimi i të gjitha çështjeve që ne kishim menduar. Duhet pasur parasysh se sovjetikët pak a shumë ishin në korent se çfarë do të shtronim ne në Mbledhjen e Moskës. Ata i kishte vënë në korent për pikëpamjet tona Koço Tashkoja.

Së dyti, duke folur kundër Partisë sonë dhe duke na kërcënuar ne, ata paralajmëronin në fakt edhe kinezët, pra me një të shtënë mendonin të vritnin dy zogj.

Dhe së treti, duke e paraqitur çështjen sikur ne po ndiqnim rrugën e Jugosllavisë, udhëheqësit sovjetikë kërkonin të diskreditonin Partinë tonë, të shtrembëronin qëndrimin tonë, të largonin diskutimin nga baza parimore në shpifje etj.

Bashkë me metodën e kërcënimeve indirekte, udhëheqësit sovjetikë përdorën edhe metodën e presioneve direkte, të takimeve e të bisedimeve me delegacionin tonë.

Para se të flasim mbi takimet që patëm në Moskë, është e nevojshme të themi dy fjalë lidhur me pikëpamjen tonë ndaj metodës së bisedimeve, të takimeve dhe të konsultimeve. Kjo është e domosdoshme, sepse udhëheqësit sovjetikë u përpoqën shumë herë ta paraqitnin çështjen sikur ne jemi kundër bisedimeve dhe

për këtë sollën këta shembuj: refuzimin tonë për t'u takuar me udhëheqësit sovjetikë sipas propozimit që ata bënë me letrën e njohur të 13 gushtit [1960]; faktin që shoku Enver nuk shkoi për pushime gjatë verës në Bashkimin Sovjetik, gjoja sikur ne donim të evitonim çdo takim dhe, më në fund, refuzimin që i bëmë ne ftesës së Hrushovit për t'u takuar me të më 9 nëntor, për të cilën do të flas më poshtë.

Partia dhe Komiteti ynë Qendror kurdoherë kanë qenë dhe janë të mendimit se metoda e takimeve, e bisedimeve dhe e konsultimeve midis udhëheqësve të partive motra, shkëmbimi i pikëpamjeve mbi probleme të ndryshme të interesit reciprok dhe aq më tepër kur midis dy partive apo vendeve socialiste kanë lindur mosmarrëveshje, është metoda më e drejtë, metodë e këshillueshme marksiste-leniniste. Prandaj, as në të kaluarën as në të ardhshmen, Partia jonë dhe Komiteti i saj Qendror nuk kanë refuzuar dhe nuk do të refuzojnë asnjë takim, aq më tepër kur qëllimi i tyre është të forcojmë e të çelikosim unitetin marksist-leninist të kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Por duke u nisur nga këto pozita parimore, Partia jonë njëkohësisht është e mendimit se në këto takime duhet të respektohen gjithashtu edhe disa parime të tjera të marksizëm-leninizmit, midis të tjerave: *Së pari*, është e palejueshme dhe në kundërshtim me normat leniniste që në një takim të dy partive të bisedohet për një parti të tretë, të merret nëpër gojë vija e saj e përgjithshme, pa qenë e pranishme kjo parti, dhe *së dyti*, çdo bisedim apo takim midis dy partive, cilatdo qofshin ato, duhet të bëhet në kushte të barazisë, mbi bazën e kon-

sultimit dhe të respektit reciprok, duke përjashtuar çdo shfaqje të imponimit të vullnetit të njëjës palë, palës tjetër, ose të çdo pozite të privilegjuar të njëjës palë mbi palën tjetër etj. Këto parime Partia jonë i ka respektuar dhe do t'i respektojë. Kjo është pozita parimore e Partisë sonë në lidhje me çështjen e takimeve, të bisedimeve dhe të konsultimeve. Këtë pozitë kemi pasur në të kaluarën, këtë do të mbajmë edhe në të ardhshmen.

Tani le të shohim konkretisht, a kanë të drejtë udhëheqësit sovjetikë kur na akuzojnë se ne jemi kundër takimeve, duke sjellë rastet që përmenden më sipër? Është e vërtetë që ne e refuzuam takimin e propozuar në letrën e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të 13 gushtit 1960. Por ne refuzuam të takohemi jo pse në parim nuk jemi për takimet, ose pse donim t'i shmangeshim takimit me udhëheqësit sovjetikë, por sepse një takim i tillë do të ishte në kundërshtim me normat leniniste, sepse, siç dihet, në letrën e tyre udhëheqësit sovjetikë propozonin të diskutonim për të shuar «në kohën e duhur shkëndijën e keqkuptimit» që lindi midis nesh në Bukuresht, në mënyrë që në Mbledhjen e nëntorit të dyja partitë tona «të shkojnë me një unitet të plotë mendimesh». Po përse lindi keqkuptimi në Bukuresht? Cili ishte problemi themelor i Mbledhjes së Bukureshtit? Ishte kritika ndaj Partisë Komuniste të Kinës. Pra, ne duhej të diskutonim lidhur me Kinën, të formulonim pikëpamjen e përbashkët mbi këtë çështje dhe gjithë kjo punë të bëhej prapa shpinës së Partisë Komuniste të Kinës. A është kjo parimore? A nuk ngjet kjo me një punë fraksioniste? Këto ne ia shpjeguam Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të

Bashkimit Sovjetik në letrën tonë të përgjigjes qysh në gusht, duke theksuar se një takim midis nesh për një qëllim të tillë nuk është i drejtë. Ne përsëri mendojmë se kemi vepruar shumë drejt.

Të marrim çështjen e refuzimit nga ana jonë për t'u takuar me Nikita Hrushovin në datën 9 nëntor 1960. Ne mendojmë se drejt veproi delegacioni që e refuzoi atë takim dhe këtë ua shpjeguam udhëheqësve sovjetikë. Çështja është se, nga njëra anë, në datën 8 nëntor 1960 udhëheqja sovjetike na dorëzoi letrën që i adresoj Partisë Komuniste të Kinës, ku, siç thamë më sipër, Shqipëria nuk radhitej si vend socialist dhe akuzoj Partia jonë si antisovjetike, që ka shqelmuar gjoja parimet e centralizmit demokratik etj. dhe ky material u ishte shpërndarë përfaqësuesve të 81 partive, kurse, nga ana tjetër, po atë ditë na ftonin të bisedonim për të shqyrtuar mosmarrëveshjet që kanë lindur midis nesh! Shokëve kinezë u thonë, nga njëra anë, se «ne do ta trajtojmë Shqipërinë si Jugosllavinë» e, nga ana tjetër, kërkojnë të takohen me ne! A ka këtu kushte të barabarta për bisedime? A është krijuar baza për një frymë shoqërore, e domosdoshme për bisedime të frytshme? A nuk shprehet qartë këtu tendenca e udhëheqësve sovjetikë për të pasur ata pozitë të privilegjuar në bisedime? Është e qartë se në kushte të tilla ne nuk mund të bisedonim, sepse kjo është në kundërshtim me parimet e barazisë e të respektit reciprok, aq më shumë se deri atëherë ne, para lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, nuk kishim thënë as gjysmë fjale për mosmarrëveshjet konkrete që kishim me udhëheqësit sovjetikë. Ja pse e refuzuam atë takim. Komiteti Qe-

ndror i Partisë le të gjykojë nëse veproi drejt apo jo delegacioni ynë.

Përsa i përket çështjes «së mosvajtjes për pushime të shokut Enver këtë vit në Bashkimin Sovjetik», për këtë nuk do t'ia vlente barra qiranë të thuhej asnjë fjalë, sepse këtu s'ka asgjë politike. Edhe vitin e kaluar unë nuk vajta për pushime në Bashkimin Sovjetik, e megjithatë nuk u bë ndonjë skandal. Çështja është se këtë vit udhëheqësit sovjetikë «paskan menduar» se kur të shkonte shoku Enver për pushime do të bisedonin me të! Por për këtë gjë asnjë njoftim nuk kishte as Byroja Politike as unë vetë. Duhej të shtinin «fall» për një gjë të tillë që ta gjenim.

Në fakt, jo Partia jonë, por udhëheqësit sovjetikë kanë qenë kundër bisedimeve, kundër zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me anë të konsultimeve. Siç dihet, qysh në fillim të gushtit, ne i dërguam Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik një letër në lidhje me veprimet antimarksiste të disa punonjësve të ambasadës sovjetike me ambasadorin Ivanov në krye. Pse udhëheqësit sovjetikë, të cilët tregohen të vendosur t'i zgjidhin çështjet me bisedime, as sot e kësaj dite nuk na janë përgjigjur? Në Moskë ata na thanë se nuk na janë përgjigjur ngaqë gjoja nuk donin të acaronin marrëdhëniet, pse përgjigjja e tyre mund të ishte fyese për ne. Kjo tregon qartë se ata as nuk e shkonin ndër mend se duheshin zgjidhur mosmarrëveshjet, se duhej biseduar për këtë qëllim, por kishin vendosur një qëndrim: të mohonin çdo gjë. Atëherë përse të bisedohet? Dhe kush në fakt është kundër bisedimeve? Është e qartë se jo ne, jo Partia e Punës e Shqipërisë, por kundër bi-

sedimeve është udhëheqja e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Pavarësisht nga të gjitha këto, me gjithë kushtet jo të barabarta për bisedime, që, siç e thamë, i krijuan vetë udhëheqësit sovjetikë, dhe me gjithë qëndrimet e tyre joshoqërORE ndaj delegacionit tonë, të cilat shkuan aq larg sa u vunë në përdorim edhe metoda të tilla antmarksiste e policore, si përgjimi i bisedimeve tona me anë aparatesh speciale, qoftë në selinë ku banonim, qoftë në ambasadën tonë, delegacioni ynë, duke parë insistimin e tyre për t'u takuar dhe duke iu përmbajtur parimit të Partisë sonë mbi nevojën e bisedimeve, të konsultimeve dhe të shkëmbimit të mendimeve, para se të fillonte mbledhja, si dhe gjatë saj, pranoi dhe zhvilloi tri biseda me udhëheqësit sovjetikë.

Qëllimin e vërtetë të udhëheqësve sovjetikë delegacioni ynë e kuptoi nga bashkëbisedimet që pati më 9 nëntor 1960, me Moris Torezin, i cili, siç doli qartë nga biseda, ishte ngarkuar prej tyre për t'u takuar me ne. Torezi u përpoq të na «bindte» për drejtësinë e vijës që ndjek Bashkimi Sovjetik në të gjitha drejtimet, në çështjen e luftës dhe të paqes, në politikën e bashkekzistencës paqësore, e quajti Hrushovin si Leninin e sotëm etj. Nga ana tjetër, foli kundër Kinës duke e paraqitur Partinë Komuniste të Kinës si «dogmatike, fraksioniste e trockiste, si rrezik të madh për lëvizjen komuniste, partizane të luftës, që kërkon të diskreditojë Bashkimin Sovjetik» etj. Më në fund, na foli për dashurinë që ushqen Bashkimi Sovjetik për Shqipërinë, për ndihmat që i ka dhënë ai Shqipërisë, se si ne duhet t'i jemi mirënjohës dhe më në fund tha

se të gjithë duhet ta ndjekim e të vemi pas Bashkimit Sovjetik.

Ne i folëm për pikëpamjet tona, duke i theksuar se kemi mosmarrëveshje me udhëheqësit sovjetikë, të cilat do t'i shtrojmë në mbledhje (çdo gjë që ne thoshim e kishim parasysh që përgjohej nga udhëheqësit sovjetikë ose që do t'u transmetohej atyre nga Torezi). Torezi u përpoq të na «bindë» për të mos i shtruar këto çështje në mbledhje, se përndryshe gjithë mbledhja do të ngrihej kundër nesh dhe do të na quante provokatorë, se këto gjëra duhej t'i zgjidhnim me udhëheqësit sovjetikë shtruar, në bisedime dhe këtu përmendi se gjoja kishim bërë keq që nuk u takuam me Hrushovin. Takimi me Torezin zgjati tri orë dhe më në fund të dyja palët u ndamë duke ruajtur secila pikëpamjet e veta. Ky ishte presioni i parë direkt që të mos flitnim hapur në mbledhje dhe përpjekja për të mësuar se çfarë do të shtronim atje.

Pas këtij takimi u bënë dy takimet me udhëheqës sovjetikë, në datën 10-11 dhe 12 nëntor.

Në takimin e parë u paraqitën pikëpamjet e secilës palë dhe, si të thuash, u pregatit terreni për takimin e dytë që ishte në fakt takimi zyrtar. Në ditën e parë të këtij takimi nga pala sovjetike merrnin pjesë Kozllovi, Mikojani, Susllovi, Pospjellovi dhe Andropovi, ndërsa ditën e dytë vetëm Kozllovi e Mikojani. Kurse nga pala jonë në takim merrte pjesë gjithë delegacioni.

Qysh në fillim të takimit udhëheqësit sovjetikë u paraqitën sikur nga ana e tyre nuk ka ndodhur asgjë, sikur fajin për çdo gjë e ka Partia e Punës e Shqipërisë, se bile ne duhej të flitnim hapur, pse po

i acarojmë marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, ç'ka ndodhur dhe ç'kërkojmë nga udhëheqësit sovjetikë. Në fakt ky qe qëndrimi edhe në takimet e mëvonshme. Natyrisht, delegacioni ynë e hodhi poshtë një pretendim të tillë dhe me fakte konkrete provoi se jo ne, por udhëheqësit sovjetikë, me qëndrimet dhe me veprimet e tyre të gabuara kundër Partisë dhe vendit tonë, ishin bërë shkaktarë të acarimit të marrëdhënieve tona. Ne u përmendëm çështjen e ambasadorit dhe të punonjësve të ambasadës, çështjen e bukës, fjalët e Malinovskit dhe të Greçkos, punën antiparti të Kozllovit me delegacionin tonë që kthehej nga Kina, veprimet e shtrembra të disa oficerëve sovjetikë në bazën e Vlorës etj. Të gjitha këto fakte, theksuam, nuk janë të shkëputura, por të lidhura njëra me tjetrën. Të gjitha këto kanë ndodhur pas Mbledhjes së Bukureshtit dhe kanë karakter politik. Qëllimi i tyre ka qenë ta detyronin Partinë tonë të ndryshonte qëndrimin që mbajti në Bukuresht, të minonin unitetin e Partisë, të përçanin dhe ta rrëzonin udhëheqjen e saj. Ne u kërkuam udhëheqësve sovjetikë që, për të përmirësuar marrëdhëniet midis dy partive e vendeve tona, gjë që është dëshira e Partisë sonë, si dhe për të forcuar miqësinë tonë, ata duhet t'i dënojnë këto veprime dhe të marrin masa që të mos përsëriten në të ardhshmen.

Udhëheqësit sovjetikë asgjë nuk pranuan sinqerisht dhe hapur, por të gjithave kërkuam t'u bënin bisht. Ata shumë herë përsëritën tezën se gjoja Partia jonë është fajtores për acarimin e gjendjes, se gjoja ajo nuk është për bisedime, siç e theksuam më sipër. U përpoqën të mohojnë veprimet e diplomatëve sovjetikë në Tiranë,

por, më në fund, u detyruan të pranojnë se mund të jetë bërë ndonjë «gabim i vogël» nga «budallallëku» i ambasadorit. Thanë se tani do të dërgojnë ambasador tjetër dhe çdo gjë merr fund. Çështjen e bukës e paraqitën sikur ne nuk ishim aq keq, sepse ishin dërguar vaporë me bukë në Shqipëri, ndërsa për çështjen e blerjes së drithit me flori thanë se ky ishte propozim i palës shqiptare, të cilin e pranuan njerëzit e tregtisë së jashtme sovjetike. Po kështu u përpoqën të justifikonin qëndrimet e mareshalëve Malinovski dhe Greçko, duke pranuar se edhe po të jetë thënë ndonjë gjë e tepërt, kjo është e rastit e pa qëllim. Pra, sipas tyre, në të gjitha këto veprime, nuk ka asgjë politike. Partia jonë kot kërkoi t'u japë këtë ngjyrë, këto janë gjëra të vogla etj.!

Ishte e qartë se ata nuk donin të pranonin asgjë. Kurse edhe për atë çka pranonin, e bënë sa për sy e faqe e me gjysmë zëri, me qëllim që ne të mos i thoshim në mbledhje. Faktet e mëvonshme e treguan më së miri këtë gjë. Në përgjigjen që u shpërndau më 1 dhjetor 1960 delegatëve të mbledhjes lidhur me fjalimin tonë, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik nuk pranoi asgjë, përkundrazi u përpoq të hidhte poshtë dhe mori nën mbrojtje si ambasadorin, ashtu edhe Malinovskin, Greçkon e të tjerë.

Gjatë bisedimeve ata u ndalën shumë për të akuzuar njerëzit tanë për situatën e rëndë që gjoja qenkej krijuar në bazën e Vlorës. Këtë fakt si edhe masat që mori Plenumi i Komitetit Qendror kundër Liri Belishovës dhe Koço Tashkos i përdornin si argumentim të një farë fryme antisovjetike që gjoja paska filluar në Shqipëri. Veçanërisht shumë folën për bazën detare.

Tani marrim vesh se gjithë ajo zhurmë që u bë në Moskë për bazën e Vlorës, paska qenë e koordinuar mirë me akte provokacioni dhe sjelljeje shumë të rrezikshme që disa elementë të këqij sovjetikë në ato ditë kishin ndërmarrë në bazën e Vlorës. Çdo gjë, siç duket, bëhej me plan. Këtu provokacionet, atje këto gjëra, përdorshin si argumente për të provuar se ne kemi ndryshuar qëndrim, se ne po acarojmë marrëdhëniet etj. Por as provokacionet këtu, as kërcënimet dhe akuzat false atje, nuk patën sukses. Këtu njerëzit tanë, të edukuar nga Partia, ditën të evitonin skandalet, duke mos rënë në grackën e provokacioneve të kurdisura, gjë që, më në fund, i detyroi provokatorët të hiqnin dorë nga planet e tyre; kurse atje delegacioni ynë, i bindur se komandantët dhe oficerët tanë zbatojnë me përpikëri direktivat e Partisë, hodhi poshtë çdo kërcënim dhe akuzë false, duke u theksuar udhëheqësve sovjetikë se Komiteti Qendror i Partisë sonë ka dhënë udhëzime të posaçme për bazën e Vlorës dhe ne jemi të bindur se atje asgjë nuk ka ndodhur e nuk do të ndodhë për fajin e njerëzve tanë, por shihni mirë punën e njerëzve tuaj. Dhe në fakt kështu ishte.

Si përfundim i bisedimeve të para, të cilat herë-herë u zhvilluan edhe me ton të lartë, të dyja palët njohën mendimet e njëra-tjetrës, por secila mbajti pozitën përkatëse. Vetëm se u arrit marrëveshja që të organizonim një takim tjetër, të nesërmen, ku delegacionin sovjetik do ta udhëhiqte Hrushovi. Ne u theksuam udhëheqësve sovjetikë se ishim dakord ta bënim edhe këtë takim, por ata, nga ana e tyre, duhej të reflektonin më mirë, të shihnin gjërat nën prizmin politik dhe të

mos i katandisnin në gjëra pa rëndësi ose në gabime të rastit e teknike, siç u përpoqën t'i shpjegojnë.

Më 12 nëntor u bë takimi zyrtar, në të cilin nga pala sovjetike merrnin pjesë Hrushovi, Mikoiani, Kozllovi dhe Andropovi, kurse nga ne — gjithë delegacioni.

Edhe ky takim u zhvillua njëlloj si i pari. Hrushovi mbajti të njëjtin qëndrim, duke e paraqitur çështjen se ata asgjë nuk kanë bërë, bile asgjë e keqe nuk i kujtohej që të mund të ketë shkaktuar zemërimin e shokëve shqiptarë, me përjashtim të kritikës që kishte bërë kur ishte në Shqipëri, për çështjen e plepave (!). Pasi ne i shtruum çështjen e ambasadorit, si dhe çështjen e asaj që ishte shkruar në letrën që u drejtohej shokëve kinezë kundër Partisë sonë, Hrushovi pranoi për sy e faqe si budallallëk veprimin e ambasadorit me ushtarakët tanë, por mbrojti dhe e quajti të drejtë çka ishte shkruar kundër Partisë sonë në letrën e 5 nëntorit drejtuar shokëve kinezë. Çështja kryesore e bisedës ishte problemi i bazës detare të Vlorës. Tanimë u bë e qartë, pse ngrihej kaq shumë kjo çështje dhe ç'kuptim kishin shantazhet ushtarake dhe provokacionet që organizoheshin ato ditë këtu. Hrushovi ngriti çështjen se në bazë është krijuar një gjendje e rëndë, se oficerët tanë po zihen me oficerët sovjetikë, se njerëzit tanë folkan kundër Hrushovit etj. Dhe, më në fund, shtroi çështjen se sovjetikët mund ta heqin bazën.

Ky ishte një kërcënim i hapur, i cili nga ana tjetër vërtetonte se të gjitha ato që ishin thënë më parë kundër Partisë sonë nuk ishin të rastit; pra, as ajo që tha mareshali Greçko se «Shqipëria hëpërhë është në Traktatin e Varshavës», as ajo që Hrushovi u tha sho-

këve kinezë se «ne do ta trajtojmë Shqipërinë si Jugosllavinë», as ajo që Gomulka u tha kinezëve se «derisa Shqipëria është anëtare e Traktatit të Varshavës ne nuk lejojmë që ajo të bëjë me kokë të vet, ndryshe do të mbledhim Traktatin e Varshavës që ta shohim çështjen e Shqipërisë».

Hrushovi, duke propozuar që të hiqte bazën, shprehu gjithë planin që, siç dukej, kishte bërë me shokët e tij. Ai me këtë deshi të kërcënojë Partinë tonë, por pa sukses. Ne ia hodhëm poshtë idenë e tij të shtrembër, e cilësuam atë si një gabim fatal, të cilin askush nga populli sovjetik nuk do ta pranonte, i thamë se nuk pijnë ujë kërcënimeve dhe se, po të duan që të shtrohet çështja e likuidimit të bazës, kjo duhet bërë nga mbledhja e Traktatit të Varshavës. Por ne deklaruar zyrtarisht se Partia e Punës e Shqipërisë nuk do të jetë asnjëherë dakord me një vendim të tillë, se ne jemi që baza të ruhet, sepse ajo u përgjigjet interesave të mbrojtjes së atdheut tonë. Ne u shtruam pyetjen udhëheqësve sovjetikë se, duke hequr dorë nga baza e Vlorës, mos vallë ata donin t'i linin fushë të lirë Flotës VI Amerikane në Mesdhe dhe të mos angazhoheshin në luftë me të në rast të një agresioni imperialist kundër vendit tonë?

Natyrisht, diskutimi i kësaj çështjeje kaq të rëndësishme i ashpërsoi shumë bisedimet, por ajo që e bëri të pamundur zhvillimin e tyre të mëtejshëm ishte konsiderata jomiqësore dhe e ulët e Hrushovit kur krahasoi bisedimet me ne si bisedimet me Makmilanin. Në këtë moment delegacioni ynë, në shenjë proteste, ndërpreu bisedimet dhe u largua nga salla.

Si konkluzion, mund të thuhet se udhëheqësit sovjetikë nuk donin të bisedonin, as të merreshin vesh për asgjë me ne. Ata planin e tyre, pikëpamjen e tyre e kishin përcaktuar. Për këtë kishin filluar të flitnin me të tjerët duke pasur një qëllim: diskreditimin e Partisë sonë. Në qoftë se ata kërkuan të bisedonin, këtë e bënë jo se donin t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet, por donin të na kërcënonin, të na detyronin që të hiqnim dorë nga fjalimi në mbledhje. Pas këtyre takimeve edhe një herë u duk qartë se kush ishte për bisedime e kush jo. Ato treguan edhe se udhëheqësit sovjetikë për çdo gjë që kishin bërë kundër Partisë sonë dhe kundër vendit tonë, nuk kishin ndër mend të bënin autokritikë, përkundrazi, siç e tregoi kërcënimi për bazën e Vlorës, ishin të vendosur që të shkonin më tutje.

Prandaj ne mund të përsëritim edhe një herë se në këto kushte Komiteti Qendror i Partisë veproi shumë drejt, bëri shumë mirë që vendosi t'i shtrojë dhe i shtroi të gjitha kontradiktat tona me udhëheqësit sovjetikë në Mbledhjen e përfaqësuesve të 81 partive komuniste e punëtore të botës në Moskë.

IV. — MBI ZHVILLIMIN E PUNIMEVE TË MBLEDHJES SË MOSKËS

Mbledhja e Moskës u organizua që të diskutonte problemet aktuale të gjendjes ndërkombëtare dhe çështjet e strategjisë e të taktikës së lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Bazë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes ishte projektdeklarata e pregatitur nga ko-

misioni i 26 partive, që, siç thamë, u mbledh në Moskë qysh në muajin tetor. Duke diskutuar për këto çështje mbledhja në fakt duhej të shprehej për mosmarrëveshjet që ishin shfaqur në gjirin e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, duhej të dënonte pikëpamjet e gabuara dhe të fiksonte në deklaratën që do të aproonte pikëpamjen e drejtë marksiste-leniniste, pikëpamjen unike të të gjithë lëvizjes komuniste mbi këto çështje.

Por qysh në fillim të mbledhjes, bile edhe para saj, u duk qartë se udhëheqësit sovjetikë dhe ata të disa partive komuniste të vendeve socialiste dhe kapitaliste të Evropës mendonin ndryshe. Shpërndarja e letrës së Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës në pragun e punimeve të mbledhjes dhe punimi i saj me të gjitha delegacionet e bëri më të qartë planin e udhëheqësve sovjetikë. Tendenca ishte të organizohej një Bukuresht i ri, të legalizoheshin jashtë mbledhjes të gjitha ato që u thanë në Bukuresht kundër Kinës, të krijohej opinionin në të gjithë se Partia Komuniste e Kinës është «dogmatike dhe fraksioniste», se «ajo ka shkelur Deklaratën e Moskës dhe vepron në kundërshtim me të gjithë lëvizjen komuniste, se bashkë me Partinë Komuniste të Kinës, të njëjtin kurs ndjek edhe Partia e Punës e Shqipërisë», kundër së cilës gjithashtu flitej në letrën e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Për të krijuar këtë opinion udhëheqësit sovjetikë, në ditët para fillimit të mbledhjes, organizuan një punë intensive përgatitore me delegacionet e ndryshme. Për

këtë qëllim punonin në mënyrë të veçantë delegacioni i Partisë Komuniste të Francës (me delegacionet e vendeve kapitaliste të Evropës), delegacioni i Partisë Komuniste të Spanjës dhe i Partisë Popullore të Kubës (me delegacionet e Amerikës Latine), delegacioni i Sirisë (me delegacionet e vendeve arabe e afrikane). Veç kësaj pune të organizuar, ku lexohej e komentohej letra e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e 5 nëntorit drejtuar Partisë Komuniste të Kinës, u zhvilluan edhe shumë takime e bisedime dypalëshe me delegacionin sovjetik dhe me delegacionet e vendeve socialiste të Evropës. Një punë e tillë, natyrisht, nuk mund të konsiderohet normale, përkundrazi, ajo është e shtrembër dhe antimarksiste. Ajo tregon, nga ana tjetër, se sa të dobëta janë pozitat e udhëheqësve sovjetikë, sepse ai që është në rrugë të drejtë dhe që u përmbahet mësimëve të Marksit e të Leninit nuk ka nevojë që, me metoda të gabuara, me presione e me përpunime të këllij lloji, të bëjë aleatë.

Duke bërë këtë punë përgatitore, jashtë mbledhjes, udhëheqësit sovjetikë synonin që vetë zhvillimit të saj t'i jepnin një karakter demonstrativ, ku të mbaheshin fjalime të përgjithshme, të bëheshin elozhe për sukseset e arritura, të mos zbuloheshin kontradiktat që ekzistojnë, por në mënyrë të maskuar të hidheshin thumba kundër pozitës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë Komuniste të Kinës dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë për çështjet themelore. Një zhvillim i tillë i mbledhjes do të ishte në favor të udhëheqjes sovjetike dhe të partive që përkrahnin pikëpamjen e saj, sepse, nga njëra anë, ata jashtë mbledhjes e bënë punën e tyre, krijuan

opinionin se Partia Komuniste e Kinës gjoja ka gabuar, bile se ajo është për luftën, për aventura, kundër bashkëzistencës paqësore etj. dhe nga ana tjetër, duke mos zbuluar në mbledhje kontradiktat, udhëheqësit sovjetikë paraqiteshin gjoja si partizanë të vendosur të ruajtjes së unitetit të lëvizjes komuniste dhe të kampit socialist, pra, tregoheshin «zemërgjerë» dhe evitonin diskutimin e vijës së tyre, të gabimeve të tyre, të devijimeve nga Deklarata e Moskës [1957] dhe nga mësimet e marksizëm-leninizmit.

Udhëheqësit sovjetikë e kishin të qartë se në mbledhje një diskutim i hapur i kontradiktave, do t'i diskreditonte ata përpara lëvizjes në shumë drejtime: *E para*, sepse ata kanë shkëlur Deklaratën e Moskës dhe kanë adoptuar një politikë pajtuese në luftën kundër imperializmit e revizionizmit; *e dyta*, sepse ata kanë thyer normat leniniste që rregullojnë marrëdhëniet midis shteteve socialiste dhe partive komuniste e punëtore, siç është rasti me Kinën e me Shqipërinë; *e treta*, sepse në sy të të gjithë lëvizjes komuniste, të përfaqësuesve të 81 partive komuniste e punëtore të botës, do të zhdukej opinioni i krijuar për pagabueshmërinë e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të udhëheqësve të saj, opinioni se Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe udhëheqësit e saj janë të pakritikueshëm, se çdo gjë që thonë ata «është ligj, është e drejtë, është fjala e fundit e marksizmit dhe, pra, e detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë» etj. etj.

Në përputhje me një taktikë të tillë, në Mbledhjen e Moskës, që ditën e parë të fillimit të saj, në emër të delegacionit sovjetik, foli Nikita Hrushovi. Fjalimi i tij

ishte në fakt orientim për frymën që duhej të kishin diskutimet në këtë mbledhje.

Fjalimi i Hrushovit ishte pregatitur me djallëzi, ai ndryshonte mjaft nga letra që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik i drejtoi më 5 nëntor Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, dhe që iu shpërnda gjithë delegacioneve para mbledhjes ku hapur akuzoheshin shokët kinezë për shkelje të Deklaratës së Moskës dhe të parimeve të marksizëm-leninizmit. Fjalimi që u mbajt në mbledhje ishte shkruar me një ton të tillë, sikur midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës nuk ekzistonin gati kurrfarë mosmarrëveshjes, bile në tërë fjalimin prej më se 80 faqesh nuk përmendej asnjëherë me emër Partia Komuniste e Kinës. Në fjalimin e Hrushovit jepeshin «argumente» kryesore në mbrojtje të tezave të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik lidhur me çështjet kryesore, për të cilat ka mosmarrëveshje, si për çështjen e luftës e të paqes, për problemet teorike të Kongresit XX, për çështjen e luftës kundër «fraksionizmit» në lëvizjen komuniste ndërkombëtare etj. Oratorët që përkrahën më vonë Hrushovin, si Zhivkovi e të tjerë, e quajtën fjalimin e Hrushovit si «zhvillim krijues të marksizmit» dhe përsëritën në forma të ndryshme argumentet e tij.

Megjithëse në fjalimin e Hrushovit bëhej orvatje për të mos i përmendur mosmarrëveshjet, për t'iu përmbytur një toni të moderuar, prapëseprapë, në mënyrë të kamufluar, përmbaheshin aluzione plot helm, që drejtoheshin në radhë të parë kundër shokëve kinezë, për një sërë problemesh të rëndësishme.

Hrushovi insistoi me forcë për të dënuar të ashtuquajturën veprimtari fraksioniste në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, duke deklaruar me hipokrizi se kjo tezë nuk drejtohej kundër ndonjë partie të veçantë dhe theksoi me të madhe se kushti vendimtar për arritjen e unitetit në lëvizjen komuniste ndërkombëtare është gjoja respektimi dhe zbatimi i vendimeve të shumicës nga pakica. Me këtë ai u dha vijën gjithë përkrahësve të tij në mbledhje për çështjen kyç dhe qëllimin e tij kryesor: dënimin dhe nënshttrimin e Partisë Komuniste të Kinës dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Menjëherë pas fjalimit të Hrushovit mbledhja filloi kursin e saj «të qetë», ashtu siç e donin taktika dhe qëllimi i udhëheqësve sovjetikë, sipas parimit «mishi të piqet e helli të mos digjet». Kështu, në tri ditët e para të mbledhjes e morën fjalën 18 përfaqësues të partive të ndryshme, midis të cilëve përfaqësuesit e partive të Bullgarisë, Hungarisë, Kanadasë, Greqisë, Argjentinës, Irakut, Bashkimit Jugafrikan e të tjerë, të cilët, duke mbështetur qëndrimin e delegacionit sovjetik në të gjitha çështjet e ngritura në fjalimin e Hrushovit, duke i bërë elozhe këtij të fundit, kritikonin në mënyrë të maskuar pikëpamjet e drejta të Partisë Komuniste të Kinës. Të gjithë këta, sipas shembullit të Hrushovit, ngulën këmbë që në deklaratën e përgatitur të mbeteshin të paprekura çështjet, për të cilat delegacioni i Kinës, delegacioni ynë dhe ato të disa partive të tjera, qysh në komisionin e tetorit, ishin shprehur kundër. Këto çështje, siç dihet, ishin vlerësimi i kongreseve XX e XXI të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, çësh-

tja e «kultit të individit», çështja e «fraksioneve» dhe ajo e «komunizmit nacional».

Kështu filloi punimet mbledhja dhe këtë pamje «të qetë» pati faza e parë e zhvillimit të saj. Por, në qoftë se formalisht pamja ishte e qetë, në esencë atmosfera ishte e rëndë, sepse të gjithë i brente diçka përbrenda, të gjithë kishin një lëmsh në gjoks, nga i cili mund të shpëtohej, vetëm në qoftë se do të nxirrej jashtë. Të gjithë i preokuponte çështja e unitetit, por rruga që kishte marrë mbledhja nuk të çonte drejt unitetit. Ajo i mbulonte kontradiktat, por nuk i zhdukte, prandaj herët a vonë ato do të shpërthenin, do të dilnin mbi ujë dhe, sa më vonë të ndodhte kjo, aq më keq do të ishte për fatet e lëvizjes sonë. Marksizëm-leninizmi na mëson ta shohim të vërtetën drejt në sy dhe të mos kemi frikë nga ajo, sado e hidhur që të jetë. Kontradiktat ekzistojnë, prandaj ato duheshin diskutuar me guxim, duhej gjetur kush e ka drejt e kush gabim, nëpërmjet kritikës dhe autokritikës, nëpërmjet një konsultimi e diskutimi të hapur e shoqëror dhe pastaj, të pastruar nga fëlliqësitat, të bashkuar në unitet të vërtetë marksist-leninist, të ecnim përpara drejt fitoresh të reja. Kështu e konceptonim ne dhe shokët kinezë zhvillimin e Mbledhjes së Moskës të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore.

Prandaj ishte e domosdoshme të ndryshonte fryma e punimeve dhe e diskutimeve në mbledhje, i duhej dhënë fund fazës së «qetësisë» relative, që u interesonte udhëheqësve sovjetikë, por që nuk i shërbente forcimit të vërtetë të unitetit tonë.

Fryma e punimeve të mbledhjes ndryshoi pas fja-

limit të delegatit kinez, shokut Ten Hsiao Pin, dhe të fjalimit që mbajta unë në emër të delegacionit të Partisë së Punës të Shqipërisë. Mbledhja hyri në fazën e saj të dytë, e cila karakterizohet nga diskutimi i hapur i mosmarrëveshjeve që ekzistojnë në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare për çështjet themelore. Ky diskutim i detyroi përfaqësuesit e çdo partie të mbanin qëndrim ndaj këtyre çështjeve të mëdha, kështu që dolen më mirë në shesh edhe pikëpamjet e vërteta të secilës parti.

Fjalimi i delegacionit të PK të Kinës ishte një fjalim me përmbajtje të lartë ideologjike, një fjalim parimor, i argumentuar shumë mirë, që demaskonte pikëpamjet e gabuara dhe shtrembërimet e devijimet e udhëheqësve sovjetikë në çështjet themelore të strategjisë e të taktikës së lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Që në fillim të fjalimit të tij delegati i PK të Kinës demaskoi metodën dhe qëllimin e udhëheqësve sovjetikë për të mos i hapur çështjet në mbledhje. Ai e cilësoi letrën e 5 nëntorit prej 125 faqesh, që ishte mbushur me sulme të egra kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe udhëheqësit të saj, shokut Mao Ce Dun, në fakt si fjalimin kryesor të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Ndryshimi, theksoi ai, konsiston vetëm në faktin, se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, duke përfituar nga kushtet e favorshme për të, meqë mbledhja mbahej në Moskë, e shpërndau atë fjalim jashtë mbledhjes, kurse në mbledhje mbajti edhe një tjetër.

Delegacioni kinez hodhi poshtë shtrembërimin që i bëhet pozitës së Komitetit Qendror të Partisë Komu-

niste të Kinës në lidhje me përmbajtjen kryesore të epokës së sotme. Ai tha se asnjëherë PK e Kinës nuk e ka karakterizuar epokën e sotme si epokë e imperializmit, e luftës dhe e revolucionit. Këtë shpifje e bëri për të parën herë në Mbledhjen e Bukureshtit kryetari i delegacionit sovjetik, bashkë me shtrembërimet e tjera se gjoja kinezët mbivlerësojnë forcat e imperializmit dhe nënvleftësojnë forcat tona. Duke folur për përmbajtjen e epokës së sotme, delegacioni kinez u shpreh kundër zëvendësimit të aktivitetit të masave në luftën për paqen me aktivitetin e udhëheqësve shtetërorë, shpjegoi kuptimin që u jepet shprehjeve «era e Lindjes sundon mbi erën e Perëndimit», «imperializmi është tigër prej letre» dhe theksoi nevojën e edukimit të masave me frymën e vendosmërisë për luftë kundër armikut të klasës.

Duke folur për çështjet e luftës e të paqes, të bashkekzistencës paqësore, delegati i Partisë Komuniste të Kinës tregoi se nga vjen burimi i luftërave, hodhi poshtë akuzën që i bëhet Partisë Komuniste të Kinës se gjoja ajo do luftën, se gjoja është për luftën e ftohtë e se gjoja me anën e luftës kërkon vendosjen e socializmit në tërë botën. Kjo, tha ai, është një lloj sikur të thuash se rreziku i luftës vjen nga Kina e jo nga imperializmi. Shoku Ten Hsiao Pin tha se duhet të flasim për të dyja mundësitë, për atë të ndalimit të luftës dhe për atë të shpërthimit të saj dhe të përgatitemi me kujdes për secilën nga këto mundësi. «Mbivlerësimi i forcave të popujve dhe nënvleftësimi i forcave të armiqve, tha ai, është një tendencë. Po të mos luftohet kjo tendencë, ajo mund të shpjerë në gabime aventu-

reske të majta dhe në gabime sektare. Mbivlerësimi i forcave të armiqve dhe nënvleftësimi i forcave të popujve është një tjetër tendencë. Po të mos luftohet kjo tendencë, ajo mund të shpjerë në gabime revizioniste dhe në gabime të oportunitetit të djathtë. Është e nevojshme të luftohet kundër të dyja këtyre tendencave. Ne mendojmë, tha ai, se në kushtet e sotme rreziku kryesor në radhët e lëvizjes komuniste ndërkombëtare është tendenca e dytë dhe jo e para».

Ai kërkoi të përfshihej në projektdeklaratë fraza: «Luftë nuk do të ketë me siguri vetëm atëherë, kur socializmi do të fitojë të paktën në vendet kryesore të botës». Ai shpjegoi ndryshimin që ekziston midis mundësisë për të evituar luftën botërore dhe mundësisë për të përjashtuar çdo lloj luftime. Popujt e shtypur, në mënyrë të pashmangshme, do të ngrihen në luftë kundër qeverive reaksionare dhe ne duhet t'i mbështetim këto luftëra. Përfaqësuesi i PK të Kinës tregoi se politika e Bashkimit Sovjetik në lidhje me bisedimet është mbështetur nga Republika Popullore e Kinës. Por nuk duhet që tërë shpresat, ose shpresat kryesore, t'i mbështetim në bisedimet. Tërë puna varet nga lufta aktive e masave në gjithë botën për paqen.

Shoku Ten Hsiao Pin tha se rreziku kryesor në lëvizjen komuniste ndërkombëtare është revizionizmi. Kurrë ndonjëherë nuk ka ndodhur, tha ai, që të zhvillohet revizionizmi nga shkakun se është luftuar shumë kundër tij, siç pretendojnë udhëheqësit sovjetikë. Ai kërkoi që të plotësohej më mirë kapitulli i projektdeklaratës që flet për këtë çështje dhe tha se ekzistojnë edhe tendenca dogmatike, të cilat, në kushte të caktuara,

mund të bëhen rrezik kryesor. Por dogmatizmi nuk shfaqet në Partinë Komuniste të Kinës dhe aq më pak në çështjet, për të cilat shpifet kundër saj.

Një vend të veçantë ai u kushtoi marrëdhënieve midis partive komuniste e punëtore motra. Ai theksoi në mënyrë të veçantë parimin e barazisë, të pavarësisë së partive të ndryshme e të internacionalizmit proletar. Rëndësi të veçantë i kushtoi parimit të konsultimeve midis partive dhe arritjes së unanimitetit. Ai tha se kritika midis partive është bazë e shëndoshë për unitetin midis tyre. Delegacioni kinez hodhi poshtë akuzën se gjoja Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës ka për qëllim të hedhë poshtë gjithçka që ka bërë Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik. Është gabim të mendohet se kritika prish unitetin. Nëse kritika u bë me ton të ashpër, për këtë nuk është fajtor Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës. Nuk duhet dhe nuk mund të aplikohet në marrëdhëniet midis partive parimi i shumicës dhe i pakicës. Ky është parim që zbatohet brendapërbrenda partive, por jo në mbledhjet ndërkombëtare, ku secila parti ruan pavarësinë e saj. Delegati i PK të Kinës kritikoi Mbledhjen e Bukureshtit, në të cilën u shkelën parimet marksist-leniniste, vuri në dukje anët pozitive dhe negative të kongreseve XX e XXI të PK të BS, kritikoi qëndrimin e Komitetit Qendror të PK të BS ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe hodhi poshtë propozimin që të dënohet në deklaratë «veprimtaria fraksioniste», propozim i cili drejtohej kundër Partisë Komuniste të Kinës.

Në fund, ai u ndal me hollësi te mosmarrëveshjet

midis Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Pasi bëri historikun e mosmarrëveshjeve dhe tregoi se si ato Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik po i shtrin edhe në marrëdhëniet shtetërore, Ten Hsiao Pin tha se këto mosmarrëveshje u ashpërsuan si rezultat i shkeljes së parimit të barazisë midis partive nga ana e udhëheqjes sovjetike dhe se nuk u respektua Deklarata e Moskës.

Përsa i përket fjalimit të delegacionit tonë, Komiteti Qendror është në dijeni të përmbajtjes së tij, prandaj nuk është nevoja të ndalemi këtu. Por mund të themi se ai u dëgjua me vëmendje të madhe nga pjesëmarrësit e mbledhjes dhe, pavarësisht nga sulmet që na u bënë më vonë, për të cilat do të flasim më poshtë, askush, as Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në deklaratën e tij të shkruar të 1 dhjetorit, nuk mundi të rrëzojë me argumente bindëse qoftë edhe një tezë të vetme tonën. Përkundrazi karakteri i tij parimor, analiza e drejtë e çështjeve dhe kritika e guximshme në adresë të udhëheqësve sovjetikë që përmbante fjalimi ynë, u përshëndet nga shumë delegacione të partive motra.

Siç u tha më parë, pas fjalimeve tona, mbledhja mori një rrugë tjetër. Edhe kjo fazë e mbledhjes mund të ndahet në dy pjesë: në dy-tri ditët e para pas fjalimeve tona zotëruan diskutimet e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtoresh që mbronin tezat e udhëheqësve sovjetikë dhe për konsekuencë sulmuan Partinë Komuniste të Kinës dhe Partinë tonë të Punës. Kurse

dy-tri ditët e fundit të mbledhjes zotëruan fjalimet e delegacioneve të partive komuniste e punëtore që mbronin pozitat e drejta marksiste-leniniste, pra që ishin të një pikëpamjeje me shokët kinezë dhe me ne. Pse ndodhi kjo? Sepse udhëheqësit sovjetikë edhe në këtë drejtim ndoqën një procedurë të padrejtë: ata, duke dashur të krijonin përshtypjen se kundër nesh është gjithë lëvizja, u dhanë fjalën njërit pas tjetrit atyre delegacioneve që ishin të bindur se do të mbronin pikëpamjen e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, kurse të tjerëve nuk ua jepnin. Kështu, për shembull, delegacionit indonezian ia shtynë të drejtën e fjalës tri ditë me radhë. Por, duke ua shtyrë kështu fjalën të gjithëve, ndodhi që fjalimet e fundit që u mbajtën, të ishin të partive me qëndrim të drejtë marksist-leninist.

Çfarë ka karakteristike në fjalimet e fazës së dytë të mbledhjes?

E para, sulmet kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe veçanërisht kundër Partisë sonë ishin të organizuara (kaq sa ishin furnizuar edhe me citate nga dokumente të Partisë sonë, që i disponon vetëm Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik) dhe karakteristike tjetër ishte mungesa e argumenteve, zëvendësimi i tyre me fjalë fyese.

E dyta, në fillim, pas fjalimit të delegatit kinez, sulmet u drejtuan vetëm kundër Partisë Komuniste të Kinës, pas fjalimit tonë sulmet u drejtuan kryesisht kundër Partisë sonë dhe nga fundi, e veçanërisht gjatë diskutimeve të dyta, kritikata u përqëndruan njëkohësisht kundër të dyja partive tona, Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë.

E treta, diskutimet ishin tendencioze, ato dënonin çdo gjë kineze ose shqiptare, por linin në heshtje, pra përkrahnin, edhe shfaqjet më ekstreme të oportunitizmit të djathtë, i cili u mundua të përfitonte nga situata për të hedhur idetë e tij. Kështu, për shembull, në fjalimin e tij, i cili të linte më tepër përshtypjen e fjalimit të një socialdemokrati, sesa të një komunisti, përfaqësuesi i Partisë Komuniste të Suedisë, Hagberg, shtroi këto teza oportuniste:

1) Ai tha se në kuadrin e bashkëpunimit me partinë socialdemokrate Partia Komuniste e Suedisë ka arritur suksese pikërisht në saje të faktit se ajo është për një bashkëpunim të gjerë me të gjithë socialdemokratët, se ata flasin për ato gjëra që i bashkojnë dhe jo që i ndajnë me ta. Ai deklaroi se udhëheqja e Partisë Komuniste të Suedisë është kundër krijimit të një krahu të majtë në partinë socialdemokrate, duke qenë se komunistët duhet të bashkëpunojnë me të gjitha repartet e klasës punëtore.

2) Ai mbrojtí revizionistët jugosllavë dhe kritikoi ata që flasin me një gjuhë të ashpër kundër tyre. Ai deklaroi se kryesorja për ne është izolimi i armikut kryesor dhe jo i Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë, se nuk duhet mbajtur ndaj udhëheqësve jugosllavë një qëndrim më i ashpër sesa ndaj krerëve socialdemokratë, gjë që prek ndjenjat kombëtare të popullit jugosllav. Ne duhet të mos i acarojmë marrëdhëniet me udhëheqjen jugosllave, në mënyrë që ta kemi atë si bashkudhëtare, qoftë dhe të përkohshme e jo shumë të sigurtë në luftën e përbashkët për paqe etj.

3) Ai deklaroi se «në dokumentin që do të adoptojë

mbledhja nuk duhet të figurojë termi «diktaturë e proletariatit», i cili mund të shkaktojë vetëm dëm. Termi «diktaturë e proletariatit» është një term i vjetër i shekullit XIX, të cilit i ka kaluar koha dhe i tremb masat. Megjithëse ne, komunistët, e kuptojmë përmbajtjen e këtij termi, nuk e përdorim atë, sepse si nga ana logjike, ashtu edhe nga pikëpamja filologjike, «diktaturë» do të thotë e kundërta e demokracisë, mohim i saj. Punëtorët suedezë e quajnë për ofendim t'u flasësh për «diktaturë të proletariatit». Ky term nuk përmbahet në programin e Partisë Komuniste të Suedisë dhe ne, kur u flasim punëtorëve për pushtetin socialist, u theksojmë atyre se ky është pushteti më demokratik» etj.

Po kështu, përfaqësuesit e Partisë Komuniste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Partisë Komuniste të Britanisë së Madhe kërkuan gjithashtu, me pretekste të ndryshme, që nga projektdeklarata të hiqej formulimi mbi diktaturën e proletariatit.

Përfaqësuesi i Partisë Komuniste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës kërkoi gjithashtu që nga projektdeklarata të hiqej fraza ku thuhet: «Në rast se imperialistët e çmendur do të shpërthejnë luftën, popujt do ta fshijnë dhe do ta varrosin kapitalizmin». Kurse delegati i Partisë Komuniste Italiane, deklaroi në fjalinë e tij se asnjë punëtor nuk do të ishte dakord ta paguajë me gjak fitoren e socializmit, domethënë se ata janë për «paqe me çdo kusht». Përfaqësuesi i Partisë Komuniste Italiane propozoi një formulim të ri të asaj pjese të projektdeklaratës, ku bëhet fjalë për revizionizmin jugosllav, në të cilin liheshin jashtë tezat

se revizionistët jugosllavë kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin dhe zhvillojnë veprimtari minuese kundër kampit socialist dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Megjithëkëtë, asnjë nga delegatët e mbledhjes, duke përfshirë edhe delegacionin sovjetik, nuk u ngrit të kundërshtojë këto teza antimarksiste dhe hapur revizioniste. Vetëm delegacioni i Partisë Komuniste të Kinës, delegacioni ynë dhe i disa partive të tjera që qëndrojnë në pozitë marksiste-leniniste, luftuan dhe hodhën poshtë në komisionin e redaktimit këto pikëpamje të padrejta dhe oportuniste.

Mbi qëndrimin e disa delegacioneve kundrejt fjalimit të delegacionit tonë

Menjëherë pas fjalimit që mbajti në mbledhje delegacioni ynë, përfaqësuesit e disa partive komuniste e punëtore shpërthyen kundër Partisë së Punës të Shqipërisë sulme të rënda plot epitete ofenduese. Pa marrë parasysh faktet ose pa i ditur ato, ata i deklaruan shpifje të gjitha kritikën që përmbaheshin në fjalimin tonë në drejtim të udhëheqësve të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Sulmin e hapi Dolores Ibarruri, e cila midis të tjerash, tha: «Sot para dite dëgjova fjalimin më të turpshëm gjatë shumë vitesh të lëvizjes komuniste; të tillë fjalim nuk kemi dëgjuar qysh nga koha e Troçkit. Ai ishte një fjalim provokues. Si mund të flitet me falsifikime të tilla kundër Bashkimit Sovjetik... Ne protes-

tojmë për shpifjet kundër Hrushovit. Besojmë se e gjithë lëvizja do ta dënojë fjalimin tuaj...» etj.

Me epitetet më fyese foli kundër fjalimit të mbajtur dhe kundër Partisë sonë Gomulka. Ai e cilësoi fjalimin tonë si «një sulm pa përgjegjësi kundër Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, si një akt prej vagabondi, të cilin nuk mund t'ia lejojë vetes asnjë njeri që ka ndjenjën e përgjegjësisë». Më tej Gomulka tha: «Nëse ndonjëri nuk beson për fraksionizmin e kinezëve, le ta shohë atë te shqiptarët...».

Longo dhe përfaqësuesit e disa partive të tjera, duke sulmuar fjalimin e delegacionit tonë, deklaruan se «ai tingëllon si një ofendim e poshtërim jo vetëm për Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, por edhe për gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare».

Sulme të poshtra bëri kundër udhëheqjes së Partisë sonë edhe përfaqësuesi i Partisë Komuniste të Marokut, Ali Jata.

Georgiu Dezh u shpreh në këtë mënyrë kundër fjalimit tonë: «Ne dëgjuam me indinjatë fjalimin e Sekretarit të Parë të Partisë së Punës të Shqipërisë. Ne e përmbajtëm veten, vumë në provë durimin tonë, sepse dukej sikur nga kjo tribunë fliste «Zëri i Amerikës» apo «Evropa e lirë». Asnjë ndryshim nga revizionistët jugosllavë. Me politikën e tyre aventureske shqiptarët krijojnë situata të vështira në Ballkan... Mbledhja jonë duhet të dënojë me vendosmëri fjalimin dhe veprimin përçarës të delegatit shqiptar».

Delegacionet e disa partive, të cilat ishin pronicuar para se të flisja unë, nuk vonuan të bënin deklarata me shkrim për të dënuar fjalimin e delegacionit të Par-

tisë sonë dhe udhëheqjen e saj. Kështu vepruan delegacionet e Partisë Komuniste të Bullgarisë, të Partisë Komuniste të Francës, të Partisë Komuniste të Çekosllovakisë e të tjera.

Në deklaratën që shpërndau delegacioni i Partisë Komuniste të Bullgarisë thuhet ndër të tjera: «...Ajo që bënë përfaqësuesit e Partisë së Punës të Shqipërisë, është një mosmirënjohje e zezë dhe cinizëm. Si shpërblim për ndihmën vëllazërore janë falsifikimet më të poshtra dhe shpifjet kundër Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Bashkimit Sovjetik. Revizionistët e Beogradit nuk kanë baza për të qenë të pakënaqur nga lufta e udhëheqësve të Partisë së Punës të Shqipërisë kundër tyre. Nga kjo «luftë» ata vetëm se çmohen më shumë në tregun amerikan, marrin një ndihmë më zemërgjerë dhe huara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës».

Në deklaratën e delegacionit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Çekosllovakisë, në lidhje me fjalimin e delegacionit të Partisë së Punës të Shqipërisë, ndër të tjera thuhet: «Çfarë qëllimesh ndjekin shpifjet e përbindshme të delegacionit shqiptar, i cili i lejon vetes ta quajë Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik gati fajtoreshë për kundërrevolucionin hungarez? Aq më tepër indignatë ngjallin fjalët e sotme të delegacionit shqiptar, që akuzon rëndë Bashkimin Sovjetik gati për metoda koloniale dhe për shovinizëm të shtetit të madh. Këto fyerje mund t'i japin ushqim vetëm propagandës borgjeze dhe revizioniste rreth të ashtuquajturit «kolonializëm» sovjetik dhe «hegjemonizëm» sovjetik» etj.

Një pjesë e madhe delegacionesh që folën pas nesh, lidhur me fjalimin tonë, u shprehën vetëm me ndonjë frazë, si për shembull, «nuk ishte vendi këtu për të hapur këto diskutime», ose «fjalimet e shokëve kinezë e shqiptarë nuk ishin të përshtatshme, ishin të dëmshme dhe përmbanin shpifje kundër Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik», ose «jemi dakord me vlerësimin që iu bë fjalimit të delegatit shqiptar nga oratorët parafolës» etj.

Përgjithësisht qëndrimi i delegacioneve të ndryshme ndaj pikëpamjeve të shprehura në fjalimin tonë mund të ndahet në tri grupe:

a) Në grupin e parë hyjnë ato parti që na mbrojtën hapur ose që mbështetën tezat tona, pa na përmendur fare, ose që thanë ndonjë fjalë sa për sy e faqe kundër fjalimit tonë.

Në këtë grup në radhë të parë duhet përmendur delegacioni kinez që mbrojti me vendosmëri Partinë tonë.

Përveç delegacionit kinez, hapur në mbrojtje të Partisë sonë, dolën mjaft delegacione të partive komuniste e punëtore të Azisë, disa prej të cilave si ai i Birmanisë dhe i Malajës, i Indonezisë, kritikuan metodat jokomuniste, kur në adresë të partive që flasin hapur me kurajë përdoren fjalë fyese etj., kurse disa delegacione të tjera nuk u prononcuan hapur, por ato na thanë mënjane se janë dakord me ne.

b) Grupi i dytë përbëhet nga ato delegacione, të cilat folën kundër nesh, por, siç thamë më sipër, me terma shumë të matura, si «fjalim i papërshtatshëm» etj. Këtu hyjnë shumica e vendeve të Amerikës Latine,

vendet skandinave, disa delegacione të Afrikës e të tjera.

c) Grupi i tretë përbëhet nga delegacionet që folën kundër nesh me zjarr të madh dhe që mbrojtën pa rezervë pozitat e udhëheqësve sovjetikë. Por edhe të këta ka disa nuanca:

— Më agresivët qenë: Gomulka, Ibarruri, Ali Jata i Marokut, Zhivkovi dhe çekët (këta dy të fundit bënë deklaratat me shkrim), Dezhi, Longo i Italisë e të tjerë, të cilët përdorën kundër nesh fjalët më fyese.

— Më pak agresivë, francezët, që bënë deklaratat me shkrim, tunizianët e të tjerë, të cilët folën kundër nesh, veç jo me termat e mësipërme, por «fjalim i turpshëm», «fjalim i palejueshëm dhe i papranueshëm», «që synon të diskreditojë Bashkimin Sovjetik» etj.

— Më në fund të moderuarit, ku mund të futen hungarezët, të cilët në deklaratën me shkrim ishin shumë të matur.

Sulmet e ashpra kundër delegacionit kinez dhe delegacionit tonë nuk ishin një gjë e papritur për ne. Ato ishin një shpërthim i organizuar pasionesh joparimore, një përpjekje pa sukses për të mbytur me sulme të ulëta, me fjalë fyese, pikëpamjet dhe kritikën tona parimore, për të devijuar, me ndihmën e frazave sentimentale, diskutimin parimor të çështjeve që ishin shtruar etj. Por këtyre qëllimeve nuk ia arritën dot. Në fakt, shumica e delegacioneve filloi të lëkundej dhe sa më shumë ftoheshin gjakrat dhe sundonte logjika mbi sentimentet, aq më tepër pikëpamjet e drejta parimore, marksiste-leniniste, që mbronin delegacionin kinez, ai

i Partisë sonë e të tjerë, gjykoheshin me objektivitet nga një sërë delegacionesh. Kjo shprehet qartë në ndryshimin e raportit të forcave dhe në përfundimin e punimeve të mbledhjes.

Siç e thamë në fillim të këtij raporti, në pozita të vendosura marksiste-leniniste në Mbledhjen e nëntorit u gjendën veç delegacionit kinez e delegacionit tonë edhe përfaqësuesit e mjaft partive të tjera. Të gjithë këta u shprehën për unitetin e lëvizjes komuniste, pranuam hapur se pa Kinën dhe Partinë e saj Komuniste nuk mund të flitet për unitet as të lëvizjes komuniste, as të kampit socialist. Ky ishte një qëndrim i hapur kundër propozimeve dhe tezave të sovjetikëve dhe përkrahësve të tyre të zjarrtë, për të dënuar Partinë Komuniste të Kinës dhe Partinë e Punës të Shqipërisë si fraksioniste etj.

Në fund të seancës plenare të mbledhjes, pasi diskutuan 79 përfaqësues të partive të ndryshme, e mori fjalën për të dytën herë N.S. Hrushovi dhe pas tij Ten Hsiao Pin e 23 veta të tjerë. Karakteristike në fjalimet e Hrushovit dhe të përkrahësve të tij ishte se ata u treguan më të moderuar, me shprehje më të kontrolluara, u përpoqën më shumë jo për të sulmuar, por për të mbrojtur pikëpamjet e tyre.

Fjalimi i dytë i Nikita Hrushovit pasqyrore gjendjen që ishte krijuar në mbledhje deri atëherë: nga njëra anë, fjalimi i delegacionit kinez dhe ai i delegacionit tonë që një grusht për argumentet e udhëheqësve sovjetikë lidhur me akuzat kundër Partisë Komuniste të Kinës, dhe, nga ana tjetër, ishte fakt që përveç partive që përkrahën hapur, qoftë dhe pa argumente bin-

dëse, pozitën e udhëheqjes sovjetike kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, ekzistonte edhe një grup jo i vogël partish që përkrahu pikëpamjet tona dhe një grup tjetër i qendrës, të cilët ishin kundër përçarjes.

Në përshtatje me këtë, fjalimi i dytë i Hrushovit kishte dy anë karakteristike:

a) Megjithëse nga forma e jashtme ai qe më i ashpër nga fjalimi i tij i parë dhe prekte drejtpërdrejt shokët kinezë dhe ne, në esencë ai ishte fjalim nga pozitë e mbrojtjes. Në të Hrushovi, duke u mbrojtur nga kritikën e shokëve kinezë dhe tonat, u përpoq të justifikonte pikëpamjet e udhëheqjes sovjetike për një radhë çështjesh: lidhur me çështjen e luftës e të paqes, të qëndrimit kundrejt imperializmit, të tezës së Kongresit XX mbi rrugët e kalimit për në socializëm, mbi qëndrimin kundrejt lëvizjes nacionalçlirimtare, mbi kritikën e «kultit të individit të Stalinit» etj. Në këtë drejtim, ai, duke mos guxuar të hyjë në trajtimin e fakteve, tha me një frazë të përgjithshme se të gjitha «shpifjeve e sulmeve kundër Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik», Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik do t'u përgjigjet me një letër të posaçme. Veç asaj, në fjalimin e dytë të Hrushovit, u dukën shenjat e para të tërheqjes, kur ai deklaroi se përballë armikut mbledhja duhet të përfundojë patjetër me një dokument të përbashkët dhe me zhdukjen e mosmarrëveshjeve.

b) Duke u mbështetur në përkrahjen e shumicës, Hrushovi në fjalimin e tij të dytë vazhdoi presionin mbi Partinë Komuniste të Kinës për ta dënuar e për

ta nënshtruar atë. Në këtë drejtim ai insistoi me të madhe se gjoja divergjencat ekzistojnë midis Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, nga njëra anë, dhe të gjitha partive komuniste e punëtore, nga ana tjetër; se pakica duhet t'i bindet shumicës dhe të respektojë mendimin e saj; se duhet dënuar «veprimtaria fraksioniste» në lëvizjen komuniste ndërkombëtare etj. Ai vazhdoi sulmet kundër shokëve kinezë, duke i akuzuar ata se nuk duan të pranojnë gabimet e veta për arsye se vënë dinjitetin e tyre mbi interesat e lëvizjes komuniste ndërkombëtare etj. Ai sulmoi gjithashtu, pa argumente e mbi bazë falsifikimesh, udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë.

Fjalimi i dytë i Nikita Hrushovit tregoi se udhëheqja e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, e kryesuar nga Hrushovi, nuk ka hequr dorë nga pikëpamjet dhe metodat e saj të shtrembra në marrëdhëniet midis partive motra.

Pas fjalimit të Hrushovit, si përgjigje atij, foli për të dytën herë shoku Ten Hsiao Pin.

Fjalimi i këtij u përqëndrua rreth dy çështjeve kryesore: *E para*, a e ka mbrojtur apo e ka shkëlur Deklaratën e Moskës të vitit 1957 udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës? *E dyta*, qëndrimi i udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës ka për qëllim të mbrojë kompaktësinë apo e ka vënë në rrezik kompaktësinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare?

Lidhur me çështjen e parë, delegati kinez theksoi se udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës ka qëndruar në mënyrë konsekuente në pozitat e Deklaratës së Mos-

kës të vitit 1957 dhe e ka mbrojtur atë me vendosmëri. Ai hodhi poshtë edhe një herë akuzat e shumë oratorëve se gjoja shokët kinezë, sidomos në artikujt e përmbledhur në broshurën «Rroftë leninizmi», janë larguar nga Deklarata e vitit 1957, se ata gjoja mohojnë rëndësinë e sistemit socialist botëror në arenën ndërkombëtare, mohojnë parimin e bashkëkzistencës paqësore, janë aventurierë të majtë, dogmatikë etj. Ai provoi se, përkundrazi, udhëheqësit sovjetikë dhe udhëheqës të disa partive të tjera motra filluan t'i deklarojnë si të vjetruara disa teza të rëndësishme të leninizmit, të vep-rojnë sipas supozimit se natyra e imperializmit ka ndryshuar, të përhapin iluzione të dëmshme lidhur me mbledhjet e nivelit' të lartë etj. Artikujt e përmbledhur në broshurën «Rroftë leninizmi» drejtoheshin kundër imperializmit, kundër revizionizmit dhe kundër iluzioneve të dëmshme të krijuara nga udhëheqësit sovjetikë lidhur me imperializmin. Pra, ata ishin larguar nga pozitat e Deklaratës së Moskës të vitit 1957 dhe jo shokët kinezë; si rrjedhim, ata duhej të konsultoheshin me partitë e tjera për këto pikëpamje që ndryshonin nga ato të Deklaratës dhe jo shokët kinezë për artikujt e tyre, që janë mbrojtja e tezave të Deklaratës në fjalë.

Lidhur me çështjen e dytë, delegati i Partisë Komuniste të Kinës hodhi poshtë akuzën e bërë nga shumë oratorë se gjoja fjalimi i parë i delegacionit të Partisë Komuniste të Kinës vuri në rrezik kompaktësinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Përkundrazi, ai fjalim që një përgjigje letrës së Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të datës 5 nëntor, e cila në fakt i thelloi kontradiktat. Delegati i

PK të Kinës hodhi poshtë gjithashtu, në mënyrë të vendosur, akuzat që shumë oratorë drejtuan gjatë mbledhjes kundër Partisë Komuniste të Kinës, si dhe akuzën e bërë në fjalimin e dytë të Hrushovit, se gjoja shokët kinezë vënë dinjitetin e tyre mbi interesat e lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Ai tregoi qartë se është krijuar një situatë e sëmurrë dhe e palejueshme, ku çdo kritikë në adresë të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik deklarohet «veprimtari fraksioniste», ndërsa shokëve sovjetikë u lejohej të vendosin vetë e pa pyetur aspak të tjerët për gjithçka dhe partitë e tjera duhet vetëm të shkojnë pas tyre. Kjo shkel parimin e barazisë dhe të konsultimeve në marrëdhëniet midis partive motra. Lidhur me këtë delegati kinez demaskoi manovrën e Hrushovit, i cili me qëllim që të justifikonte veprimet e veta arbitrare, në fjalimin e tij të dytë tha se çështja e dënimit të «kultit të individit të Stalinit» nuk mund të bëhej objekt diskutimi midis partive motra para Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik pa marrë më parë mendimin e Partisë, kurse pas vendimit të kongresit nuk mund të shkelej ky vendim (domethënë në fakt mohohet krejtësisht mundësia e konsultimeve midis partive motra).

Delegati kinez theksoi me forcë se parimi i konsultimeve nuk është aspak imponim i vullnetit të pakicës shumicës, se uniteti i lëvizjes komuniste nuk u vu në rrezik nga parimi i barazisë dhe i konsultimeve, por përkundrazi nga fakti që ky parim po shkelet. Ai u shpreh vendosmërisht kundër futjes në projekt të tezave të tilla, si teza mbi të ashtuquajturën «veprimtari

fraksioniste» në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, mbi «komunizmin nacional» etj., që drejtohen kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe theksoi se mbi këtë bazë uniteti nuk mund të arrihet. Ai u shpreh gjithashtu kundër tezës mbi rëndësinë e Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, futja e së cilës në projekt do të thotë imponim i pikëpamjeve të një partie partive të tjera. Ai theksoi se lufta e përbashkët e të gjitha partive komuniste e punëtore përbën një bazë të gjerë, e cila lejon kapërcimin e të gjitha divergjencave ekzistuese.

Fjalimi i delegatit të PK të Kinës tregoi se Partia Komuniste e Kinës qëndron e vendosur në pozitën e saj të drejtë marksiste-leniniste, se kjo është e vetmja rrugë e drejtë për arritjen e unitetit.

Delegacioni ynë vendosi të mos diskutonte për herën e dytë, prandaj edhe nuk e kërkoi fjalën, por ne bëmë një deklaratë të shkurtër me shkrim, e cila iu shpërnda të gjitha delegacioneve. Në deklaratën tonë ne theksonim se qëndrojmë në ato pozita që shprehëm në fjalim dhe vinim në dukje se kritikën fyese që na u bënë ishin të nxituara dhe nuk i shërbenin forcimit të unitetit të lëvizjes sonë. Lidhur me këtë ne theksonim:

«Tipik në këtë drejtim ishte fjalimi i delegatit të Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë, Vladislav Gomulka, i cili shkoi aq larg në orvatjet e tij të padenja për të shtrembëruar të vërtetën mbi Partinë e Punës të Shqipërisë, sa që përdori kundër saj epitete, kualifikime dhe insinuata krejtësisht të palejueshme në marrëdhëniet midis partive marksiste, të cilat në adresën tonë përsëriten çdo ditë vetëm nga imperialistët dhe revizionistët jugosllavë. Nga përmbajtja dhe toni i fja-

limit të delegatit polak, del qartë se atij nuk i intereson aspak zhdukja e mosmarrëveshjeve midis partive dhe forcimi i unitetit të lëvizjes komuniste e punëtorë, por përkundrazi me zell të madh përpiqet t'i thellojë ato, gjë që është vetëm në interes të armiqve tanë. Qëllimi i tij ishte që ta fuste mbledhjen tonë në një qorrsokak dhe të diskreditonte Partinë e Punës të Shqipërisë përpara lëvizjes komuniste e punëtorë ndërkombëtare. Por, kjo përpjekje për të izoluar Partinë tonë dështoi dhe është destinuar të dështojë kurdoherë me turp.

Ne hedhim poshtë të gjitha shpifjet dhe provokacionet që u bënë në këtë mbledhje kundër delegacionit tonë, kundër Partisë dhe popullit tonë.

Partisë së Punës të Shqipërisë i vjen keq që edhe disa delegatë të tjerë të disa partive motra, në fjalimet e tyre ose në deklaratat me shkrim që shpërndanë në këtë mbledhje, pa i studjuar mirë faktet reale dhe pa qenë fare në korant të së vërtetës, u ngutën dhe përdorën një gjuhë jokorrekte dhe joshqërrore ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë. Megjithatë, Partia jonë shpreson se këta shokë do të reflektojnë më thellë dhe do të kuptojnë të vërtetën mbi përmbajtjen e fjalimit të delegacionit të Partisë së Punës të Shqipërisë».

Siç shihet, veç emrit të Gomulkës, ne nuk përmendëm asnjë tjetër, e nuk iu përgjigjëm sulmeve personale për të mos u larguar edhe ne nga pozitat parimore. Kjo deklaratë e shkurtër jona u prit mirë nga delegacionet dhe kundër saj nuk foli asnjë nga të 23 diskutantët e dytë, bile as vetë Gomulka.

Në këtë mënyrë mori fund pjesa e parë e më kryesore e Mbledhjes së Moskës dhe filloi punën komisioni

për redaktimin përfundimtar të deklaratës. Komisioni punoi 5 ditë. Atje u zhvillua një luftë e ashpër dhe e vendosur nga ana e delegacionit kinez, e delegacionit tonë dhe e delegacioneve të tjera që kishin pikëpamje të njëjta me ne. Në komision u duk qartë ndryshimi i situatës. Atje u vunë re më mirë, jo vetëm ndryshimi i raportit të forcave, por edhe rezultatet e luftës së vendosur dhe të pozitës së guximshme e të papërkulur që zunë gjatë mbledhjes plenare, veçanërisht, delegacioni kinez dhe delegacioni ynë. Shumë delegacione të partive që qëndronin në qendër silleshin me respekt ndaj propozimeve të delegacioneve tona.

Si përfundim, në projektdeklaratën e paraqitur u bënë disa ndryshime, të cilat e përmirësuan atë, kurse të gjitha propozimet që synonin të dobësonin Deklaratën, t'i jepnin asaj një karakter oportunist, siç ishin propozimet e italianëve për të zbutur paragrafin mbi revizionizmin jugosllav, apo propozimet e suedezëve etj. u hodhën poshtë. Komisioni hodhi poshtë gjithashtu edhe tezën mbi «komunizmin nacional», por, më në fund, përsëri mbetën pa u zgjidhur 4 çështje: Vlerësimi i kongreseve XX dhe XXI, çështja e kultit të individit, çështja e fraksioneve dhe përfshirja në Deklaratë e parimit të konsultimit për arritjen e unitetit që u propozua nga delegacioni kinez.

U bë një ditë pushim, për t'u konsultuar me kryetarët e delegacioneve për gjetjen e rrugës së daljes. Megjithëkëtë, delegacionet tona shprehën vendosmërinë e tyre për të mos pranuar vënien në Deklaratë të 3 çështjeve të para nga 4 çështjet e sipërme. Bile me anë të disa delegacioneve të qendrës ne kishim lënë të kup-

tohej se, po të mbeten në deklaratë çështjet e sipërme, ne nuk do ta firmosnim Deklaratën.

Vetëm në gjysmën e ditës së fundit, në saje të luftës dhe të qëndrimit tonë të prerë, u arrit në unanimitet të plotë, pasi delegacioni i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik u detyrua të tërhiqej. Në fakt, çështjet që diskutoheshin u zgjidhën kështu: u hoq fare nga teksti çështja e fraksioneve; u fut në Deklaratë propozimi kinez për konsultimet; u hoq fare vlerësimi i Kongresit XXI dhe mbeti vetëm formula e Deklaratës së vitit 1957 mbi Kongresin XX, por duke iu shtuar një frazë mbi kontributin që japin edhe partitë e tjera për pasurimin e marksizëm-leninizmit; mbeti formula për kultin e individit, por jo më si fenomen që kishte lidhje me gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Pas këtyre ndryshimeve Deklaratën e aprovuan unanimisht të gjitha delegacionet.

Çështjet themelore, për të cilat kishte pikëpamje të ndryshme, në Deklaratë janë paraqitur drejt dhe janë interpretuar sipas pikëpamjes marksiste. Karakteristika e epokës, problemet e luftës dhe të paqes, çështja e bashkekzistencës paqësore, problemet e lëvizjes nacionalçlirimtare, të lëvizjes komuniste në vendet kapitaliste, të unitetit të kampit socialist dhe të partive komuniste, kanë gjetur në Deklaratë një pasqyrim të drejtë. E vetmja çështje themelore për të cilën ne nuk ishim dakord, por që u detyruam për hir të unitetit të bëjmë lëshim, është përmendja e Kongresit XX.

Por një gjë duhet pasur parasysh gjithnjë. Ekziston mundësia që secili t'i interpretojë në mënyrën e vet tezat e Deklaratës. Dihet se Deklarata e Moskës e vitit

1957 ishte gjithashtu e drejtë, por, megjithatë, në lidhje me interpretimin e saj, lindën shumë mosmarrëveshje. Shtrembërimet mund të bëhen, jo duke revizionuar tezat e deklaratës e duke i zëvendësuar ato me teza të reja, por duke theksuar në mënyrë të njëanshme tezat e saj, duke përmendur vetëm njërin anë të çështjes e duke lënë mënjanë anën tjetër. Kështu, për shembull, ekziston rreziku që në karakteristikën e epokës sonë të theksohen e të mbivlerësohen vetëm forcat tona; ekziston rreziku që në lidhje me problemin e luftës të mos vihet sa duhet në dukje rreziku i luftës e të mos demaskohet imperializmi; ekziston rreziku që të bëhet vetëm politika e aleancës me socialdemokratët e borgjezinë nacionale e të lihet mënjanë lufta e kritika kundër pikëpamjeve dhe veprimeve të tyre reaksionare; ekziston rreziku që të theksohet kryesisht rruga paqësore e të mos përmendet si duhet rruga jopaqësore për kalimin në socializëm; ekziston rreziku që revizionizmi vetëm me një fjalë të pranohet si rreziku kryesor e të theksohet më shumë lufta kundër dogmatizmit e sektarizmit. Të tilla shtrembërime mund të bëhen edhe për problemet e tjera që përmenden në Deklaratë.

Këtëj lind pyetja: si do të zbatohet kjo Deklaratë? A do të respektohet nga të gjithë?

Me siguri ne mund të përgjigjemi vetëm përsa i përket Partisë sonë. Partia jonë e Punës do të luftojë me të gjitha forcat e saj, jo vetëm për ta zbatuar Deklaratën e aprovuar, por ne e ndiejmë për detyrë që në të njëjtën kohë të luftojmë edhe kundër kujtdo që do ta shkelë atë, që do të përpiqet ta shtrembërojë përmbajtjen e saj.

Përsa u përket partive të tjera ne urojmë, për hir të unitetit, të luftës së përbashkët kundër imperializmit dhe revizionizmit, për hir të kampit të socializmit dhe të komunizmit, që ta zbatojnë të gjithë Deklaratën e aprovuar. Zbatimi me përpikëri i kësaj Deklarate do të shënojë një hap vendimtar për likuidimin e çdo mosmarrëveshjeje në gjirin e lëvizjes komuniste, do të jetë një kontribut i çmueshëm për çelikosjen e unitetit të kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, që është i domosdoshëm për fitoren mbi armiqtë. Vetë Deklarata dhe përmbajtja e saj përbën një bazë reale mbi të cilën mund të mbështetet ky unitet.

Por ne nuk mund të mos e njoftojmë Komitetin Qendror të Partisë për disa rezerva që duken qysh tani nga ana e udhëheqësve sovjetikë lidhur me zbatimin e Deklaratës.

Rezervat që janë shprehur, të cilat ne i gjukojmë jo të drejta, janë këto: Vetë Nikita Hrushovi në fjalimin që mbajti në tetor, gjatë drekës për nder të pjesëmarrësve të komisionit të redaktimit të Deklaratës, e quajti deklaratën si një «dokument kompromisi». «Dokumente të tilla, theksoi ai, siç dihet, nuk kanë jetë të gjatë». Më vonë, në drekën e fundit që u dha për nder të pjesëmarrësve të Mbledhjes së Moskës, më 2 dhjetor 1960, pra, pasi u firmua Deklarata, Nikita Hrushovi, duke folur për Jugosllavinë, theksoi se ajo nuk është vend socialist, por ekonomia e saj zhvillohet në rrugë socialiste (!) dhe se ne nuk do të luftojmë kundër revizionizmit jugosllav siç luftojnë shqiptarët, sepse kemi parasysh se Jugosllavia në rast lufte nxjerr disa divizione dhe ne nuk duam që këto t'i kemi kundër.

Se çfarë fshihet pas këtyre deklaratave, se ku është qëllimi i tyre, ne nuk do të përpiqemi t'i komentojmë. Do të rrojmë e do të shohim. Ne vetëm konstatuam këto fakte dhe po e njoftojmë për to Komitetin Qendror të Partisë. Natyrisht, sipas pikëpamjes sonë, deklarata të tilla nuk janë optimiste. Ato të bëjnë të mendosh se udhëheqja sovjetike nuk do të luftojë ashtu si duhet të luftojë çdo parti për të zbatuar zotimet që rrjedhin nga aprovimi njëzëri i Deklaratës së firmuar.

V. — DETYRAT E PARTISË PËR TË ARDHSIMEN

Veprimtaria e delegacionit të Partisë sonë, qëndrimi i tij i vendosur e parimor, fjalimi i guximshëm dhe gjithë puna e zhvilluar në Mbledhjen e Moskës ka qenë shumë e mirë dhe, siç e thamë, dha rezultate pozitive. Ne duhet të theksojmë se si rrjedhim personaliteti i Partisë sonë është rritur, dashuria dhe respekti për guximin e saj, për qëndrimin parimor, për vendosmërinë në mbrojtjen e marksizëm-leninizmit është shtuar pa masë. Kjo na gëzon, por nuk na bën të mburremi e të na rritet mendja. Ne nuk bëjmë tjetër veçse detyrën tonë ndaj marksizëm-leninizmit, ndaj internacionalizmit proletar, ndaj Partisë dhe popullit tonë.

Por njëkohësisht përpara nesh dalin disa probleme të reja, të cilat me urtësinë karakteristike të Partisë sonë, me gjakftohtësi e zgjuarsi duhet t'i zgjidhim.

Ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm se qëndrimi ynë i guximshëm e parimor nuk u ka pëlqyer as udhëheqësve sovjetikë, as përfaqësuesve të disa partive të ven-

deve socialiste e kapitaliste dhe kjo duket edhe nga sulmet që ata drejtuan kundër Partisë sonë. Nga ana tjetër, si efekt i punës së udhëheqësve sovjetikë me delegacionet e ndryshme, sidomos pas fjalimit tonë, dhe të shpifjeve që u bënë në mbledhje kundër nesh, në shumë delegacione është krijuar përshtypja sikur ne atakuar Bashkimin Sovjetik dhe Partinë e tij Komuniste. Këtë lind çështja: Cili duhet të jetë në të ardhshmen qëndrimi ynë? Si duhet të veprojmë ne, në mënyrë që çdo keqkuptim të zhduket?

Mbi qëndrimin kundrejt Bashkimit Sovjetik

Për ne duhet të jetë e qartë se udhëheqësit sovjetikë do të mbajnë kundrejt nesh një qëndrim të ndryshëm nga ai që kanë mbajtur më përpara. Ne duhet të përgatitemi për të përballuar vështirësi dhe pengesa serioze.

Kjo gjë u duk qartë në bashkëbisedimet e fundit që pati delegacioni ynë me delegacionin sovjetik më 25 nëntor 1960. Në këtë takim merrnin pjesë nga ana sovjetike Kozllovi e Mikojani, kurse nga ana jonë shokët Mehmet Shehu e Hysni Kapo. Shokët tanë shprehën pikëpamjen e Partisë sonë që në të ardhshmen të forcohen miqësia dhe marrëdhëniet midis vendeve e partive tona, duke u dhënë fund veprimeve të padrejta që udhëheqësit sovjetikë kanë bërë deri tani kundër Partisë dhe vendit tonë, të shohim përpara dhe të forcojmë lidhjet ekonomike e politike, të koordinojmë çdo veprim tonin, në mënyrë që të mos ndodhin mosmarrë-

veshje etj. Në qoftë se në të ardhshmen do të ndodhë ndonjë keqkuptim dhe veprim i gabuar, atëherë njëra palë menjëherë të njoftojë palën tjetër që të mos trashen gjërat etj. Mirëpo kësaj dëshire të delegacionit tonë Kozllovi e Mikojani iu përgjigjën me kërcënime. Ata kërcënuan se do të shohin në Traktatin e Varshavës çështjen e bazës së Vlorës, se do të ndryshojnë qëndrim në çështjet ekonomike duke qenë më të shtrënguar etj. Shokët tanë iu përgjigjën udhëheqësve sovjetikë, duke theksuar se me kërcënime e me presion nuk do të nxjerrin gjë, prandaj nëse duan përmirësim të marrëdhënieve duhet t'i rishikojnë pozitat e tyre dhe se ne kurdoherë, në baza të drejta, do të jemi të gatshëm të punojmë për forcimin e miqësisë midis dy vendeve tona.

Siç shihet, qëndrimi i udhëheqësve sovjetikë, pikëpamjet e tyre shumë të gabuara ndaj vendit dhe Partisë sonë vazhdojnë të mbeten ato që ishin. Dhe kjo është logjike. Derisa udhëheqja sovjetike, me të cilën ne kemi mosmarrëveshje, nuk do të pranojë gabimet e saj, ajo do të vazhdojë njëlloj të mendojë dhe të veprojë kundër nesh. Që nuk i ka pranuar gabimet e saj, kjo duket edhe nga materiali që udhëheqja sovjetike shpërndau më 1 dhjetor si përgjigje ndaj fjalimit të delegacionit tonë në mbledhje, ku çdo fakt të ngritur nga ne nuk e pranon dhe përpiket ta paraqitë si fals e ta hedhë poshtë.

Në këto kushte ne duhet të jemi të pregatitur për çdo gjë.

Ne duhet të mbrojmë me vendosmëri parimet dhe pikëpamjet tona të drejta, nga të cilat nuk duhet të

lëshojmë aspak. Por, në të njëjtën kohë, duke ruajtur të paprekura parimet e pikëpamjet tona, në marrëdhëniet ekonomike e politike me Bashkimin Sovjetik duhet të jemi korrektë, të kujdesshëm dhe të matur. Si gjithnjë Partia jonë duhet të punojë për forcimin e lidhjeve të miqësisë dhe të dashurisë për popujt e Bashkimit Sovjetik.

Përsa i përket qëndrimit tonë ndaj vendeve të demokracisë popullore, ne duhet të kemi parasysh se jo të gjithë janë sjellë me ne njëlloj. Duke zbatuar vijën e përgjithshme të Partisë, për forcimin e lidhjeve dhe të miqësisë me të gjithë popujt e vendet e demokracisë popullore, duhet të ndjekim në praktikë qëndrimet konkrete të tyre ndaj nesh. Është e nevojshme, përgjithësisht, që njerëzit tanë, duke qenë të patundur në parime, të jenë elastikë, të matur dhe korrektë nga ana taktike.

Mbi marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Kinës

Kohët e fundit lidhjet dhe marrëdhëniet me shokët kinezë janë bërë akoma më të ngushta. Dhe kjo shpjegohet me faktin se të dyja partitë tona ndjekin një rrugë, një qëllim, sepse të dyja i bashkoi dhe i lidhi më ngushtë lufta parimore për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Disa përfaqësues të partive të ndryshme në Moskë si Zhivkovi e të tjerë u përpoqën ta paraqitin çështjen sikur Partia e Punës e Shqipërisë veproi e vepron sipas porosive të Partisë Komuniste të Kinës. Është e tepërt të theksohet këtu se Partia jonë ka mendimin e saj, pikëpamjen e saj, personalitetin e saj. Ajo

ka luftuar dhe lufton për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, me vendosmëri prej shumë vjetësh. Në këtë luftë ne u gjendëm krah për krah me shokët kinezë, të cilët gjithashtu luftojnë me guxim e me vendosmëri për mbrojtjen e ideve tona fitimtare. Dhe mbi këtë bazë, mbi bazën e luftës për marksizëm-leninizmin, u lidhën dhe u bashkuan fort të dyja partitë tona.

Duhet thënë se në Mbledhjen e Bukureshtit ne i mbrojtëm shokët kinezë, duke u nisur nga pozitat e marksizëm-leninizmit. Po kështu nga të njëjtat pozita ne i mbrojtëm ata edhe në Mbledhjen e Moskës. Por nga ana e tyre edhe shokët kinezë në Mbledhjen e Moskës e mbrojtën me vendosmëri Partinë tonë, pozitat e saj parimore. Më lejoni t'ju parashtroj këtu se ç'tha delegati i PK të Kinës në dy fjalimet e tij lidhur me Partinë tonë.

Në fjalimin e parë ai, ndër të tjera, tha se pozita që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ka zënë në këto kohët e fundit kundrejt Partisë së Punës të Shqipërisë, ka ngjallur te ne një shqetësim të madh. Bashkimi Sovjetik i ka dhënë ndihmë Shqipërisë dhe këtë nuk e mohon asnjëri. «Por vallë, theksoi ai, a mund të konsiderohet si krejt e parëndësishme ndihma internacionaliste që i jep populli heroik dhe punëdashës shqiptar Bashkimit Sovjetik, gjithë kampit socialist, lëvizjes komuniste ndërkombëtare, çështjes së paqes në mbarë botën dhe revolucionit të popujve të vendeve të ndryshme? Sido që të jetë puna, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik nuk mundet, për shkak se i ka dhënë ndihmë Shqipërisë, të konsiderojë të lejueshme të përdorë privilegjin që të ndërhyjë në punët e brendshme

të Shqipërisë dhe, po për këtë arsye, shokët shqiptarë nuk kanë humbur aspak të drejtën për të zgjidhur në mënyrë të pavarur çështjet e tyre të brendshme.

Këto kohët e fundit udhëheqësit e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik kanë sulmuar më se një herë para shokëve kinezë Partinë e Punës të Shqipërisë, duke deklaruar se ata do të mbajnë kundrejt Partisë marksiste-leniniste të Punës të Shqipërisë dhe kundrejt Republikës Popullore të Shqipërisë po atë qëndrim që ata mbajnë kundrejt Jugosllavisë, se ata duan ta dënojnë Partinë e Punës të Shqipërisë, duke ia ndërprerë çdo lloj ndihme, për arsyen e thjeshtë se shokët shqiptarë mbrojnë pikëpamjet e tyre për një radhë çështjesh, se, sidomos në Mbledhjen e Bukureshtit dhe pas kësaj Mbledhjeje, nuk shkuan pas shokëve sovjetikë në veprimet që drejtoheshin kundër Partisë Komuniste të Kinës. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në letrën e tij të datës 5 nëntor, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, shpreh bile përkrahjen e tij të hapur ndaj elementëve antiparti të Shqipërisë, duke i quajtur ata miq të Bashkimit Sovjetik. Ne shpresojmë se shokët sovjetikë do të mendohen me qetësi për faktin nëse, duke mbajtur një qëndrim të tillë kundrejt Partisë së Punës të Shqipërisë, ata udhëhiqen nga parimet e internacionalizmit proletar apo nga parimet patriarkale që janë të palejueshme në radhët e komunistëve? Në qoftë se puna do të shkojë deri atje që të gjitha partitë motra dhe të gjithë vendet vëllezër do të ndërhyjnë në punët e brendshme të njëri-tjetrit dhe do të provokojnë përçarje te njëri-tjetri, pa u ndalur përpara asnjë mjeti,

atëherë lind pyetja: Çfarë do të bëhet familja jonë e madhe komuniste? Nuk ka dyshim se akte të tilla janë absolutisht të papajtueshme me interesat e kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare...».

Dhe në fjalimin e dytë theksoi:

«Delegacioni i Partisë Komuniste të Kinës mendon se çështjet që paraqiti shoku Enver Hoxha në lidhje me marrëdhëniet midis partive dhe shteteve të Bashkimit Sovjetik dhe të Shqipërisë janë serioze dhe meritojnë vëmendje serioze e studim nga ana e shokëve. Shokët mund të mos pajtohen me këtë apo atë pikë të vërejtjeve të tij kritike, por ndërkaq duhet të mbështeten vetëm në faktet dhe nuk duhet që pa i shqyrtuar faktet të quajnë shpifje çdo gjë që u tha, tamam sikur në këtë mënyrë mund të zgjidhen mosmarrëveshjet serioze që kanë lindur midis partive motra dhe vendeve vëllezër. Partia Komuniste e Kinës dëshiron sinqerisht që mosmarrëveshjet midis partive dhe shteteve të Bashkimit Sovjetik e të Shqipërisë të zgjidhen me anën e konsultimeve miqësore dhe që midis tyre edhe në të ardhshmen të ruhen marrëdhëniet e mira vëllazërore që janë krijuar gjatë shumë vitësh. Këtë e kërkojnë interesat e kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Disa shokë e fyen delegacionin e Partisë së Punës të Shqipërisë, gjë që është në kundërshtim me frymën e barazisë midis partive motra. Ne na habiti fakti që, bile edhe shoku Gomulka, i lejoji vetes të përdorë në fjalimin e tij fjalë fyese, duke thënë se fjalimi i shokëve shqiptarë është «sulm i ndyrë prej vagabondësh». Mos vallë Shqipëria nuk është vend socialist dhe Partia e Punës e Shqipërisë nuk është Parti

internacionaliste dhe komuniste? Mos vallë shokët shqiptarë nuk bëjnë një luftë të vendosur kundër imperializmit dhe revizionizmit jugosllav? Po të mendojmë me qetësi, që Shqipëria është një vend i vogël në kampin tonë socialist dhe ndodhet e rrethuar nga armiq, do të jetë e vështirë të besohet që shokët shqiptarë të trajtojnë me përbuzje të tjerët. Këto apo ato fjalë fyese të thëna në adresë të shokëve shqiptarë nuk ndihmojnë as për kompaktësinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, as për përmirësimin e marrëdhënieve midis Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë.

Disa shokë i lejuan vetes të deklarojnë se fjalimi i shokëve shqiptarë është gjoja rezultat i veprimtarisë fraksioniste që bëjnë shokët kinezë, ata bile deklaruan se kjo është një «shpërndarje rolesh» midis shokëve shqiptarë dhe kinezë. Për ne është shumë vështirë të kuptojmë se si këta shokë mund të thonë të tilla trillime. Po të quhet veprimtari fraksioniste ose rezultat i veprimtarisë fraksioniste fakti që shokët shqiptarë dhe kinezë shfaqën pikëpamje të njëjta për një sërë çështjesh, lind pyetja: Si mund të quhet kjo, që shokët e partive të tjera motra shfaqën pikëpamje të njëjta? Shokë, në radhët tona, në radhët e partive motra, është shfaqur edhe një atmosferë e tillë papërgjegjësie dhe padrejtësie. Kjo nuk mund të mos shkaktojë një shqetësim serioz...».

Partia jonë e Punës i është mirënjohëse Partisë motër të Kinës për këtë mbështetje internacionaliste e marksiste-leniniste.

Partia jonë në të ardhshmen do të forcojë lidhjet dhe miqësinë me Partinë Komuniste të Kinës dhe po-

pullin e madh kinez, duke iu përmbajtur kurdoherë mësimëve të marksizëm-leninizmit dhe vijës së drejtë që ka ndjekur kurdoherë Komiteti Qendror i Partisë sonë.

Mbi punimin e këtyre çështjeve në Parti dhe në Kongres

Komiteti Qendror i Partisë deri tani e ka vënë në dijeni Partinë, me një letër të veçantë, vetëm përsa i përket Mbledhjes së Bukureshtit. Ne mendojmë se tani me një letër tjetër duhet të vëmë në dijeni organizatat e Partisë edhe për Mbledhjen e Moskës e kontradiktat që ekzistojnë midis Partisë sonë dhe udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Kjo letër e Komitetit Qendror mendojmë se duhet të punohet në konferencat e Partisë në rrethe (ose në aktive) dhe pastaj në organizatat-bazë të Partisë. Është mirë që gjithë kjo punë të përfundojë para Kongresit, me qëllim që delegatët, të cilët do të vijnë në Kongres, qysh më parë, të jenë në dijeni të këtyre çështjeve.

Organizatat e Partisë duhet të kenë kujdes që një-rëzit tanë, në radhë të parë komunistët, të mprehin më tej vigjilencën politike revolucionare dhe më shumë t'u kushtojnë vëmendje problemeve të prodhimit, realizimit të planeve ekonomike, si në industri, ndërtim, miniera, tregti, bujqësi etj. Në kushtet e tanishme duhet një mobilizim i përgjithshëm, bile dhjetëfishimi i entuziazmit dhe i vendosmërisë së masave, për të përballuar vështirësitë e pengesat që na presin, për të dalë faqebardhë si Partia dhe populli.

Përsa i përket Kongresit të Partisë, ne mendojmë se është më mirë që atë ta shtyjmë, ta zhvillojmë aty nga fillimi i muajit shkurt, me qëllim që të kemi kohë për t'i shtruar në Parti çështjet për të cilat folëm, edhe që të pregatitemi më mirë për në Kongres.

Shokë,

Këto ishin çështjet që deshëm t'i raportojmë Plenumit. Partia jonë, ashtu si gjithnjë, do të ecë përpara drejt fitoresh të reja nën flamurin e marksizëm-leninizmit. Ne do të sigurojmë suksese gjithnjë e më të mëdha, sepse jemi në rrugë të drejtë, sepse luftojmë për një çështje fisnike, prandaj asnjë pengesë, asnjë vësh-tirësi, nuk ka e nuk do të ketë që të ndalë vrullin tonë fitimtar.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LUFTA PARIMORE E KONSEKUENTE KUNDËR IMPERIALIZMIT DHE REVIZIONIZMIT KA QENË DHE MBETET RRUGA E PARTISË SONE

Fjala e mbylljes në Plenumin XXI të KQ të PPSH

20 dhjetor 1960

Do të përpiqem të flas shkurt, sepse diskutimet e shokëve të Plenumit mbi këtë problem kaq të madh e vendimtar për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe të vijës së Partisë sonë ishin në lartësinë e duhur dhe e plotësuan shumë mirë raportin që u mbajt në Plenum në emër të Byrosë Politike të Komitetit Qendror.

Dua të theksoj në radhë të parë se ajo që bëmë ne në Moskë, ku paraqitëm vijën e Partisë sonë, nuk është merita ime personale ose vetëm e delegacionit tonë, por është merita e gjithë Partisë sonë dhe veçanërisht e udhëheqjes së saj, Komitetit Qendror, i cili e ka udhëhequr vazhdimisht drejt Partinë, i ka analizuar situatat kurdoherë në prizmin e marksizëm-leninizmit, i ka qëndruar kurdoherë besnik teorisë sonë të lavdishme,

! ka zbatuar me përpikëri të gjitha vendimet e drejta që janë marrë dhe ka ditur gjithashtu t'ia komunikojë këto si duhet Partisë dhe ta armatosë atë fort. Për këto arsye e gjithë vija e përgjithshme e Partisë sonë ka pasur suksese të mëdha. Prandaj ta kemi të qartë se merita për këtë i takon Komitetit Qendror dhe gjithë Partisë sonë heroike.

Revizionistët mund të mendojnë dhe të thonë se, po të marrë vesh Partia jonë për qëndrimin që mbajti delegacioni në Mbledhjen ndërkombëtare të Moskës, nuk do ta duronte Komitetin Qendror. Por askush nga ne nuk ka dyshimin më të vogël për unitetin e çeliktë që ekziston në udhëheqjen tonë, për unitetin e çeliktë të Partisë sonë rreth Komitetit Qendror dhe Byrosë Politike. Kjo përbën forcën e madhe të Partisë sonë dhe ky unitet ka dhënë mundësi që Partia jonë të kontribuojë në mbrojtjen e marksizëm-leninizmit edhe në shkallë ndërkombëtare. Sigurisht për këtë ne nuk kemi bërë tjetër veç detyrën si parti marksiste, si internacionalistë. Me këtë kuptim të drejtë të detyrës që karakterizon Partinë tonë jemi të bindur dhe të sigurtë se si një trup do të vëmë të gjitha forcat për zbatimin e përpiktë të marksizëm-leninizmit deri në fund, pa lëkundje dhe në çfarëdo rrethane.

Siç u theksua nga shokët, ne kemi përpara një luftë të madhe dhe të rëndë. Ne të gjithë jemi të ndërgjegjshëm për luftën që na pret, por që nuk na tremb. Këtë nuk e themi për t'i dhënë kurajë shoku-shokut, këtë e ka treguar gjithë jeta e Partisë sonë, e provuan veçanërisht ngjarjet e kohëve të fundit. Partia jonë, duke mbajtur qëndrime parimore, konsekuente, për të mbroj-

tur vijën e saj të drejtë, domethënë marksizëm-leninizmin, nuk mori parasysh as vështirësitë aktuale, as ato të së ardhshmes. Pra, vështirësitë dhe lufta ne nuk na trembin. Kjo është një karakteristikë marksiste. Ne as kemi qenë, as do të jemi kurrë pesimistë për të ardhshmen, përkundrazi do të jemi optimistë dhe kemi besim se marksizmi kurdoherë do të fitojë mbi oportunizmin, revizionizmin, si dhe mbi imperializmin.

Po përse është e vështirë kjo luftë? Sepse, kur themi që kemi përballë revizionizmin modern, e kuptojmë se nuk kemi përballë vetëm revizionizmin jugosllav, për të cilin në Deklaratën e Moskës thuhet se është koncentrimi i revizionizmit modern, por kemi revizionistë edhe më të rrezikshëm. Këtë gjë, për sy e faqe e pranuan të gjithë, edhe revizionistët e tjerë, edhe Hrushovi me shokë që janë vetë të tillë. Këtë ata e bënë për t'u maskuar, për të pranuar midis dy të këqijave të keqen më të vogël. Ndryshe do të binte erë, do të zbulohesh ajo që ata kërkonin të fshihnin. Për këtë ata kanë luftuar dhe do të luftojnë edhe në të ardhshmen që të fshihen me gjithfarë dredhirash.

Këta elementë propozuan të mos flitej në Deklaratë mbi revizionizmin jugosllav dhe vetëm pas një lufte të gjatë pranuan vënien e kësaj çështjeje. Por revizionizmi nuk përqëndrohet vetëm në Jugosllavi. Ai është një rrymë e tërë e rrezikshme në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ai është bërë i rrezikshëm sidomos nga përpjekjet që bëjnë oportunistët për të qetësuar njerëzit, duke përhapur idenë se revizionizmi ekziston vetëm në Jugosllavi, pra luftojnë që ta kufizojnë çështjen vetëm atje. Kështu revizionizmi ndërkombëtar shkakton, dhe

në të ardhshmen do të shkaktojë akoma konfuzion të madh, do të mundohet ta mbulojë këtë rrezik serioz që kërcënon lëvizjen komuniste ndërkombëtare, do të vazhdojë të trubullojë dhe të mashtrojë në të ardhshmen edhe njerëz të tjerë. Përballë këtij rreziku, një nga partitë marksiste-leniniste që duhet t'i bëjë dhe do t'i bëjë një luftë të ashpër dhe konsekuente revizionizmit, është edhe Partia jonë.

Është fakt se ne nuk jemi vetëm në këtë luftë. Kur Hrushovi u tha përfaqësuesve të Partisë Komuniste të Kinës që «ne do ta trajtojmë Shqipërinë si Jugosllavinë», ose «shqiptarët sillen me ne si Titoja», ky ishte një bluf dhe nuk gënjeu njeri. Nuk është Titoja armik i Hrushovit, po jemi ne. Por, meqenëse revizionistët jugosllavë, pa dashjen e Hrushovit, janë dënuar nga lëvizja komuniste ndërkombëtare si tradhtarë dhe renegatë të marksizëm-leninizmit, atëherë Hrushovi me shokë, duke mos i mbrojtur dot ata drejtpërsëdrejti, përpiqen të njollosin pozitat e marksistëve të vërtetë dhe të futin «dogmatikët», në të vërtetë ata që mbrojnë parimet e marksizëm-leninizmit, në një radhë me revizionistët, me të cilët, siç na mëson marksizmi, Hrushovi e ata që e pasojnë një mëngjes patjetër do të puqen plotësisht në rrugën që ndjekin. Kështu Hrushovi thotë se shqiptarët nuk janë revizionistë po janë «dogmatikë» dhe se ne i luftokemi sovjetikët njëjloj si titistët; domethënë, sipas tij, del se ai me shokët e tij qenkan marksistë, kurse ne qenkemi krahu «i majtë» i marksizmit. «Kështu ne, marksistët, thotë ai, na luftojnë njëjloj, si Titoja nga e djathta, ashtu edhe shqiptarët nga e majta».

Por, armiqtë e Hrushovit dhe të gjithë grupit të

tij nuk janë revizionistët. Jeta po tregon se armiqtë e këtij grupi janë vetëm marksistët. Byroja Politike thekson se pas ardhjes së tij në fuqi Hrushovi dhe grupi i tij revizionist, kanë pasur një plan të tërë: të mohojë marksizëm-leninizmi dhe të rehabilitoheshin gjithë ato rryma dhe njerëz që ishin zbuluar, ishin goditur e ishin shpartalluar si antimarksistë, ose që ishin likuiduar nga marksizëm-leninizmi në veprim; të mohojë e gjithë lufta e BS dhe e PK të BS kundër renegatëve të marksizëm-leninizmit, luftë e cila ishte personifikuar te PK (b) e BS e udhëhequr nga Lenini dhe nga Stalini.

Kjo do të thotë se duheshin goditur edhe Lenini edhe Stalini. Por të goditej Lenini ishte e pamundur për ta, ajo do të ishte katastrofë e madhe për revizionistët, prandaj u kufizuan me Stalinin dhe kundër tij nxorën një mijë gjëra. Sot është akoma më e qartë që këta intrigantë, rrenacakë, oportunistë dhe revizionistë po bëjnë sy për sy gjithë këto gjëra, kurdisin gjithë këto poshtërsi në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, organizojnë prapaska në turpshme në partitë motra.

Duke parë këto metoda të poshtra që përdorin revizionistët, Partia jonë është plotësisht e bindur që edhe për Stalinin janë kurdisur akuza e shpifje të tilla monstruoze, për të diskredituar atë si person dhe veprën e këtij marksist-leninist të madh. Këto kurdisje në BS i kanë pranuar elementët revizionistë, karrieristë, jomarksistë. Ata kanë pranuar tezat e Hrushovit dhe të grupit të tij përsa u përket «gabimeve të Stalinin» etj.

Byroja Politike thekson se udhëheqja sovjetike me Hrushovin në krye, u përpoq të rehabilitonte klikën e

Titos dhe ky është fakt. Të mos shihen nuancat e zigzagjet, se ato ai nuk ka mundur t'i evitojë, pasi nuk ka qenë në gjendje të ndryshonte në një ditë situatën; në parti ka pasur forca të shëndosha marksiste-leniniste që nuk e kanë lejuar të ecte në atë rrugë dhe me atë shpejtësi që do të dëshironte për të realizuar bashkë me grupin e tij menjëherë planet e veta. Por është fakt se ai ka bërë të gjitha përpjekjet që të rehabilitonte plotësisht të gjithë armiqtë e marksizëm-leninizmit që ishin dënuar deri atëherë në BS. Ai nxori nga varri akuza të tilla kundër Stalinit, siç ishte ajo nëse duheshin vrrarë apo jo Kamenievi me Zinovievin që kishin tradhtuar Leninin. I pushkatonte ose jo këta tradhtarë Stalini, ata, me tradhtitë që kishin bërë kundrejt BS dhe komunizmit, ishin të pushkatuar. Tani Hrushovi nxjerr gjithë këto gjëra dhe përploqet të rehabilitojë njerëz të tillë. Prandaj për të rehabilituar edhe revizionistët jugosllavë, atij i duhej të nxirrte shumë kleçka kundër Stalinit.

Të mos na shkojë aspak në mendje se vija e Hrushovit dhe e grupit të tij do të ketë ndryshime. Kjo vijë nuk do të ndryshojë aspak përsa i përket politikës ndërkombëtare dhe mbrojtjes që ai i bën revizionizmit. Hrushovi dhe grupi i tij janë në rrugë revizioniste. Ky qëndrim i tij ka pasur dhe do të ketë reperkusione të rënda në arenën ndërkombëtare.

Por a do të kenë sukses në planet e tyre Hrushovi dhe grupi i tij? Ne kemi bindjen e plotë se ai nuk do të ketë sukses, megjithatë ne do të hasim shumë vështirësi në rrugën tonë. Politikën e tij ne duhet ta kemi parasysh e ta trajtojmë me shumë kujdes, se ai nuk është një revizionist dosido, po njeri i rafinuar dhe pehli-

van i shkathët. Po të analizojmë mirë veprimtarinë e tij që kur ka ardhur në fuqi, do të shohim se ai kudo ka zënë kyçet, ka përdorur gjithfarë formash për t'u maskuar dhe punën e tij të rrezikshme vazhdon ta bëjë. Në fillim, me pehlivanllëqet e tij, ai arriti të krijojë një situatë që të mos i dilnin kundërshtime, u kap pas disa parullave të jetës politike ndërkombëtare ose të zhvillimit të ekonomisë dhe i përhapri ato me të madhe në të katër anët për t'i hutuar për një moment njerëzit.

Këtë taktikë ndoqi ai edhe në BS duke predikuar një farë ndryshimi deri në jetesën e njerëzve. Ai trumbetoi se jeta e punonjësve në BS në kohën e Stalinit gjoja ishte skëterrë, kurse tani Hrushovi është bërë «promotori i një jete të re demokratike dhe të pasur nga ana ekonomike». Pastaj ngriti edhe çështjen e paqes në botë që ai do t'ua «impononte» imperialistëve etj.

Kjo politikë, qysh në fillim të karrierës, kur udhëzimet e tij akoma nuk i kishin dhënë frytet, u propagandua me të madhe. Fjalë u thanë shumë, por asgjë në trastë. E gjithë kjo u bë për të përgatitur terrenin dhe situatën. Në këtë rrugë vazhdoi të ecte Hrushovi.

Një kurs i tillë ka pasur reperkusione të mëdha në politikën ndërkombëtare, ai i ka vënë njerëzit në gjumë ndaj rrezikut imperialist, ndaj rrezikut revizionist dhe të gjitha rrymave të tjera oportuniste që kërcënojnë komunizmin ndërkombëtar.

Hrushovi, me pikëpamjet dhe me politikën e tij prej oportunisti e revizionisti, ka nxitur dhe ka aktivizuar të gjithë elementët revizionistë, prandaj është bërë shumë i rrezikshëm. Revizionistët që ekzistonin përpara në vende të tjera nuk ndiheshin jo se i trembe-

shin Stalinit, jo se ai do t'i pushkatonte, sepse në Bullgari, në Shqipëri apo gjetkë Stalini, edhe po të donte apo të ishte vërtet ashtu siç e paraqit tani Hrushovi, nuk kishte ku t'i gjente, por nuk ndiheshin sepse në atë kohë në të gjitha partitë ekzistonte vija e drejtë marksiste-leniniste, që nuk lejonte të gjallërohej revizionizmi.

Revizionizmi jugosllav u demaskua e u dënua nga PK e BS dhe nga Stalini. Kjo vijë u përqaftua nga të gjitha partitë e tjera. Kur Hrushovi me shokë erdhën në fuqi, të gjithë revizionistët panë se te ata kanë një mbështetje të fuqishme, pasi këta njerëz janë në udhëheqje të BS. Prandaj tani vihet re se në shumë parti marksiste-leniniste që kanë pasur një qëndrim konsekuent, njerëz të rrymave oportuniste-revizioniste gjatë kësaj periudhe kanë ngritur veshët, bile, kanë arritur të vihen edhe në udhëheqje të disa partive.

Por Hrushovi kujtoi për një moment se vija e tij do të ecte si në gjalpë, prandaj pikëpamjet e tij nuk kishin fre, qoftë në masat e brendshme ekonomike e organizative që u morën në BS, qoftë edhe në politikën ndërkombëtare. Kështu ai, duke ndjekur vijën oportuniste e revizioniste thoshte ç'i vinte në kokë dhe bënte lëshime të vazhdueshme ndaj imperializmit. Imperialistët mund t'i kërcënosh sa të duash me fjalë, por ata mendtë i kanë në kokë, i bëjnë mirë hesapet, gyykojnë jo vetëm nga deklaratat dhe taktikat e të tjerëve, por dhe nga mjetet e forcat e tyre. Imperialistët ndihmohen edhe nga revizionistët që e njohin realitetin konkret në vendet tona.

Është fakt se gjatë kohës që kur kanë ardhur në fuqi Nikita Hrushovi dhe grupi i tij, imperializmi

nuk ka bërë asnjë lëshim. Përkundrazi ai është armatosur edhe më shumë dhe po përgatitet për luftë. Kemi plotësisht të drejtë kur themi se kampi i socializmit dhe forcat e paqes janë shumë më të forta nga ato të imperializmit. Por këto forca mund të dobësohen, në rast se ne ulim vigjilencën, në rast se nuk mbrojmë me vendosmëri marksizëm-leninizmin, në rast se nuk u themi ndal këtyre veprimeve të revizionistëve dhe nuk i demaskojmë pa ndërprerje imperializmin dhe revizionizmin, në rast se nuk e edukojmë politikisht popullin dhe nuk e armatosim për të qenë kurdoherë i gatshëm përpara çdo rreziku eventual.

Është e qartë se metodat që përdorin Nikita Hrushovi dhe ata që e ndihmojnë influencojnë që të ulët vigjilencën përpara këtij rreziku. Prandaj, sikurse vihet në dukje në raportin e Byrosë Politike, erdhi një kohë që nuk mund të pritej më, nuk mund të shkohej më tutje me këto metoda. Ato që thonë udhëheqësit sovjetikë se «fillove ti më përpara nga sulmet» etj. janë profka, janë maska për të mbuluar rrugën e tyre. Çështja qëndron kryesisht në faktin se ata kanë filluar të ndjekin një vijë oportuniste, e cila ka ardhur duke u trashur vazhdimisht qysh nga koha që ata kanë marrë fuqinë në dorë.

Mbrojtja e tyre karakterizohet vetëm në formula, jo the kështu, jo the ashtu. Po ato s'pijnë ujë. Ne po e shohim se që kur kanë ardhur në fuqi, ata po ndjekin një vijë revizioniste dhe punojnë që të dobësohet lufta kundër imperializmit, të dobësohet vigjilencën e popujve dhe të ndihmohet revizionizmi për të shtënë në dorë lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Mirëpo tani kësaj pune iu tha stop! Kështu u vu në rrezik e gjithë kjo vijë oportuniste e kryesuar nga Hrushovi. Ai në mënyrë oportuniste deshi të shpartalloste rezistencën marksiste-leniniste kundër vijës së tij. Mendoj se kjo rezistencë në BS mund të shpartallohej duke nxjerrë çështjen e Stalinit, duke dënuar «kultin» e tij të individit. Ai mendoi gjithashtu se ka aq forca edhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare sa t'i jepte një grusht vendimtar sulmit marksist-leninist që bëhej kundër kësaj vije oportuniste. Kjo u duk qartë në Mbledhjen e Bukureshtit ku u bënë përpjekje për ta dënuar dhe për ta likuiduar situatën që i pengonte, por, siç e dimë, nuk patën sukses.

Në Mbledhjen e Bukureshtit Partia jonë ka luajtur një rol të rëndësishëm. Ajo ishte e vetmja parti që kundërshtoi çka po bëhej atje. Dhe që këtej nisi armiqësia e hapur kundër nesh, që deri atëherë ka qenë e mbuluar. Prandaj duhet gjykuar se sa e rëndë e ç'humbeje e madhe ishte për ata qëndrimi i Partisë sonë.

Ne duhet të kemi besim të plotë se situata që ka krijuar ai në mjaft parti komuniste të Evropës, të cilat ka mundur t'i bëjë për vete, është një situatë e përkohshme. Këtë besim ne e mbështetim në forcën e marksizëm-leninizmit. Sidoqoftë, përkohësisht ai e ka krijuar këtë situatë të sëmurë, duke sjellë, në një mënyrë ose në një tjetër, në udhëheqje të disa partive njerëz me pikëpamje oportuniste-revizioniste. Në këto kushte të favorshme për të që ai kishte përgatitur, kundër vijës së tij u ngrit përveç Partisë së madhe Komuniste të Kinës edhe një Parti e vogël, e cila e kuptoi rrezikshmërinë e kësaj vije dhe i tha me vendosmëri:

«Stop, deri këtu, nuk jam me ju, nuk jam me rrugën që ndiqni ju!».

Deri tani, në interes të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, ne kemi bërë edhe taktikë, por tani që Hrushovi kërkon t'i japë grushte pjesës së shëndoshë të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe ta detyrojë të ndjekë vijën e tij oportuniste, ne i themi: «ndal!». Kjo për ta, natyrisht, është një humbje e madhe.

Por situata për ta u komplikua më shumë në Mbledhjen e Moskës. Punimet e Mbledhjes së Moskës nuk u zhvilluan siç i kishin parashikuar ata. Këtë e vërtetoi Deklarata e Moskës, që është një dokument i mirë, i pranuar nga të gjithë. Natyrisht, po të ishte një situatë e shëndoshë, do të kishte dalë një deklaratë më e zjarrtë, më luftarake. Sidoqoftë ky dokument është i pranueshëm dhe duhet kuptuar drejt, ashtu siç është.

Tani vihet pyetja: Mos do të ndryshojnë këta njerëz që nënshkruan një dokument të tillë? Ne duhet t'i themi Komitetit Qendror se ata nuk do ta ndryshojnë vijën e tyre. Kjo kuptohet nga fjalët që ka thënë Hrushovi dhe që u përmendën në raport, të cilat nuk duhen harruar. Për Deklaratën ai ka thënë se «është një dokument kompromisi». Për Hrushovin ky është një kompromis, sepse ai hyn në një fazë tjetër, po edhe taktika jonë tani hyn në një fazë tjetër.

Të gjitha partitë komuniste dhe punëtoare marksiste-leniniste kanë pasur një dashuri të zjarrtë, një besim të patundur për BS, për PK të BS dhe për udhëheqjen e PK të BS, me Stalinin në krye. Ky ishte një besim i merituar, i drejtë, marksist-leninist. Kur erdhi në fuqi grupi i Hrushovit nuk gjeti më atë ngrohtësi në

zembrën e komunistëve shqiptarë dhe të vendeve të tjera siç qe më parë. Ne për BS dhe për PK të BS vazhdonim të ushqenim po ato ndjenja dashurie dhe besimi si dhe më parë, me ndryshimin që, duke u bazuar në ngjarjet që po zhvilloheshin atje, thoshim se në PK të BS po bëhen padrejtësi, se atje po shtrembërohet vija. Në fillim kishte disa gjëra të papërcaktuara, ndërsa më vonë ato u konkretizuan.

Dashurinë për BS ne e ruajmë edhe në këtë fazë, por gjatë kësaj kohe ne pamë dhe kuptuam se udhëheqja e PK të BS po shkonte nga e djathta, drejt rrugës oportuniste, revizioniste. Në këto kushte ne adoptuam taktikën e heshtjes në publik, veçanërisht në atë ndërkombëtar. Kjo ishte një taktikë e drejtë dhe jo e rastit për udhëheqjen tonë. Qëllimi i saj ishte të mbrohej marksizëm-leninizmi, të mbrohej vija e Partisë sonë.

Po cila është vija jonë? Lufta kundër revizionizmit dhe çdo rryme oportuniste ose dogmatike që godet dhe synon të shkatërrojë marksizëm-leninizmin; demaskimi i imperializmit dhe i revizionizmit jugosllav dhe i çfarëdo lloj revizionizmi, ideologjikisht dhe politikisht; forcimi i vigjilencës, armatosja e gatishmëria e përhershme përpara çdo rreziku eventual dhe miqësia e pandarë me të gjitha partitë komuniste e punëtore dhe me vendet e kampit të socializmit, pa marrë parasysh nëse Hrushovit, Zhivkovit, Gomulkës e të tjerëve u pëlqen ose nuk u pëlqen vija jonë. Domethënë ne as politikisht, as ideologjikisht nuk kemi bërë lëshime nga vija jonë, lëshime bënë ata. Ne u përpoqëm të mbrojmë me vendosmëri vijën tonë dhe dashurinë për PK të BS dhe për BS, por me Hrushovin me shokë nuk kemi qenë

dhe nuk jemi dakord. Këtë ata e kanë kuptuar dhe e dinë.

Tani vjen një fazë tjetër që e hapën Mbledhja e Bukureshtit dhe ajo e Moskës. Në këtë fazë edhe taktika e tyre ka marrë dhe do të marrë forma të reja. Por dhe taktika jonë nuk do të qëndrojë në vend; ajo do t'i përshtatet zhvillimit të ngjarjeve, por kurdoherë ne do të vazhdojmë të mbrojmë me vendosmëri marksizëm-leninizmin, do t'i demaskojmë të gjithë armiqtë e marksizëm-leninizmit.

Pozitat e këtyre njerëzve, që mendonin se kishin fituar, pas Mbledhjes së Bukureshtit dhe sidomos pas asaj të Moskës, janë lëkundur dhe për këtë asnjëri nuk ka dyshim. Nikita Hrushovi nuk qëndron më i kapardisur në atë fron që kishte zënë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, për arsye të luftës parimore që iu bë nga Partia jonë, nga PK e Kinës dhe nga mjaft parti të tjera që mbajtën qëndrim marksist-leninist.

Këto qëndrime kanë rëndësi të madhe historike se i thanë stop Hrushovit. Ato ia lëkundën atij nga themeli pozitat që kishte menduar se i kishte të paprekshme në partitë e ndryshme.

Por ne duhet të kemi parasysh se Hrushovi do të mundohet t'i ketë me vete të gjithë ata që i shkuan pas në Mbledhjen e Bukureshtit dhe të Moskës, se janë mjaft të komprometuar. Revizionistëve sovjetikë dhe lajkaxhinjve të tyre, që u ndodhën në Mbledhjen e Moskës, u interesonte shumë që ne të mos i kritikonim, ndaj u përpoqën të na hidhnin pluhur syve duke na marrë me të mirë. Kështu u përpoq Mikoiani para se të flitnim ne në mbledhje. «Dakord me ju, tha përafërsisht ai, jemi

edhe ne për Stalinin, për «dënimin» e revizionizmit jugosllav, prandaj na thoni, ç'doni».

Po ta shohim problemin nga pikëpamja ideologjike, do të bindemi se çfarë kishte më shumë rëndësi: të flitnim për ato probleme të mëdha parimore të lëvizjes komuniste, apo për ndonjë gjë tjetër, për shembull, për fjalët që tha Malinovski etj. Natyrisht, mbrojtja e çështjeve parimore të lëvizjes komuniste, në radhë të parë, kishte më shumë rëndësi sesa ato që udhëheqësit sovjetikë na kishin bërë neve, por edhe këto ishin tepër diskredituese për ta, prandaj u munduan që ne të mos i përmendnim në fjalimin tonë, sepse një gjë e tillë do të demaskonte jo vetëm vijën e tyre oportuniste, por edhe metodat e fshehta, djallëzore, të ndyra, që revizionistët dhe udhëheqja sovjetike kanë përdorur kundër nesh dhe shumë të tjerëve, të cilave tani u kanë hedhur një cipë që ka zënë dregëz, por që nuk janë harruar dhe kanë influencuar të bëhen gabime në shumë çështje të mëdha të komunizmit ndërkombëtar.

Moris Torezi, për shembull, mund të kishte arsye të tjera, për qëndrimin që mbajti kundër nesh në Mbledhjen e Moskës, megjithëse, kur ishte në Shqipëri për pushime, ai ishte plotësisht dakord me sa i referova unë. Por edhe atij fjalimi i Partisë sonë në Moskë i ka djegur, sepse si përfaqësues dhe udhëheqës i PK të Francës ai ka një përgjegjësi të madhe, se ka lejuar që një çështje shumë e rëndësishme, siç është ajo e qëndrimit ndaj revizionistëve jugosllavë, të cilët i kishte dënuar Byroja Informative, nga N. Hrushovi dhe pasuesit e tij nuk u zgjidh në rrugën marksiste-leniniste, por vetëm me anën e një telegrami.

Për shumë arsye Gomulka u ngrit në mbledhje dhe kërkoi që çështja e Shqipërisë të shihet në Traktatin e Varshavës, por ai atë e tha edhe për arsyen se përfaqësuesi i Partisë sonë iu kundërvu politikës së tij dhe nuk ishte dakord me propozimet e Gomulkës në OKB. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe, sepse me propozimet e tij ai u tha imperialistëve: «I ruani të gjitha bazat e shumta ushtarake që keni ngritur, mbajeni bombën atomike dhe të tjerët të mos e kenë». Kup-tohet lehtë që, sipas Gomulkës, këtë armë nuk duhet ta ketë Kina dhe kjo u intereson shumë imperialistëve. Qëndrimi i delegacionit tonë, pra, ishte një goditje e rëndë për politikën e tyre aventurcske e oportuniste që ka për qëllim ta çojë kampin socialist në greminë. Prandaj Gomulka tha që Shqipëria të nxirret nga Traktati i Varshavës.

Ngritja e këtyre çështjeve të mëdha për fatet e socializmit kishte rëndësi shumë të madhe. Udhëheqjes sovjetike nuk i prishej puna, në rast se ne vinim në dukje vetëm ato që Ivanovi bëri në Shqipëri etj. Atyre u digjte ngritja e problemeve ashtu si bëmë ne, sepse në këtë mënyrë do të demaskohej politika e tyre. Por duke ngritur edhe çështjen e ndërhyrjes në punët e brendshme të vendit tonë, çështjen e synimeve të tyre për të përçarë udhëheqjen tonë, këto i dogjën shumë Zhivkovit, sepse dihet se ka ndërhyrë Hrushovi që e solli atë në fuqi në Bullgari.

Pra, fjala jonë në Mbledhjen e Moskës Hrushovit i dogji jashtëzakonisht shumë. Është e kuptueshme se ky demaskim i hapte atij avaze shumë të mëdha. Kjo i bëri ata të hidhen në ofendime pa princip, sepse, po t'u

futeshin të tjerët thellë këtyre gjërave, kjo do t'u nxirrte telashe jo vetëm atyre që drejtonin sharjet kundër nesh, por edhe dirigjentëve të tyre.

Dihet se pas Kongresit XX të PK të BS u ndryshuan udhëheqjet e shumë partive komuniste e punëtoresh. Hrushovi e kuptonte se partitë ku nuk u ndryshuan udhëheqjet ishin një rrezik i madh për vijën e tij, sepse përpjekjet dhe pikëpamjet e tij në këto parti nuk mund të zinin vend. Prandaj kundër dëshirës së tij ai që i detyruar të buzëqeshte dhe për sy e faqe mbante edhe marrëdhënie miqësore me Partinë tonë. Por ai e shihte se nuk ia arrinte dot qëllimit dhe në mos sot, mendonte, do të përpiqem t'ia arrij nesër. Kështu mendonte ai për Partinë tonë, për PK të Kinës e për disa parti të tjera. Në këto parti ai nuk ka mundur t'i minojë dot udhëheqjet, prandaj, duke parë në to rrezikun, ka punuar për të realizuar planet e tij edhe me rrugë të tjera.

Në fillim ai u përpoq të forconte pozitat e tij, të krijonte një atmosferë besimi se ai na qenkej «Lenini i sotëm», të zhdukte çdo dyshim ndaj tij dhe gjatë kësaj veprimtarie të përgatiste kuadrot e tij besnikë që do ta mbështetnin. Ai shihte se në Shqipëri bëhej një propagandë e mirë për BS dhe shpresonte se do të vinte një kohë që edhe ne të ecnim në rrugën e tij. Por nuk i doli.

Megjithëse ata e nënshkruan deklaratën, kjo nuk do të thotë se kanë ndërruar rrugë. Kjo është vetëm një taktikë e tyre. Sa do të vazhdojë kjo nuk dihet, por është një taktikë e rrezikshme. Atë ne do ta shohim, do ta ndjekim këmba-këmbës, situatat ndërkombëtare do të bëhen më të ndërlikuara, megjithëse Hrushovi me

pasuesit e tij kanë propaganduar zhvillimin paqësor. Mirëpo kudo po shohim se ka greva, kryengritje, lëvizje nacionalçlirimtare nga ana e popujve dhe terror nga ana e imperialistëve. Kjo e rrëzon pikëpamjen aq shumë të përhapur të Hrushovit për zhvillimin paqësor të ngjarjeve.

Këta njerëz nuk do t'i ndalë në rrugën e tyre veçse forca e madhe e komunizmit ndërkombëtar, forca e atyre partive që luftojnë me konsekuencë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit.

Ne duhet të jemi optimistë. Çdo ditë që kalon çështjet do të sqarohen më mirë dhe situata ndërkombëtare do t'i vërtetojë patjetër tezat tona. Por ne kemi përpara një luftë të gjatë. Nuk duhet të mendohet në asnjë mënyrë se ata do t'i hedhin armët, përkundrazi, ata do të përpiqen të manovrojnë me mënyrat më brutale dhe më të stërholluara. Kontradiktat e politikës që ndjekin ndaj imperialistëve do të dalin në shesh gjithnjë e më qartë, kush është marksist do t'i kuptojë, sepse imperia- lizmi po përgatitet për luftë, ndërsa revizionistët duan ta frenojnë vetëm me fjalë. Ata po i lënë fushë të lirë imperializmit me politikën që ndjekin, prandaj ai po bëhet çdo ditë rrezik i madh për kampin e socializmit, për tërë botën komuniste, për paqen në botë.

Ne kemi pasur besim te Bashkimi Sovjetik, sepse në raste vështirësish ai dhe vendet e demokracisë popullore na kanë ndihmuar. Por ne asnjëherë nuk kemi fjetur duke mbështetur shpresat vetëm në ndihmën e miqve. Hrushovi me demagogji gjithnjë ka thënë: «Ç'ju duhen juve armët, ju mbrojmë ne!». Mirë, po gjithë këto që po ndodhin ç'janë? Përse nuk jemi mbledhur

një herë të bisedojmë mbi këto probleme kaq të rëndësishme për fatet e kampit socialist dhe të komunizmit ndërkombëtar, t'i shohim bashkërisht këto probleme të mëdha? Përse është caktuar ministri ynë i Mbrojtjes si zëvendëskomandant i forcave të bashkuara të Traktatit të Varshavës? Përse janë caktuar gjithashtu edhe kolegët e tij të Polonisë, të Çekosllovakisë e të tjerë? Po ata janë vetëm për formë, sepse asnjërin prej tyre nuk e thërret njeri për të biseduar, të gjitha masat që merren në emër të kampit socialist i vendos Hrushovi me shokë. «Kini besim te ne, thotë Hrushovi, ne jemi të armatosur mirë». Mirëpo ai tjetri mund të na sulmojë befasisht dhe ne nuk kemi armë, që t'i përgjigjemi. «I godasim ne që nga Siberia», thotë ai. Por, si po zhvillohen ngjarjet, ne të gjithë së bashku duhet të përgatitemi më mirë. Në luftë do të vemë bashkë. Prandaj edhe mënyrën si të mbrohemi duhet ta vendosim bashkë. Ne nuk kërkojmë të dimë sekretet ushtarake të BS, por Hrushovi vazhdon të bëjë strategji të madhe në Kremlin për të gjitha vendet e kampit dhe ne nuk na thërret një herë të na thotë të paktën: «Ne kemi këto lloj armësh dhe në vende të sigurta». Nuk mblidhen herë pas here përfaqësuesit e vendeve të Traktatit të Varshavës të kontrollojnë armatimet ushtarake, të merren masa bashkërisht dhe kështu të njihen e të vëllazërohen ushtritë tona. Këto situata i dinë vetëm shokët e Hrushovit. Unë kam besim se edhe të tjerët, edhe Gomulka që tani hesht, me siguri ka kundërshtime për këto çështje, por tani ai u ujdís me Hrushovin dhe, me një kritikë që bëmë ne, përveç kërcënimeve të tjera, kërkoi menjëherë të nxirremi nga Traktati i Varshavës.

Pra, lufta që kemi përpara, në situatat që janë krijuar, nuk është aq e lehtë. Përkundrazi, ajo do të jetë shumë e vështirë. Por ne duhet të luftojmë me vendosmëri, të ndjekim hap pas hapi situatën, duke pasur të qartë ç'janë këta njerëz dhe ç'duan të bëjnë. Në rast se ata do të vihen në rrugë të drejtë, ne do ta ndryshojmë qëndrimin tonë ndaj tyre dhe do të ecim me ta si përpara, por nuk na lejohet të flemë të shkujdesur. Pas gjithë këtyre gjërave që po ndodhin, besim qorrazi nuk do të kemi, sepse pikëpamjet dhe veprimet e këtij njeriu janë haptas antimarksiste. Hrushovi është duke bërë një krim të madh ndaj popullit sovjetik dhe ndaj komunizmit ndërkombëtar.

Kërcënimet që na bënë, ne duhet t'i shikojmë seriozisht. Në rast se ata nuk do të mund të na nxjerrin nga Traktati i Varshavës, në rast se nuk i largojnë njerëzit e tyre nga baza detare e Vlorës, në rast se nuk do të na i presin kreditë, këto nuk do t'i bëjnë jo pse na duan, por se hovi i tyre u pre në Moskë, si dhe për rrethana politike ndërkombëtare. Ato që na bënë për bazën detare nuk ishin vetëm shantazhe, por një vijë e tërë e hartuar jo vetëm nga Hrushovi.

Përse ata mbajtën qëndrim ndaj nesh, kur ne akoma nuk e kishim shfaqur pikëpamjen tonë? Ata ishin konsultuar me njëri-tjetrin dhe, për të bërë këtë, sinjalizimin ua dha Mbledhja e Bukureshtit. Më vonë na bënë thirrje të shkonim në rrugën e tyre dhe, derisa nuk shkuam, kishin menduar ç'qëndrim do të mbanin ndaj nesh.

Në rast se kursi i tyre nuk do të ishte ndalur në Mbledhjen e Moskës, ata do të përpiqeshin të na tër-

hiqnin në rrugën e tyre antimarksiste ose, po të mos arrinin këtë, të na hidhnin poshtë dhe, po të mos mundnin të na përjashtonin, të mbanin ato qëndrime që mbajnë tani.

Të parën nuk e bënë dot, as të dytën dhe u arrit në situatën që dimë. Sigurisht, planin e kishin ndryshe ndaj nesh, por nuk e patën lehtë ta realizonin, se do të demaskoheshin në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, sidomos në sytë e popujve të Bashkimit Sovjetik. Megjithëse plani i tyre ndaj Partisë sonë dështoi, ata nuk do ta harrojnë kurrë qëndrimin burrëror dhe të drejtë marksist-leninist që ka mbajtur e mban Partia jonë dhe do të kurdisin plane që në mos sot, nesër të hakmerren. Por ne nuk do t'u japim armë të na luftojnë. Ne gabime nuk do të bëjmë, vijën nuk e shkelim dhe as kurrizin nuk e ulim, ne do të qëndrojmë si kurdoherë vigjilentë në pozitë e marksizem-leninizmit.

Qëndrimi marksist-leninist që mbajtëm ne, si dhe qëndrimi i PK të Kinës, ka rëndësi vendimtare për jetën e vendeve socialiste, për paqen dhe socializmin në të gjithë botën. Partia Komuniste e Kinës qëndron e patundur në rrugën marksiste-leniniste dhe është bërë një pengesë jashtëzakonisht serioze për ta. Një nga shkaqet kryesore të tërheqjes së tyre në Mbledhjen e Moskës është qëndrimi i drejtë parimor i PK të Kinës.

Ne mendojmë se, sikur Hrushovi me shokë të mos ishin tërhequr, kjo do të kishte qenë katastrofë e madhe për ata vetë dhe për gjithë këlyshët e tyre, sepse partitë e tyre nuk do të pranonin të bëhej një krim i tillë ndaj komunizmit ndërkombëtar. Po edhe sikur partitë e tyre

ta pranonin këtë përkohësisht, pas një kohe do të vërtetohej patjetër se ata ishin revizionistë dhe tradhtarë, kurse Kina e Shqipëria janë në rrugë marksiste-leniniste, luftojnë kundër revizionizmit dhe ndërtojnë socializmin. Prandaj preferuan dhe pranuan tërheqjen, me qëllim që nga këto pozita të tërhequra të marrin forca të reja. Për këtë ne mendojmë se do të kemi përpara një luftë të vështirë dhe me përgjegjësi të madhe për mbrojtjen e socializmit në Shqipëri, të vijës së përgjithshme të Partisë sonë dhe të parimeve të drejta të Deklaratës së Moskës.

Por gjendja e rëndë që është krijuar në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe në marrëdhëniet tona me udhëheqjen e PK të BS e me udhëheqjet e disa partive të tjera, na shtron përpara detyra shumë të rëndësishme, të cilat, ashtu si gjer më sot, duhet t'i kryejmë kurdoherë drejt, me mençuri e me guxim marksist-leninist.

Në radhë të parë ne duhet të forcojmë çdo ditë e më shumë unitetin e Partisë. Ky unitet është i çeliktë, por duhet të punojmë vazhdimisht ta kalitim, se këto momente janë kthesa të rëndësishme dhe në këto kthesa ka edhe njerëz që tronditen. Prandaj, Partia të jetë jo vetëm afër komunistëve, por afër çdo njeriu, afër të gjitha masave të popullit, në mënyrë që uniteti i radhëve të Partisë dhe uniteti Parti-popull të kaliten në rrugë marksiste-leniniste.

Ne jemi të mendimit që Partia duhet t'i dijë veprimet armiqësore dhe revizioniste të këtyre tradhtarëve, të shohë cilët janë ata që duan t'i bëjnë varrin Partisë sonë, si dhe komunizmit ndërkombëtar. Për këtë ka

edhe dokumente të shkruara, por duhet punuar edhe me gojë për ta sqaruar Partinë, me qëllim që t'i bëhet një luftë e rreptë revizionizmit, jo vetëm nga ana teorike, por edhe në praktikë me shembuj konkretë. Anëtarët e Partisë duhet të jenë vigjilentë, të mbrojnë vijën e saj dhe të ruajnë interesat e mëdha të popullit tonë, të Partisë dhe të marksizëm-leninizmit.

Rëndësi, pra, ka që ne ta edukojmë mirë Partinë se kështu ajo do t'i kuptojë drejt edhe taktikat që ne duhet të përdorim në këto situata kaq të ndërlikuara.

Partia jonë do të përdorë taktika, kjo është e domosdoshme, përveç të tjerave, që populli sovjetik dhe popujt e tjerë të vendeve të demokracisë popullore ta kuptojnë se ne jemi në rrugë marksiste-leniniste dhe në miqësi me ta, por në kundërshtim me ata që janë armiq të tyre e të marksizëm-leninizmit.

Po të vazhdojnë udhëheqjet e këtyre vendeve të veprojnë kundër nesh, do të marrin përgjigjen e duhur, por ne do të përpiqemi të mbajmë marrëdhënie miqësore me të gjitha vendet socialiste, pa bërë lëshime parimore, pa shtrembëruar vijën e duke mbajtur kurdoherë qëndrime korrekte, në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit.

Të kemi parasysh se do të kemi kontakte me njerëzit sovjetikë ose të vendeve të demokracisë popullore. Qëndrimet tona ne nuk do t'i ndryshojmë, por marrëdhëniet me ta, sigurisht, nuk kanë për të qenë si më parë dhe për këtë nuk jemi ne shkaktarë, shkaktarë janë ata vetë. Mikoiani na tha: «Tani nuk është e nevojshme të kemi marrëdhënie të ngushta partie, por vetëm marrëdhënie tregtare». Ne i thamë se nuk ishim

dakord me një pikëpamje të tillë, por, meqenëse dëshirojnë ata, edhe ashtu mund të veprojmë.

Ne kemi qenë ata që, kur vinin Ivanovi ose Novikovi për takime, i vinim në korent me dashamirësi për problemet që dëshironin të ishin në dijeni. Ne këtë e bënim jo për t'u dhënë llogari atyre, por këto qëndrime lidheshin me çështjen e miqësisë së ngushtë dhe pa rezerva që ne ushqenim për Bashkimin Sovjetik. Tani që situata ka ndryshuar vetëm për fajin e tyre, kur ata të na vijnë përsëri ne do t'i presim, do t'i pyesim ç'dëshirojnë, por do t'u japim atë që shohim ne të arsyeshme dhe jo ç'të duan ata.

Me teknikët e specialistët që punojnë në ndërmarrjet tona, duhet të tregohemi të ngrohtë, të dashur e miqësorë. Sigurisht, midis tyre mund të ketë edhe njerëz të djallëzuar, por edhe sikur të mos jenë të djallëzuar, disa do të udhëzohen të bëhen të tillë. Ndaj duhet të tregohemi të kujdesshëm e vigjilentë, të dallojmë mirë cilët janë të ndershëm e të sigurtë me ne dhe cilët janë dërguar për të zbatuar udhëzimet armiqësore të Hrushovit me shokë. Vijën tonë marksiste-leniniste ne duhet ta mbrojmë kurdoherë e me këdo. Të mos kemi aspak frikë t'u përgjigjemi, kur ata, në rrugë të gabuar, atakojnë Partinë, udhëheqjen dhe unitetin tonë. Duhet të ruhem nga provokacionet, sepse ka njerëz që bëjnë provokime, por ka edhe provokime të cilave duhet t'u përgjigjemi në vend e t'u japim grushtin e merituar atyre që i kurdisin.

Të kemi kujdes dhe të jemi vigjilentë për t'u orientuar drejt në bazë të vijës së Partisë në çdo rast. Këtu duhet të tregohet zotësia dhe zgjuarsia e komunistëve.

Është lehtë t'i thuash tjetrit «largohu», ose «nuk dëshiroj të flas me ty», por një qëndrim i tillë nuk do të ishte as politik as marksist. Prandaj të veprojmë me pjekuri dhe elasticitet.

T'u flitet njerëzve të huaj që gjenden në Shqipëri për vijën e Partisë sonë, për qëndrimin tonë, të mundohemi t'i sqarojmë që ata t'i kuptojnë drejt këto gjëra, se shumë prej tyre mund t'i kenë të paqarta.

Shumë vigjilente dhe të matura duhet të jenë sidosmos organet e shtypit. Shtypi ynë duhet të paraqitë si duhet vijën dhe taktikën e Partisë sonë. Kjo punë duhet të bëhet me kujdes nga Drejtoria e Propagandës dhe e Agjitacionit. Ka rëndësi të mbahet timoni drejt në lidhje me shtypin se nga një gabim yni mund të përfitojnë armiqtë e jashtëm imperialistë e revizionistë ose mund të mos orientohen drejt masat e gjera të Partisë e të popullit.

Prandaj, të punojmë me kujdes që ta orientojmë drejt Partinë me anën e shtypit. Atje të reflektohet çdo gjë që është në rrugën e drejtë marksiste-leniniste, në interesin e Partisë, të popullit e të socializmit, ndërsa çdo manovër e revizionistëve, që mund të duket e bukur, por në fakt është e dëmshme, të mos botohet në shtyp dhe për këtë askujt nuk i japim llogari.

Çdo gjë duhet ta gjykojmë thellë, ta peshojmë me kujdes edhe të mirën, edhe të keqen dhe të zgjedhim më të mirën, atë që i shërben punës dhe çështjes sonë.

Këto situata të vështira ne me siguri do t'i kapërcejmë. Prandaj Partia, në radhë të parë, duhet të mobilizohet, të jetë e sqaruar dhe në unitet të plotë, të ngrihet niveli politik dhe ideologjik i saj, të zbatohet

me konsekuencë vija e saj marksiste-leniniste dhe të mobilizohemi totalisht për të realizuar planet tona.

Shokët e Partisë dhe të pushtetit t'i kenë parasysh këto situata dhe t'i kushtojnë kujdes shumë të madh punës bindëse e edukative me masat, t'i bëjnë ato të ndërgjegjshme për realizimin e të gjitha detyrave dhe sidomos për shfrytëzimin e mundësive të brendshme. Kështu, kur themi të hapen toka të reja, të mos i vëmë shpresat vetëm te traktorët. Po të ketë mundësi edhe traktorë do të sjellim, por ne duhet të forcojmë potencialin tonë ekonomik me të gjitha mundësitë që kemi, në mënyrë që të furnizohet rregullisht populli, të mos ndodhemi në krizë, të krijojmë rezerva në çdo drejtim, duke ekonomizuar drejt pasuritë tona.

Në këtë drejtim duhet bërë një program pune nga e tërë Partia dhe nga aparatet shtetërore. Shumë detyra na dalin për këtë çështje në praktikë.

Partia dhe populli ynë janë kalitur me vështirësi, prandaj edhe planet tona kurdoherë janë realizuar. Kështu edhe vështirësitë e reja ne do t'i kapërcejmë, do të vijmë ditë më të mira për Partinë dhe për popullin tonë, se me ne është e drejta, se në botë kemi shumë miq, jo vetëm Kinën e madhe, por gjithë popujt dhe komunistët e vërtetë, për të cilët është e shtrenjtë çështja e lirisë, e pavarësisë dhe e socializmit.

Këto kisha për të thënë. Tani të aprovojmë komunikatën. Përveç kësaj përpara kemi Kongresin IV të Partisë që, siç vendosëm, do t'i zhvillojë punimet në shkurtin e vitit të ardhshëm. Gjatë kësaj kohe Partia duhet të mobilizojë gjithë forcat, të zhvillohet një punë e gjithanshme politike, ideologjike e ekonomike, me

qëllim që në Kongres të shkojmë me unitet të çeliktë marksist-leninist, me detyra të realizuara në të gjitha fushat, të ndërgjegjshëm për të diskutuar me frymë të lartë partie e për të marrë përsipër detyrat e vështira, por të lavdishme që do të na ngarkohen.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

L È N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 19-të V—VIII

1960

RADIOGRAM SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT (21 qershor 1960)	1
TË NDJEKIM SI KURDOHERË NJË VIJË TË DREJTË — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (22 qershor 1960)	2—7
LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT (22 qershor 1960)	8—16
NGA LETRA DËRGUAR LIRI BELISHOVËS MBI QËNDRIMIN QË DUHET TË MBANTE NË PEKIN NDAJ MOSMARRËVESHJEVE TË KRIJUARA MIDIS BASHKIMIT SOVJETIK DHE KINËS (23 qershor 1960)	17—19
RADIOGRAM SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT (23 qershor 1960)	20
RADIOGRAM SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT (24 qershor 1960)	21—22
RADIOGRAM SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT (24 qershor 1960)	23
ASNJË PRESIONI TË MOS I NËNSHTROHEMI — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (24 qershor 1960)	24—27

LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT (25 qershor 1960)	28
RADIOGRAM SHOKUT HYSNI KAPO NË BUKURESHT (25 qershor 1960)	29—30
NGA LETRA DËRGUAR LIRI BELISHOVËS MBI ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SË BUKURESHTIT DHE MBI QËNDRIMIN QË DUHEJ TË MBANTE AJO NË MOSKË (28 qershor 1960)	31—32
NOTË VERBALE DHËNË AMBASADORIT SOVJETIK NË TIRANË MBI QËNDRIMIN ANTIMARKSIST TË AMBASADORIT SOVJETIK E TË ATASHEUT USH-TARAK NË BEOGRAD LIDHUR ME MITINGUN NË SREMSKA MITROVICA (9 korrik 1960)	33—37
NË MBLEDHJEN E BUKURESHTIT NE S'PRANUAM TË SHKELEN NORMAT LENINISTE TË MARRËDHËNIEVE MIDIS PARTIVE — Nga fjala në Plenumin XVII të KQ të PPSH (11 korrik 1960)	38—61
NE DO TË FLASIM NË MOSKË SIÇ NA MËSON MARKSIZËM-LENINIZMI, GJUHË TJETËR PËR NE NUK KA — Fjala e mbylljes në Plenumin XVII të KQ të PPSH (12 korrik 1960)	62—75
TELEGRAM NGUSHULLIMI KQ TË PK TË FRANCES ME RASTIN E VDEKJES SË SHOKUT GASTON MONMUSO (15 korrik 1960)	76—77
LETËR DREJTUAR KQ TË PK TË BS LIDHUR ME INCIDENTIN E KRYER NË AMBASADËN E RP TË SHQIPËRISË NË POLONI (21 korrik 1960)	78—83
KOMITETI QENDROR ËSITË UDHËHEQJA E PARTISË QË GJYKON KURDOHERË DREJT, URTE, QETË, POR KUR DUHET EDHE ASHPËR — Nga biseda me Koço Tashkon (3 gusht 1960)	84—104

- LETËR DREJTUAR KQ TË PK TË BASHKIMIT SOVJETIK LIDHUR ME NDRËRHYRJEN E HAPUR NË PUNËT E BRENDSIEME TË PPSH DHE TË SHTETIT SHQIPTAR NGA DISA FUNKSIONARË TË AMBASADËS SË BS NË TIRANË (6 gusht 1960) 105—110
- LETËR DREJTUAR TË GJITHA ORGANIZATAVE-BAZË TË PARTISË MBI ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SË BUKURESHTIT DHE MBI MOSMARRËVESHJET MIDIS PARTISË KOMUNISTE TË BASHKIMIT SOVJETIK DHE PARTISË KOMUNISTE TË KINËS (9 gusht 1960) 111—119
- UNITETI I VËRTETË ARRIHET E FORCOHET VETËM MBI BAZËN E PARIMEVE MARKSISTE-LENINISTE — Letër dërguar KQ të PK të BS dhe KQ të PK të Kinës (27 gusht 1960) 120—127
- LETËR DREJTUAR KQ TË PK TË BS LIDHUR ME PROPOZIMIN E BËRË NGA KQ I PK TË BS PËR ORGANIZIMIN E NJË TAKIMI TË PËRFAQËSUESVE TË PK TË BS DHE TË PPSH PARA MBLEDHJES SË NËNTORIT TË VITIT 1960 TË PARTIVE KOMUNISTE DHE PUNËTORE NË MOSKË (29 gusht 1960) 128—131
- MBI GABIMET E RËNDA POLITIKE DHE IDEOLOGJIKE TË LIRI BELISHOVËS — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (30 gusht 1960) 132—153
- AI QË NUK KA BESIM TE PARTIA, ARRIN NË KONKLUZIONE DHE NË VEPRIME TË GABUARA — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi veprimet e Koço Tashkos në kundërshtim me vijën e Partisë (31 gusht 1960) 154—167
- PUNA ORGANIZATIVE DUHET TË SHËRBEJË PËR ZBATIMIN E TË GJITHA DIREKTIVAVE E VENDIMEVE TË PARTISË NË FUSHËN POLITIKE, IDEOLOGJIKE DHE EKONOMIKE — Diskutim në Plenumin XVIII të KQ të PPSH (6 shtator 1960) 168—185

NE DO TË SHKOJMË NË MOSKË JO ME DHJETË FLAMURË, POR VETËM ME NJË, ME FLAMU- RIN E MARKSIZËM-Leninizmit — Fjala në Ple- numin XVIII të KQ të PPSH lidhur me gabimet e rën- da në vijë të Liri Belishovës (6 shtator 1960)	186—209
FJALA E Mbylljes në Plenumin XVIII të KQ të PPSH lidhur me qëndrimin armiqësor dhe në opozicion me vijën e Partisë të Liri Belishovës (7 shtator 1960)	210—224
RAPORT NË PLENUMIN XVIII TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI VEPRIMTARINË ANTI- PARTI TË KOÇO TASHKOS» (7 shtator 1960)	225—230
TË RUHEMI NGA PROVOKACIONET DHE TË MBROJMË PARTINË — Diskutim në Plenumin XVIII të KQ të PPSH mbi qëndrimin armiqësor dhe antiparti të Koço Tashkos (8 shtator 1960)	231—234
TË VENDOSËT NË ÇDO SEKTOR KONTROLLI I PARTISË DHE DISIPLINA E FORTË PËR ÇËSHTJET E NAFTËS — Fjala në takimin me një grup përfaqë- suesish të kolektivit punonjës të kombinatit të naftës «Stalin» (13 shtator 1960)	235—253
RADIOGRAM SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK (20 shtator 1960)	254—255
RADIOGRAM SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK (23 shtator 1960)	256—257
RADIOGRAM SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK (26 shtator 1960)	258—259
RADIOGRAM SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK (28 shtator 1960)	260—261
RADIOGRAM SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK (29 shtator 1960)	262—264

RADIOGRAM SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK (30 shtator 1960)	265—267
POPULLI DHE PARTIA JONË DO TË VËNË TË GJITHA FORCAT QË TA RUAJNË E TA ZHVILLOJNË MË TEJ MIQËSINË ME RP TË KINËS — Fjala në pritjen e dhënë nga Ambasada e RP të Kinës me rastin e 11-vjetorit të shpalljes së RP të Kinës (30 shtator 1960)	268—278
LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË (1 tetor 1960)	279—282
RADIOGRAM SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË (1 tetor 1960)	283—287
RADIOGRAM SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK (1 tetor 1960)	288—290
DEKLARATA E MOSKËS TË BËHET SA MË E FORTË, ME BARUT E JO ME PAMBUK — Letër drejtuar shokut Hysni Kapo në Moskë (4 tetor 1960)	291—296
RADIOGRAM SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK (4 tetor 1960)	297—299
RADIOGRAM SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK (6 tetor 1960)	300—301
LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË (7 tetor 1960)	302—307
PËR PROBLEMET E SHKOLLËS TË KUJDESEN JO VETËM ARSIMTARËT, POR GJITHË SHOQËRIA — Fjala e mbylljes në Plenumin XIX të KQ të PPSH (8 tetor 1960)	308—323
RADIOGRAM SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË (9 tetor 1960)	324—325
RADIOGRAM SHOKUT MEHMET SHEHU NË NJU-JORK (9 tetor 1960)	326—327

RADIOGRAM SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË (11 tetor 1960)	328
LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË (13 tetor 1960)	329—331
EDHE PA BUKË TË MBETEMI NE SHQIPTARËT, PARIMET NUK I SHKELIM, MARKSIZËM-LENINIZ- MIN NUK E TRADHTOJMË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (31 tetor 1960)	332—339
KUSH NUK ECËN DREJT NË RRUGËN E PARTISË. AI ME SIGURI DO TË GABOJË — Diskutim në mble- dhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, mbi të metat në punë e qëndrimet e gabuara të Maço Çomos (31 tetor 1960)	340—345
RAPORT I MBAJTUR NË PLENUMIN XX TË KQ TË PPSH MBI TË METAT KRYESORE NË PUNËN E MAQO ÇOMOS (1 nëntor 1960)	346—354
TË JETË OSE JO SHQIPËRIA VEND SOCIALIST. KËTË NUK E VENDOS HRUSHOVI, POR E KA VEN- DOSUR POPULLI SHQIPTAR ME LUFTËRAT DHE ME GJAKUN E TIJ — Nga biseda e zhvilluar me J. Andropovin në Moskë (8 nëntor 1960)	355—357
MARKSIZËM-LENINIZMIN DHE INTERESAT E PO- PULLIT NE DO TI MBROJMË ME ZJARR — Nga biseda e delegacionit të PPSH me përfaqësuesit e PK të BS, A. Mikojan, F. Kozilov, M. Susilov, P. Pospjellov, J. Andropov, në Moskë (10 nëntor 1960)	358—371
NE KEMI LUFTUAR EDHE PA BUKË E TË ZBA- THUR, POR ASNJËHERË NUK JI JEMI PËRKULUR ASKUJT — Biseda e delegacionit të PPSH të kryesuar nga shoku Enver Hoxha, në takimin me N. S. Hru- shovin në Moskë, Kremlin (12 nëntor 1960)	372—381

FJALA E MBAJTUR NË EMËR TË KQ TË PPSH NË MBLEDHJEN E 81 PARTIVE KOMUNISTE DHE PUNËTORE NË MOSKË (16 nëntor 1960)	382—463
RADIOGRAM SHOKUT HYSNI KAPO NË MOSKË (30 nëntor 1960)	464
MIRËMBAJTJA E BANESAVE ËSHTË NJË ÇËSHTJE SHUMË SERIOZE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (10 dhjetor 1960)	465—468
MË SHUMË KUJDES PËR QARKULLIMIN E MONEDHËS — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 dhjetor 1960)	469—472
DISA REKOMANDIME PËR SEKTORIN E NAFTËS — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 dhjetor 1960)	473—478
LËVIZJA PËR SHPIKJE E PËR RACIONALIZIME KËRKON MË TEPËR PUNË IDEOPOLITIKE, ORGANIZUESE E DREJTUESE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 dhjetor 1960)	479—483
RAPORT NË PLENUMIN XXI TË KQ TË PPSH «MBI MBLEDHJEN E PËRFAQËSUESVE TË PARTIVE KOMUNISTE E PUNËTORE QË U BË NË MOSKË NË NËNTOR 1960» (19 dhjetor 1960)	484—573
LUFTA PARIMORE E KONSEKUENTE KUNDËR IMPERIALIZMIT DHE REVIZIONIZMIT KA QENË DHE MBETET RRUGA E PARTISË SONË — Fjala e mbylljes në Plenumin XXI të KQ të PPSH (20 dhjetor 1960)	574—599

Shtyp. Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë, 1975

